



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTARË AUDITIMI NË MINISTRINË PËR
EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

MINISTRIA PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Tiranë, Nëntor 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-17
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	17-21
II.	HYRJA	22
1.	Objekti i auditimit	22
2.	Qëllimi i auditimit	22
3.	Identifikimi i çështjes	23
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	23
5.	Përgjegjësitë e audituesve	24
6.	Kriteret e vlerësimit	24-25
7.	Standardet e auditimit	25
8.	Metodat e auditimit	25-26
9.	Dokumentimi i auditimit	26
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	26
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	26-27
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejttimeve të auditimit	27
2.1	Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit	27-82
2.2	Mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (Përfaqësitë diplomatike dhe Konsullore dhe Aparati MEPJ- së)	82-178
2.3	Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	179-282
2.4	Prokurimet e fondeve publike	283-303
2.5	Vlerësimi aktivitetit të njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	303-322
2.6	Zbatimi rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme	322-347
2.7	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit	347-350
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	350-400
V.	ANEKSE	401-417

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është një nga ministritë e shtetit shqiptarë.

Misioni i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, drejtimi politik i procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Fondet e përfituara për ushtrimin e veprimtarisë janë fondet buxhetore të çelura nga buxheti i shtetit për paga, sigurime, shpenzime operative dhe për investime sipas programeve dhe fondeve të miratuara me ligjet vjetore të buxhetit të shtetit.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- a) Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;
- b) Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;
- c) Mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;
- ç) Mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe të komuniteteve shqiptare jashtë vendit, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre në bashkëpunimin me ministritë përgjegjëse;
- d) Nxiti dhe ndihmon për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës dhe të shqiptarëve jashtë kufijve me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetet ku ata banojnë;
- dh) Promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë;
- e) Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuar në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;
- ë) Bashkërendon procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislationit dhe hartimit të politikave të integritimit, si dhe propozon projekt aktet, që kanë lidhje me procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Nga auditimi i kryer pranë “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” Tiranë, për periudhën 01.01.2020-30.09.2022, lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare, rezultoi se, Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të disa meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen kryesisht me mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, hartimit dhe plotësimit të gjurmës së auditimit, regjistri i aktiveve që ka në pronësi apo posedim, nuk është plotësuar me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Në procedurat e blerjeve me vlera të vogla u konstatuan mangësi dhe vonesa në realizimin e procedurave. Problematika janë konstatuar në zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave. Nga auditimi u konstatuan mangësi në disa raste në llogaritjen e vlerës së kontratave dhe hartimin e kriterëve të kualifikimit. Në procedurat e prokurimit emergjente, u konstatuan një numër tejet i lartë i tyre për periudhën objekt auditimit në total 283 procedura emergjente. Janë konstatuar pasaktësi në shpenzimet e përfaqësive diplomatike, etj.

1.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nga auditimi u konstatuan mangësi dhe ndër gjetjet kryesore citojmë:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>Nga auditimi rezultoj një mungesë përcaktimesh dhe harmonizimi e plotësimesh në bazën ligjore e rregullatorë, për sa i takon shpenzimeve për sigurimin e jetës së përfaqësuesve të shërbimit të jashtëm dhe shoqëruesve të tyre. Kështu, konstatohet se në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, nuk është sanksionuar qartë “Pagesa për sigurim e jetës së familjarëve/shoqëruesve të këtyre diplomatëve”, dhe një gjë e tillë është specifikuar në VKM nr.20 datë 18.01.2017. Nga auditimi i kontratave të lidhura rezultoj se, referuar Ligjit nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” MEPJ mbulon masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për diplomatën e emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor dhe në raste të veçanta, kur është emëruar në zona me rrezikshmëri të lartë i mbulon diplomatit dhe familjarëve të tij sigurimin e jetës, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.</p> <p>E njëjta gjë specifikohet edhe në VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullor të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, MEPJ paguan shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë. Nga auditimi u konstatua se, në 100% të rasteve të audituara siguracioni i jetës ka përfshirë edhe shoqëruesit e përfaqësuesve, por asnjë nga përfaqësitë nuk kishte të shpallur situatë me rrezikshmëri të lartë për periudhën objekt auditimi.</p> <p>Pra mungon një përcaktim mbi autoritetin, rastet dhe procedurat e kryerjes së sigurimit të jete për personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë.</p>		E Lartë	<p>Nga ana e MEPJ të merren masat për harmonizimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi shërbimin e jashtëm, duke marrë masat për një zbatim të plotë dhe efektiv të parimit të ekskluzivitetit, dhe të ndërmerren masat e nevojshme për të iniciuar amendime në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e dala në zbatim të tij, me synim qartësimin dhe sanksionimin e “pagesës së sigurimit të shëndetit”, në funksion të përdorimit me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit.</p>
2.	<p>Nga auditimi u konstatua se, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mungon një rregullim nënligjor mbi përcaktimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - limiteve të qirapagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim; - përcaktimin periodik të kushteve kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit. - gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve, apo mënyrën se si do të kryhet kjo 		E Lartë	<p>Të merren masat nga ana e MEPJ për hartimin dhe miratimin nga ana e Ministrisë të urdhëresave dhe metodologjive të brendshme që përcaktojnë rregullat dhe normojnë kriteret e limitet, gjurmët e auditimit, aprovimet dhe procedurën që duhet zbatuar në lidhje me marrjen me qira të godinave të mabasadeve dhe selive diplomatike apo apartamenteve në përdorim të diplomatëve gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar prej tyre si dhe mënyrës së zbatimit të gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	praktikë (nëpërmjet kontraktimit të një kompanie apo një personi fizik) , referuar nevojave dhe specifikeve të punëve brenda misioneve respektive në përputhje me parimin e 3E- ve, eficientë, efektivitet dhe ekonomicitet,etj.			kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve.
3.	<p>Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të praktikave të vlerësuara për tu audituar nga grupi i auditimit rezultoj mungesë e dokumentacionit justifikues të lëvizjes së automjeteve duke vepruar në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr.507 dt 15.10.2012, ku konkretisht mungonte:</p> <p>Gjurma e urdhrave të titullarëve të përfaqësive për autorizimin e lëvizjes së automjeteve me specifikim të arsyes së lëvizjes dhe itinerari;</p> <p>Gjurma e kërkesës për përdorimin e automjetit nga ana e punonjësve të përfaqësive, ku të jetë specifikuar qartë arsyeja si dhe pamundësia e përdorimit të transportit publik për në destinacion.</p> <p>Gjurma e marrjes së dakortësisë nga ana e titullarit të misionit (konsull/ambasador)</p>		E mesme	Të merren masat për plotësimin e zbatimit të gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve të lëvizjes së automjeteve referuar Urdhërit të Ministrit nr.507 dt 15.10.2012
4.	<p>Nga auditimi rezultoi se, nga ana e MEPJ për hartimin e pasqyrave financiare mungon përditësimi me Udhëzimin aktual në fuqi.</p> <p>Aktualisht operohet bazuar në dispozita ligjore që janë të shfuqizuara dhe jo sipas UMFE nr.8 datë 09.03.2018, i ndryshuar për “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>			Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimet dhe formatet zyrtare aktuale të miratuara nga MEF.
5.	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e të dhënave dhe informacioneve të trajtuara në relacionin shoqëruar të pasqyrave financiare, evidentohet se, nga ana e MEPJ-së në përbërje të llogarisë 212 “Ndërtime dhe konstruksione” përfshihet në masën prej 52,601,250 lekë rikonstruksioni godinës kryer në vitin 2020 dhe në masën 1,543,680 lekë vlera për mbikëqyrje punimesh të këtij rikonstruksioni.</p> <p>Nga auditimi rezulton problematika si më poshtë vijon:</p> <p>MEPJ ka llogaritur për vitin 2020 shpenzime amortizimi mbi vlerën e ndërtesës ndërkohë që këtë aset nuk e disponon as në pronësi dhe as në përdorim.</p> <p>Për sa më sipër nga MEPJ nuk janë kryer procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek MEPJ dhe ato kontabël për përcaktimin e aktiveve afatgjata në përdorim të institucioneve të varësisë dhe të tjera, në kundërshtim me pikën nr.10 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, i ndryshuar, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet problematikë sa i takon kontabilizimit të vlerës së garancisë së</p>			<p>- Nga ana e MEPJ-së, të kryhen procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek ajo;</p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në mënyrë të drejtë duke llogaritur zërat e bilancit në përputhje me VKM nr. 688 datë 14.11.2018 dhe bazës ligjore tatimore në fuqi. Gjithashtu t’i kushtohet rëndësi e veçantë klasifikimit në mënyrë të drejtë të posteve të bilancit. Aktivitet afatgjata në përdorim të njësisë të kontabilizohen në përputhje me procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	ndërtimit (5% i garancisë), ku konkretisht u konstatua mungesë e kësaj llogarie në pasqyrat financiare (po ashtu në PF mungon gjurmë e pranisë së llogarisë 466), as për garancinë e punimeve dhe as për rimbursimin e TVSH nga llogaria e tatimeve nuk është prekur kjo llogari. Nga ana e MEPJ-së kjo vlerë është kontabilizuar në llogarinë 212 të ndërtime konstruksione.			
6.	Nga auditimi konstatohet se, lidhur me rimbursimin e TVSH-së, në aktrakordimin me thesarin pasqyrohet një llogari me përshkrim "rimbursim TVSH" e cila përfaqëson vlerën e TVSH të rimbursueshme për trupin diplomatik të akredituar në vendin tonë, e cila është keq klasifikuar si pjesë e këtij aktrakordimi. Nisur nga fakti që MEPJ përmes Drejtorisë së Protokollit, përgatit urdhër shpenzimet me shumat përkatëse të TVSH-së që do të rimbursohet çdo misioni diplomatik dhe diplomati të akredituar në RSH, nuk mund të trajtohet si e ardhur një shumë që është shpenzim.		E LARTE	- Të merren masat nga MEPJ të rishikohet formati i aktrakordimit të të ardhurave me thesarin duke mos përfshirë shpenzimin konkret në aktrakordimin e të ardhurave të Institucionit, kjo me qëllim të shmangies së keqklasifikimit të të ardhurave
7.	Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimeve të prapambetura llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" përbëhet nga detyrime që stafi dhe të tretët kanë ndaj MEPJ-së. Detajuar në: 489,528 lekë detyrime nga të tretët që i përkasin një periudhe kohore mbi 10 vite, 16,786,553 lekë detyrime të mbartura nga stafi dhe kompani apo persona të tretë, konkretisht detajuar në 10,448,110 lekë detyrime që stafi ka ndaj MEPJ-së dhe 6,338,443 lekë detyrime që kompanitë/të tretët kanë ndaj MEPJ-së; Nga vlerësimet e audituesve të pavarur, gjykohen si më problematike vlerat që të tretët kanë ndaj institucionit ku peshën më të lartë e ka kompania "D. sh.p.k" me vlerën 6,025,225 lekë apo 95% në terma relative të totalit të detyrimeve të të tretëve. Nga ana e MEPJ-së janë ndërmarr nisma për arkëtimin e shumave, por përpjekjet kanë qenë të pamjaftueshme.			Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerave debitore, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.
8.	Nga auditimi rezulton se, nuk janë kryer procedurat e inventarizimit të aktiveve të njësisë, e për pasojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen me siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe transparencën e të dhënave që përbëjnë llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" që gjykuar nga vlera e lartë (127,143,416 lekë) përbën risk të moderuar deri në të lartë.			Të kryhet detajim i përbërjes së llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" duke specifikuar peshën specifike në vlera absolute në bilancin kontabël (dhe relative në shënime shpjeguese).
9.	Nga auditimi u konstatua fenomeni i përsëritur, për të dy vitet objekt auditimi, sa i takon llogarisë 215 "mjete transporti". Në inventarin e automjeteve të MEPJ, rezultojnë 29 mjete, konkretisht 27 automjete dhe 2 motor-cikleta, nga të cilët aktualisht funksional janë vetëm 13 (12 automjete dhe 1 motor-ciklet) dhe vlerë kontabël të mbetur kanë vetëm 6 (1 motor-ciklet dhe 5 automjete) prej 15,059,069 lekë. Sa më sipër konstatohen dy problematika:			- Të vijohet me finalizimin e procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit të automjeteve, duke plotësuar praktikën me ndjekjen e hapave të nevojshme. Kryerja e një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe marrja e një opinioni / relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p><i>Së pari, problemi i vlerës së mbetur.</i> U konstatuan automjete që janë jashtë përdorimit aktualisht por që kanë vlerë kontabël të mbetur (me vit prodhimi të afërt p.sh 2008, 2015) konkretisht Mercedes Benz C Class vit prodhimi 2015 me vlerë të mbetur 2,683,994 lekë dhe ndërkohë që për automjetet që janë në përdorim vetëm 3 prej tyre kanë vlerë kontabël (Toyota Rav 4 me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 3,019,061 lekë, Toyota Prius me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë si dhe Toyota Prius me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë.</p> <p>Në këtë rast kemi të bëjmë me një pakuptueshmëri financiare, janë funksionale automjete pa vlerë kontabël dhe nga ana tjetër vlera mbi të cilën llogaritet amortizimi përshin automjete të cilat nuk janë funksionale, në kundërshtim me SKK5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” pika 43 ku specifikohet se, amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je <u>përgjatë jetës së tij të dobishme</u>. Ku me jetë të dobishme kuptohet: (a) <u>periudha gjatë të cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësia ekonomike</u>.</p> <p><i>Së dyti, mbajtja e automjeteve që janë jashtë përdorimit në inventar.</i> Konkretisht janë 16 automjete dhe 1 motocikletë jashtë funksionit dhe vazhdojnë të mbahen duke ngarkuar në këto kushte pasqyrat financiare dhe dhënë një pamje jo reale të tyre. Si edhe duke konsumuar hapësirën fizike të parkimit të MEPJ-së.</p> <p>Përsa i përket numrit të lartë të automjeteve jashtë funksionit, në vitin 2021 është iniciuar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit por kjo procedurë nuk është vijuar më tej prej Institucionit. Nga ana e MEPJ-së janë hartuar procesverbale vlerësimi për secilin prej këtyre automjeteve, por mungon një relacion final që të ketë vënë në dijeni titullarin apo nga ana e grupit të ngritur të jetë nxjerr një përfundim lidhur me to.</p> <p>Nga ana tjetër, procesverbalet e vlerësimit janë të mangëta, mungon një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe një relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues.</p>			
10.	<p>Sa i takon amortizimit, nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi si më poshtë vijon,</p> <ul style="list-style-type: none"> - llogaritja e amortizimit vjetor është kryer në bazë të normave të amortizimit të VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Mbi normat e amortizimit të mjeteve kryesore”, sipas së cilës ndërtesa amortizohet me normë amortizimi 1.3%, dhe vlerë 5,857,164 lekë, pajisje zytrash me normë amortizimi 5.8% dhe vlerë 7,828,363 lekë, mjete transporti me normë amortizimi 13.8% dhe vlerë 2,078,152 lekë dhe inventari ekonomik 			<ul style="list-style-type: none"> - Të merren masat për llogaritjen e amortizimit të aktiveve në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, pika 36, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik,

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>me normë amortizimi 3% dhe vlerë 541,686 lekë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 36, sipas të cilit ...“<i>Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur; • Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%; • Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; • Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%. 			
11.	<p>Nga auditimi i të ardhurave të shërbimit konsullor dhe reflektimit të tyre në kontabilitet rezulton se, për të dy vitet objekt auditimit, në detyrimin total nga veprimtaria e shërbimit konsullor për tu arkëtuar vijon të mbetet paarkëtuar vlera e detyrimit të D. prej 22,950 lekë mbartuar qysh nga viti 2019.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se, arkëtimet e munguara i përkasin muajit dhjetor plus mbartjen e D.-së, por në dokumentacionin e vendosur në dispozicion këto vlera nuk rakordojnë. Konstatohet diferencë në arkëtimin e munguar prej 408,380 lekë në të dy vitet. Diferencë e cila ka ardhur si rrjedhojë e llogaritjes jo të saktë kryer nga ana e MEPJ-së.</p> <p>Referuar të dhënave vendosur në dispozicion vlera e detyrimit të mbartur për tu arkëtuar, i cili përfshin edhe muajin dhjetor 2022 dhe detyrimin e D. duhet të ishtë 12,580,919 lekë ndërkohë kjo vlerë e llogaritur prej institucionit rezultonte 12,110,539 lekë.</p>			<p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa konkrete për të arkëtuar vlerat e munguara dhe sistemuar diferencat reale të të ardhurave të munguara.</p>
12.	<p>Nga auditimi u konstatua se, nuk kryej rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve, në përputhje dhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme me nr.37, datë 31/12/2014 “<i>Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit</i>”, pika 5 e tij.</p> <p>Konkretisht,</p> <p>a. rakordimi kryhej mes Inspektorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Zyrës së Veprimeve</p>			<p>- Të merren masa konkrete për kryerjen e veprimtarisë operative në përputhje dhe në zbatim me bazën ligjore rregullatore si dhe të zbatohen detyrimet e kontratës mes palëve “P.Sh” sh.a dhe MEPJ-së, sikundër edhe parashikohet në nenin 2 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 2.3 dhe 2.4 e saj.</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>Konsullore për MEPJ dhe ky <u>rakordim nuk kryhej rregullisht</u>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kështu, për vitin 2020 akt rakordimi mban datën 22.02.2021 dhe është kryer vetëm 1 (një) herë. - Për vitin 2021 akt rakordimi për muajt janar-qershor dhe mban datën 09.08.2021 dhe për muajt korrik-dhjetor është kryer pas përfundimit të vitit kalendarik dhe mban datë 17.02.2022. <p>b. Nga auditimi u konstatua se, për të ardhurat e mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave (P.Sh. T.N.T, A.C dhe A.D.E) nga ana e MEPJ-së nuk mbahej asnjë aktrakordimi me degën e thesarit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.37, datë 31.12.2014 me pretendimin e institucionit, se operonin në zbatim të VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” dhe kontratës për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së.</p> <p>Nga auditimi nënvizohet se, VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” pika 1, shkronja b, u drejtohet të gjithë shërbimeve financiare, ndërkohë që Udhëzimi nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit” nxjerr me vonë se VKM ka fushëveprimi specifike dhe i drejtohet pikërisht shërbimit konsullor.</p>			
13.	<p>Në lidhje me rakordimin e vlerave të pasqyruara në situacionin e shpenzimeve, (të paraqitura në akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit Tiranë), për zërin “Shpenzimet korrente” dhe atyre të evidentuara në pasqyrat financiare vjetore të MEPJ, për llogaritë e shpenzimeve për vitin 2021, u konstatua një diferencë ose mungesë rakordimi, në shumën prej 2,701,850 lekë, pasi sipas pasqyrave të llogaridhënies vjetore ato paraqiten në vlerën 408,393,801 lekë, kurse sipas akt rakordimit të nënshkruar me Degën e Thesarit, vlera e tyre është 411,641,651 lekë.</p> <p>Në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore mungon shpjegimi i diferencave dhe i mungesës së rakordimeve, për shpjegimin e arsyeve ngase rezultojnë këto diferenca. Sa më lartë, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkaptulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 37 – 39.</p>			<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të kryer rakordimin dhe unifikim të vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare, me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit të kundërfirmuara me degën e thesarit, si dhe për rastet e mospërputhjeve të bëhen shpjegimet e nevojshme në relacionet që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore. - Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e MEPJ dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
14.	<p>Nga auditimi ka rezultuar se, në MEPJ nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, konkretisht me pikat</p> <p><i>Pika 26 .. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.</i></p> <p><i>Pika 27 ... Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.</i></p> <p><i>Pika 30 ... Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</i></p>			<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në përputhje me UMFE nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
15.	<p>Nga auditimi ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi (2020-09.2022) lidhur me inventarizimin e aktiveve (pavarësisht se nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ-së është miratuar urdhri për iniciimin e inventarizimit, për 2020 <i>Urdhër nr.241 datë 20.05.2020 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve”</i> dhe për 2021 me nr.533 datë 27.10.2020) është operuar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 dhe 74 e tij duke mos kryer procesin e inventarizimit.</p> <p><i>Pika 73 ... Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficientë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.</i></p> <p><i>Pika 74 ... Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjatë materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.</i></p> <p>Si rezultat, gjendja e të dhënave kontabël në pozicionin financiar të vitit 2020-2021, nuk</p>			<ul style="list-style-type: none"> - Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e inventarizimit të aseteve të njësisë dhe çdo aktiv tjetër që ky Institucion disponon/zotëron. - Të kryhet rakordimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	është rakorduar me gjendjen fizike dhe nuk arrijmë të japim dot siguri të arsyeshme mbi pohimet e nevojshme që lidhen me saktësinë e vlerave të aktiveve.			
16.	<p>Nga ana e MEPJ nuk është zbatuar plotësisht VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.</p> <p>Konkretisht për sa i përket zbatimit të detyrimit të pikës nr.2, ...Institucionet e administratës qendrore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë palë pjesëmarrëse aktive në këtë proces dhe janë të detyruara të përgatisin dhe të vënë në dispozicion të AITPP-së të gjithë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e këtij procesi, sipas përcaktimeve në këtë vendim.</p> <p>Pikës nr.9, Çdo institucion i pushtetit qendror dhe çdo njësi e qeverisjes vendore, në strukturën e administratës së vet, krijon, me miratimin e këshillit përkatës, një njësi të veçantë (zyrë ose sektor) me karakter të përkohshëm. Gjatë periudhës së ushtrimit të misionit auditues, u konstatua përmesje e vetëm Pikës nr. 10, të VKM sipërcituar.</p> <p>Në kushtet e sipërcituara, nga ana e MEPJ nuk janë regjistruar pronësitë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.</p>			<p>- Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e regjistrimit të pronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast dhe kryerja e rivlerësimit të tyre në mënyrë që të pasqyrojnë drejt dhe saktë vlerat në pasqyrat financiare.</p>
17.	<p>Nga auditimi i administrimit të karburanteve rezultoi se,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezultojnë mospërputhje në të gjithë rastet për të dhënat, nga krahasimi mes normave të konsumit për çdo mjet referuar manualit të automjeteve dhe normave të specifikuara nga MEPJ; - Mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së; - Nuk janë nxjerrë normativat e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së për vitin 2022, si dhe për periudhën 2020-2021 nuk janë të miratuara me Urdhër të Titullarit, etj. - Nga ana e MEPJ-së, nuk kryhet asnjë verifikim për kilometrat e regjistruara nga makinat e Ministrisë që të shërbejnë për efekt llogaritjesh të karburantit të shpenzuar; 			<p>Të merren masa nga ana e zyrta përgjegjës për :</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktimin e normave harxhimit / konsumit për se automjetet në përdorim në përputhje me bazën ligjore përkatëse. - hartimin në mënyrë periodike procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit të automjeteve e institucionit, si dhe raporteve mbi monitorimin informimin e rezultateve, kuadër të një sistemi kontrolli monitorimi proaktiv; - hartimin dhe miratimin e një manuali për matjen e harxhimit të karburantit të automjeteve sipas tipit të makinave ngarkesës së punëve, për lëvizjet të personave që i përdorin automjetet për nevoja të punës dhe në mënyrë të vazhdueshme kryhen verifikime për kilometrat

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				<p>përkruara nga makinat Ministrisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - plotësimin me dokumentacion domosdoshëm justifikues të këtyre praktikave administrative.
18.	<p>Nga auditimi me përzgjedhje përsa i takon dokumentimit të lëvizjes së automjeteve rezultuan parregullsi e mangësi si vijon,</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Për vitin 2020</i> për 3 automjete të përzgjedhura për testim, në vetëm për 2 prej tyre mund të përcaktohej numri i lëvizjeve dhe rezultoi të jenë kryer 369 lëvizje, për të cilat janë përkruar 38,019.9 km dhe të gjitha pa një destinacion të specifikuar; - <i>Për vitin 2021</i> për 5 automjete të përzgjedhura për testim rezultojnë të jenë kryer 1179 lëvizje gjithsej, për të cilat janë përkruar 95,209 km, të gjitha pa destinacion të specifikuar. - <i>Për vitin 2022 (për periudhën janar-gusht 2022)</i>, për 3 automjete të përzgjedhura për testim rezultojnë të jenë kryer 795 lëvizje, për të cilat janë përkruar 51,364 km pa destinacion të specifikuar - Për të tre vitet e audituara, në asnjë rast nuk ishte shënuar në dokumentin e fletudhëtimit, arsyeja e udhëtimit dhe itinerari, në kundërshtim me kuadrin nënligjor në fuqi. 			<ul style="list-style-type: none"> - Të merren masa të dokumentohen dhe monitorohen me korrektesë lëvizjet e automjeteve me qëllim që të shmangur veprimet që sjellin keqadministrim financiar të fondeve publike.
20.	<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezultoi se për periudhën objekt auditimi, nuk janë hartuar pasqyrat financiare individuale sipas përcaktimeve të kuadrin nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik. Informacioni i përgatitur mbi veprimtarinë e tyre financiare është në trajtën e evidencave mujore dhe përmbledhëse vjetore, të cilat dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropën, dhe shërbejnë si bazë për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara. <i>Sa më sipër</i>, hartimi i këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara nuk ndjek parashikimet e akteve nënligjore dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar. - Monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë për të garantuar vërtetësinë dhe besueshmërinë e këtyre të dhënave dhe transaksioneve kryhet vetëm nga shërbimi i auditimit të brendshëm të kësaj Ministrie. 			<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare individuale nga këto njësi shpenzuese në përputhje me Udhëzimet dhe formatatet zyrtare të miratuara nga Ministria përgjegjëse për financat. - Nga ana e MEPJ-së të përditësohet, standardizohet dhe zyrtarizohet evidencia, e cila do të përdoret për raportimin e shpenzimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në MEPJ.
21.	<p>Nga auditimi rezultoi fenomeni i përsëritur i mos kryerjes së procesit të inventarizimit të plotë të aktiveve të MEPJ si dhe inventarizimi i përgjithshëm i aseteve të përfaqësive diplomatike e konsullore të Shqipërisë jashtë</p>			<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ të merren masat për evidentimin, regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogaritë e aktiveve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>vendit, e për pasojë Audituesit shtetërorë të autorizuar të KLSH nuk mund të shprehen mbi nivelin e saktësisë dhe rregullshmërisë së regjistrimit dhe pasqyrimin në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë. Në vlerësimin e audituesve të pavarur të KLSH, inventarizimi i aktiveve është një element shumë i domosdoshëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të Ministrisë, përmes të cilit vërtetohet saktësia, cilësia dhe ekzistenca fizike e aktiveve në një kohë të caktuar si dhe një mekanizëm i përdorimit në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre, për të evituar riskun e dëmtimit, humbjes dhe keq administrimit të tyre.</p>			<p>afatgjata dhe aktiveve qarkulluese duke garantuar elementet e kontrollit të përvitshëm të ekzistencës së aktiveve nëpërmjet inventarizimit vjetor e periodik, për të evituar riskun e humbjes dhe keqadministrimit të aktiveve.</p>
22.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi kontratat e qirave, për 18 përfaqësitë diplomatike të përzgjedhura për t'u audituar nga ana e grupit të auditimit, u konstatua se,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësive nuk disponohet dokumentacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së ofertës më të mirë për godinat e ambasadave dhe konsullatave si dhe apartamenteve të banimit për përfaqësuesit e shërbimit të jashtëm, apo një analizë e vlerës së tregut që është përdorur për përzgjedhjen e tyre bazuar në koston më të mirë, referuar zonës ku ndodhen ndërtesat dhe sipërfaqeve në dispozicion. - Nuk ka gjurmë të urdhrimit të brendshëm për ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të përzgjedhjes së ambienteve për zyrat qendrore apo apartamentet e banimit, e për pasojë nuk disponohet informacion për mënyrën e testimit, marrjes dhe vlerësimit të disa ofertave dhe më tej përzgjedhjes së ofertës më të përshatshme dhe më të arsyeshme. - Sa i takon <u>kontratave të nënshkruara të qirave</u> (megjithëse një pjesë e tyre janë lidhur në periudha të hershme, përtej periudhës së auditimit), rezultoi se, këto akte zyrtare nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, ato janë hartuar dhe nënshkruar në gjuhët respektive të vendit pritës (Izrael, Greqi, Gjermani, etj), duke vepruar në këto kushte në kundërshtim me kërkesat e legjisllacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kontabilitetin e sektorit publik si dhe përcaktimet e pikës nr. 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, e cila ka parashikuar se <i>...Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund</i> 			<p>Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH jashtë vendit, të merren masa të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryhen përmirësimet ligjore e nënlitore të nevojshme, duke plotësuar bazën rregullatore me të gjithë elementët që parashikon kuadri ligjor për fushën e përgjegjësisë së MEPJ; - Studiohet tregu i pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe operohet sipas formave që parashikon ligji për vijueshmërinë; - Përcaktohen periodikisht kushtet kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit; - Nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip (si varianti origjinal), për rastet e hartimit të këtyre dokumenteve në gjuhë të huaj fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p><i>të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.”</i></p> <p>- Nga auditimi i kontratave të pronësisë për selitë e përfaqësive të Republikës së Shqipërisë në Athinë dhe Stokholm, të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit për shqyrtim e vlerësim rezultojnë se, këto kontrata janë të mbajtura në gjuhën angleze ose gjermane, mungon një kopje dublikatë në shqip, në mospërputhje me pikën nr. 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”;</p> <p>MEPJ për marrjen me qira të ambienteve të banimit dhe të selisë së përfaqësive nuk ka përcaktuar e miratuar rregulla apo manuale të shkruara si do të procedohet për këtë veprimtari të një natyre të veçantë që rregullojnë fushën e përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie.</p>			
23.	<p>Nga auditimi i kontratave të pronësisë të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit për shqyrtim e vlerësim, rezultojnë se, Republika e Shqipërisë disponon pronësitë e selive për përfaqësitë Athinë, Stokholm, Bruksel, Romë, Washington dhe New York.</p> <p>Praktika e kontratave të qirave ishim me mangësi në përbërjen e tyre, konkretisht si më poshtë:</p> <p>30.1 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Izrael Për vitin 2021 Zëri i qirave ka ndikim nga ndryshimi i rritjes së qirasë nga 3% mbi qiranë e vitit pararendës sipas kontratës, në 1.5% për arsye të pandemisë dhe totali i shpenzimeve është 100,895.4 \$ dhe jo 100,909.06 \$ sikundër paraqitur në evidenca, duke marr parasysh se norma e rritjes së rentës është 3% dhe jo 1.5%, e përbërë nga 44,015.4 \$ për seli dhe 56,880 \$ për banim.</p> <p>30.2 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Madrid Për vitin 2021 nga auditimi i kontratave të qirasë vendosur në dispozicion, rezultoi se, totali i shpenzimeve të qirasë për selinë është 28,237.92 Euro, por nisur nga fakti i mos vënies në dispozicion të audituesve shtetëror të autorizuar, të informacioneve specifike mbi përcaktimin e vlerës konkrete të ndryshimit (rritjes së vlerës së qirasë dhe indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) , specifikohet vetëm se, duke nisur nga viti i katërt (nga 2021) qiraja të rritet 10% përveç rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit; por as sa është indeksi i çmimeve të konsumit dhe as sa është impakti i rritjes 10% mbi të), ka bërë të pamundur vlerësimin mbi rregullshmërinë dhe saktësinë e</p>			<p>Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH jashtë vendit, të merren masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për të plotësuar praktikatat dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm; - Të kryhet analiza e tregut në vazhdimësi, nëse ka ndryshim në termat e kontratave apo do të lidhen kontrata të reja, shoqëruar me argumentimin shterues për rastet kur pranohet rinovim me rritje rente/norme qiraje mujore/vjetore. - Në të gjitha rastet të hartohet kopje e dokumentacionit /dublikatë në gjuhën amtare për kontratat e lidhura.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>pagesave të qirasë për godinën/at në përfaqësinë e vendit tonë në Madrid.</p> <p>U kontaktua mungesë e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme dhe mosargumentim se përse është pranuar të rinovohet kontrata me një nivel rritje të përgjithshëm prej 10% përveç rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit.</p> <p>30.3 Gjetje nga auditimi Përfaqësia Paris : Nga auditimi rezultoi se, referuar evidencave të vendosura në dispozicion në qiranë vjetore janë përfshirë rritjet për qiratë e diplomatëve me 3% por në kontratat e qirave mungonte një klauzolë specifikuese e tillë. Në kontratat e banimit nuk specifikohet klauzola e rilidhjes së kontratës pas përfundimit të afatit. Në rastin e përfaqësisë N.Y haset kriptimi i të dhënave.</p> <p>30.4 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia New york Nga auditimi rezultoi se 7 nga 8 kontratat e vendosura në dispozicion janë nënshkruar në vitin 2022 dhe mungon gjurmë justifikuese e dokumentacionit të ri që të jetë i përafuar me vlerat e tregut, për rrjedhë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen mbi rregullaritetin e shpenzimeve të kryera për qeratë për vitet 2020-2021.</p> <p>Në total shpenzimet e qiramarrjes së përfaqësisë New york për vitin 2021 ishin 309,300.72 Dollar, ku shpenzimet e qirasë për apartamente ishin 110,450.70 Dollar, shpenzimet e qirasë së zyrave ishin 84,828.15 Dollar dhe shpenzime të tjera qiraje ishin 84,980.52 Dollar. Grupi auditimit nuk arrin të shprehet dot lidhur me shpenzimet e qiramarrjes së kësaj përfaqësie duke qenë se dokumentacioni i vendosur në dispozicion është i pjesshëm.</p> <p>Nga auditimi u konstatua pagesa e 29,041.35 Dollar për broker fees, por mungonte gjurma justifikuese e tyre. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10, gërma ç, e VKM nr.20 datë 18.01.2017.</p> <p>30.5 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Moskë Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Moskë, rezultoi se shpenzimet e qiramarrjes për vitet 2020 dhe 2021 përfaqësia vijonte ti kishte në vlerën 78.536.41 Euro ku shpenzimet për 1 apartament ishin 44,951.15 Euro dhe për zyra 33,585.26 Euro, si numër ambientesh me qira janë 4 (katër) zyra dhe 1 (një) apartament. Struktura e Ambasadës është 1 (Ambasadori) + 2 (Diplomatë). Në prill të vitit 2018 janë larguar dy diplomat dhe ambasada ka funksionuar me strukturë 1+1 deri në shkurt 2021, kur ka vijuar funksionimin vetëm me pozicionin e Ambasadorit.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se, vijojnë të paguhen shpenzimet e qirasë për 4 (katër) zyra, ku në 2 prej tyre janë depozituar mobiljet dhe orenditë e apartamenteve të diplomatëve të larguar e të cilat nuk kryejnë funksionin si zyra por përdoren në trajtën e magazinave, megjithëse të</p>			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>4 zyrat ndodhen në një godinë duhet rivlerësuar vlera e rentës totale.</p> <p>30.6 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Podgoricë Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Podgoricë rezultoi se, për vitin 2021 totali shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi ishte 46,800 Euro dhe shpenzimet e qiramarrjes së selisë ishin 25,800 €. Në total 72,600 Euro nga 72,900 Euro të raportuara në evidencat periodike të MEPJ-së, një diferencë prej 300 Euro raportuar më tepër.</p> <p>30.7 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Londër Nga auditimi rezultoi se, nuk arrijmë dot të verifikojmë vlerën e plotë të shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi, për shkak se dokumentacioni i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është i mangët. Një pjesë e kontratave të vendosura në dispozicion i përkasin periudhës nga gusht 2021 e në vijim dhe një pjesë i përkasin vitit 2022, për rrjedhojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen me vërtetësi mbi rregullaritetin e shpenzimeve të kryera.</p> <p>Referuar evidencave të dërguara në MEPJ shpenzimet e qiramarrjes së selisë, për vitin 2021 ishin 102,504 £ konvertuar në Euro referuar kursit të cituar në evidenca prej 1£ në 1.15€ rezulton 117,879.60 Euro nga 127,327.70 Euro të raportuara në evidencat dërguar në MEPJ. Në total një diferencë prej 9,448.1 Euro të pa mbuluara me dokumentacion.</p> <p>30.8 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Vjenë Nga auditimi i kontratave të qirasë, rezultoi prania e 4 nga 5 kontratat për ambiente banimi, që përfaqësia disponon; Dy pa emra nominal përfituesi por lidhur në emër të ambasadorit, (Kontratë nënshkruar më 30.11.2016 me afat të papërcaktuar, me vlerë rente 824 € në muaj, Kontratë nënshkruar më 01.03.2017 me afat të papërcaktuar, me vlerë rente 1,297.06 € në muaj); Nisur nga fakti i mos vënies në dispozicion të audituesve shtetëror të autorizuar, të dokumentacionit të plotë justifikues mbi kontratat e qirasë ka bërë të pamundur të auditohej vlera e plotë dhe e saktë e zërit; Prania e kontratave të periudhave të largëta dhe mungesë e gjurmës së përditësimit të informacionit mbi kushtet e vijueshmërisë së tyre.</p> <p>Totali shpenzimeve të qirasë për seli rezultonte në 29,268 Euro nga 28,921.56 Euro të raportuara, me një diferencë prej 346.44 Euro.</p> <p>30.9 Gjetje nga auditimi: Përfaqësia Berlin Nga auditimi i kontratave të qirasë për përfaqësinë Berlin, u konstatua, Prania e një kontrate që i përket një periudhe të largët të nënshkrimit, konkretisht vitet 2000 kur monedha e përdorur nuk ka qenë Euro por 1,800.04 DM/Marka Gjermane dhe mungesa e informacioneve të përditësuara bën të pamundur që audituesit shtetëror të autorizuar të arrijnë të kryejnë konvertimin e vlerave.</p>			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	Mosvënia në dispozicion e kontratave të tjera të qirasë bën të pamundur që audituesit shtetëror të verifikojnë shpenzimet e qiramarrjes për seli si dhe llogaritjen e totalit të shpenzimeve.			
24	<p>Parregullsi në përcaktimin e kriterëve kualifikuese në procedurat e prokurimit publik si:</p> <p>a. Në procedurën Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, DST ka parregullsi përkatësisht në kriteret mbi kapacitetin financiar dhe kapacitetin teknik, si rrjedhojë KVO ka kualifikuar një operator pa vërtetuar që disponon kapacitetet e nevojshme për kryerjen e kësaj shërbimi.</p> <p>b. Në procedurën Blerje dhe vendosje gjeneratori godine, viti 2022, kriterin mbi licencën kategoria 4/c jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e punimeve.</p> <p>c. Në procedurën Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022, kriterin mbi zotërimin të licencës për Klasa A1 “Sigurimi i aksidenteve” dhe Klasa A2 “Sigurimi i sëmundjeve dhe/ose “Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit”, dhe klasa B23 “Për veprimtarinë e sigurimit të jetës”, kritere jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.</p> <p>- Parregullsi në vlerësimin e ofertave në procedurat e prokurimit publik si:</p> <p>a. Në procedurën Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian, viti 2021, KVO ka kualifikuar OE i cili nuk ka dorëzuar kopje të deklaratave të xhiros vjetore sipas kërkesave të DST.</p> <p>b. Në procedurën Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, KVO ka kualifikuar OE i cili nuk ka përcaktuar çfarë punimesh merr secili nga pjesëmarrësit, dhe njëri nga OE pjesëmarrës në BOE, nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes për punën e ngjashme, e cila i përket sektorin privat, në kundërshtim me kriteret/kërkesat e përcaktuara në DST.</p> <p>-Nga auditimi rezultoi se në MEPJ të gjitha dosjet e procedurave të prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit.</p>		E LARTË	<p>- Njësitë e Prokurimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.</p> <p>- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.</p> <p>- Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.</p>

1.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinion mbi përputhshmërinë: (Opinion i Modifikuar/ kualifikuar)¹

Në përputhje me programin e auditimit, për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 deri 30.09.2022 KLSH ka audituar përputhshmërinë mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, mbi zbatimin e legjislacionit për

¹ - Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, vendimin nr. 24, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.2. “Në varësi të masës së mospërputhjes, kjo mund të rezultojë në: (i) Opinion të kualifikuar (nëse rastet e mospërputhjeve janë materiale, por jo të përhapura: “Bazuar në punën e kryer të auditimit, kemi zbuluar se, përveç [përshkruaj përjashtimin....],Informacioni mbi çështjen e subjektit të audituar është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuara [...]”;

realizimin, ekzekutimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, për të vlerësuar nëse çdo aspekt material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë MEPJ, të përshkruar në këtë Raport Përfundimtar, ku është siguruar evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, për dhënien e një opinionin.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se, në veprimtarinë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinion”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar/kualifikuar.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130-Kodi Etik, dhe kemi kryer auditimin në përputhje me ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë” si dhe në zbatim të kërkesave të “Kodit Etik të KLSH”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 56, datë 30.04.2015. Dokumentacioni administrativ, procedurat prokuruese, janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve materiale të vendimmarrjes nga MEPJ, me kriteret e parashikuara.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar MEPJ, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

- Nga auditimi u konstatua një mungesë përcaktimesh dhe harmonizimi e plotësimesh në bazën ligjore e rregullatore, për sa i takon shpenzimeve për sigurimin e jetës së përfaqësuesve të shërbimit të jashtëm dhe shoqëruesve të tyre.

- Mungon një rregullim nënligjor mbi përcaktimin limiteve të qirapagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim;

- Në përfaqësitë diplomatike janë emëruar 28 (njëzetë e tetë) punonjës, në cilësinë e ekspertëve, por nuk rezulton asnjë gjurmë dokumentare, ku të shpjegohet përse konsiderohen raste të veçanta, çfarë njohurish dhe ekspertize zotërojnë, cila është procedura e hapjes së thirrjes për nevoja të rekrutimit të këtyre lloj ekspertëve dhe të dhëna të ngjashme, duke mundësuar rekrutimin e tyre pa një procedurë transparente, në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 dhe nenit 5, të ligjit Nr. 23/2015;

- MEPJ kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregulloreje të brendshme e pa përditësuar të vitit 2010, përkatësisht “Rregullore për disiplinën e brendshme në MPJ”, nr. 478 prot., datë 08.06.2010.

- Rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve nuk kryhet në përputhje dhe zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit”, pika 5 e tij.

- Në disa procedura të prokurimit publik u konstatuan parregullsi në përcaktimin e kriterëve kualifikuese, veprime që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

- MEPJ nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe

menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit edhe pse është hartuar një plan integriteti me urdhrin nr. 150/2022, ky dokument nuk ka të parashikuara të gjithë elementet e kodit të etikes.

- MEPJ nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

-Të gjitha misionet diplomatike dhe postet konsullore funksionojnë pa një strukturë personeli të miratuar, si dhe nuk disponohen marrëveshje të lidhura me shtetet pritëse mbi përcaktimin e numrit të personelit në këto struktura, në kundërshtim me pika 2, neni 21, ligji Nr. 23/2015.

- Nga auditimi me zgjedhje i kryer mbi përfaqësitë diplomatike dhe konsullore rezultuan problematika kryesisht në dokumentacionin justifikues për procedurat e blerjeve dhe në të gjitha rastet nuk është ndjekur një procedurë standarde.

II. Opinioni financiar i modifikuar/kualifikuar².

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore të MEPJ-së (aparatis dhe të konsoliduara), për vitin ushtrimor nga 01.01.2020 -31.12.2020 dhe nga 01.01.2021 – 31.12.2021 ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 130 “Kodi Etik” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, referuar të dhënave për aparatin e MEPJ-së, grupi i auditimit të KLSH për vitin 2021 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit të materialitetit sasior prej 6,615,980 lekë për shpenzimet. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Pasqyrat Financiare nuk janë hartuar sipas formateve të miratuara nga UMFE nr. 8 datë 09.03.2018, i ndryshuar;

- Nga auditimi rezultoi fenomeni i përsëritur i mos kryerjes së procesit të inventarizimit të plotë të aktiveve të MEPJ si dhe inventarizimi i përgjithshëm i aseteve të përfaqësive diplomatike e

² - Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3.5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

konsullore të Shqipërisë jashtë vendit. Këto veprime e mosveprime sjellin si pasojë, cenimin e saktësisë së të dhënave të kontabilizuara të zërave dhe konfirmimin e vërtetësisë së ekzistencës së tyre, (si për aparatit e MEPJ si dhe për informacionin e konsoliduar);

- Nga MEPJ nuk janë kryer procedurat e dhënies së dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek MEPJ dhe ato kontabël për përcaktimin e aktiveve afatgjata në përdorim të institucioneve të varësisë dhe të tjera, në kundërshtim me pikën nr.10, të VKM nr.500, datë 14.08.2001, i ndryshuar, “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”.

- Nga auditimi u konstatua se, nuk kryej rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr.37, datë 31/12/2014 “*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit*” pika 5 e tij.

- Në pasqyrat financiare mungon relacioni shpjegues dhe nuk jepet informacion mbi shifrat e rakorduara me thesarin dhe mungojnë sqarimet për rastet kur të dhënat e pasqyrave financiare vjetore nuk rakordojnë me të dhënat e shpenzimeve dhe të ardhurave të rakorduara me Degën e Thesarit dhe rezultojnë diferenca.

- Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për periudhën objekt auditimi, rezulton se, nuk janë hartuar pasqyrat financiare individuale sipas përcaktimeve të kuadrit nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik. Informacioni mbi veprimtarinë financiare të tyre pasqyrohet në trajtën e evidencave mujore dhe përmbledhëse vjetore, të cilat dërgohen në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila më tej vijon me reflektimin e këtyre të dhënave në pasqyrat financiare të konsoliduara.

- Konsolidimi është kryer pa verifikuar zërat dhe llogaritë kontabile, por vetëm duke përmbledhur të dhënat e njësisve shpenzuese të varësisë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme:

Strukturat drejtuese të Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me aktet nënligjore që rregullojnë sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitetit të institucioneve të sektorit publik, si dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Drejtimi i MEPJ është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose

në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.
Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 894/1 prot, datë 10.10.2022, i ndryshuar, nga data 10.10.2022-16.05.2023, për periudhën nga 01.01.2020 deri më 30.09.2022, u krye auditimi i përputhshmërisë financiare në MEPJ, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Z. M.K, (përgjegjës grupi),
2. Znj. A.K (H) Audituese
3. Znj. B.B, Audituese
4. Znj. E.T, Audituese
5. Z. S.H, Auditues

A. Objekti e auditimit

Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të kryera nga ana e subjektit Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) përgjatë periudhës 01.01.2020 deri më 30.09.2022, nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni:

- janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi mbi bazën e të cilave funksionon veprimtaria e këtij institucioni,

- fondet e akorduara nga buxheti i shtetit në funksion të kësaj veprimtarie, janë përdorur konform akteve ligjore në fuqi dhe në mënyrë efektive.

- dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që MEPJ u ka bërë fondeve të çelura, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij dhe planeve strategjike të miratuara nga strukturat përkatëse.

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

B. Qëllimi i auditimit

Qëllim i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Përmes këtij auditimi synojmë të identifikojmë dhe vlerësojmë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale në transaksionet e kryera, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, ne synojmë të japim një opinion bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, si dhe auditimin e prokurimit të fondeve publike etj.

C. Identifikimi i çështjes:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- a) Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;
- b) Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;
- c) Mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;
- ç) Mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe të komuniteteve shqiptare jashtë vendit, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre në bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse;
- d) Nxit dhe ndihmon për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës dhe të shqiptarëve jashtë kufijve me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetet ku ata banojnë;
- dh) Promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë;
- e) Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuar në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;
- ë) Bashkërendon procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit dhe hartimit të politikave të integritit, si dhe propozon projekt aktet, që kanë lidhje procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

- MEPJ bashkëpunon, bashkërendon dhe harmonizon veprimtarinë me institucionet publike dhe organizmat e tjerë shtetërorë, organizatat e shoqërisë civile dhe me organizmat e tjerë shoqërorë, që veprojnë në fusha apo sektorë të lidhur me zhvillimin rajonal dhe vendor.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike dhe për shkak të rëndësisë së veçantë që ky Institucion disponon.

Grupi i auditimit është fokusuar në detyrat kryesore të administrimit të fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe investimet/prokurimet e realizuara nga këto fonde nga ana e MEPJ-së dhe përfaqësive diplomatike e konsullore që Republika e Shqipërisë ka nëpër botë.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit 894/1 datë 10.10.2022, i ndryshuar.

D. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. MEPJ drejton dhe bashkërendon procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

MEPJ në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtar, pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbron interesat kombëtare si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre.

E. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MEPJ-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vendosjen në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

F. Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit do të bëhen në bazë të procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave në funksion të vetëvlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Financave.

- Kushtetuta dhe Ligji nr.154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit;
- Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të RSH”;
- Ligji nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar;
- Ligjin nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar;
- VKM 816, datë 07.10.2015, Për miratimin e rregullore së shërbimit të jashtëm të RSH;

- VKM nr. 20, datë 18.01.2017, Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misione diplomatike dhe poste konsullore të RSh jashtë vendit;
- Udhëzimi i APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrimit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrimit të realizimeve të prokurimit publik”;
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”;
- Udhëzimi i MF nr.8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”;
- Udhëzimet standarte të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Udhëzimi nr.2, datë 04.02.2014 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal”;
- Udhëzim nr. 6, datë 3.9.1992 “Për Zbatimin e Ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”;
- Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

G. Standardet e auditimit

- Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:
- ISSAI100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm*";
- ISSAI-n 10 Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t;
- ISSAI 30 Kodi Etikës;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*"; etj.

H. Metodatat e auditimit:

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e MEPJ, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të

finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti.

I. Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti përfundimtarë i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), lidhur me vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë në zbatimin e programeve dhe projekteve të realizuara me fondet e Buxhetit të Shtetit duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

- Njohjen me aktivitetin ekonomiko-financiar të MEPJ-së dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara; auditimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2020-30.09.2022; evidentimin dhe auditimin e kontratave të lidhura për punët publike, afatet e tyre, zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave material e monetare; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave; vlerësimin e sektorit të auditit të brendshëm si dhe probleme të tjera që mund të dalin gjatë auditimit;

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- a) Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;
- b) Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;
- c) Mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;
- ç) Mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe të komuniteteve shqiptare jashtë vendit, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre në bashkëpunimin me ministritë përgjegjëse;

d) Nxiti dhe ndihmon për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës dhe të shqiptarëve jashtë kufijve me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetet ku ata banojnë;

dh) Promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë;

e) Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuara në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;

ë) Bashkërendon procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit dhe hartimit të politikave të integrimit, si dhe propozon projekt aktet, që kanë lidhje procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, drejtimi politik i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

a. Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë dhe e operacioneve të kryera nga ana e subjektit MEPJ-së, përgjatë periudhës 01.01.2020 deri më 30.09.2022.

b. Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MEPJ-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit.

c. Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të MEPJ-së me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2020 deri më 30.09.2022, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në këtë periudhë. U audituan procesi i inventarizimit, administrimi i pronave shtetërore nga ana e MEPJ-së, dispozitat ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave u operua me përzgjedhje dosjesh punonjësish lidhur me emërimet dhe largimet nga detyra, plotësia e dosjeve dhe procedurat e kryera që nga momenti i inicimit të procesit të punësimit (vakancat dhe rekrutimi) e deri në finalizim të tij. U auditua rregullshmëria e procesit të përzgjedhjes së përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor.

2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit:

Përputhshmëria ligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, për periudhën 01.01.2020-30.09.2022

Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2020 dhe 2021.

Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Realizimi i planit të buxhetit.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e Ministrisë

Auditimi për vitin 2020, 2021 dhe 9-mujorin e vitit 2022 u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016,

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015.

Ligji nr.88/2019 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”.

Ligj nr.137/2020 datë 16.12.2020 “Për buxhetin i vitit 2021”.

Ligj nr.84/2022 datë 24.11.2022 “Për buxhetin i vitit 2021”.

VKM nr. 557/2020, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të për PBA 2021-2023”

VKM nr. 897/2020, “Për miratimin e dokumentit për programin buxhetor afatmesëm 2021-2023 të rishikuar”

Udhëzimi Standard i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 02.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”,

Udhëzimi nr. 28, datë 10.07.2019, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023”

Udhëzimit nr. 7, date 28.02.2018, “Për procedurat standarde te përgatitjes së Programimit Buxhetor Afatmesëm”.

Aktit Normativ nr. 17/2020, datë 22.04.2020 “Për përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe afateve për përgatitjen e projekt dokumentit te programi buxhetor afatmesëm për vitin 2020”.

Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 20.01.2020, të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit 2020”.

Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Udhëzimi plotësues nr. 4, date 25.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2021”.

VKM nr. 735, date 03.12.2021 Për miratimin e Projekt dokumentit te Programit Buxhetor Afatmesmes 2022-2024.

Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 09.07.2021 “Për Përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm 2022-2024.

Udhëzim nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

VKM nr. 81, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”.

VKM nr. 518, date 29.07.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime te VKM nr. 81, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”.

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 894/1, datë 10.10,2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

Projekt buxheti afatmesëm 2021-2023, 2022-2024, të përgatitur nga MEPJ

Kërkesat buxhetore sipas EMP

Çeljet e buxhetit dhe rialokimet brenda periudhës së auditimit

Raportet e monitorimit të vitit 2020, 2021 dhe 8- mujorit të vitit 2022

Të dhënat e publikuara në faqet zyrtare të MFE dhe MEPJ

Viti 2020

PBA 2021-2023

Planifikimi Buxhetor Afatmesëm i MEPJ për periudhën 2021-2023, është kryer në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore. Planifikimi ka patur në themel objektivat e përcaktuara në Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Orientimi i politikës së jashtme për tre vitet e PBA-së 2021-2023, është fokusuar drejt zgjerimit, intensifikimit, diversifikimit, thellimit dhe pasurimit të marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë në rajon, Evropën dhe vendet e tjera të botës; thellimin e dialogut politik me institucionet evropiane dhe avancimin e mëtejshëm në procesin e integritit evropian të vendit; përfaqësimi dhe pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale ku Shqipëria aderon, në forume shumëpalëshe dhe koalicione ndërkombëtare ku ndajmë interesa dhe vlera të pranuar ndërkombëtarisht; përmirësimi i imazhit të vendit në botë, pasqyrimi i zhvillimit të reformave të gjithanshme në vend, duke synuar tërheqjen e investimeve të huaja dhe adresimin e tyre në sektorë strategjikë të zhvillimit të Shqipërisë si dhe sigurimi i një shërbimi konsullor cilësor, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë vendit.

Kërkesat buxhetore janë përgatitur sipas Udhëzimit nr. 7, dt. 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 28, dt. 10.07.2020, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”.

Kërkesat buxhetore, janë paraqitur brenda tavanëve buxhetore të miratuara në nivel programi për politikën ekzistuese të institucionit.

Me urdhrin nr. 431, datë 15.08.2020 nënshkruar nga titullari i Ministrisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për buxhetin afatmesëm për periudhën 2021-2023 me kryetar Ministrin, koordinator grupi Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretare, Drejtoreshën e Drejtorisë së Financës.

Sipas këtij urdhri, për 4 programet e MEPJ-së janë ngritur 4 nëngrupe të tjera për hartimin e projektbuxhetit afatmesëm për programet që menaxhon MEPJ.

Në zbatim të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023” dhe VKM nr. 577/2020, datë 15.03.2017 “Për miratimin e tavanëve përgatitorë të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, MEPJ, me shkresën nr.9885, datë 01.09.2020 ka dorëzuar në Ministrinë e Financave kërkesat buxhetore sipas programeve të buxhetit afatmesëm.

Gjatë auditimit u morën parasysh tavanet e shpenzimeve të PBA 2021-2023, të miratuara me nr. VKM nr. 577/2020, datë 15.03.2017 “Për miratimin e tavanëve përgatitorë të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023, te detajuara si vijon:

Emri i Grupit	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme			
	Buxheti	PBA 2021 - 2023		
Artikujt	2020	2021	2022	2023

Paga (600-601)	1,130,500.0	1,130,500.0	1,130,500.0	1,130,500.0
Korente të Tjera (602-606)	2,121,600.0	1,551,376.0	1,586,776.0	1,694,778.0
Kapitale (230-232) Të Brendshme	29,500.0	43,000.0	43,000.0	43,000.0
Kapitale (230-232) Të Huaja	134,780.0	80,780.0	80,780.0	80,780.0
Jashtë-buxhetore				
Totali	3,416,380.0	2,805,656.0	2,841,056.0	2,949,058.0

Emri i Programit	Planifikim, Menaxhim, Administrim			
	Buxheti	PBA 2021 - 2023		
Artikujt	2020	2021	2022	2023
Paga (600-601)	80,000.0	80,000.0	80,000.0	80,000.0
Korente të Tjera (602-606)	62,600.0	62,600.0	66,500.0	68,500.0
Kapitale (230-232) Të Brendshme	2,000.0	7,000.0	7,000.0	7,000.0
Kapitale (230-232) Të Huaja				
Jashtë-buxhetore				
Totali	144,600.0	149,600.0	153,500.0	155,500.0

Emri i Programit	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit
-------------------------	--

	Buxheti	PBA 2021 - 2023		
Artikujt	2020	2021	2022	2023
Paga (600-601)	857,500.0	857,500.0	857,500.0	857,500.0
Korente të Tjera (602-606)	1,904,000.0	1,366,276.0	1,396,276.0	1,482,278.0
Kapitale (230-232) Të Brendshme	7,000.0	15,000.0	15,000.0	15,000.0
Kapitale (230-232) Të Huaja				
Jashtë-buxhetore				
Totali	2,768,500.0	2,238,776.0	2,268,776.0	2,354,778.0

Emri i Programit	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ
-------------------------	---

	Buxheti	PBA 2021 - 2023		
Artikujt	2020	2021	2022	2023
Paga (600-601)	139,500.0	139,500.0	139,500.0	139,500.0
Korente të Tjera (602-606)	112,500.0	71,000.0	71,500.0	71,500.0
Kapitale (230-232) Të Brendshme	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitale (230-232) Të Huaja				
Jashtë-buxhetore				
Totali	252,000.0	210,500.0	211,000.0	211,000.0

Emri i Programit	Mbështetje institucionale për procesin e integritimit			
------------------	---	--	--	--

Artikujt	Buxheti	PBA 2021 - 2023		
	2020	2021	2022	2023
Paga (600-601)	53,500.0	53,500.0	53,500.0	53,500.0
Korente të Tjera (602-606)	42,500.0	51,500.0	52,500.0	72,500.0
Kapitale (230-232) Të Brendshme	20,500.0	21,000.0	21,000.0	21,000.0
Kapitale (230-232) Të Huaja	134,780.0	80,780.0	80,780.0	80,780.0
Jashtë-buxhetore				
Totali	251,280.0	206,780.0	207,780.0	227,780.0

Në programin buxhetor 0110 “Planifikim, menaxhim, administrim”, kërkesat buxhetore nuk janë rishikuar në përputhje me politikat ekzistuese si dhe tavanet e rishikuar të programit sipas produkteve të këtij programi.

Programi buxhetor 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, ka përfshirë tërësinë e funksioneve, aktiviteteve dhe shërbimeve që ofrojnë përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore të RSH jashtë vendit, në përputhje me Kushtetutën, normat e të drejtës ndërkombëtare, ligjin për shërbimin e jashtëm, që synojnë nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm, mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare dhe përkujdesin për qytetarët shqiptar kudo që ndodhen.

Në kuadrin e angazhimeve që ka marrë MEPJ për tre vitet e ardhshme, në këtë program krahas kërkesave sipas taveve buxhetore, gjatë fazës së parë të PBA-së, janë paraqitur edhe kostot e produkteve sipas politikave të reja si më poshtë:

Me VKM nr. 116, dt. 13.03.2019, në MEPJ është ngritur struktura e Task Forcës, dhe me urdhrin e Kryeministrit nr. 77, dt. 17.04.2019 është miratuar organika e Task-Forcës e cila është struktura përgjegjëse për kryesimin e OSBE-së dhe konkretisht për kryesimin e:

Grupit të Kontaktit të Mesdheut (GKM); në vitin 2019
O.S.B.E (GKM), në vitin 2020
G.K.A në kuadrin e OSBE-së (GKA), në vitin 2021

Task forca ka patur si synim arritjen e objektivave si:

- Drejtimin me sukses të gjithë procesit të kryesimit të OSBE-së, GKM, GKA sipas periudhave të mësipërme;
- Drejtimin në emër të Kryetarit të radhës, të gjithë veprimtarisë së Kryesimit të OSBE-së, nëpërmjet koordinimit të punës me Misionin e RSH pranë organizatave ndërkombëtare si dhe ON në Vjenë;
- Mbështetjen e përfaqësimit të RSH si Kryetare e Radhës në OSBE-së;
- Drejtimin dhe koordinimin e punës ndërmjet MEPJ, institucionit të Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe institucioneve të administratës shtetërore shqiptare për periudhën e kryesimit të OSBE-së, GKM-së dhe GKA-së;

- Hartimin dhe propozimin për miratim, ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme të prioritetëve dhe qëndrimeve të Kryesimit të OSBE-së, GKM-së, GKA-së;
- Evidentimin dhe përcimin e vlerave më të mira të politikës së jashtme të RSH në ruajtjen dhe forcimin e paqes dhe të sigurisë, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve në rajonet ku vepron OSBE-ja, në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër janë paraqitur kërkesa për një rritje të financimit për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në lidhje me zbatimin e kësaj politike të re të programit, në vlerën 125,000,000 lekë për vitin 2020, të paraqitur në Formatin 3 “Politikat e reja”(Faza e Parë). Kërkesa është marrë në konsiderate vetëm për 19 milion lekë.
- Përbushje e angazhimeve në kuadër të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare nëpërmjet një politike pro aktive.

Për gjatë vitit 2021 MEPJ ka pasur si angazhim që Shqipëria të bëhet pjesë e një prej 10 vendeve anëtare jo të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB, për të shërbyer përgjatë periudhës 2022-2023. Për këtë arsye ka qenë e nevojshme që pranë MEPJ të funksionojë një Taskë Forcë e posaçme në kuadër të fazës përfundimtare dhe për performancën e Shqipërisë në KS. Gjithashtu, misioni ynë në Nju Jork të përforcohet me staf të mjaftueshëm diplomatik dhe teknik, për të përballuar detyrat që dalin nga angazhimi në Këshillin e Sigurimit si një vend jo i përhershëm, por edhe për realizimin e detyrave në kuadër të veprimtarisë së OKB. Për realizimin e këtij objekti gjatë Fazës së Parë të PBA-së janë llogaritur kostot përkatëse në formatin për **politikat e reja, të cilat nuk janë marrë në konsiderate në tavanet e rishikuara të PBA-së për mos justifikim të vlerës.**

Titulli i Gjetjes 1:	<i>Mos justifikim i buxhetit të kërkuar</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MEPJ, për financimin e task forcës së ngritur me VKM nr. 116, dt. 13.03.2019, “Për ngritjen e task-forcës pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të njesisë pranë misionit të Republikës së Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare në Vjenë, përgjegjëse për kryesimin e grupit të kontaktit të mesdheut, O.S.B.E dhe G.K.A” është kërkuar një rritje e buxhetit prej 125,000,000 lek e cila nuk është pranuar nga ministria e financave por është miratuar vetëm në vlerën prej 19,000,000 lekë duke mos e justifikuar vlerën e kërkuar nga MEPJ.
Kriteri:	VKM nr. 897/2020, “Për miratimin e dokumentit për programin buxhetor afatmesëm 2021-2023 të rishikuar”
Ndikimi/Efekti:	Financim pjesor i strukturës
Shkaku:	Mos hartim si duhet i planit buxhetor
Rekomandimi:	Nga ana e MEPJ-së në çdo rast të analizohen me saktësi elementet e buxhetit për çdo zë të tij duke argumentuar shtesat dhe pakësimet me qëllim rritjen e efektshmërisë së planifikimit dhe realizimit të tij dhe mirëadministrimin e buxhetit të akorduar.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Në vijimësi

Për përmirësimin e strukturës dhe të metodave të punës të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj të gjithë personave të interesuar tashmë me VKM janë hapur një sërë konsullatash, **por që nuk janë bërë efektive për mungesë të fondeve financiare.**

Hapja efektive e Konsullatave të reja të përgjithshme realizohet në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare me qëllim intensifikimin dhe rritjen e marrëdhënieve politike, diplomatike, kulturore dhe ekonomike me shtetet ku janë propozuar të hapen; forcimin e lidhjeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë në ato rajone me shtetin amë; ofrimin e shërbimeve konsullore për shtetasit shqiptarë që jetojnë në ato zona, si dhe ofrimin e shërbimeve konsullore për shtetasit e huaj të vendeve që janë nën juridiksionin e këtyre posteve konsullore, të cilët kanë nevojë për këto shërbime.

Ulqin:

Konsullata e Përgjithshme në Ulqin brenda shtrirjes së saj gjeografike që mbulon, do të kujdeset për shtetasit shqiptarë që janë rezidentë në këtë zonë apo ndodhen atje për qëndrim të përkohshëm. Po ashtu, ajo do të mundësojë dhe lehtësojë kontaktet e institucioneve shqiptare me autoritetet vendore në Mal të Zi. KP do të promovojë marrëdhëniet ekonomike, kulturore, si dhe në promovimin e imazhit të Shqipërisë në zonën që mbulon.

Strugë:

Konsullata e Përgjithshme në Strugë brenda shtrirjes së saj gjeografike që mbulon, do të kujdeset për shtetasit shqiptarë që janë rezidentë në këtë zonë apo ndodhen atje për qëndrim të përkohshëm. Po ashtu, ajo do të mundësojë dhe lehtësojë kontaktet e institucioneve shqiptare me autoritetet vendore në MV. KP do të promovojë marrëdhëniet ekonomike, kulturore, si dhe në promovimin e imazhit të Shqipërisë në zonën që mbulon.

Libani:

Vlerësohet se hapja e një Konsullate të Përgjithshme në Beirut do të kontribuonte direkt në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, duke i dhënë një shtysë të rëndësishme bashkëpunimit ekonomik, shkëmbimeve tregtare, si dhe atyre kulturore.

Hapja e Konsullatës së Përgjithshme në Guanzhou/Kinë është në interes të veçantë për biznesmenët shqiptarë që operojnë; të shtetasve shqiptar për asistencë në probleme me dokumentacionin ose të tjera probleme konsullore; për shtetasit kinez në drejtim të shërbimeve konsullore, veçanërisht në lëshimin e vizave dhe shërbimeve të tjera konsullore, pasi distanca me kryeqytetin Pekinin ku ne kemi ambasadë është 2120 km larg; do të këtë impakt pozitiv në aspektin turistik, jo vetëm në tërheqjen individuale apo grupe turistësh kinez, por edhe në paketat turistike rajonale që mund të krijohen dhe ofrohen, përfshirë edhe Shqipëria.

<i>Titulli i Gjetjes 2:</i>	<i>Mungesë efektiviteti i posteve konsullore të hapura</i>
<i>Situata:</i>	Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MEPJ, për përmirësimin e strukturës dhe të metodave të punës të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj të gjithë personave të interesuar, janë hapur 4 qendra konsullore në Ulqin, Strugë, Guanzhou dhe në Liban, por që nuk janë bërë efektive për mungesë të fondeve financiare. Mos bërja efektive e katër posteve konsullore në Ulqin, Strugë, Guanzhou dhe në Liban tregon një moskoordinim të politikës së jashtme të MEPJ me Qeverinë Shqiptare
<i>Kriteri:</i>	VKM nr. 735, date 03.12.2021 Për miratimin e Projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 09.07.2021 “Për Përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm 2022-2024.
<i>Ndikimi/Efekti:</i>	Shërbim jo funksional në postet konsullore të përcaktuara
<i>Shkaku:</i>	Mungesë likuiditeti
<i>Rekomandimi:</i>	Nga ana e MEPJ-së të merren masa që në çdo rast përpara inicimit të një procesi zgjerimi apo shtimi në poste konsullore apo stafi në postet ekzistuese të miratohen dhe fondet përkatëse. Të merren masa për koordinimin e politikave të jashtme të ndërmara nga MEPJ dhe qeveria Shqiptare me qëllim mbarvajtjen e tyre.
<i>Rëndësia:</i>	E mesme
<i>Afati zbatimit:</i>	Në vijimësi

Programi buxhetor 01150 “Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritit”

Programi buxhetor 01150 “Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritit” në PBA 2021 – 2023, synon mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Qëllimi i politikës së këtij Programi është fillimi i negociatave të anëtarësimit dhe demonstrimi përpara shteteve anëtare i aftësisë së Shqipërisë për të plotësuar kriteret e anëtarësimit.

Programi mbështetet në shtyllat e mëposhtme:

Zhvillimi i negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së;

Menaxhimi i fondeve të BE-së;

Përkthimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe;

Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi procesin e anëtarësimit.

Në realizimin e të gjitha këtyre shtyllave, Programi ka mbështetur bashkëpunimin me shoqërinë civile në procesin e anëtarësimit dhe ka synuar mbështetjen e politikave të barazisë gjinore.

Objekivi i këtij Programi është në përputhje me Programin e Qeverisë 2017 – 2021, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2015 – 2020, sikurse miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 11.5.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim”.

Realizimi i objektivit të këtij Programi, do të kryhet nëpërmjet një produkti të vetëm me emërtimin “Aktivitete për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian”. Ky produkt përfshin në vetvete një numër relativisht të madh aktiviteteve që do të kontribuojnë të gjithë së bashku në realizimin e objektivit të Programit, d.m.th në anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në lidhje me kostot e produktit “Aktivitete për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian” vërejmë se numri i aktiviteteve në këtë produkt është planifikuar të rritet me vetëm 1 aktivitet shtesë nga viti 2020 në vitin 2021 dhe më pas mbetet i pandryshuar. Ndërkohë kostoja për njësi e produktit është rritur me rreth 5% në vitin 2021, rreth 1% në vitin 2022 dhe rreth 19% në vitin 2023. Kjo rritje ka pasqyruar rritjen e tavanit buxhetor në artikullin 602 për këtë program buxhetor, veçanërisht në vitin 2023.

Edhe pse nuk kemi një rritje të numrit të aktiviteteve për afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Evropian vihet re një rritje e kostos për këto aktivitete me 19%.

Kërkesë shtesë për projektin SEI.

Për të mbështetur hapjen e negociatave të anëtarësimit, Bashkimi Evropian do të hapë një asistencë të konsiderueshme në rreth 2 milion euro për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministritë e linjës dhe strukturat negociuese në tërësi.

Kjo asistencë do të jepet në formën e një projekti të veçantë të emëruar “Mbështetje për Integrimin Evropian (Support for European Integration).

Për këtë qëllim, Delegacioni i Bashkimit Evropian ka iniciuar tashmë procedurën e tenderimit të projektit në përputhje me procedurat e Bashkimit Evropian.

Aktualisht, faza e parë e tenderit ka përfunduar dhe janë përzgjedhur kompanitë që do të marrin pjesë në fazën e dytë të tenderit. Më datë 15 shtator 2020 janë paraqitur dokumentet e tenderit nga kompanitë e përzgjedhura në fazën e parë të tenderit, për të mbështetur me ekspertizë por edhe me mjete financiare si zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ashtu edhe ngritjen dhe funksionimin e strukturave negociuese. Ky projekt do të vazhdojë për dy vjet deri në mes të vitit 2023.

Në këtë kuadër ka patur kërkesa për një shtesë fondi total prej 241,760,000 Lekë për tre vitet 2021 – 2023. Ndërkohë, për vitin 2020, janë parashikuar në total 60,460,000 Lekë, nga të cilat, 60,000,000 Lekë janë financim grant i huaj i dhënë nga instrumenti IPA, ndërsa pjesa tjetër prej 460,000 Lekë janë financim i brendshëm që do të shërbejë për të mbuluar me TVSH shpenzimet që parashikohen nga projekti në përputhje me kontratën përkatëse.

Kërkesë shtesë për projektet: Asistencë teknike për MEPJ dhe ministritë e linjës për proceset e programimit dhe monitorimit të projekteve IPA/PPF dhe Asistencë teknike për MEPJ dhe ministritë/institucionet pjesëmarrëse në programet Evropiane

Gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë së COVID-19, janë evidentuar disa vonesa në realizimin e aktiviteteve të të dy projekteve. Si rezultat, projekti Asistencë teknike për MEPJ dhe ministritë e linjës për proceset e programimit dhe monitorimit të projekteve IPA, është shtyrë deri në fund të muajit Janar 2021, ndërsa projekti Mbështetje për Programet Evropiane do të kryejë aktivitetet brenda të njëjtës periudhë siç ishte parashikuar.

Nisur nga shumat e alokuara si financim i huaj për këtë program, dhe parashikimet vjetore sipas marrëveshjeve financiare dhe kontratave të nënshkruara, kanë mbetur jashtë programit, pa pasqyruar në formatin 2, shumat e financimit të huaj (IPA) si më poshtë:

Projekti	Viti 2021
Asistencë teknike për MEPJ dhe ministrinë e linjës për proceset e programimit dhe monitorimit të projekteve IPA /PPF	3 000 000 ALL
Asistencë teknike për MEPJ dhe ministrinë/institucionet pjesëmarrëse në programet Europiane	36 000 000 ALL

Kërkesë shtesë për projektin e Asistencës Teknike ADRION

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), në cilësinë e Autoritetit Kombëtar për Projektin e Asistencës Teknike të programit Transnacional ADRION, i financuar nga Bashkimi Evropian, përfiton një shumë grant prej 186,495.00 Euro nga ku 27,602.00 Euro është kosto bashkëfinancimi. Projekti i Asistencës Teknike ka filluar të zbatohet përmes një kontrate granti nga data 14 korrik 2016 dhe do të vazhdojë të zbatohet deri më 13 korrik 2021. Objektivi i përgjithshëm i projektit të Asistencës Teknike është forcimi i mekanizmit të zbatimit të programit Interreg ADRION në kohë dhe në mënyrë efikase.

Në përputhje me Manualin e Asistencës Teknike së programit ADRION dhe me Nenin 2 (29) të Rregullores (BE) Nr. 1303/2013, Autoriteti Menaxhues i programit ADRION kërkon çdo vit kuotën e bashkëfinancimit si pjesë e kontributit kombëtar në buxhetin kryesor të Asistencës Teknike. Për vitin 2019 kjo shumë për Republikën e Shqipërisë ishte 7.469,15 Euro. Për shkak të mosparashikimit të kuotës së bashkëfinancimit për vitin 2019 në buxhetin e MEPJ, **ky detyrim vjetor nuk është ekzekutuar**. Kjo vlerë automatikisht do të mbartet në detyrimin e vitit pasardhës 2020. Në kushtet kur Kapitulli 03 për vitin 2020 nuk mund të rishikohet, është kërkuar si kërkesë shtesë për vitin 2021 në kuotën e bashkëfinancimit Kapitulli 03 të projektit të Asistencës Teknike të programit ADRION.

Konkretisht, nisur nga shumat e financimit të huaj për këtë program, dhe parashikimet vjetore sipas marrëveshjes financiare dhe kontratës së nënshkruara, kanë mbetur jashtë programit, pa pasqyruar në formatin 2, shumat e Kuotës së Bashkëfinancimit (IPA) për produktin 11 “Asistencë teknike IPA CBC ADRION/Asistencë teknike Programi Adrion” si më poshtë:

Projekti i Asistencës Teknike ADRION	Viti 2021
Parashikimi në PBA Kapitulli 03 Asistencë teknike IPA CBC ADRION	800 000 ALL
Kërkesë shtesë Kapitulli 03 Asistencë teknike IPA CBC ADRION	1 000 000 ALL

Kërkesë shtesë për Projektin Platform/PANORAMED

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është partnere në Projektin Panoramë i cili bashkëfinancohet nga Aksi 4 – Qeverisja e Programit Interreg Mesdheu 2014 – 2020 me një vlerë totale prej 9 milion Euro (ERDF + IPA + bashkëfinancim). Në këtë projekt marrin pjesë 12 shtete të rajonit të Mesdheut, mes të cilëve edhe Republika e Shqipërisë. Projekti në vetvete ka për qëllim zbatimin e politikave të përbashkëta në bashkëpunim me projektet strategjike në

zonën Euro-Mesdhetare, duke u përqendruar veçanërisht në tema relevante për zonën siç janë a) Mbikëqyrja detare dhe b) Turizmi bregdetar e detar.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), në cilësinë e Autoritetit Kombëtar për Projektin Platformë PANORAMED, i financuar nga Bashkimi Evropian, përfiton një shumë grant prej 184,014.00 Euro nga ku 27,602.00 Euro është kosto bashkëfinancimi, e shtrirë në periudhën zbatuese 2017 – 2022.

Në përputhje me kontratën e shërbimit mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Oficerit që mbështet koordinatoren kombëtar të këtij projekti “Aksi 4 – Përforcimi i Qeverisjes së Mesdheut” Projekti Platform PANORAMED 2017 – 2022, i programit Transnacional V-B Mesdheu, lind nevoja e kryerjes së pagesës mujore kundrejt këtij oficeri. Për shkak të vonesave në certifikimin e shpenzimeve të kryera deri më tani për këtë projekt si dhe kuotës së ulët të bashkëfinancimit për vitin 2020 në buxhetin e MEPJ, ka pasur vonesa në shlyerjen e pagave ndaj këtij punonjësi. Gjithashtu, ky projekt përfundon në fund të vitit 2022 ndërkohë që kuota totale e bashkëfinancimit prej 27,602.00 euro është reduktuar vetëm në vlerën e 1 566 000 Lekë (bashkëfinancimet e viteve 2019 – 2020) duke lënë një diferencë prej përafërsisht 18 000 000 Lekë për vitet 2021 dhe 2022.

Në këto kushte janë paraqitur kërkesa shtesë në Kapitullin 03 për vitin 2021 të këtij projekti si më poshtë:

Projekti Platform/PANORAMED	Viti 2021
Parashikimi në PBA Kapitulli 03 Projekti Platform/PANORAMED	800 000 ALL
Kërkesë shtesë Kapitulli 03 Projekti Platform/PANORAMED	500 000 ALL

Nga krahasimi i të dhënave të tavaneve të kësaj VKM, rezulton se financimi i shpenzimeve nga buxheti i shtetit për vitin 2021, 2022, 2023 planifikohet të jetë në rritje relativisht të vogël kundrejt vitit 2020, me rreth 17%.

Për auditimin e planifikimit dhe realizimit të fondeve buxhetore grupi i auditimit u bazua në Urdhrin e ministrit nr. 431, datë 15.08.2020 “Për ngritjen e GMS për planifikimin e Projekt Buxhetit Afat Mesëm”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr. 28 datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”.

Faza e II-të e PBA-së janë dërguar në MFE me shkresën përkatëse nr. 9885, datë 01.09.2020 dhe nga ku konstatojmë sa më poshtë vijon:

Në programin e PBA-së, në mënyrë të detajuar, është hedhur informacioni për secilin program buxhetor si: Deklarata e Politikës së Programit, planifikimi i projekteve, planifikimi i produkteve dhe aktiviteteve të programit, me kostot përkatëse sipas viteve buxhetore. Në zbatim të udhëzimit kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese janë gjeneruar edhe përmes sistemit AFMIS.

Mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2020

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimit dhe fuqizimit të

diplomacisë ekonomike si dhe bashkërendimin e ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian. MEPJ ushtron veprimtarinë e saj sipas fushave të përgjegjesisë shtetërore si:

- Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikës e jashtme të shtetit shqiptar.
- Shpreh dhe mbron interesat e shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.
- ✓ Mbështet Kuvendin e RSH-së, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e RSH-së në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme.
- ✓ Mbron të drejtat e shtetasve shqiptar dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shtetit dhe Diasporës.
- ✓ Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuar në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ndërkombëtare në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe investimet strategjike në RSH.
- ✓ Bashkërendon procesin integrimit të RSH-së në Bashkimin Evropian nëpërmjet përafrimit të legjislacionit, hartimit të politikave të integrimit, bashkërendimit të ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian dhe informimit të publikut për këtë proces.
- ✓ Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën e Bashkimit Evropian për RSH-në, sipas përparësive të vendit, në kuadër të procesit të integrimit evropian si dhe bashkërendon e ndjek nënshkrimin e marrëveshjeve në lidhje me këto ndihma financiare.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2020 menaxhon fondet publike në katër programe buxhetore:

- Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, përfshin shpenzimet për aktivitetet me karakter mbështetës të institucionit.
- Programi “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, përfshin shpenzimet për funksionimin e përfaqësive të RSH-së në botë.
- Programi “Aktivitet diplomatik dhe konsullor i MPJ”, përfshin shpenzimet për aktivitetet e drejtorive politike në MEPJ të cilat hartojnë dhe zbatojnë politikën e jashtme.
- Programi “Mbështetje institucionale për procesin e integrimit”, përfshin shpenzimet që kanë të bëjnë me drejtimin dhe bashkërendimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

Realizimi i buxhetit për vitin 2020 paraqitet në masën 92.3% Sipas programeve buxhetore realizimi i buxhetit jepet në tabelën e mëposhtme:


Në milionë lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti përfundimtar. vitit 2020	Realizimi i periudhën janar-dhjetor 2020	Realizimi në %
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	135,800.0	118,295	87.1
2	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,683,451	2,624,316	97.8
3	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	237,500.0	164,002	69.1
4	Mbështetje institucionale për procesin e integrimit	247,580	144,588	58.4
	Totali:	3,273,380	3,051,200	92.3


Struktura e shpenzimeve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për çdo program, sipas buxhetit të miratuar për vitin 2020 dhe realizimit faktik, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Nr.	Emri i programit	Struktura e shpenzimeve sipas buxhetit përfundimtar 2020	Struktura e shpenzimeve sipas realizimit të buxhetit për vitin 2020
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	4.1	3.9
2	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	81.2	86.0
3	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	7.2	5.4
4	Mbështetje institucionale për procesin e integrimit	7.5	4.7
	Totali:	100	100

Në përqindje



Struktura faktike e shpenzimeve sipas programeve për vitin 2020



Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

1. Programi 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim” përfshin shpenzimet për aktivitetet me karakter mbështetës të institucionit të cilat realizohen nëpërmjet planifikimit, menaxhimit eficient dhe monitorimit të burimeve financiare të MEPJ-së, me synim mbështetjen financiare dhe njerëzore

për realizimin e politikave të institucionit, duke siguruar një lidhje efikase midis MEPJ-së dhe përfaqësive diplomatike. Tërësia e aktiviteteve të këtij programi buxhetor ka për qëllim mbështetjen e strukturave të shërbimit të jashtëm të RSH-së në funksion të realizimit të misionit të MEPJ-së.

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 3.9 përqind të totalit të shpenzimeve të institucionit për periudhën 12 mujore. Sipas zërave të strukturës buxhetore realizimi i buxhetit për vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 97.9 përqind
- Shpenzime të tjera operative 74.8 përqind
- Shpenzime kapitale 88.5 përqind
- Gjithsej: 87.1 përqind

Për vitin 2020 në këtë program, janë parashikuar 6 produkte, të cilat rezultojnë të realizuara si në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2020 (në 000 lekë)	Realizimi për periudhën janar – dhjetor 2020		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i produktit
Akte Ligjore dhe Nënligjore të hartuara	71,650	69,775	97.4	Plotësisht
Punonjës të rekrutuar dhe të trajnuar	2,000	1,968	98.4	Plotësisht
Detyrime kontraktuale	45,150	37,692	83.5	Plotësisht
Misione auditimi të kryera sipas standardeve	3,000	1,750	58.3	Plotësisht
Aktivitete protokollare dhe veprimtari protokollare sipas Ceremonialit të RSH-së	12,000	5,339	44.5	Plotësisht
Pajisje zyre të blera për aparatin e MEPJ	2,000	1,771	88.6	Plotësisht
TOTALI:	135,800	118,295	87.1	

Siç vihet re dhe nga tabela të gjitha zërat kanë një realizim të plotë por në vlerë numerike dukshëm më të vogël se planifikimi duke treguar në një planifikim të fryrë të zërave.

Produktet e programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim” paraqiten me status realizimi të plotësuar. Objektivat e programit “Planifikim menaxhim, administrim”, janë përcaktuar si më poshtë:

- Përmirësim i planifikimit të burimeve financiare dhe materiale si dhe rritja e efektivitetit në administrimin e tyre.
- Menaxhim efektiv dhe racional i burimeve njerëzore dhe teknologjisë së lartë për të rritur reagimin dhe cilësinë e shërbimit diplomatik. Përmirësim i teknologjisë së informacionit e komunikimit nëpërmjet rritjes së sigurisë dhe cilësisë së transmetimit të informacionit e komunikimit, mbështetjes me teknologji të reja si dhe garantimit të funksionimit të sistemeve të pajisjeve në përdorim.
- Rritja e vazhdueshme e cilësisë së punës dhe veprimit të burimeve njerëzore të shërbimit të jashtëm, përmes kurseve të përditësimit të dijeve, përmes trajnimit dhe cikleve të kualifikimeve të përgjithshme dhe të posaçme, brenda dhe jashtë vendit si dhe në lidhje me botimet konvencionale (libri, dokumenti, biblioteka MEPJ në shërbim të punës së diplomatit) dhe ato

dixhitale elektronike në synim të rritjes së studimit, analizës dhe parashikimit të aksionit tonë në politikën e jashtme.

- Përmirësim i kushteve për ruajtjen, administrimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit historik arkivor 100-vjeçar dhe atij të krijuar rishtazi nga shërbimi i jashtëm, në mbështetje të interesave të politikës së jashtme shqiptare dhe interesave studimore të publikut.
- Menaxhim me efektivitete të fondeve buxhetore për realizimin e buxhetit vjetor të planifikuar për prokurimin e fondeve për mallra dhe shërbime në funksion të nevojave të institucionit duke përmirësuar metodat e vlerësimit të burimeve financiare, në respekt të parimeve të transparencës e të ligjshmërisë për një administrim sa më të saktë të vlerave materiale dhe monetare.
- Përmirësim i punës në mbarëvajtjen e aktivitetit diplomatik dhe në veçanti të vizitave zyrtare jashtë dhe brenda vendit, të konferencave brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrje në samite dhe ministeriale të nivelit të lartë.
- Rritja e cilësisë së veprimtarisë audituese në funksion të përmirësimit të sistemeve të kontrollit të brendshme në MEPJ.
- Përmirësim i ambienteve dhe kushteve të punës në MEPJ.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërme rezultojnë të realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Trajnimi i stafi të MPJ-së për të mundur zhvillimin e kapaciteteve profesionale me qëllim garantimin e cilësisë së punës.
- Mbarëvajtja e vizitave zyrtare të delegacioneve të larta shtetërore.
- Përgatitja e një sërë raportesh mbi konsulencat juridike, përfaqësimi në organet gjyqësore, prokurorisë dhe përbarimit.
- Plotësimi i strukturës së personelit të MEPJ me prurje të reja dhe transferimit nga përfaqësitë diplomatike.
- Përgatitja e raporteve buxhetore: raporteve të Monitorimit, raporteve të detyrimeve të prapambetura, raporte të tjera në zbatim të Udhëzimit nr. 2 të MF Për zbatimin e buxhetit”, raporte financiare /Bilanci në kuadër të planifikimit dhe analizave të burimeve financiare të institucionit, PBA 2021-2023 etj.
- Çelja e programit të Akademisë Diplomatike Kombëtare me synim edukimin e përgjithshëm të diplomateve të së nesërme por dhe rritjen e njohurive të diplomateve për historinë e politikës së jashtme të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2020, buxheti i programit “Planifikim, menaxhim administrim” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Referuar shkresës nr 3016/2, datë 21.02.2020, në programi 01110 i alokohet shtesë buxheti nga Fondi i Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	200,000	-

Në zbatim të Aktin Normativ Nr. 34, datë 16.12.2020, programi 01110 i pakësohen fondet sipas tabelës:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi

Akti Normativ nr. 34, datë 16.12.2020	600	Paga	-	8,000,000
	601	Sigurime	-	1,000,000

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Planifikim, menaxhim administrim” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	80,000	0	(9,000)	71,000	69,520
(602-606) Shpenzime Operative	62,600	200	0	62,800	47,004
(231) Investime	2,000	0	0	2,000	1,771
Totali:	144,600	200	(9,000)	135,800	118,295

Programi 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.

Programi “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” përfshin tërësinë e funksioneve dhe shërbimeve që ofrojnë përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së jashtë vendit, në përpunje me Kushtetutën, normat e së drejtës ndërkombëtare, ligjin për shërbimin e jashtëm dhe të tjera akte ligjore. Aktivitetet e këtij programi synojnë nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm, mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare dhe përkujdesin ndaj qytetarëve shqiptar kudo ata ndodhen.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën 12-mujore 2020 në këtë program, sipas zërave të strukturës buxhetore, paraqiten si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 99.7 përqind
- Shpenzime të tjera operative 97.1 përqind
- Shpenzime kapitale 100 përqind
- Gjithsej: 97.8 përqind

Ky program përfaqëson rreth 86 përqind të totalit të buxhetit të realizuar nga institucioni për vitin 2020.

Në këtë program janë parashikuar 8 produkte, performanca e të cilëve në përqindje me planin e rishikuar jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2020 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2020		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i realizimit

Mbështetje e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese	1,562,500	1,557,586	100	Plotësisht
Mbështetje e misioneve diplomatike dhe konsullore me logjistikën e nevojshme për përmbushjen e funksioneve	196,750	196,750	100	Plotësisht
Familjare të diplomateve të trajtuar sipas ligjit	51,000	51,000	100	Plotësisht
Adresari i shtetasve shqiptar jashtë territorit të Shqipërisë	0	0	0	Plotësisht
Kryesimi i OSBE-së	543,250	489,650	90.1	Plotësisht
Kuota Ndërkombëtare	322,951	322,329	100	Plotësisht
Blerje pajisje zyre për misionet diplomatike dhe postet konsullore	4,000	4,000	100	Plotësisht
Blerje pajisje kompjuterike për misionet diplomatike dhe postet konsullore	3,000	3,000	100	Plotësisht
TOTALI:	2,683,451	2,624,315	97.8	

Kryesisht produktet e programit “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” paraqitet me status realizimi të 100%. Ky program ka patur realizimin e objektivave:

- Përmirësim i strukturave dhe metodave të punës të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj të gjithë personave të interesuar.
- Avancim i procesit të integritimit Evropian, pjesëmarrje aktive në NATO, konsolidimi i marrëdhënieve dy dhe shumë palëshe, me fokus të veçantë dimension ekonomik tregtar si dhe ekspozimin tonë kulturor jashtë vendit, kontribut konstruktiv në rajon dhe organizata ndërkombëtare, avancim i procesit të njohjeve dhe integritimit ndërkombëtar të Kosovës.
- Sigurim i përfaqësimit diplomatik dhe konsullor efikas dhe profesional në vendet e tjera, në organizata ndërkombëtare dhe nisma rajonale. Përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe të jetesës, përfshirë ato të sigurisë së personelit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të rritjes së cilësisë së punës dhe arritjen e rezultateve.
- Sigurimi i një komunikimi të vazhdueshëm, të shpejtë, të sigurt dhe të ndërsjellët ndërmjet MEPJ dhe posteve konsullore duke shfrytëzuar teknologjinë bashkëkohore të informacionit.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërme rezultojnë të realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Derdhja e pjesshme e kontributeve vjetore për organizatat ku vendi ynë është palë si: detyrimet ndaj Organizatës së Kombeve të Bashkuara; Misioneve Paqeruajtëse; Frankofonisë; ANEA-s; UNIDO-s; UNESCO; Këshilli i Evropës, NATO-s; OSBE-së etj.
- Raporte mbi zgjerimin e shërbimeve konsullore ku theksojmë procesin e lëshimit të çertifikatave nga përfaqësitë diplomatike.
- Përmirësim i strukturës dhe performancës së përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve.
- Plotësimi i Strukturës së Taks Forcës për Kryesinë e OSBE-së nga Shqipëria pranë Misionit Vjenë,
- Aktivitet me Diasporën Shqiptare.
- Finalizimi me sukses aksioni i evakuimit të studentes Shqiptare nga Wuhan.

- Miratimi i VKM-së për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme në Strugë.
- Takimi i përbashkët ndërmjet Këshillit të Përhershëm PC dhe Forumit të bashkëpunimit për Sigurinë FSC dedikuar rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 Grat Paqja dhe Siguria.
- Kontribut i Kryesisë shqiptare të OSBE-seë në miratimin e buxhetit të organizates se OSBE për vitin 2020.
- Nënshkrimi i deklaratës së përbashkët me 58 vende të OKB-së për mbrojtjen dhe promovimin e përgjegjësive gjinore në krizën COVID-19.
- Shpërndarja falas e 20,000 teksteve shkollore shqip për 4,000 nxënës të luginës së Preshevës.
- Shpërndarja falas nga ambasadat e RSh-së të 17,000 tekste shkollore në gjuhën shqipe në të gjitha hapësirat ku jetojnë shqiptarë.
- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ambasadave të Shqipërisë dhe Kosovës në Gjermani.
- Nënshkrimi i marrëveshjes midis Shqipërisë dhe Kosovës për zbatimin e projekti të krijimit të hapësirës së përbashkët konsullore në qytetin e Strugës.
- Kryesia Shqiptare e OSBE-së.

Duke filluar nga 1 Janari 2020, Shqipëria mbajti Kryesinë e Përgjithshme të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) për një vit kalendarik deri më 31 Dhjetor 2020. Si rezultat, Shqipëria do të jetë pjesë e Trojkës së Kryesisë së Organizatës së bashku me Italinë dhe Sllovakinë, të cilat përkatësisht në 2018 dhe 2019, mbajtën Kryesinë e OSBE-së.

Prej 1 janari, vendi ynë ishte në qendër të vëmendjes së 56 vendeve të tjera pjesëmarrëse, dhe vendeve partnere mesdhetare dhe vendeve aziatike, duke i atribuar asaj një rol më të gjerë diplomatik dhe një përgjegjësi të madhe për të kryesuar një nga organizatat kryesore më të mëdha në arenën ndërkombëtare. Angazhimi i Shqipërisë për të forcuar paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe atë të OSBE-së.

Kryesia në vetvete mbledh takime të pafundme si dhe rreth 40 evente të mëdha me pjesëmarrje të gjerë. Këto evente më së shumti zhvillohen në Vjenë nën kujdesin e Misionit të RSH-së në Organizatat ndërkombëtare por edhe në Tiranë në Task Forcën për Kryesinë Shqiptare të OSBE-së. Pavarësisht faktit të COVID-19, u kryen një numër i madh takimesh të parapërcaktuara në udhërrëfyesin e Kryesive të Organizatës.

Gjatë vitit, buxheti i programit “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Në zbatim të Aktin Normativ Nr. 15, datë 15.04.2020, programit 01120 i pakësohen fondet sipas tabelës:

Akti Normativ	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
nr. 15, datë 15.04.2020	600	Paga	-	90,000,000
	602	Shpenzime operative (Shtetas shqiptar që jetojnë jashtë territorit të RSH-së të regjistruar)	-	35,000,000

Në zbatim të VKM nr. 717, datë 16.09.2020, “Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe zyrave të tij në Preshevë dhe Medvegjë dhe Këshillit Kombëtar të Shqiptareve në Mal të Zi dhe zyrës Koordinuese të tij në Plavë”, në programin 01120 alokohet shtesë fondi 70,000 euro detajuar si më poshtë:

VKM nr.	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
717, datë 16.09.2020	605	Kuota Ndërkombëtare	8,701,000	-

Në zbatim të VKM nr. 1116, datë 29.12.2020, “Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Kroacisë për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 29.12.2020” në programin 01120 alokohet shtesë fondi 250.000 euro detajuar si më poshtë:

VKM nr.	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
1116, datë 29.12.2020	605	Kuota Ndërkombëtare	31,250,000	-

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	857,500	0	(90,000)	767,500	765,363
(602-606) Shpenzime Operative	1,904,000	39,951	(35,000)	1,905,951	1,852,953
(231) Investime	7,000	0	0	7,000	7,000
Totali:	2,768,500	39,951	(125,000)	2,683,451	2,624,315

Programi 01130 “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPEJ” përfshin aktivitetet të cilat vënë në zbatim prioritetet e politikës së jashtme të RSH-së sipas programit të qeverisë. Në thelb të këtij programi qëndron përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave kombëtare dhe të shtetasve shqiptar nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Krahasuar me zërat e planit të buxhetit, realizimi i shpenzimeve në këtë program i cili përfaqëson rreth 5.4 përqind të totalit të shpenzimeve të institucionit për 12-mujorin, rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 89 përqind
- Shpenzime të tjera operative 40 përqind
- Shpenzime kapitale 0 përqind
- Gjithsej: 69 përqind

Për vitin 2020 në këtë program ishin parashikuar 5 produkte, realizimi i të cilëve krahasuar me planin jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti përfundimtar 2020 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2020		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i realizimit
Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara	140,000	124,617	89	pjesëshëm
Takime lobim për hapjen e negociatave	10,000	4,705	47	pjesëshëm
Takime diplomatike dy dhe shumë palëshe	71,000	28,020	39.5	pjesëshëm
Shërbime konsullore të ofruara	4,000	1,111	27.8	pjesëshëm
Aktivitete promovuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të objektivave të diplomacisë ekonomike publike dhe diasporës	12,500	5,549	44.4	pjesëshëm
TOTALI:	237,500	164,002	69	

Kryesisht produktet e programit “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor në MEPJ”, paraqitet me status realizimi të pjesëshëm. Krahasuar me planin, realizimi i zërit “paga” paraqiten në masën 89 % dhe zëri “shpenzime operative” në masën 40 %. Ky zë nuk paraqitet i realizuar në nivel të kënaqshëm për shkak të bllokimit të aktivitetit të institucionit si pasojë e shpalljes së emergjencës kombëtare nga COVID-19.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, buxheti i programit “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Referuar shkresës nr. 3016/2, datë 21.02.2020, në programi 01130 alokohet shtesë buxheti nga Fondi i Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	500,000	-

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, programi 01130 i pakësohen fondet sipas tabelës:

Akti Normativ nr. 28, date 02.07.2020	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	602	Shpenzime operative (Takime diplomatike dy dhe shumë palësh)	-	15,000,000

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Aktiviteti diplomatike dhe konsullor i MEPJ” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	139,500	0	0	139,500	124,490
(602-606) Shpenzime Operative	112,500	500	(15,000)	98,000	39,512
(231) Investime	0	0	0	0	0
Totali:	252,000	500	(15,000)	237,500	164,002

Programi 01150 “Mbështetje institucionale për procesin e integritit”.

Programi “Mbështetje institucionale për procesin e integritit” ka në thelb të tij zbatimin e prioriteteve të politikës së jashtme të Qeverisë shqiptare dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim me qasje drejtimin teknik dhe bashkërendim e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Objektivi i këtij programi është hapja e negociatave të anëtarësimit në BE.

Gjatë 12-mujorit të vitit 2020, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin e planit të buxhetit të vitit 2020 të miratuar, si më poshtë:

000/lekë

	Buxheti i miratuar 2020	Fakti 12-mujor 2020	Realizimi në % kundrejt planit vjetor
Paga	43,500	37,370	86
Sigurime shoqërore	6,000	5,597	93
Trans për Buxh. Fam. & Individ	300	57	19
Mallra dhe Shërbime të Tjera	42,500	35,458	83
Kapitale të brendshme	20,500	15,980	76
Financime të huaja total	134,780	50,126	37
TOTALI	247,580	144,588	58

Gjatë 12-mujorit të vitit 2020, për programin “Mbështetja institucionale për procesin e integritit”, sikurse tregohet edhe në tabelën e mësipërme, janë përdorur 144,588,000 lekë nga 247,580,000 lekë ose afërsisht 58.4% e buxhetit të alokuar për vitin 2020.

Nr	Emri i produktit	Buxheti 2020 në 000/lekë	Realizimi 12-mujori 2020		
			Në mijë lekë	Në %	Statusi i produktit
1.	Aktivitete të koordinuara për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian	247,580	144,588	58%	Pjesërisht
TOTALI:		247,580	144,588	58%	Pjesërisht
Projekti Platform		5,000	1,666	33	Pjesërisht
Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile		19,000	622	3	Pjesërisht
Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Mali i Zi		9,000	3,729	41	Pjesërisht
Asistencë teknike IPA – CBC Greqi – Shqipëri		22,000	17,892	81	Pjesërisht
Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Maqedoni		5,000	7,383	147	Plotësisht
Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Kosovë		9,000	4,809	53	Pjesërisht
Asistencë teknike MED (Mesdheu)		3,000	0	0	Aspak
PPF		20,280	0	0	Aspak

Asistencë teknike IPA – CBC Ballkan – Mediteran	1,500	0	0	Aspak
Asistencë teknike IPA – CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi	11,000	12,667	115	Plotësisht
Asistenca teknike IPA – CBC Adrion	5,000	0	0	Aspak
Asistenca teknike IPA – CBC Adrion (EUSAIR)	4,000	1,278	32	Pjesërisht
Asistencë Teknike për Programet Europiane	19,000	0	0	Aspak
Projekti IPA CBC SMART ADRIA	2,000	80	4	Pjesërisht
Totali Financimi i Huaj	134,780	50,126	37	Pjesërisht

Programi buxhetor “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit” ka 1 produkt, i cili në vlerë është realizuar në vlerë në masën 58% krahasuar me planin vjetor.

Në kuadër të këtij produkti, gjatë vitit 2020 janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Tetë takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nga nëntë takime të planifikuara. Takimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit u shty me kërkesë të institucioneve të Bashkimit Evropian për t’u zhvilluar në vitin 2021.
- Takimi i Nënkomitetit Inovacioni, shoqëria e informacionit dhe politikat sociale, më datë 23 janar 2020;
- Takimi i Nënkomitetit Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, më datë 22 prill 2020.
- Takimi i Nënkomitetit Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit, më datë 10 qershor 2020;
- Takimi i Nënkomitetit Transporti, energjia, mjedisi dhe zhvillimi rajonal, më datë 12 qershor 2020;
- Takimi i Nënkomitetit Drejtësia, liria dhe siguria, më datë 30 qershor – 1 korrik 2020;
- Takimi i Nënkomitetit Çështjet ekonomike, financiare dhe statistikat, më datë 11 – 12 nëntor 2020;
- Takimi i Nënkomitetit Bujqësia dhe peshkimi, më datë 3 dhjetor 2020;
- Takimi i Komitetit të Stabilizim-Asociimit 2020, më datë 9 dhjetor 2020.

Ky aktivitet është realizuar pjesërisht:

- Dy raportime të plota dhe një raportim plotësues i Qeverisë shqiptare në kuadër të përgatitjes së Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020. Këto raportime iu paraqitën shërbimeve të Komisionit Evropian respektivisht në datat 17 shkurt 2020, 24 prill 2020 dhe 18 qershor 2020. Ky aktivitet është realizuar plotësisht për vitin 2020.
- U realizua hartimi dhe monitorimi për të katër tremujorët e vitit 2020 i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 – 2022, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 151, datë 19.2.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 – 2022”. Ky aktivitet është realizuar plotësisht.
- Në vitin 2020, është dhënë mendim për 55 projektakte që synonin përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ky aktivitet është plotësuar pjesërisht. Numri i mendimeve mbi përafrimin e projektakteve shqiptare me legjislacionin e Bashkimit Evropian varet nga numri i projektakteve të paraqitura për miratim nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore.
- Gjatë vitit 2020 përfundoi me sukses procedura e tenderit të përkthimit të legjislacionit evropian dhe ka nisur procedura e përkthimit të akteve të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Deri në fund të vitit 2020 janë përkthyer 3 000 faqe për pesë fusha si:

drejtësia, energjia, sistemi doganor, tatimet dhe mbikëqyrja financiare. Gjatë vitit 2021 do të finalizohet përkthimi i akteve të tjera të mbetura (përafërsisht rreth 5 000 faqe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Ky aktivitet vlerësohet i plotësuar në masën 80% për vitin 2020.

- Gjatë vitit 2020 u miratua Marrëveshja e Financimit mes Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për Programin IPA për vitin 2019, si dhe u miratuan ndryshimi i Marrëveshjes së Financimit IPA 2017 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, ndryshimi i tretë i Marrëveshjes së Financimit IPA 2013 (me menaxhim të drejtpërdrejtë), ndryshimi i parë i Marrëveshjes së Financimit IPA 2018. Ndërkohë kanë vazhduar përgatitjet për Instrumentin e ri Financiar IPA III. Në kuadër të këtij instrumenti u koordinua përgatitja e fishave të aplikimeve për fonde IPA të cilat iu paraqitën shërbimeve të Komisionit Evropian gjatë vitit 2020. Ky aktivitet u realizua plotësisht.
- Gjatë vitit 2020 u zhvilluan takimet e shtatë Komiteteve Sektoriale të Monitorimit të IPAs nëpërmjet procedurës së shkruar (për shkak të pandemisë COVID-19). Ne raportimet e përgatitura nga institucionet përfituese IPA u përshkrua përparimi në zbatimin e aktiviteteve IPA, në zbatimin e konkluzioneve operacionale të takimeve të KMS-ve, dhe impakti e masat e marra në kuadrin e pandemisë në lidhje me projektet IPA. Gjithashtu, më datë 3 dhjetor 2020 u mbajt takimi vjetor i radhës i Komitetit të Monitorimit të IPA-s Shqipëri – BE ku u diskutuan zhvillimet e periudhës maj 2019 – nëntor 2020 në menaxhimin e portofolit IPA dhe u përcaktuan prioritetet strategjike për vitin 2021. Ky aktivitet është realizuar plotësisht.
- Gjatë 2020, Shqipëria vijoi me fazat e programimit të paketës IPA me Shumë Vende Përfituese për vitin 2020 – 2021, duke përfshirë dhe konsultimet e njëfaqëshe. Ky aktivitet u realizua plotësisht.
- Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria mori pjesë në tre thirrje të hapur në kuadër të Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (ĒBIF) (dy thirrje për përgatitje projektesh/ asistencë teknike dhe një thirrje për investime). Shqipëria përfitoi në total gjashtë projekte për asistencë teknike dhe dy projekte investimi. Ky aktivitet u realizua plotësisht.
- Në periudhën e raportimit, me mbështetjen e Asistencës Teknike për Programet Evropiane, u koordinua pjesëmarrja e Shqipërisë në Programet Evropiane. Ky aktivitet u realizua plotësisht.
- Gjatë vitit 2020, u koordinua pjesëmarrja e Shqipërisë në programimin e Programeve të Bashkëpunimit Territorial. Projektet e Asistencës Teknike kanë vazhduar implementimin normal të tyre gjatë gjithë vitit 2020. Ky aktivitet u realizua plotësisht.
- Gjatë vitit 2020 u zhvilluan vizitat monitoruese në kuadër të programeve të Bashkëpunimit Territorial.

Ky aktivitet u realizua plotësisht.

Gjatë vitit 2020, buxheti i programit “Mbështetje Institucionale për Procesin e Integritimit” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Referuar shkresës nr 3016/2, datë 21.02.2020, në programi 01150 alokohet Fondit të Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	300,000	-

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, programi 01150 i pakësohen fondet sipas tabelës:

Akti Normativ nr. 28, datë 02.07.2020	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	600	Paga (Koordinimi i aktiviteteve për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian)	-	4,000,000

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Mbështetje Institucionale për procesin e integritit” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	53,500	0	(4,000)	49,500	42,962
(602-606) Shpenzime Operative	42,500	300		42,800	35,515
(231) Investime	155,280	0	0	155,280	66,106
Totali:	251,580	300	(4,000)	247,580	144,588

Referuar Raportit të Monitorimit që MEPJ ka dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, rezultoi se:

Në fund të vitit 2020, në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin me ndryshime, situata paraqitet si më poshtë:

Kod. Prog	Programi	% e Realizimit/Buxh. Rishikuar
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	87.1
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	97.8
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	69.1
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integritit	58.4
	TOTALI	92.3

Konkluzion realizimi i buxhetit viti 2020

Përgjithësisht MEPJ ka një disablancim të madh në realizimin e zërave të buxhetit ku zëri 01120 Mbështetje diplomatike jashtë shteti paraqitet me realizim në masën 97.8 % ndërsa zëri 01150 Mbështetje institucionale për procesin e integritit paraqitet me realizim në masën 58.4% që tregon një keq planifikim, keq menaxhim dhe keq organizim të situatës edhe pse në total realizimi për efekt vlere paraqitet në masën 92.3%.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, situata në fund të vitit 2020 paraqitet e tillë:

Kod. Prog	Programi	Shpenzime Korente (në %)	Shpenzime Kapitale(në %)
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	87.1	88.5
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	97.8	100.0
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	69.1	-
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integritimit	85.0	42.6
	TOTALI	94.8	45.6

Sikurse evidentohet nga më sipër, përqindja e realizimit për shpenzimet korente është tejet e ndryshme nga zëri në zë që tregon në një planifikim jo të saktë. Realizimi i programit 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” është 87.1%, në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” realizimi është 97.85%. Në programin “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ”, 69.1% dhe programin “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit” realizimi është 85%. Ndërsa pjesa e përkjet shpenzimeve kapitale, masa e realizimit është më e ulët. Përqindja e realizimit totale është 45.6%. Ndërsa sipas programeve konstatojmë se në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” është realizuar i gjithë fondi sipas parashikimeve, në programin “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit” është realizuar 42.6% e fondeve, ndërsa në programin 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” vërehet se janë saktësuar regjistrimet e hedhura në periudhat paraardhëse raportuese dhe përqindja e realizimit është 88.5%.

-Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar 2020, buxhetit me ndryshime dhe realizimit për vitin 2020, paraqitet si më poshtë:

Kod. Prog	Struktura për programet	Buxheti Fillestar	Buxheti me ndryshime	Fakti 4M 2020
	Programi			
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	4.2	4.1	3.9
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	81.0	81.2	86.0
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	7.4	7.2	5.4
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integritimit	7.4	7.5	4.7
	TOTALI	100	100	100

Nga sa më sipër rezulton se më shumë se 86% e totalit të shpenzimeve faktike të vitit 2020, janë përdorur në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.

1. Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

Programi Planifikim, administrim dhe menaxhim synon mbështetjen financiare dhe njerëzore në realizimin e politikave në tërësi të drejtorive të MEPJ duke siguruar një lidhje efektive ekonomike dhe financiare midis aparatit qendror dhe përfaqësive diplomatike. Tërësia e aktiviteteve të këtij

programi buxhetor ka për qëllim mbështetjen e strukturave të shërbimit të jashtëm të RSH-së në funksion të realizimit të misionit të MEPJ-së.

Në këtë program janë realizuar 21 nga 24 “Akte ligjore dhe nënligjore” të planifikuara për hartim; janë zhvilluar 10 trajnime për të zhvilluar kapacitetet profesionale të stafit të MEPJ-së me qëllim garantimin e cilësisë në punë; janë realizuar gjithashtu 40 nga 90 aktivitete protokollare si takime, vizita dhe pritje zyrtare të delegacioneve të larta shtetërore; janë kryer 9 nga 16 auditime të programuara si dhe janë përgatitur 42 nga 50 raportime (detyrime kontraktuale) mbi konsulentat juridike, përfaqësimi në organet gjyqësore, prokurorisë dhe përmbarimit.

Programi Mbështetje diplomatike synon nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm, mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare e shtetërore dhe përkujdesen për interesat e qytetarëve shqiptarë kudo ata ndodhen. Në këtë program janë parashikuar disa produkte, nga të cilat me realizim faktik për periudhën përmendim “Mbështetje e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese” për 336 punonjës, “Mbështetje e misioneve diplomatike dhe konsullore me logjistiken e nevojshme për përmbushjen e funksioneve” për 50 diplomat, “Trajtimi i familjeve të diplomatëve sipas ligjit” për 220 punonjës dhe “Pagesa e Kuotave Ndërkombëtarë” konkretisht për vitin 2020 janë paguar 60 kuota. Ndërsa lidhur me projektet e investimit për vitin 2020 është realizuar blerja e pajisjeve të zyrës dhe ato kompjuterike për misionet diplomatike dhe postet konsullore.

Programi Mbështetje institucionale për procesin e integritetit, fokusohet në anëtarësimin e Shqipërisë në BE, nëpërmjet bashkërendimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, menaxhimit të fondeve të BE-së, zhvillimin e negociatave të anëtarësimit të RSH në BE, forcimin e rolit të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse si dhe informimin e publikut duke ruajtur parimin e aksesit të barabartë të grave në këtë proces. Në këtë program janë parashikuar 28 “Aktivitete të koordinuara për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian” nga të cilat janë realizuar 26 prej tyre.

Gjatë vitit 2020, janë realizuar të ardhura nga veprimtaria konsullore si leje kalimi, lidhje martesë, prokura, noterizime, certifikata të ndryshme, vërtetime konsullore, përkthim dokumenti, aplikim për viza etj, (rreth 40 lloj shërbimesh konsullore) si më poshtë:

- Programi 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim” 76,350 mijë lekë
- Programi 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” 156,046 mijë lekë.

2. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit

Programi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Diferencat
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	144,600	135,800	-8,800
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,768,500	2,683,451	-85,049
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	252,000	237,500	-14,500
Mbështetje institucionale për procesin e integritetit	251,280	247,580	-3,700
TOTALI	3,416,380	3,304,331	-112,049

Sikurse vihet re edhe nga tabela më sipër, në të gjitha programet ka pasur ndryshime në vlerat buxhetore fillestare dhe ato aktuale duke treguar në një planifikim jo të saktë.

Këto ndryshime lidhen me shtesën e bërë në buxhetin e MEPJ për Fondin e Veçantë, ndryshimet në zbatim të Aktit Normativ nr.15, datë 15.4.2020, Aktit Normativ nr.28, datë 2.7.2020 si dhe të Aktit normativ nr.34 date 16.12.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar”.

3.Komente të tjera

Raporti i monitorimit të Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme është paraqitur në kohë në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit, për njësitë e qeverisjes qendrore”. Ky raport, në përgjithësi paraqitet i plotë dhe me analizë të shkaqeve që kanë sjellë mosrealizim të fondeve apo të produkteve.

Raporti i monitorimit të vitit 2020 për MEPJ është plotësuar me të gjitha anekset shoqëruese sipas udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit, për njësitë e qeverisjes qendrore”.

Pjesë e raportimit janë bërë edhe të ardhurat e krijuara nga MEPJ nga veprimtaria konsullore të cilat janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka publikuar në faqen e internetit raportin e monitorimit të vitit 2020.

Viti 2021

PBA 2022-2024

Kërkesat buxhetore janë përgatitur sipas Udhëzimit nr. 7, dt. 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 19, dt. 09.07.2021, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Kërkesat buxhetore, janë paraqitur brenda tavanëve buxhetore të miratuara në nivel programi për politikën ekzistuese të institucionit.

Me urdhrin nr. 162, datë 09.04.2021 nënshkruar nga titullari i Ministrisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për buxhetin afatmesëm për periudhën 2022-2024 me kryetar Ministrin, koordinator grupi Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretare, Drejtore e Drejtorisë së Financës. Sipas këtij urdhri, për 4 programet e MEPJ-së janë ngritur 4 nëngrupe të tjera për hartimin e projektbuxhetit afatmesëm për fazën e parë dhe të dytë për programet që menaxhon MEPJ.

Në zbatim të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe udhëzimit nr. 19, dt. 09.07.2021, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” dhe VKM nr. 440, datë 09.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”, MEPJ, me shkresën nr.10867, datë 31.08.2021 ka dorëzuar në Ministrinë e Financave kërkesat buxhetore sipas programeve të buxhetit afatmesëm, së bashku me formularët e propozimit të projekteve.

Në funksion të prioriteteve të politikës së jashtme, krahas kërkesave buxhetore për financimin e politikave ekzistuese janë përgatitur edhe kërkesat buxhetore për financimin e politikave të reja, të cilat janë të pa financuara.

Për vitin 2022, për financimin e politikave ekzistuese janë kërkuar financim shtesë në vlerë 16,000,000 lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Fondi është shpenzuar për riparimin e pjesës së brendshme të MEPJ e cila u dëmtua 2 herë nga tërmetet e vitit 2019.

Gjithashtu për financimin e politikave ekzistuese, për vitin 2022 janë kërkuar financim për produktin "Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së MEPJ" në vlerë 139.000.000 lekë ku përfshihet: projekti i ri konceptimit dhe rikonstruksionit të ambienteve të jashtme të institucionit; Hidroizolim, termoizolim i tarracave, sistem kapot, suvatim, lysterje e fasadës, panele diellore për prodhimin e energjisë së rinovueshme. Gjithashtu këtu përfshihet edhe rikonstruksioni i ambienteve të jashtme të ministrisë ku përfshihet: muri perimetral rrethues, sistemi i jashtëm i ndriçimit, ambientet e gjelbra dhe lulishtet, sheshi dhe hyrja kryesore, portal automatike rrëshqitëse dhe parkime nëntokësore.

Në kuadrin e angazhimeve që ka marrë MEPJ për tre vitet e ardhshme janë paraqitur kërkesa për financimin e politikave të reja, si më poshtë:

Këshilli i Sigurimit të OKB

Për të realizuar këtë objektiv të politikës së jashtme shqiptare, synohet një intensifikim gjatë vitit të ardhshëm dhe atij në vijim i punës në MEPJ dhe të Misionit të Përhershëm të R.SH në NY si në planin shumëpalësh ashtu dhe në atë dypalësh, nëpërmjet rritjes së nivelit të përfaqësimit, rritjes së kontributeve në to, zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme për Shqipërinë për rritje variabiliteti, organizim të vizitave të niveleve të ndryshme, sipas nevojave të agjendës së Këshillit të Sigurimit. Për këtë qëllim pranë MEPJ do të funksionojë Drejtoria e Këshillit të Sigurimit e cila do mbështesë punën e Misionit të Përhershëm në NY, koordinimin brenda MEPJ të hartimit të dosjeve mbështetëse dhe për formulimin e qëndrimeve për çështjet në diskutim në Këshillin e Sigurimit, si dhe koordinimin ndër-institucional në përputhje me Urdhrin Nr. 21, datë 29.01.2021 të Kryeministrit. Në këtë kuadër edhe Misioni i Përhershëm në Nju Jork do të përballojë volum pune të rritur për t'u përgjigjur detyrimeve si anëtar i Këshillit të Sigurimit. Për këtë qëllim Misioni i Përhershëm në NY do të përforcohet me personel të mjaftueshëm diplomatik dhe teknik, për të përballuar detyrat që dalin nga angazhimi në KS si një vend jo i përhershëm, por edhe detyrat në kuadër të veprimtarisë së OKB.

Për përmbushjen e këtij angazhimi të politikës së jashtme për vitet 2022-2024, në programin "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", një pjesë e shpenzimeve do të përballohen nga tavanet buxhetore të institucionit për tre vitet e PBA. Meqenëse kostoja për këtë produkt është relativisht e madhe kërkohet financim shtesë sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
253,700,000	199,360,000	Nga tavanet buxhetore

Programi buxhetor 01130 "Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ"

Edhe në këtë program kërkesat buxhetore janë rishikuar në përputhje me Politikën ekzistuese si dhe tavanet indikativë të programit. Nuk kemi kërkesa për financime të politikave të reja. Pjesa e shpenzimeve që i referohet strukturës së ngritur në MEPJ për Këshillin e Sigurimit do të përballohet nga tavanet e miratuara të programit.

Programi buxhetor 01150 “Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit” në PBA 2022 – 2024, synon mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Programi mbështetet në shtyllat e mëposhtme:

- Zhvillimi i negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së;
- Menaxhimi i fondeve të BE-së;
- Përkthimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe;
- Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi procesin e anëtarësimit.

Në realizimin e të gjitha këtyre shtyllave, Programi do të mbështesë bashkëpunimin me shoqërinë civile në procesin e anëtarësimit dhe do të synojë mbështetjen e politikave të barazisë gjinore. Objektivi i këtij Programi është në përputhje me Programin e Qeverisë 2017 – 2021, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2015 – 2020, sikurse miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 11.5.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim”. Realizimi i objektivit të këtij Programi, do të kryhet nëpërmjet një produkti të vetëm me emërtimin “Aktivitete për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian”.

Fondet buxhetore për artikujt Paga, Sigurime Shoqërore dhe Mallra e Shërbime janë shpërndarë sipas taveve buxhetore për të tre vitet që mbulon ky program si më poshtë.

Artikujt	Buxheti	PBA 2022 – 2024		
	2021	2022	2023	2024
Paga (600-601)	53,500.0	53,500.0	53,500.0	53,500.0
Korente të Tjera (602-606)	46,500.0	56,740.0	77,540.0	81,950.0
Kapitale (230-232) Të Brendshme	21,000.0	21,000.0	21,000.0	0.0
Kapitale (230-232) Të Huaja	80,780.0	80,780.0	80,780.0	0.0
Jashtë-buxhetore	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	201,780.0	212,020.0	232,820.0	135,450.0

Në lidhje me kostimin e produktit “Aktivitete për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian” vërejmë se numri i aktiviteteve në këtë produkt është planifikuar të rritet me 2 aktivitete shtesë nga viti 2021 në vitin 2022 dhe më pas mbetet i pandryshuar. Ndërkohë kostoja për njësi e produktit është rritur me rreth 2.9% në vitin 2022 dhe rreth 18.9% në vitin 2023. Kjo rritje ka pasqyruar rritjen e tavanit buxhetor në artikullin 602 për këtë program buxhetor, veçanërisht në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Kjo rritje pritet të shërbejë për të përballuar rritjen e pritshme të kostonë së realizimit të aktiviteteve pas fillimit të negociatave të anëtarësimit.

<i>Titulli i Gjetjes 3:</i>	<i>Planifikim jo efektiv buxhetor</i>
<i>Situata:</i>	<p>Nga auditimi u konstatua se kërkesat shtesë për të siguruar vijueshmërinë normale të aktivitetit të programit 01150 “Mbështetja institucionale në procesin e integritetit” viti 2021 nuk janë marrë parasysh. Këto kërkesa shtesë ishin:</p> <p>Ngritja e Sekretariatit të Bashkimit Evropian</p> <p>Mbulimi me fondet e nevojshme i projektit “Mbështetje për procesin e anëtarësimit në BE (SEI – SMEI 5) financuar nga Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II) i Bashkimit Evropian (Kodi i projektit GM15009). Ky projekt asiston Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Zyrën e Kryenegociatorit në procesin e përgatitjeve për negociatat e anëtarësimit;</p> <p>Mbulimi i rikuperimit të fondit për projektin EuropeAid/137464/IH/SER/AL “Ndërtimi i kapaciteteve për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministritë e linjës për përgatitjen e procesit të negociatave dhe përafrimit ligjor”;</p> <p>Mbulimi me fondin e nevojshëm i projektit “Mbështetje për organizatat e shoqërisë civile” financuar nga Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II) i Bashkimit Evropian (Kodi i projektit 18AI201). Ky projekt synon dhënien e mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve të shoqërisë civile në Shqipëri dhe forcimin e rolit të saj në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.</p>
<i>Kriteri:</i>	<p>Vendimi të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”;</p> <p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe udhëzimit nr. 19, dt. 09.07.2021, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”</p> <p>VKM nr. 440, datë 09.07.2021 “Për miratimin e tavaneve perfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”,</p> <p>MEPJ, me shkresën nr.10867, datë 31.08.2021 ka dorëzuar në Ministrinë e Financave kërkesat buxhetore sipas programeve të buxhetit afatmesëm, së bashku me formularët e propozimit të projekteve.</p>
<i>Ndikimi/Efekti:</i>	Krijimi i vonesave në zbatimin e projekteve
<i>Shkaku:</i>	Mungesë përcaktimi prioritetesh buxhetor

Rekomandimi:	Nga ana e MEPJ-së të merren masa për planifikim dhe alokim buxhetor sipas prioriteve të projekteve në kuadër të mbështetjes për Shqipërinë dhe forcimin e rolit të saj në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Në vijimësi

Mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2021

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2021 ka menaxhuar fondet publike në katër programe buxhetore:

- Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, përfshin shpenzimet për aktivitetet me karakter mbështetës të institucionit.
- Programi “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, përfshin shpenzimet për funksionimin e përfaqësive të RSH-së në botë.
- Programi “Aktivitet diplomatik dhe konsullor i MPJ”, përfshin shpenzimet për aktivitetet e drejtorive politike në MEPJ të cilat hartojnë dhe zbatojnë politikën e jashtme.
- Programi “Mbështetje institucionale për procesin e integrimit”, përfshin shpenzimet që kanë të bëjnë me drejtimin dhe bashkërendimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

Realizimi i buxhetit për vitin 2021 paraqitet në masën 97 % Sipas programeve buxhetore realizimi i buxhetit jepet në tabelën e mëposhtme:

Në milionë lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti i vitit 2021	Realizimi i për periudhën janar-dhjetor 2021	Realizimi në %
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	159,800	141,695	88.7
2	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,462,276	2,462,276	97.4
3	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	196,000	174,547	89.1
5	Mbështetje institucionale për procesin e integrimit	202,080	214,166	105.9
	Totali:	3,020,156	1,456,455	97

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për çdo program, sipas buxhetit të miratuar për vitin 2021 dhe realizimit faktik, jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i programit	Struktura e shpenzimeve sipas planit të rishikuar për periudhën janar - dhjetor 2021	Struktura e shpenzimeve sipas realizimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2021
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	5.3	4.8
2	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	81.5	91.9

3	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	6.5	6.0
4	Mbështetje institucionale për procesin e integritit	6.7	7.3
	Totali:	100	100

Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

2. Programi 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim” përfshin shpenzimet për aktivitetet me karakter mbështetës të institucionit të cilat realizohen nëpërmjet planifikimit, menaxhimit eficient dhe monitorimit të burimeve financiare të MEPJ-së, me synim mbështetjen financiare dhe njerëzore për realizimin e politikave të institucionit, duke siguruar një lidhje efikase midis MEPJ-së dhe përfaqësive diplomatike. Tërësia e aktiviteteve të këtij programi buxhetor ka për qëllim mbështetjen e strukturave të shërbimit të jashtëm të RSH-së në funksion të realizimit të misionit të MEPJ-së.

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 4.8 përqind të totalit të shpenzimeve të institucionit për vitin 2021. Sipas zërave të strukturës buxhetore realizimi i buxhetit paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 87.8 përqind
 - Shpenzime të tjera operative 89.0 përqind
 - Shpenzime kapitale 95.1 përqind
- Gjithsej: 88.7 përqind

Për vitin 2021 në këtë program, janë parashikuar 8 produkte, të cilat rezultojnë të realizuara si në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2021 (në 000 lekë)	Realizimi për periudhën janar – dhjetor 2021		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i produktit
Akte Ligjore dhe Nënligjore të hartuara	80,650	70,240	87.9	Plotësisht
Punonjës të rekrutuar dhe të trajnuar	2,000	1,961	98.1	Plotësisht
Detyrime kontraktore	55,150	52,206	94.7	Pjesërisht
Misione auditimi të kryera sipas standardeve	3,000	1,980	66.0	Pjesërisht
Aktivitete protokollare dhe veprimtari protokollare sipas Ceremonialit të RSH-së	12,000	8,499	70.8	Pjesërisht
Pajisje zyre të blera për aparatin e MEPJ	3,000	2,780	92.7	Plotësisht
Ashensor	3,000	2,879	96.0	Plotësisht
Pajisje kompjuterike	1,000	1,000	100	Plotësisht
TOTALI:	159,800	141,695	88.7	

Ndonëse nga pikëpamja monetare buxheti i programi 01110 nuk është realizuar në masën 100%, sasitë e produkteve paraqiten me status realizmi Plotësisht duke konsideruar faktin se aktiviteti i institucionit ka qenë i kufizuar për shkak të pandemisë COVID-19.

Objektivat e percaktuara në programin “Planifikim menaxhim, administrim”, janë :

- Përmirësim i planifikimit të burimeve financiare dhe materiale si dhe rritja e efektivitetit në administrimin e tyre.
- Menaxhim efektiv dhe racional i burimeve njerëzore dhe teknologjisë së lartë për të rritur reagimin dhe cilësinë e shërbimit diplomatik. Përmirësim i teknologjisë së informacionit e komunikimit nëpërmjet rritjes së sigurisë dhe cilësisë së transmetimit të informacionit e komunikimit, mbështetjes me teknologji të reja si dhe garantimit të funksionimit të sistemeve të pajisjeve në përdorim.
- Rritja e vazhdueshme e cilësisë së punës dhe veprimit të burimeve njerëzore të shërbimit të jashtëm, përmes kurseve të përditësimit të dijeve, përmes trajnimit dhe cikleve të kualifikimeve të përgjithshme dhe të posaçme, brenda dhe jashtë vendit si dhe në lidhje me botimet konvencionale (libri, dokumenti, biblioteka MEPJ në shërbim të punës së diplomatit) dhe ato dixhitale elektronike në synim të rritjes së studimit, analizës dhe parashikimit të aksionit tonë në politikën e jashtme.
- Përmirësim i kushteve për ruajtjen, administrimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit historik arkivor 100-vjeçar dhe atij të krijuar rishtazi nga shërbimi i jashtëm, në mbështetje të interesave të politikës së jashtme shqiptare dhe interesave studimore të publikut.
- Menaxhim me efektivitete i fondeve buxhetore për realizimin e buxhetit vjetor të planifikuar për prokurimin e fondeve për mallra dhe shërbime në funksion të nevojave të institucionit duke përmirësuar metodat e vlerësimit të burimeve financiare, në respekt të parimeve të transparencës e të ligjshmërisë për një administrim sa më të saktë të vlerave materiale dhe monetare.
- Përmirësim i punës në mbarëvajtjen e aktivitetit diplomatik dhe në veçanti të vizitave zyrtare jashtë dhe brenda vendit, të konferencave brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrje në samite dhe ministeriale të nivelit të lartë.
- Rritja e cilësisë së veprimtarisë audituese në funksion të përmirësimit të sistemeve të kontrollit të brendshme në MEPJ.
- Përmirësim i ambienteve dhe kushteve të punës në MEPJ.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërme janë realizuar aktivitete:

- Trajnimi i stafi të MPJ-së për të mundësuar zhvillimin e kapaciteteve profesionale me qëllim garantimin e cilësisë së punës.
- Mbarëvajtja e vizitave zyrtare të delegacioneve të larta shtetërore.
- Përgatitja e një sërë raportesh mbi konsulencat juridike, përfaqësimi në organet gjyqësore, prokurorisë dhe përbarimit.
- Plotësimi i strukturës së personelit të MEPJ me prurje të reja dhe transferimit nga përfaqësitë diplomatike.
- Përgatitja e raporteve buxhetore: raporteve të Monitorimit, raporteve të detyrimeve të prapambetura, raporte të tjera në zbatim të Udhëzimit nr. 2 të MF Për zbatimin e buxhetit”, raporte financiare /Bilanci në kuadër të planifikimit dhe analizave të burimeve financiare të institucionit.
- Programe trajnimi të Akademisë Diplomatike Kombëtare

Gjatë vitit 2021, buxheti i programit “Planifikim, menaxhim administrim” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Referuar shkresës nr .1381/8, datë 11.02.2021, në programi 01110 alokohet shtesë buxheti nga Fondi i Veçantë i Qeverise

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
Fondi i Veçantë	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	200,000	-

Në zbatim të VKM nr. 224, datë 07.04.2021, në programi 01110 alokohet shtesë buxheti nga Fondit Rezerve i Qeverisë:

VKM nr.	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
224, datë 07.04.2021	602	Detyrime kontraktuale	20,000,000	-

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Planifikim, menaxhim administrim” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	80,000	0	0	80,000	70,240
(602-606) Shpenzime Operative	52,600	20,200	0	72,800	64,796
(231) Investime	7,000	0	0	7,000	6,659
Totali:	139,600	20,200	0	159,800	141,695

Në mijë lekë

Programi 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën 2021 në këtë program, sipas zërave të strukturës buxhetore, paraqiten si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 100 përqind
- Shpenzime të tjera operative 96 përqind
- Shpenzime kapitale 100 përqind
- Gjithsej: 97.4 përqind

Ky program përfaqëson rreth 91.9 përqind të totalit të buxhetit të realizuar nga institucioni për periudhën e raportimit. Në këtë program janë parashikuar 7 produkte, performanca e të cilëve në përqindje me planin e rishikuar jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2021 (në mijë lekë)	Realizimi për periudhën janar-dhjetor 2021		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i realizimit
Mbështetje e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese	1,615,776	1,594,229	98.6	Plotësisht
Mbështetje e misioneve diplomatike dhe konsullore me logjistikën e nevojshme për përmbushjen e funksioneve	496,500	489,095	98.5	Plotësisht
Familjare të diplomateve të trajtuar sipas ligjit	51,000	50,960	99.9	Plotësisht
Adresari i shtetasve shqiptar jashtë territorit të Shqipërisë	35,000	0	0	Aspak
Kuota Ndërkombëtare	233,000	233,000	100	Plotësisht
Blerje pajisje zyre për misionet diplomatike dhe postet konsullore	23,000	23,000	100	Plotësisht
Blerje pajisje kompjuterike për misionet diplomatike dhe postet konsullore	8,000	8,000	100	Plotësisht
TOTALI:	2,462,276	2,398,284	97.4	

Gjatë 4 mujorit të III-rë të vitit 2021, buxheti i programit “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Në zbatim të VKM nr. 224, datë 07.04.2021, në programi 01210 alokohet shtesë buxheti nga Fondit Rezervë i Qeverisë:

VKM nr. 224 datë 07.04.2021	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	602	Mbështetje e misioneve diplomatike dhe konsullore me logjistikën e nevojshme për përmbushjen e funksioneve	123,500,000	-

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 26, datë 22.06.2021, në programi 01120 alokohet shtesë buxheti si me poshtë:

AN nr. 26, datë 22.06.2021	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	231	Pajisje Zyre	16,000,000	-
	602	Mbështetje e misioneve diplomatike dhe konsullore me logjistikën e nevojshme për përmbushjen e funksioneve	184,000,000	

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	837,000	0	0	837,000	837,000
(602-606) Shpenzime Operative	1,286,776	307,500	0	1,594,267	1,530,284
(231) Investime	15,000	16,000	0	31,000	31,000
Totali:	2,138,776	323,500	0	2,462,267	2,398,284

Programi 01130 “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPEJ” përfshin aktivitetet të cilat vënë në zbatim prioritetet e politikës së jashtme të RSH-së sipas programit të qeverisë.

Krahasuar me zërat e planit të buxhetit, realizimi i shpenzimeve në këtë program i cili përfaqëson rreth 6 përqind të totalit të shpenzimeve të institucionit për 12-mujorin, rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 63.6 përqind
 - Shpenzime të tjera operative 34.8 përqind
 - Shpenzime kapitale 0 përqind
- Gjithsej: 89.1 përqind

Për vitin 2021 në këtë program janë parashikuar 5 produkte, realizimi i të cilëve krahasuar me planin jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2021 (në mijë lekë)	Realizimi për periudhë janar –dhjetor 2021		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i realizimit
Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara	130,000	127,876	98.4	Plotësisht
Takime lobim për hapjen e negociatave	10,000	3,749	37.5	Plotësisht
Takime diplomatike dy dhe shumë palëshe	41,600	32,933	79.2	Plotësisht
Shërbime konsullore të ofruara	4,000	1,484	37.1	Plotësisht
Aktivite promovuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të objektivave të diplomacisë ekonomike publike dhe diasporës	10,400	8,505	81.8	Plotësisht
TOTALI:	196,000	174,547	89.1	

Ndonëse nga pikpamja monetare buxheti i programi 01130 nuk është realizuar në masën 100%, sasitë e produkteve paraqiten me status realizmi Plotësisht duke konsideruar faktin se aktiviteti i institucionit ka qenë i kufizuar për shkak të pandemisë COVID-19.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, buxheti i programit “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPEJ” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Referuar shkresës nr. 1381/8 datë 11.02.2020, në programi 01130 alokohet shtesë buxheti nga Fondi i Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferata për buxhete familjare dhe individ	500,000	-

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	129,500	0	0	129,500	127,876
(602-606) Shpenzime Operative	66,000	500	0	66,500	46,671
(231) Investime	0	0	0	0	0
Totali:	195,500	500	0	196,000	174,547

Programi 01150 “Mbështetje institucionale për procesin e integritit”.

Programi “Mbështetje institucionale për procesin e integritit” ka në thelb të tij zbatimin e prioriteteve të politikës së jashtme të Qeverisë shqiptare dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim me qasje drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Programi synon mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian,

Objekti i këtij programi është hapja e negociatave të anëtarësimit dhe demonstrimi përpara shteteve anëtare të BE-së i aftësisë së Shqipërisë për të plotësuar kriteret e anëtarësimit në BE.

Gjatë vitit 2021, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin e planit të buxhetit të vitit 2021 të miratuar, si më poshtë:

	Buxheti i miratuar 2021	Fakti 4-mujor III 2021	Realizimi në % kundrejt planit vjetor
Paga	47,500	46,867	99
Sigurime shoqërore	6,000	5,986	100
Trans për Buxh. Fam. & Individ	300	46	0.15
Mallra dhe Shërbime të Tjera	46,500	27,669	60
Kapitale të brendshme	21,000	13,479	64
Financime të huaja total	80,780	120,125	149
TOTALI	202,080	214,172	106

Gjatë vitit 2021, për programin “Mbështetja institucionale për procesin e integritit”, sikurse tregohet edhe në tabelën e mësipërme, janë përdorur 214,172,000 lekë nga 202,080,000 lekë ose afërsisht 106% e buxhetit të alokuar për vitin 2021.

Nr	Emri i produktit	Buxheti 2021 në 000/lekë	Realizimi 4-mujori III 2021		
			Në mijë lekë	Në %	Statusi i produktit
1.	Aktivitete të koordinuara për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian	202,080	214,172	106%	Plotësisht
TOTALI:		202,080	214,172	106%	Plotësisht
Projekti Platform		5,000	2	0.04	Pjesërisht
Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile		4,080	67,212	1647	Plotësisht
Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Mali i Zi		7,000	4,803	69	Pjesërisht
Asistencë teknike IPA – CBC Greqi – Shqipëri		22,000	16,017	73	Pjesërisht
Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Maqedoni		4,000	7,083	177	Plotësisht
Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Kosovë		7,000	9,694	138	Plotësisht
Asistencë teknike MED (Mesdheu)		3,000	0	0	Aspak
PPF/ SEI		4,000	0	0	Aspak
Asistencë teknike IPA – CBC Ballkan – Mediteran		1,500	0	0	Aspak
Asistencë teknike IPA – CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi		12,000	13,747	115	Plotësisht
Asistenca teknike IPA – CBC Adria		5,000	0	0	Aspak
Asistenca teknike IPA – CBC Adria (EUSAIR)		4,000	920	23	Pjesërisht
Asistencë Teknike për Programet Evropiane		0	0	0	Aspak
Projekti IPA CBC SMART ADRIA		2,200	644	29	Pjesërisht
Totali Financimi i Huaj		80,780	120,125	149	Plotësisht

Programi buxhetor “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit” ka 1 produkt, i cili në vlerë është realizuar në vlerë në masën 106% krahasuar me planin vjetor.

Titulli i Gjetjes 4:	Tejkalim i tavanit buxhetor
Situata:	Nga auditimi u konstatua se ka një tejkalim të tavanit buxhetor në lidhje me financimin e huaj. Kjo ka ardhur për shkak se kërkesa shtesë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për një korrigjim të tavanit buxhetor nuk u mor parasysh gjatë fazës së hartimit të buxhetit për vitin 2021 dhe realizimit të mirë të projekteve me asistencë të huaj gjatë të gjithë vitit 2021.
Kriteri:	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe udhëzimit nr. 19, dt. 09.07.2021, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” VKM nr. 440, datë 09.07.2021 “Për miratimin e tavaneve perfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”,
Ndikimi/Efekti:	Krijimi i vonesave në zbatimin e projekteve

Shkaku:	Zbatim i pasaktë i planifikimit buxhetor
Rekomandimi:	Nga ana e MEPJ-së të merren masa për planifikim dhe alokim buxhetor në kohën e duhur dhe sipas prioriteve të projekteve në kuadër të mbështetjes për Shqipërinë dhe forcimin e rolit të saj në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian si dhe shmangien e vonesave në implementimin e projekteve
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Në vijimësi

Gjatë vitit 2021, buxheti i programit “Mbështetje Institucionale për Procesin e Integritit” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Referuar shkresës nr 1381/8, datë 11.02.2021, në programi 01150 alokohet Fondit të Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	300,000	-

Ndryshimet në zërat e buxhetit për programin “Mbështetje Institucionale për procesin e integritit” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Zërat e Buxheti	Buxheti Fillestar	Shtesa	Pakësim	Buxheti rishikuar	Realizimi i Buxhetit
(600+601) Paga+Sigurime	53,500	0	0	53,500	52,853
(602-606) Shpenzime Operative	46,500	300	0	46,800	27,715
(231) Investime	101,780	0	0	101,780	133,598
Totali:	201,780	300	0	202,080	214,166

Investimet publike

Ecuria e zbatimit të tyre ka qenë e pjesore, ku ka patur rast ku situata e pandemisë ka ndikuar në ngadalësimin të ndonjë aktiviteti të parashikuar si dhe anulimin nga mungesa e financimit. Vlen të theksohen projektet e Asistencës Teknike të financuara nga programet transnacionale si p.sh Programi MED, Adrion të cilat kanë pasur realizim shumë të ulët, kjo kryesisht për shkak të mungesës së likuiditetit.

Projektet që **nuk** janë realizuar gjatë vitit 2021 janë:

- Projekti i Asistencës Teknike – Programi MED
- Projekti Panoramed – Programi MED
- Programi Balkanmed

Arsyet e mos realizimit lidhen kryesisht **me mungesën e likuiditetit** e cila vjen si rrjedhojë e vonesave në disbursim të transeve që Autoritetet Menaxhuese duhet të dërgojnë bazuar në shumën e shpenzimeve të certifikuara por edhe vonesave të transferimit të fondeve nga Banka e Shqipërisë në bankën e nivelit të dytë nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe nga një mos programim siç duhet i investimeve në kohë dhe vlerë. Gjithashtu, një faktor tjetër shumë i rëndësishëm që ndikoi në mos realizimin e këtyre aktiviteteve ishte edhe pandemia për shkak të së cilës një pjesë e mirë e aktiviteteve nuk u zhvilluan ose u zhvilluan online. Kjo ndikoi në mungesën e shpenzimeve dhe për rrjedhojë në mungesën e përthithjes dhe të realizimit të dobët të projektit.

Në tabelën e mëposhtme kemi veçuar projektet që rezultojnë me status realizimi 100 % dhe që janë mbyllur përfundimisht për vitin 2021.

Programi	Kodi projektit	Emërtimi i Projektit	Plani	Realizimi	Devijanca
01110	M150001	Blerje pajisje zyre për aparatin e MEPJ	1,000	1,000	-
	18AG703	Ashensor	3,000	2,879	121
	M150026	Blerje pajisje kompjuterike	3,000	2,780	220
011120	18AG901	Pajise zyre	23,000	23,000	-
	M150027	Pajisje informatike për përfaqësitë diplomatike	8,000	8,000	-

Afati i implementimit shtrihej përgjatë periudhës janar-dhjetor 2021. Devijim nga plani evidentohet vetëm për projektet 18AG703 dhe M150026 si rezultat e uljes së vlerës së projektit nga operatorët në garë gjatë fazës së tenderimit.

Referuar Raportit të Monitorimit që MEPJ ka dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, rezultoi se:

Në fund të vitit 2021, në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin me ndryshime, situata paraqitet si më poshtë:

Kod. Prog	Programi	% e Realizimit/ Buxh. Rishikuar
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	88.7
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	97.4
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	89.1
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integritimit	82.7
	TOTALI	95.2

Realizimi i shpenzimeve paraqitet në nivelin 95.2%.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, situata në fund të vitit 2021 paraqitet e tillë:

Kod. Prog	Programi	Shpenzime Korente (në %)	Shpenzime Kapitale (në %)
-----------	----------	-----------------------------	---------------------------------

01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	88.4	95.1
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	97.4	100.0
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	89.1	-
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integrit	80.3	84.2
	TOTALI	95.7	87.0

Sikurse evidentohet nga më sipër, përqindja e realizimit për shpenzimet korente nuk është e knaqshme duke cilësuar projektin “Mbështetje institucionale për procesin e integrit” me një përqindje realizimi prej 80.3%, çka është më e ulëta për këtë institucion. Arsyeja që ka kontribuar kryesisht në këtë % realizimi ka qenë organizimi online i shumë nga takimeve të planifikuara për tu zhvilluar fizikisht. Ndërsa për sa i përket shpenzimeve kapitale, masa e realizimit është 87%. Ndërsa sipas programeve konstatojmë se në programin “Mbështetje institucionale për procesin e integrit” është realizuar 84.2% e fondeve të planifikuara, pasi nuk u realizua projekti “Asistencë teknike – Programi MED”, “Panoramed-Programi MED” dhe “Programi BalkanMed”.

Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar 2021, buxhetit me ndryshime dhe realizimit për vitin 2021, paraqitet si më poshtë:

Struktura për programet		Buxheti Fillestar	Buxheti me ndryshime	Fakti 12-M 2021
Kod. Prog	Programi			
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	5.2	5.2	4.8
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	79.9	79.9	81.7
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	7.3	6.4	5.9
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integrit	7.5	8.6	7.5
	TOTALI	100	100	100

Nga sa më sipër rezulton se 81.7% e totalit të shpenzimeve faktike të vitit 2021, janë përdorur në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.

Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

Programi Planifikim, administrim dhe menaxhim synon mbështetjen financiare dhe njerëzore në realizimin e politikave në tërësi të drejtorive të MEPJ duke siguruar një lidhje efikase ekonomike dhe financiare midis aparatit qendror dhe përfaqësive diplomatike. Tërësia e aktiviteteve të këtij programi buxhetor ka për qëllim mbështetjen e strukturave të shërbimit të jashtëm të RSH-së në funksion të realizimit të misionit të MEPJ-së.

Në këtë program janë realizuar 24 “Akte ligjore dhe nënligjore” të planifikuara për hartim; janë zhvilluar 10 trajnime për të zhvilluar kapacitetet profesionale të stafit të MEPJ-së me qëllim garantimin e cilësisë në punë; janë realizuar gjithashtu 71 aktivitete protokollare si takime, vizita dhe pritje zyrtare të delegacioneve të larta shtetërore nga 100 te planifikuara; janë kryer 11 nga 18 auditime të programuara si dhe janë përgatitur 79 nga 54 raportime (detyrime kontraktuale) mbi konsulencat juridike, përfaqësimi në organet gjyqësore, prokurorisë dhe përmbarimit.

Programi Mbështetje diplomatike jashtë shtetit synon nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm, mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare e shtetërore dhe përkujdesin për interesat e qytetarëve shqiptarë kudo ata ndodhen. Në këtë program janë

parashikuar disa produkte, nga të cilat me realizim faktik për periudhën përmendim “Mbështetje e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese” për 359 punonjës, “Mbështetje e misioneve diplomatike dhe konsullore me logjistiken e nevojshme për përmbushjen e funksioneve” për 135 diplomat, “Trajtimi i familjeve të diplomatëve sipas ligjit” për 220 familjar diplomatësh dhe nuk ka realizim faktik për “Adresari i shtetasve shqiptar jashtë RSH” si edhe nuk jepen shpjegime pse nuk është realizuar aspak ky produkt, ndërsa “Pagesa e Kuotave Ndërkombëtare” konkretisht për vitin 2021 janë paguar 53 nga po të planifikuara. Ndërsa lidhur me projektet e investimit për vitin 2021 është realizuar blerja e 110 pajisjeve kompjuterike dhe 120 pajisje zyre për misionet diplomatike dhe postet konsullore.

Programi Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ, ka për qëllim zgjerimin, intensifikimin, diversifikimin, thellimin dhe pasurimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, në rajon, Europë, dhe vende të tjera të botës. Në këtë program janë hartuar 24 akte ligjore dhe nënligjore të planifikuara; janë kryer 6 vizita dhe takime lobimi për hapjen e negociatave nga 16 të planifikuara për tu zhvilluar në vijim; janë zhvilluar 115 nga 145 vizita, takime dhe konsultime dypalëshe dhe shumë palëshe; janë ofruar 7 shërbimet konsullore nga 19 të tilla të planifikuara si dhe janë zhvilluar 75 aktivitete promovuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të objektivave të diplomacisë ekonomike dhe diasporës nga 92 të planifikuar të zhvillohen.

Në këtë program nuk ka të planifikuar shpenzime kapitale për vitin 2021.

Programi Mbështetje institucionale për procesin e integritit, fokusohet në anëtarësimin e Shqipërisë në BE, nëpërmjet bashkërendimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, menaxhimit të fondeve të BE-së, zhvillimin e negociatave të anëtarësimit të RSH në BE, forcimin e rolit të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse si dhe informimin e publikut duke ruajtur parimin e aksesit të barabartë të grave në këtë proces. Në këtë program janë parashikuar 28 “Aktivitete të koordinuara për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian” nga të cilat janë realizuar 27 prej tyre për periudhën raportuese.

Gjatë vitit 2021, janë realizuar të ardhura nga veprimtaria konsullore si leje kalimi, lidhje martesë, prokura, noterizime, certifikata të ndryshme, vërtetime konsullore, përkthim dokumenti, aplikim për viza etj. (rreth 40 lloj shërbimesh konsullore) si më poshtë:

- Programi 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim” 109,017 mijë lekë
- Programi 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” 264,810 mijë lekë.

Krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese.

Kod. Prog	Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
		Ministria	Oracle	Diferenca	Ministria	Oracle	Diferenca	Ministria	Oracle	Diferenca
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	135,036	135,036	0	6,659	6,659	0	141,695	141,695	0
01120	Mbështetje diplomatike jashte shtetit	2,367,284	2,367,284	0	31,000	31,000	0	2,398,284	2,398,284	0
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	174,547	174,547	0	0	0	0	174,547	174,547	0
01150	Mbështetje institucionale për procesin e Integritimit	80,568	80,509	59	133,598	138,668	-5,070	214,166	219,178	-5,012
	MEPJ	2,757,435	2,757,376	59	171,257	176,327	-5,070	2,928,692	2,933,703	-5,011

Sikurse vihet re edhe nga tabela e mësipërme, të dhënat e paraqitura nga MEPJ krahasuar me të dhënat e nxjerra nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë **nuk përputhen plotësisht në programin** “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit”, për shpenzimet korrente në vlerën 59 mijë lekë dhe për shpenzimet kapitale në vlerën rreth 5 milionë lekë.

Titulli i Gjetjes 5:	<i>Mospërputhje në sisteme raportimi</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se ka mospërputhje mes të dhënave të regjistruara nga ana e MEPJ dhe nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë për shpenzimet korrente në vlerën 59 mijë lekë dhe për shpenzimet kapitale në vlerën rreth 5 milionë lekë
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 ”Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,
Ndikimi/Efekti:	Regjistrime të gabuara/inkoherecë mes dy sistemeve
Shkaku:	Mungesë kontrolli përputhshmërie informacioni
Rekomandimi:	Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të kontrolluar vazhdimisht përputhshmërinë me të gjitha sistemet e raportimit dhe për të paraqitur regjistrimet financiare në përputhje me ligjet, Udhëzimet dhe standardet e kontabilitetit.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Në vijimësi

Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit

Në mijë lekë

Programi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Diferencat
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	139,600	159,800	20,200
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,138,776	2,462,276	323,500
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	195,500	196,000	500
Mbështetje institucionale për procesin e integritetit	201,780	265,080	63,300
TOTALI	2,675,656	3,083,156	407,500

Sikurse vihet re edhe nga tabela më sipër, në të gjitha programet ka pasur ndryshime në vlerat buxhetore fillestare dhe ato aktuale. Këto ndryshime lidhen me shtesën e bërë në buxhetin e MEPJ për Fondin e Veçantë prej 1 milionë lekë, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 224, datë 7.4.2021 me vlerë 143.5 milionë lekë dhe me zbatimin e Aktit Normativ nr.26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, nëpërmjet së cilës janë shtuar 184 milionë lekë për shpenzimet korrente dhe 16 milionë lekë për shpenzime investimi.

Komente të tjera

- Raporti i monitorimit të Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme është paraqitur në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit, për njësitë e qeverisjes qendrore”. Ky raport, në përgjithësi paraqitet i plotë por kërkohet që në analizën narrative të ketë një argumentim të shkaqëve që kanë sjellë mosrealizim të fondeve/të produkteve apo aktiviteteve.
- Raporti i monitorimit të vitit 2021 për MEPJ nuk është plotësuar për të gjitha anekset shoqëruese sipas udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit, për njësitë e qeverisjes qendrore” nuk ka konsistencë në raportimin e të dhënave si brenda raportimit për 12 mujorin ashtu edhe në raportimin e të dhënave nga 8 mujori 2021 në 12 mujorin e vitit 2021. Psh: në Aneksin 3 thuhet se i është ofruar “Mbështetje e misionëve diplomatike dhe konsullore me logjistiken e nevojshme për përmbushjen e funksioneve” për 135 diplomat, ndërsa në aneksin nr. 4 raportohet për 52 diplomat. Ndërsa lidhur me jo koherencën midis periudhave mund të përmendim nr. e auditimeve të kryera për 8 mujorin 2021 ishte 12 dhe për gjithë vitin raportohet 11 numri i raportimeve.
- Realizimi faktik për vitin 2021 të raportuar nga MEPJ, krahasuar me atë të nxjerrë nga sistemi i thesarit Qeverisë nuk përputhet plotësisht në programin “Mbështetje institucionale për procesin e integritetit”, për shpenzimet korrente vlera është 59 mijë lekë dhe për shpenzimet kapitale vlera është rreth 5 milionë lekë.
- Pjesë e raportimit janë bërë edhe të ardhurat e krijuara nga MEPJ nga veprimtaria konsullore të cilat janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.
- Në analizën narrative nuk është bërë pjesë përcaktimi i pikës 148 të Udhëzimit nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, më poshtë cituar:

“Për plotësimin e anekseve të raporteve të monitorimit për vitin 2021 si dhe ato periodike dhe vjetore të vitit 2022, strukturat përgjegjëse për monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e

investimeve publike, në strukturat përgjegjëse për buxhetin në ML/IB, të dhënat do t'i sigurojnë nga raportet përkatëse të modulit të Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve (BPPM), në sistemin AFMIS. Këto të dhëna duhet të jenë të njëjta me të dhënat e strukturave buxhetore përkatëse në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ). Nëse nuk janë të barabarta, kjo duhet të evidentohet nga ana e ML/IB në relacionin shoqërues të raporteve të monitorimit, ku të jepen shpjegimet përkatëse. Gjithashtu në relacion duhet të evidentohen të gjitha problematikat që lidhen me përdorimin e raporteve të modulit të Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve (BPPM) me formatin apo përmbajtjen e tyre.”

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka publikuar në faqen e internetit raportin e monitorimit, pra mungon publikimi për vitin 2021.

VITI 2022

MBI ZBATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2022

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2022 menaxhon fondet publike në katër programe buxhetore

- Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, përfshin shpenzimet për aktivitetet me karakter mbështetës të institucionit.
- Programi “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, përfshin shpenzimet për funksionimin e përfaqësive të RSH-së në botë.
- Programi “Aktivitet diplomatik dhe konsullor i MPJ”, përfshin shpenzimet për aktivitetet e drejtorive politike në MEPJ të cilat hartojnë dhe zbatojnë politikën e jashtme të RSH.
- Programi “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit”, përfshin shpenzimet që kanë të bëjnë me drejtimin dhe bashkërendimin e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 paraqitet në masën 39%. Në realizimin e buxhetit të MEPJ në këtë nivel ka ndikuar mosrealizimi i projekteve me FH të cilat aktualisht menaxhohen nga struktura e ngritur për këtë qëllim SASPAK. Gjithashtu, sipas AN nr. 12, dt. 29.07.2022, në buxhetin e MEPJ u miratuan fonde shtesë në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, të cilat u bënë efektive në degën e thesarit në muajin gusht.

Sipas programeve buxhetore realizimi i buxhetit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në milionë lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti i vitit 2022	Realizimi i për periudhën janar-gusht 2022	Realizimi në %
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	225,711	121,709	54
2	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,452,596	881,976	36
3	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	194,209	124,952	64

4	Mbështetje institucionale për procesin e integritetit	172,409	75,293	44
	Totali:	3,044,925	1,203,930	40

Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

Programi 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 10.1 përqind të totalit të shpenzimeve të institucionit për periudhën 8-mujore. Sipas strukturës buxhetore realizimi i buxhetit paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 59 përqind
- Shpenzime të tjera operative 57 përqind
- Shpenzime kapitale 30 përqind
- Gjithsej: 54 përqind

Për vitin 2022 në këtë program, janë parashikuar 9 produkte, të cilat rezultojnë të realizuara si në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2022 (në 000 lekë)	Realizimi për periudhën janar – gusht 2022		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i produktit
Akte Ligjore dhe Nënligjore të hartuara	95,487	62,111	65	Pjesërisht
Punonjës të rekrutuar dhe të trajnuar	2,050	0	0	Aspak
Detyrime kontraktuale	57,724	37,724	65	Pjesërisht
Misione auditimi të kryera sipas standardeve	3,090	823	26	Pjesërisht
Aktivitete protokollare dhe veprimtari protokollare sipas Ceremonialit të RSh-së	12,360	4,667	38	Pjesërisht
Rikonstruksion Ambientesh	17,000	15,832	93	Plotësisht
Blerje dhe vendosje gjeneratori	6,000	0	0	Aspak
Pajisje kompjuterike të blera	1,000	552	55	Pjesërisht
Shpenzime funksionale për Shërbimin e Diasporës	31,000	0	0	Aspak
TOTALI:	225,711	121,709	54	

Produktet e programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim” paraqitet me status realizimi të pjesshëm.

Objektivat që synohen të arrihen në programin “Planifikim menaxhim, administrim”, janë :

- Përmirësim i planifikimit të burimeve financiare dhe materiale si dhe rritja e efektivitetit në administrimin e tyre.

- Menaxhim efektiv dhe racional i burimeve njerëzore dhe teknologjisë së lartë për të rritur reagimin dhe cilësinë e shërbimit diplomatik. Përmirësim i teknologjisë së informacionit e komunikimit nëpërmjet rritjes së sigurisë dhe cilësisë së transmetimit të informacionit e komunikimit, mbështetjes me teknologji të reja si dhe garantimit të funksionimit të sistemeve të pajisjeve në përdorim.
- Rritja e vazhdueshme e cilësisë së punës dhe veprimit të burimeve njerëzore të shërbimit të jashtëm, përmes kurseve të përditësimit të dijeve, përmes trajnimit dhe cikleve të kualifikimeve të përgjithshme dhe të posaçme, brenda dhe jashtë vendit si dhe në lidhje me botimet konvencionale (libri, dokumenti, biblioteka MEPJ në shërbim të punës së diplomatit) dhe ato dixhitale elektronike në synim të rritjes së studimit, analizës dhe parashikimit të aksionit tonë në politikën e jashtme.
- Përmirësim i kushteve për ruajtjen, administrimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit historik arkivor 100-vjeçar dhe atij të krijuar rishtazi nga shërbimi i jashtëm, në mbështetje të interesave të politikës së jashtme shqiptare dhe interesave studimore të publikut.
- Menaxhim me efektivitete të fondeve buxhetore për realizimin e buxhetit vjetor të planifikuar për prokurimin e fondeve për mallra dhe shërbime në funksion të nevojave të institucionit duke përmirësuar metodat e vlerësimit të burimeve financiare, në respekt të parimeve të transparencës e të ligjshmërisë për një administrim sa më të saktë të vlerave materiale dhe monetare.
- Përmirësim i punës në mbarëvajtjen e aktivitetit diplomatik dhe në veçanti të vizitave zyrtare jashtë dhe brenda vendit, të konferencave brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrje në samite dhe ministeriale të nivelit të lartë.
- Rritja e cilësisë së veprimtarisë audituese në funksion të përmirësimit të sistemeve të kontrollit të brendshme në MEPJ.
- Përmirësim i ambienteve dhe kushteve të punës në MEPJ.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërme janë realizuar aktivitete:

- Trajnimi i stafi të MPJ-së për të mundësuar zhvillimin e kapaciteteve profesionale me qëllim garantimin e cilësisë së punës.
- Mbarëvajtja e vizitave zyrtare të delegacioneve të larta shtetërore.
- Përgatitja e një sërë raportesh mbi konsulencat juridike, përfaqësimi në organet gjyqësore, prokurorisë dhe përmbartimit.
- Plotësimi i strukturës së personelit të MEPJ me prurje të reja dhe transferimit nga përfaqësitë diplomatike.
- Përgatitja e raporteve buxhetore: raporteve të Monitorimit, raporteve të detyrimeve të prapambetura, raporte të tjera në zbatim të Udhëzimit nr. 2 të MF Për zbatimin e buxhetit”, raporte financiare /Bilanci në kuadër të planifikimit dhe analizave të burimeve financiare të institucionit.
- Programe trajnimi të Akademisë Diplomatike Kombëtare me synim edukimin e përgjithshëm të diplomateve të së nesërme por dhe rritjen e njohurive të diplomateve për historinë e politikës së jashtme të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2022, buxheti i programit “Planifikim, menaxhim administrim” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Shtesë buxheti nga Fondit të Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	600,000	-

Pakësim buxheti në zbatim të Aktit Normativ nr. 3 datë, 12.03.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
AN nr.3 datë 12.03.2022	600	Akte ligjore dhe nënligjore te hartuara (Paga)	-	2,857,560-
	601	Akte ligjore dhe nënligjore te hartuara (Sigurim shëndetësor)	-	412,500
	602	Detyrime kontraktuale	-	27,501,200

Pakësim buxheti në zbatim të VKM nr 295, datë 11.05.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
VKM nr. 295, datë 11.05.2022	600	Akte ligjore dhe nënligjore te hartuara (Paga)	-	9,856,560-
	601	Akte ligjore dhe nënligjore te hartuara (Sigurim shëndetësor)	-	1,507,620
	602	Detyrime kontraktuale	-	20,400,000

Shtesë buxheti në zbatim të Aktit Normativ nr. 12, datë 29.07.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
AN nr. 12 datë 11.05.2022	602	Detyrime kontraktuale	20,000,000	-

Transferim për institucion varësie:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
Transferim	600	Akte ligjore dhe nënligjore te hartuara (Paga)	-	18,802,442
	601	Akte ligjore dhe nënligjore te hartuara (Sigurim shëndetësor)	-	2,926,542
	602	Detyrime kontraktuale	-	34,381,106

Realizimi i shpenzimeve për fondet e transferuara pranë Agjencisë së Diasporës dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Diasporën.

- Aktivitete AKD 2,035,653 lekë
- Aktivitete QSPA 2,518,854 lekë

Programi 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.

Programi “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” përfshin tërësinë e funksioneve dhe shërbimeve që ofrojnë përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së jashtë vendit, në përputhje me

Kushtetutën, normat e së drejtës ndërkombëtare, ligjin për shërbimin e jashtëm dhe të tjera akte ligjore. Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson 73.3% të totalit të shpenzimeve të institucionit për periudhën 8-mujore. Sipas strukturës buxhetore realizimi i buxhetit paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 43 përqind
- Shpenzime të tjera operative 33 përqind
- Shpenzime kapitale 47 përqind
- Gjithsej: 36 përqind

Në këtë program janë parashikuar 8 produkte, performanca e të cilëve në përqindje me planin e rishikuar jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2022 (në mijë lekë)	Realizimi për periudhën janar-gusht 2022		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i realizimit
Misioneve diplomatike dhe posteve konsullore mbështetur me kushte te përshtatshme	1,512,658	632,310	42	Pjesërisht
Misioneve diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me logjistikën e nevojshme	271,000	0	0	Aspak
Familjare të diplomateve të trajtuar sipas ligjit	71,000	17,100	24	Pjesërisht
Shtetasve shqiptar qe jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë te regjistruar	35,000	0	0	Aspak
Kuota Ndërkombëtare	349,760	225,547	64	Pjesërisht
Këshilli i Sigurimit	198,151	0		Aspak
Pajisje zyre te blera	7,000	7,000	100	Plotësisht
Pajisje kompjuterike te blera	8,000	0	0	Aspak
TOTALI:	2,452,596	881,976	36	

Ky program synon realizimin e objektivave:

- Përmirësim i strukturave dhe metodave të punës të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj të gjithë personave të interesuar.
- Avancim i procesit të integrimit Evropian, pjesëmarrje aktive në NATO, konsolidimi i marrëdhënieve dy dhe shumë palëshe, me fokus të veçantë dimension ekonomik tregtar si dhe ekspozimin tonë kulturor jashtë vendit, kontribut konstruktiv në rajon dhe organizata ndërkombëtare, avancim i procesit të njohjeve dhe integrimit ndërkombëtar të Kosovës.
- Sigurim i përfaqësimit diplomatik dhe konsullor efikas dhe profesional në vendet e tjera, në organizata ndërkombëtare dhe nisma rajonale. Përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe të jetesës, përfshirë ato të sigurisë së personelit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të rritjes së cilësisë së punës dhe arritjen e rezultateve.
- Sigurimi i një komunikimi të vazhdueshëm, të shpejtë, të sigurt dhe të ndërsjellët ndërmjet MEPJ dhe posteve konsullore duke shfrytëzuar teknologjinë bashkëkohore të informacionit.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërme rezultojnë të realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Derdhja e pjesshme e kontributeve vjetore për organizatat ku vendi ynë është palë si: detyrimet ndaj Organizatës së Kombeve të Bashkuara; Misioneve Paqeruajtëse; Frankofonisë; ANEA-s; UNIDO-s; UNESCO; Këshilli i Evropës, NATO-s; OSBE-së etj.
- Raporte mbi zgjerimin e shërbimeve konsullore ku theksojmë procesin e lëshimit të certifikatave nga përfaqësitë diplomatike.
- Përmirësim i strukturës dhe performancës së përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve.
- Aktivitetet me Diasporën Shqiptare.
- Shqipëria merr Presidencën e Keshillit të Sigurimit të OKB-së.

Gjatë 4 mujorit të II-rë të vitit 2022, buxheti i programit “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Pakësim buxheti në zbatim të Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
AN nr.3 datë 12.03.2022	600	Misione diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me kushte të përshtatshme pune (Paga)	-	19,412,500
	601	Misione diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me kushte të përshtatshme pune (Sigurim shëndetësor)	-	1,512,500
	602	Misione diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me kushte të përshtatshme pune(shpenzime operative)	-	132,192,800

Shtesë buxheti në zbatim të VKM nr. 406, datë 10.06.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
VKM nr 406 datë 10.06.2022	605	Kuota Ndërkombëtare	116,760,000	-

Shtesë buxheti në zbatim të AN nr. 12, datë 29.07.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
VKM nr .12 datë 29.07.2022	602	Misione diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me kushte të përshtatshme pune(shpenzime operative)	82,000,000	-

Transferim fondi:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
Transferim	600	Misione diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me kushte të përshtatshme pune (Paga)	-	15,000,000

	601	Misione diplomatike dhe poste konsullore mbështetur me kushte të përshtatshme pune (Sigurim shëndetësor)	15,000,000	-
--	-----	--	------------	---

Programi 01130 “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ” përfshin aktivitetet të cilat vënë në zbatim prioritetet e politikës së jashtme të RSH-së sipas programit të qeverisë. Në thelb të këtij programi qëndron përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave kombëtare dhe të shtetasve shqiptar.

Krahasuar me zërat e planit të buxhetit, realizimi i shpenzimeve në këtë program i cili përfaqëson rreth 10.4 përqind të totalit të shpenzimeve të institucionit për 8-mujorin, rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të personelit 73 përqind
 - Shpenzime të tjera operative 47 përqind
 - Shpenzime kapitale 0 përqind
- Gjithsej: 64 përqind

Për vitin 2022 në këtë program janë parashikuar 6 produkte, realizimi i të cilëve krahasuar me planin jepet në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Buxheti 2022 (në mijë lekë)	Realizimi për periudhën janar- gusht 2022		
		Në 000 lekë	Në %	Statusi i realizimit
Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara	126,763	93,122	74	Pjesërisht
Takime lobim për hapjen e negociatave	0	0	0	Aspak
Takime diplomatike dy dhe shumë palëshe	29,106	16,395	56	Pjesërisht
Shërbime konsullore të ofruara	4,160	3,585	86	Pjesërisht
Aktivite promovuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të objektivave të diplomacisë ekonomike publike dhe diasporës	11,300	3,118	28	Pjesërisht
Këshilli i Sigurimit	22,880	8,732	38	Pjesërisht
TOTALI:	194,209	124,952	64	

Ky program synon realizimin e objektivave:

- Marrja e miratimit nga Këshilli i BE-së për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian. Zhvillimi i bisedimeve të anëtarësimit me BE-në dhe thellimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me Bashkimin Evropian.

- Zhvillimi i mëtejshëm i tërësisë së marrëdhënieve me vendet e tjera me prioritet marrëdhëniet me partner strategjik, vendet mike dhe Ae si dhe vendet fqinjë.
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të RSH-së në kuadër të NATO-s dhe në tërësi në favor të paqes dhe sigurisë në Rajon e më gjerë.
- Përbushje e angazhimeve në kuadër të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare nëpërmjet një politike pro aktive.
- Lidhja e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, bërja palë në konventa ndërkombëtare dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe evropiane.
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike, ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtar dypalësh dhe shumëpalësh.
- Realizimi i një shërbimi konsullor të mbështetur në profesionalizëm, efeciencë, transparencë dhe përgjegjshmëri.
- Rritja e përfaqësimit të grave në strukturat e shërbimit të jashtëm.

Në funksion të përbushjes së objektivave të mësipërme, janë realizuar aktivitete si vijon:

- Nënshkrimi i marrëveshjes së Partneritetit të Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republike së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut.
- Vizita zyrtare e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme në Itali
- Nënshkrimi i kalendarit të aktiviteteve të përbashkëta në diplomacinë publike midis Shqipërisë dhe Kosovës.
- Nënshkrimi i marrëveshjes për njohjen e ndërsjelle të lejeve të drejtimit midis Shqipërisë dhe Italisë
- Aktivitete diplomatike në kuadër të politikës konstruktive të vendit tonë në shërbim të integritetit evropian.
- Konsultime diplomatike në nivele specialistësh dhe Drejtorësh Drejtorie.
- Pjesëmarrje e zëvendësministrit në takim të koalicionit global në shkatërrimin e ISIS.
- Organizmi i Forumit të Shtatë të Nismës Adriatiko Joniane NAJ/EUSAIR
- Pjesëmarrje e zëvendësministrit në Takimin e Biznesit në Lombardi.
- Pjesëmarrja e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme në Sesionin e 132-të të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.
- Pjesëmarrja e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme në Samitin e NATO-s.

Gjatë periudhës janar-gusht 2022, buxheti i programit “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ” ka pësuar ndryshimet si vijon:

Shtesë buxheti nga Fondit të Veçantë i Qeverisë:

Fondi i Veçantë	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
	606	Transferta për buxhete familjare dhe individ	500,000	-

Pakësim buxheti në zbatim të Aktit Normativ Nr. 3 datë, 12.03.2022:

	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Shtesa	Pakësimi
AN nr.3 datë	600	Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara (Paga)	-	2,712,500
12.03.2022	601	Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara (Sigurim shëndetësor)	-	525,000
	602	Detyrime kontraktuale	-	7,494,000

Programi 01150 “Mbështetje institucionale për procesin e integritit”.

Programi “Mbështetje institucionale për procesin e integritit” ka në thelb të tij zbatimin e prioritetëve të politikës së jashtme të Qeverisë shqiptare dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim me qasje drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Gjatë katër mujorit të dytë të vitit 2022, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin e planit të buxhetit të vitit 2022 të miratuar, si më poshtë

	Plani 2022	Pakësim sipas Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022 dhe Aktit Normativ Nr. 12, datë 29.07.2022	Buxheti i rishikuar 2022	Fakti 4-mujor II 2022	Realizimi në % kundrejt planit vjetor
Paga	29,500	-7,737	21,763	13,751	63.2
Sigurime shoqërore	4,000	-100	3,900	2,737	70.2
Trans për Buxh. Fam. & Individ	0	200	200	42	21.0
Mallra dhe Shërbime të Tjera	49,740	-4,974	44,766	18,010	40.2
TOTALI pa FB+FH:	83,240	-12,611	70,629	34,540	48.9
Kapitale të brendshme	21,000	0	21,000	8,682	41.3
Financime të huaja total	80,780	0	80,780	32,071	39.7
TOTALI përfshirë FB+FH:	185,020	-12,611	172,409	75,292	40

Gjatë katër mujorit të dytë të vitit 2022, për programin “Mbështetja institucionale për procesin e integritit”, sikurse tregohet edhe në tabelën e mësipërme, janë përdorur 34 540 000 lekë nga 70 620 000 lekë ose afërsisht 48.9% e buxhetit të alokuar (pa përfshirë FB+FH) pas Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022 dhe Aktit Normativ Nr. 12, datë 29.07.2022.

Duke marrë në konsideratë edhe shpenzimet kapitale të brendshme dhe financimet e huaja (FB+FH), janë përdorur gjithsej 75,292,304 lekë nga 172 409 000 lekë ose afërsisht 38.4% e buxhetit pas akteve normative të sipërpërmendura.

Nr	Emri i produktit	Buxheti 2022 në 000/lekë	Buxheti i rishikuar 2022 në 000/lekë	Realizimi 4-mujori II i 2022		
				Në mijë lekë	Në %	Statusi i produktit
1.	Aktivite të koordinuara për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian	83,240	70,629	34,540	48.9	Pjesërisht
TOTALI:		83,240	70,629	34,540	48.9	Pjesërisht
	Projekti Platform	6,100	6,100	730	12	
	Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile	4,580	4,580	566	0	
	Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Mali i Zi	7,400	400	0	0	
	Asistencë teknike IPA – CBC Greqi – Shqipëri	27,350	5,350	3,888		
	Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Maqedoni	4,200	200	0	0	
	Asistencë teknike IPA – CBC Shqipëri – Kosovë	7,500	500	0	0	
	Asistencë teknike MED (Mesdheu)	3,600	3,600	0	0	
	PPF/ SEI	4,700	4,700	0	0	
	Asistencë teknike IPA – CBC Ballkan – Mediteran	1,800	1,800	1.7	0	
	Asistencë teknike IPA – CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi	17,500	17,500	4,066	0	
	Asistenca teknike IPA – CBC Adrion	6,750	6,750	2	0	
	Asistenca teknike IPA – CBC Adrion (EUSAIR)	6,000	6,000	0	0	
	Asistencë Teknike për Programet Evropiane	4,250	4,250	15,443		
	Projekti IPA CBC SMART ADRIA					
Totali (FB+FH)		101,780	101,780	32,071	31.1	Pjesërisht

Programi buxhetor “Mbështetje institucionale për procesin e integritimit” ka një produkt “Aktivite të koordinuara për mbështetjen institucionale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian”, i cili në vlerë është realizuar 34 540 000 lekë ose 48.9% krahasuar me planin vjetor të rishikuar.

Në kuadër të këtij produkti, gjatë 4-mujorit të dytë të vitit 2022 janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Dy takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ky aktivitet është realizuar pjesërisht:
 - Takimi i Nënkomitetit Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, më datë 5 maj 2022;
 - Takimi i Nënkomitetit Tregtia, industria, doganat dhe tatimet, më datë 29 qershor 2022.
- Hartimi i kontributit të dytë të Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, i cili iu paraqit shërbimeve të Komisionit Evropian më datë 22 qershor

2022. Kontributi i parë ishte paraqitur më datë 20 prill 2022. Ky aktivitet është realizuar plotësisht për vitin 2022;

- Monitorimi i realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për tremujorin e dytë të vitit 2022. Ky aktivitet është realizuar pjesërisht;
- Në katër mujorin e dytë të vitit 2022, është dhënë mendim për 28 akte ligjore. Ky aktivitet është plotësuar pjesërisht. Numri i mendimeve mbi përafrimin e projekt akteve shqiptare me legjislacionin e Bashkimit Evropian varet nga numri i projekt akteve të paraqitura për miratim nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore;

Gjatë katër mujorit të dytë janë përkthyer 1,073.51 faqe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe 188.295 faqe nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, në fushat e drejtësisë, prokurimit publik, energjisë, mbrojtjes, shëndetësisë, punëve të brendshme, arsimit dhe financës. Procesi i certifikimit për të gjitha fushat e përkthyer, ka mbetur ende i përcaktuar. Ky aktivitet është plotësuar pjesërisht.

Monitorimi i projekteve të huaja nga strukturat e MEPJ është i pamundur, pasi punonjësit që menaxhojnë projektet tashmë janë transferuar në strukturat e SASPAC, ndërkohë që fondet buxhetore të projekteve (FH+FB) janë përfshirë në buxhetin e MEPJ për vitin 2022.

Konkluzion:

Nga sa konstatohet më sipër gjatë planifikimit dhe realizimit të buxhetit nga ana e MEPJ për periudhën objekt auditimi janë konstatuar disa devijime nga kuadri ligjor si dhe mos realizime dhe tejkalime të buxhetit të planifikuar. Këto mos realizime pjesërisht kanë ardhur nga situata e krijuar nga pandemia COVID-19, pjesërisht nga parashikimet jo të sakta të strukturave planifikuese sipas rastit. Gjithashtu janë konstatuar dhe mosrakovime ndërmjet sistemeve të raportimit pranë MFE siç identifikohen për çdo rast në materialin më sipër.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023 dhe administruar nga grupi i auditimit më 21.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në faqen 7 të observacioneve paragrafi parë shprehet se: Për sa konstatuar në gjetjen nr. 52 të projekt raportit sqarojmë se, MEPJ referuar ligjit nr. 9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" ka përcjellë në MF dokumentin e Projektbuxhetit Afatmesëm 2022-2024 në të cilin referuar udhëzimeve të MF për përgatitjen e dokumentit të PBA, në fazën strategjike të tij (Faza I), ka paraqitur sipas formateve të miratuar kërkesa për financim shtesë për projekte të cilat nuk mund të përballohen nga tavanet buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave. Kërkesat shtesë të paraqitura janë prioritetizuar dhe argumentuar si shumë të domosdoshme nga ana e MEPJ sepse shërbejnë:

-për përmirësimin e strukturës dhe të metodave të punës të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj të gjithë personave të interesuar nëpërmjet çeljes se katër posteve konsullore (Konsullata të Përgjithshme) në Ulqin, Strugë, Guanzhou dhe Liban.

-për të siguruar një vijueshmëri normale të aktivitetit të programit 01150 "Mbështetja institucionale në procesin e integritetit.

-për përballimin e efekteve në zbatim të VKM nr. 116, datë, 13.03.2019, "Për ngritjen e strukturës së Task Forcës dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 77, dt. 17.04.2019 "Për miratimin e organikes së Task-Forcës e cila është struktura përgjegjëse për kryesimin e OSBE-së".

Ministria e Financave ka tagër të marr në konsiderate ose jo kërkesat shtesë të paraqitura nga ana e MEPJ. Mos marrja në konsideratë e tyre ose marrja në konsideratë pjesërisht mbetet në diskecion të MF.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja observacioni nuk merret në konsideratë: sqarojmë se çelja e konsullatave apo ambasadave të reja është në vendimarrjen dhe politik bërjen e Shtetit shqiptar dhe domosdoshmërisht do marrin financimet e kërkuara, por nisur nga kërkesa për shtesë buxheti për këtë qëllim tregon në një parashikim dhe studim jo të mirë të politikave afatshkurtra dhe afatmesme të MEPJ dhe si rrjedhe në pasojën e mos marrjes së financimit të plotë dhe mos funksionimit të këtyre konsullatave.*

2.2 Mbi Pasqyrat Financiare të Institucionit:

Auditimi i Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (Aparati) .

Për vitet objekt auditimi ky Institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të strukturuar brenda Drejtorisë së Financës.

Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020 dhe 2021 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme është bërë në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar me Ligjin nr.9477 datë 09.02.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 9228" dhe Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, dhe Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 "Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjsteve që varen prej tyre", ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njëjsteve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj".

Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të Ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- Aktivet ekzistojnë fizikisht;
- ato i përkasin subjektit;
- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte;
- janë regjistruar në mënyrë korrekte;

- është bërë mire ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuarra dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivitet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivitet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivitet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivitet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuarra;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Pasqyrat financiare viti 2020 .

Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit me shkresën nr.100 prot, datë 15.03.2021 konfirmuar nga dega e thesarit. Pra bilanci kontabël i vitit 2020 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Pasqyrat financiare të MEPJ janë të formatit të vjetër.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin sipas formatit nr.1; Pasivin sipas formatit nr.2; Shpenzime të ushtrimit sipas formatit 3/1, Të ardhurat e ushtrimit sipas formatit 3/2; Pasqyrën financiare të burimeve dhe shpenzimeve lidhur me investimet sipas formatit nr.4; Pasqyrën e

lëvizjeve në 'cash' sipas formatit nr.5; Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në e Aktiveve të Qendrueshme sipas formatit nr.6; Pasqyrën e amortizimeve sipas formatit nr.7; Pasqyrën e lëvizjes së fondeve sipas formatit nr.8; Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.9 si dhe Pyetësin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.12

Gjetje nr.1

Nga auditimi rezultoj se, nga ana e MEPJ për hartimin e pasqyrave financiare mungon përditësimi me Udhëzimin aktual në fuqi.

Aktualisht operohet bazuar në dispozita ligjore që janë të shfuqizuara dhe jo sipas UMFE nr.8 datë 09.03.2018, i ndryshuar për "Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Titulli i Gjetjes 1:	Hartimi i Pasqyrave Financiare
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MEPJ për hartimin e pasqyrave financiare mungon përditësimi me Udhëzimin aktual në fuqi. Aktualisht operohet ende bazuar në Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj" dhe jo sipas Udhëzimit aktual në fuqi nr.5 datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në UMFE nr.8 datë 09.03.2018 për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me planin kontabël të miratuar për institucionet Udhëzimi nr.46, datë 24.12.2020 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020", Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021", Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë

	21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF 10, datë 27.02.2008 për ndryshim UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”
Ndikimi/Efekti:	Operim jo konform formateve të miratuara në fuqi në Udhëzimin e MFE-së
Shkaku:	Mos përditësim me rregullat dhe udhëzimet aktuale.
Rekomandimi:	- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimet dhe formatet zyrtare aktuale të miratuara nga MEF.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Në vijimësi

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2020 rezultoi:

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në çelje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2020	Pakësime gjatë vitit 2020	Gjendja në mbyllje	Ndryshimi
Aktive të trupëzuara					
Ndërtim edhe konstruksione	402,340,488	54,144,930	5,934,310	450,551,108	48,210,620
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	127,244,100	3,801,300	8,824,809	122,220,591	(5,023,509)
Mjete transporti	20,915,618	-	5,856,549	15,059,069	(5,856,549)
Inventar Ekonomik	18,614,641	-	558,440	18,056,201	(558,440)
Totali	569,114,847	57,946,230	21,174,108	605,886,969	36,772,122

Burimi: MEPJ, përpunoi grupi auditimit

Nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtime e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej afërsisht 74% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, pas saj vijon llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” e cila zë peshën prej 20% , llogaria “Inventar ekonomik” me peshën prej 3.5% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe në fund me peshën më të vogël prej 2.5% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara përfaqësohet llogaria “Mjete transporti”.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2020, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2020	2019	Diferenca 2020 – 2019
A	AKTIVE	605,886,969	569,114,847	36,772,122
21,23,24,28	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara	605,886,969	569,114,847	36,772,122
212	Ndërtime e Konstruksione	450,551,108	402,340,488	48,210,620
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	122,220,591	127,244,100	(5,023,509)
215	Mjete transporti	15,059,069	20,915,618	(5,856,549)
218	Inventar ekonomik	18,056,201	18,614,641	(558,440)
B	Aktive Qarkulluese	108,137,613	108,091,382	46,231
Klasa 3	I.Gjendje inventari	13,235,403	14,201,425	(966,022)
31	Materiale	13,235,403	14,201,425	(966,022)
klasa 4	II. Kërkesa arkëtimi mbi debitorë	51,968,310	80,142,397	(28,174,087)
423-428	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	5,329,300	5,704,760	(375,460)
4342	Të tjera operacione me shtetin	29,362,929	57,161,556	(27,798,627)
468	Debitorë të ndryshëm	17,276,081	17,276,081	-
50-59	Llogaritë financiare	42,933,900	13,747,560	29,186,340
20	Aktive Afatgjata Jomateriale	0	0	-
50	Letra me vlerë të vendosjes (pulla konsullore)	42,933,900	13,747,560	29,186,340
	TOTALI I AKTIVIT	714,024,582	677,206,229	36,818,353

Burimi: MEPJ, përpunoi grupi auditimit

Zëri Aktive paraqitet për lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive qarkulluese” plus “Aktive të qëndrueshme”.

Aktive qarkulluese. Totali i kësaj rubrike përfaqëson shumën e përgjithshme të posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Disponibilitete”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Gjendja e inventarit me vlerën 13,235,403 lekë.

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një pakësim me 966,022 lekë nga viti i shkuar 2019. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 13,235,403 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 966,022 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2020.

Në total ndryshimi i gjendjes së materialeve është pakësuar me 966,022 lekë, e barabartë me llogarinë 63 evidentuar në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit.

2. Kërkesa arkëtimi mbi debitorë me vlerë 51,968,310 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 29,362,929 lekë shtuar nga viti shkuar me 29,186,340 lekë, kjo llogari përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin

dhjetor 2020, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj si dhe fatura të pa likuiduara të vitit korrent.

Furnitore e llogari te lidhura me to (401)	1,254,888
Furnitore e llogari te lidhura me to (467)	6,169,389
Paga Dhjetor 2020 (421)	14,580,200
Tatim te ardhura personale Dhjetor 2020 (431)	1,564,498
Sigurime Shoqërore (435) Dhjetor 2020	4,935,814
Sigurime Shëndetësore (436) Dhjetor 2020	641,850
Djeta punonjësish	216,560
Totali detyrimeve	29,362,929

Llogaritë e grupit 423-429 "Personeli paradhënie deficite e gjoba" për 5,329,300 lekë dhe përfaqëson paradhënie të punonjësve në Euro dhe Dollar, të pambyllura në vitin 2020. Pakësuar nga viti i shkuar me 375,460 lekë.

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" për 17,276,081 lekë, mbartur ndër vite dhe përfaqëson detyrime të subjekteve private dhe punonjësve të konstatuara nga KLSH.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, lidhur me këtë llogari (llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm") me vlerë 17,276,081 lekë e mbartuar ndër vite, nga ana e MEPJ nuk janë marr masa për iniciimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve ndaj Ministrisë.

3. Llogaritë financiare në vlerën 42,933,900 lekë

Kjo llogari përbëhet nga llogaria 50 "letra me vlerë të vendosjes (pulla konsullore)" për 42,933,900 lekë. Shtuar nga viti shkuar me 29,186,340 lekë dhe përfaqëson tituj (pulla konsullore) të blerë për të realizuar qëllime afatshkurtra. Shtimi i lartë vjen si rrjedhojë e rritjes së sasisë së pullave konsullore gjendje në fund të vitit si nga reduktimi i aktivitetit konsullor për shkak të shpalljes së emergjencës kombëtare COVID-19.

Aktive të qëndrueshme. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 605,886,969 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive "aktive të qëndrueshme të trupëzuara" dhe "aktive të qëndrueshme të trupëzuara".

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Llogaritë e grupit 21,23,24,28 "Aktive të qëndrueshme të trupëzuara" me vlerë totale prej 605,886,969 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 36,772,122 lekë përbëhet nga:

Llogaria 212 "Ndërtime dhe konstruksione" në vlerën e 450,551,108 lekë, shtuar nga viti shkuar me 48,210,620 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie përfshihet vlera prej 52,601,250 lekë rikonstruksioni godinës në vitin 2020 dhe 1,543,680 lekë mbikëqyrje punimesh të godinës viti 2020. (vlera më 31.12.2019 prej 456,485,418 me normën 1.3% vlera e amortizimit 5,934,310 lekë.

Gjetje nr.2:

Nga shqyrtimi dhe analiza e të dhënave dhe informacioneve të trajtuara në relacionin shoqëruar të pasqyrave financiare, evidentohet se, nga ana e MEPJ-së në përbërje të llogarisë 212 "Ndërtime

dhe konstruksione” përfshihet në masën prej 52,601,250 lekë rikonstruksioni godinës kryer në vitin 2020 dhe në masën 1,543,680 lekë vlera për mbikëqyrje punimesh të këtij rikonstruksioni.

Nga auditimi rezulton problematika si më poshtë vijon:

- MEPJ ka llogaritur për vitin 2020 shpenzime amortizimi mbi vlerën e ndërtesave ndërkohë që këtë aset nuk e disponon as në pronësi dhe as në përdorim.

Për sa më sipër nga MEPJ nuk janë kryer procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek MEPJ dhe ato kontabël për përcaktimin e aktiveve afatgjata në përdorim të institucioneve të varësisë dhe të tjera, në kundërshtim me pikën nr.10 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, i ndryshuar, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Gjetje nr.2.1:

Nga auditimi konstatohet problematikë sa i takon kontabilizimit të vlerës së garancisë së ndërtimit, 5% i garancisë duhet kontabilizuar në llogarinë 466 “kreditorë për mjete në ruajtje”. Kjo llogari është specifike në sektorin publik. Në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve. Të tilla janë:

- ✓ Garancitë bankare të ndryshme;
- ✓ Rimbursimi i TVSH nga llogaria e tatimeve;

Nga auditimi u konstatua mungesë e kësaj llogarie në pasqyrat financiare, pra as për garancinë e punimeve dhe as për rimbursimin e TVSH nga llogaria e tatimeve nuk është prekur kjo llogari.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Lidhur me llogarinë 212 – Ndërtime dhe konstruksione, shuma prej 52 601 250 lekë është rikonstruksioni i godinës i cili ka përfunduar në 2019. Vlera e tij është përfshirë e plotë në llogarinë 212 sipas projektit dhe sipas fondeve të çelura në degën e thesarit në zërin 231 me kod projekti M 15 00 30. Vlera 52 601 250 lekë nuk mund të ndahet në rikonstruksion (212) dhe shpenzime mirëmbajtje (602). Fatura vjen e shoqëruar me situacionin përkatës dhe i përket e gjitha zërit investime.

Gjithashtu shuma prej 1 543 680 lekë – mbikëqyrje punimesh – në degën e thesarit fondi është hapur në zërin 231 (investime). Ata nuk e likujdojnë atë nga shpenzimet operative 602.

Meqënëse likujdohet nga zëri 231 – investime, mbikëqyrja e punimeve është pjesë e investimit dhe i shtohet vlerës totale. Referuar Udhëzimit nr. 8 dt 09.03.2018 faqe 34 – 35, në AAGJM përfshihen “Kostoja e blerjes së bashku me taksat” dhe “Kosto të tjera të drejtpërdrejta si kosto projektimi, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj”. Gjithashtu sipas këtij udhëzimi faqja 34 – Amortizimi në sektorin publik ka veçori, sepse nuk ka ndikim në shpenzimet e institucionit. Lidhur me garancinë 5 % të shumës 52 601 250 lekë, kjo shumë në masën 3 749 397 lekë është ndalur te U.SH nr. 1007 dt 13.12.2019 (bashkëngjitur) dhe është kthyer me U.SH nr. 828dt 24.12.2020. Është e pasqyruar te Akt rakordimi i 2020. Amortizimi është llogaritur sipas VKM nr. 401 dt 23.10.1989, pasi ky vendim nuk është shfuqizuar. Udhëzimi nr, 8 dt 09.03.2018. nuk mund të ketë përparësi mbi një vendim qeverie. Amortizimi i automjeteve është llogaritur vetëm mbi vlerën e 5 automjeteve dhe 1 motoçiklet nga 28 automjete që ka institucioni. Pasi vetëm ato kanë vlerë të mbetur, ndërsa te tjerat nga pikëpamja kontabël janë 100 % të amortizuara dhe nuk janë në gjendje pune. Janë bërë procedurat për nxjerrjen nga përdorimi, por nuk është bërë asgjësimi i tyre.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm, rezulton se MEPJ ka dërguar mot a mot të njëjtin observacion me atë të pasqyruar edhe në fazën e projekt raportit lidhur me këtë çështje. Sa më sipër, në mungesë të paraqitjes së fakteve të reja apo dokumentacionit të ri justifikues grupi auditimit vijon të mbajë të njëjtin qëndrim.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes 2:	<i>Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione”</i>
Situata:	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e të dhënave dhe informacioneve të trajtuara në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare, evidentohet se, nga ana e MEPJ-së në përbërje të llogarisë 212 “Ndërtime dhe konstruksione” përfshihet në masën prej 52,601,250 lekë rikonstruksioni godinës kryer në vitin 2020 dhe në masën 1,543,680 lekë vlera për mbikëqyrje punimesh të këtij rikonstruksioni.</p> <p>Nga auditimi rezulton problematika si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none">• MEPJ ka llogaritur për vitin 2020 shpenzime amortizimi mbi vlerën e ndërtesës ndërkohë që këtë aset nuk e disponon as në pronësi dhe as në përdorim. <p>Për sa më sipër nga MEPJ nuk janë kryer procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek MEPJ dhe ato kontabël për përcaktimin e aktiveve afatgjata në përdorim të institucioneve të varësisë dhe të tjera, në kundërshtim me pikën nr.10 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, i ndryshuar, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.</p> <p>3.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet problematikë sa i takon kontabilizimit të vlerës së garancisë së ndërtimit (5% i garancisë), ku konkretisht u konstatua mungesë e kësaj llogarie në pasqyrat financiare (po ashtu në PF mungon gjurmë e pranisë së llogarisë 466), as për garancinë e punimeve dhe as për rimbursimin e TVSH nga llogaria e tatimeve nuk është prekur kjo llogari. Nga ana e MEPJ-së kjo vlerë është kontabilizuar në llogarinë 212 të ndërtime konstruksione</p>
Kriteri:	<p>- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”,</p> <p>- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</p> <p>-Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet,</p> <p>Udhëzimi nr.46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”.</p> <p>-Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 ”Për procedurat e mbylljes se llogarive vjetore te buxhetit per vitin 2021”.,</p> <p>- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,</p>

	<p>- UMF 10, datë 27.02.2008 për ndryshim UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”.</p> <p>- SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar.</p>
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë i zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	<p>2. Nga ana e MEPJ-së, të kryhen procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakordësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek ajo;</p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në mënyrë të drejtë duke llogaritur zërat e bilancit në përputhje me VKM nr. 688 datë 14.11.2018 dhe bazës ligjore tatimore në fuqi. Gjithashtu t’i kushtohet rëndësi e veçantë klasifikimit në mënyrë të drejtë të posteve të bilancit.</p> <p>- Aktivët afatgjata në përdorim të njësisë të kontabilizohen në përputhje me procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.</p> <p>2.1 Kontabilizimi i vlerës së garancisë së ndërtimit, duhet kryer në llogarinë 466 “kreditorë për mjete në ruajtje”. Kjo llogari është specifike në sektorin publik. Në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve. Të tilla janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Garancitë bankare të ndryshme; ✓ Rimbursimi i TVSH nga llogaria e tatimeve;
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 122,220,591 lekë, pakësuar nga viti shkuar për 5,023,509 lekë për shkak të transferimit të pajisjeve të zyrave nga MEPJ tek Garda e Republikës.

Kjo llogari paraqitet e shtuar në masën 3,801,300 lekë nga blerjet e kryera me fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2020 si dhe e pakësuar për vlerën 1,299,550 lekë për shkak të transfertës nga MEPJ tek Garda e Republikës si dhe vlerës së amortizimit prej 7,525,259 lekë. (vlera më 31.12.2019 prej 129,745,850 me normën 5.8% vlera e amortizimit 7,525,259 lekë).

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se në kushtet e mungesës së proësisë të inventarizimit të aktiveve të njësisë nuk arrijmë dot të shprehemi me siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe transparencën e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”.

Llogaria 215 “Mjete transporti” me vlerën 15,059,069 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 5,856,549 lekë. Pakësim ka ardhur si rrjedhojë e transfertës së një automjeti në Ministrinë e Mbrojtjes, me vlerën e kostos historike prej 3,445,700 lekë dhe amortizimit prej 2,410,849 lekë. (vlera më 31.12.2019 prej 17,469,918 me normën 13.8 % vlera e amortizimit 2,410,849 lekë).

Tabela nr.

Nr.	Lloji i automjetit	Targa	Viti prodh.
1.	Hyunday Tucson	TR 69 02 R	2008
2.	Toyota Rav 4	AA 096 PL	2016
3.	Toyota Prius	AA 097 PL	2016
4.	Benz E320	TR 6828 K	2003
5.	Benz S 300	Tr 3019 I	1990
6.	Audi A6	AA 280 MR	2011
7.	Motociklete Lifan	AH 345	2008
8.	Jeep Grand Cherokee	AA 770 DI	2009
9.	Toyota Prius	AA 016 PL	2016
10.	Volkswagen Touareg	AA 243 JB	2007
11.	Volkswagen Touareg	AA 781 IK	2007
12.	Volkswagen Passat	AA 845 YG	2008
13.	Mercedes Benz S 350 Blue Tech	AA 575 OS	2017
	<i>Total</i>		

Burimi: MEPJ, përpunoi grupi auditimit

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 18,056,201 lekë dhe është pakësuar nga viti i shkuar me 558,400lekë, veprim i ardhur si rrjedhojë e amortizimit të akumuluar (vlera më 31.12.2019 prej 8,614,641 me normën 3% vlera e amortizimit 558,439 lekë).

Konstatim: Sa i takon amortizimit, nga auditimi u konstatua se:

- llogaritja e amortizimit vjetor është kryer në bazë të normave të amortizimit të VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “*Mbi normat e amortizimit të mjeteve kryesore*”, sipas së cilës ndërtesa amortizohet me normë amortizimi 1.3%, dhe vlerë 5,934,310 lekë, pajisje zyrash me normë amortizimi 5.8% dhe vlerë 7,525,259 lekë, mjete transporti me normë amortizimi 13.8% dhe vlerë 2,410,849 lekë dhe inventari ekonomik me normë amortizimi 3% dhe vlerë 558,439 lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar Pika 36, sipas të cilit ... “*Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:*
 - Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
 - Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
 - Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi;
 - Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Në përlllogaritjen e amortizimit për llogarinë 215 “mjete transporti” u konstatua se, llogaritja e amortizimit mbarte në vetvete vlerë të përlllogaritur mbi automjete jashtë funksionit. Ndërkohë që referuar SKK5, “*Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale*” pika 43 Amortizimi është ...shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je **përgjatë jetës së tij të dobishme**. Ku me jetë të dobishme kuptohet: (a) **periudha gjatë të cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësisia ekonomike**.

Llogaria 50 “Letrat me vlerë të vendosjes” në vlerën 42,933,900 lekë, shtuar nga viti shkuar me 29,186,340 lekë dhe përfaqëson tituj (pulla konsullore) të blerë për të realizuar qëllime afatshkurtra. Shtimi i lartë vjen si rrjedhojë e rritjes së sasisë së pullave konsullore gjendje në fund

të vitit nga reduktimi i aktivitetit konsullor për shkak të shpalljes së emergjencës kombëtare COVID-19.

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2020, gjendja e tyre një vit më parë, si dhe diferenca midis dy periudhave (2020-2019), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivët	2020	2019	Diferenca 2020-2019
A	FONDE TË VETA	619,122,372	583,312,272	35,810,000
	Fonde të veta	619,122,372	583,312,272	35,810,000
101	Fonde bazë	473,126,303	437,320,203	(35,806,100)
105	Grante të brendshme kapitale	125,511,589	125,511,589	-
106	Grante të huaja kapitale	20,484,480	20,484,480	-
B	DETYRIME	94,902,210	93,889,957	1,012,253
Klasa 4	Detyrime afatshkurtër	94,902,210	93,889,957	1,012,253
401-408	Furnitorë 401	1,254,888	7,627,129	(6,372,241)
421	Personeli e llogari të lidhura me to - paga	14,580,200	16,462,041	(1,881,841)
428	Personeli e llogari të lidhura me to - djeta	216,560	192,809	23,751
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	1,564,498	1,646,058	(81,560)
4341	Të tjera operacione me shtetin (kreditor)	22,605,381	22,980,841	(375,460)
435	Sigurime shoqërore	4,935,814	4,874,503	61,311
436	Sigurime shëndetsore	641,580	646,079	(4,499)
44	Institucione të tjera publike (Dega Tatimeve pulla)	42,933,900	13,747,560	29,186,340
467	Kreditorë të ndryshëm	6,169,389	25,712,937	(19,543,548)
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)	714,024,582	677,206,229	36,818,353

Burimi: MEPJ, përpunoi grupi auditimit

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 36,818,353 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 101 “Fonde bazë”, është pakësuar me 35,806,100 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

Llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” është mbartuar me vlerë të njëjtë si një vit më parë, prej 20,44,480 lekë dhe përfaqëson kalime kapitale të brendshme pa pagesë të transferuara nga institucionet vendore.

Referuar Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “ Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 Llogaritë 105 mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Këto mbylljen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Në rastin e MEPJ, në dokumentacion justifikues të mbylljes së zërave, vlera e mbylljes së kësaj llogaria paraqitet 0.

Llogaria 106 “Grant i Huaj Kapital” është mbartuar me vlerë të njëjtë si një vit më parë, prej 20,44,480 lekë dhe përfaqëson kalime kapitale pa pagesë nga organizma të huaja.

Llogaritë 106 mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Referuar Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” në rastin e MEPJ këto llogari janë mbartur por nga ana e auditimit të dokumentacionit destinacioni si burim për investimet në proces për institucionin

nuk arrin të qartësohet. Nga ana tjetër këto llogari duhet të pasqyrohen në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23 ku në rastin e MEPJ nuk është kryer kontabilizim i saktë.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, shtuar këtë vit me vlerën prej 1,012,253 lekë si më poshtë: Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit me 7,501,241 lekë përfaqëson detyrimin e institucionit ndaj furnitorëve për faturat që paguhen në vitin pasardhës.

Detyrime të 2020 që mbarten në 2021		
Nr.	Përshkrimi veprimit	Detyrimi
1	Buqeta lule	18,000
2	Buqeta lule	18,000
3	Flamuj	24,600
4	Kancelari	9,000
5	Kancelari	105,600
6	Kanceleri	105,600
7	Kanceleri	118,800
8	Kuti arshive	119,448
9	Pjesë ndërrimi makina	22,100
10	Mirëmbajtje sistemit kamerave	48,000
11	Rroba pune	44,000
12	Materiale pastrimi	148,440
13	Pjesë ndërrim makina	76,700
14	Flamuj	396,600
Totali		1,254,888

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) në vlerën 1,254,888 lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, përzgjedhëm për të kontrolluar rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet 3 raste me qëllim që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

1-Urdhër shpenzimi Nr. 504 dt. 06.08.2020 për vlerën 62,240 lekë për pagesë uji për muajin qershor, fatura tatimore Nr 2006-159294-1-1 datë 30.06.2020 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2020 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2020.

2- Urdhër shpenzimi Nr. 714 dt. 23.11.2020 për vlerën 13,170 lekë për pagesë për bileta avioni fatura tatimore Nr 354 datë 03.09.2020 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2020 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2020.

3 - Urdhër shpenzimi Nr. 628 dt. 08.10.2020 për vlerën 576,960 lekë për pagesë për dosje, rregjistra, kuti arshive, fatura tatimore Nr 813 datë 10.08.2020 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2020 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2020.

Llogaria 421 “Personeli e llogari të lidhura me to-paga”, është pakësuar këtë vit me 1,881,841lekë si rrjedhojë e vendeve vakante në stafin e ministrisë (mosplotësim i strukturës).

Llogaria 428 “Personeli e llogari të lidhura me to-dieta”, është shtuar këtë vit me 23,751 lekë si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për telefon, kompensim për shpenzime transporti etj

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat e muajt dhjetor është pakësuar këtë vit me vlerën 81,560 lekë për shkak të vendeve vakante në stafin e ministrisë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit si rrjedhojë e rritjes së tavanit të sigurimeve shoqërore me vlerën 61,311 lekë duke arritur vlerën prej 4,935,814 lekë.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, është pakësuar këtë vit me 4,499 lekë për shkak të ndikimit të mosplotësimit të organikës së punonjësve të Institucionit.

Llogaria 467 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 6,169,389 lekë është pakësuar nga viti i shkuar, me vlerën 19,543,548 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit ndaj furnitorëve për mallra (llog 401) që likuidohen në janar.

Llogaria 44 “Institucione të tjera publike”, në vlerën 42,933,900 lekë është shtuar nga viti i shkuar me vlerën 29,186,340 lekë dhe përfaqëson gjendjen e pullave në konsullore në MEPJ në datë 31 Dhjetor 2020.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2020. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2020 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2019.

Në lekë

		Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
B	Shpenzimet	351,915,502	438,359,908	86,444,406
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	221,318,983	220,945,708	373,275
6001	Paga, personel i përhershëm	147,115,659	156,256,576	(9,140,917)
6002	Paga, personel i përkohëshëm	24,035,560	14,991,664	9,043,896
6003	Shpërblime	69,700	731,465	(661,765)
6009	Shpenzime të tjera personeli	50,098,064	48,966,003	1,132,061
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	34,612,901	34,179,493	433,408
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	30,871,671	30,443,332	428,339
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	3,741,230	3,736,161	5,069
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	94,647,996	165,472,846	(70,824,850)
6020	Materiale zyre e të përgjithëshme	6,908,017	10,734,530	(3,826,513)
6021	Materiale dhe shërbime special	2,264,125	2,804,586	(540,461)
6022	Shërbime nga të tretë	36,179,315	67,234,146	(31,054,831)
6023	Shpenzime transporti	7,264,773	6,982,224	282,549
6024	Shpenzime udhëtimi	21,597,312	60,686,886	(39,089,574)
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	7,682,920	4,859,136	2,823,784
6026	Shpenzime për qiramarrje		136,844	(136,844)
6029	Shpenzime te tjera operative	12,751,534	12,034,494	717,040
605	Transferata korrente me jashtë	-	12,439,130	(12,439,130)
6052	Transferime për Qeveri të Huaja		12,439,130	(12,439,130)
606	Transferime për buxhetet familjare e individ	369,600	248,850	(120,750)
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SË INVENTARIT	96,022	5,073,881	(4,977,859)
Klasa 6	Totali Shpenzimeve	351,912,502	438,359,908	(86,447,406)

82,83,84	D. OPERACION KORRIGJIM REZULTATI	108,146,642	144,436,130	(36,289,488)
8420	Derdhje të ardhura në buxhet	108,146,642	144,436,130	(36,289,488)
	TOTALI	460,062,144	582,796,038	(122,733,894)

Burimi: MEPJ, përpunoi grupi auditimit

Analizuar si më poshtë vijon:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzime personeli” për 221,318,983 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Ku pagat për personel të përhershëm janë në vlerën prej 147,115,659 lekë dhe pagat për personel të përkohshëm janë 24,035,560 lekë bazuar në VKM nr. 47, datë 22.01.2020, VKM nr. 395, datë 29.04.2015 dhe shkresë së Ministrisë së Arsimit nr. 368 datë 15.01.2020 janë 24,035,560 lekë.

Llogaria 601 “kontribute të sigurimeve shoqërore” për 34,612,901 lekë,

Llogaria 602 “blerje mallra dhe shërbime” për 94,647,996 lekë e përbërë nga:

- 602 Mallra dhe shërbime të tjera për 94,647,996 lekë përfaqëson shpenzimet operative te institucionit.
- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 6,908,017 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2020.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 2,264,125 lekë paraqet shpenzimet e institucioni për dezinfektim, etiketa adezivi, material pastrimi, vula, kuti arkivi etj.
- 6022 Shërbime nga të tretë për shumën 36,17,315 lekë përfaqëson shpenzimet e institucionit për shërbime qe ofrohen nga OSSHE, UKT, Posta, Telefoni, Internet dhe shërbim përkthimi.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 21,597,312 lekë përfaqësojnë shpenzime për bileta avioni dhe dieta jashtë vendit.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 7,682,920 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre si mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm.
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 12,751,534 lekë përfaqëson shpenzime të institucionit për shlyerje vendim gjyqësore dhe rimbushim TVSH për projektet me financim te huaj.

Llogaria 606 “Transferata tek buxhetet familjare” për shumën 369,600 lekë përfaqëson kompensim të shpenzimeve të transportit për Zv. Ministrat bazuar në Ligjin 169/2013 dt 07.11.2013

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat në magazinë, paraqitet me vlerën (966,022) lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes se inventarit sipas aktivitet të bilancit.

Llogaria 8420 “Derdhje të ardhura në buxhet” në vlerën 108,146,642 lekë.

Konstatim: Kjo llogari evidenton transferimin e të ardhurave të realizuara nga institucioni në buxhet, ku pjesëmarrës në to është buxheti shtetit, në përputhje me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018”. Nga auditimi u konstatua problematikë në kontabilizimin e hapave lidhur me këtë llogari, si funksionimi, transferimi në buxhet dhe në fund mbyllja e kësaj llogarie me qëllim shmangien e efektit në rezultat.

Funksionimi i llogarisë 8420 kryhet duke debituar llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe kreditohen llogaritë e klasës 7, në vijim për transferimin e pjesës së buxhetit nga këto të ardhura debitohet llogaria 8420 dhe kreditohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin kreditor”. Në fund për mbylljen e llogarisë 8420, që të shmanget efekti në rezultat do të debitohet llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe kreditohet llogaria 8420.

Krahasimi mes pasqyrës së performancës dhe situacionit të shpenzimeve:

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 në total *nuk përputhen* me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në, vlerën 350,949,480 lekë kurse sipas situacionit të shpenzimeve me degën e thesarit vlera e tyre është 359,168,587 lekë.

Konstatim: Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk specifikohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Proçesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 46, dt. 24.12.2020 “Për proçedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020” pika 34 “Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë proçesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës”.

Konstatim: Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve për vitin 2020, u konstatua një diferencë prej 8,219,107 lekë më pak në PASH.

Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare dhe shpjegimi se përse këto shuma rezultojnë me diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Proçesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Proçedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.

Analizojmë më poshtë këto të dhëna

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente			
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	221,318,983	201,988,490	19,330,493
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	34,612,901	34,988,505	375,604
602	Mallra dhe shërbime te tjera	94,647,996	121,752,892	27,104,896
606	Transferta për buxh. familjare e individë	369,600	438,700	69,100
	Totali	350,949,480	359,168,587	(8,219,107)

Burimi MEPJ, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi mbi rakordimin total të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare rezulton diferencë prej 8,219,107 lekë më pak në PASH e ardhur për shkak të faturave të fundit të vitit.

Mbi të ardhurat:

Klasa 7 të ardhurat e ushtrimit. Në këtë pasqyrë të ardhurat paraqiten në shumën 458,624,304 lekë, ky total është i rakorduar me “Shpenzime të shfrytëzimit” dhe “Llogaritë Debitore”. Të ardhurat e MEPJ-së janë të karakterit “Grante korrente” me vlerë 351,026,662 lekë dhe Të ardhura JoTatimore me vlerën 107,597,642 lekë. Këto të ardhura përfaqësohen nga:

Llogaria 71. III “Të ardhura Jotatimore” në total prej 107,597,642 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 36,172,067 lekë, për shkak të reduktimit të numrit të veprimeve konsullore të kryera gjatë vitit si pasojë e shpalljes së emergjencës botërore COVID.

Kjo llogari përbëhet nga:

- Llogaria 710 a. “Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia” me vlerë 130,000 lekë që përfaqëson qiranë e lokalit në ambientet e MEPJ-së.
- Llogaria 711 b. “Të ardhura nga shërbime administrative e të ardhura sekondare” me vlerë 107,467,642 lekë të përbërë nga:
 - ✓ llogaria 7110 “tarifa administrimi dhe rregullore” me vlerë 107,420,868 lekë që janë të ardhura nga shërbimi konsullor dhe derdhen në Degën e Tatimeve nga P.Sh, TNT A.Cdhe A.D.E.
 - ✓ llogaria 7113 “të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve” me vlerë 46,774 lekë dhe që janë të ardhura të krijuara nga fotokopjimi i dokumentave në arkivin e MEPJ-së nga studiues të ndryshëm jo punonjës të Ministrisë.

Llogaria 72. IV “Grante Korente” në total prej 351,026,662 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 82,057,234 lekë, për shkak të të mosrealizimit të planit të buxhetit si pasojë e bllokimit të aktivitetit të institucionit nga pandemia.

Kjo llogari përbëhet nga:

- Llogaria 720 a. “Grant korrent i brendshëm” për vlerën 350,477,662lekë të përbërë nga:
 - ✓ llogaria 7200 “Nga i njëjti nivel qeverisje” për vlerën 321,090,233 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 47,162,466 lekë si rrjedhojë e reduktimit të aktiviteti ekonomik financiar të institucionit.

- ✓ llogaria 7201 “Nga nivele të tjera qeverisje” për vlerën 24,500 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 6,978,720 lekë si rrjedhojë e reduktimit të aktivitetit nga pandemia.
- ✓ llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga Buxheti” me vlerë prej 29,362,929 lekë, pakësuar gjatë këtij viti me 27,798,627 lekë dhe përfaqëson të drejta të njësisë në marrëdhënie me shtetin. Rakorduar me kundërpartinë, llogarinë 4342 “Operacione me shtetin”.
- Llogaria 721b.“Grant korrent i jashtëm” për vlerën 549,000lekë dhe përfaqëson një sponsorizim të bërë nga Ambasada Gjermane për organizim event.

Totali i ardhurave të funksionimit në formatin nr.3/2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore formati nr.3/1 plus rezultatin e ushtrimit. Konkretisht për vitin 2020 paraqiten si më poshtë vijon:

- i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 458,624,304 lekë
 - ii. Operacione Korrigjim Rezultati (llog. 829, 841)= 1,437,840 leke
-
- Totali ii + iii = 460,062,144 leke

- i. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 351,915,502 lekë
 - ii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 108,146,642 lekë
-
- Totali ii + iii = 460,062,144 lekë

Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat e vitit 2020, nënshkruar nga Shefi Financës Z. P.Kdhe nëpunësi zbatues Zj. I.D, nga ana e Degës së Thesarit nga specialistja e të ardhurave Znj. M.Fdhe Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave Zj. Sh.Ç. Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë 994,873 lekë, nga të cilat janë derdhur në buxhet 445.873 lekë dhe mban Institucioni 549,000 lekë, mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 0 lekë.

Në lekë

Kod Institucion i	Klasifikim i Buxhetor	Përshkrimi	Të ardhura mujore	Të ardhura progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1015001	710 9600	Të ardhura nga qiratë		130,000	0		130,000	
1015001	711 3006	Të ardhura nga shtypshkrimet	5,850	46,774	0		46,774	
1015001	711 3099	Të ardhura nga shitja e shërbimeve	200,899	269,099	0		269,099	
1015001	721 1100	Të ardhura nga sponsorizimet		549,000	549,000	549,000		
1015001	778 0100	Të ardhura të hyra gabimisht						
1015001	466 8100	Rimbursim TVSH		448,400,653	448,400,653			
		Totali	206,749	449,395,526	448,949,653	549,000	445,873	0.00

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Gjetje nr.3:

Nga auditimi konstatohet se,

- Lidhur me rimbursimin e TVSH-së, në aktrakordin me thesarin pasqyrohet një llogari me përshkrim “rimbursim TVSH” e cila përfaqëson vlerën e TVSH të rimbursueshme për trupin diplomatik të akredituar në vendin tonë, e cila është keqklasifikuar si pjesë e këtij aktrakordimi. Nisur nga fakti që MEPJ përmes Drejtorisë së Protokollit, përgatit udhëshpenzimet me shumat përkatëse të TVSH-së që do ti rimburohet çdo misioni diplomatik dhe diplomati të akredituar në RSH.

Nuk mund të trajtohet si e ardhur një shumë që është shpenzim.

- Kjo shumë çelet nga Drejtoria e Tatimeve dhe Institucioni (MEPJ) bën vetëm procedurat e transferimit në llogaritë përkatëse të përfaqësive diplomatike dhe diplomatëve të tyre. Nga ana e grupit të auditimit gjykohet se, paraqitja e kësaj llogarie *Brenda aktrakordimit të të ardhurave të Institucionit* konfondon lexuesin dhe çënon parimin e transparencës.

Në thelb veprimtaria e MEPJ lidhur me TVSH e rimbursueshme do të shpjegohet si më poshtë: Çdo mision diplomatik, organizatë ndërkombëtare për blerjet e bëra nga vetë ato ose nga personeli i tyre dërgon në drejtorinë e mësipërme dy kopje të formularit "Kërkesë për rimbursim" (të firmosur e të vulosur nga titullari i ambasadës apo i organizatës ndërkombëtare) të cilave u bashkëngjisin edhe faturat origjinale të blerjes. Drejtoria e Protokollit, kopjen origjinale të formularit "kërkesë për rimbursim" dhe faturat origjinale të blerjes i dërgon në degën e tatimeve. Dega e tatimeve është e detyruar që brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të mësipërm të bëjë rimbursimin e TVSH së paguar në faturat përkatëse. Brenda këtij afati, dega e tatimeve verifikon direkt në vend tek shitësi, faturën e lëshuar nga ai për misionin diplomatik apo organizatën ndërkombëtare, regjistrimin e saj në librin e shitjeve, pasqyrimin e të dhënave në deklaratën e pagesës së TVSH për muajin përkatës dhe derdhjen në fakt të TVSH së mbledhur nga subjektet e mësipërme. Pas verifikimit dhe miratimit të Kërkesave për rimbursim, dega e tatimeve lëshon një Urdhër Rimbursimi për degën e Thesarit. Urdhër Rimbursimi lëshohet për të gjithë shumën e TVSH që do të rimbursohet në bazë të kërkesave të paraqitura nga Drejtoria e Protokollit. Ndaj sa më sipër gjykohet se nevojitet rishikim i formatit të aktrakordimit të të ardhurave me thesarin.

Titulli i Gjetjes 3:	Rimbursimi TVSH-së
Situata:	Nga auditimi konstatohet se, lidhur me rimbursimin e TVSH-së, në aktrakordimin me thesarin pasqyrohet një llogari me përshkrim "rimbursim TVSH" e cila përfaqëson vlerën e TVSH të rimbursueshme për trupin diplomatik të akredituar në vendin tonë, e cila është keq klasifikuar si pjesë e këtij aktrakordimi. Nisur nga fakti që MEPJ përmes Drejtorisë së Protokollit, përgatit urdhër shpenzimet me shumat përkatëse të TVSH-së që do të rimbursohet çdo misioni diplomatik dhe diplomati të akredituar në RSH. Nuk mund të trajtohet si e ardhur një shumë që është shpenzim.
Kriteri:	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me planin kontabël të miratuar për institucionet, - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", - Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 " Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	- Te merren masat nga MEPJ të rishikohet formati i aktrakordimit të të ardhurave me thesarin duke mos përfshirë shpenzimin konkret në

	aktrakordimin e të ardhurave të Institucionit, kjo me qëllim të shmangies së keqklasifikimit të të ardhurave.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Viti 2020

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2020:

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 1 dhe Formatit nr. 2** “Pasqyra e Aktiv - Pasivit të bilancit kontabël”*

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 714,024,582 lekë në vitin 2020;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

*- Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 3/1 dhe 3/2** “Pasqyra e të ardhura - shpenzimeve” Të ardhurat e paraqitura në formatin nr.3/1 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po formatin 3/2 plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 460,062,144 lekë (103,364,519- (108,146,642)). Pra totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 3/2), në shumën 460,062,144 lekë;*

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr.3/1, për 966,022 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit. Pra, (14,201,425-13,235,403) dhe janë të barabarta që të dyja me vlerën prej (966,022) lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 4** “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.*

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 5** “Pasqyra e lëvizjes në cash” kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të regjistruar fondet buxhetore korrente dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korrente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura.*

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

*-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.6** “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve të qëndrueshme” kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.*

Është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit. Në zërin blerje me pagesë janë dy zëra llogaria 212 “ndërtime dhe konstruksione”

për 54,144,930 lekë ku përshihet 52,601,250 lekë rikonstruksioni godinës dhe 1,543,680 lekë mbikëqyrje punimesh dhe llogaria 214 për vlerën 3,801,300 lekë. Ndërsa në pakësimet janë përfshirë llogaria 214 instalime teknike, makineri, pajisje” për vlerën 1,299,550 lekë dhe llogaria “mjete transporti” me vlerën 3,445,700 lekë të dyja për shitje kapitali, si dhe nxjerrje jashtë përdorimit dhe tjetra për arsye të tjera.

Nga auditimi praktikave u konstatua se, bëhet fjalë për transfertë kapitale nga MEPJ tek MM të automjetit tip Land Rover Discovery me Urdhër nr.818 dhe të disa mjeteve pajisje zyra tek Garda e Republikës.

Sa më sipër nuk kemi të bëjmë me shitje por kalim kapitali.

Sa më sipër, u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 7 “Pasqyra e amortizimit vjetor”, kjo pasqyrë nuk është plotësuar.

Sa më sipër, nuk mund të shprehemi përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, plotësuar duke filluar si në çelje, ashtu edhe lëvizjet debi e kredi dhe gjendja në fund është e barabartë me pasivin e bilanci të kuadruar me fondin në total.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket këtyre llogarie.

Formati nr.9 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen lëvizjet dhe gjendja në fund e punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasyra e shpenzimeve.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket këtyre llogarie.

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.12 “Shënime shpjeguese”, Referuar SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”/ “Shënimet shpjeguese”, shënimet shpjeguese japin një përshkrim ose zbërthim të mëtejshëm të zërave të paraqitur në këto pasqyra, si dhe informacion mbi zërat që nuk plotësojnë kriteret për një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike raportuese do të japë informacionin, duke u bazuar në konceptin e materialitetit, dhe zërat jo materialë mund të paraqiten të grupuar.

- Mbyllja e bilancit për vitin 2020 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”
- Veprimet për vitin 2020 janë axhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
- Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë, përkatësisht me shkresat nr. 1, datë 30.03.2018, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2017” dhe nr. 100, datë 29.03.2019, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018” nuk janë miratuar nga Nëpunësi autorizues i MEPJ, në kundërshtim me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9, Pika 4 dhe Neni 12, Pika 2.

Pasqyrat financiare viti 2021 .

Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit me shkresën nr.1 prot, datë 15.03.2022 konfirmuar nga dega e thesarit. Pra bilanci kontabël i vitit 2021 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Pasqyrat financiare të MEPJ janë të formatit të vjetër.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin sipas formatit nr.1; Pasivin sipas formatit nr.2; Shpenzime të ushtrimit sipas formatit 3/1, Të ardhurat e ushtrimit sipas formatit 3/2; Pasqyrën financiare të burimeve dhe shpenzimeve lidhur me investimet sipas formatit nr.4; Pasqyrën e lëvizjeve në ‘cash’ sipas formatit nr.5; Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në e Aktiveve të Qendrueshme sipas formatit nr.6; Pasqyrën e amortizimeve sipas formatit nr.7; Pasqyrën e lëvizjes së fondeve sipas formatit nr.8; Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.9 si dhe Pyetëtorin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.12

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 rezultoi:

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2021	Pakësime gjatë vitit 2021	Gjendja në mbyllje	Ndryshimi
Aktive të trupëzuara					
Ndërtim edhe konstruksione	450,551,108	-	5,857,164	444,693,944	(5,857,164)
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	122,220,591	16,671,368	11,748,543	127,143,416	4,922,825
Mjete transporti	15,059,069	-	2,078,152	12,980,917	(2,078,152)
Inventar Ekonomik	18,056,201	-	541,686	17,514,515	(541,686)
Totali	605,886,969	16,671,368	20,225,545	602,332,792	(3,554,177)

Burimi: MEPJ, përpunoi grupi auditimit

Nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtime e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej afërsisht 74% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara, pas saj vijon llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” e cila zë peshën prej 21% , llogaria “Inventar ekonomik” me peshën prej 3% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara dhe në fund me peshën më të vogël prej 2% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara përfaqësohet llogaria “Mjete transporti”.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2021, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2021	2020	Diferenca 2020 – 2019
A	AKTIVE	602,332,792	605,886,969	(3,554,177)
21,23,24,28	Aktive të Qendrueshme të Trupëzuara	602,332,792	605,886,969	(3,554,177)
212	Ndërtime e Konstruksione	444,693,944	450,551,108	(5,857,164)
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	127,143,416	122,220,591	4,922,825
215	Mjete transporti	12,980,917	15,059,069	(2,078,152)
218	Inventar ekonomik	17,514,515	18,056,201	(541,686)
B	Aktive Qarkulluese	100,225,066	108,137,613	(7,912,547)

Klasa 3	I.Gjendje inventari	15,039,000	13,235,403	1,803,597
31	Materiale	15,093,000	13,235,403	1,803,597
klasa 4	II.Kërkesa arkëtimi mbi debitorë	55,650,141	51,968,310	3,681,831
423-428	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	4,927,900	5,329,300	(401,400)
4342	Të tjera operacione me shtetin	33,446,160	29,362,929	12,086,848
468	Debitorë të ndryshëm	17,276,081	17,276,081	-
50-59	III.Llogaritë financiare	29,481,925	42,933,900	(13,451,975)
20	Aktive Afatgjata Jomateriale	0	0	
50	Letra me vlerë të vendosjes (pulla konsullore)	29,481,925	42,933,900	(13,451,975)
	TOTALI I AKTIVIT	702,557,858	714,024,582	(11,466,724)

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Zëri Aktive paraqitet për 702,557,858 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive qarkulluese” plus “Aktive të qëndrueshme”.

Aktive qarkulluese. Totali i kësaj rubrike përfaqëson shumën e përgjithshme të posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Disponibilitete”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

4. Gjendja e inventarit me vlerën 15,093,000 lekë.

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një shtim me 1,857,597 lekë nga viti i shkuar 2020. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 15,093,000 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 1,857,597 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2021.

Në total ndryshimi i gjendjes së materialeve është pakësuar me 1,857,597 lekë, e barabartë me llogarinë 63 evidentuar në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit.

5. Kërkesa arkëtimi mbi debitorë me vlerë 55,650,141lekë shtuar nga viti shkuar me 3,681,831 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaritë e grupit423-429”Personeli paradhënie deficite e gjoba” për 4,927,900 lekë dhe përfaqëson paradhënie të punonjësve në Euro dhe Dollar, të pambyllura në vitin 2021. Pakësuar nga viti i shkuar me 401,400 lekë.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 33,446,160 lekë shtuar nga viti shkuar me 4,083,231 lekë, *kjo llogari përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2021, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj si dhe fatura të pa likuajuara të vitit korrent.*

Furnitore e llogari te lidhura me to (401)	1,007,620
Furnitore e llogari te lidhura me to (467)	8,346,666
Paga Dhjetor 2021 (421)	15,978,341
Tatim te ardhura personale Dhjetor 2021 (431)	1,734,143

Sigurime Shoqërore (435) Dhjetor 2021	5,487,797
Sigurime Shëndetësore (436) Dhjetor 2021	700,601
Djeta punonjësish	190,992
Totali detyrimeve	33,446,160

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për 17,276,081 lekë, mbartur ndër vite dhe përfaqëson detyrime të subjekteve private dhe punonjësve të konstatuara nga KLSH.

Nga auditimi u konstatua se, në këtë total detyrimesh të prapambetura prej 17,276,081 lekë detajohen në:

- ✓ 489,528 lekë detyrime nga të tretët që i përkasin një periudhe kohore mbi 10 vite,
- ✓ 16,786,553 lekë detyrime të mbartura nga stafi dhe kompani apo persona të tretë, konkretisht detajuar në 10,448,110 lekë detyrime që stafi ka ndaj MEPJ-së dhe 6,338,443 lekë detyrime që kompanitë/të tretët kanë ndaj MEPJ-së;

Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimeve që stafi dhe të tretët kanë ndaj MEPJ-së kjo e fundit ka ndërmarr nisma për arkëtimin e shumave, por përpjekjet kanë qenë të pamjaftueshme. Sa më sipër gjykojmë si më problematike vlerat që të tretët kanë ndaj institucionit ku peshën më të lartë e ka kompania “D. sh.p.k” me vlerën 6,025,225 lekë apo 95% në terma relative të totalit të detyrimeve të të tretëve.

Datë	Emri subjektit	Detyrimi	Ndalur në 2012	Ndalur në 2013	Ndalur në 2014	Ndalur në 2015	Ndalur në 2016	Ndalur në 2017	Ndalur në 2018	Diferenca për tu ndalur
	T.B	11,700								11,700
	T.B	31,500								31,500
	T.B	16,100								16,100
	A.I	110,000								110,000
	A.I	3,000								3,000
	M.K	43,200								43,200
24.11.09.	Shuma	215,500								215,500
.24.11.09.	K.B	81,500								81,500
.24.11.09.	D sh.p.k resorant	42,500		-42,500						0
.24.11.09.	N.C	28,000		-7,000	-12,000	-9,000				0
.24.11.09.	S. K piktor	22,000								22,000
.24.11.09.	G.L piktor	18,000								18,000
.24.11.09.	A.Q	40,000								40,000
.24.11.09.	Servis makina A.	60,242								60,242
.24.11.09.	H.M	29,120								29,120
18.11.11.	R.Xh	137,666	-54,500	-60,000						23,166
	Shuma	459,028	-54,500	-109,500	-12,000	-9,000				274,028
	Detyrime 2009 - 2017	674,528	-54,500	-109,500	-12,000	-9,000	0	0	0	489,528
	A.H	469,000								469,000
	A.L	1,067,000							-1,067,000	0
	A.T	109,080								109,080
	A.Gj	36,254								36,254
	B.Sh	53,782								53,782
	B.N	587,200							-587,200	0
	E.R	441,350								441,350
	E.D	278,640								278,640
	E.I	11,509								11,509
	E.B	363,894								363,894
	F.P	109,300								109,300
	J.D	589,800							-589,800	0
	L.F	99,363								99,363
	O.C	284,454								284,454
	R.G	237,400								237,400
	Sh.I	920,000							-920,000	0
	Sh.L	56,110								56,110
	S.V	59,608								59,608
	S.V	812,555							-812,555	0

	A.B	477,400								477,400
	A.A	556,535						-556,535		0
	B.D	584,600						-584,600		0
	E.I	582,000								582,000
	E.J	337,820								337,820
	E.T	472,200								472,200
	F.B	1,012,800								1,012,800
	I.L	1,513,446								1,513,446
	J.J	467,000								467,000
	J.L	432,320								432,320
	L.C	92,000								92,000
	M.H	920,000								920,000
	S.N	983,700								983,700
	V.I	126,600								126,600
	Xh.S	421,080								421,080
31.10.18.	Shuma	15,565,800	0	0	0	0	0	0	-5,117,690	10,448,110
31.10.18.	Kompania "K"	274,218								274,218
31.10.18.	F.D.B	18,750								18,750
31.10.18.	A.H	20,250								20,250
31.10.18.	Kompania "D."	6,025,225								6,025,225
	Detyrime 2018	21,904,243	0	0	0	0	0	0	-5,117,690	16,786,553
	TOTALI detyrimeve	22,578,771	-54,500	-109,500	-12,000	-9,000	0	0	-5,117,690	17,276,081

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Gjetje nr.4:

Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimeve të prapambetura llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" përbëhet nga detyrime që stafi dhe të tretët kanë ndaj MEPJ-së. Detajuar në:

- ✓ 489,528 lekë detyrime nga të tretët që i përkasin një periudhe kohore mbi 10 vite,
- ✓ 16,786,553 lekë detyrime të mbartura nga stafi dhe kompani apo persona të tretë, konkretisht detajuar në 10,448,110 lekë detyrime që stafi ka ndaj MEPJ-së dhe 6,338,443 lekë detyrime që kompanitë/të tretët kanë ndaj MEPJ-së;

Nga vlerwsimet e audituesve tw pavarur, gjykohen si më problematike vlerat që të tretët kanë ndaj institucionit ku peshën më të lartë e ka kompania "D. sh.p.k" me vlerën 6,025,225 lekë apo 95% në terma relative të totalit të detyrimeve të të tretëve e ndjekur nga kompania "Kastrati" me vlerë detyrimi 274,218 lekë. Nga ana e MEPJ-së janë ndërmarr nisma për arkëtimin e shumave, por përpjekjet kanë qenë të pamjaftueshme.

Titulli i Gjetjes 4:	<i>Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm",</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimeve të prapambetura llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" përbëhet nga detyrime që stafi dhe të tretët kanë ndaj MEPJ-së. Detajuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ 489,528 lekë detyrime nga të tretët që i përkasin një periudhe kohore mbi 10 vite, ✓ 16,786,553 lekë detyrime të mbartura nga stafi dhe kompani apo persona të tretë, konkretisht detajuar në 10,448,110 lekë detyrime që stafi ka ndaj MEPJ-së dhe 6,338,443 lekë detyrime që kompanitë/të tretët kanë ndaj MEPJ-së; <p>Sa më sipër gjykojmë si më problematike vlerat që të tretët kanë ndaj institucionit ku peshën më të lartë e ka kompania "D. sh.p.k" me vlerën 6,025,225 lekë apo 95% në terma relative të totalit të detyrimeve të të tretëve. Nga ana e MEPJ-së janë ndërmarr nisma për arkëtimin e shumave, por përpjekjet kanë qenë të pamjaftueshme.</p>

Kriteri:	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerave debitore, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

6. Llogaritë financiare në vlerën 29,481,925 lekë

Kjo llogari përbëhet nga llogaria 50 “letra me vlerë të vendosjes (pulla konsullore)” për 29,481,925 lekë. Pakësuar me 13,451,975 lekë pasi nga ana e MEPJ-së është ulur sasia e tërheqjeve nga Drejtoria e Tatimeve duke qenë se gjatë vitit 2020 krijoji stok për shkak të kufizimeve të veprimeve konsullore nga situata e pandemisë.

Aktive të qëndrueshme. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 602,332,792 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara” dhe “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

2. Llogaritë e grupit 21,23,24,28 “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara” me vlerë totale prej 602,332,792 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 6,554,177 lekë përbëhet nga:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në vlerën e 444,693,944 lekë, pakësuar nga viti shkuar me vlerën e amortizimit (vlera më 31.12.2021 prej 450,551,108 me normën 1.3% vlera e amortizimit 5,857,164 lekë).

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 127,143,416 lekë, shtuar nga viti shkuar për 4,922,825 lekë. Kjo llogari paraqitet e shtuar për shkak të blerjes së pajisjeve te zyrave gjate vitit 2021 dhe transferimeve kapitale nga Misioni OSBE dhe AKSHI. (vlera më 31.12.2021 prej 134,971,779 me normën 5.8% vlera e amortizimit 7,828,363 lekë).

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, vlera në fund të vitit mbi të cilën është llogaritur amortizimi nuk rakordon me vlerën e paraqitur në pasqyrën financiare të bilancit kontabël, konkretisht në bilanc kontabël kjo vlerë është 122,220,591 lekë dhe në dokumentacionin justifikues të llogaritjes së amortizimit rezulton 134,971,779 lekë.

Gjetje nr.5:

Nga auditimi rezulton se, nuk janë kryer procedurat e inventarizimit të aktiveve të njësisë, e për pasojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehin me siguri të arsyeshme mbi

vërtetësinë dhe transparencën e të dhënave që përbëjnë llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” që gjykuar nga vlera e lartë (127,143,416 lekë) përbën risk të moderuar deri në të lartë.

Titulli i Gjetjes 5:	<i>Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje"</i>
Situata:	Nga auditimi rezulton se, nuk janë kryer procedurat e inventarizimit të aktiveve të njësisë, e për pasojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen me siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe transparencën e të dhënave që përbëjnë llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” që gjykuar nga vlera e lartë (127,143,416 lekë) përbën risk të moderuar deri në të lartë.
Kriteri:	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Të kryhet detajim i përbërjes së llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” duke specifikuar peshën specifike në vlera absolute në bilancin kontabël (dhe relative në shënime shpjeguese).
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Llogaria 215 “Mjete transporti” me vlerën 12,980,917 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 2,078,152 lekë. Pakësimi ka ardhur si rrjedhojë e amortizimit (vlera më 31.12.2020 prej 15,059,069 lekë me normën 13.8% vlera e amortizimit 2,078,152 lekë).

Nga auditimi u konstatua se, përsa i përket numrit të lartë të automjeteve jashtë funksionit, në vitin 2021 është iniciuar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit.

Janë hartuar procesverbale vlerësimi për 12 automjete si më poshtë vijon:

1. Mercedes Bens E-240 me targë TR 30 92 F , vit prodhimi 2002 me vlerë fillestare 4,883,180 lekëi cili nuk figuron në listën e automjeteve të vendosura në dispozicion grupit të auditimit;
2. BMW me targë TR ... I , vit prodhimi 1992;
3. Mercedes Bens 230 me targë TR H , vit prodhimi 1996;
4. Audi A4 me targë TR ...J , vit prodhimi2003;
5. Peugeot 407 me targë TR L , vit prodhimi2005;
6. Renault MEGANE me targë TR P , vit prodhimi 2008;
7. Mercedes Bens E-230 me targë CD vit prodhimi 1996;
8. Mercedes Bens 200 me targë CC AA , vit prodhimi1999;
9. Volsvagen Phaeton me targë TR Z , vit prodhimi 2004;
10. Volsvagen Passat me targë TR K , vit prodhimi 2008;
11. Volsvagen Touareg me targë TR P ,vit prodhimi2008;

12. Mercedes Bens 300 me targë TR G ,vit prodhimi 1988.

Gjetje nr.6:

Megjithëse në vitin 2021 janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të 12 automjeteve (nga 17 të tilla) të papërdorshme, ato nuk janë vijuar më tej prej Institucionit.

Nga ana tjetër, procesverbalet e vlerësimit nuk janë të plota, mungon një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe një relacion argumentues për çdo makinë nga ana e ing.vlerësues.

Titulli i Gjetjes 6:	<i>Llogaria 215 "Mjete transporti"</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, në inventarin e automjeteve të MEPJ-së, rezultojnë 29 mjete, konkretisht 27 automjete dhe 2 motoçikleta, nga të cilët aktualisht funksional janë vetëm 13 (12 automjete dhe 1 motor-ciklet) dhe 17 automjete janë të papërdorshme.</p> <p>Përsa i përket numrit të lartë të automjeteve jashtë funksionit, në vitin 2021 është iniciuar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit por kjo procedurë nuk është vijuar më tej prej Institucionit. Nga ana e MEPS-së janë hartuar procesverbale vlerësimi për secilin prej këtyre automjeteve, por mungon një relacion final që të ketë vënë në dijeni titullarin apo nga ana e grupit të ngritur të jetë nxjerr një përfundim lidhur me to.</p> <p>Nga ana tjetër, procesverbalet e vlerësimit janë të mangëta, mungon një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe një relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me planin kontabël të miratuar për institucionet, - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 " Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Të vijohet me finalizimin e procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit të automjeteve, duke plotësuar praktikën me ndjekjen e hapave të nevojshme. Kryerja e një analize konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe marrja e një opinionit / relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nr.7:

Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur, për të dy vitet objekt auditimi, sa i takon llogarisë 215 "mjete transporti". Në inventarin e automjeteve të MEPJ, rezultojnë 29 mjete, konkretisht 27 automjete dhe 2 motor-cikleta, nga të cilët aktualisht funksional janë vetëm 13 (12 automjete dhe

1 motor-ciklet) dhe vlerë kontabël të mbetur kanë vetëm 6 (1 motor-ciklet dhe 5 automjete) prej 15,059,069 lekë.

Sa më sipër konstatohen dy problematika:

Së pari, problemi i vlerës së mbetur. U konstatuan automjete që janë jashtë përdorimit aktualisht por që kanë vlerë kontabël të mbetur (me vit prodhimi të afërt p.sh 2008, 2015) konkretisht Mercedes Benz C Class vit prodhimi 2015 me vlerë të mbetur 2,683,994 lekë dhe ndërkohë që për automjetet që janë në përdorim vetëm 3 prej tyre kanë vlerë kontabël (Toyota Rav 4 me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 3,019,061 lekë, Toyota Prius me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë si dhe Toyota Prius me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një pakuptueshmëri financiare, janë funksionale automjete pa vlerë kontabël dhe nga ana tjetër vlera mbi të cilën llogaritet amortizimi përshin automjete të cilat nuk janë funksionale, në kundërshtim me SKK5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” pika 43 ku specifikohet se, amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je përgjatë jetës së tij të dobishme. Ku me jetë të dobishme kuptohet: (a) periudha gjatë të cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësi ekonomike.

Së dyti, mbajtja e automjeteve që janë jashtë përdorimit në inventar. Konkretisht janë 16 automjete dhe 1 motocikletë jashtë funksionit dhe vazhdojnë të mbahen duke ngarkuar në këto kushte pasqyrat financiare dhe dhënë një pamje jo reale të tyre. Si edhe duke konsumuar hapësirën fizike të parkimit të MEPJ-së.

7.2 Gjetje nga auditimi: Përsa i përket numrit të lartë të automjeteve jashtë funksionit, në vitin 2021 është iniciuar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit por kjo procedurë nuk është vijuar më tej prej Institucionit. Nga ana e MEPJ-së janë hartuar procesverbale vlerësimi për secilin prej këtyre automjeteve, por mungon një relacion final që të ketë vënë në dijeni titullarin apo nga ana e grupit të ngritur të jetë nxjerr një përfundim lidhur me to.

Nga ana tjetër, procesverbalet e vlerësimit janë të mangëta, mungon një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe një relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues.

Në lekë

Nr.	Lloji i automjetit	Targa	Viti prodh.	Vlera/lekë	Vlera aktuale mbetur
	Në funksion				
1.	Hyunday Tucson	TR 69 02 R	2008	2,640,000	
2.	Toyota Rav 4	AA 096 PL	2016	5,102,269	3,019,061
3.	Toyota Prius	AA 097 PL	2016	5,006,418	2,962,345
4.	Benz E320	TR 6828 K	2003	6,826,407	
5.	Benz S 300	Tr 3019 I	1990	64,600	
6.	Audi A6	AA 280 MR	2011	3,968,708	
7.	Motociklete Lifan	AH 345	2008	50,000	
8.	Jeep Grand Cherokee	AA 770 DI	2009	6,593,300	
9.	Toyota Prius	AA 016 PL	2016	5,006,418	2,962,345
10.	Volksëagen Touareg	AA 243 JB	2007	4,350,227	
11.	Volksëagen Touareg	AA 781 IK	2007	2,566,112	
12.	Volksëagen Passat	AA 845 YG	2008	3,385,480	
	Mercedes Benz S 350 Blue Tech	AA 570 OS	2017		
	Jashtë funksionit				
1.	Kamioni Fiat Iveko	TR 39 - 71 H	1998		
2	BMV	TR 40 - 04 I	1992		
3	Bens 300	TR 01 - 10 G	1988		
4.	Bens	TR 30 - 92 F	2003		
5.	Bens 230	TR 39 - 78 H	1996		
6.	Audi A4	TR 77 – 72 J	2003		

7.	Peugeot	TR 49 - 05 L	2005		
8.	Renault MEGANE	TR 58-18 P	2008		
9.	Bens E230	CD 54-1	1996		
10.	Mercedes Benz C Class	CC 00 29 AA	2015		2,683,994
11.	Motor Ciklet "Lifan"	AH 435	2013		102,957
12.	Bens 200	CC 00 01 AA	1999		
13.	Volsvagen Phaeton	TR 01-34 Z	2004		
14.	Volsvagen Passat	TR 33-85 K	2008		
15.	Volsvagen Touareg	TR 61 – 66 P	2008		
	Total				

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Ministria ka në inventar 29 automjete. 23 automjete nga pikëpamja kontabël janë 100% të amortizuara dhe mbi to nuk llogaritet amortizimi. 6 të tjerat prodhim i viteve 2015 – 2017 kanë vlerë kontabël dhe vetëm mbi to llogaritet amortizimi. Ato janë në proces për daljen nga përdorimi.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm, rezulton se nga ana e MEPJ është dërguar mot a mot i njëjtin observacion me atë të pasqyruar edhe në fazën e projekt raportit lidhur me këtë çështje.

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, e për pasojë mos ndryshimin e gjendjes së evidentuar grupi auditimit vijon të mbaj të njëjtin qëndrim.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Llogaria 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 17,514,515 lekë dhe është pakësuar nga viti shkuar me 541,686 lekë, veprim i ardhur si rrjedhojë e amortizimit të akumuluar (vlera më 31.12.2020 prej 18,056,201 me normën 3% vlera e amortizimit 541,686 lekë).

Titulli i Gjetjes 7:	Llogaria 215 "Mjete transporti"
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur, për të dy vitet objekt auditimi, sa i takon llogarisë 215 "mjete transporti". Në inventarin e automjeteve të MEPJ, rezultojnë 29 mjete, konkretisht 27 automjete dhe 2 motor-cikleta, nga të cilët aktualisht funksional janë vetëm 13 (12 automjete dhe 1 motor-ciklet) dhe vlerë kontabël të mbetur kanë vetëm 6 (1 motor-ciklet dhe 5 automjete) prej 15,059,069 lekë.</p> <p>Sa më sipër konstatohen dy problematika:</p> <p>Së pari, problemi i vlerës së mbetur. U konstatuan automjete që janë jashtë përdorimit aktualisht por që kanë vlerë kontabël të mbetur (me vit prodhimi të afërt p.sh 2008, 2015). Konkretisht Mercedes Benz C Class vit prodhimi 2015 me vlerë të mbetur 2,683,994 lekë dhe ndërkohë që për automjetet që janë në përdorim vetëm 3 prej tyre kanë vlerë kontabël (Toyota Rav 4 me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 3,019,061 lekë, Toyota Prius me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë si dhe Toyota Prius me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë).</p> <p>Në këtë rast kemi të bëjmë me një parregullsi financiare, pasi janë funksionale automjete pa vlerë kontabël dhe nga ana tjetër vlera mbi të cilën llogaritet amortizimi përfshin automjete të cilat nuk janë në funksion, në</p>

	<p>kundërshtim me SKK5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” pika 43 ku specifikohet se, amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je <u>përgjatë jetës së tij të dobishme</u>. Ku me jetë të dobishme kuptohet: (a) <u>periudha gjatë të cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësia ekonomike</u>. Së dyti, <u>mbajtja e automjeteve që janë jashtë përdorimit në inventar</u>. Konkretisht janë 16 automjete dhe 1 motocikletë jashtë funksionit dhe vazhdojnë të mbahen duke ngarkuar në këto kushte pasqyrat financiare dhe dhënë një pamje jo reale të tyre. Si edhe duke konsumuar hapësirën fizike të parkimit të MEPJ-së.</p> <p>7.2 Gjetje nga auditimi: Përsa i përket numrit të lartë të automjeteve jashtë funksionit, në vitin 2021 është iniciuar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit por kjo procedurë nuk është vijuar më tej prej Institucionit. Nga ana e MEPJ-së janë hartuar procesverbale vlerësimi për secilin prej këtyre automjeteve, por mungon një relacion final që të ketë vënë në dijeni titullarin apo nga ana e grupit të ngritur të jetë nxjerr një përfundim lidhur me to.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana tjetër, procesverbalet e vlerësimit janë të mangëta, mungon një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe një relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 Mbi ndryshimin e udhëzimit numër 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Të vijohet me finalizimin e procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit të automjeteve, duke plotësuar praktikën me ndjekjen e hapave të nevojshme. Kryerja e një analizë konkrete kosto përfitim mbi këto automjete si dhe marrja e një opinionit / relacion argumentues për çdo makinë nga ana e inxhinierit vlerësues.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nr.8:

Sa i takon amortizimit, u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi, si më poshtë vijon,

- llogaritja e amortizimit vjetor është kryer në bazë të normave të amortizimit të VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Mbi normat e amortizimit të mjeteve kryesore”, sipas së cilës ndërtesa amortizohet me normë amortizimi 1.3%, dhe vlerë 5,857,164 lekë, pajisje zytrash me normë

amortizimi 5.8% dhe vlerë 7,828,363 lekë, mjete transporti me normë amortizimi 13.8% dhe vlerë 2,078,152 lekë dhe inventari ekonomik me normë amortizimi 3% dhe vlerë 541,686 lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 36, sipas të cilit ...“Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi;
- Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Amortizimi është llogaritur sipas VKM nr. 401 dt 23.10.1989 i cili nuk është shfuqizuar. Udhëzimi nr.8 nuk mund të ketë përparësi mbi një VKM.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm, rezulton se nga ana e MEPJ është dërguar mot a mot i njëjtin observacion me atë të pasqyruar edhe në fazën e projekt raportit lidhur me këtë çështje.

Grupi auditimit vijon të mbaj të njëjtin qëndrim dhe për shkak të sensitivitetit të çështjes risjell të njëjtën përgjigje sikundër në projekt raport:

*Rikujtojmë edhe njëherë se, VKM nr.401 datë datë 23.10.1989 “Mbi normat e amortizimit të mjeteve kryesore” nuk ka penguar daljen e Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin dhe të ardhurat” i ndryshuar me Ligjin nr.156/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime, si dhe udhëzimeve të përvitshme për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare, ku specifikisht udhëzimi i fundit që ka prekur amortizimin është UMFJE nr.8 datë 09.03.2018 , neni 36 specifikon ... Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, **deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik**, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të **llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës**. Këto akte dhe dispozita ligjore të më vona nuk bien ndesh, nuk kundërshtojnë por përmirësojnë dhe specifikojnë normat dhe kategoritë e llogaritjes së amortizimit.*

Po ashtu, VKM nr.401 për shkak të periudhës së largët kohore ka mungesë të aseteve të cilat janë prezente tani (sidomos pajise elektronike/kompjuterike) çka bën edhe më tepër të detyrueshme për zbatim aktet e më vona të nxjerra.

Risjellim në vëmendjen tuaj se, gjatë këtij auditimi është konstatuar mungesë e regjistrimit të aktiveve po ashtu mos kryerje e procedurave të inventarizimit. Rrjedhim i së cilave veç të tjerash, është mospatja dijeni e aseteve totale që entiteti disponon. Në këto kushte nuk mund të ngrihen pretendime për saktësi në llogaritjen e amortizimit kur vlera dhe sasia e aseteve nuk dihet prej jush.

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, e për pasojë mosndryshimin e gjendjes së evidentuar mbajmë të njëjtin qëndrim.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes 8:	Amortizimi
Situata:	<p>Sa i takon amortizimit, nga auditimi u konstatua fenomeni i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi si më poshtë vijon,</p> <ul style="list-style-type: none"> - llogaritja e amortizimit vjetor është kryer në bazë të normave të amortizimit të VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Mbi normat e amortizimit të mjeteve kryesore”, sipas së cilës ndërtesa amortizohet me normë amortizimi 1.3%, dhe vlerë 5,857,164 lekë, pajisje zyrash me normë amortizimi 5.8% dhe vlerë 7,828,363 lekë, mjete transporti me normë amortizimi 13.8% dhe vlerë 2,078,152 lekë dhe inventari ekonomik me normë amortizimi 3% dhe vlerë 541,686 lekë. <p>Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 36, sipas të cilit ...“Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur; • Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%; • Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; • Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standarteve dhe rregullave kontabël”, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	- Të merren masat për llogaritjen e amortizimit të aktiveve në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, pika 36, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik,
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Llogaria 50 “Letrat me vlerë të vendosjes” në vlerën 29,481,925 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 13,451,975 lekë dhe përfaqëson gjendjen e titujve (pulla konsullore) më 31.12.2021. Pakësimi krahasuar me vitin e shkuar vjen si rrjedhojë e rritjes volumit të pullave konsullore të konsumuara gjatë vitit.

Të ardhurat nga pullat konsullore

Nga auditimi i të ardhurave të shërbimit konsullor dhe reflektimit të tyre në kontabilitet rezulton se, veprimtaria e shërbimit konsullor është bazuar në Udhëzimin e përbashkët të MFE dhe MPJ nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit”. Sipas këtij udhëzimi, pika 1 specifikohet se, *...Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), me institucionet e vartësisë, cakton agjentë për mbledhjen e tarifave për shërbimet konsullore.*

Pika 3 specifikon se, *.... Për tarifën e arkëtuara brenda vendit, si dhe për tarifën e arkëtuara nga përfaqësitë tona diplomatike, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e agjentit të mbledhjes të këtyre tarifave, është e detyruar:*

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajë, për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën e arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës;

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin, zbatohen sanksione sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se,

- Për vitet 2020-2021 agjentët janë P.Sh, TNT, A.C dhe A.D.E.
- Nga dokumentet bashkëngjitur pasqyrave financiare u konstatua se, për vitin 2020 për 4 nga 5 agjentë ka patur detyrim të mbartur për derdhjen e të ardhurave nga tarifën konsullore në drejtim të MEPJ në vlerën 22,950 lekë dhe përfaqëson detyrim të D. prej vitit 2010, i paarkëtuar.

Për të dy vitet objekt auditimit, rezulton se vijon të mbetet paarkëtuar vlera e detyrimit të D. prej 22,950 lekë.

Detajuar si më poshtë vijon :

Në lekë

	2020					2021				
	Detyrim i mbartur (dhjetor 2019)	Të ardhura të arkëtuara	Për tu derdhur	Derdhur në buxhet	Për tu dherdh në 2021	Detyrim i mbartur (dhjetor 2020)	Të ardhura të arkëtuara	Për tu derdhur	Derdhur në buxhet	Për tu derdh në 2022
P.Sh	8,667,813	76,648,430	85,316,243	79,908,763	5,407,480	5,407,480	108,896,497	114,303,977	105,277,539	9,026,438
T.N.T	2,255,390	18,925,371	21,180,761	19,951,142	1,229,619	1,229,619	30,573,072	31,802,691	29,191,240	2,611,451
A.C	644,243	6,984,607	7,628,850	6,984,607	644,243	644,243	10,030,993	10,675,236	9,861,533	813,703
A.D.E	1,400	329,257	330,657	307,257	23,400	23,400	611,199	634,599	590,222	44,377
D.	22,950		22,950		22,950	22,950		22,950		22,950
	11,591,796	102,887,665	114,479,461	107,151,769	7,327,692	7,327,692	150,111,761	157,439,453	144,920,534	12,518,919

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Sa i përket muajit detyrimit të mbartur për tu arkëtuar, i cili përfshin muajin dhjetor dhe detyrimin e D.-së të vitit 2010, paraqitet si më poshtë vijon:

	P.Sh	T.N.T	Albanian Courier	ADEX	total	Total + mbartje	Sipas MEPJ
2020	5,407,480	1,229,619	644,243	23,400	7,304,742	7,327,692	6,919,312
2021	9,026,438	2,611,451	813,703	44,377	12,495,696	12,518,919	12,110,539

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Gjetje nr.9:

Nga auditimi i të ardhurave të shërbimit konsullor dhe reflektimit të tyre në kontabilitet rezulton se, për të dy vitet objekt auditimit, në detyrimin total nga veprimtaria e shërbimit konsullor për tu arkëtuar vijon të mbetet paarkëtuar vlera e detyrimit të D. prej 22,950 lekë mbartuar qysh nga viti 2019.

Nga auditimi u konstatua se, arkëtimet e munguara i përkasin muajit dhjetor plus mbartjen e D.-së, por në dokumentacionin e vendosur në dispozicion këto vlera nuk rakordojnë. Konstatohet diferencë në arkëtimin e munguar prej 408,380 lekë në të dy vitet

Referuar Udhëzimit nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit”, pika 5 e tij specifikon se Ministria e Punëve të Jashtme transferon brenda datës 15 të çdo muaji, në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit shumën totale të tarifave sipas raportimit të bërë nga përfaqësitë diplomatike. Cdo muaj, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme rakordon me degët respektive të thesarit. Shuma e tarifave të arkëtuara sipas këtij udhëzimi, i takojnë 100% buxhetit të shtetit.

Sa i takon rakordimit të të ardhurave mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave dhe rakordimit më degët e thesarit të këtyre të ardhurave, nga ana e MEPJ-së operohej në zbatim të VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore”, si dhe kontratës për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së.

Referuar VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” pika 1 specifikon ... Kryeministria, ministritë, institucionet e sektorit publik, veprimtaria e të cilave mbështetet në pronën publike, shtetërore, institucionet e qeverisjes vendore, si dhe shoqëritë tregtare me capital shtetëror, si për llogari të tyre, ashtu edhe në shërbim të shtetasve e anasjellas, të realizojnë nëpërmjet “P.Sh” sh.a., këto shërbime:

b)... Shërbimet financiare që nuk bien ndesh me legjislacionin aktual

Referuar Kontratës për Sipërmarrje Shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së neni 2 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 2.3 specifikon ... Posta ka për detyrë të mbaj një proces verbal në fund të çdo muaj me Znj. O. Ç., përgjegjëse e sektorit të Legalizimeve në Drejtorinë Konsullore për shërbimet postare dhe financiare mujore të kryera për legalizimin e dokumentave.

Pika 2.4 Posta ka për detyrë, të derdh pranë Raiffeisen Bank brenda ditës së nesërme të punës të gjithë arkëtimet e kryera për pulla tarife konsullore të dokumentave për legalizim.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 23.05.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Lidhur me të ardhurat që realizohen nga shërbimi konsullor nëpërmjet P.Sh, T.N.T etj ato ndiqen nga Drejtoria Konsullore dhe Inspektori i Drejtorisë së Tatimeve, i cili ndjek arkëtimin e këtyre të ardhurave duke krahasuar me pullat konsullore që konsumohen.

Qendrimi grupit të auditimit:

Referuar relatimit narrativ të dhënë në observacion nuk arrijmë të kuptojmë se çfarë po observohet nga gjetja lidhur me të ardhurat konsullore.

Risjellim në vëmendje tuaj se: Referuar Udhëzimit nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit”, pikat 3 germa a dhe b të tij specifikojnë se ... Për tarifën e arkëtuara brenda vendit si dhe për tarifën e arkëtuara nga përfaqësitë tonadiplomatike Ministria e Punëve të Jashtme në cilësinë e agjentit të mbledhjes të këtyre tarifave është e detyruar:

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguaj për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën e arkëtuar për atë muaj në datën ose paradatës së detyrueshme të deklaratës.

pika 5 e tij specifikon se ..Tarifat e arkëtuara brenda vendit derdhen brenda ditës në llogarinë bankare të thesarit për llogari të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Përfaqësitë tona diplomatike raportojnë çdo muaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi tarifën e arkëtuar prej tyre. Ministria e Punëve të Jashtme transferon brenda datës 15 të çdo muaji, në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit shumën.

Me qëllim ndërtimin e një sistemi proaktiv të secilit departament e më tej të entitetit në tërësi, nevojitet formalizim i procesit përmes zbatimit të akteve ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi. Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, e për pasojë mosndryshimin e gjendjes së evidentuar mbajmë të njëjtin qëndrim.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes 9:	Të ardhurat nga pullat konsullore
Situata:	<p>Nga auditimi i të ardhurave të shërbimit konsullor dhe reflektimit të tyre në kontabilitet rezulton se, për të dy vitet objekt auditimit, në detyrimin total nga veprimtaria e shërbimit konsullor për tu arkëtuar vijon të mbetet paarkëtuar vlera e detyrimit të D. prej 22,950 lekë mbartuar qysh nga viti 2019.</p> <ul style="list-style-type: none">- Nga auditimi u konstatua se, arkëtimet e munguara i përkasin muajit dhjetor plus mbartjen e D.-së, por në dokumentacionin e vendosur në dispozicion këto vlera nuk rakordojnë. Konstatohet diferencë në arkëtimin e munguar prej 408,380 lekë në të dy vitet.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”,- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.37, dt. 31.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit”, i ndryshuar,- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet,- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

<i>Ndikimi/Efekti:</i>	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
<i>Shkaku:</i>	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
<i>Rekomandimi:</i>	Të merren masa konkrete për të arkëtuar vlerat e munguara dhe sistemuar diferencat reale të të ardhurave të munguara.
<i>Rëndësia:</i>	E lartë
<i>Afati zbatimit:</i>	Menjëherë

Gjetje nr.10:

Nga auditimi i të ardhurave të shërbimit konsullor dhe reflektimit të tyre në kontabilitet rezulton se, për të dy vitet objekt auditimit, në detyrimin total nga veprimtaria e shërbimit konsullor për tu arkëtuar vijon të mbetet paarkëtuar vlera e detyrimit të D. prej 22,950 lekë mbartuar qysh nga viti 2019.

- Nga auditimi u konstatua se, arkëtimet e munguara i përkasin muajit dhjetor plus mbartjen e D.-së, por në dokumentacionin e vendosur në dispozicion këto vlera nuk rakordojnë. Konstatohet diferencë në arkëtimin e munguar prej **408,380 lekë në** të dy vitet. Diferencë e cila ka ardhur si rrjedhojë e llogaritjes jo të saktë kryer nga ana e MEPJ-së. Referuar të dhënave vendosur në dispozicion vlera e detyrimit të mbartur për tu arkëtuar, i cili përfshin edhe muajin dhjetor 2022 dhe detyrimin e D. duhet të ishte 12,580,919 lekë ndërkohë kjo vlerë e llogaritur prej institucionit rezultonte 12,110,539 lekë.

Pra për vitin 2021 është kryer 2 herë, një përgjatë vitit dhe tjetri në vitin pasardhës.

<i>Titulli i Gjetjes 10:</i>	<i>Të ardhurat nga pullat konsullore</i>
<i>Situata:</i>	<p>Nga auditimi u konstatua se, MEPJ me Drejtorinë e Tatimeve kryente rakordim të të ardhurave konsullore, duke operuar në kundërshtim me bazën ligjore, konkretisht Udhëzimin nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit” pika 5 e tij.</p> <p>Konkretisht, rakordimi kryhej mes Inspektorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Zyrës së Veprimeve Konsullore për MEPJ dhe ky rakordim kryhej 1 herë/2 herë në vitin pasardhës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konkretisht për vitin 2020 akt rakordimi mban datë 22.02.2021 dhe është kryer vetëm 1 herë. - Për vitin 2021 akt rakordimi për muajt janar-qershor mban datë 09.08.2021 dhe për muajt korrik-dhjetor mban datë 17.02.2022. <p>Pra për vitin 2021 është kryer 2 herë, një përgjatë vitit dhe tjetri në vitin pasardhës.</p>
<i>Kriteri:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, - Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme nr.37, dt. 31.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit”, i ndryshuar, - VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore”, - Kontrata për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së,

	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,
Ndikimi/Efekt:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	- Nga ana e MEPJ-së të merren masa konkrete për të arkëtuar vlerat e munguara dhe sistemuar diferencat reale të të ardhurave të munguara.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë

Gjetje nr.10.1

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve nuk kryej në përputhje dhe zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit” pika 5 e tij.

Konkretisht, rakordimi kryhej mes Inspektorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Zyrës së Veprimeve Konsullore për MEPJ dhe ky rakordim kryhej 1 herë/2 herë në vitin pasardhës.

- Konkretisht për vitin 2020 akt rakordimi mban datë 22.02.2021 dhe është kryer vetëm 1 herë.
- Për vitin 2021 akt rakordimi për muajt janar-qershor mban datë 09.08.2021 dhe për muajt korrik-dhjetor mban datë 17.02.2022.

Pra për vitin 2021 është kryer 2 herë, një përgjatë vitit dhe tjetri në vitin pasardhës.

10.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për të ardhurat e mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave (P.Sh, TNT, A.Cdhe A.D.E) nga ana e MEPJ-së *nuk mbahej asnjë aktrakordimi me degën e thesarit*, në kundërshtim me Udhëzimin nr.37, datë 31.12.2014 me argumentimin e dhënë nga institucioni, se operonin në zbatim të VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” dhe kontratës për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së.

Nga auditimi u konstatua se, VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” pika 1, shkronja b, u drejtohet të gjithë shërbimeve financiare, ndërkohë që Udhëzimi nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit” nxjerr me vonë se VKM ka fushëveprimi specifike dhe i drejtohet pikërisht shërbimit konsullor.

Titulli i Gjetjes 10.1:	<i>Të ardhurat nga pullat konsullore</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve nuk kryej në përputhje dhe zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore

	<p><i>të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit”</i> pika 5 e tij.</p> <p>Konkretisht, rakordimi kryhej mes Inspektorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Zyrës së Veprimeve Konsullore për MEPJ dhe ky rakordim kryhej 1 herë/2 herë në vitin pasardhës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konkretisht për vitin 2020 akt rakordimi mban datë 22.02.2021 dhe është kryer vetëm 1 herë. - Për vitin 2021 akt rakordimi për muajt janar-qershor mban datë 09.08.2021 dhe për muajt korrik-dhjetor mban datë 17.02.2022. <p>Pra për vitin 2021 është kryer 2 herë, një përgjatë vitit dhe tjetri në vitin pasardhës.</p> <p>10.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për të ardhurat e mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave (P.Sh, T.N.T, A.C dhe A.D.E) nga ana e MEPJ-së <u><i>nuk mbahej asnjë aktrakordimi me degën e thesarit</i></u>, në kundërshtim me Udhëzimin nr.37, datë 31.12.2014 me argumentimin e dhënë nga institucioni, se operonin në zbatim të VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” dhe kontratës për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se, VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore” pika 1, shkronja b, u drejtohet të gjithë shërbimeve financiare, ndërkohë që Udhëzimi nr.37, datë 31/12/2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit” nxjerr me vonë se VKM ka fushëveprimi specifike dhe i drejtohet pikërisht shërbimit konsullor.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, - Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr.37, dt. 31.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit”, i ndryshuar, - VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore”, - Kontrata për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së, - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.

Rekomandimi:	- Të merren masa konkrete për kryerjen e veprimtarisë operative në përputhje dhe në zbatim me bazën ligjore rregullatore si dhe të zbatohet kontrata mes palëve P.Sh sh.a dhe MEPJ-së, sikundër edhe parashikohet në nenin 2 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pikat 2.3 dhe 2.4 të tij.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2021, gjendja e tyre një vit më parë, si dhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2021	2020	Diferenca 2020-2019
A	FONDE TË VETA	617,425,792	619,122,372	(1,696,580)
	Fonde të veta	617,425,792	619,122,372	(1,696,580)
101	Fonde bazë	458,532,405	473,126,303	(14,593,898)
105	Grante të brendshme kapitale	138,408,907	125,511,589	12,897,318
106	Grante të huaja kapitale	20,484,480	20,484,480	-
B	DETYRIME	85,132,066	94,902,210	(9,770,144)
Klasa 4	Detyrime afatshkurtër	85,132,066	94,902,210	(9,770,144)
401-408	Furnitorë 401	1,007,620	1,254,888	(247,268)
421	Personeli e llogari të lidhura me to – paga	15,978,341	14,580,200	1,398,141
428	Personeli e llogari të lidhura me to – djeta	190,992	216,560	(25,568)
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	1,734,143	1,564,498	169,645
4341	Të tjera operacione me shtetin (kreditor)	22,203,981	22,605,381	(401,400)
435	Sigurime shoqërore	5,487,797	4,935,814	551,983
436	Sigurime shëndetsore	700,601	641,580	59,021
44	Institucione të tjera publike (Dega Tatimeve pulla)	29,481,925	42,933,900	(13,451,975)
467	Kreditorë të ndryshëm	8,346,666	6,169,389	2,177,277
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)	702,557,858	714,024,582	(11,466,724)

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më pak se një vit më parë për 11,466,724 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 101 “Fonde bazë”, është pakësuar me 1,696,580 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivit të bilancit.

Llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” prej 138,408,907 lekë, është shtuar nga një vit më parë me 12,897,318 lekë dhe përfaqëson kalime kapitale të brendshme pa pagesë të transferuara nga misioni OSBE dhe AKSHI.

Llogaritë 105 mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Këto mbyllën (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. (si është ne rastin konkret, sepse ne dok justifik vlera është 0)

Llogaria 106 “Grant i Huaj Kapital” është mbartuar me vlerë të njëjtë si një vit më parë, prej 20,44,480 lekë dhe përfaqëson kalime kapitale pa pagesë nga organizma të huaja.

Llogaritë 106 mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23.

Në rastin e MEPJ-së këto vlera janë mbart, pra nuk janë mbyll me veprimet e mbylljes së periudhave.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, pakësuar këtë vit me vlerën prej 9,770,144 lekë si më poshtë: Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit me 247,268 lekë përfaqëson detyrimin e institucionit ndaj furnitorëve për faturat që paguhen në vitin pasardhës.

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) në vlerën 1,254,888 lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, përzgjedhëm për të kontrolluar rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet 3 raste me qëllim që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

1-Urdhër shpenzimi Nr. 79 dt. 24.02.2021 për vlerën 127,986 lekë për pagesë për telefon, me faturë elektronike nr.fature 601/2021 NIVF b51f8bfa-o491-4dd5-9150-847e741e44ea, datë 27.02.2021 ora 21:13:09 i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

2-Urdhër shpenzimi Nr. 598 dt. 12.10.2021 për vlerën 167,700 lekë për pagesë për përkthim me faturë elektronike nr.fature 6/2021, NIVF 3ebcf7c8-4473-49a0-81ad-3ed7a8d87800, datë 22.09.2021 ora 10:44:30 i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor.

3-Urdhër shpenzimi Nr. 683 dt. 17.11.2021 për vlerën 119,520 lekë për pagesë për shërbim postar jashtë vendit, faturë elektronike nr.fature 1356/21, datë 16.09.2021, NIVF d0210cdd-3e9f-4049-ba80-85b027230b74 datë 16.09.2021 ora 12:00:00 i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2021.

Llogaria 421 “Personeli e llogari të lidhura me to-paga”, është shtuar këtë vit me 1,398,141 lekë si rrjedhojë e plotësimit të pjesshëm të strukturës së stafit të MEPJ.

Llogaria 428 “Personeli e llogari të lidhura me to-dieta”, është pakësuar këtë vit me 25,568 lekë si rrjedhojë e reduktimit të shpenzimeve të dietave gjatë muajit dhjetor.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat e muajt dhjetor është shtuar këtë vit me vlerën 169,645 lekë për shkak të rritjes së numrit të punonjësve subjekt deklarimi tatim page.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit si rrjedhojë e shtimit të stafit në strukturën e MEPJ me vlerën 551,983 lekë duke arritur vlerën prej 5,487,797 lekë.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, është shtuar këtë vit me 59,021 lekë për shkak të ndikimit të rritjes së vlerës bruto të pagës për muajin dhjetor ndikuar nga plotësimi i strukturës.

Llogaria 467 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 8,346,666 lekë është pakësuar nga viti i shkuar, me vlerën 19,543,548 lekë dhe përfaqëson detyrimet e institucionit ndaj furnitorëve për shërbime që likuidohen në janar.

Llogaria 44 “Institucione të tjera publike”, në vlerën 29,481,925 lekë është shtuar nga viti i shkuar me vlerën 2,177,277 lekë dhe përfaqëson vlerën e pullave gjendje në MEPJ në datë 31 dhjetor 2021.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2020. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2020 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2019.

Në lekë

		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
B	Shpenzimet	406,536,204	351,915,502	54,620,702
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	235,394,046	221,318,983	14,075,063
6001	Paga, personel i perhershëm	160,155,758	147,115,659	13,040,099
6002	Paga, personel i perkohëshëm	20,846,285	24,035,560	(3,189,275)
6003	Shpërblime	1,557,186	69,700	1,487,486
6009	Shpenzime të tjera personeli	52,834,817	50,098,064	2,736,753
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	37,442,281	34,612,901	2,829,380
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	33,516,935	30,871,671	2,645,264
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	3,925,346	3,741,230	184,116
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	135,308,732	94,647,996	40,660,736
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	9,791,042	6,908,017	2,883,025
6021	Materiale dhe sherbime special	4,952,961	2,264,125	2,688,836
6022	Sherbime nga te trete	57,723,009	36,179,315	21,543,694
6023	Shpenzime transporti	13,441,931	7,264,773	6,177,158
6024	Shpenzime udhetime	19,609,300	21,597,312	1,988,012
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	10,827,965	7,682,920	3,145,045
6026	Shpenzime per qiramarrje	1,201,604		1,201,604
6029	Shpenzime te tjera operative	17,760,920	12,751,534	5,009,386
605	Transfera korrente me jashtëm		-	-
6052	Transferime për Qeveri të Huaja			-
606	Transferime per buxhetet familjare e individ	248,742	369,600	(120,858)
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	(1,857,597)	96,022	(1,953,619)
Klasa 6	Totali Shpenzimeve	406,536,204	351,912,502	54,623,702
82,83,84	D. OPERACION KORRIGJIM REZULTATI	173,310,127	108,146,642	65,163,485
8420	Derdhje të ardhura në buxhet	171,452,530	108,146,642	63,305,888
	TOTALI	579,846,331	460,062,144	119,784,187

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Analizuar si më poshtë vijon:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzime personeli” për 235,394,046 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Ku pagat për personel të përhershëm janë në vlerën prej 160,155,758 lekë dhe pagat për personel të perkohëshëm janë 20,846,285 lekë, ku ky i fundit përfaqësonë punonjësit me kontratë sipas VKM nr. 1151, datë 24.12.2020, VKM nr. 395, datë 29.04.2015 dhe shkresës së Ministrisë së Arsimit nr. 252/1, datë 14.01.2021 janë 20,846,285 lekë, si dhe shpërblime 1,557,186 lekë dhe shpenzime të tjera personeli 52,834,817 lekë.

Llogaria 601 “kontribute të sigurimeve shoqërore” për 37,442,281 lekë,

Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” për 135,308,732 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 9,791,042 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2021.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 4,952,961 lekë paraqet shpenzimet e institucioni për dezinfektim, etiketa adezivi, material pastrimi, vula, kuti arkivi etj..
- 6022 Shërbime nga të tretë për shumën 57,723,009 lekë përfaqëson shpenzimet e institucionit për shërbime që ofrohen nga OSSHE, UKT, Posta, Telefoni, Internet dhe shërbim përkthimi.
- 6023 Shpenzime transporti për shumën 13,441,931 lekë përfaqësojnë shpenzimet e institucioni për karburant, siguracion makine, pjesë këmbimi etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 19,609,300 lekë përfaqësojnë shpenzime për bileta avioni dhe dieta jashtë vendit.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 10,827,965 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre si mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm.
- 6025 Shpenzime për qiramarrje për shumën 1,201,604 lekë përfaqëson shpenzime për marrjen me qira për zyrat e projekteve.
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 17,760,920 lekë përfaqëson shpenzime të institucionit për shlyerje vendim gjyqësore dhe rimbushim TVSH për projektet me financim të huaj.

Llogaria 606 “Transferata tek buxhetet familjare” për shumën 248,742 lekë përfaqëson kompensim të shpenzimeve të transportit për Zv.Ministrat bazuar në Ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publikë dhe Nëpunësit Civilë” , i ndryshuar me Ligjin 169/2013 dt 07.11.2013

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat në magazinë, paraqitet me vlerën (1,857,597) lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes së inventarit sipas aktivitetit të bilancit.

Llogaria 8420 “Derdhje të ardhura në buxhet” në vlerën 171,452,530 lekë dhe përfaqëson të ardhurat e krijuara nga aktiviteti konsullor në MEPJ.

Kjo llogari evidenton transferimin e të ardhurave të realizuara nga institucioni në buxhet, ku pjesëmarrës në to është buxheti shtetit, në përputhje me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018.

Krahasimi mes pasqyrës së performancës dhe situacionit të shpenzimeve:

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 në total *nuk përputhen* me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 408,939,801 lekë kurse sipas situacionit të shpenzimeve me degën e thesarit vlera e tyre është 411,641,651lekë.

Konstatim: Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk specifikohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësisia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 46, dt. 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020” pika 34 “Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës”.

Gjetje nr.11:

Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve për vitin 2021, konkretisht, u konstatua një diferencë prej 2,701,850 lekë. Sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 408,393,801 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 411,641,651 lekë.

Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare dhe shpjegimi se përse këto shuma rezultojnë me diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente			
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	235,394,046	215,152,835	(20,241,211)
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	37,442,281	35,815,613	()
602	Mallra dhe shërbime te tjera	135,308,732	138,927,195	3,618,463
606	Transferta për buxh. familjare e individë	248,742	150,150	(98,592)
	Totali			

Burimi MEPJ, përpunuar nga Grupi Auditimit

Nga auditimi mbi rakordimin total të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare rezulton diferencë prej 8,219,107 lekë më pak në PASH e ardhur për shkak të faturave të fundvitit.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Lidhur me diferencën midis pasqyrave financiare dhe Akt rakordimit me Degen e Thesarit zërat e shpenzimeve në paqyrën financiare nuk përputhen asnjëherë me Akt rakordimin:

Pasqyra e shpenzimeve të vitit 2021 përmban PAGAT nga 1 Janari – 31 Dhjetor 2021

Akt Rakordimi (600) përmban PAGAT nga 1 Dhjetori 2020 – 30 Nendor 2021.

E njëjta gjë edhe për sigurimet shoqërore (601) dhe për shpenzimet operative (602).

Te pasqyra e shpenzimeve futen të gjitha shpenzimet operative nga 1 janari – 31 Dhjetor 2021

Te akt rakordimi përfshihen detyrime nga 2020 (llog. 401 e llog 467) që janë likuiduar në 2021 dhe nuk përfshihen detyrimet e 2021 (llog. 401 e llog. 467) që janë likuiduar në 2023.

Gjithashtu ministria në këtë periudhw 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ka pasur edhe një specifik tjetër.

Me mbylljen e Ministrisë së Integritit disa projekte të përbashkëta me disa vende të rajonit kaluan në varësi të ministrisë. Të gjitha fondet që përdornin ato për paga, sigurime dhe shpenzime operative, Ministria e Financave i hapte te zëri 231.

Nëse te Akt rakordimi me thesarin ato përfshihen te zëri 231 investime, nw ditarin e shpenzimeve, pra dhe në pasqyrat financiare ato pasqyrohen si janë në të vërtetë, pra paga, sigurime, dieta, qira, rimbursim tvsh etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Referuar observacionit të mësipërm, rezulton se nga ana e MEPJ është dërguar mot a mot i njëjti observacion me atë të pasqyruar edhe në fazën e projekt raportit lidhur me këtë çështje.

Grupi auditimit vijon të mbaj të njëjtin qëndrim sa i takon gjetjes, megjithatë sjellim në vëmendjen tuaj se, njohja dhe likuidimi i vlerave nga viti 2021 i llogarisë 401 dhe llogarisë 407 në vitin 2023 nuk është praktikë e legjitimuar në kushtet e njohjes dhe paraqitjes së drejtë të të drejtave dhe detyrimeve në kotabilitet.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

<i>Titulli i Gjetjes 11:</i>	<i>Shpenzimet korrente</i>
<i>Situata:</i>	<p>Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi, mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve për vitet korrente.</p> <p>Konkretisht për vitin 2021, u konstatua një diferencë prej 2,701,850 lekë. Sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 408,939,801 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 411,641,651 lekë.</p> <p>Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare dhe shpjegimi se përse këto shuma rezultojnë me diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III,</p>

	“Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, - Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.37, dt. 31.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit”, i ndryshuar, - VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore”, - Kontrata për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së, - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e MEPJ-së të merren masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rakordimi dhe unifikimi i vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit. - Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e MEPJ dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Periodikisht dhe çdo muaj

Mbi të ardhurat:

Klasa 7 të ardhurat e ushtrimit. Në këtë pasqyrë të ardhurat paraqiten në shumën 579,583,501 lekë, ky total është i rakorduar me “Shpenzime të shfrytëzimit” dhe “Llogaritë Debitore”. Të ardhurat e MEPJ-së janë të karakterit “Grante korrente” me vlerë 409,433,103 lekë dhe “Të ardhura JoTatimore” me vlerën 170,150,398 lekë. Këto të ardhura përfaqësohen nga:

Llogaria 71. III “Të ardhura Jotatimore” në total prej 170,150,398 lekë shtuar nga viti i shkuar me 62,552,756 lekë, për shkak të rritjes së aktivitetit konsullor në MEPJ.

Kjo llogari përbëhet nga:

- Llogaria 710 a. “Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia” me vlerë 110,000 lekë që përfaqëson qirane e lokalit në ambientet e MEPJ-së. pakësuar me 20,000 lekë nga viti shkuar.

- Llogaria 711 b. “Të ardhura nga shërbime administrative e të ardhura sekondare” me vlerë 170,040,398 lekë të përbërë nga:
 - ✓ llogaria 7110 “tarifa administrimi dhe rregullore” me vlerë 169,931,068 lekë që janë të ardhura nga shërbimi konsullor dhe derdhen në Degën e Tatimeve nga P.Sh, TNT A.C dhe A.D.E.
 - ✓ llogaria 7113 “të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve” me vlerë 109,330 lekë dhe që janë të ardhura të krijuara nga fotokopimi i dokumentave në arkivin e MEPJ-së nga studiues të ndryshëm jo punonjës të Ministrisë. Shtuar nga viti shkuar me 62,556 lekë.

Llogaria 72. IV “Grante Korente” në total prej 409,433,103 lekë shtuar nga viti i shkuar me 58,406,441 lekë, për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik financiar te MEPJ.

Kjo llogari përbëhet nga:

- Llogaria 720 a. “Grant korrent i brendshëm” për vlerën 408,883,731 lekë të përbërë nga:
 - ✓ llogaria 7200 “Nga i njëjti nivel qeverisje” për vlerën 373,969,411 lekë, shtuar nga viti shkuar me 52,879,178 lekë si rrjedhojë e shtimit të aktivitetit ekonomik financiar.
 - ✓ llogaria 7201 “Nga nivele të tjera qeverisje” për vlerën 715,400 lekë, shtuar nga viti shkuar me 690,900 lekë si rrjedhojë e aktivitetit të shtuar të institucionit.
 - ✓ llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga Buxheti” me vlerë prej 33,446,160 lekë, shtuar gjatë këtij viti me 4,083,231 lekë dhe përfaqëson të drejta të njësisë në marrëdhënie me shtetin. Rakorduar me kundërpartinë, llogarinë 4342 “Operacione me shtetin”.
 - ✓ llogaria 7207 “Sponsorizime nga të tretë” me vlerë prej 752,760 lekë përfaqëson një shumë të kaluar gabimisht ndaj një personi, i cili e ka kthyer shumën.
- Llogaria 721 b. “Grant korrent i jashtëm” për vlerën 549,372 lekë të përbërë nga:
 - ✓ llogaria 7211 “Nga organizata ndërkombëtare” për vlerën 549,372 lekë dhe përfaqëson një sponsorizim të bërë nga Organizata Frankfonisë për organizim eventi.

Totali i ardhurave të funksionimit në formatin nr.3/2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore formati nr.3/1 plus rezultatin e ushtrimit. Konkretisht për vitin 2021 paraqiten si më poshtë vijon:

i.	Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 579,583,501 lekë
ii.	Operacione Korrigjim Rezultati (llog. 829, 841)= 262,830 lekë
Totali ii + iii = 579,846,331lekë	

i.	Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 406,536,204 lekë
ii.	Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 173,310,127 lekë
Totali i + ii = 579,846,331 lekë	

Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat e vitit 2021, nënshkruar nga Shefi Financës Z. P.K dhe nëpunësi zbatues Zj.I.D, nga ana e Degës së Thesarit nga specialistja e të ardhurave Znj. M.F dhe Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave Zj.Sh.Ç. Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë 26,531,995.6 lekë, nga të cilat janë derdhur në buxhet 25,229,864 lekë dhe mban Institucioni 1,302,131.6 lekë , mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 0 lekë.

Në lekë

Kod Institucioni	Klasifikimi Buxhetor	Përshkrimi	Të ardhura mujore	Të ardhura progresive	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1015001	710 9600	Të ardhura nga qiratë		110,000	0		110,000	
1015001	711 3006	Të ardhura nga shtypshkrimet	26,070	109,330	0		109,330	
1015001	711 3099	Të ardhura nga shitja e shërbimeve	2,770,427	25,010,534.35	0		25,010,534.35	
1015001	721 0101	Të ardhura nga sponsorizimet		752,760	752,760	752,760		
1015001	721 1100	Të ardhura nga org.ndërkombëtare		549,371.6	549,371.6	549,371.6		
1015001	778 0100	Të ardhura të hyra gabimisht						
1015001	466 8100	Rimbursim TVSH	89,465,856	600,687,028	600,687,028			
		Totali	98,262,353	627,219,024	601,989,160	1,302,131	25,229,864	0.00

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Ne pasqyrën e performancës financiare, të ardhurat rezultojnë në vlerën 579,583,501 lekë dhe në aktrakordimin me Thesarin mbi të ardhurat shuma rezulton 25,229,864 lekë.

Lidhur me të ardhurat nga qira për objektin “hapësirë në katin e nëndheshëm-lokal”

Nga auditimi u konstatua se, me kontratën e lidhur mes MEPJ dhe subjektit A.H me NUIS K.....U për dhënien me qira të objektit “hapësirë 40m²” me afat 1 vit, është përcaktuar vlera e kontratës në bazë të VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë për kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” prej 12,000 lekë në muaj (40m * 300all/muaj).

Lidhur me çështjen e mësipërme “ Pasqyrat Financiare të Aparatit” mbajtur Akt Konstatim nr.3 datë 16.05.2023, protokolluar në MEPJ nr.8649 prot., datë 16.05.2023, personat përgjegjës mbi gjetjet nga MEPJ janë: P. K, O. C.

Mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (Përfaqësitë diplomatike dhe Konsullore dhe Aparati MEPJ- së):

Për vitet objekt auditimi pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi janë dërguar materialet në trajtën e evidencave është kryer organizimi dhe konsolidimi i tyre nga ana e Drejtorisë së Financës.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- Aktivitet ekzistojnë fizikisht;
- Ato i përkasin subjektit;
- Janë të vlerësuara në mënyrë korrekte;
- Janë regjistruar në mënyrë korrekte;
- Është bërë mire ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- Informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivitet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivitet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivitet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivitet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Shënim: Misioni i Republikës së Shqipërisë në New York periudhën 2022 - 2024 është një nga 10 anëtarët e Këshillit të Sigurimit pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ky Këshill është organi suprem i OKB që dikton qëndrimet e organizatës për çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare. Në këto kushte çdo komunikim me këtë përfaqësi kryhet vetëm nëpërmjet rrjetit të klasifikuar. Çdo material i cili përcillet nëpërmjet rrjetit tradicional të komunikimit (mail) **kriptonet automatikisht.**

Sa më sipër pjesa më e madhe e informacionit të kërkuar lidhur me shpenzimet është i paaksesueshëm.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2020 dhe 2021 u konstatua se,

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme operon referuar

- Ligjit nr. 23/2015 ku specifikohet se, ...Kreu II, Institucionet e Shërbimit të Jashtëm, Neni 13 “Ministria e Punëve të Jashtme është institucioni drejtues i Shërbimit të Jashtëm dhe harton, përpunon, koordinon, bashkërendon dhe zbaton politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë në përputhje me interesat kombëtarë.”
- VKM nr. 816, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të RSH”, Pika 2, “Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme”.
- Ligjit. nr. 110/2015 datë 15.10.2015, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Neni 4, Pika 5. “Njësi të qeverisjes qendrore” ...Janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj, që kanë si

veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore. Njësia e qeverisjes qendrore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të vitit 2020 dhe vitit 2021 janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë përkatësisht:

- ✓ me shkresat nr. 4594 prot., datë 15.04.2021, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2017” dhe nr. 100, datë 29.03.2019, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore (përmbledhëse) të vitit 2020” duke respektuar afatet ligjore.
- ✓ Për vitin 2021 mungojnë ekstremitetet në dërgimin e pasqyrave financiare të konsoliduara (vula e thesarit dhe numër protokolli).

Sipas UMFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Sipas këtij udhëzimi, pika 10 Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në NjQP” Formatet e PF vjetore dhe statistikore miratohen me këtë udhëzim dhe janë paraqitur në aneksin 2 bashkëlidhur”.

Seksioni II. Parimet dhe Rregullat e Organizimit dhe Mbajtjes së Kontabilitetit Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, 2.1 Parimet e kontabilitetit në sektorin publik, 5. *Kontabiliteti në sektorin publik mbështetet në këto parime bazë:*

1. Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme.

2. Të dhënat që përmbajnë pasqyrat financiare duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesit, të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për veprimtaritë ekonomike të njësive së qeverisjes së përgjithshme dhe për kontabilitetin.

3. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Si dhe Pika 21 “Përbërja dhe përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” PF vjetorë të konsoliduara përfshijnë si rregull:

- Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar (bilanci);
- Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare;
- Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të flukseve monetare;
- Shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pika 22, *Konsolidimi i pasqyrave financiare vjetore në nivel njësie publike kryhet nga struktura përgjegjëse për financat në organin qendror (aparati) të njësisë publike sipas hapave të mëposhtëm:*

- Disponimi i pasqyrave financiare individuale vjetore të secilës njësi shpenzuese të njësisë publike (aparati dhe të gjitha njësitë e varësisë) , si dhe pasqyrat financiare vjetore të kompanive nën kontrollin apo pronësinë e njësisë publike;
- Hartimi i përmbledhëses së thjeshtë të pasqyrave financiare vjetore, për të gjitha institucionet e varësisë (çdo zë në pasqyrat përkatëse financiare të çdo njësie bashkohet thjeshtë në përmbledhësen e pasqyrave financiare vjetore);

- Pas prodhimit të pasqyrës financiare përmbledhëse, realizohet procesi i konsolidimit, i cili përfshin bashkimin në shumatore të secilës rubrikë e nënrubrikë si të aktiveve dhe pasiveve të pasqyrave financiare individuale të pozicionit financiar; dhe të të ardhurave e shpenzimeve, granteve, transfertave dhe subvencioneve të pasqyrave financiare individuale të performancës financiare.
- Më pas, realizohet procesi i eleminimit të dublimeve, përmbledhjes dhe konsolidimit.

1. Gjetje nga auditimi:

- Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për periudhen objekt auditimi, rezulton se, nuk janë hartuar pasqyrat financiare individuale sipas përcaktimeve të kuadrit nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik. Informacioni mbi veprimtarinë financiare të tyre pasqyrohet në trajtën e evidencave mujore dhe përmbledhëse vjetore, të cilat dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropën, e cila më tej vijon me reflektimin e këtyre të dhënave në pasqyrat financiare të konsoliduara.

- Sa më sipër hartimi i këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara nuk ndjek parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018....i ndryshuar ;

- Monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë për të ruajtur vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre kryhet vetëm nga auditimi i brendshëm i kësaj Ministrie.

Nga auditimi i fondeve të transferuara përfaqësive konstatohet se, shuma e transferuar për vitet ushtrimore mban vlerat repektive prej 12,965,776 Euro dhe 4,050,000 Dollar për vitin 2020 dhe për vitin 2021 prej 10,709,000 Euro dhe 4,450,000 Dollar në bazë të të cilave përfaqësitë realizojnë aktivitetin e tyre operativ dhe investues.

Monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë për të ruajtur vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre kryhet vetëm nga auditimi i brendshëm i kësaj Ministrie.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 28 faqe 355 Projekt Raport

Në vijim të gjetjes suaj lidhur me pasqyrat financiare të përfaqësive diplomatike ju informojmë se, duke konsideruar kushtet specifike në të cilat ushtrijnë aktivitetin e tyre përfaqësitë, hartimi i pasqyrave sipas Udhëzimit nr.8 datë 09.03.201, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së Përgjithshme” nuk është i mundur.

Personeli i financës së përfaqësive shpesh herë nuk ka edukim në fushën e financës madje në strukturë ky staf emërohet si i/e ngarkuar me financën”. Në këto kushte raportimi financiar i tyre bëhet mbi bazë të një formati të thjeshtuar në trajtën e evidencës mujore.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Ashtu sikundër jemi shprehur edhe në material, grupi auditimit pasi është vendosur në dijeni nga ana Juaj të kësaj suate, në pamundësi të patjes së një strukture finance të mirëfilltë pranë përfaqësive, ka sygjëruar që nga ana e MEPJ-së të përditësohet, standartizohet dhe zyrtarizohet evidenca e cila do të përdoret për raportim të shpenzimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore. Sa më sipër argumentimi se, *...Personeli i financës së përfaqësive shpesh herë nuk ka edukim në fushën e financës* nuk gjen vend dhe është në përgjegjësinë tuaj të merrni masa për përmirësimin e kësaj suate me qëllim forcimin e menaxhimit të financave publike.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes 1:	Hartimi i Pasqyrave Financiare të Konsoliduara
Situata:	<p>-Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për periudhen objekt auditimi, rezulton se, nuk janë hartuar pasqyrat financiare individuale sipas përcaktimeve të kuadrit nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik. Informacioni mbi veprimtarinë financiare të tyre pasqyrohet në trajtën e evidencave mujore dhe përmbledhëse vjetore, të cilat dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropën, e cila më tej vijon me reflektimin e këtyre të dhënave në pasqyrat financiare të konsoliduara.</p> <p>- Sa më sipër hartimi i këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara nuk ndjek parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018....i ndryshuar ;</p> <p>- Monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë për të ruajtur vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre kryhet vetëm nga auditimi i brendshëm i kësaj Ministrie. (Trajtuar më hollësisht në faqe 144-146 , të Projekt Raportit të Auditimit).</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,</p> <p>VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”,</p> <p>UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</p> <p>Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet</p> <p>Udhëzimi nr.46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”,</p> <p>Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 ”Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”,</p> <p>Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimi të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,</p> <p>UMF 10, datë 27.02.2008 “Për ndryshim të UMF nr.26, dt.27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”,</p> <p>Ligji nr. 23/2015 ku specifikohet se, ...Kreu II, Institucionet e Shërbimit të Jashtëm, Neni 13 “Ministria e Punëve të Jashtme është institucioni drejtues i Shërbimit të Jashtëm dhe harton, përpunon, koordinon,</p>

	bashkërendon dhe zbaton politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë në përputhje me interesat kombëtarë”, VKM nr. 816, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të RSH”, Pika 2, “Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme”, Ligjit nr. 110/2015 datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 4, Pika 5. "Njësi të qeverisjes qendrore".
Ndikimi/Efekti:	Operim jo konform bazës ligjore dhe rregullatore.
Shkaku:	Mos përditësim me rregullat dhe udhëzimet aktuale.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimet dhe formatatet zyrtare aktuale të miratuara nga MEF. - Nga ana e MEPJ-së të përditësohet, standartizohet dhe zyrtarizohet evidenca e cila do të përdoret për raportim të shpenzimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore;
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Konstatim:

1. Nga auditimi u konstatua se, pronësitë e ndërtesave të përdorura si seli dhe ambienteve të banimit të përfaqësive New York, Romë, Washington, Stockholm, Bruksel Athinë, janë në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe dokumentacionin justifikues të tyre e mban Drejtoria e Shërbimeve të Trupit Diplomatik (DSHTD), e për pasojë janë të raportuara në pasqyrat e tyre financiare.
2. Për përfaqësinë Pekin është mbajtur marrëveshje reciprociteti nga DSHTD dhe nuk janë ngarkuar me shpenzime qiraje.
3. Ndërsa Përfaqësitë Abu Dhabi, Doha, Kuvajt janë pa shpenzime qiraje, si incentiv nga shtetet ku ndodhen ndërtesat ku kryhet shërbimi i jashtëm.

Të ndodhur në kushtet e auditimit të evidencave justifikuese financiare dhe jo pasqyrave financiare të konsoliduara të mirëfillta nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën në bazë risku vetëm disa zëra prej aktivitetit të bilancit kontabël të konsoliduar (për vitin 2021), ku paraqiten si më poshtë vijon: Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”

- ✓ Për vitin 2020 me vlerë 450,551,108 lekë, shtuar nga viti 2019 me vlerën 48,210,620 lekë
- ✓ Për vitin 2021 me vlerë 444,693,944 lekë, pakësuar nga viti 2020 me vlerën 5,857,164 lekë.

Konstatim:Sa i takon llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” nga auditimi u konstatua se, kjo llogari pasqyrore vetëm përbërjen e aparatit, ndërkohë që për 6 godinat që Republika e Shqipërisë ka në pronësi nuk pasqyrohen vlerat në evidencat e tyre e për pasojë kryhet konsolidimi nga ana e MEPJ. (këto të dhëna disponohen nga DSHTD dhe prej tyre kryhet kontabilizimi).

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”

- ✓ Për vitin 2020 me vlerë 315,616,431 lekë, shtuar nga viti 2019 me vlerën 2,863,250 lekë
- ✓ Për vitin 2021 me vlerë 320,168,289 lekë, pakësuar nga viti 2020 me vlerën 4,551,858 lekë.

Sa i takon llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” me vlerë 320,168,289 lekë, shtuar nga viti shkuar me 4,551,858 lekë. Kjo llogari pasqyron vlera për aparat prej 127,143,416 lekë për vitin 2021 dhe diferenca prej 193,024,873 lekë është vlerë e marr nga përfaqësitë.

2. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoj fenomeni i përsëritur i mos kryerjes së procesit të inventarizimit të plotë të aktiveve të MEPJ si dhe inventarizimi i përgjithshëm i aseteve të përfaqësive diplomatike e konsullore të Shqipërisë jashtë vendit, e për pasojë Audituesit shtetërorë të autorizuar të KLSH nuk mund të shprehen mbi nivelin e saktësisë dhe rregullshmërisë së regjistrimit dhe pasqyrimit në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” që gjykuar nga vlera e lartë prej 320,168,289 lekë, konsiderohen si zëra me risk të lartë për humbjen dhe keqadminstrimin e tyre. (Trajtuar më hollësisht në faqe 147-148, të Projekt Raportit të Auditimit).

Titulli i Gjetjes 2:	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”
Situata:	Nga auditimi rezultoj fenomeni i përsëritur i mos kryerjes së procesit të inventarizimit të plotë të aktiveve të MEPJ si dhe inventarizimi i përgjithshëm i aseteve të përfaqësive diplomatike e konsullore të Shqipërisë jashtë vendit, e për pasojë Audituesit shtetërorë të autorizuar të KLSH nuk mund të shprehen mbi nivelin e saktësisë dhe rregullshmërisë së regjistrimit dhe pasqyrimit në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogarinë 214 “ <i>Instalime teknike, makineri e pajisje</i> ” që gjykuar nga vlera e lartë prej 320,168,289 lekë, konsiderohen si zëra me risk të lartë për humbjen dhe keqadminstrimin e tyre. (Trajtuar më hollësisht në faqe 147-148, të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” - Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet Udhëzimi nr.46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”, -Udhëzimi nr. 25, datë 09.12.2021 ”Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMF 10, datë 27.02.2008 “Për ndryshim të UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” - SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	- Nga ana e MEPJ të merren masat për evdientimin, regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogaritë e aktiveve afatgjata dhe aktiveve qarkulluese (me

	vëmendje të shtuar për llog.214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”) për të evituar riskun e humbjes dhe keqadminstrimit të aktiveve.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Llogaria 511 “vlera për tu arkëtuar”

- ✓ Për vitin 2020 me vlerë 82,085,893 lekë, shtuar nga viti 2019 me vlerën 1,152,777 lekë
- ✓ Për vitin 2021 me vlerë 88,530,323 lekë, pakësuar nga viti 2020 me vlerën 6,444,430 lekë.

Sa i takon llogarisë 511 “vlera për tu arkëtuar” kjo llogari paraqet vlerat e fondeve të ngurtësuar në banka gjendje në 31.12.2020 dhe 31.12.2021 për qirat e godinave dhe apartamenteve të punonjësve të përfaqësive jashtë vendit.

Llogaria 512 “llogari në banka”

- ✓ Për vitin 2020 me vlerë 1,891,339,543 lekë, shtuar nga viti 2019 me vlerën 677,230,191 lekë
- ✓ Për vitin 2021 me vlerë 2,294,409,294 lekë, shtuar nga viti 2020 me vlerën 403,069,751 lekë.

Sa i takon llogarisë 512 “llogari në banka” me vlerë 2,294,409,294 lekë pasqyron gjendjen në valutë (Euro dhe Dollar) në llogaritë bankare të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në datë 31.12.2020 dhe 31.12.2021

Konstatim: Nga auditimi i llogarisë 512 “llogari në banka” u konstatua vlerë e lartë e mbajtjes në llogari bankare, e shtuar edhe më tepër gjatë vitit 2021, me vlerën 403,069,751 lekë. Aktualisht gjendja e fondeve në bankë për përfaqësitë diplomatike rezulton e lartë. Kjo nga ana e MEPJ-së argumentohet për shkak të angazhimit financiar që ka vendi ynë në kuadër të kryesimit të Këshillit të Sigurimit i cili është institucioni më i lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara që drejton qëndrimet dhe merr vendime për çështje të paqes dhe sigurisë në nivel ndërkombëtar.

Llogaria 531 “llogaria në arkë”

- ✓ Për vitin 2020 me vlerë 11,912,821 lekë, pakësuar nga viti 2019 me vlerën 1,989,275 lekë
- ✓ Për vitin 2021 me vlerë 9,215,232 lekë, pakësuar nga viti 2020 me vlerën 2,697,589 lekë.

Sa i takon llogarisë 531 “llogaria në arkë” me vlerë 9,215,232 lekë për vitin 2021 pasqyron gjendjen në valutë (Euro dhe Dollar) në arkat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në datë 31.12.2020 dhe 31.12.2021.

Aktualisht nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore operohet jo në përputhje me Ligjin nr.83/2022 “Për ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Llogaria 6059 “transferime të tjera korrente me jashtë”

- ✓ për vitin 2020 me vlerë 2,270,415,887 lekë përfaqëson pagesën për kompaninë A
- ✓ për vitin 2021 me vlerë 2,576,526,150 lekë përfaqëson pagesën për kompaninë A

Sa i takon llogarisë 6059 “transferime të tjera korrente me jashtë” me vlerë 2,576,526,150 lekë për vitin 2021 shtuar nga viti shkuar me 306,110,263 lekë, pasqyron pagesa për kompaninë A. e cila prodhon Pasaporta dhe Karta Identiteti për shtetasit shqiptar jashtë shtetit.

Konstatim: Referuar të dhënave vendosur në dispozicion lidhur me veprimtarinë e A. u konstatua se, totali transferimeve tek A gjatë vitit 2021 ishte në 19,728,588 Euro dhe 1,051,727 Dollar. Konvertuar me kursin e këmbimit rezultojnë në 164,384,930.1 lekë (kursi këmbimit dollar në lekë 156.3 lekë) dhe 2,367,430,560 lekë (kursi këmbimit euro në lekë 120 lekë) totali prej 2,724,402,885.3 lekë diferenca prej 94,681.7 lekë efekt i kursit të këmbimit.

Llogaria 7209 “të tjera grante të brendshme”

- ✓ për vitin 2020 me vlerë 2,371,090,167 lekë përfaqëson arkëtime nga qytetarët tanë jashtë vendit për tu pajisur me pasaporta dhe Karta identiteti.
- ✓ për vitin 2021 me vlerë 2,724,497,567 lekë përfaqëson arkëtime nga qytetarët tanë jashtë vendit për tu pajisur me pasaporta dhe Karta identiteti.

Konstatim: Sa i takon llogarisë 7209 “transferime të tjera korrente me jashtë” me vlerë 2,724,497,567 lekë për vitin 2021 shtuar nga viti shkuar me 353,407,400 lekë, pasqyron arkëtime nga qytetarët tanë jashtë vendit për tu pajisur me pasaporta dhe Karta identiteti.

Referuar të dhënave vendosur në dispozicion lidhur me veprimtarinë e A u konstatua se, totali hyrjeve gjatë vitit 2021 ishte në 21,264,836 Euro dhe 1,104,431 Dollar. Konvertuar me kursin e këmbimit rezultojnë në 172,622,565.3 lekë (kursi këmbimit dollar në lekë 156.3 lekë) dhe 2,551,780,320 lekë (kursi këmbimit euro në lekë 120 lekë) totali prej 2,724,402,885.3 lekë diferenca prej 94,681.7 lekë efekt i kursit të këmbimit.

Llogaria 7210 janë grante nga qeveritë e vendeve arabe për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të ambasadave tona në këto vende

- ✓ për vitin 2020 me vlerë 22,223,848 lekë detajuar:
 - Qeveria në Doha – Katar 72,727,\$ konvertuar në 7,563,608 lekë
 - Qeveria në Abu Dhabi – Emiratet e Bashkuara Arabe 135,685 \$ konvertuar në 14,111,240 lekë
 - Sponsorizim nga Ambasada Gjermane 549,000 lekë
- ✓ Për vitin 2021 me vlerë 25,152,746 lekë detajuar:
 - Qeveria në Doha – Katar 72,727,\$ konvertuar në 7,490,881 lekë
 - Qeveria në Abu Dhabi – Emiratet e Bashkuara Arabe 135,685 \$ konvertuar në 13,975,555 lekë
 - Qeveria e Kosovës transferuar 30,000 Euro Ambasadës në Beograd për komunat e Preshevës, konvertuar në 3,686,310 lekë.

Konstatim: Sa i takon vlerave të sipër cituara nga ana e MEPJ-së mungon një dokument zyrtar për rakordimin e këtyre fondeve, apo autorizimin e transferimit në destinacionin e përcaktuar të vlerave të mësipërme.

Nga ana e grupit të auditimit për vitet 2020-09.2022, u përzgjedhën për tu audituar 18 përfaqësi të cilat në krahasim me totalin e transferimeve të bëra kundrejt tyre përgjatë vitit 2020 përbëjnë 36.65 % të fondeve të transferuara gjatë këtij viti dhe për vitin 2021 kanë përfituar 51.86% të totalit të fondeve të transferuara dhe 45.38% për vitin 2022.

1. Pragë
2. Podgoricë
3. Moskë
4. Vjenë
5. Tel Aviv
6. Washington
7. Londër
8. Romë
9. New york
10. Pekin
11. Selanik
12. Athinë

13. BE - Bruxel
14. Mynih
15. Berlin
16. Paris
17. Madrid
18. Milano

Nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se:

I. Shpenzimet për sigurim jete dhe shëndeti për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Sa i takon sigurimit të jetës së përfaqësuesve nëpër misionet diplomatike dhe konsullore baza ligjore e përdorur është si më poshtë vijon:

- **Ligji nr. 23/2015** “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53 “Trajtimi financiar i personelit të Shërbimit të Jashtëm” pikat 4-6 specifikon se ...

4. Ministria e Punëve të Jashtme mbulon masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për diplomatit e emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor.

5. Në raste të veçanta, kur është emëruar në zona me rrezikshmëri të lartë, Ministria e Punëve të Jashtme i mbulon diplomatit dhe familjarëve të tij sigurimin e jetës, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

6. Ministria e Punëve të Jashtme mbulon sigurimin e jetës së diplomatit, i cili kryen një shërbim të përkohshëm në zonë me rrezikshmëri të lartë jashtë vendit, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

- **VKM nr.20 datë 18.01.2017** “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, pika 3 dhe 4 specifikon se ...

3. Ministria e Punëve të Jashtme përballon shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë. Në rastet kur familjarët nuk e shoqërojnë personelin e shërbimit të jashtëm në vendin pritës, ata nuk e përfitojnë sigurimin e jetës.

Rrezikshmëri e lartë, për efekt sigurimi sipas këtij vendimi, konsiderohen situatat kur:

- a) në shtetin pritës shpallet gjendja e luftës ose e jashtëzakonshme;
- b) në shtetin pritës mbizotërojnë situata të përkeqsuara të sigurisë dhe të rendit publik, të cilat vlerësohen të rrezikshme për jetën.

Procedurat e përzgjedhjes së kompanive të sigurimit dhe prokurimi i fondeve për sigurimin e jetës kryhen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe i nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

4. Ministria e Punëve të Jashtme mbulon shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të bashkëshortit/es të personelit të shërbimit të jashtëm për periudhën që ai e shoqëron personelin në shërbim.

Nga auditimi u konstatua një mungesë përcaktimesh dhe harmonizimi e plotësimesh në bazën ligjore e rregullatorë, për sa i takon shpenzimeve për sigurimin e jetës së përfaqësuesve të shërbimit të jashtëm dhe shoqëruesve të tyre. Kështu, konstatohet se në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, nuk është sanksionuar qartë “Pagesa për sigurim e jetës së familjarëve/shoqëruesve të këtyre diplomatëve”, dhe një gjë e tillë është specifikuar në VKM nr.20

datë 18.01.2017. Nga auditimi i kontratave të lidhura rezultoj se, referuar Ligjit nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” MEPJ mbulon masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për diplomatit e emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor dhe në raste të veçanta, kur është emëruar në zona me rrezikshmëri të lartë i mbulon diplomatit dhe familjarëve të tij sigurimin e jetës, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

E njëjta gjë specifikohet edhe në VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, MEPJ paguan shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë. Nga auditimi u konstatua se, në 100% të rasteve të audituara siguracioni i jetës ka përfshirë edhe shoqëruesit e përfaqësuesve, por asnjë nga përfaqësitë nuk kishte të shpallur situatë me rrezikshmëri të lartë për periudhën objekt auditimi.

Pra mungon një percaktim mbi autoritetin, rastet dhe procedurat e kryerjes së sigurimit të jetës për personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë.

Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion:

Personeli i përfaqësuesve është siguruar konform akteve nënligjore në fuqi dhe procedura është kryer me miratim nga MEPJ, pranë Kompanive të Sigurimit të përzgjedhura. Nga auditimi i kontratave të lidhura rezultoj si më poshtë:

1.1 Nga auditimi u konstatua se, referuar Ligjit nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” MEPJ mbulon masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për diplomatit e emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor dhe në raste të veçanta, kur është emëruar në zona me rrezikshmëri të lartë i mbulon diplomatit dhe familjarëve të tij sigurimin e jetës, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

E njëjta gjë specifikohet edhe në VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, MEPJ paguan shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

- Nga auditimi u konstatua se, në 100% të rasteve të audituara siguracioni i jetës ka përfshirë edhe shoqëruesit e përfaqësuesve, por asnjë nga përfaqësitë nuk kishte të shpallur situatë me rrezikshmëri të lartë për periudhën objekt auditimi.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2021, në 35 kontrata të vendosura në dispozicion për tu audituar, 21 prej tyre ishin lidhur me kompaninë EUROSIG, 1 me kompaninë Sigma, 1 me kompaninë AlbSig, 5 me kompaninë Sigal dhe 7 me kompani të huaja sipas vendeve ku kanë selitë përfaqësitë (*Abu Dhabi, Kanberra, Riad, Kopenhagen, Gjenevë, Kuvajt, Bern dhe një prej kontratave në Ankara*)

Përsa i takon procedurave të përzgjedhjes së kompanive të sigurimit dhe prokurimit të fondeve për sigurimin e jetës kryhen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe i nënshtrohen legjislacionit në fuqi, referuar VKM nr.20 datë 18.01.2017 pika 3 paragrafi II. Nga auditimi u konstatua se, me

përrjashtim të përfaqësisë në Romë, në të gjithë rastet e tjera kishte mungesë në gjurmën e prokurimit të këtyre kompanive të sigurimit.

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2020, në 35 kontrata të vendosura në dispozicion për tu audituar, 21 prej tyre ishin lidhur me kompaninë E., 1 me kompaninë S., 1 me kompaninë A., 5 me kompaninë Sigal dhe 7 me kompani të huaja sipas vendeve ku kanë selitë përfaqësitë (*Abu Dhabi, Kanberra, Riad, Kopenhagen, Gjenevë, Kuvajt, Bern dhe një prej kontratave në Ankara, të cilat janë kontrata të rinovuara*).

Konstatim: Nga auditimi mbi shpenzimet për sigurim jete të përfaqësuesve nëpër misionet diplomatike dhe konsullore, të përzgjedhura për tu audituar, vlera monetare e shpenzimeve për vitin 2021 rezultoj në 364,155.19 Euro dhe 147,165 Dollar nga 412,191.97 Euro dhe 515,734 Dollar të raportuara në evidencat e vendosura në dispozicion.

Nga auditimi i kontratave të sigurimit të shëndetit rezultoi se,

- Kontrata me kompaninë S., për Ambasadën e Shqipërisë në Prishtinë nuk kishte të specifikuar vlerën e Primit. Në nenin 42 të kontratës "Shuma e Primit" pikat 6-9 specifikojnë vlerat prim në muaj/në Euro për secilën kategori por jo konkrete për rastin në fjalë.
- Përfaqësia në Paris dhe Podgoricë kishte diferencë të vogla në vlerën e kontratës me ato të raportuara në evidencat e MEPJ konkretisht prej 59.45 Euro (36.35+23.10) ndërsa përfaqësia në New York kishte diferencë të konsiderueshme mes kontratave dhe raportimit, prej 275,150 Dollar më tepër në raportim.
- Përfaqësia në Selanik kishte diferencë në vlerën e kontratës me ato të raportuara në evidencat e MEPJ konkretisht prej 6,520 Euro, Kontrata për familjen P. ishte draft dhe mungonte specifikimi vlerës së primit.(mungonte 1 kontratë)
- Përfaqësia në Athinë kishte diferencë në vlerën e kontratës me ato të raportuara në evidencat e MEPJ konkretisht prej 42.72 Euro
- Përfaqësia në Zagreb, Kroaci kishte diferencë në vlerën e kontratës me ato të raportuara në evidencat e MEPJ konkretisht prej 9,200 Euro.(mungonte 1 kontratë)
- Përfaqësia në Sofje, Bullgari kishte diferencë në vlerën e kontratës me ato të raportuara në evidencat e MEPJ konkretisht prej 997 Euro
- Përfaqësia në Otava, Kanada kishte diferencë në vlerën e kontratës me ato të raportuara në evidencat e MEPJ konkretisht prej 4,560 Dollar.(mungonte 1 kontratë)

<i>Nr.</i>	<i>Përfaqësia Diplomatike</i>	<i>Sigurim shëndeti</i>	<i>Sigurim shëndeti sipas kontratave</i>	<i>Diferenca</i>
	<i>Në Euro</i>			
1	Misioni BE	28,200		
2	Athinë	51,968.49	52,011.21	42.72
3	Berlin	36,323.55		
4	Mynih	9,720		
5	Podgoricë	14,716.35	14,680	36.35
6	Madrid	1,932.06		
7	Selanik	24,400	17,880	6,520
8	Vjenë	6,087.15		
9	Romë	26,600	26,600	-
11	Milano	5,161.50		
12	Londër	18,681.78		
13	Paris	22,223.10	22,200	23.10

14	Bern	44,000		
15	Ankara	5,333		
16	Kroaci	20,300	11,100	9,200
17	Prishtinë			
18	Budapest	20,800		
19	Bari	6,660		
20	Bullgari	6,297	5,300	997
22	Maqedoni	28,800		
23	Moskë	6,200		
24	Strasburg	12,080		
25	Stokholm		1,950	
26	Janinë		3,200	
27	Misioni OSBE Vjenë		434,27	
28	Poloni		15,520	
29	Rumani		22,500	
30	Hagë		6,300	
31	Stamboll		14,400	
32	Gjenevë	58,765		
	TOTAL	455,248.98 €		
	Në dollar			
33	New york	359,200	84,050	275,150
34	Washington DC	67,006.46		
35	Canada	43,320	38,760	4,560
36	Izrael	8,237.99		
37	Brazilia	11,030 \$	11,500	
38	Pekin	11,500		
39	Riad		38,970.05 Sar	
40	Kanberra	4,514		
41	Tokio	6,800		
42	Abu Dhabi	15,156	12,855	
43	Kuëajt	14,988		
	TOTAL	541,752.45 \$		

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Shënim: Sigurimi shëndetësor për Konsullatën Milano rregullohet sipas Dekretit të Ministrisë së Shëndetësisë Italiane datë 08/10/1986. Në bazë të nenit 10 të këtij dekreti plotësohet një formular për deklarimin e të ardhurve vjetore të individit. Ky formular plotësohet për të gjithë qytetarët të cilët nuk i përkasin Bashkimit Europian, dhe kur motivi i qëndrimit është për arsye të ndryshme (duke përfshirë këtu edhe përfaqësuesit diplomatik të shteteve.)

Shënim: Prej vitit 2022 mënyra e operimit për sigurimin e jetës ka ndryshuar, nga kryerje individuale e sigurimit për përfaqësi në një mënyrë të koncentruar nëpërmjet koncorsiumit.

Prej vitit 2022 është vijuar sigurimi shëndetit të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre përmes një koncorsiumi të lidhur. Nga auditimi u konstatua se, 4 nga 18 përfaqësitë e përzgjedhura rezultojnë se për vitin 2022 kanë vijuar me kontratat individuale të sigurimit të shëndetit, e në vijim ka hyrë në fuqi koncorsiumi edhe për to.

Nga ana e grupit të auditimit u kërkua informacion për prezencën e një relacioni/memo shoqëruese justifikuese të ndryshimit të metodës së sigurimit në atë përmes koncorsiumit, si dhe u kërkua gjurmë për testim tregu nëse kjo është metoda më kosto më të ulët dhe përfitim më të lartë apo një relacion justifikues të metodës së përzgjedhur. Të dyja këto gjurmë audituese mungojnë.

Sa më sipër operuar jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021, neni 13 Studimi paraprak i tregut, pika 1 dhe 4.

II. Shpenzimet për qiramarrje të ambienteve të banimit dhe selive të përfaqësive diplomatike dhe konsullore

Lidhur me ambientet e banimit dhe ushtrimit të veprimtarisë për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, si dhe shpenzimet për qiramarrje (*ambiente për zyra dhe apartamente banimi*) baza ligjore e përdorur është Ligji nr.25/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”. Ku konkretisht shprehet në geramat c dhe ç të saj:

c) Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit, personeli i shërbimit të jashtëm, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve të qirasë së banesës, energjisë elektrike, ujit, gazit dhe ngrohjes. Fondet dhe masa e mbulimit të këtyre shpenzimeve përcaktohen nga MPJ-ja, në përputhje me parashikimet e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

ç) Ministria e Punëve të Jashtme përcakton, periodikisht, kushtet kryesore të qiramarrjes, listën e orendive të nevojshme për ambientin e banimit dhe limitet e qira pagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim. Rregullat e përcaktuara në këtë paragraf do të zbatohen vetëm për kontratat e qiramarrjes, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Në lidhje me gjetjen e mëposhtme u paraqitën observacione të cilat pas shqyrtimit nga grupi auditimit u pranuan pjesërisht me argumentimet përkatëse, si dhe u krye reflektimi përkatës në projekt raport.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka gjurmë të përcaktimit të:

- limiteve të qira pagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim;
- përcaktimit periodik të kushteve kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 11397 prot., datë 14.07.2023 me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 1.2 faqe 339 Projekt Raport

MEPJ aktualisht nuk ka detyrim ligjor nga aktet që rregullojnë aktivitetin e saj për të vendosur limite për qira pagesat për banesat e punonjësve të përfaqësive. Limitet vendosen në bazë të buxhetit të miratuar që shoqëron diplomatin.

MEPJ me anë të urdhrin nr 79, datë 01.02.2023 ka ngritur grupin e punës i cili do të hartojë ndryshimet e ligjit nr.23/2015 “Për shërbimin e jashtëm në RSh”. Në këtë kuadër grupi punës do të evidentojë dispozitat që do të preken nga ndryshimi i ligjit dhe do të përgatis një analizë të detajuar mbi ato se çfarë synon ndryshimi i dispozitave.

Referuar sa më sipër, në proces rishikimi janë edhe të gjithë dispozitat ligjore, urdhërat, udhëzimet dhe manualët që referohen në ligj. Objekt rishikimi dhe sistemi do të jetë ndër të tjera procedura e qeramarrjes së selive diplomatike dhe apartamenteve të diplomatëve.

Përsa cituar në gjetjen 1.2 ju bëjmë me dije se, kontratat e qerave për përfaqësitë e përzgjedhura janë kryesisht kontrata që janë nënshkruar përpara periudhës objekt auditimi.

Gjatë vitit 2020 dhe 2021 tregu i pasurive të paluajtshme në të gjithë botën është diktuar direkt nga shpallja e gjendjes së pandemisë botërore dhe lufta në Ukrainë. Gjatë periudhës 2020-2022 është vërejtur vështirësi në gjetjen e apartamenteve për marrje me qira, çmime shumë të larta për qiramarrje fenomen i listave të pritjes për një ambientet si pasojë e kërkesave të larta.

Në zbatim të Urdhrit nr. 79, datë 28.03.2023, MEPJ është në proces të draftimit të udhëzimeve dhe përcaktimit të praktikave të brendshme lidhur me rregullat dhe manualët e marrjes me qira të ambienteve që do të shërbejnë si banesa për punonjësit e përfaqësive diplomatike. Por duke vlerësuar artificat e tregut mobiluar gjatë këtyre 2 viteve të fundit nga faktorët e cituar më lartë procesi nuk është përmbyllur ende.

Konsullata Munihi nuk paguan qira për ambientet e konsullatës, sepse ushton aktivitetin pranë ambienteve të konsullatës së Përgjithshme të Kosovës në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit për hapjen e konsullatave të përbashkëta.

MEPJ nuk ka detyrim ligjor nga aktet që rregullojnë aktivitetin e saj për të vendosur limite për qira pagesat për banesat e punonjësve të përfaqësive. Limitet vendosen në bazë të buxhetit të miratuar që shoqëron diplomatën.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mos paraqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, si dhe në frymën e ndërtimit të një sistemi prokativ të menaxhimit të parasë dhe pronës publike dhe me qëllim kornizimin e sistemit rregullator funksional.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi kontratat e qirave, për 18 përfaqësitë diplomatike të përzgjedhura për tu audituar nga ana e grupit të auditimit, totali i këtyre shpenzimeve të raportuara në MEPJ arrin në vlerën 1,690,266 Euro dhe 407,004 Dollar për vitin 2020 dhe 1,835,214 Euro dhe 538,958 Dollar për vitin 2021.

Nga auditimi u konstatua se,

- Nga ana e përfaqësive nuk disponohet informacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së ofertës më të mirë të ambientit, apo një analizë së vlerës së tregut që është përdorur për përzgjedhjen e ambientit më të përshtatshëm me koston më të mirë, referuar zonës së ndodhur dhe metrave katrorë të hapësirës. (nuk kemi informacion për sipërfaqet Vs koston)
- Nuk ka gjurmë ekzistencë të një urdhri të brendshëm për ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të përzgjedhjes së ambienteve për zyrat qendrore apo banimi, e për pasojë nuk disponohet informacion për marrjen e disa ofertave dhe më tej përzgjedhjen e më të mirës,
- Sa i takon kontratave të qirave (*megjithëse një pjesë e tyre është e lidhur prej periudhave të hershme të kaluara*) u konstatua problematika e gjuhës, ato janë hartuar dhe nënshkruar në gjuhët respektive të vendit pritës (Izrael, Greqi, Gjermani etj), duke operuar në këto kushte në mospërputhje të plotë me pikën 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, e cila ka parashikuar se

...Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 22 faqe 352 Projekt Raport

MEPJ me anë të urdhrit nr 79, datë 01.02.2023 ka ngritur grupin e punës i cili do të hartojë ndryshimet e ligjit nr.23/2015 “Për shërbimin e jashtëm në RSh”. Në këtë kuadër grupi punës do të evidentojë dispozitat që do të preken nga ndryshimi i ligjit dhe do të përgatis një analizë të detajuar mbi ato se çfarë synon ndryshimi i dispozitave.

Referuar sa më sipër, në proces rishikimi janë edhe të gjithë dispozitat ligjore, urdhërat, udhëzimet dhe manualët që referohen në ligj. Objekt rishikimi dhe sistemi do të jetë ndër të tjera procedura e qeramarrjes së selive diplomatike dhe apartamenteve të diplomatëve.

Gjatë periudhës 2020-2022 është vërejtur vështirësi në gjetjen e apartamenteve për marrje me qira, çmime shumë të larta për qiramarrje fenomen i listave të pritjes për një ambientet si pasojë e kërkesave të larta.

Në zbatim të Urdhrit nr. 79, datë 28.03.2023, MEPJ është në proces të draftimit të udhëzimeve dhe përcaktimit të praktikave të brendshme lidhur me rregullat dhe manualët e marrjes me qira të ambienteve që do të shërbejnë si banesa për punonjësit e përfaqësive diplomatike. Por duke vlerësuar artificat e tregut mobiluar gjatë këtyre 2 viteve të fundit nga faktorët e cituar më lartë procesi nuk është përmbyllur ende.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mos paraqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, si dhe në frymën e synimit të ndërtimit të një sistemi proaktiv të menaxhimit të parasë dhe pronës publike dhe me qëllim kornizimin e sistemit rregullator funksional vijojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim. Sa i takon materialit në trajtën draft, mbi të nuk mund të marrim siguri të arsyeshme për tu shprehur mbi outputin tinal të tij, kjo gjë ngelet për tu verifikuar rast pas rasti.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes 3:	Shpenzimet për qiramarrje të ambienteve të banimit dhe selive të përfaqësive diplomatike dhe konsullore.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi kontratat e qirave, për 18 përfaqësitë diplomatike të përzgjedhura për tu audituar nga ana e grupit të auditimit, u konstatua se, Nga ana e përfaqësive nuk disponohet informacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së ofertës më të mirë të ambientit, apo një analizë së vlerës së tregut që është përdorur për përzgjedhjen e ambientit më të përshtatshëm me koston më të mirë, referuar zonës së ndodhur dhe metrave katrorë të hapësirës. (nuk kemi informacion për sipërfaqet Vs koston) Nuk ka gjurmë ekzistencë të një urdhri të brendshëm për ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të përzgjedhjes së ambienteve për zyrat qendrore apo banimi, e për pasojë nuk disponohet informacion për marrjen e disa ofertave dhe më tej përzgjedhjen e më të mirës,

	<p>Sa i takon kontratave të qirave (megjithëse një pjesë e tyre është e lidhur prej periudhave të hershme të kaluara) u konstatua problematika e gjuhës, ato janë hartuar dhe nënshkruar në gjuhët respektive të vendit pritës (Izrael, Greqi, Gjermani etj), duke operuar në këto kushte në mospërputhje të plotë me pikën 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, e cila ka parashikuar se ...Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.</p> <p>3.1 MEPJ për marrjen me qira të ambienteve të banimit dhe të selisë së përfaqësive nuk ka të hartuara rregulla apo manuale për këtë veprimtari.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”; - Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve dhe likuiditeteve të institucionit
Shkaku:	Moszbatim i bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi
Rekomandimi:	<p>Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSh të merren masa të:</p> <p>Plotësohet baza rregullatorë me të gjithë elementët që parashikon Ligji/VKM respektive;</p> <p>Studiohet tregu i pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe operohet sipas formave që parashikon ligji për vijueshmërinë;</p> <p>Përcaktohen periodikisht kushtet kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit;</p> <p>Për rastet e dokumentave me vende të huaja të nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirave u konstatua se,

- MEPJ për marrjen me qira të ambienteve të banimit dhe të selisë së përfaqësive nuk ka të hartuara rregulla apo manuale për këtë veprimtari.
- Praktika e kontratave të qirave ishim me mangësi në përbërjen e tyre, konkretisht si më poshtë:

Përfaqësia Izrael

Nga auditimi i kontratave të nënshkruara u konstatua prania e:

Kontratës së godinës së ambasadës, e lidhur më 19.01.2017 për 5 vite me vlerë 3,000 US \$ plus TVSH (VAT) në muaj (3510\$). Më klauzolën se, në fund të vitit të 3, fillimi i vitit të katërt renta do të rritet me një normë prej 3% mbi tarifat e qirasë në fuqi që aplikohen.

2 Kontratave për ambiente banimi, konkretisht

E para nënshkruar më 27.10.2022 deri më 19.01.2023 me vlerë rente 2,840 \$ në muaj.

E dyta nënshkruar më 20.12.2021 deri më 19.12.2022 me vlerë rente 1,900 \$ në muaj për dy vitet e para.

Zëri i Qirave ka ndikim nga ndryshimi i rritjes së qirasë nga 3% mbi qiranë e vitit pararendës sipas kontratës, në 1.5% për arsye të pandemisë.

Gjetje nr.4.1

- Për vitin 2021 Zëri i qirave ka ndikim nga ndryshimi i rritjes së qirasë nga 3% mbi qiranë e vitit pararendës sipas kontratës, në 1.5% për arsye të pandemisë dhe totali i shpenzimeve është 100,895.4 \$ dhe jo 100,909.06 \$ sikundër paraqitur në evidenca, duke marr parasysh se norma e rritjes së rentës është 3% dhe jo 1.5%, e përbërë nga 44,015.4 \$ për seli dhe 56,880 \$ për banim.

Përfaqësia Madrid

Nga auditimi i kontratave të qirasë, u konstatua prania e:

Kontratës së godinës së ambasadës, e lidhur më 30.11.2017 deri më 30.11.2022 me vlerë 28,237.92 € në vit dhe 2,353.16 € në muaj. Më klauzolën se, gjatë rinovimit të dytë dhe të tretë të saj, pra prej vitit 2017 të nënshkrimit të saj, vlera e rentës do të rishikohet duke u rritur me 10% përveç rritjes së IÇK-së .

3 Kontratave për ambiente banimi, konkretisht

E para nënshkruar më 17.09.2021 me vlerë rente 1,200 € në muaj për vitin e parë të zbatimit të kontratës. Pa specifikuar se si do të jetë në vijim.

E dyta nënshkruar më 12.08.2019 deri më 31.07.2020 me vlerë rente 1,200 € në muaj. Me klauzolë rinovimi me dakortësi të palëve, në të njëjtat kushte.

E treta nënshkruar më 09.09.2019 për 4 vite dhe më të drejtë rinovimi edhe 3 vite më tepër, me vlerë rente 2,800 € në muaj.

Gjetje nr.4.2

Për vitin 2021

- Nga auditimi i kontratave të qirasë vendosur në dispozicion, rezultoi se, totali i shpenzimeve të qirasë për selinë është 28,237.92 Euro, por nuk arrijmë dot të përcaktojmë vlerën e saktë të ndryshimit në totalin e shpenzimeve të qiramarrjes për selinë e përfaqësisë për arsye se, nuk është specifikuar vlera konkrete e ndryshimit, specifikohet se, që duke nisur nga viti i katërt (nga 2021) qiraja të rritet 10% përveç rritjes së IÇK-së; por as sa është IÇK dhe as sa është impakti i rritjes 10% mbi të.
- U konstatua mungesë e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme dhe mos argumentim se përse është pranuar të rinovohet kontrata me një nivel rritje të përgjithshëm prej 10% përveç rritjes së IÇK.

Përfaqësia Paris

Nga auditimi i kontratave të qirasë, u konstatua prania e 4 Kontratave për ambiente banimi nga 5 që janë të tilla, konkretisht

Kontrata e godinës së ambasadës, nënshkruar më 01.11.2020 me vlerë rente 115,000 € në muaj

E para nënshkruar më 30.06.2020 me vlerë rente 1,600 € në muaj. pa afat

E dyta nënshkruar më 26.10.2018-25.10.2019 me vlerë rente 1,998 € në muaj.

E treta me afat 01.02.2017-31.01.2018 me vlerë rente 3,430 € në muaj

E katërta nënshkruar më 04.09.2017 me vlerë rente 2,070 € në muaj.

Gjetje nr.4.3

Nga auditimi u konstatua se,

- Referuar evidencave të vendosura në dispozicion në qiranë vjetore janë përfshirë rritjet për qiratë e diplomatëve me 3% por në kontratat e qirave mungonte një klauzolë specifikuuese e tillë.
- Në kontratat e banimit nuk specifikohet klauzola e rilidhjes së kontratës pas përfundimit të afatit.

Përfaqësia Mynih

Nga auditimi i kontratave të qirasë, u konstatua:

Prania e 2 Kontratave për ambiente banimi, konkretisht:

E para me vlerë rente 4,300 € në muaj për periudhën 01.06.2022 – 31.05.2023

E dyta deri më 28.09.2023 me vlerë rente 2,350 € në muaj për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025

Mungesë e kontratës së godinës së ambasadës

Përfaqësia Neë york

Nga auditimi i kontratave të qirasë, u konstatua prania e:

- 8 Kontratave për ambiente banimi nga 19 që janë të tilla, konkretisht:

Në rastin e përfaqësisë N.Y hasim problematikën e kriptimit të të dhënave (shpjeguar më gjerësisht në shënimin në fillim të trajtimit të pasqyrave të konsoliduara)

Gjetje nr. 4.4

Nga auditimi u konstatua se:

- 7 nga 8 kontratat e vendosura në dispozicion janë nënshkruar në vitin 2022 dhe nuk arrijmë të përcaktojmë prej tyre vlerën e shpenzimeve të qirasë për vitet 2020-2021.
- Në total shpenzimet e qiramarrjes së përfaqësisë Neë york për vitin 2021 ishin 309,300.72 Dollar, ku shpenzimet e qirasë për apartamente ishin 110,450.70 Dollar, shpenzimet e qirasë së zyrave ishin 84,828.15 Dollar dhe shpenzime të tjera qiraje ishin 84,980.52 Dollar. Grupi auditimit nuk arrin të shprehet dot lidhur me shpenzimet e qiramarrjes së kësaj përfaqësie duke qenë se dokumentacioni i vendosur në dispozicion është i pjesshëm.
- Nga auditimi u konstatua pagesa e 29,041.35 Dollar për broker fees, por mungonte gjurma justifikuese e tyre. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10 gërma ç e VKM nr.20 datë 18.01.2017.

Përfaqësia Moskë

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Moskë, rezultoi se shpenzimet e qiramarrjes për vitet 2020 dhe 2021 përfaqësia vijonte ti kishte në vlerën 78.536.41 Euro ku shpenzimet për 1 apartament ishin 44,951.15 Euro dhe për zyra 33,585.26 Euro, si numër ambientesh me qira janë 4 (katër) zyra dhe 1 (një) apartament. Struktura e Ambasadës është 1 (Ambasadori) + 2 (Diplomatë). Në prill të vitit 2018 janë larguar dy diplomat dhe ambasada ka funksionuar me strukturë 1+1 deri në shkurt 2021, kur ka vijuar funksionimin me vetëm ambasadorin.

Gjetje nr.4.5

- Nga auditimi u konstatua se, vijojnë të paguhen shpenzimet e qirasë për 4 (katër) zyra, ku në 2 prej tyre janë depozituar mobiljet dhe orenditë e apartamenteve të diplomatëve të larguar e të cilat nuk kryejnë funksionin si zyra por përdoren në trajtën e magazinave. Megjithëse të 4 zyrat ndodhen në një godinë duhet rivlerësuar vlera e rentës totale.

Përfaqësia Podgoricë

Nga auditimi i kontratave të qirasë për vitin 2021, u konstatua prania e:

2 Kontratave për ambiente, konkretisht

E para me afat nga 01.10.2021 deri më 2023 me vlerë rente 2,000 € në muaj nga 2,100 € në muaj

E dyta me afat 01.09.2022-01.09.2023 me vlerë rente 600 € në muaj

Kontrata e godinës së ambasadës, nga 01.04.2021 me vlerë rente 2,150 € në muaj nga 2,350 € në muaj

Gjetje nr.4.6

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Podgoricë u konstatua se,

- Nga auditimi i kontratave të qiramarrjes, për vitin 2021 totali shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi ishte 46,800 Euro dhe shpenzimet e qiramarrjes së selisë ishin 25,800 €. Në total 72,600 Euro nga 72,900 Euro të raportuara në MEPJ, një diferencë prej 300 Euro raportuar më tepër.

Përfaqësia Londër

Nga auditimi i kontratave të qirasë, u konstatua prania e:

- 5 Kontratave për ambiente banimi, konkretisht

E para me afat 10.08.2021-09.08.2022 me vlerë rente 2,750 £ për muaj.

E dyta me afat 23.10.2021-22.10.2024 me vlerë rente 2,600 £ në muaj

E treta me afat 15.08.2022-14.08.2023 me vlerë rente 3,650 £ në muaj

E katërta me afat 16.08.2021-16.08.2023 me vlerë rente 3,293.33 £ në muaj

E pesta me afat 03.10.2022-15.03.2023 me vlerë rente 2,513.33 £ në muaj

Kontrata e godinës së ambasadës me afat 19.09.2019-28.06.2024 me vlerë rente 8,542 £ për muaj

Gjetje nr. 4.7

Nga auditimi u konstatua se,

- Nuk arrijmë dot të verifikojmë vlerën e plotë të shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi, për shkak se, një pjesë e kontratave që na janë vendosur në dispozicion i përkasin periudhës nga gusht 2021 dhe një pjesë e vitit 2022, duke na penalizuar në vlerat e vitit 2021.
- Shpenzimet e qiramarrjes së selisë, për vitin 2021 ishin 102,504 £ konvertuar në Euro referuar kursit të cituar në evidenca prej 1£ në 1.15€ rezulton 117,879.60 Euro nga 127,327.70 Euro të raportuara në evidencat dërguar në MEPJ. Në total një diferencë prej 9,448.1 Euro të pa mbuluara me dokumentacion.

Përfaqësia Vjenë

Gjetje nr.4.8

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Vjenë u konstatua,

Prania e 4 nga 5 kontratat për ambiente banimi, që përfaqësia disponon;

- Dy pa emra nominal përfituesi por lidhur në emër të ambasadorit, (Kontratë nënshkruar më 30.11.2016 me afat të papërcaktuar, me vlerë rente 824 € në muaj, Kontratë nënshkruar më 01.03.2017 me afat të papërcaktuar, me vlerë rente 1,297.06 € në muaj);
- Mungesë e dokumentacionit të plotë justifikues mbi kontratat e qirasë, në mënyrë që të auditonim vlerën e plotë dhe të saktë të zërit;
- Prania e kontratave të periudhave të largëta dhe mos disponim i informacionit mbi kushtet e vijueshmërisë së tyre.
- Totali shpenzimeve të qirasë për seli rezultonte në 29,268 Euro nga 28,921.56 Euro të raportuara, me një diferencë prej 346.44 Euro.

Përfaqësia Berlin

Gjetje nr.4.9

Nga auditimi i kontratave të qirasë për përfaqësinë Berlin, u konstatua,

- Prania e një kontrate që i përket një periudhe të largët të nënshkrimit, konkretisht vitet 2000 kur monedha e përdorur nuk ka qenë Euro por 1,800.04 DM/Marka Gjermane, për rrjedhojë nuk arrijmë dot të bëjmë konvertimin e vlerave. Referuar pagesave të kryera rezultojnë të jetë 1,581.65 Euro;
- Duke supozuar se, kontratat e qiramarrjes kanë vazhduar në të njëjtat kushte si janë lidhur rezultojnë se, për vitin 2020 totali shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi ishte 85,532 Euro dhe për vitin 2021 ishin 86,998.2 Euro;
- Shpenzimet e qiramarrjes për seli nuk i verifikojmë dot për shkak të mungesës së kontratës. Në total referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion totali shpenzimeve nuk arrin të llogaritet për shkak të mangësive në të dhëna.

Përfaqësia Athinë

Gjetje nr.4.10

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Athinë u konstatua se,

- Republika e Shqipërisë disponon pronësitë e selive për përfaqësinë Athinë, dhe nga auditimi i kontratave të pronësisë për selitë e përfaqësive Athinë, të cilat na u vendosën në dispozicion për tu audituar, u konstatua se,
- Këto kontrata janë të mbajtura vetëm në gjuhën greke, pra gjuhën respektive ku janë të dislokuara dhe mungon një kopje dublikatë në shqip.

Pjesë përbërëse e përfaqësive të përzgjedhura për tu audituar ishin edhe Përfaqësitë Përfaqësia Vjenë, Misioni BE Bruksel, Përfaqësia Selanik, Përfaqësia Athinë por dokumentacioni mbështetës i tyre ishte në gjuhët e vendeve pritëse Gjermanisht, Frengjisht dhe Greqisht gjë që vështirësonte punën audituese në kuptimin e plotë të termave ligjore të kontratës.

<i>Titulli i Gjetjes 4:</i>	<i>Shpenzimet për qiramarrje të ambienteve të banimit dhe selive të përfaqësive diplomatike dhe konsullore</i>
<i>Situata:</i>	Nga auditimi i kontratave të qiramarrjes për përfaqësitë e përzgjedhura për tu audituar, për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

	<p>Republika e Shqipërisë disponon pronësitë e selive për përfaqësitë Athinë, Stokholm, Bruksel, Romë, Washington dhe New York.</p> <p>Nga auditimi i kontratave të pronësisë për selitë e përfaqësive të Republikës së Shqipërisë në Athinë dhe Stokholm, të cilat na u vendosën në dispozicion për tu audituar, u konstatua se,</p> <p>Këto kontrata janë të mbajtura në gjuhët anglisht (Stokholm në gjermanisht), dhe mungon një kopje dublikatë në shqip, në mospërputhje me pikën 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”;</p> <p>Praktika e kontratave të qirave ishim me mangësi në përbërjen e tyre, konkretisht si më poshtë:</p> <p><i>Përfaqësia Izrael</i> <i>Gjetje nr.4.1</i></p> <p>Për vitin 2021 Zëri i qirave ka ndikim nga ndryshimi i rritjes së qirasë nga 3% mbi qiranë e vitit pararendës sipas kontratës, në 1.5% për arsye të pandemisë dhe totali i shpenzimeve është 100,895.4 \$ dhe jo 100,909.06 \$ sikundër paraqitur në evidenca, duke marr parasysh se norma e rritjes së rentës është 3% dhe jo 1.5%, e përbërë nga 44,015.4 \$ për seli dhe 56,880 \$ për banim.</p> <p><i>Përfaqësia Madrid</i> <i>Gjetje nr.4.2</i></p> <p>Për vitin 2021</p> <p>Nga auditimi i kontratave të qirasë vendosur në dispozicion, rezultoj se, totali i shpenzimeve të qirasë për selinë është 28,237.92 Euro, por nuk arrijmë dot të përcaktojmë vlerën e saktë të ndryshimit në totalin e shpenzimeve të qiramarrjes për selinë e përfaqësisë për arsye se, nuk është specifikuar vlera konkrete e ndryshimit, specifikohet se, që duke nisur nga viti i katërt (nga 2021) qiraja të rritet 10% përveç rritjes së IÇK-së; por as sa është IÇK dhe as sa është impakti i rritjes 10% mbi të.</p> <p>U kontaktua mungesë e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme dhe mosargumentim se përse është pranuar të rinovohet kontrata me një nivel rritje të përgjithshëm prej 10% përveç rritjes së IÇK.</p> <p><i>Përfaqësia Paris</i> <i>Gjetje nr.4.3</i></p> <p>Nga auditimi u konstatua se,</p> <p>Referuar evidencave të vendosura në dispozicion në qiranë vjetore janë përfshirë rritjet për qiratë e diplomatëve me 3% por në kontratat e qirave mungonte një klauzolë specifikuese e tillë.</p> <p>Në kontratat e banimit nuk specifikohet klauzola e rilidhjes së kontratës pas përfundimit të afatit.</p> <p><i>Përfaqësia Neë york</i></p> <p>Në rastin e përfaqësisë N.Y hasim problematikën e kriptimit të të dhënave (shpjeguar më gjerësisht në shënimin në fillim të trajtimit të pasqyrave të konsoliduara)</p> <p><i>Gjetje nr.4.4</i></p>
--	---

Nga auditimi u konstatua se:

7 nga 8 kontratat e vendosura në dispozicion janë nënshkruar në vitin 2022 dhe nuk arrijmë të përcaktojmë prej tyre vlerën e shpenzimeve të qirasë për vitet 2020-2021.

Në total shpenzimet e qiramarrjes së përfaqësisë New York për vitin 2021 ishin 309,300.72 Dollar, ku shpenzimet e qirasë për apartamente ishin 110,450.70 Dollar, shpenzimet e qirasë së zyrave ishin 84,828.15 Dollar dhe shpenzime të tjera qiraje ishin 84,980.52 Dollar. Grupi auditimit nuk arrin të shprehet dot lidhur me shpenzimet e qiramarrjes së kësaj përfaqësie duke qenë se dokumentacioni i vendosur në dispozicion është i pjesshëm.

Nga auditimi u konstatua pagesa e 29,041.35 Dollar për broker fees, por mungonte gjurma justifikuese e tyre. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10 gërma ç e VKM nr.20 datë 18.01.2017.

Përfaqësia Moskë

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Moskë, rezultoj seshpenzimet e qiramarrjes për vitet 2020 dhe 2021 përfaqësia vijonte ti kishte në vlerën 78.536.41 Euro ku shpenzimet për 1 apartament ishin 44,951.15 Euro dhe për zyra 33,585.26 Euro, si numër ambientesh me qira janë 4 (katër) zyra dhe 1 (një) apartament. Struktura e Ambasadës është 1 (Ambasadori) + 2 (Diplomatë). Në prill të vitit 2018 janë larguar dy diplomat dhe ambasada ka funksionuar me strukturë 1+1 deri në shkurt 2021, kur ka vijuar funksionimin me vetëm ambasadorin.

Gjetje nr.4.5

Nga auditimi u konstatua se, vijojnë të paguhen shpenzimet e qirasë për 4 (katër) zyra, ku në 2 prej tyre janë depozituar mobiljet dhe orenditë e apartamenteve të diplomatëve të larguar e të cilat nuk kryejnë funksionin si zyra por përdoren në trajtën e magazinave, megjithëse të 4 zyrat ndodhen në një godinë duhet rivlerësuar vlera e rentës totale.

Përfaqësia Podgoricë

Gjetje nr.4.6

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Podgoricë u konstatua se, për vitin 2021 totali shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi ishte 46,800 Euro dhe shpenzimet e qiramarrjes së selisë ishin 25,800 €. Në total 72,600 Euro nga 72,900 Euro të raportuara në MEPJ, një diferencë prej 300 Euro raportuar më tepër.

Përfaqësia Londër

Gjetje nr.4.7

Nga auditimi u konstatua se, kontratat e qirasë që na janë vendosur në dispozicion i përkasin periudhës nga gusht 2021 dhe një pjesë e vitit 2022, e për pasojë nuk arrijmë dot të verifikojmë vlerën e plotë të shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi për vitin 2021.

Shpenzimet e qiramarrjes së selisë, për vitin 2021 ishin 102,504 £ konvertuar në Euro referuar kursit të cituar në evidenca prej 1£ në 1.15€ rezulton 117,879.60 Euro nga 127,327.70 Euro të raportuara në evidencat

	<p>dërguar në MEPJ. Në total një diferencë prej 9,448.1 Euro të pa mbuluar me dokumentacion.</p> <p><i>Përfaqësia Vjenë</i> <i>Gjetje nr.4.8</i></p> <p>Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Vjenë u konstatua, Prania e 4 nga 5 kontratat për ambiente banimi, që përfaqësia disponon; Dy pa emra nominal përfituesi por lidhur në emër të ambasadorit, (Kontratë nënshkruar më 30.11.2016 me afat të papërcaktuar, me vlerë rente 824 € në muaj, Kontratë nënshkruar më 01.03.2017 me afat të papërcaktuar, me vlerë rente 1,297.06 € në muaj);</p> <p>Mungesë e dokumentacionit të plotë justifikues mbi kontratat e qirasë, në mënyrë që të auditonim vlerën e plotë dhe të saktë të zërit;</p> <p>Prania e kontratave të periudhave të largëta dhe mosdipsonim i informacionit mbi kushtet e vijueshmërisë së tyre.</p> <p>Totali shpenzimeve të qirasë për seli rezultonte në 29,268 Euro nga 28,921.56 Euro të raportuara, me një diferencë prej 346.44 Euro.</p> <p><i>Përfaqësia Berlin</i> <i>Gjetje nr.4.9</i></p> <p>Nga auditimi i kontratave të qirasë për përfaqësinë Berlin, u konstatua, Prania e një kontrate që i përket një periudhe të largët të nënshkrimit, konkretisht vitet 2000 kur monedha e përdorur nuk ka qenë Euro por 1,800.04 DM/Marka Gjermane, për rrjedhojë nuk arrijmë dot të bëjmë konvertimin e vlerave. Referuar pagesave të kryera rezulton të jetë 1,581.65 Euro;</p> <p>Duke supozuar se, kontratat e qiramarrjes kanë vazhduar në të njëjtat kushte si janë lidhur rezultoj se, për vitin 2020 totali shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi ishte 85,532 Euro dhe për vitin 2021 ishin 86,998.2 Euro Shpenzimet e qiramarrjes për seli nuk i verifikojmë dot për shkak të mungesës së kontratës. Në total referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion totali shpenzimeve nuk arrin të llogaritet për shkak të mangësive në të dhëna.</p> <p><i>Përfaqësia Athinë</i> <i>Gjetje nr.4.10</i></p> <p>Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Athinë u konstatua se, Republika e Shqipërisë disponon pronësitë e selive për përfaqësinë Athinë, dhe nga auditimi i kontratave të pronësisë për selitë e përfaqësive Athinë, të cilat na u vendosën në dispozicion për tu audituar, u konstatua se, këto kontrata janë të mbajtura vetëm në gjuhën greke, pra gjuhën respektive ku janë të dislokuara dhe mungon një kopje dublikatë në shqip.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet

	diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”; - Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i asetëve dhe likuiditeteve të institucionit
Shkaku:	Moszbatim i bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi
Rekomandimi:	Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSh të merren masa të: Plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm; Të kryhet analizë tregut nëse ka ndryshim në termat e kontratave apo do të lidhen kontrata të reja, si dhe të shoqërohen me argumentim shteruesrastet kur pranohet rinovim me rritje rente/norme. Në të gjitha rastet të merret kopje dublikatë në gjuhën amëtare të kontratave të lidhura.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 31 faqe 356 Projekt Raport

Lidhur me gjetjet përse i përket çështjes së kontratave të qirave informojmë se informacioni i audituar është përcjell në formë elektronike nga ana e përfaqësive dhe ka qenë mjaft voluminoz. Në këto kushte materialet e dërguara për arsye teknike mund të mos jenë përcjell të plota, të kenë probleme skanimi apo printimi të emaileve të dërguara. Referuar rekomandimit tuaj MEPJ do të bashkëpunojë për secilin prej rasteve të cituar në gjetjen tuaj për të verifikuar problematikën.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar argumentimit tuaj sa i takon volumit të audituar dakortësojmë lidhur me masivitetin e dokumentacionit. Ndërkohë që, argumentimi i dhënë nga ana Juaj nuk shprehet mbi problematikat e konstatuara në gjetje por faktin që do të vlerësohet rast pas rasti secila çështje e parashtruar. Në mungesë të fakteve kundërshtuese të gjetjes mbajmë të njëjtin qëndrim sikundër në gjetje.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

III. Shpenzime Transporti për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Lidhur me lëvizjet e makinave dhe shpenzimet e transportit në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë vazhdon të jetë në fuqi Urdhër i Ministrit nr.507 datë 15.10.2012 “Për përdorimin e automjeteve në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë”.

Në lidhje më Gjetjen e mëposhtme u paraqitën observacione të cilat pas shqyrtimit nga grupi auditimit u pranuan me argumentimet përkatëse, si dhe u krye reflektimi përkatës në projekt raport.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua, mosmbajtja e dokumentacionit të lëvizjes së automjeteve sipas Urdhrit të Ministrit nr.507 dt 15.10.2012 nga ana e përfaqësive Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të detajuar:

- Mungesë e gjurmëve të Urdhrave të titullarëve të përfaqësive për autorizimin e lëvizjes së automjeteve, ku të specifikohet arsyeja e lëvizjes dhe itinerari. (moszbatim i pikës nr.8 të urdhrin nr.507 dt.15.10.2012).
- Mungesa e gjurmës së kërkesës për përdorimin e automjetit nga ana e punonjësve të përfaqësive, ku të jetë specifikuar qartë arsyeja si dhe pamundësia e përdorimit të transportit publik për në destinacion. (pika 2 e urdhrin nr.507 dt.15.10.2012).
- Mungesë e gjurmës së marrjes së dakortësisë nga ana e titullarit të misionit (konsull/ambasador)
- Mungesë e gjurmës dokumentuese të lëvizjes së automjeteve, (kartelat e lëvizjes të cilat duhet të përmbajnë nënshkrimin e shoferit dhe personit që udhëton).
- Nga shoferet e përfaqësive nuk janë mbajtur të gjithë formularët e urdhrin nr.507, datë 15.10.2012, i Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për përdorimin e automjeteve dhe të karburantit në Përfaqësitë Diplomatike e Konsullore të Republikës së Shqipërisë”.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023 me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 1.3 faqe 339 Projekt Raport

MEPJ është në procesin e rishikimit të Urdhrin të Ministrit 507 date 15.10.2012 sepse është konstatuar vështirësi nga ana e përfaqësive për përmbushjen e kërkesave të specifikuara në këtë urdhër. Kryesisht punonjësit që ushtojnë detyrën e shoferit në përfaqësitë diplomatike nuk janë shtetas shqiptar. Gjithashtu puna në kushtet e pandemisë, mungesa e stafit në përfaqësi e cila ka pamundësuar krijimin komisionet e parashikuar në urdhrin 507, dikton rishikimin e tij.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, por është i njëjti me atë të paraqitur në projekt raport me shkresën nr.8650/3 datë 23.05.2023 argumentat e dhëna në këtë observacion nuk kundërshtojnë gjetjen, por ngelen për tu verifikuar rast pas rasti.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua, mangësi në procedurat dhe hartimin e gjurmës së auditimit lidhur me lëvizjet e automjeteve,

- Mungesa e një regjistri lëvizjesh të automjeteve, duke mos mundësuar vijimin me verifikimin e orarit të lëvizjeve të automjeteve të përfaqësisë vetëm brenda orarit zyrtar (pika 3 e urdhrin nr.507 dt.15.10.2012) si dhe verifikimin e destinacionit të lëvizjeve, sasisë së karburantit të harxhuar, qëllimit të lëvizjes (pika 14 e urdhrin nr. 507 dt.15.10.2012)

5.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua, mangësi në sistemet e ngritura për sistemimin e dokumentacionit dhe korrespondencën me MEPJ sa i takon çështjeve të lëvizjes së automjeteve dhe shpenzimeve të transportit.

- Mungesa e plotë e gjurmës së komunikimit me Drejtorinë Juridike dhe të Shërbimeve në MEPJ, në moszbatim të pikave 4 dhe 5 të Urdhrin nr.507 datë 15.10.2012. Konkretisht nga ana e përfaqësive për rastet e pritjeve apo përcjelljeve në aeroporte, porte apo pika të kalimit kufitar nuk ka gjurmë të kërkesës e më tej miratimit të lëvizjes së automjetit.

- Mungesë e gjurmës të realizimit të praktikës së furnizimit të automjetit me karburant, në moszbatim të plotë të pikës nr.11 të urdhrin nr.507 dt.15.10.2012, konkretisht:

1.1 mungesë e gjurmës së dokumentimit të bërjes hyrje kontabile në magazinë të sasisë së karburantit;

1.2 mungesë e gjurmës së dokumentimit të bërjes dalje shoferit sipas destinacionit të çdo lëvizje që shoqërohet me harxhim karburanti.

5.2 Gjetje nga auditimi:

Mungesë e plotë e formularëve bashkangjitur shpenzimeve të transportit. MEPJ mbulon pagesën e karburantit të automjeteve zyrtare për përdorim zyrtar në Mision. Sikundër është specifikuar në aktin përkatës nënligjor të MEPJ, Urdhri nr.507 dt 15.10.2012, pika 12 e tijshoferët janë të detyruar të plotësojnë formatet shoqëruese nr.1-nr.6 për çdo automjet. Misionet diplomatike duhet të dorëzojnë këto formular me qëllim dokumentimin dhe justifikimin e veprimtarisë së automjeteve nëpër përfaqësi.

5.3. Gjetje nga auditimi:

Mungesë e plotë e gjurmës së krijimit nga ana e titullarit të misioneve të komisionit i cili do të provoj për çdo automjet sasinë e harxhuar të karburantit për 100 km brenda dhe jashtë qytetit. (moszbatim i plotë i pikës nr.10 të urdhrin nr.507 dt.15.10.2012, për vitin 2021 nga 22 përfaqësi të përzgjedhura për tu audituar dokumentacionin vetëm 1 e ka plotësuar, përfaqësia në Athinë)

5.4 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit të përfaqësive u konstatua në shumicën e rasteve mungesë e gjurmës së marrjes së automjeteve në dorëzim nga shoferi i përfaqësive. Për vitin 2021 nga 22 përfaqësi të përzgjedhura për tu audituar dokumentacionin, vetëm 2 prej tyre e kanë plotësuar kriterin e marrjes së automjetit në ngarkim nga ana e shoferit (përfaqësia në Athinë dhe përfaqësia në Milano).

Titulli i Gjetjes 5:	Lëvizje automjeteve
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua, mangësi në procedurat dhe hartimin e gjurmës së auditimit lidhur me lëvizjet e automjeteve,</p> <p>Mungesa e një regjistri lëvizjesh të automjeteve, duke mos mundësuar vijimin me verifikimin e orarit të lëvizjeve të automjeteve të përfaqësisë vetëm brenda orarit zyrtar (pika 3 e urdhrin nr.507 dt.15.10.2012) si dhe verifikimin e destinacionit të lëvizjeve, sasisë së karburantit të harxhuar, qëllimit të lëvizjes (pika 14 e urdhrin nr. 507 dt.15.10.2012)</p> <p>Gjetje nr.5.1</p> <p>Nga auditimi u konstatua, mangësi në sistemet e ngritura për sistemimin e dokumentacionit dhe korrespondencën me MEPJ sa i takon çështjeve të lëvizjes së automjeteve dhe shpenzimeve të transportit.</p> <p>Mungesa e plotë e gjurmës së komunikimit me Drejtorinë Juridike dhe të Shërbimeve në MEPJ, në moszbatim të pikave 4 dhe 5 të Urdhrin nr.507 datë 15.10.2012. Konkretisht nga ana e përfaqësive për rastet e pritjeve apo përcjelljeve në aeroporte, porte apo pika të kalimit kufitar nuk ka gjurmë të kërkesës e më tej miratimit të lëvizjes së automjetit.</p> <p>Mungesë e gjurmës të realizimit të praktikës së furnizimit të automjetit me karburant, në moszbatim të plotë të pikës nr.11 të urdhrin nr.507 dt.15.10.2012, konkretisht:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - mungesë e gjurmës së dokumentimit të bërjes hyrje kontabile në magazinë të sasisë së karburantit; - mungesë e gjurmës së dokumentimit të bërjes dalje shoferit sipas destinacionit të çdo lëvizje që shoqërohet me harxhim karburanti. <p>Gjetje nr.5.2 Mungesë e plotë e formularëve bashkangjitur shpenzimeve të transportit. MEPJ mbulon pagesën e karburantit të automjeteve zyrtare për përdorim zyrtar në Mision. Sikundër është specifikuar në aktin përkatës nënligjor të MEPJ, Urdhri nr.507 dt 15.10.2012, pika 12 e tij ...shoferët janë të detyruar të plotësojnë formatet shoqëruese nr.1-nr.6 për çdo automjet. Misionet diplomatike duhet të dorëzojnë këto formular me qëllim dokumentimin dhe justifikimin e veprimtarisë së automjeteve nëpër përfaqësi.</p> <p>Gjetje nr.5.3 Mungesë e plotë e gjurmës së krijimit nga ana e titullarit të misioneve të komisionit i cili do të provoj për çdo automjet sasinë e harxhuar të karburantit për 100 km brenda dhe jashtë qytetit. (moszbatim i plotë i pikës nr.10 të urdhrin nr.507 dt.15.10.2012, për vitin 2021 nga 22 përfaqësi të përzgjedhura për tu audituar dokumentacionin vetëm 1 e ka plotësuar, përfaqësia në Athinë).</p> <p>Gjetje nr.5.4 Nga auditimi i dokumentacionit të përfaqësive u konstatua në shumicën e rasteve mungesë e gjurmës së marrjes së automjeteve në dorëzim nga shoferi i përfaqësive. Për vitin 2021 nga 22 përfaqësi të përzgjedhura për tu audituar dokumentacionin, vetëm 2 prej tyre e kanë plotësuar kriterin e marrjes së automjetit në ngarkim nga ana e shoferit (përfaqësia në Athinë dhe përfaqësia në Milano).</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Mosmbajtje dokumentacionit autorizues të plotë
Rekomandimi:	<p>Nga ana e përfaqësive të merren masa për të zbatuar Urdhrin nr.507 datë 15.10.2012 të Ministrit të Punëve të Jashtme, duke mbajtur në konsideratë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm autorizues dhe justifikues sipas formave që parashikon baza ligjore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merrën masa për të kryer inventarizim dhe ngarkim të aseteve respektive në personat përkatës që mbajnë përgjegjësi mbi to.

Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

- Nga verifikimi që ju bë harxhimit të karburantit u konstatua se, nga ana e përfaqësive mungon gjurma e përcaktimit të normave të harxhimit të karburantit për çdo mjet në përdorim;
- Nga ana e përfaqësive nuk është vendosur një plan mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së lëvizjeve të personave që i përdorin për nevoja të punës;
- Nga ana e përfaqësive nuk janë përcaktuar normativat e harxhimit për asnjë nga automjetet respektiv të përfaqësive;
- Nga auditimi u konstatua mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e përfaqësive;
- Nga auditimi u konstatua se, nuk mund të kryenim kryqëzimim të të dhënave midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimeve të plotësuara për lëvizjet e brendshme/jashtme për të cilat është bërë tërheqja e karburantit bazuar në kilometrat e përshkruar, për arsye sepse nuk disponoheshin të dhëna të plota të lëvizjeve, operuar jo në përputhje me Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes 6:	Harxhimi karburantit
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se,</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nga verifikimi që ju bë harxhimit të karburantit u konstatua se, nga ana e përfaqësive mungon gjurma e përcaktimit të normave të harxhimit të karburantit për çdo mjet në përdorim; - Nga ana e përfaqësive nuk është vendosur një plan mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së lëvizjeve të personave që i përdorin për nevoja të punës; - Nga ana e përfaqësive nuk janë përcaktuar normativat e harxhimit për asnjë nga automjetet respektiv të përfaqësive; - Mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e përfaqësive; - Nuk disponoheshin të dhëna të plota të lëvizjeve, operuar jo në përputhje me Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;

	- VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Mosmbajtje dokumentacionit autorizues të plotë
Rekomandimi:	Nga ana e përfaqësive të merren masa që i gjithë dokumentacioni të mbahet në mënyrë kronologjike dhe të plotë. Me qëllim kjo, verifikimin e përdorimit të karburantit në përputhje me parimin e 3 E-ve. Si dhe kryqëzimin e të dhënave midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimeve të plotësuara për lëvizjet e brendshme/jashtme për të cilat është bërë tërheqja e karburantit bazuar në kilometrat e përshkruar.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 32, 33 faqe 359 të Projekt Raportit

Lidhur me konstatimet për lëvizjet e automjeteve të përfaqësive, ju informojmë se, MEPJ është në proces rishikimi të Urdhërit të Ministrit nr.507, datë 15.10.2012 sepse është konstatuar vështirësi nga ana e përfaqësive për mbushjen e kërkesave të specifikuara në këtë urdhër. Kryesisht punonjësit që ushtrojnë detyrën e shoferit në përfaqësitë diplomatike nuk janë shtetas shqipëtar. Gjithashtu puna në kushtet e pandemisë, mungesa e stafit në përfaqësi e cila ka pamundësuar krijimin e komisioneve të parashikuara në Urdhërin nr.507 dikton rishikimin e këtij urdhëri.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, por kufizimi në observacion vetëm me argumentim narrativ i cili thekson edhe më tepër konstatimin tonë, duke cituar vështirësitë në zbatimin e Urdhrit nr.507 datë 15.10.2012 por pa dhënë argumenta kundërshtues të gjetjes mbajmë të njëjtin qëndrim sikundër në gjetje.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi përfaqësinë diplomatike Vjenë u konstatua se, 2 automjetet e përfaqësisë të cilat janë në inventar të ambasadës, janë çrregjistruar dhe mbahen në parkim, automjeti Mercedes Benz dhe Citroen, ku pagesa mujore e parkimit të secilës është 58 Euro për makinë, për vit shkon në 1,392 Euro.

Në analizë shpenzimet për automjete:

Tipi automjetit	Viti vënies në punë	Sigurimi vjetor	Pagesë antarësie OAMTC	Paketa ndihme OAMTC	Euro	
					Vinjeta e Autostradës	Vinjeta e Aeroportit
Benz EH 3013	2019	1.337.09			92.50	180
Passat ED 3030	2010	874.08	87	46.70	92.50	180

Nga auditimi u konstatua se, 2 automjetet të cilat aktualisht nuk përdoren, kanë kosto të larta mbajtje të tyre, konkretisht referuar të dhënave të vendosura në dispozicion, (komunikimi me MEPJ) prej 4,385.87 Euro në vit. Nga ana e përfaqësisë të kryhet analiza kosto përfitim dhe të gjykohet për vijueshmërinë duke patur në konsideratë menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Titulli i Gjetjes 7:	Vjenë
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit mbi përfaqësinë diplomatike Vjenë u konstatua se, 2 automjetet e përfaqësisë të cilat janë në inventar të ambasadës, janë çrregjistruar dhe mbahen në parkim, automjeti Mercedes Benz dhe Citroen, ku pagesa mujore e parkimit të secilës është 58 Euro për makinë, për vit shkon në 1,392 Euro. Nga auditimi u konstatua se, 2 automjetet të cilat aktualisht nuk përdoren, kanë kosto të larta mbajtje të tyre, konkretisht referuar të dhënave të vendosura në dispozicion, (komunikimi me MEPJ) prej 4,385.87 Euro në vit.
Kriteri:	- Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Mosmbajtje dokumentacionit autorizues të plotë
Rekomandimi:	Nga ana e përfaqësisë të kryhet analiza kosto përfitim dhe të gjykohet për vijueshmërinë duke patur në konsideratë menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi:

Përfaqësuesit diplomatik/konsullor në nisje/përfundim të mandatit të tyre në vendin pranues mund të sjellin në vendin pritës/e origjinës sendet personale të tyre. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit diplomatik/konsullor rregullohet nga VKM nr 20 datë 18.01.2017, gërma b e pikës 10 konkretisht ... *MEPJ mbulon shpenzimet e transportit të sendeve personale të personelit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në momentin e emërimit dhe kthimit në atdhe. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor bëhet me miratimin e MPJ-së, deri në masën 7,5 m³ për anëtar familjeje, pa kaluar limitin e 30 m³ për çdo familje. Prokurimi i fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi;*

Nga auditimi i dokumentacionit të përfaqësive u konstatua mungesë e dokumentacionit justifikues lidhur me praktikën e bartjes së sendeve personale të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre (“cargo”).

Titulli i Gjetjes 8:	Cargo
Situata:	Përfaqësuesit diplomatik/konsullor në nisje/përfundim të mandatit të tyre në vendin pranues mund të sjellin në vendin pritës/e origjinës sendet personale të tyre. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit diplomatik/konsullor rregullohet nga VKM nr 20 datë 18.01.2017, gërma b e pikës 10 konkretisht ... MEPJ mbulon shpenzimet e transportit të sendeve personale të personelit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në momentin e emërimit dhe kthimit në atdhe. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor bëhet me miratimin e MPJ-së, deri në masën 7,5 m ³ për anëtar familjeje, pa kaluar limitin e 30 m ³ për çdo familje. Prokurimi i fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi; Nga auditimi i dokumentacionit të përfaqësive u konstatua mungesë e dokumentacionit justifikues lidhur me praktikën e bartjes së sendeve personale të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre (“cargo”).
Kriteri:	- Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Mosmbajtje dokumentacionit autorizues të plotë
Rekomandimi:	Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merrën masa për të plotësuar me dokumentacion justifikues të nevojshëm praktikat. Të vlerësohet rast pas rasti praktika e cargo-ve nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes përfaqësive dhe Drejtorisë së Financës së MEPJ-së,
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 35 faqe 361 Projekt Raport

Lidhur me gjetjet përsa i përket çështjes së transportit Cargo, informojmë se, informacioni i audituar është përcjell në formë elektronike nga ana e përfaqësive dhe ka qenë mjaft voluminoz. Në këto kushte, materialet e dërguara me anë të postës elektronike, për arsye teknike, mund të kenë mangësi apo probleme me skanimet apo printimet. Gjithashtu theksojmë faktin se në kushtet e pandemisë botërore COVID 19, aktiviteti i përfaqësive është kryer kryesisht sipas sistemit on-line

në përmbushje të masave shtrënguese të aplikuara nga vendet e akreditimit të përfaqësive. Ju informojmë se, për vitin 2023, MEPJ e ka parashikuar procedurën e transportit Cargo në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike me afat realizimi të kësaj procedure muajin Dhjetor 2023.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar argumentimit tuaj sa i takon volumit të audituar dakortësojmë lidhur me masivitetin e dokumentacionit. Ndërkohë që, argumentimi i dhënë nga ana Juaj nuk shprehet mbi problematikat e konstatuara në gjetje por faktin që MEPJ e ka parashikuar procedurën e transportit Cargo në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike me afat realizimi të kësaj procedure muajin Dhjetor 2023. Në mungesë të fakteve kundërshtuese të gjetjes mbajmë të njëjtin qëndrim sikundër në gjetje.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

9. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Paris, e cila posedonte vetëm 1 automjet, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se,

- Për të dy vitet 2020-2021 nga analiza e të dhënave, në varësi të llojit të karburantit të blerë, rezulton të jenë furnizuar me karburant më tepër se 1 makinë (të paktën 2 apo më tepër).
- Për vitin 2020 përfaqësia diplomatike totalin e shpenzimeve për karburant dhe vaj e kishte 4,827.07 Euro, por në këtë total u konstatua se nuk është blerë vetëm “Naftë” për makinën zyrtare por edhe benzinë (të gjitha varietetet e saj).
- Për vitin 2021 totali shpenzimeve për karburant dhe vaj rezulton të jetë 5,320.13 Euro, por në këtë total u konstatua se nuk është blerë vetëm “Naftë” për makinën zyrtare por edhe benzinë (të gjitha varietetet e saj).
 - ✓ Fatura prej 457.84 Euro, për kryerjen e shërbimit të automjetit (ferrota, disk, paketa etj) nuk rezulton të jetë për makinën zyrtare të deklaruar të përfaqësisë.
(Të dyja automjetet janë të tipt ‘Mercedes Benz’ por në të dhënat e faturës evidentohet tek kjo e fundit se data e vendosjes në qarkullim është 21.01.2013, ndërkohë në automjetin tjetër zyrtar data e vendosjes në qarkullim është 12.12.2014)
 - ✓ Nga auditimi rezulton se, prej faturave të servisit arrijmë të identifikojmë edhe 2 automjete të tjera:
 - Një me numër serie 27490303633256 vendosur në qarkullim më 12.12.2014
 - Një me numër serie (të pavendosur numrin) vendosur automjeti në qarkullim më 08.01.2016

<i>Titulli i Gjetjes 9:</i>	Paris
<i>Situata:</i>	Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Paris, e cila posedonte vetëm 1 automjet, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se, Për të dy vitet 2020-2021 nga analiza e të dhënave, në varësi të llojit të karburantit të blerë, rezulton të jenë furnizuar me karburant më tepër se 1 makinë (të paktën 2 apo më tepër). Për vitin 2020 përfaqësia diplomatike totalin e shpenzimeve për karburant dhe vaj e kishte 4,827.07 Euro, por në këtë total u konstatua se nuk është blerë vetëm “Naftë” për makinën zyrtare por edhe benzinë (të gjitha varietetet e saj).

	<p>Për vitin 2021 totali shpenzimeve për karburant dhe vaj rezulton të jetë 5,320.13 Euro, por në këtë total u konstatua se nuk është blerë vetëm “Naftë” për makinën zyrtare por edhe benzinë (të gjitha varietetet e saj). Fatura prej 457.84 Euro, për kryerjen e shërbimit të automjetit (ferrota, disk, paketa etj) nuk rezulton të jetë për makinën zyrtare të deklaruar të përfaqësisë.</p> <p>(Të dyja automjetet janë të tipt ‘Mercedes Benz’ por në të dhënat e faturës evidentohet tek kjo e fundit se data e vendosjes në qarkullim është 21.01.2013, ndërkohë në automjetin tjetër zyrtar data e vendosjes në qarkullim është 12.12.2014)</p> <p>Nga auditimi rezulton se, prej faturave të servisit arrijmë të identifikojmë edhe 2 automjete të tjera:</p> <p>Një me numër serie 27490303633256 vendosur në qarkullim më 12.12.2014 Një me numër serie (të pavendosur) vendosur në qarkullim më 08.01.2016</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekt:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik. - Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushes për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar saktësinë e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 3 faqe 377 Projekt Raport

Përfaqësitë diplomatike hasin shpesh herë flukse të shtuar vizitashtë delegacioneve të larta shtetërore shqiptare me përfaqësues të vendeve ku përfaqësitë janë akredituar. Në këto raste, në kushtet e mungesës së infrastrukturës për përballimin e shërbimit të transportit të të gjithë anëtarëve të delegacioneve (si pasojë e numrit të reduktuar të automjeteve që përfaqësitë kanë në inventar) janë përdorur automjete personale të titullarit apo diplomatëve për të siguruar mbarëvajtjen e

vizitave protokollare. Kjo është arsyeja përse janë hasur raste të furnizimeve me karburant të automjeteve që nuk kanë inventar i përfaqësisë. Gjithashtu informojmë se, informacioni i audituar është përcjellë në formë elektronike nga ana e përfaqësisë. Në këto kushte materialet e dërguara me anë të postës elektronike, për arsye teknike, mund të kenë mangësi dhe probleme me skanimet apo printimet.

Theksojmë faktin se në kushtet e pandemisë botërore COVID 19 aktiviteti ambasadës është zhvilluar kryesisht sipas sistemit online në përmbushje të masave shtrënguese të aplikuara nga shteti francez. Referuar rekomandimit tuaj, MEPJ do ti kërkojë përfaqësisë të verifikoj vlerën e detajuar në gjetje, të plotësojë dhe të administrojë në mënyrë të rregullt dokumentacionin justifikues të pagesave në përmbushje të ligjit nr.8503.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Së pari Gjetja nr.3 përkon me faqen 379 të Projekt Raportit

Në kuadër të realizimit të veprimtarisë operative të përfaqësisë por ndërkohë kryerjen e saj konformë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Është e nevojshme shoqërimi me dokumentacion justifikues provues të ngjarjes/ve respektive. Argumentimi i mësipërm në mungesë të dokumentacionit justifikues shoqërues nuk ndryshon qëndrimin e grupit të auditimit.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

10. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Mynih, e cila posedonte vetëm 1 automjet, nga auditimi dokumentacionit (faturat e karburantit) vendosur në dispozicion u konstatua se,

- Për vitin 2021 totali i shpenzimeve për karburant për periudhën 11 mujore, 31.12.2020-30.11.2021 të identifikuar përmes faturave bashkangjitur është 3,044.5 Euro. Nga auditimi, rezultoj se furnizoheshin 3 automjete me karburant ndërkohë që Konsullata në pronësi të saj ka të deklaruar vetëm 1 automjet. (karta: 700669, 748947, 000031).
- Referuar faturave të paguara për shërbimin e servisit, rezulton të jetë kryer 3 herë shpeznimi për “Servis Benzi”, i pari më 15.02.2021 me vlerë 1,727.37 Euro dhe i dyti më 15.11.2021 me vlerë 1,966.34 Euro; si dhe një sërish më 15.02.2021 me vlerë 1,835.72 Euro. Mbi faturën e këtij të fundit specifikohet me shkrim dore, vlera 1,685.72 është arkëtuar nga A.V. në kartën e konsullores dhe shpenzimi është vetëm 150 Euro, por nuk ka gjurmë dokumentare mbi këtë të fundit.
- Rezultonte mosrakordim i vlerave në fatura/dokumentacion justifikues dhe evidencën e dërguar pranë MEPJ.
 - Për vitin 2020 nga ana e përfaqësisë është kryer shërbimi i riparimit të automjetit 5 herë me një vlerë totale prej 4,285.25 Euro, ku vetëm për një interval një mujor frekuenca e riparimit është 3 raste;
 - në asnjë rast nuk u konstatua prania e gjurmës së argumentimit të nevojës së kryerjes së shërbimit të riparimit, pra mungon një memo argumentuese e situatës;

<i>Titulli i Gjetjes 10 :</i>	Mynih
<i>Situata:</i>	Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Mynih, e cila posedonte vetëm 1 automjet, nga auditimi dokumentacionit (faturat e karburantit)vendosur në dispozicion u konstatua se,

	<p>Për vitin 2021 totali i shpenzimeve për karburant për periudhën 11 mujore, 31.12.2020-30.11.2021 të identifikuar përmes faturave bashkangjitur është 3,044.5 Euro. Nga auditimi, rezultoj se furnizoheshin 3 automjete me karburant ndërkohë që Konsullata në pronësi të saj ka të deklaruar vetëm 1 automjet. (karta: 700669, 748947, 000031).</p> <p>Referuar faturave të paguara për shërbimin e servisit, rezultojnë të jetë kryer 3 herë shpeznimi për “Servis Benzi”, i pari më 15.02.2021 me vlerë 1,727.37 Euro dhe i dyti më 15.11.2021 me vlerë 1,966.34 Euro; si dhe një sërish më 15.02.2021 me vlerë 1,835.72 Euro.</p> <p>Mbi faturën e këtij të fundit specifikohet me shkrim dore, vlera 1,685.72 është arkëtuar nga A.V në kartën e konsullores dhe shpenzimi është vetëm 150 Euro, por nuk ka gjurmë dokumentare mbi këtë të fundit.</p> <p>Rezultonte mosrakordim i vlerave në fatura/dokumentacion justifikues dhe evidencën e dërguar pranë MEPJ.</p> <p>Për vitin 2020 nga ana e përfaqësisë është kryer shërbimi i riparimit të automjetit 5 herë me një vlerë totale prej 4,285.25 Euro, ku vetëm për një interval një muaj frekuenca e riparimit është 3 raste; në asnjë rast nuk u konstatua prania e gjurmës së argumentimit të nevojës së kryerjes së shërbimit të riparimit, pra mungon një memo argumentuese e situatës;</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i asetëve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave.</p> <p>Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë BE-Bruksel, e cila posedonte 3 automjete funksionale, nga auditimi dokumentacionit (faturat e karburantit) vendosur në dispozicion u konstatua se,

- Praktika dokumentare ishte e mangët, në dosje rezultojnë të dhëna vetëm për 2 nga automjetet e përfaqësisë dhe fletë udhëtime vetëm për disa muaj;

- Në të gjitha rastet mungonte praktika e plotë me specifikim të destinacionit, arsyes së lëvizjes dhe personit udhëtues;
- Në të gjitha rastet mungonin urdhër pagesat dhe faturat e karburantit;
- Në total shpenzime transporti sipas dokumentacionit justifikues rezultojnë të jenë 5,316.57 Euro, pra 1,445.66 Euro më pak nga sa janë raportuar;

Gjetje 11.1

Nga auditimi praktikës mbi karburantin e vendosur në dispozicion u konstatua se,

- Rezulton një diferencë prej 619.91 Euro e raportuar më tepër dhe pa dokumentacion justifikues;
- Nga faturat bashkangjitur rezultonte furnizim për vetëm 2 automjete dhe vetëm për disa muaj,
- Faturat ishin jo të plota si më poshtë vijon:
 - ✓ Për pagesën 60.45 Euro karburant për automjetin CD AL 088 në praktikën dokumentare rezultonte bashkangjitur fatura për automjetin me targë CD AC 145
 - ✓ Për pagesën 66.66 Euro karburant për automjetin CD AL 088 në praktikën dokumentare rezultonte bashkangjitur fatura për automjetin me targë CD AC 145 me vlerë 83.28.

Gjetje 11.2

Për shpenzime transporti për vitin 2021 me vlerë totale 6,762.23 Euro rezultuan mos rakordime në dokumentacion

- ✓ shpenzime për karburant dhe vaj, totali i raportuar është 1,323.33 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 703.42 Euro
- ✓ shpenzime për pjesë këmbimi, goma, bateri totali i raportuar është 2,482.80 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 0 Euro
- ✓ shpenzime për sigurim të mjetetve të transportit totali i raportuar është 2,956.10 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 4,613.15 Euro

Në total shpenzime transporti sipas dokumentacionit justifikues rezultojnë të jenë 5,316.57 Euro, pra 1,445.66 Euro më pak nga sa janë raportuar;

Për vitin 2020

- Në të gjithë rastet urdhër pagesat janë pa vlerë ekonomike të specifikuar;
- Sa i takon furnizimit me karburant për 5 raste me vlerë totale prej 394.48 Euro rezulton se nëpërmjet dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk arrijmë të sigurojmë informacion se për cilat automjete është marr ky karburant.

Titulli i Gjetjes 11:	BE – Bruksel
Situata:	<p>Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë BE-Bruksel, e cila posedonte 3 automjete funksionale, nga auditimi dokumentacionit (faturat e karburantit) vendosur në dispozicion u konstatua se,</p> <p>Praktika dokumentare ishte e mangët, në dosje rezultonin të dhëna vetëm për 2 nga automjetet e përfaqësisë dhe fletë udhëtime vetëm për disa muaj;</p> <p>Në të gjitha rastet mungonte praktika e plotë me specifikim të destinacionit, arsyes së lëvizjes dhe personit udhëtues;</p> <p>Në të gjitha rastet mungonin urdhër pagesat dhe faturat e karburantit;</p> <p>Në total shpenzime transporti sipas dokumentacionit justifikues rezultojnë të jenë 5,316.57 Euro, pra 1,445.66 Euro më pak nga sa janë raportuar;</p> <p>Gjetje 11.1</p> <p>Nga auditimi praktikës mbi karburantin e vendosur në dispozicion u konstatua se për vitin 2022,</p>

	<p>Rezulton një diferencë prej 619.91 Euro e raportuar më tepër dhe pa dokumentacion justifikues;</p> <p>Nga faturat bashkangjitur rezultonte furnizim për vetëm 2 automjete dhe vetëm për disa muaj,</p> <p>Faturat ishin jo të plota si më poshtë vijon:</p> <p>Për pagesën 60.45 Euro karburant për automjetin CD AL 088 në praktikën dokumentare rezultonte bashkangjitur fatura për automjetin me targë CD AC 145</p> <p>Për pagesën 66.66 Euro karburant për automjetin CD AL 088 në praktikën dokumentare rezultonte bashkangjitur fatura për automjetin me targë CD AC 145 me vlerë 83.28.</p> <p><i>Gjetje 11.2</i></p> <p><i>Për shpenzime transporti për vitin 2021 me vlerë totale 6,762.23 Euro rezultuan mos rakordime në dokumentacion</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - shpenzime për karburant dhe vaj, totali i raportuar është 1,323.33 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 703.42 Euro - shpenzime për pjesë këmbimi, goma, bateri totali i raportuar është 2,482.80 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 0 Euro - shpenzime për sigurim të mjetetve të transportit totali i raportuar është 2,956.10 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 4,613.15 Euro. <p><i>Në total shpenzime transporti sipas dokumentacionit justifikues rezultojnë të jenë 5,316.57 Euro, pra 1,445.66 Euro më pak nga sa janë raportuar;</i></p> <p>Për vitin 2020</p> <p>Në të gjithë rastet urdhër pagesat janë pa vlerë ekonomike të specifikuar;</p> <p>Sa i takon furnizimit me karburant për 5 raste me vlerë totale prej 394.48 Euro rezulton se nëpërmjet dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk arrijmë të sigurojmë informacion se për cilat automjete është marr ky karburant.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji,

	i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik. - Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushes për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime transporti' për përfaqësinë Pragë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se,

- Përfaqësia Pragë disponon 3 automjete, nga dokumentacioni vendosur në dispozicion mbi shpenzimet e transportit konstatohet se vetëm 2 prej tyre përdoren.
- Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues për shpenzimet e siguracionit të automjeteve, për vitin 2021, praktika për siguracionin e automjetit Mercedes Benz përmbante mungesa si më poshtë vijojnë:
 - ✓ Së pari kartela e siguracionit mungonte, dokumentacioni vendosur në dispozicion ishte vetëm një informacion i përgjithshëm (në version elektronik) dërguar nga kompania e sigurimit (G.C.P) për të kryer pagesën; vlera e paspecifikuar po ashtu edhe afati (shkruar me shkrim dore në fletë);
 - ✓ U konstatua prania e tre faturave, nga Servis Mercedes Benz ku për dy të parat me vlerë totale 1,497.14 Euro nuk arrijmë dot të vërtetojmë se për cilin automjet janë kryer dhe pronësin e tij, dhe tjetra me vlerë 245.8 Euro nuk dihet se për çfarë është kryer kjo pagesë, detajuar:
 - ✓ një rezulton për shërbim filtrër i kabinës së kondicionuar, me vlerë 14,060.20 CZK (565.4€), por pa argumentim nga ana e përfaqësisë së nevojës së ndërmarrjes së këtij shërbimi, po ashtu pa element verifikues se është për automjetet e përfaqësisë (veç emrit të Ambasadorit nuk ka specifikim të tipit të automjetit)
 - ✓ një rezulton për shërbim filtrër i kabinës së kondicionuar, ndërrim i lëngut të frenave, rimbushje agjentit katalitik selektiv, sensori NOX me vlerë 24,187 CZK (931.74€), por pa argumentim nga ana e përfaqësisë së nevojës së ndërmarrjes së këtij shërbimi, po ashtu pa element verifikues se është për automjetet e përfaqësisë (veç emrit të Ambasadorit nuk ka specifikim të tipit të automjetit)
 - ✓ një faturë nuk ka gjurmë se për çfarë shërbimi bëhet fjalë, vetëm vlerëtotal 6,255.70 CZK/245.8 €.
- Totali shpenzimeve mbështetur me dokumentacion justifikues rezulton të jetë në vlerën 2,460.23 Euro ku shpenzimet për karburant janë 2,204.32 Euro dhe siguracioni për automjetin BMW është 255.91 Euro.

Diferenca prej 3,215.95 Euro përfaqëson shpenzime të kryera pa dokumentacion justifikues mbështetës.

- Përfaqësia Pragë dokumentacionet justifikuese mbështetëse të transaksioneve financiare nuk i kishtë në formatin zyrtar, (referuar Ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare") neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik;

Për vitin 2020

- Në të gjitha rastet mungonte hartimi i mandat pagesës, si një dokumentacion autorizues për procedim të mëtejshëm të pagesës financiare;
- Të gjitha dokumentacionet janë në gjuhën Ceke pa patur dublikatë në gjuhën Shqipe çka çënon kuptueshmërinë dhe transparencën e tyre.

Titulli i Gjetjes 12:	Pragë
Situata:	<p>Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Pragë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se, Përfaqësia Pragë disponon 3 automjete, nga dokumentacioni vendosur në dispozicion mbi shpenzimet e transportit konstatohet se vetëm 2 prej tyre përdoren.</p> <p>Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues për shpenzimet e siguracionit të automjeteve, për vitin 2021, praktika për siguracionin e automjetit Mercedes Benz përmbante mungesa si më poshtë vijojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari kartela e siguracionit mungonte, dokumentacioni vendosur në dispozicion ishte vetëm një informacion i përgjithshëm (në version elektronik) dërguar nga kompania e sigurimit (G.C.P) për të kryer pagesën; vlera e paspecifikuar po ashtu edhe afati (shkruar me shkrim dore në fletë); - U konstatua prania e tre faturave, nga Servis Mercedes Benz ku për dy të parat me vlerë totale 1,497.14 Euro nuk arrijmë dot të vërtetojmë se për cilin automjet janë kryer dhe pronësin e tij, dhe tjetra me vlerë 245.8 Euro nuk dihet se për çfarë është kryer kjo pagesë, detajuar: <ul style="list-style-type: none"> ✓ një rezulton për shërbim filtrër i kabinës së kondicionuar, me vlerë 14,060.20 CZK (565.4€), por pa argumentim nga ana e përfaqësisë së nevojës së ndërmarrjes së këtij shërbimi, po ashtu pa element verifikues se është për automjetet e përfaqësisë (veç emrit të Ambasadorit nuk ka specifikim të tipit të automjetit) ✓ një rezulton për shërbim filtrër i kabinës së kondicionuar, ndërrim i lëngut të frenave, rimbushje agentit katalitik selektiv, sensori NOX me vlerë 24,187 CZK (931.74€), por pa argumentim nga ana e përfaqësisë së nevojës së ndërmarrjes së këtij shërbimi, po ashtu pa element verifikues se është për automjetet e përfaqësisë (veç emrit të Ambasadorit nuk ka specifikim të tipit të automjetit) <p>një faturë nuk ka gjurmë se për çfarë shërbimi bëhet fjalë, vetëm vlerëtotal 6,255.70 CZK/245.8 €.</p> <p>Totali shpenzimeve mbështetur me dokumentacion justifikues rezulton të jetë në vlerën 2,460.23 Euro ku shpenzimet për karburant janë 2,204.32 Euro dhe siguracioni për automjetin BMË është 255.91 Euro.</p> <p>Diferenca prej 3,215.95 Euro përfaqëson shpenzime të kryera pa dokumentacion justifikues mbështetës.</p> <p>Përfaqësia Pragë dokumentacionet justifikuese mbështetëse të transaksioneve financiare nuk i kish të në formatin zyrtar, (referuar Ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo</p>

	<p>Iloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik;</p> <p>Për vitin 2020</p> <p>Në të gjitha rastet mungonte hartimi i mandat pagesës, si një dokumentacion autorizues për procedim të mëtejshëm të pagesës financiare;</p> <p>Të gjitha dokumentacionet janë në gjuhën Ceke pa patur dublikatë në gjuhën Shqipe çka cënon kuptueshmërinë dhe transparencën e tyre.</p>
Kriteri:	<p>- Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012;</p> <p>- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;</p> <p>- Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;</p> <p>- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;</p> <p>- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e përfaqësuesit të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës totale prej 4,958.89 Euro (detajuar si në gjetje) si dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave.</p> <p>Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo Iloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Romë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

- Për shpenzimin me vlerë 2,380 Euro, transport për marrjen e automjetit të ceremonialit nga Gjermania në Itali, praktikës dokumentare i mungonte shkresa e marrjes së miratimit nga MEPJ, shkresa që përfaqësia ka njoftuar MEPJ-në; si dhe specifikimet teknike të automjetit apo kontrata e blerjes së tij;
- Për shpenzimin me vlerë 1,640 Euro, riparim automjeti Benz CD 081 AA pas aksidentit, praktikës dokumentare i mungonte memo/shkresa njoftuese e titullarit të përfaqësuesit po ashtu dhe dokumentacion justifikues i vërtetimit të ngjarjes;
- Për shpenzimin me vlerë 1,327 Euro, riparim i automjetit Audi A6 Cd 0141 AA, praktikës dokumentare i mungonte shkresa e marrjes së miratimit nga MEPJ, si dhe memo/shkresa njoftuese e titullarit të përfaqësuesit ku detajohet problematika.

Titulli i Gjetjes 13:	Romë
Situata:	<p>Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Romë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, Për shpenzimin me vlerë 2,380 Euro, transport për marrjen e automjetit të ceremonialit nga Gjermania në Itali, praktikës dokumentare i mungonte shkresa e marrjes së miratimit nga MEPJ, shkresa që përfaqësia ka njoftuar MEPJ-në; si dhe specifikimet teknike të automjetit apo kontrata e blerjes së tij;</p> <p>Për shpenzimin me vlerë 1,640 Euro, riparim automjeti Benz CD 081 AA pas aksidentit, praktikës dokumentare i mungonte memo/shkresa njoftuese e titullarit të përfaqësisë po ashtu dhe dokumentacion justifikues i vërtetimit të ngjarjes;</p> <p>Për shpenzimin me vlerë 1,327 Euro, riparim i automjetit Audi A6 Cd 0141 AA, praktikës dokumentare i mungonte shkresa e marrjes së miratimit nga MEPJ, si dhe memo/shkresa njoftuese e titullarit të përfaqësisë ku detajohet problematika.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave.</p> <p>Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Madrid, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

- Në total për 3 makinat që përfaqësia disponon janë paguar siguracionet vjetore respektive me vlerë totale prej 2,238.2 Euro, por praktikë dokumentare janë të mangëta. Konkretisht për të tre automjetet rezultojnë vetëm prania e ekstraktit të llogarisë dhe urdhër pagesa e nxjerrë nga përfaqësia por mungon fatura e lëshuar nga ana e kompanisë së sigurimit;
- Për automjetin Citroen C1 është kryer shërbimi dhe blerja e pajisjes ‘stop i djathtë i pasëm’ me vlerë 50.19 Euro, por praktika dokumentare është e mangët, konkretisht mungon relacioni

identifikues i situatës, mungon urdhër i titullarit për blerjen e artikullit, mungon kryerja e testimi të tregut;

- Sa i takon pagesave për karburant, për muajit shkurt dhe tetor, referuar përmbledhjes së pagesave mujore, u konstatua se mungonin fatura justifikuese për muajin shkurt 2 me vlerë 103.47 Euro dhe për muajin tetor 2 me vlerë 90 Euro;

Në total shpenzimet e transportit referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion shkojnë 3,460.83 Euro nga 3,601 të raportuara, pra një diferencë e pambuluar me dokumentacion prej 140.17 Euro.

Titulli i Gjetjes 14:	Madrid
Situata:	<p>Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Madrid, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, Në total për 3 makinat që përfaqësia disponon janë paguar siguracionet vjetore respektive me vlerë totale prej 2,238.2 Euro, por praktikat dokumentare janë të mangëta. Konkretisht për të tre automjetet rezultojnë vetëm prania e ekstraktit të llogarisë dhe urdhër pagesa e nxjerrë nga përfaqësia por mungon fatura e lëshuar nga ana e kompanisë së sigurimit;</p> <p>Për automjetin Citroen C1 është kryer shërbimi dhe blerja e pajisjes ‘stop i djathtë i pasëm’ më vlerë 50.19 Euro, por praktika dokumentare është e mangët, konkretisht mungon relacioni identifikues i situatës, mungon urdhër i titullarit për blerjen e artikullit, mungon kryerja e testimi të tregut;</p> <p>Sa i takon pagesave për karburant, për muajit shkurt dhe tetor, referuar përmbledhjes së pagesave mujore, u konstatua se mungonin fatura justifikuese për muajin shkurt 2 me vlerë 103.47 Euro dhe për muajin tetor 2 me vlerë 90 Euro;</p> <p>Në total shpenzimet e transportit referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion shkojnë 3,460.83 Euro nga 3,601 të raportuara, pra një diferencë e pambuluar me dokumentacion prej 140.17 Euro.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 2,481.86 Euro si dhe operuar duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave.</p> <p>Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.</p>

Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nr.15

Nga auditimi i dokumentacionit mbi “shpenzimet e transportit” për përfaqësinë Athinë, u konstatua se:

- Referuar të dhënave vendsour në dispozicion kjo përfaqësi disponon 3 automjete ndërkohë nga auditimi dokumentacionit rezulon prania e 4 automjeteve (CD 54, CD 54-1, CD 54-2, CD 54-27) dhe ku automjeti me targë 54 27 është automjet personal i ambasadores;
- Për 18 ngjarje me vlerë 651.72 Euro që përfaqësojnë larje automjetetesh dhe taksa rruge mungon dokumentacioni justifikues i përdorur për të dokumentuar veprimtaritë/ngjarjet dhe ishte present vetëm urdhër pagesa;
- Sa i takon pagesës së vlerës 280 Euro që përfaqëson servis automjeti për automjetin me targë CD 54-27 që është automjeti personal i titullarit të përfaqësisë dhe pagesa e tij është kryer nga buxheti përfaqësisë gjykojmë nevojën e verifikimit të vlerës, pasi vet përfaqësia ka 2 automjete në pronësi të cilat mund të përdoren për përmbushje të nevojave të përfaqësuesve referuar edhe VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”.

Titulli i Gjetjes 15 :	Athinë
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi “shpenzimet e transportit”për përfaqësinë Athinë, u konstatua se:</p> <p>Referuar të dhënave vendsour në dispozicion kjo përfaqësi disponon 2 automjete ndërkohë nga auditimi dokumentacionit rezulon prania e 4 automjeteve (CD 54, CD 54-1, CD 54-2, CD 54-27) dhe ku automjeti me targë 54 27 është automjet personal i ambasadores;</p> <p>Për 18 ngjarje me vlerë 651.72 Euro që përfaqësojnë larje automjetetesh dhe taksa rruge mungon dokumentacioni justifikues i përdorur për të dokumentuar veprimtaritë/ngjarjet dhe ishte present vetëm urdhër pagesa;</p> <p>Sa i takon pagesës së vlerës 280 Euro që përfaqëson servis automjeti për automjetin me targë CD 54-27 që është automjeti personal i titullarit të përfaqësisë dhe pagesa e tij është kryer nga buxheti përfaqësisë gjykojmë nevojën e kërimit të kthimit të vlerës, pasi vet përfaqësia ka 2 automjete në pronësi të cilat mund të përdoren për përmbushje të nevojave të përfaqësuesve referuar edhe VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”.</p>

Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i asetëve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 931.72 Euro si dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik. - Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi “shpenzimet e transportit” për përfaqësinë Washington për vitin 2020, u konstatua se:

- Në asnjë rast pagesat nuk janë shoqëruar me mandate pagesë, është evidente prania e vetëm faturave por këto nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar transparencën e transaksioneve dhe vërtetësinë e ngjarjeve;
- Referuar të dhënave vendsour në dispozicion kjo përfaqësi disponon 2 automjete ndërkohë nga auditimi dokumentacionit rezulton prania e 4 automjeteve (Sahouri Insurance: Chevrolet Captiva; Dodge dart; Cadillac XTS, Mitsubishi Outlander)

Titulli i Gjetjes 16:	Ëashington
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi “shpenzimet e transportit” për përfaqësinë Washington për vitin 2020, u konstatua se:</p> <p>Në asnjë rast pagesat nuk janë shoqëruar me mandate pagesë, është evidente prania e vetëm faturave por këto nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar transparencën e transaksioneve dhe vërtetësinë e ngjarjeve;</p> <p>Referuar të dhënave vendsour në dispozicion kjo përfaqësi disponon 2 automjete ndërkohë nga auditimi dokumentacionit rezulton prania e 4 automjeteve (Sahouri Insurance: Chevrolet Captiva; Dodge dart; Cadillac XTS, Mitsubishi Outlander);</p>

Kriteri:	- Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	- Nga ana e përfaqësuesve të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Tel Aviv, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

- Referuar kursit mesatar të këmbit të Shekel/Dollar rezulton se 1 Shekel konvertohej mesatarisht në 0.2909 Dollar, dhe totali rezultonte në 3,735.16 Dollar nga 3,866 Dollar raportuar, me një diferencë prej 130.84 Dollar më tepër nga sa rezulton nga dokumentacioni justifikues.

Titulli i Gjetjes 17:	Tel Aviv
Situata:	Kursi Këmbimit Sa i takon zëri ‘shpenzime transporti’ për përfaqësinë Tel Aviv, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, Referuar kursit mesatar të këmbit të Shekel/Dollar rezulton se 1 Shekel konvertohej mesatarisht në 0.2909 Dollar, dhe totali rezultonte në 3,735.16 Dollar nga 3,866 Dollar raportuar, me një diferencë prej 130.84 Dollar më tepër nga sa rezulton nga dokumentacioni justifikues.
Kriteri:	- Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit

Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	Nga ana e përfaqësisë të vlerësohet kursi këmbimit që do të përdoret me qëllim minimizimin sa më shumë të humbjeve nga diferenca e konvertimit.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime transporti' për përfaqësinë Moskë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

- Në të gjitha rastet mungonte hartimi i mandat pagesës, si një dokumentacion autorizues për procedim të mëtejshëm të pagesës financiare;
- Të gjitha dokumentacionet janë në gjuhën Ruse pa patur dublikatë në gjuhën Shqipe ç'ka cënon kuptueshmërinë dhe transparencën e tyre;

Titulli i Gjetjes 18:	Moskë
Situata:	Sa i takon zëri 'shpenzime transporti' për përfaqësinë Moskë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, Në të gjitha rastet mungonte hartimi i mandat pagesës, si një dokumentacion autorizues për procedim të mëtejshëm të pagesës financiare; Të gjitha dokumentacionet janë në gjuhën Ruse pa patur dublikatë në gjuhën Shqipe çka cënon kuptueshmërinë dhe transparencën e tyre;
Kriteri:	- Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; - Ligji nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë"; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës".
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare") neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik.
Rëndësia:	E lartë

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 36, 37, 38, 39, 40, 42 faqe 362-366 Projekt Raport

Lidhur me gjetjen përsa i përket çështjes së shpenzimeve të transportit, informojmë se, informacioni audituar është përcjell në formë elektronike nga ana e përfaqësive dhe është mjaft voluminoz. Në këto kushte materialet e dërguara me anë të postës elektronike, për arsye teknike, mund të kenë mangësi dhe probleme me skanimet apo printimet. Gjithashtu theksojmë faktin se në kushtet e pandemisë botërore COVID 19 aktiviteti i përfaqësive është zhvilluar kryesisht sipas sistemit on-line në përmbushje të masave shtrënguese të aplikuara nga shtetet respektive. Referuar rekomandimit tuaj, MEPJ do tu kërkojë përfaqësive të plotësojnë dhe të administrojnë në mënyrë të rregullt dokumentacionin justifikues të pagesave në përmbushje të ligjit nr.8503

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar argumentimit të paraqitur nga ana juaj në observacionin e mësipërm nuk vërehet kundërshtim i gjetjes dhe as dokumentacion justifikues për të objeksuar konstatimet e grupit të auditimit. Sa më sipër grupi auditimit vijon të mbaj të njëjtin qëndrim.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 4, 5, 6, 9 faqe 377-378, 389 Projekt Raport

Lidhur me gjetjen përsa i përket çështjes së shpenzimeve të transportit, informojmë se, informacioni audituar është përcjell në formë elektronike nga ana e përfaqësive dhe është mjaft voluminoz. Në këto kushte materialet e dërguara me anë të postës elektronike, për arsye teknike, mund të kenë mangësi dhe probleme me skanimet apo printimet. Gjithashtu theksojmë faktin se në kushtet e pandemisë botërore COVID 19 aktiviteti i përfaqësive është zhvilluar kryesisht sipas sistemit on-line në përmbushje të masave shtrënguese të aplikuara nga shtetet respektive.

Referuar rekomandimit tuaj, MEPJ do tu kërkojë përfaqësive të plotësojnë dhe të administrojnë në mënyrë të rregullt dokumentacionin justifikues të pagesave në përmbushje të ligjit nr.8503

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar argumentimit të paraqitur nga ana juaj në observacionin e mësipërm nuk vërehet kundërshtim i gjetjes dhe as dokumentacion justifikues për të objeksuar konstatimet e grupit të auditimit. Sa më sipër grupi auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

19. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi është konstatuar se, përfaqësia diplomatike në Londër operon me 4 llogari bankare të hapura tek banka M.B, ku prej përfaqësive është dhënë informacion si më poshtë vijon:

1. Llogaria 976 në Euro përfaqëson llogarinë për MEPJ, kjo llogari pret të gjitha furnizimet nga MEPJ.
2. Llogaria 641 në GBP përfaqëson llogarinë e ambasadës, kjo është llogari kyesore në GBP e cila furnizohet nga llogaria më sipër në Euro. Nga kjo llogari kryen të gjitha shpenzimet operative të Ambasadës.
3. Llogaria 749 në GBP përfaqëson llogarinë e konsullatës ku hyrjet janë arketimet e të ardhurave të krijuara nga shtetasit Shqiptarë për të gjitha produktet së bashku, shitja e ID, pashaportave, pullave, prokurave, përkthimeve. Daljet e kësaj llogarie janë ajo pjesë e të ardhurave të krijuara vetëm nga ID dhe Pashaportat, dhe këto likuiditete hyjnë tek llogaria 684 e A.

4. Llogaria 684 në GBP përfaqëson llogarinë e A. e cila pret hyrjet e të ardhurave nga Llogaria 749 e Konsullates vetëm per ID dhe pashaporta dhe daljet e kësaj llogarie janë detyrimet ndaj A. Nga kjo llogari bëhen edhe shpenzime të tjera si pagat e operatoreve dhe shpenzime kancelerike.

Grupi auditimit gjykon si me risk të lart mbajtjen e 4 llogarive të ndryshme bankare, ku veç të tjerash duhet theksuar se janë në 2 monedha të ndryshme e kjo sjell impakt të konsiderueshëm nga kursi këmbimit në konvertim.

Titulli i Gjetjes 20:	Londër
Situata:	<p>Nga auditimi është konstatuar se, përfaqësia diplomatike në Londër operon me 4 llogari bankare të hapura tek banka M.B, ku prej përfaqësisë është dhënë informacion si më poshtë vijon:</p> <p>Llogaria 976 në Euro përfaqëson llogarinë për MEPJ, kjo llogari pret të gjitha furnizimet nga MEPJ.</p> <p>Llogaria 641 në GBP përfaqëson llogarinë e ambasadës, kjo është llogari kyesore në GBP e cila furnizohet nga llogaria më sipër në Euro. Nga kjo llogari kryen të gjitha shpenzimet operative të Ambasadës.</p> <p>Llogaria 749 në GBP përfaqëson llogarinë e konsullatës ku hyrjet janë arketimet e të ardhurave të krijuara nga shtetasit Shqiptarë për të gjitha produktet së bashku, shitja e ID, pashaportave, pullave, prokurave, përkthimeve. Daljet e kësaj llogarie janë ajo pjesë e të ardhurave të krijuara vetëm nga ID dhe Pashaportat, dhe këto likujditete hyjnë tek llogaria 684 e A.</p> <p>Llogaria 684 në GBP përfaqëson llogarinë e A. e cila pret hyrjet e të ardhurave nga Llogaria 749 e Konsullates vetëm per ID dhe pashaporta dhe daljet e kësaj llogarie janë detyrimet ndaj Ait. Nga kjo llogari bëhen edhe shpenzime të tjera si pagat e operatoreve dhe shpenzime kancelerike.</p> <p>Grupi auditimit gjykon si me risk të lart mbajtjen e 4 llogarive të ndryshme bankare, ku veç të tjerash duhet theksuar se janë në 2 monedha të ndryshme e kjo sjell impakt të konsiderueshëm ngakursi këmbimit në konvertim.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	Nisur nga risku i lartë që mbart mbajtja e 4 llogarive të ndryshme bankare, ku veç të tjerash duhet theksuar se janë në 2 monedha të ndryshme e kjo sjell impakt të konsiderueshëm nga kursi këmbimit në konvertim, respektivisht mundësi të larta për humbje nga kursi këmbimit, të merren masat për të mbajtur vetëm 2 llogari bankare duke shmangur 2 të tjerat, të cilat në vetvete janë pjesë e njëra tjetrës.

Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

20.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua problematika e konvertimit të monedhës. Për periudhën objekt auditimi mungon hartimi i gjurmës sa i takon procesit të konvertimit të monedhës për llogari të buxheteve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për të parashikuar rrjedhën e dokumentuar të kësaj kategorie të transaksioneve financiare, nga fillimi deri në përfundim të tyre, me synimin që të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Aktualisht, nga ana e përfaqësive operohet në disa lloj monedhash, në varësi kjo të vendit se ku është e dislokuar përfaqësia.

Impakti më i madh krijohet nga përfaqësia Londër, kjo për shkak edhe të faktit të mbajtjes së 4 llogarive si më lartë cituar.

Humbja e krijuar nga kursi këmbimit është në vlera relativisht të konsiderueshme konkretisht për vitin 2020 është 4,540.55 Euro dhe 342.95 Dollar, dhe për vitin 2021 është 5,294.43 Euro dhe 1,731.35 Dollar.

<i>Efekti Kursit të Këmbimit</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>
Moskë	1,166.28	310.73
Londër	3,371.38	4,938.26
Pragë	2.89	45.44
Euro	4,540.55	5,294.43
Tel Aviv	200.13	1,568.09
Pekin	142.82	163.26
Dollar	342.95	1,731.35

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Titulli i Gjetjes 20.1:	Kursi Këmbimit															
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua problematika e konvertimit të monedhës. Për periudhën objekt auditimi mungon hartimi i gjurmës sa i takon procesit të konvertimit të monedhës për llogari të buxheteve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për të parashikuar rrjedhën e dokumentuar të kësaj kategorie të transaksioneve financiare, nga fillimi deri në përfundim të tyre, me synimin që të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.</p> <p>Aktualisht, nga ana e përfaqësive operohet në disa lloj monedhash, në varësi kjo të vendit se ku është e dislokuar përfaqësia.</p> <p>Impakti më i madh krijohet nga përfaqësia Londër, kjo për shkak edhe të faktit të mbajtjes së 4 llogarive si më lartë cituar (gjetja nr.20).</p> <p>Humbja e krijuar nga kursi këmbimit është në vlera relativisht të konsiderueshme konkretisht për vitin 2020 është 4,540.55 Euro dhe 342.95 Dollar, dhe për vitin 2021 është 5,294.43 Euro dhe 1,731.35 Dollar.</p>															
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Efekti Kursit të Këmbimit</th> <th>2020</th> <th>2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Moskë</td> <td>1,166.28</td> <td>310.73</td> </tr> <tr> <td>Londër</td> <td>3,371.38</td> <td>4,938.26</td> </tr> <tr> <td>Pragë</td> <td>2.89</td> <td>45.44</td> </tr> <tr> <td>Tel Aviv</td> <td>200.13</td> <td>1,568.09</td> </tr> </tbody> </table>	Efekti Kursit të Këmbimit	2020	2021	Moskë	1,166.28	310.73	Londër	3,371.38	4,938.26	Pragë	2.89	45.44	Tel Aviv	200.13	1,568.09
Efekti Kursit të Këmbimit	2020	2021														
Moskë	1,166.28	310.73														
Londër	3,371.38	4,938.26														
Pragë	2.89	45.44														
Tel Aviv	200.13	1,568.09														

	Pekin	142.82	163.26
	Euro	4,540.55	5,294.43
	Dollar	342.95	1,731.35
<i>Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit</i>			
Kriteri:	- Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.		
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i asetëve të institucionit		
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.		
Rekomandimi:	Nga ana e MEPJ duke ja përcjell përfaqësive, të merren masa për të formalizuar procedurën e konvertimit të monedhave të huaja në monedhën bazë LEK, me qëllim aplikimin e kursit të këmbimit në përputhje me të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë dhe përllogaritjen e saktë të fitim/humbjes nga kursi këmbimit.		
Rëndësia:	E lartë		
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi		

IV. Auditimi i aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese. Mbajtja e librit të magazinës, procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve të përfaqësive (selia) dhe të apartamenteve të personelit të përfaqësive.

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi për këtë çështje rezulton se nuk është mbajtur i plotë dhe korrekt procesi inventarizimit dhe dokumentacioni për magazinën. Konkretisht, nga ana e përfaqësive nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, dalë në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Magazina

21.Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi dokumentacioni i magazinës nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore nuk mbahej i plotë.

- Mungon gjurma e ngarkimit të detyrës së magazinës me një akt administrativ (urdhër titullari).
- Regjistrimi dhe lëvizja e aktiveve që qarkullojnë nuk rregjistrohen në libër magazine. Plotësohen sporadikisht fletë hyrje dhe fletë dalje.
- Aktivitetet e blera vetëm në disa raste është operuar me fletë hyrje në magazinë

<i>Titulli i Gjetjes 21:</i>	Auditimi i aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese. Mbajtja e librit të magazinës, procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve të përfaqësive (selia) dhe të apartamenteve të personelit të përfaqësive.
<i>Situata:</i>	Për periudhën objekt auditimi dokumentacioni i magazinës nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore nuk mbahej i plotë.

	Mungon gjurma e ngarkimit të detyrës sëmagazinës me një akt administrativ (urdhër titullari). Regjistrimi dhe lëvizja e aktiveve që qarkullojnë nuk rregjistrohen në libër magazine. Plotësohen sporadikisht fletë hyrje dhe fletë dalje. Aktivitetet e blera vetëm në disa raste është operuar me fletë hyrje në magazinë.
Kriteri:	- Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	Nga ana e secilës përfaqësi të merren masa për mirëmenaxhimin e magazinës, kryerjes e inventarizimit të saj si dhe hartimin e kartelave personale të punonjësve.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 45, 46 faqe 367 Projekt Raport

Lidhur me gjetjet për magazinën e përfaqësive ju informojmë se, referuar specifikave të misionëve diplomatike konstatohet se zbatimi i Udhëzimit nr.30 në shumicën e rasteve është thuajse i pamundur për shkak të numrit të reduktuar të stafit që ato kanë. Ky fakt ka kushtëzuar gjithashtu procesin e inventarizimit sepse jemi në kushtet e pamundësisë së krijimit të komisioneve të inventarizimit, komisioneve të vlerësimit apo atyre të nxjerrjes jashtë përdorimit.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar argumentimeve nga ana e subjektit (MEPJ) sjellim në vëmendjen Tuaj se, procesi inventarizimit është një proces i detyrueshëm për tu realizuar çdo vit (referuar UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar) me qëllim monitorimin e riskut të keqmenaxhimit / keqpërdorimit të pasurisë / pronës publike.

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Inventarët

Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion (kartela inventar, fletë inventari, regjistra) u konstatua mos zbatim i Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 ”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

22.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi inventarët u konstatua se,

- Në të gjitha rastet, vlera ekonomike përfaqëson çmimin e blerjes, nuk i është llogaritur amortizim dhe vlerë e mbetur aseteve të përfaqësisë;
- Në të gjitha rastet mungonte gjurma e pasqyrim të inventarëve në evidencat përmbledhëse të përfaqësisë;
- Në të gjitha rastet, investimet korrente nuk janë pasqyruar si pjesë e inventarit të vitit;
- Në të gjitha rastet mungon një informacion përmbledhës apo një relacion në fund të inventarizimit;
- Për vitin 2021, në 6 raste kishte mungesë të plotë inventari për apartamentet e banimit (Madrid, Mynih, Berlin, Londër, Vjenë dhe Podgoricë);
- Për vitin 2021, në 6 raste kishte pasqyrim pjesor të inventarëve për ambientet e banimit (Milano, Athinë, Selanik, Pekin, Neë york, Romë), ku për përfaqësinë Berlin dhe Londër ishte fenomen i mbartur nga 2020;
- Për vitin 2021, në 5 raste mungonte totalisht gjurma për inventarë zyre apo banimi (Paris, Izael) ndërkohë që mungonte edhe për vitin 2020 në përfaqësitë Bruksel, Moskaë dhe Pragë);
- Për vitin 2021, në 2 raste kishte pasqyrim pjesor të inventarëve për zyra (Berlin, Londër) fenomen i mbartur nga 2020;
- Në rastin e përfaqësisë Podgoricë të gjithë artikujt pjesë e inventarit janë të pasqyruar pa vlerë ekonomike të përcaktuar;
- Në 2 raste inventari është pasqyruar si kartelë pa ekstremitete (Madrid dhe New york);
- Në 4 raste nuk ka gjurmë të ngritjes së komisionit të inventarizimit nga ana e Titullarit (Milano, Romë, Londër dhe Washington) ;
- Në 6 raste mungon gjurma e inventarit të zyrave A (Mynih 1 zyrë, Athinë 16 zyra, Selanik 4 zyra, N.York 1 zyrë, Romë 3 zyra dhe Londër 2 zyra) fenomen i mbartur nga 2020;

22.1 Gjetje nga auditimi:

- Aktivet e blera nuk janë shtuar në asnjë rast në inventar,
- Sa i takon nxjerrjeve jashtë përdorimit nuk ka gjurmë të dokumentaimit të procesit
- Nuk ka gjetur zbatim pika nr.12 aktivet duhet të kenë specifikime të sakta dhe të merren në dorzim nga personi që i përdor.

22.2 Gjetje nga auditimi:

Në rastin e përfaqësisë Athinë, u konstatua rasti i përcaktimit të 5 artikujve për nxjerrje jashtë përdorimit me vlerë 19,034.29 Euro, por pa evidence justifikuese.

22.3 Gjetje nga auditimi:

Referuar inventarizimit të fundit (viti 2021) të kryer nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se,

- Në përfaqësinë New york,
 - Kartela e aktiveve të zyrës (në formë regjistri) përmbante 70 artikuj, me vlerë 7,794.47 Dollar. U konstatuan pjesë të inventarit edhe produkte personale (tavolinë studimi, raftë librash për fëmijë, mbajtëse sapuni dhe gotë furcë, dollap për fëmijë, kornizë 1+1 panoramë, karrige për fëmijë, shtroje për fëmijë) me vlerë 298.86Dollar. Në të shpëcifikohet se 26 artikuj ishin vlerësuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit, por mungonte gjurma e relacionit dhe vlerësimit të komisionit. Gjithashtu kartela e inventarëve ishte pa ekstremitete

- Kartela e aktiveve të banesës (në formë regjistri) përmbante 51 artikuj, me vlerë 7,756.38 Dollar. U konstatuan pjesë të inventarit edhe produkte personale (kavanoza qelq ushqimesh, ngrohëse qumështi inoks, mbajtëse shamposh, gërsërë kuzhine, mixer kuzhine Cuisinart) me vlerë 135.57 Dollar. Në të specifikohet se 11 artikuj ishin vlerësuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit, por mungonte gjurma e relacionit dhe vlerësimit të komisionit. Gjithashtu kartela e inventarëve ishte pa ekstremitete.

Titulli i Gjetjes 22:	Inventarët, dokumentacioni i vendosur në dispozicion (kartela inventar, fletë inventari, regjistra)
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion (kartela inventar, fletë inventari, regjistra) u konstatua mos zbatim i Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi inventarët u konstatua se,</p> <p>Në të gjitha rastet, vlera ekonomike përfaqëson çmimin e blerjes, nuk i është llogaritur amortizim dhe vlerë e mbetur aseteve të përfaqësisë;</p> <p>Në të gjitha rastet mungonte gjurma e pasqyrimit të inventarëve në evidencat përmbledhëse të përfaqësisë;</p> <p>Në të gjitha rastet, investimet korrente nuk janë pasqyruar si pjesë e inventarit të vitit;</p> <p>Në të gjitha rastet mungon një informacion përmbledhës apo një relacion në fund të inventarizimit;</p> <p>Për vitin 2021, në 6 raste kishte mungesë të plotë inventari për apartamentet e banimit (Madrid, Mynih, Berlin, Londër, Vjenë dhe Podgoricë);</p> <p>Për vitin 2021, në 6 raste kishte pasqyrim pjesor të inventarëve për ambientet e banimit (Milano, Athinë, Selanik, Pekin, Neë york, Romë), ku për përfaqësinë Berlin dhe Londër ishte fenomen i mbartur nga 2020;</p> <p>Për vitin 2021, në 5 raste mungonte totalisht gjurma për inventarë zyre apo banimi (Paris, Izael) ndërkohë që mungonte edhe për vitin 2020 në përfaqësitë Bruksel, Moska dhe Pragë);</p> <p>Për vitin 2021, në 2 raste kishte pasqyrim pjesor të inventarëve për zyra (Berlin, Londër) fenomen i mbartur nga 2020;</p> <p>Në rastin e përfaqësisë Podgoricë të gjithë artikujt pjesë e inventarit janë të pasqyruar pa vlerë ekonomike të përcaktuar;</p> <p>Në 2 raste inventari është pasqyruar si kartelë pa ekstremitete (Madrid dhe New york);</p> <p>Në 4 raste nuk ka gjurmë të ngritjes së komisionit të inventarizimit nga ana e Titullarit (Milano, Romë, Londër dhe Washington) ;</p> <p>Në 6 raste mungon gjurma e inventarit të zyrave A (Mynih 1 zyrë, Athinë 16 zyra, Selanik 4 zyra, N.York 1 zyrë, Romë 3 zyra dhe Londër 2 zyra) fenomen i mbartur nga 2020;</p> <p>Në rastin e përfaqësisë Izrael, u konstatua se, nëse krahasojmë vlerat e totalit të fletëve të inventarit dhe vlerat e totalit të bllokut të inventarit të përfaqësisë rezultonte diferencë në artikuj dhe vlerë prej 35 artikuj më tepër në bllokun e inventarit të përfaqësisë dhe 45,018.84 Dollar në vlerë mungesë e inventarit të ambienteve të banimit për përfaqësuesit;</p>

	<p>Gjetje nr.22.1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aktivet e blera nuk janë shtuar në asnjë rast në inventar, - Sa i takon nxjerrjeve jashtë përdorimit nuk ka gjurmë të dokumentaimit të procesit nuk ka gjetur zbatim pika nr.12 aktivet duhet të kenë specifikime të sakta dhe të merren në dorzim nga personi që i përdor. <p>Gjetje nr.22.2: Në rastin e përfaqësisë Athinë, u konstatua rasti i përcaktimit të 5 artikujve për nxjerrje jashtë përdorimit me vlerë 19,034.29 Euro, por pa evidence justifikuese.</p> <p>Gjetje nr.22.3: Referuar inventarizimit të fundit (viti 2021) të kryer nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në përfaqësinë New york, <ul style="list-style-type: none"> - Kartela e aktiveve të zyrës (në formë regjistri) përmbante 70 artikuj, me vlerë 7,794.47 Dollar. U konstatuan pjesë të inventarit edhe produkte personale (tavolinë studimi, raftë librash për fëmijë, mbajtëse sapuni dhe gotë furcë, dollap për fëmijë, kornizë 1+1 panoramë, karrige për fëmijë, shtroje për fëmijë) me vlerë 298.86 Dollar. Në të shpëcifikohet se 26 artikuj ishin vlerësuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit, por mungonte gjurma e relacionit dhe vlerësimit të komisionit. Gjithashtu kartela e inventarëve ishte pa ekstremitete - Kartela e aktiveve të banesës (në formë regjistri) përmbante 51 artikuj, me vlerë 7,756.38 Dollar. U konstatuan pjesë të inventarit edhe produkte personale (kavanoza qelq ushqimesh, ngrohëse qumështi inoks, mbajtëse shamposh, gërshërë kuzhine, mixer kuzhine Cuisinart) me vlerë 135.57 Dollar. Në të specifikohet se 11 artikuj ishin vlerësuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit, por mungonte gjurma e relacionit dhe vlerësimit të komisionit. Gjithashtu kartela e inventarëve ishte pa ekstremitete
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p>Për shkak të ndjeshmërisë së lartë që kjo pjesë ka, nga ana e secilës përfaqësi diplomatike dhe konsullore të merren masa për mirëmenaxhimin e aseteve pronë e shtetit dhe kryerjen e procesit të rregullt të inventarizimit të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i MEPJ-së në bashkëpunim me titullarët e përfaqësive të marrin masa të menjëherëshme të kryejnë

	<p>procesin e inventarizimit të aktiveve dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të merren masa të menjëhershme për të kryer evidentim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do te procedohet ne vijim, etj. - Të merren masa për aktivet që janë për dalje jashtë përdorimit të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar <i>procesin e vlerësimit të aktiveve</i> të propozuara për dalje nga përdorimi; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. - Të merren masa për të shmangur kryerjen e shpenzimeve për motive personale me paratë publike dhe përfshirjen e tyre në inventarët e njësisë;
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë

Konstatim: Për përfaqësinë Berlin, nga auditimi u konstatua se, procesi inventarizimit nuk rezulton të jetë kryer për vitin 2020, procedura e ndjekur mbulon periudhën deri në shkurt/mars të vitit 2020.

Konstatim: Për përfaqësinë Mynih, nga auditimi u konstatua se, praktika e vendosur në dispozicion kishte bashkangjitur 5 procesverbale, me datë 05.01.2020 por këto të dhëna rezultojnë për vitin 2019 i cili nuk përfshihet në periudhën tonë të auditimit. *Për vitin 2020 mungon inventari i zyrave dhe apartamenteve të banimit të Konsullatës në Mynih.*

V. Shpenzime udhëtimi për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda dhe jashtë shtetit pranues si dhe drejt shtetit dërgues, të zyrtarit të misionit ose stafit administrativ dhe teknik, paguhen nga buxheti i misionit diplomatik dhe konsullor dhe trajtohen si shpenzime operacionale. Duke patur parasysh se, mbulohen edhe shpenzimet e fjetjes dhe ushqimit.

Nga auditimi me zgjedhje, që iu bë praktikave në lidhje me përfitimin e dietave në rastet e udhëtimeve, në zbatimin e VKM-së nr 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, u konstatua se,

23. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës rregullatore lidhur me shpenzimet e transportit publik të stafit të Misionit diplomatik dhe konsullor për vajtje – ardhjet në punë (rasti Neë york) si dhe përdorimit të taksive.
- Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së argumentimit të nevojës për kryerje të udhëtimit, si dhe më tej mungesë e gjurmës së kërkimit/miratimit të kryerjes së udhëtimit (përfshijmish përfaqësia Podgoricë)

Shpenzimet e udhëtimit, për përfaqësitë e përzgjedhura për vitin 2021 në total ishin në vlerën 38,715.11 Euro dhe 50,740.82 Dollar.

Viti 2021

23.1 Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Mynih, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se,

- Në të gjitha rastet lëvizjet janë pa destinacion të përcaktuar, pa arsye të lëvizjes (ato që janë jashtë qytetit pa një agend/protokoll apo document tjetër justifikues), pa përcaktuar personin që po udhëton.

23.2 Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Athinë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se,

- Për shpenzime udhëtimi tunizi/kredencialet me vlerë totale 2,509.08/1,263.91 Euro rezulton mbuluar me dokumentacion justifikues vetëm vlera prej 978.09 Euro për tunizi kredencialet, diferenca prej 2,509.08 Euro për shpenzime udhëtimi dhe 285.82 Euro rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues.

23.3 Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë BE - Bruksel, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se,

- Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se në 18 Urdhër Pagesa, vetëm 3 ishin të nënshkuara nga personi i ngarkuar me financën dhe vetëm në 2 raste ishte përcaktuar vlera për tu paguar;
- Sa i takon faturës me vlerë 607.31 Euro, rezulton prania e dokumentacionit justifikues vetëm për pagesën e parkimit prej 6.40 Euro dhe diferenca prej 600.91 Euro rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues;
- Sa i takon pagesës prej 395.48 Euro mungon fatura, nga auditimi nuk konstatohet gjurmë e agendës së veprimtarisë apo argumentim i vizitës (aneks);
- Sa i takon pagesës prej 81.88 Euro mungon fatura, ka gjurmë rezervimi në booking i cili është fotokopje e pjesshme(aneks);

Viti 2020

23.4 Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Berlin, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

- Në të gjitha rastet praktikat dokumentare e shpenzimeve të udhëtimit me vlerë totale prej 3,895.02 Euro, ishin pjesore, pa agend apo memo shoqëruese/argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë personi me qëllim verifikimin e lëvizjes.

23.5 Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Londër, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, shpenzimet e udhëtimit janë kryer për 4 procedura ku:

- 3 nga të cilat rezultojnë të paplota, udhëtimi për në Shqipëri nuk ka dokumentacion justifikues mbështetës për transaksionet financiare, mungon gjurma justifikuese e ngjarjes për vlerën e paguar prej 343.66 Paund Britanik (bileta);

- Vlera për riprerje të biletës për shkak të anulimit të fluturimeve për arsye Covid 19 prej 501.66 Paund Britanik nuk ka dokumentacion justifikues mbështetës për transaksionet financiare, mungon gjurma justifikuese e ngjarjes për vlerën e paguar (bileta);
- Pagesa prej 227.16 Paund Britanik për shpenzime diete në Irland nuk ka gjurmë dokumentare, praktika justifikuese mban informacion vetëm për dy fatura për taxi me vlerë 124.95 Euro;
- Vlera totale rezulton 1,331.25 Paund Britanik e pambështetur në dokumentacion justifikues.

23.6 Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Madrid, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

- Me Mandat Pagesë nr.16 datë 05.11.2020 janë paguar shpenzime udhëtimi dhe diete për Ambasadorin me vlerë 80.15 Euro, (aktivitet në Galicia);

Për dy pagesa të tjera me vlerë totale 225.01 Euro praktika dokumentare e mangët si më poshtë vijon:

1. Fletë shërbimi-udhëtimi për titullarin e përfaqësisë shërbim në Barcelonë, vlera totale e dietës 50 Euro dhe fatura ehotelit 125.01 Euro.
 - Praktika dokumentare pjesore, pa agend apo memo shoqëruese argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë me qëllim verifikimin e lëvizjes;
 - Pa nxjerrje të urdhër pagesës për procedim të mëtejshëm të transaksioneve financiare
2. Fletë shërbimi – udhëtimi për titullarin e përfaqësisë shërbim në Santiago de Compostela, vlera totale e dietës 50.
 - Praktika dokumentare pjesore, pa agend apo memo shoqëruese argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë me qëllim verifikimin e lëvizjes;
 - Pa nxjerrje të urdhër pagesës për procedim të mëtejshëm të transaksioneve financiare
 - Për pagesën e udhëimit Madrid Tiranë me vlerë 80 Euro dhe fjetjen në hotel .H Hotels me vlerë 325.34 Euro mungon gjurma e argumentimit të nevojës së lëvizjes.

Titulli i Gjetjes 23:	Shpenzime udhëtimi për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua mungesë e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjurmës rregullatore lidhur me shpenzimet e transportit publik të stafit të Misionit diplomatik dhe konsullor për vajtje – ardhjet në punë (rasti New York) si dhe përdorimit të taksive. - Gjurmës së argumentimit të nevojës për kryerje të udhëimit, si dhe më tej mungesë e gjurmës së kërkimit/miratimit të kryerjes së udhëimit (përfshirë përfaqësitë Podgoricë) <p>2021</p> <ul style="list-style-type: none"> -Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Mynih, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se, në të gjitha rastet lëvizjet janë pa destinacion të përcaktuar, pa arsye të lëvizjes (ato që janë jashtë qytetit pa një agend/protokoll apo document tjetër justifikues), pa përcaktuar personin që po udhëton; - Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Athinë, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se, për shpenzime udhëtimi tunizi/kredencialet me vlerë totale 2,509.08/1,263.91 Euro rezulton mbuluar me dokumentacion justifikues vetëm vlera prej 978.09 Europër tunizi kredencialet,

	<p>diferenca prej 2,509.08 Euro për shpenzime udhëtimi dhe 285.82 Euro rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues;</p> <p>-Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë BE - Bruksel, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se, nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se në 18 Urdhër Pagesa, vetëm 3 ishin të nënshkruara nga personi i ngarkuar me financën dhe vetëm në 2 raste ishte përcaktuar vlera për tu paguar;</p> <p>- Sa i takon faturës me vlerë 607.31 Euro, rezulton prania e dokumentacionit justifikues vetëm për pagesën e parkimit prej 6.40 Euro dhe diferenca prej 600.91 Euro rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues;</p> <p>Sa i takon pagesës prej 395.48 Euro mungon fatura, nga auditimi nuk konstatohet gjurmë e agendës së veprimtarisë apo argumentim i vizitës; (trajtuar në aneks tek viti 2021);</p> <p>- Sa i takon pagesës prej 81.88 Euro mungon fatura, ka gjurmë rezervimi në booking i cili është fotokopje e pjeshme (trajtuar në aneks tek viti 2021);</p> <p>2020</p> <p>-Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Berlin, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, në të gjitha rastet praktikat dokumentare e shpenzimeve të udhëtimit me vlerë totale prej 3,895.02 Euro, ishin pjesore, pa agend apo memo shoqëruese/argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë personi me qëllim verifikimin e lëvizjes.</p> <p>- Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Londër, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, shpenzimet e udhëtimit janë kryer për 4 procedura ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>3 nga të cilat rezultojnë të paplota, udhëtimi i Ambasadorit për në Shqipëri nuk ka dokumentacion justifikues mbështetës për transaksionet financiare, mungon gjurma justifikuese e ngjarjes për vlerën e paguar prej 343.66 Paund Britanik (bileta);</i> - <i>Vlera për riprerje të biletës për shkak të anulimit të fluturimeve për arsye Covid 19 prej 501.66 Paund Britanik nuk ka dokumentacion justifikues mbështetës për transaksionet financiare, mungon gjurma justifikuese e ngjarjes për vlerën e paguar (bileta);</i> - <i>Pagesa prej 227.16 Paund Britanik për shpenzime diete në Irland nuk ka gjurmë dokumentare, praktika justifikuese mban informacion vetëm për dy fatura për taxi me vlerë 124.95 Euro;</i> - <i>Vlera totale rezulton 1,331.25 Paund Britanik e pambështetur në dokumentacion justifikues.</i> <p>-Sa i takon zëri 'shpenzime udhëtimi' për përfaqësinë Madrid, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,</p>
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Me Mandat Pagesë nr.16 datë 05.11.2020 janë paguar shpenzime udhëtimi dhe diete për Ambasadorin me vlerë 80.15 Euro, (aktivitet në Galicia); • Për dy pagesa të tjera me vlerë totale 225.01 Euro praktika dokumentare e mangët si më poshtë vijon: • Fletë shërbimi-udhëtimi për titullarin e përfaqësisë shërbim në Barcelonë, vlera totale e dietës 50 Euro dhe fatura e hotelit 125.01 Euro. • Praktika dokumentare pjesore, pa agend apo memo shoqëruese argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë me qëllim verifikimin e lëvizjes; • Pa nxjerrje të urdhër pagesës për procedim të mëtejshëm të transaksioneve financiare • Fletë shërbimi – udhëtimi për titullarin e përfaqësisë shërbim në Santiago de Compostela, vlera totale e dietës 50. • Praktika dokumentare pjesore, pa agend apo memo shoqëruese argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë me qëllim verifikimin e lëvizjes; • Pa nxjerrje të urdhër pagesës për procedim të mëtejshëm të transaksioneve financiare; • Për pagesën e udhëtimimit Madrid Tiranë me vlerë 80 Euro dhe fjetjen në hotel .H Hotels me vlerë 325.34 Euro mungon gjurma e argumentimit të nevojës së lëvizjes.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p>Të merren masa për hartimin e gjurmës rregullatore lidhur me shpenzimet e transportit publik si dhe përdorimit të taksive, nga ana e stafit të misioneve diplomatik dhe konsullore;</p> <p>Të merren masa për hartimin e gjurmës së plotë të argumentimit dhe miratimit lidhur me nevojën për kryerje të udhëtimeve;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësia Mynih, të marr masa për plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve; - Përfaqësinë Athinë, të marr masa për verifikim të vlerës prej 2,509.08 Euro dhe 285.82 Euro për shpenzime udhëtimi e cila rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues, si dhe

	<p>plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësia BE - Bruksel, të marr masa për plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve si dhe verifikim të vlerës prej 600.91 Euro, e cila rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues; - Përfaqësia Berlin, të marr masa për plotësim të praktikave dokumentare; - Përfaqësia Londër, të marr masa për verifikim të vlerës totale prej 1,331.25 Paund Britanik e pambështetur në dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues. - Përfaqësia Madrid, të marr masa për verifikim të vlerës prej 710.5 Euro si dhe plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

VI. Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të kryera nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për vitin 2021

Për vitin 2021 shpenzimet e mirëmbajtjes së përfaqësive ishin në vlerën 44,471 Euro dhe 59,766 Dollar dhe për vitin 2020 ishin në vlerën 54,551 Euro dhe 38,372 Dollar.

Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi për vitin 2020

Konstatim: Nga auditimi u konstatua:

- Mungesë e gjurmës së një baze rregullore për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes apo mënyrën se si do të kryhet kjo praktikë (nëpërmjet kontraktimit të një kompanie apo një personi fizik)
- Mungesë e gjurmës së propozimit të një kostoje mujore mirëmbajtje dhe riparimi, referuar nevojave dhe specifikave të punëve Brenda misioneve respektive në përputhje me parimin e 3E- ve, efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Përfaqësitë diplomatike për shkak të specifikës së tyre janë përjashtuar nga procedurat e ligjit për prokurimin publik cituar në nenin 7 pika 1 gërma i e ligjit nr. 162/2020 .

Në këto kushte procedura e prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve nuk ka një kornizë procedurale të përcaktuar.

Referuar Urdhrit nr. 79, date 28.03.2023 MEPJ është në proces të zhvillimit të praktikës rregullore për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes nga ana e përfaqësive diplomatike.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, por është i njëjti me atë të paraqitur në projekt raport me shkresën nr.8650/3 datë 23.05.2023 argumentimi i dhënë në observacion nuk kundërshton gjetjen por ngelet për tu verifikuar rast pas rasti.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion lidhur me shpenzimet operative dhe të tjera operative u konstatua se,

1. Pekin:

Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	Dollar
<i>Evidenca</i>	
1. Pajisje zyresh	18.6
2. Zyrë përfaqësie	1.695.11
<i>Dokumentacioni justifikues</i>	
1. Shërbimi pastrimit të oborrit për 12 muaj	1,441.44
2. Pemë për oborrin e Ambasadës	22.52
3. Material të ndryshme mirëmbajtje	63.26
4. Pjesë këmbimi për riparimin e makinës korrëse të barit	87.12
5. Riparuar brava e derës së drurit	8.26
6. Material për riparim të dritave të jashtme	34.83
7. Material pastrimi	27.03
8. Thikë për makinën korrëse të barit	31.53
9. Riparuar dera	22.52
<i>Total</i>	1,735.60
	1,714

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Nga auditimi dokumentacionit justifikues rezultoj se,

- *Fatura për pagesën e 800 Yan (RMB) në muaj/12 muaj, për pastrimin e ambienteve të jashtme të Ambasadës (nga 30 janar-përmbante parregullsi. Kjo faturë i referohej shkresës së miratimit nga Ministria e Financave me 09.09.1999. Për muajin janar-shkurt specifikohet pagesa për muajin Nëntor 2020, për muajin tetor dhe dhjetor specifikohet pagesa për muajin Gusht 2021*
- *Pagesa e riparimit të bravës së derës së drurit, 55 RMB gjendej bashkangjitur në urdhër pagesën nr.1 datë 08.07.2021 si një nga 4 zërat e saj, fatura bashkangjitur ishte në gjuhën kineze.*
- *Pagesa e blerjes së pemëve për oborrin e ambasadës, 75 RMB gjendej bashkangjitur në urdhër pagesën nr.5 datë 06.04.2021 dhe blerja e dytë 75 RMB në urdhër pagesën nr.5 datë 30.03.2021*
- *Pagesa e riparimit të derës kryesore të Ambasadës 150 RMB gjendej bashkangjitur në urdhër pagesën nr.4 nëntor 2021, si një nga 5 zërat e saj, fatura bashkangjitur ishte në gjuhën kineze.*

- *Pagesa e blerjes së thikës për makinën korrëse të barit dhe material të ndryshme pastrimi 390 RMB gjendej bashkangjitur në urdhër pagesën nr.8 shtator 2021, fatura bashkangjitur ishte në gjuhën kineze dhe e palexueshme për shkak të bojës.*
- *Pagesa e blerjes së materialeve për mirëmbajtje, 417.50 RMB faturat bashkangjitur në gjuhën kineze, pa ekstremitete 3 nga 4 faturat.*
- *Pagesa e blerjes dhe instalimit të pjesëve të këmbimit të makinës korrëse 575 RMB gjenden bashkangjitur në urdhër pagesën nr.2 datë 23.04.2021 si dy nga 3 zërat e saj, fatura bashkangjitur ishte në gjuhën kineze.*
- *Pagesa e blerjes së materialeve për riparimin e dritave 232 RMB fatura bashkangjitur në gjuhën kineze.*

Total 11,569.5 RMB konvertuar në kursin e dhënë prej përfaqësisë (6.66) në 1,735.60 Dollar, raportuar në MEPJ në 1,713.71 Dollar.

Përfaqësia Paris

Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi për vitin 2021

24. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dokumentacionit justifikues mbi mirëmbajtjen e zakonshme rezulton se,

- Diferenca prej 45.84 Euro e pajustificuar me dokumentacion mbështetës.
- Pagesa për mirëmbajtje softëare prej 99 Euro, është kryer pa faturë tatimore bashkangjitur, por
- është faturë e nxjerr nga Microsoft Account/Older History.
- Ku me shkrim dore “pagesë për mirëmbajtje soft kompjuterik ii rrjetit të PC të Ambasadës”

Përfaqësia Mynih

24.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme u konstatuan:

- 25 raste të larjes së automjetit të përfaqësisë, ku intensiteti më i lartë është në muajin mars, 5 raste brenda 29 ditëve, totali shpenzimeve për larje automjeti është 291.6 Euro;
- 17 raste për pastrim dhe mirëmbajtje të ambienteve të konsullatës ku pagesa është fikse prej 50 Euro/hera, totali 850 Euro;
- 1 rast pagesa e postës 5.85 Euro;

Diferenca 19.9 Euro pa dokumentacion justifikues.

Përfaqësia Berlin

24.2 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

- Me Vërtetim shpenzimi nr.20 datë 18.02.2021 është paguar diferenca për rritje qiraje garazhi me vlerë 257.46 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi nr.10 datë 05.03.2021 është paguar shpenzim për evadim mbeturinash me vlerë 2,900 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 08.04.2021 është paguar shpenzim për riparim aparati printer HP, me vlerë 127.99 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);

- Me Vërtetim shpenzimi nr.20 datë 19.04.2021 është paguar shpenzim komuniale viti 2020, banesa am Zirkus 5, 10117 Berlin me vlerë 323.77 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi nr.21 datë 19.04.2021 është paguar riparim i lavamanit të kuzhinës në katin e 5 të përfaqësisë me vlerë 437.18 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 30.04.2021 është paguar shpenzim për riparim të ekranit të tabletit në përdorim të titullarit, me vlerë 584.80 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 05.07.2021 është paguar shpenzim për riparim të sistemit të ujit të ngrohtë në kuzhinën e katit të pestë të përfaqësië ku u ndërrua dhe bolieri ujit të nxehtë, me vlerë 488.27 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 26.07.2021 është paguar shpenzim për riparim të lavatrics Tip Bosch, me vlerë 286 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);

Totali i shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme, referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton të jetë 5,405.47 Euro. Sa më sipër i jemi referuar vetëm vlerave dhe urdhër pagesave të cilat janë të hartuara në shqip, dokumentacioni justifikues nuk është audituar për shkak të gjuhës.

Përfaqësia Romë

24.3 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se, totali shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme për përfaqësinë Romë rezultonte në 5,202.96 Euro, dhe mungonte gjurma e dokumentacionit justifikues për shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme për pajisje zyrash.

Përfaqësia Athinë rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues.

Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi për vitin 2020

Përfaqësia Londër

24.4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi shpenzimet e mirëmbajtjes u konstatua se,

- Nga ana e përfaqësisë janë kryer 3 blerje për qëllime mirëmbajtje të përfaqësisë me vlerë totale 626.26 Paund Britanik;
- Në 2 nga 3 rastet mungonte gjurma e fletë hyrjes në magazinë;
- Mungonte urdhër i titullarit për kryerjen e shërbimit.

Përfaqësia Vjenë

24.5 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi shpenzimet e mirëmbajtjes u konstatua se, për 5 raste pagesash lidhur me këtë zë

- Në të gjithë rastet mungojnë urdhër pagesat;
- Në 3 raste rezulton prania e vetëm faturave, me vlerë totale prej 218.57 Euro, nuk ka as procesverbal as urdhër pagesë;

- Në total rezultoj një diferencë 50 Euro raportuar më tepër nga ana e përfaqësisë.

Titulli i Gjetjes 24:	Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të kryera nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore
Situata:	<p>Përfaqësia Paris</p> <p>Nga auditimi dokumentacionit justifikues mbi mirëmbajtjen e zakonshme rezulton se,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diferenca prej 45.84 Euro e pajustificuar me dokumentacion mbështetës. • Pagesa për mirëmbajtje softëare prej 99 Euro, është kryer pa faturë tatimore bashkangjitur, por është faturë e nxjerr nga Microsoft Account/Older History. Ku me shkrim dore “pagesë për mirëmbajtje soft kompjuterik i rrjetit të PC të Ambasadës” <p>Përfaqësia Mynih.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme u konstatuan:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 25 raste të larjes së automjetit të përfaqësisë, ku intensiteti më i lartë është në muajin mars, 5 raste brenda 29 ditëve, totali shpenzimeve për larje automjeti është 291.6 Euro; • 17 raste për pastrim dhe mirëmbajtje të ambienteve të konsullatës ku pagesa është fikse prej 50 Euro/hera, totali 850 Euro; • 1 rast pagesa e postës 5.85 Euro; • Diferenca 19.9 Euro pa dokumentacion justifikues. <p>Përfaqësia Berlin</p> <p>Nga auditimi u konstatua se,</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi nr.20 datë 18.02.2021 është paguar diferenca për rritje qiraje garazhi me vlerë 257.46 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi nr.10 datë 05.03.2021 është paguar shpenzim për evadim mbeturinash me vlerë 2,900 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi datë 08.04.2021 është paguar shpenzim për riparim aparati printer HP, me vlerë 127.99 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi nr.20 datë 19.04.2021 është paguar shpenzim komuniale viti 2020, banesa am Zirkus 5, 10117 Berlin me vlerë 323.77 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi nr.21 datë 19.04.2021 është paguar riparim i lavamanit të kuzhinës në katin e 5 të përfaqësisë me vlerë 437.18 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi datë 30.04.2021 është paguar shpenzim për riparim të ekranit të tabletit në përdorim të titullarit, me vlerë 584.80 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <p>Me Vërtetim shpenzimi datë 05.07.2021 është paguar shpenzim për riparim të sistemit të ujit të ngrohtë në kuzhinën e katit të pestë të</p>

	<p>përfaqësië ku u ndërrua dhe bolieri ujit të nxehtë, me vlerë 488.27 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht); Me Vërtetim shpenzimi datë 26.07.2021 është paguar shpenzim për riparim të lavatrics Tip Bosch, me vlerë 286 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Totali i shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme, referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton të jetë 5,405.47 Euro. Sa më sipër i jemi referuar vetëm vlerave dhe urdhër pagesave të cilat janë të hartuara në shqip, dokumentacioni justifikues nuk është audituar për shkak të gjuhës. <p>Përfaqësia Romë Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se, totali shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme për përfaqësinë Romë rezultonte në 5,202.96 Euro, dhe mungonte gjurma e dokumentacionit justifikues për shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme për pajisje zyrash prej 461.32 Euro. <i>Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi për vitin 2020</i></p> <p>Përfaqësia Londër Nga auditimi mbi shpenzimet e mirëmbajtjes u konstatua se, Nga ana e përfaqësisë janë kryer 3 blerje për qëllime mirëmbajtje të përfaqësisë me vlerë totale 626.26 Paund Britanik; Në 2 nga 3 rastet mungonte gjurma e fletë hyrjes në magazinë; Mungonte urdhër i titullarit për kryerjen e shërbimit</p> <p>Përfaqësia Vjenë Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi shpenzimet e mirëmbajtjes u konstatua se, për 5 raste pagesash lidhur me këtë zë Në të gjithë rastet mungojnë urdhër pagesat; Në 3 raste rezulton prania e vetëm faturave, me vlerë totale prej 218.57 Euro, nuk ka as procesverbal as urdhër pagesë; Në total rezultoj një diferencë 50 Euro raportuar më tepër nga ana e përfaqësisë.</p> <p>Përfaqësia Athinë për vitin 2021 rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.

Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësia Paris të marr masa për verifikim të vlerës prej 144.84 Euro, e pa mbështetur në dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues. - Përfaqësia Mynih të marr masa për verifikim të vlerës prej 19.9 Euro, e pa mbështetur në dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Përfaqësia Berlin të marr masa për mbajtje të dokumentacionit në përputhje me kriteret e specifikuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, ...me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, në përputhje me rregullat në fuqi dhe që ka lidhje me ushtrimin e një funksioni publik; - Përfaqësia Romë të marr masa për verifikim të vlerës prej 461.32 Euro, e pa mbështetur në dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Përfaqësia Londër të marr masa për plotësim të praktikave dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm; - Përfaqësia Vjenë të marr masa për plotësim të praktikave dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023, me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Përfaqësitë diplomatike për shkak të specifikës së tyre janë përjashtuar nga procedurat e ligjit për prokurimin publik, cituar në nenin 7, pika 1, gërma i e ligjit nr.162/2020. Në kto kushte procedura e prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve nuk ka një kornizë procedurale të përcaktuar.

Referuar Urdhrit nr.79 datë 28.03.2023, MEPJ është në proces të zhvillimit të praktikës rregullatore për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe procedurave të prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve nga ana e përfaqësive diplomatike. Në këto kushte materialet e dërguara me anë të postës elektronike, për arsye teknike mund të kenë mangësi dhe probleme me skanimet apo printimet.

Gjithashtu theksojmë faktin se, në kushtet e pandemisë botërore COVID 19 aktiviteti i përfaqësive është zhvilluar kryesisht sipas sistemit on line në përmbushje të masave shtrënguese të aplikuara nga shtetet respektive. Referuar rekomandimit Tuaj, MEPJ do tu kërkojë përfaqësive të verifikojnë vlerat e detajuara në gjetje, të plotësojnë dhe të administrojnë në mënyrë të rregullt dokumentacionin justifikues të pagesave në përmbushje të ligjit nr.8503

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Grupi auditimit duke mbajtur në çdo moment në konsideratë natyrën specifike të institucionit që auditon si dhe mënyrënsesi ligjvënësi shprehet për çdo çështje lidhur me këtë institucion, patjetër e ka mbajtur në konsideratë mënyrën sesi ligji për prokurimin publik flet dhe interpretohet për MEPJ-në.

Megjithatë, në gjetjet e mësipërme nuk është trajtuar mënyra e prokurimit, po problematika lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të kryera nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, referuar dokumentacionit justifikues mështetës rast pas rasti. Në mungesë të paraqitjes së fakteve të reja apo dokumentacionit të ri justifikues vijojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

VII. Sa i takon investimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, kryhen në trajtën e blerjeve dhe jo si procedura prokurimi

Duke qenë se, legjislacioni i prokurimit publik është i zbatueshëm vetëm për territorin shqiptar, si dhe legjislacioni ka dhënë mundësi këtyre përfaqësive që të realizojnë procedurat e prokurimit duke mos iu përmbajtur legjislacionit të prokurimit publik. Konkretisht neni 7, pika 1, gërma i , e ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku shprehimisht ligjvënësi shprehet:
Ligji për prokurimin publik nuk zbatohet për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve për nevoja të përfaqësive diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë, jashtë vendit....

Në këto kushte, sa i takon procedurave të prokurimit publik për nevoja të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, ato realizohen nga vetë përfaqësitë.

Nga auditimi u konstatua se, në tërësinë e vetë përfaqësitë kryejnë procedura blerje me vlera të vogla për përmbushje të nevojave të tyre dhe operim të vazhdueshëm.

Mënyra e operimit mund të përmbliidhet në hapat e mëposhtme:

1. Ngritje të komisionit për blerje për cdo vit me urdhër të Titullarit;
2. Urdhër i titullarit për prokurimin dhe nxjerrja e fondit limit;
3. Hartimi i procesverbalit të komisionit për testimin e tregut dhe marrja e ofertës me vlerë më të vogël;
4. Marrja e miratimit për kryerjen e blerjes nga MEPJ.

Nga auditimi për rastet e blerjeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore u konstatua se,

- Për vitin 2020 në 18% të rasteve nuk janë ngritur komisionet për blerjet me vlera të vogla, ku për vitin 2021 vetëm në 1 rast nuk është ngritur ky komision;
- Për vitin 2020 në 45% të rasteve mungon fletë hyrja në magazine, raport i cili në 2021 ka rënë në 36%;
- Për vitin 2020 në 27 % të rasteve nuk është kryer analizë tregu, raport i cili në 2021 ka rënë në 18%;
- Për vitin 2020 në 45% të rasteve nuk është urdhër i titullarit për prokurimin dhe nxjerrja e fondit limit, raport i cili në 2021 ka rënë në vetëm një rast.

Detajuar në vijim:

Përfaqësia Milano

Për vitin 2021 janë kryer blerje, referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 1,995.08 Euro detajuar në blerje për pajisje zyre.

25. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi procedurat e blerjeve u konstatua se,

- ✓ Për rastin e Urdhër Pagesë nr.112 dhe Urdhër Pagesë nr.315/2 mungon ftesa për ofertë e cila duhet ti drejtohet operatorëve ekonomikë, dhe ku të jenë përcaktuar të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit. Dokument i cili (ftesa) duhet ti bashkangjitet udhërit të prokurimit. Operuar në kundërshtim me pikën 3, paragrafi 2 të nenit 40, procedura e prokurimit me vlerë të vogël.

Përfaqësia Madrid

✓ 2020

Për vitin 2020 nga ana e përfaqësisë Madrid janë kryer investime në vlerë totale prej 1,543 Euro, në nënzërin 'pajisje zyrash'.

25.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e përfaqësisë Madrid lidhur me blerjet problematikat janë si më poshtë vijon:

- Praktika dokumentare e blerjeve rezultonte e mangët, ku në 66% të rasteve të blerjeve (2 nga 3 të tilla) mungonin faturat e artikujve të blerë apo shërbimeve të marra me vlerë totale prej 903.34 Euro;
- Nga auditimi i dokumentacionit justifikues u konstatua se, referuar urdhër pagesave totali i inventimeve rezultonte në 1,506.97 Euro, mbështetur në dokumentacionin justifikues nga 1,543 Euro raportuar në evidencë me një diferencë të pajustificuar me dokumentacion mbështetës prej 36.03 Euro.
- Për blerjen e artikullit fotokopje mungonte kryerja e analizës së tregut (marrja e 3 ofertave).
- Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së fletë hyrjes në magazinë të artikullit;

✓ 2021

Nga auditimi mbi investimet e përfaqësisë Madrid u konstatua se, artikujt e blerë me vlerë 597 Euro, shoqëroheshin me praktikë dokumentare të mangët si më poshtë vijon:

- Mungonte testimi i tregut për maus dhe program soft;
- Mungonte fletë hyrja në magazinë;

Përfaqësia Paris

✓ 2020

Përfaqësia Paris investimet për vitin 2020 i ka kryer në trajtën e blerjeve dhe janë realizuar 8 të tilla ku vlera totale referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion rezulton të jetë 2,345 Euro e detajuar në 1,147 Euro për pajisje zyre dhe 1,199 Euro për pajisje apartamenti.

25.2 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se:

- Në 7 nga 8 rastet Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes dhe komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla ka qenë me 2 anëtar (T.T dhe A.C) në kundërshtim me VKM, neni 56, pika 3 e tij e cila specifikon se *Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar*

prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.

- Mungesë e gjurmës së nxjerrjes së urdhrin të përcaktimit të komisionit të prokurimit;
- Në 7 nga 8 rastet nuk ka gjurmë të kryerjes së testimit të tregut;
- Në 1 rast nuk është përcaktuar fondi i vendosur në dispozicion.

Përfaqësia Mynih

✓ 2020

Nga auditimi lidhur me investimet në Konsullatën e Përgjithshme të RSh në Mynih u konstatua se, për vlerën totale prej 1,690 Euro e cila përfaqësonte blerje artikujsh për pajisje për zyra dhe referuar urdhër pagesës konkretisht janë artikujt laptop dhe aparat kafeje.

Nga auditimi i praktikës rezultoj se mungonte:

- Marrja e miratimit nga ana e MEPJ për kryerjen e blerjes;
- Gjurma e ngritjes së komisionit për blerjet me vlera të vogla;
- Gjurma e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim

✓ 2021

Nga auditimi lidhur me investimet në Konsullatën e Përgjithshme të RSh në Mynih u konstatua se, për vlerën totale prej 415.80 Euro e cila përfaqësonte blerje artikujsh për apartamente banimi mungonin gjurmët e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim.

Përfaqësia Berlin

✓ 2020

Për vitin 2020 janë kryer 7 blerje, referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 2,585 Euro detajuar në 2,317 Euro për pajisje zyre dhe 268 Euro për pajisje apartamenti.

25.3 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

1. Në të gjithë rastet Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes (I.D, E.G dhe K.N) është i njëjtë me atë të përcaktuar në Urdhrin e Brendshëm për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nr.4 index J, dt 07.01.2020;
2. Mungon gjurma e kryerjes së testimit të tregut;
3. Nga auditimi u konstatua se, komisioni i prokurimeve ishte me 2 anëtar dhe një i shtuar me shkrim dore.

✓ 2021

Për vitin 2021 janë kryer 6 blerje, referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 2,477.9 Euro detajuar në 1,405.8 Euro për pajisje zyre dhe 1,072.1 Euro për pajisje apartamenti.

25.4 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

1. Mungon gjurma e kryerjes së testimit të tregut;
2. Referuar faturave u konstatua se totali shpenzimeve rezultonte në 2,545.7 Euro.

Përfaqësia BE Bruksel

✓ 2020

Për vitin 2020 janë kryer blerje, referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 1,468 Euro detajuar në blerje për pajisje zyre.

- Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së ngritjes së komisionit për blerje të vogla;
 - Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së fletë hyrjes në magazinë të artikullit;
- ✓ **2021**

Për vitin 2021 janë kryer blerje, referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 898.99 Euro detajuar në blerje për pajisje zyre.

Nga auditimi u konstatua mungesë se,

- Mungonte gjurma e fletë hyrjes në magazinë të artikullit;

mbi procedurat e blerjeve:

- Nuk i është dërguar kërkesë, informacion MEPJ dhe as është kërkuar dhe marr miratimi prej Ministrisë.

Përfaqësia Ëashington

✓ **2020**

Për vitin 2021 janë kryer 5 blerje, referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 1,969 Dollar, ku detajuar në 1,787 Dollar blerje për pajisje zyre dhe 182 Dollar për pajisje apartamenti.

25.5 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

- Në të gjithë rastet mungonin gjurmët e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim;
- Mungonte gjurma e kryerjes së testimit të tregut;
- Referuar dokumentacionit justifikues totali vlerës së investimeve rezultonte në 1,596.57 Dollar, nga 1,969 Dollar të raportuara në evidencë, me nje diferencë prej 372.43 Dollar më tepër raportuar;
- Për urdhër prokurimin nr.20/07 blerje artikulli me vlerë 149 Dollar mungonte prania e gjurmës së faturës (elektronike apo fiskale);
- Për urdhër prokurimin nr.20/08 u konstatua pagesa e disa faturave, me praktikë të mangët pa dokumentacion justifikues mbështetës si më poshtë vijon:
 - Tavolinë kompiuteri e vogël Home Goods me vlerë 39.99 \$
 - Tavolinë kompiuteri Home Depot me vlerë 29.15 \$Me vlerë totale prej 69.14 Dollar;
- Për urdhër prokurimin nr.20/06 u konstatua mungesë e
 - ✓ gjurmës së faturave për të gjithë artikujt e blerë ku vlera totale shkon 628.44 Dollar
 - ✓ proçesverbali prokurimit me vlerë të vogël ishte me praninë e dy firmave në kundërshtim me neni 56, pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “*për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

✓ **2021**

Nga auditimi lidhur me investimet në Ambasadën e RSh në Ëashington: u konstatua se, për vlerën totale prej 415.80 Dollar e cila përfaqësonte blerje artikujsh për apatamente banimi mungonin gjurmët e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim.

Sa i takon proçedurës së prokurimit për blerje me vlerë të vogël u konstatua se:

- Komisioni i blerjes është i përbërë nga 2 anëtar;
- Mungon gjurma e testimit të tregut dhe marrja e disa ofertave përpara vendosjes së asaj fituese;

- Sa i takon blerjes, për kompletin e servisit disponohet gjurma e porositjes online të tij, me vlerë totale 802.95 Dollar; për 2 kompletet lugë dhe pirunj nuk disponohet gjurmë e porosisë së tyre apo fatyrë blerje e tyre, vlera 274.78 Dollar;
- Për blerjet e mësipërme mungojnë faturat shoqëruese të blerjeve, për rrjedhojë mungojnë fletë hyrjet në magazinë.
- Bazuar në evidencat shkresore të vendosura në dispozicion, për vitin 2021 rezulton se, janë kryer investime, të pasqyruara në “pajisje apartamenti”, por vlera e pasqyruar në formatet e shpenzimeve nisur në MEPJ nuk korrespondon me atë të pasqyruar në kartelën shoqëruese të inventarëve.

Dollar

Nr.	Artikulli	Vlera në USD
1.	Lugë dhe pirunj për 16 persona	274.78
2.	Qilim dhe shtresë mbajtëse	508.79
3.	Pjata për 16 persona	802.95
	Total	1,586.52

- Nga auditimi u konstatua se, referuar kartelës shoqëruese të inventarëve, sipas blerjeve të kryera me Urdhër Prokurimi nr.21/11 datë 05.11.2021 rezulton se vlera është 1,032.28 Dollar, ndërkohë në formatin e shpenzimeve rezulton 783.57 Dollar, me një diferencë prej 248.71 Dollar.

Përfaqësia Athinë

✓ 2021

Për vitin 2021 janë kryer 9 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 4,777.79 Euro dhe referuar faturave janë 4,856.6 Euro.

25.6 Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi u konstatua se, sa i takon specifikimeve teknike të produkteve të blera, nuk arrijmë dot të kryejmë verifikime pasi janë në gjuhën greke. Po ashtu çdo lloj fature dhe dokumentacioni shoqërues të veprimeve të mësipërme janë në gjuhën greke, duke operuar sa më sipër në kundërshtim të plotë me pikën 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, e cila ka parashikuar:*Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.*
- Nga auditimi u konstatua se, nuk ka specifikim se cili person i ka marr në ngarkim e as fletë inventari për blerjet e mësipërme;
- Në 4 raste nga 6 total të blerjeve, u konstatua se testimi i tregut për ofertat nuk përmbante ekstremitetet e dokumentit zyrtar (fletë formati me shkrim dore, pa emrat e anëtarëve të komisionit dhe pa firma);
- Në 2 raste u konstata se ofera ishte identike e njëjtë, testimi tregut dhe ofertat e paraqitura për njësinë qendrore (urdhër pagesa nr.10 datë 19.01.2021) janë të njëjta me ato të pasqyruara për blerjen me urdhër pagesë nr.6 datë 11.01.2021 (ekran kompiuteri);
- Me procesverbalin datë 24.05.2021 komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka përcaktuar si fitues operatorin “k.” me çmimin total 1,060.50 Euro, por në faturë dhe fletë hyrje në magazinë vlera totale është 1000.90 Euro;
- Nga auditimi i praktikës “blerje fshesë korrenti” u konstatua se, operatori i tretë i cituar në procesverbal “p.g” nuk ka gjurmë oferte në dokumentacion;

- Nga prakika rezultoj gjurmë për ofertën “M.” 360 Euro, por jo për ofertën e shpallur fituese “M.’289 Euro.

Përfaqësia Romë

✓ **2020**

Për vitin 2020 janë kryer 2 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 10,301.40 Euro ku 1,583.51 Euro për pajisje zyre dhe 8,717.89 Euro për pajisje apartamenti

25.7 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, është plotësuar me shkrim dore pjesa e përshkrimit të artikullit/produktit/veprimit dhe vlera ekonomike etyre;
- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes (J.Sh, T.K dhe A.P) është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit nr.4 dt 09.12.2020 (T.K, A.B dhe A.M) dhe atë nr.3 , datë 11.09.2020 (F.F, J.Sh dhe E.C).
- Shkresa e njoftimit për blerje nga ana e përfaqësisë dhe ajo me marrjes së miratimit nga ana e MEPJ-së është e njëjta në të dy rastet, konkretisht nr.10383 indexi j datë 04.08.2020 shkresa miratuese dhe nr.195 datë 20.12.2019 shkresa e kërkesës nga ana e përfaqësisë, fondi total vendosur në dispozicion është 1,560 Euro i së njëjtës shkresë miratuese nga ana e MEPJ, totali vlerës së blerjeve 1,563.62 Euro;

✓ **2021**

Për vitin 2021 janë kryer 6 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 10,301.40 Euro ku 1,583.51 Euro për pajisje zyre dhe 8,717.89 Euro për pajisje apartamenti,

25.7.1 Gjetje nga auditimi:

- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, është plotësuar me shkrim dore pjesa e përshkrimit të artikullit/produktit/veprimit dhe vlera ekonomike etyre;
- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes (J.Sh, T.K dhe A.P) është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit nr.4 dt 06.02.2021(T.K, J.A dhe A.M);
- Blerja e pajisjeve të akomodimit të apartamentit të Ambasadores, me vlerë 2,320 Euro është mbështetur në praktikë dokumentare të mangët, është operuar pa kryer testim të tregut (marrja e minimumit të 3 ofertave për të operuar me përzgjedhjen e asaj që ofron çmimin më të ulët) si dhe praktika përmban vetëm faturën dhe marrjen e miratimit prej MEPJ-së;
- Blerja e pajisjeve të akomodimit të apartamentit 22, referuar Urdhër Pagesë nr.240 datë 28.12.2021 ishte me vlerë 2,080 Euro referuar faturave shoqëruese të veprimeve rezulton totali prej 1,785.36 Euro, diferencë e pajustificuar me dokumentacion mbështetës prej 294.65 Euro.

Përfaqësia Londër

✓ **2020**

Për vitin 2020 janë kryer 3 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 4,238 Euro për pajisje zyre.

25.8 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi praktikës së blerjes referuar urdhër pagesës nr.20/6 datë 16.12.2020 me vlerë totale 269.99 Euro, rezultoj se:

- Mungon gjurma e kryerjes së testimit të tregut (marrja e 3 ofertave);
- Faturat për të gjithë artikujt;
- Mungonte gjurma e nxjerrjes së urdhrit të prokurimit;
- Procesverbali ishte me praninë e dy firmave;
- Nga auditimi u konstatua se investimet e përfaqësisë janë në trajtën e blerjeve, 8 blerje të paflektuara si shtesa në inventar.

✓ **2021**

Për vitin 2021 janë kryer 6 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 15,898.75 Euro ku 1,583.51 Euro për pajisje zyre.

25.8.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e blerjeve u konstatua se:

1. Sa i takon përllogaritjes së fondit limit ku në përllogaritjen e të cilit autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave, nuk ka gjurmë auditi se si është operuar.
2. Për secilin rast mungon ftesa për ofertë e cila duhet ti drejtohet operatorëve ekonomikë, dhe ku të jenë përcaktuar të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit. Dokument i cili (ftesa) duhet ti bashkangjitet udhërit të prokurimit. Operuar kështu në kundërshtim me pikën 3, paragrafi 2 të nenit 40, procedura e prokurimit me vlerë të vogël.
3. Sa i takon operimit në kushte emergjente, u konstatuan 2 raste të trajtuara si të tilla, me mungesë specifikimi të nevojave të situatës që kanë cuar në këtë zgjedhje.

Sa i takon blerjeve u konstatua se:

- për punimet e banakut dhe xhamit (3 copë), pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.2 mungonte në dokumentacion gjurma e ofertës së përzgjedhur fituese;

mungonte fatura tatimore, (u konstatua prania e invoice që ngjasonte me një situacion punimesh dhe nuk përmbante ekstremitetet e faturës tatimore);

- për shpenzimet për kaldajën e Ambasadës në katin e parë dhe kaldajën në katin e tretë pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.3

mungonte fatura tatimore, (u konstatua prania e invoice që ngjasonte me një situacion punimesh dhe nuk përmbante ekstremitetet e faturës tatimore

- për blerje të karrigeve statike dhe mbajtëse celulari pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.4,

kishte mungesë të gjurmës së ofertave nga të 3 kompanitë për të operuar më tej me vlerësimin e ofertës së përzgjedhur, si dhe mungesë e faturës tatimore për blerjen, ishte e pranishme "payment information" në të cilën specifikohet: This is not a VAN invoice;

- për shpenzimet për blerje të bravave të reja për të gjithë dyert e Ambasadës, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.5,

mungesë e gjurmës së ofertave nga të 3 kompanitë për të operuar më tej me ofertën e përzgjedhur;

- për shpenzimet për montim dhe përshtatje të bravave të reja për të gjithë dyert e Ambasadës, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.6,

mungesë e gjurmës së ofertave nga të 3 kompanitë për të operuar më tej me ofertën e përzgjedhur, mungesë e faturës tatimore mbi shërbimin e kryer;

- për shpenzimet për mirëmbajtje të zyrave të konsullatës, tualeteve të prishura, tubacioneve të konsumuara, ventilatorëve dhe punëtori, *trajtuar si blerje emergjente*

mungesë të faturës tatimore për shërbimin;

- për shpenzimet për rregullim, montim dhe zëvendësim të kamerave të sigurisë, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.17, *trajtuar si blerje emergjente,*

mungesë të faturës tatimore për shërbimin;

- për shpenzimet për blerje kompjutera Lenovo 2 copë, karrige 2 copë, mbajtëse tavoline për kompiuter 1 copë, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.37,

u konstatua në fletë hyrjen nr.12 një mospërputhje sa i takon tavolinës standing desk, në të dhënat e vendosura në dispozicion nuk evidentohet e qartë gjurma e kërimit të ofertës.

Përmbledhje:

1. Sa i takon fondeve të investimeve, referuar evidencave të vendosura në dispozicion u konstatua se,

- së pari në mbështetje të faturave të disponuara totali i shpenzimeve për investim është 12,455 £ për pajisje zyre nga 13,825 £ të pasqyruara në tabelat e dërguara në MEPJ,

së dyti, nga ana e përfaqësisë u konstatua se në pasqyrën e shpenzimeve të Ambasadës Londër, nuk pasqyroheshin shpenzimet për investime të bëra nga zyra konsullore. *Kjo me motivacionin se, pasyrohen më vete në Konsullatën Londër. ndërkohë kjo zyrë është pjesë integrale e Ambasadës Londër.*

Përfaqësia New york

✓ **2020**

Për vitin 2020 janë kryer 7 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 2,209.86 Euro për pajisje zyre.

25.9 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dokumentacionit justifikues lidhur me investimet e përfaqësisë N.York u konstatua se:

- Në 86 % të rasteve rastet (6 nga 7 të tilla) mungon gjurma e urdhrit të titullarit për ngritjen e komisionit të prokurimit;
- Mungon gjurma e dërgimit të kërkesës dhe marrja e miratimit nga MEPJ;
- Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes është i njëjti me komisionin e prokurimit;

Në 2 raste procedura e testimit të tregut është fictive dhe jo e besueshme pasi data e kryerjes së testimit është pas datës së hartimit të proç esverbalit të blerjes.

Shënim: Në rastin e përfaqësisë N.Y hasim problematikën e kriptimit të të dhënave (shpjeguar më gjerësisht në shënimin në fillim të trajtimit të pasqyrave të konsoliduara)

Titulli i Gjetjes 25:	Sa i takon investimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, kryhen në trajtën e blerjeve dhe jo si procedura prokurimi
------------------------------	---

<p>Situata:</p>	<p><i>Përfaqësia Milano</i> Nga auditimi mbi procedurat e blerjeve u konstatua se, Për rastin e Urdhër Pagesë nr.112 dhe Urdhër Pagesë nr.315/2 mungon ftesa për ofertë e cila duhet ti drejtohet operatorëve ekonomikë, dhe ku të jenë përcaktuar të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit. Dokument i cili (ftesa) duhet ti bashkangjitet udhërit të prokurimit.</p> <p><i>Përfaqësia Madrid</i> Për vitin 2020 praktika dokumentare e blerjeve rezultonte e mangët, ku në 66% të rasteve të blerjeve (2 nga 3 të tilla) mungonin faturat e artikujve të blerë apo shërbimeve të marra me vlerë totale prej 903.34 Euro; Nga auditimi i dokumentacionit justifikues u konstatua se, referuar urdhër pagesave totali i investimeve rezultonte në 1,506.97 Euro, mbështetur në dokumentacionin justifikues nga 1,543 Euro raportuar në evidencë me një diferencë të pajustificuar me dokumentacion mbështetës prej 36.03 Euro. Për blerjen e artikullit fotokopje mungonte kryerja e analizës së tregut (marrja e 3 ofertave). Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së fletë hyrjes në magazinë të artikullit;</p> <p><u><i>Për vitin 2021</i></u> Nga auditimi mbi investimet e përfaqësisë Madrid u konstatua se, artikujt e blerë me vlerë 597 Euro, shoqëroheshin me praktikë dokumentare të mangët si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungonte testimi i tregut për maus dhe program soft; - Mungonte fletë hyrja në magazinë; <p><i>Përfaqësia Paris</i> Në 7 nga 8 rastet Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes dhe komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla ka qenë me 2 anëtar (T.T dhe A.C); Mungesë e gjurmës së nxjerrjes së urdhrit të përcaktimit të komisionit të prokurimit; Në 7 nga 8 rastet nuk ka gjurmë të kryerjes së testimit të tregut; Në 1 rast nuk është përcaktuar fondi i vendosur në dispozicion.</p> <p><i>Përfaqësia Mynih</i> Nga auditimi i praktikës rezultoi se mungonte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrja e miratimit nga ana e MEPJ për kryerjen e blerjes; - Gjurma e ngritjes së komisionit për blerjet me vlera të vogla; - Gjurma e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim <p>Nga auditimi lidhur me investimet në Konsullatën e Përgjithshme të RSh në Mynih për vitin 2021 u konstatua se, për vlerën totale prej 415.80 Euro e cila përfaqësonte blerje artikujsh për apatamente banimi mungonin gjurmët e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim.</p> <p><i>Përfaqësia Berlin</i> Për vitin 2020 nga auditimi u konstatua se, në të gjithë rastet Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes (I.D, E.G dhe K.N) është i njëjtë me</p>
------------------------	---

atë të përcaktuar në Urdhrin e Brendshëm për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nr.4 index J, dt 07.01.2020;

Mungon gjurma e kryerjes së testimit të tregut;

Nga auditimi u konstatua se, komisioni i prokurimeve ishte me 2 anëtar dhe një i shtuar me shkrim dore.

Për vitin 2021 nga auditimi u konstatua se,

- Mungon gjurma e kryerjes së testimit të tregut;

Përfaqësia BE Bruksel

Për vitin 2020 nga auditimi u konstatua:

- mungesë e gjurmës së ngritjes së komisionit për blerje të vogla;
- mungesë e gjurmës së fletë hyrjes në magazinë të artikullit;

Për vitin 2021 nga auditimi u konstatua:

- mungesë e gjurmës së fletë hyrjes në magazinë të artikullit;
- nuk i është dërguar kërkesë/informacion MEPJ dhe as është kërkuar dhe marr miratimi prej kësaj të fundit.

Përfaqësia Washington

Për vitin 2021 nga auditimi u konstatua se,

- në të gjithë rastet mungonin gjurmët e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim;
- mungonte gjurma e kryerjes së testimit të tregut;

Referuar dokumentacionit justifikues totali vlerës së investimeve rezultonte në 1,596.57 Dollar, nga 1,969 Dollar të raportuara në evidencë, me një diferencë prej 372.43 Dollar më tepër raportuar;

- Për urdhër prokurimin nr.20/07 blerje artikulli me vlerë 149 Dollar mungonte prania e gjurmës së faturës (elektronike apo fiskale);
- Për urdhër prokurimin nr.20/08 u konstatua pagesa e disa faturave, me praktikë të mangët pa dokumentacion justifikues mbështetës;
- Për urdhër prokurimin nr.20/06 u konstatua mungesë e gjurmës së faturave për të gjithë artikujt e blerë ku vlera totale shkon 628.44 Dollar, procesverbali prokurimit me vlerë të vogël ishte me praninë e dy firmave në kundërshtim me e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 56, pika 3

Nga auditimi lidhur me investimet në Ambasadën e RSh në Washington: u konstatua se, për vlerën totale prej 415.80 Dollar e cila përfaqësonte blerje artikujsh për apatamente banimi mungonin gjurmët e fletë hyrjeve në magazinë dhe marrjes së artikujve në dorëzim.

Sa i takon procedurës së prokurimit për blerje me vlerë të vogël u konstatua se:

- Komisioni i blerjes është i përbërë nga 2 anëtar;
- Mungon gjurma e testimit të tregut dhe marrja e disa ofertave përpara vendosjes së asaj fituese;
- Sa i takon blerjes, për kompletin e servisit disponohet gjurma e porositjes online të tij, por mungojnë faturat shoqëruese të blerjeve, për rrjedhojë mungojnë fletë-hyrjet në magazinë.

Nga auditimi u konstatua se, referuar kartelës shoqëruese të inventarëve, sipas blerjeve të kryera me Urdhër Prokurimi nr.21/11 datë 05.11.2021 rezulton një diferencë prej 248.71 Dollar.

Përfaqësia Athinë

Për vitin 2021 nga auditimi u konstatua se,

- sa i takon specifikimeve teknike të produkteve të blera, nuk arrijmë dot të kryejmë verifikime pasi janë në gjuhën greke.
- Po ashtu çdo lloj fature dhe dokumentacioni shoqërues të veprimeve të mësipërme janë në gjuhën greke, duke operuar sa më sipër në kundërshtim të plotë me pikën 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”;
- Nga auditimi u konstatua se, nuk ka specifikim se cili person i ka marr në ngarkim e as fletë inventari për blerjet e mësipërme;
- Në 4 raste nga 6 total të blerjeve, u konstatua se testimi i tregut për ofertat nuk përmbante ekstremitetet e dokumentit zyrtar (fletë formati me shkrim dore, pa emrat e anëtarëve të komisionit dhe pa firma);
- Në 2 raste u konstata se ofera ishte identike e njëjtë, testimi tregut dhe ofertat e paraqitura për njësinë qendrore (urdhër pagesa nr.10 datë 19.01.2021) janë të njëjta me ato të pasqyruara për blerjen me urdhër pagesë nr.6 datë 11.01.2021 (ekran kompjuteri);
- Me procesverbalin datë 24.05.2021 komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka përcaktuar si fitues operatorin “k.” me çmimin total 1,060.50 Euro, por në faturë dhe fletë hyrje në magazinë vlera totale është 1000.90 Euro;
- Nga auditimi i praktikës “blerje fshesë korrenti” u konstatua se, operatori i tretë i cituar në procesverbal “p.g” nuk ka gjurmë oferte në dokumentacion;
- Nga prakika rezultoj gjurmë për ofertën “M.” 360 Euro, por jo për ofertën e shpallur fituese “M.’ 289 Euro.

Përfaqësia Romë

Për vitin 2020 nga auditimi u konstatua se,

- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, është plotësuar me shkrim dore pjesa e përshkrimit të artikullit/produktit/veprimit dhe vlera ekonomike e tyre;
- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes (J.Sh, T.K dhe A.P) është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit nr.4 dt 09.12.2020 (T.K, A.B dhe A.M) dhe atë nr.3 , datë 11.09.2020 (F.F, J.Sh dhe E.C).
- Shkresa e njoftimit për blerje nga ana e përfaqësisë dhe ajo me marrjes së miratimit nga ana e MEPJ-së është e njëjta në të dy rastet, konkretisht nr.10383 indexi j datë 04.08.2020 shkresa miratuese dhe nr.195 datë 20.12.2019 shkresa e kërkesës nga ana e përfaqësisë,

fondi total vendosur në dispozicion është 1,560 Euro i së njëjtës shkresë miratuese nga ana e MEPJ, totali vlerës së blerjeve 1,563.62 Euro;

Për vitin 2021 nga auditimi u konstatua se:

- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, është plotësuar me shkrim dore pjesa e përshkrimit të artikullit/produktit/veprimit dhe vlera ekonomike etyre;
- Në të gjithë rastet ku procesverbali blerjes është i pranishëm, komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes (J.Sh, T.K dhe A.P) është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit nr.4 dt 06.02.2021(T.K, J.A dhe A.M);
- Blerja e pajisjeve të akomodimit të apartamentit të Ambasadores, me vlerë 2,320 Euro është mbështetur në praktikë dokumentare të mangët, është operuar pa kryer testim të tregut (marrja e minimumit të 3 ofertave për të operuar me përzgjedhjen e asaj që ofron çmimin më të ulët) si dhe praktika përmban vetëm faturën dhe marrjen e miratimit prej MEPJ-së;
- Blerja e pajisjeve të akomodimit të apartamentit 22, referuar Urdhër Pagesë nr.240 datë 28.12.2021 ishte me vlerë 2,080 Euro referuar faturave shoqëruese të veprimeve rezulton totali prej 1,785.36 Euro, diferencë e pajustificuar me dokumentacion mbështetës prej 294.65 Euro.

Përfaqësia Londër

Për vitin 2020 nga auditimi praktikës së blerjes referuar urdhër pagesës nr.20/6 datë 16.12.2020 me vlerë totale 269.99 Euro, rezultoj se:

- Mungon gjurma e kryerjes së testimit të tregut (marrja e 3 ofertave);
- Faturat për të gjithë artikujt;
- Mungonte gjurma e nxjerrjes së urdhrit të prokurimit;
- Procesverbali ishte me praninë e dy firmave;
- Nga auditimi u konstatua se investimet e përfaqësisë janë në trajtën e blerjeve, 8 blerje të paflektuara si shtesa në inventar.

Për vitin 2021 nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e blerjeve u konstatua se:

- Sa i takon përllogaritjes së fondit limit ku në përllogaritjen e të cilit autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave, nuk ka gjurmë auditi se si është operuar.
- Për secilin rast mungon ftesa për ofertë e cila duhet ti drejtohet operatorëve ekonomikë, dhe ku të jenë përcaktuar të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.
- Sa i takon operimit në kushte emergjente, u konstatuan 2 raste të trajtuara si të tilla, me mungesë specifikimi të nevojave të situatës që kanë cuar në këtë zgjedhje.

Sa i takon blerjeve u konstatua se:

për punimet e banakut dhe xhamit (3 copë), pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.2

- mungonte në dokumentacion gjurma e ofertës së përzgjedhur fituese;
- mungonte fatura tatimore, (u konstatua prania e invoice që ngjasonte me një situacion punimesh dhe nuk përmbante ekstremitetet e faturës tatimore);

për shpenzimet për kaldajën e Ambasadës në katin e parë dhe kaldajën në katin e tretë pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.3

- mungonte fatura tatimore, (u konstatua prania e invoice që ngjasonte me një situacion punimesh dhe nuk përmbante ekstremitetet e faturës tatimore
- për blerje të karrigeve statike dhe mbajtëse celulari pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.4,
- kishte mungesë të gjurmës së ofertave nga të 3 kompanitë për të operuar më tej me vlerësimin e ofertës së përzgjedhur, si dhe mungesë e faturës tatimore për blerjen, ishte e pranishme ‘payment information’ në të cilën specifikohet: This is not a VAN invoice;

për shpenzimet për blerje të bravave të reja për të gjithë dyert e Ambasadës, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.5,

- mungesë e gjurmës së ofertave nga të 3 kompanitë për të operuar më tej me ofertën e përzgjedhur;

për shpenzimet për montim dhe përshtatje të bravave të reja për të gjithë dyert e Ambasadës, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.6,

- mungesë e gjurmës së ofertave nga të 3 kompanitë për të operuar më tej me ofertën e përzgjedhur, mungesë e faturës tatimore mbi shërbimin e kryer;
- për shpenzimet për mirëmbajtje të zyrave të konsullatës, tualeteve të prishura, tubacioneve të konsumuara, ventilatorëve dhe puntori, trajtuar si blerje emergjente;
- mungesë të faturës tatimore për shërbimin;

për shpenzimet për rregullim, montim dhe zëvendësim të kamerave të sigurisë, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.17, trajtuar si blerje emergjente,

- mungesë të faturës tatimore për shërbimin;

për shpenzimet për blerje kompiutera Lenovo 2 copë, karrige 2 copë, mbajtëse tavoline për kompiuter 1 copë, pasqyruar blerja në urdhër pagesën nr.37,

- u konstatua në fletë hyrjen nr.12 një mospërputhje sa i takon tavolinës standing desk, në të dhënat e vendosura në dispozicion nuk evidentohet e qartë gjurma e kërkimit të ofertës.

Sa i takon fondeve të investimeve, referuar evidencave të vendosura në dispozicion u konstatua se,

së pari në mbështetje të faturave të disponuara totali i shpenzimeve për investim është 12,455 £ për pajisje zyre nga 13,825 £ të pasqyruara në tabelat e dërguara në MEPJ,

së dyti, nga ana e përfaqësisë u konstatua se në pasqyrën e shpenzimeve të Ambasadës Londër, nuk pasqyroheshin shpenzimet për investime të bëra

	<p>nga zyra konsullore, ndërkohë kjo zyrë është pjesë integrale e Ambasadës Londër.</p> <p><i>(Trajtuar më hollësisht në ANEKS I, faqe 66-83, të Projekt Raportit të Auditimit).</i></p> <p><i>Përfaqësia New york</i></p> <p>✓ 2020</p> <p>Për vitin 2020 janë kryer 7 blerje të cilat referuar evidencave të shpenzimeve vendosur në dispozicion me vlerë totale 2,209.86 Euro për pajisje zyre.</p> <p>Nga auditimi dokumentacionit justifikues lidhur me investimet e përfaqësisë N.York u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në 86 % të rasteve rastet (6 nga 7 të tilla) mungon gjurma e urdhrit të titullarit për ngritjen e komisionit të prokurimit; - Mungon gjurma e dërgimit të kërkesës dhe marrja e miratimit nga MEPJ; - Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes është i njëjti me komisionin e prokurimit; <p>Në 2 raste procedura e testimit të tregut është fictive dhe jo e besueshme pasi data e kryerjes së testimit është pas datës së hartimit të procesverbalit të blerjes.</p> <p><i>Shënim: Në rastin e përfaqësisë N.Y hasim problematikën e kriptimit të të dhënave (shpjeguar më gjerësisht në shënimin në fillim të trajtimit të pasqyrave të konsoliduara)</i></p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i asetëve të institucionit
Shkaku:	Problematic në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> ✓ <i>Përfaqësia Milano</i> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës; ✓ <i>Përfaqësia Madrid</i> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana përfaqësisë të merren masa për të operuar duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës problematika mbartur prej vitit 2021;

- Të marr masa për verifikim të vlerës prej 903.34 Euro dhe 36.03 Euro mbartur prej 2020 pa dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

✓ *Përfaqësia Paris*

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës.

✓ *Përfaqësia Mynih*

Nga ana e MEPJ-së në bashkëpunim me përfaqësinë të merren masa për të verifikuar vlerën prej 415.80 Euro si dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës.

✓ *Përfaqësia Berlin*

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës.

✓ *Përfaqësia BE Bruksel*

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës.

✓ *Përfaqësia Ëashington*

Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës.

- Të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 1,565.67 Dollar, të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës

Përfaqësia Athinë

- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës; problematika mbartur prej vitit 2021.

	<p>- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur dokumentacionet justifikues në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, me pikën 9, neni 4.</p> <p>- të merren masa për kryerjen e veprimeve rregulluese lidhur me diferencën e vlerave mes procesverbalit të datës 24.05.2021 dhe asaj në faturë dhe fletë hyrje në magazinë;</p> <p>✓ <i>Përfaqësia Romë</i></p> <p>Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës;</p> <p>- të merren masa për verifikimin e vlerës prej 2,614.65 Euro</p> <p>✓ <i>Përfaqësia Londër</i></p> <p>Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejten e Informimit për Dokumentet Zyrtare”) neni 2 b, si dhe të plotësoj praktikat dokumentare me të gjithë elementët përkatës;</p> <p>- Të merren masa për të operuar në mbështetje të legjislacionit në fuqi, ku në të gjitha rastet, autoriteti duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij. (në rastet e mësipërme neglizhenca e AK ka rolin kryesorë);</p> <p>- Të merren masa për të verifikuar vlerën prej 1,370 £ e ardhur si rrjedhojë e diferencës mes vlerës së faturave të dhe evidencës përmbledhëse, si dhe , si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.</p> <p>- Të merren masa për të unifikuar formatet dhe konsoliduar veprimtarinë e përfaqësisë në të njëjtën evidencë përmbledhëse;</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Problematika përmbledhëse referuar auditimit të evidencave justifikuese të shpenzimeve si më poshtë vijojnë:

26. Gjetje nga auditimi

1. Referuar evidencave vjetore të fundit (viti 2021) të kryer nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se,

- Në përfaqësinë New york,
 - Në evidencat e vitit 2021 u konstatua pagesa e 29,041.35 Dollar për broker fees, por mungonte gjurma justifikuese e tyre. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10 germa ç e VKM nr.20 datë 18.01.2017);

- Vlera prej 2,952 Dollar, paguar për qëndrimin në Hotel K. të grupit të auditit të MEPJ nuk ka faturë bashkangjitur (prania vetëm e Urdhër Pagesës);
- U konstatua në total një pagesë prej 13,209 Dollar, pagesë për qëndrim në hotel në kuadër të përgatitjes së kandidimit për Këshill Sigurie 20.07-31.08 dhe më tej qëndrim gjatë periudhës së kërkimit të apartamentit të tij të banimit;
- Pagesa prej 2,104.55 Dollar pasqyron biletën e avionit dhe shtesë në të, për udhëtim në Nice (Francë) ku mungon agenda dhe programi i veprimtarisë. Nga auditimi dokumentacionit të lëvizjes rezulton të jetë udhëtim personal, bashkangjitur praktika e lëvizjes:
 - 25.07 Nisja Nee york datë 25.07 ora 06:44
Mbërritja Paris datë 26.07 ora 05:15
 - 26.07 Nisja Paris
Mbërritja Figari – Sud Corse (France)
 - 01.08 Nisja Figari
Mbërritja Nice
- Në përfaqësinë BE-Bruksel,
 - Referuar faturave të vendosura në dispozicion “kafe pune Ambasadores” rezultonte në vlerën 20.10 Euro dhe sipas përshkrimit të faturës ishte mëngjesi për një person (personale);
 - Pagesa për hotel me vlerë 395.48 Euro, nuk ka gjurmë të pranisë së dokumentit justifikues (faturë hoteli), si dhe nga auditimi nuk konstatohet prania e gjurmës së agendës së veprimtarisë apo argumentim i vizitës;
 - Pagesa për hotel me vlerë 81.88 Euro, nuk ka gjurmë të pranisë së dokumentit justifikues (faturë hoteli), bashkangjitur është rezervimi në booking i cili është fotokopje e pjesshme;
 - Nga 51 urdhër pagesa të audituara, 35 ishin pa vlerë të specifikuar dhe vetëm 16 me vlerë ekonomike të specifikuar për tu paguar;
 - Për blerjen në Aeroportin “Nënë Tereza” faturat me vlerë 2,800 all dhe 3,675 all rezultonin pa përshkrim të produkteve të blera;
 - Në pagesën me vlerë 310.96 Euro, për blerje produkte ushqimore për pritje të doktorëve në Mision, fatura bashkangjitur lëshuar nga “D.” është e pjesshme, nuk ka datë, përmban vetëm vlerën totale prej 310.96 Euro dhe artikujt e pjesës së faturës fotokopjuar bashkangjitur janë vetëm 11 copë me vlerë 39 Euro.
- Në përfaqësinë Milano,
 - Për biletën me vlerë 99.98 Euro prerë për iteneralin Budapest – Milano nuk ka informacion se për cilin person është prerë kjo biletë;
 - Pagesa 134 Euro nuk arrin të identifikohet produkti apo shërbimi i marr;
 - Pagesa 947.63 Euro nuk arrin të identifikohet se për cilin është paguar pasi nuk ka emër personi për të cilin kryhet;
 - Për biletat e avionit, fatura me vlerë 28.846 all për iteneralin Tiranë Bergamo, nuk është e shoqëruar me një argumentim të personave që po udhëtojnë dhe arsyet e ushëtimit.
 - Në rastet e pagesave të bëra në monedhën “lekë/ all” mungon informacion në lidhje me kursin e këmbimit të monedhës së përdorur për konvertim në Euro për efekt të hedhjes së të dhënave financiare në formatet e evidencave.

- Për biletat e avionit, fatura me vlerë 79 Euro për iteneralin Milano - Tiranë, nuk është e shoqëruar me një argumentim të personave që po udhëtojnë dhe arsyet e ushëtimit;
- Pagesa e faturës prej 192.8 Euro total, për iteneralin Milano-Santiago-Milano nuk ka një argumentim të arsyes së lëvizjes si dhe të pozicionit/statusit të personit që po kryen këtë udhëtim.
- Në përfaqësinë Athinë,
 - Nga auditimi rezultoj se, shpenzimet imobiliare janë kryer për apartamentin e përfaqësuesit diplomatik në vlerën 1,488 Euro.
 - Fatura dhe dokumentacioni mbështetës ishin në greqisht duke mos patur asnjë dublikatë në gjuhën shqipe.
 - Kryerja e procesit të gjetjes së ambientit të banimit nëpërmjet një zyre imobiliare është në kundërshtim me bazën ligjore rregullative, e cila ngarkon me përgjegjësi MEPJ për kryerjen e analizës së tregut dhe gjetjen e ambienteve të përshtatshme për përfaqësuesit. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10 gërma ç e VKM nr.20 datë 18.01.2017). Nga ana tjetër nuk rezultojn të ketë gjurmë të lajmërimit të MEPJ për këtë veprimtari.
- Në përfaqësinë Romë,
 - Lidhur me pagesën 435 Euro hotel nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, mungon fatura e hotelit;
 - Lidhur me pagesën 386.60 Euro transferim u konstatuan mungesë e dokumentacionit justifikues të nevojës së kryerjes së këtij udhëtimi;
 - Referuar listës së përbërjes së përfaqësive vendosur në dispozicion nga DBNj e MEPJ, rezultojn se personi në fjalë gjatë periudhës ka qenë emëruar në Romë dhe hoteli është po prap në Romë.
 - Lidhur me pagesën 2,648.50 Euro mungon argumentimi arsyes së udhëtimit. Referuar VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 9 gërma c) dhe lidhja 1 “masa e dietës në valutë të huaj sipas kategorive” rezultojn se i përket kategorisë 7 ku hoteli është deri me 3 yje dhe jo 4 sikundër është paguar.
- Në përfaqësinë Londër
 - Lidhur me pagesën 910 GBP mungon gjurma e faturave elektronike (pa statement të pagesës) vetëm me praninë e një emaili për vlerën e pagueshme;
 - Në përfaqësinë Washington
 - Lidhur me pagesën 669.13 USD për të njëjtin shërbim janë mbajtur dy urdhër shërbime të plotësuar ndryshe, me datat dhe hotelin njësoj 18.11-20.11.2021;
- Në përfaqësinë Podgoricë
 - Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk është lehtësisht i identifikueshëm dhe i kuptueshëm. Nga ana e përfaqësuesit është operuar duke vendosur faturat (të cilat janë për total shpeznimi dhe jo detajuar zërat) mbi procesverbale dhe fotokopjuar mbi njëra tjetrën duke e bërë të pamundur kuptueshmërinë e informacionit që përmban.

Titulli i Gjetjes 26:

Problematika përmbledhëse referuar auditimit të evidencave justifikuese të shpenzimeve si më poshtë vijnë:

Situata:

1. Referuar evidencave vjetore të fundit (viti 2021) të kryer nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se,

Në përfaqësinë New york,

- Në evidencat e vitit 2021 u konstatua pagesa e 29,041.35 Dollar për broker fees, por mungonte gjurma justifikuese e tyre. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10 gërma ç e VKM nr.20 datë 18.01.2017);
- Vlera prej 2,952 Dollar, paguar për qëndrimin në Hotel K. të grupit të auditit të MEPJ nuk ka faturë bashkangjitur (prania vetëm e Urdhër Pagesës);
- U konstatua në total një pagesë prej 13,209 Dollar, pagesë për qëndrim në hotel në kuadër të përgatitjes së kandidimit për Këshill Sigurie 20.07-31.08 dhe më tej qëndrim gjatë periudhës së kërkimit të apartamentit të tij të banimit.
- Pagesa prej 2,104.55 Dollar pasqyron biletën e avionit dhe shtesë në të, për udhëtim në Nice (Francë) ku mungon agenda dhe programi i veprimtarisë. Nga auditimi dokumentacionit të lëvizjes rezulton të jetë udhëtim personal, bashkangjitur praktika e lëvizjes:

25.07 Nisja New york datë 25.07 ora 06:44

Mbërritja Paris datë 26.07 ora 05:15

26.07 Nisja Paris

Mbërritja Figari – Sud Corse (France)

01.08 Nisja Figari

Mbërritja Nice

Në përfaqësinë BE-Bruksel,

- Referuar faturave të vendosura në dispozicion “kafe pune Ambasadores” rezultonte në vlerën 20.10 Euro dhe sipas përshkrimit të faturës ishte mëngjesi për një person (personale);
- Pagesa për hotel me vlerë 395.48 Euro, nuk ka gjurmë të pranisë së dokumentit justifikues (faturë hoteli), si dhe nga auditimi nuk konstatohet prania e gjurmës së agendës së veprimtarisë apo argumentim i vizitës;
- Pagesa për hotel me vlerë 81.88 Euro, nuk ka gjurmë të pranisë së dokumentit justifikues (faturë hoteli), bashkangjitur është rezervimi në booking i cili është fotokopje e pjesshme;
- Nga 51 urdhër pagesa të audituara, 35 ishin pa vlerë të specifikuar dhe vetëm 16 me vlerë ekonomike të specifikuar për tu paguar;
- Për blerjen në Aeroportin “Nënë Tereza” faturat me vlerë 2,800 all dhe 3,675 all rezultonin pa përshkrim të produkteve të blera;

- Në pagesën me vlerë 310.96 Euro, për blerje produkte ushqimore për pritje të doktorëve në Mision, fatura bashkangjitur lëshuar nga “D.” është e pjeshme, nuk ka datë, përmban vetëm vlerën totale prej 310.96 Euro dhe artikujt e pjesës së faturës fotokopjuar bashkangjitur janë vetëm 11 copë me vlerë 39 Euro.

Në përfaqësinë Milano,

- Për biletën me vlerë 99.98 Euro prerë për iteneralin Budapest – Milano nuk ka informacion se për cilin person është prerë kjo biletë;
- Pagesa 134 Euro nuk arrin të identifikohet produkti apo shërbimi i marr;
- Pagesa 947.63 Euro nuk arrin të identifikohet se për cilin është paguar pasi nuk ka emër personi për të cilin kryhet;
- Për biletat e avionit, fatura me vlerë 28.846 all për iteneralin Tiranë Bergamo, nuk është e shoqëruar me një argumentim të personave që po udhëtojnë dhe arsyet e ushëtimit.
- Për biletat e avionit, fatura me vlerë 79 Euro për iteneralin Milano - Tiranë, nuk është e shoqëruar me një argumentim të personave që po udhëtojnë dhe arsyet e ushëtimit;
- Në rastet e pagesave të bëra në monedhën “lekë/ all” mungon informacion në lidhje me kursin e këmbimit të monedhës së përdorur për konvertim në Euro për efekt të hedhjes së të dhënave financiare në formatet e evidencave.
- Pagesa e faturës prej 192.8 Euro total, për iteneralin Milano-Santiago-Milano nuk ka një argumentim të arsyes së lëvizjes si dhe të pozicionit/statusit të personit që po kryen këtë udhëtim.
- Në rastet e pagesave të bëra në monedhën “lekë/ all” mungon informacion në lidhje me kursin e këmbimit të monedhës së përdorur për konvertim në Euro për efekt të hedhjes së të dhënave financiare në formatet e evidencave;

Në përfaqësinë Athinë,

- Nga auditimi rezultoj se, shpenzimet imobiliare janë kryer për apartamentin e përfaqësuesit diplomatik në vlerën 1,488 Euro.
- Fatura dhe dokumentacioni mbështetës ishin në greqisht duke mos patur asnjë dublikatë në gjuhën shqipe.
- Kryerja e procesit të gjetjes së ambientit të banimit nëpërmjet një zyre imobiliare është në kundërshtim me bazën ligjore rregullative, e cila ngarkon me përgjegjësi MEPJ për kryerjen e analizës së tregut dhe gjetjen e ambienteve të përshtatshme për përfaqësuesit. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të

	<p>pasurive të paluajtshme (pika 10 gërma ç e VKM nr.20 datë 18.01.2017). Nga ana tjetër nuk rezultojn të ketë gjurmë të lajmërimit të MEPJ për këtë veprimtari.</p> <p><i>Në përfaqësinë Romë,</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhur me pagesën 435 Euro hotel nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, mungon fatura e hotelit; - Lidhur me pagesën 386.60 Euro transferim për Sh.Sh u konstatuan mungesë e dokumentacionit justifikues të nevojës së kryerjes së këtij udhëtimi; - Referuar listës së përbërjes së përfaqësive vendosur në dispozicion nga DBNj e MEPJ, rezultojn se personi në fjalë gjatë periudhës ka qenë emëruar në Romë dhe hoteli është po prapë në Romë. - Lidhur me pagesën 386.60 Euro mungon dokumentacioni justifikues i nevojës së kryerjes së këtij udhëtimi; - Lidhur me pagesën 2,648.50 Euro mungon argumentimi arsyes së udhëtimit; <p>Referuar VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 9 gërma c) dhe lidhja 1 “masa e dietës në valutë të huaj sipas kategorive” rezultojn se i përket kategorisë 7 ku hoteli është deri me 3 yje dhe jo 4 sikundër është paguar.</p> <p><i>Në përfaqësinë Londër</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhur me pagesën 910 GBP mungon gjurma e faturave elektronike (pa statement të pagesës) vetëm me praninë e një emaili për vlerën e pagueshme; <p><i>Në përfaqësinë Washington</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhur me pagesën 669.13 USD për të njëjtin shërbim janë mbajtur dy urdhër shërbime të plotësuar ndryshe, me datat dhe hotelin njësoj 18.11.2021-20.11.2021; <p><i>Në përfaqësinë Podgoricë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk është lehtësisht i identifikueshëm dhe i kuptueshëm. Nga ana e përfaqësisë është operuar duke vendosur faturat (të cilat janë për total shpeznimi dhe jo detajuar zërat) mbi procesverbale dhe fotokopjuar mbi njëra tjetrën duke e bërë të pamundur kuptueshmërinë e informacionit që përmban.
<p>Kriteri:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër i Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 dt 15.10.2012; - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.

Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i aseteve të institucionit
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	<p><i>Përfaqësia Neë york, të marr masa:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 29,041.35 Dollar për broker fees, paguar në kundërshtim me VKM nr.20 datë 18.01.2017, pikën 10, gërma ç të saj, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 2,952 Dollar, paguar për qëndrimin në Hotel K. të grupit të auditit të MEPJ-së, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 13,209 Dollar, pagesë për qëndrim në hotel në kuadër të përgatitjes së kandidimit për Këshill Sigurie të F.H, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 2,104.55 Dollar, biletë avioni dhe shtesë në të për B.K, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; <p><i>Përfaqësia BE-Bruksel, të marr masa:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 20.10 Euro për kafe S.J, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 395.48 Euro pagesa për hotel kryer për M.F, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 81.88 Euro pagesa për hotel kryer për A.K, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 2,800 all dhe 3,675 all, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 271.96 Euro, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; <p><i>Përfaqësia Milano, të marr masa:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 99.98 Euro prerë për iteneralin ‘Budapest – Milano’, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 134 Euro për të cilën nuk arrin të identifikohet produkti apo shërbimi i marr, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 947.63 Euro nuk arrin të identifikohet se për cilin është paguar, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues; - Të kërkohet të kthehet në MEPJ vlera prej 28.846 all për iteneralin Tiranë Bergamo, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

	<p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 192.8 Euro total, për itinerarin Milano-Santiago-Milano, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;</p> <p><i>Përfaqësia Athinë,</i></p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 1,488 Euro për agjenci imobiliare, paguar në kundërshtim me VKM nr.20 datë 18.01.2017, pikën 10, gërma ç të saj, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;</p> <p>- të marr masa për mbajtjen e dokumentacionit justifikues në përputhje me Vendimin e Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “<i>Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë</i>”, pikën 9, neni 4;</p> <p><i>Përfaqësia Romë të marr masa:</i></p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 3,470.1 Euro;</p> <p><i>Përfaqësia Londër</i></p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 910 GBP;</p> <p><i>Përfaqësia Washington</i></p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 669.13 USD;</p> <p><i>Përfaqësia Podgoricë</i></p> <p>- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar dokumentacionin justifikues.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Konstatim:

Nga auditimi u konstatua se, monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë kryhet vetëm nga auditimi i brendshëm i MEPJ, ndërkohë që ndërtimi i pasqyrave financiare të konsoliduara që ajo realizon kërkon mbështetjen dhe verifikimin e evidencave mbështetëse për të ruajtur vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre.

Sa më sipër gjykojmë të nevojshme vlerësimin e mundësisë për përfshirje rast pas rasti të stafit të financës në monitorimin që kryhet nga ana e DAB.

Pjesa e dytë:

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2020 dhe 2021 u konstatua problematikë sa më poshtë vijon në zbatimin e kontratës me A shpk,

Përgjatë kryerjes së auditimit është konstatuar prania e një marrëveshje mirëkuptimi lidhur më 07.03.2011 mes operatorit ekonomik A. sh.p.k dhe palëve Ministria e Brendshme – Ministria për Punët e Jashtme (sot MEPJ) dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë. Në të specifikohet se, A po zbaton marrëveshjen konçesionare “*Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve dhe pasaportave elektronike*”.

Nga auditimi është konstatuar se, ky shërbim ofrohej në 14 përfaqësi ku numri i zyrave operatore është si më poshtë vijon:

	<i>Përfaqësia Diplomatike</i>	<i>A. nr.zyre</i>
1	Misioni BE	1
2	Athinë	12
3	Berlin	1
4	Mynih	1
5	Selanik	4
6	Vjenë	1
7	Romë	3
8	Milano	11
9	Londër	2
10	Paris	1
11	Neë york	1
12	Stocholm	1
13	Stamboll	1
14	Bari	1

Burimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Financës

Në bazë të dokumentacioneve të grumbulluara gjatë periudhës së auditimit, rezulton se, A. realizon të ardhura nga shitja e kuponave të pasaportave dhe letërnjoftimeve elektronike për qytetarët shqipëtar jashtë Shqipërisë, (sipas zonave të mbulimit/ofrimit të shërbimit) të ardhura të cilat i mban për vetë në nivelin 95% dhe derdh pranë përfaqësisë 5 %, të cilat kjo e fundit i mban për shpenzime të veta operative. (*informacion i nxjerr nga evidencat e shpenzimeve por nuk specifikohet në marrëveshjen e mirëkuptimit*)

Referuar marrëveshjes së mirëkuptimit, ndër detyrimet që MEPJ ka ndaj operatorit A., është edhe sigurimi i ambienteve të ushtrimit të veprimtarisë (zyra, seli), ku pagesa e shpenzimeve të qirasë për këto ambiente mbulohet nga MEPJ.

Po ashtu, nga ana e përfaqësisë paguhen edhe shpenzimet për Energji elektike, Ujë, telefon, ngrohje dhe shpenzime të përbashkëta si dhe pagat e operatorëve të A.

Pra rrjedhimisht ky 5 % që i kthehej përfaqësisë nuk ngel më në këtë nivel por zhvishet prej pagesave të sipërcituara.

Nga ana e grupit të auditimit është kërkuar:

1. Marrëveshja koncensionare, për të audituar efektet financiare për periudhën objekt auditimit;
2. Shtesa e kontratës koncensionare;
3. Të ardhurat e realizuara prej A dhe Të ardhurat e derdhura për favor të përfaqësive diplomatike dhe konsullore;
4. Shpenzimet operative të paguara për A.

Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion:

- Kontrata për ndryshimin e kontratës së koncensionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike” lidhur më 21.07.2008 ndërjet Ministrisë së Brendshme të R.Sh dhe Grupimit të Shoqërive S.S dhe Fondi Sh.A i Ndërmarrjeve, përfaqësuar nga A. sh.p.k nënshkruar më 13.07.2010.
- Marrëveshja e mirëkuptimit mes operatorit ekonomik A. sh.p.k dhe palëve Ministria e Brendshme – Ministria për Punët e Jashtme (sot MEPJ) dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë. Në të specifikohet se, A. po zbaton marrëveshjen koncesionare

“Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve dhe pasaportave elektronike lidhur më 07.03.2011.

U konstatua se, mungonte gjurma e specifikimit të detyrimit të MEPJ-së për pagesën e shpenzimeve operative dhe qirasë së ambienteve të cilat do të përdoren si zyra nga operatorët.

Pika II e Marrëveshjes së Mirëkuptimit, liston Detyrimet specifike të MPJ-së si më poshtë vijon:

II) MPJ do të :

- a. Sigurojë ambientet e përshtatshme në Ambasada/Zyra Konsullore që do të përdoren si Zyra Aplikimi pranë Ambasadave, duke plotësuar të paktën kërkesat dhe kriterin e përcaktuar në Kontratën e Konkensionit, të ndryshuar, për hapjen dhe funksionimin e Zyrave të Aplikimit;
- b. Ofrojë shërbimet në Zyrat e Aplikimit në Ambasada

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2020 veprimtaria e A përmblihet në:

Nr.	Përfaqësitë	Gjendja 1 Janar	Hyrjet gjatë vitit 2020	Shpenzime Paga	Shpenzimet Operative	Investime	Transferuar A	5 % që i kalon përfaqësisë	Totali shpenzime ve të A
1	Athinë	391,041.00	6,361,275.00	71,682.00	68,864.00	2,234.00	6,042,652.00	318,063.75	142,780
2	Misioni BE	5,366.00	532,747.00	7,818.00	10,891.00	-	439,964.00	26,637.35	17,709
3	Romë	51,142.00	1,736,580.00	5,253.00	39,236.00	-	1,509,704.00	86,829	44,489
4	Milano	241,332.00	3,878,810.00	46,468.00	108,159.00	-	3,717,924.00	193,940.50	154,627
								62,788	39,091
5	Londër	22,649.00	1,255,760.00	17,768.00	21,323.00		1,182,029.00		
6	New york	45,138.00	766,686.00	7,398.00	14,422.00	-	770,389.00	38,334.30	21,820
								68,469.05	44,974
7	Mynih	95,709.00	1,369,381.00	8,144.00	36,830.00		1,241,740.00		
8	Selanik	384,233.00	3,494,348.00	23,368.00	62,238.00	-	3,449,144.00	174,717.40	85,606
	Total	1,236,610.00	19,395,587.00	187,899.00	361,963.00	2,234.00	18,353,546.00	969,779.35	549,862

Burimi: MEPJ, drejtorja e Financës, përpunoi grupi Auditimit

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se, nga të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2020 duhet të ishin derdhur pranë buxhetit të përfaqësive 5% e totalit të të ardhurave ose e shprehur në vlera monetare nga të ardhurat e realizuara duhet të ishin derdhur në total 969,779.35 Euro dhe 38,334.3 Dollar për llogari të përfaqësive.

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e përfaqësive nga kjo vlerë e sipër përmendur që duhej derdhur referuar termave të kontratës, janë zbritur shpenzimet operative të zyrave të A. të cilat mbulohen nga përfaqësitë.

Konkretisht për vitin 2020 janë paguar nga përfaqësitë shpenzime operative të A. në vlerën totale prej 530,270 Euro dhe 21,820 Dollar. Duke zbritur këtë vlerë nga 5% i të ardhurave totale të detyruara për tu derdhur në buxhetin e përfaqësive, rezulton se, të ardhurat neto të përfituara nga aktiviteti i A. janë 401,169.05 euro (931,445.05 euro – 530,276 euro) dhe 16,514.3 Dollar (38,334.3 dollar – 21,820 dollar) konkretisht si më poshtë vijon:

Përfaqësitë	Duheshin marr (5%)	Janë marr
Athinë	318,063.75	175,283.75
Misioni BE	26,637.35	7,928.35
Romë	86,829	42,340
Milano	193,940.50	39,313.50
Londër	62,788	23,697

Mynih	68,469.05	23,495.05
Selanik	174,717.40	89,111.40
Total Euro	931,445.05	401,169.05
Neë york	38,334.30	16,514.30
Total Dollar	38,334.30	16,514.30

Burimi: MEPJ, drejtoria e Financës, përpunoi grupi Auditimit

Në total për vitin 2020 janë marr 530,276 Euro dhe 21,820 Dollar më pak.

Përsa i takon vitit 2021, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Përfaqësitë	Gjendja 1 Janar	Hyrjet gjatë vitit 2021	Shpenzime Paga	Shpenzime Operative	Investime	Transferuar A	5 % që i kalon përfaqësisë	Totali shpenzimeve të A
1	Athinë	566,884	5,154,590	156,327	167,531	-	4,735,800	257,729.50	323,858
2	Berlin	0	284,024	5,460	5,442	-	242,357	14,201.20	10,902
3	Misioni BE	79,440	513,547	7,400	8,268		514,798	25,677.35	15,668
4	Romë	233,529	2,329,001	20,585	25,295		2,329,080	116,450.05	45,880
5	Milano	247,591	6,876,623	86,455	199,352	-	6,251,212	343,831.15	285,807
6	Stokholm	0	310,529	4,673	718	-	290,919	15,526.45	5,391
7	Paris	0	598,686	3,115	44,143		462,680	29,934.30	47,258
8	Vjenë	0	50,359	8,611	60	-	46,384	2,517.95	8,671
9	Bari	0	742,811	11,356	15,034	-	679,548	37,140.55	26,390
10	Stamboll	0	87,534	6,289	-	-	82,316	4,376.70	6,289
11	Londër	57,289	1,627,849	19,068	32,985	13,626.00	1,441,655	81,392.45	66,679
12	Mynih	178,376	823,879	7,780	48,856	-	859,743	41,193.95	56,636
13	Selanik	343,831	1,865,404	25,637	81,260		1,792,096	93,270.20	106,897
Total Euro		1,726,555	22,369,267	371,744	644,201	13,626.00	20,780,315	1,063,241.80	1,005,326
14	New york	19,615	1,104,431	8,988	15,257		1,051,727	55,221.55	24,245
Total Dollar		19,615	1,104,431	8,988	15,257		1,051,727	55,221.55	24,245

Burimi: MEPJ, drejtoria e Financës, përpunoi grupi Auditimit

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se, nga të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2021 duhet të ishin derdhur pranë buxhetit të përfaqësive vlerat që korrespondojnë me 5% e totalit të të ardhurave ose e shprehur në vlera monetare nga të ardhurat e realizuara duhet të ishin derdhur në total 1,063,241.80 Euro dhe 55,221.55 Dollar për llogari të përfaqësive.

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e përfaqësisë, nga kjo vlerë e sipërpërmendur janë zbritur shpenzimet operative të zyrave të A. të cilat mbulohen nga përfaqësitë.

Konkretisht për vitin 2021 janë paguar nga përfaqësitë shpenzime operative të A. në vlerën 1,005,326 Euro dhe 24,245 Dollar.

Duke zbritur këtë vlerë nga 5% i të ardhurave totale të derdhura në buxhetin e përfaqësive rezulton se të ardhurat neto të përfituara nga aktiviteti i A. janë 57,915.8 euro (1,063,241.80 euro – 1,005,326 euro) dhe 30,976.55 (55,221.55 dollar – 24,245 dollar) konkretisht si më poshtë vijon:

Përfaqësitë	Diferenca e vlerave
--------------------	----------------------------

Athinë	(66,128.50)
Berlin	3,299.20
Misioni BE	10,009.35
Romë	70,570.05
Milano	58,024.15
Stokholm	10,135.45
Paris	(17,323.70)
Vjenë	(6,153.05)
Bari	10,750.55
Stamboll	(1,912.30)
Londër	15,713.45
Mynih	(15,442.05)
Selanik	(13,626.80)
Total Euro	57,915.8
Neë york	30,976.55
Total Dollar	30,976.65

Burimi: MEPJ, drejtoria e Financës, përpunoi grupi Auditimit

Nga ana tjetër, për vitin 2021 u konstatua fenomeni i tejkalimit të shpenzimeve për llogari të A. referuar 5 % të të ardhurave të grumbulluara, nga ana e MEPJ u dha shpjegimi i mbulimit të këtyre vlerave me fondet gjendje të trashëguara dhe akumuluar.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MEPJ janë paguar shpenzimet operative dhe paga për operatorët e A., ndërkohë që një specifikim i tillë nuk është i përcaktuar në marrëveshjen mes palëve.

Sa më sipër, duke marr të mirëqënë përqindjen e kalimit të të ardhurave MEPJ/A. prej 5% / 95% rezulton një vlerë prej 588,191.8 Euro dhe 52,796.65 Dollar të ardhura të munguara në buxhetin e përfaqësive e më tej buxhetin e MEPJ-së.

Dukshëm jemi në situatën e favorizimit të operatorit ekonomik, duke cënuar në këtë rast palën përfutuese pra shtetin Shqiptar.

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2021 evidentohen raste me një një boshllëk në mbulimin e shpenzimeve operative dhe pagave të operatorëve të A. krahas 5% të të ardhurave që duhen kaluar përfaqësive.

Konkretisht, përfaqësitë Paris, Vjenë dhe Stamboll gjendja e mbartur në çelje figuron 0 Euro ndërkohë shpenzimet që duhen mbuluar janë më të larta se të ardhurat e realizuara. Si më poshtë vijojnë:

<i>Përfaqësia</i>	<i>5% i të ardhurave që kalon përfaqësisë</i>	<i>Totali shpenzimeve të A</i>	<i>Diferenca</i>
Paris	29,934.30	47,258	(17,323.7)
Vjenë	2,517.95	8,671	(6,153.05)
Stamboll	4,376.70	6,289	(1,912.3)

Burimi: MEPJ, drejtoria e Financës, përpunoi grupi Auditimit

Nga ana e grupit të auditimit, u kërkua informacion shtesë për këtë mbulim të shpenzimeve dhe u raportua nga ana e MEPJ-së se, *Vlera e shpenzimeve që kanë tejkaluar pjesën e 5 përqindëshit të të ardhurave janë përballuar nga shuma e akumuluar e të ardhurave që rezultojnë të mbarura nga viti 2020.*

Përfaqësitë Paris, Vjenë dhe Stamboll kanë mbartje 0 sepse sektori i aplikimit të pasaportave në këto misione diplomatike është çelur gjatë vitit 2021.

Shpenzimet totale të A. vlerësohen si total i përgjithshëm i të gjitha përfaqësive që ofrojnë procesin e aplikimit për dokumente biometrike që do të thotë që rastet e humbjes për një mision diplomatik përballohen nga përfaqësitë që rezultojnë me fitim.

Referuar kontratës së mirëkuptimit dhe marrëveshjeve koncensionare (baza dhe e ndryshuar) lidhur me përballimin e humbjes është klauzolë e veçantë e cila specifikon: ...Kontrata për ndryshim të kontratës së koncensionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike” lidhur më 21.07.2008, neni 17.3.4 i shtohet Marrëveshjes së koncensionit dhe specifikon ... Në përputhje me programin 21 (Çështje të reja financiare) Palët bien dakort se, Autoriteti do ti paguaj Konçensionarit kostot përkatëse për ofrimin e shërbimeve në zyrat e aplikimit në Ambasada siç specifikohet më poshtë:

- (i) Në rast se zyrat e Aplikimit në Ambasada nuk do të arrijnë një nivel minimal aplikimesh për Pasaporta prej 1000 njësisish për muaj (me një tolerancë prej 10%) për çdo zyrë aplikimi në Ambasada, për një periudhë 6 mujore, siç specifikohet në Programin 19 (Specifikimet teknike për Zyrat e Aplikimit në Ambasada), Autoriteti do t’i paguajë Konçensionarit kostot e pambuluara të instalimit. (diferenca ndërmjet kostove të instalimit dhe kostove të mbuluara nga Shoqëria Konçensionare nëpërmjet shitjes së dokumentave të Identitetit në çdo zyrë aplikimi në Ambasada) siç specifikohet në programin 21 (Çështje të reja financiare – Seksioni 3 – Kostot e instalimit).

Nëqoftëse do ti hyjmë në gjenezë historikut të nënshkrimit të kësaj marrëveshje konstatohet se:

Nga praktika dokumentare e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua qendrimi kundër i MPJ (MEPJ sot) referuar Memorandumit Analitik të datës 08.02.2010 bashkëlidhur projekt letra e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme z. I.M për Ministrin e Brendshëm z. L.B ku shprehet sygjerimi që përzgjedhja e mënyrës së si do të ofrohet shërbimi për pasaportat biometrike të jetë objekt bisedimesh mes MB, Shoqërisë A. dhe MPJ. E më pas të operohet me përcaktimin e aspekteve financiare.

Memorandumit Analitik të datës 15.07.2010 në të specifikohet:

- Më datë 14 Korrik 2010, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme z. G.T dhe Drejtori i Drejtorisë Konsullore, z. S.B janë thirrur në Ministrinë e Brendshme nga Zëvendës Ministri i Brendshëm zoti F.P. Arsyja ishte kundërshtimi nga ana e MPJ e nënshkrimit të amendimit të kontratës për mundësinë e aplikimeve për dokumente biometrike në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.
- Projekt kontrata nuk ishte vendosur në dispozicion të MPJ. Për këtë arsye Sekretari i Përgjithshëm z. T kundërshtoi të jepte miratim pa studiuar tekstin e plotë.
- Zoti Pone në zyrën e tij shpjegoi termat e kontratës dhe përsëri kërkoj me insistim dhënie e miratimit nga MPJ pa lënë mundësinë e shqyrtimit të kontratës. Pas refuzimit të prerë për të nënshkruar z. P. urdhëroi një nga vartësit e tij të printonte vetëm paragrafët që kanë të bëjnë me Ministrinë e Jashtme.
- Sekretari i Përgjithshëm z. T. kundërshtoi përsëri dhe duke ju referuar legjislacionit në fuqi kërkoj materiale të plota. Pas refuzimit të MPJ z. P. urdhëroi vartësin të printonte kontratën (në anglisht) por jo anekset e saj të cilat pavarësisht insistimit të përsëritur nuk i vuri në dispozicion të përfaqësuesve të MPJ.

Kundërshtimet lidhur me nënshkrimin e amendimit të kontratës për mundësinë e aplikimeve për dokumente biometrike në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit konsistojnë në faktin se,

- Kontrata është hartuar dhe negociuar pa konsultimin e MPJ, institucioni kryesor zbatues;
- Nga shqyrtimi i kontratës evidentohen 5 anekse, pjesë integrale e saj, të cilat z.P në asnjë mënyrë nuk i vendos në dispozicion. Duket qartazi se anekset 19 dhe 21 lidhen direkt me MJ dhe Shërbimin Konsullor;
- Kontrata parashikon që aplikimi të pranohet nga punonjës të përfaqësive diplomatike duke ulur në minimum kostot e koncensionarit (vetëm për instalim të pajisjeve, trajnim dhe mirëmbajtje). Kostoja e personelit dhe e punës në përfaqësi përballohet nga MPJ.

Pjesa e tretë:

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2020 dhe 2021 u konstatua problematikë sa më poshtë vijon në zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës:

Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme, misionet diplomatike dhe postet konsullore.

➤ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Struktura

Për vitin 2020 struktura është ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr.145, datë 4.11.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhërin nr. 138, datë 21.10.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, të ndryshuar dhe struktura gjithësej përfshin 209 punonjës.

Për vitin 2021 nuk ka patur ndryshime në strukturë.

Për vitin 2022 struktura është ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 55, datë 18.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhërin nr. 138, datë 21.10.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, të ndryshuar”, struktura gjithësej përfshin 193 punonjës dhe me Urdhër të Kryeministrit nr. 124, datë 4.8.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhërin nr. 138, datë 21.10.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, të ndryshuar” dhe struktura gjithësej përfshin 170 punonjës.

-Gjatë auditimit u konstatua se rezultojnë 21 (njëzetë e një) vende vakante në strukturën e MEPJ, për të cilat nuk disponohet asnjë dokument justifikues për të filluar procedurat e rekrutimit dhe plotësimit të vendeve. Ndër këto, Sektori i Çështjeve Tematike i planifikuar me një strukturë 1+3 (aktualisht kthyer në drejtori 1+4), rezulton i plotësuar vetëm me një punonjës.

Përgjatë periudhës Janar 2020-Shtator 2022 pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, janë emëruar dhe janë konfirmuar me status “nëpunës civil” gjithsej 14 (katërmëdhjetë) punonjës dhe 2 (dy) janë në periudhë prove.

-Gjatë auditimit u konstatua se 4 prej punonjësve të rekrutuar përgjatë periudhës Janar 2020-Shtator 2022 në sistemin e karrierës diplomatike, figurojnë të dërguar në misione diplomatike. Procedura për dërgimin e tyre në misione diplomatike është kryer me anë të njoftimit nëpërmjet postës elektronike nga DBNj drejtuar vetëm stafit të MEPJ, duke përjashtuar në këtë mënyrë personelin e pozicionuar në misione diplomatike apo poste konsullore, të cilët gjithashtu mund të shprehin interesin për pozicionet e krijuara. Pas përcjelljes së kërkesave nga punonjësit e interesuar, DBNj përmbledh në formë tabelare të gjithë informacionin e detajuar mbi secilin prej tyre. Nuk administrohet asnjë gjurmë dokumentare lidhur me vendimmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm, në cilësinë e strukturës vlerësuese dhe përzgjedhëse të kandidatave dhe paraqitjen pranë Ministres për miratim, në kundërshtim me pikën 5 dhe 6, Kreu VII, VKM nr. 816, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë”, e cila parashikon se “*Brenda 15 ditëve, nga shpallja e vendeve të lira, Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit listën e kandidatave dhe ia paraqet, për vlerësim, sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm bën përzgjedhjen e kandidatave për vendet e lira dhe, brenda datës 15 mars të çdo viti, ia paraqet për miratim ministrit.*”

-Konstatohet se për 12 (dymbëdhjetë) punonjës të rekrutuar, procedura për përfitimin gradës “Atashe”, ka filluar për një periudhë mbi një muaj më vonë se përfundimi i periudhës së provës, duke mos respektuar afatin jo më vonë se një muaj përpara përfundimit të provës, në kundërshtim me shkronjën d), pika 2, Seksioni 2, VKM 816\2015, sipas së cilit “...*Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplommatike, vlerësimi i eprorit direkt dhe vlerësimi i strukturës trajnuese në MPJ i përcillen, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ministrit, jo me vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës...*”

-Nga auditimi me zgjedhje, rezultojnë se në strukturën e MEPJ, 3 (tre) pozicione janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave, veprime në kundërshtim me pikën 3), neni 39, Ligji Nr. 23/2015, i cili parashikon se “*Diplomati i karrierës emërohet në pozicione drejtuese në Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke respektuar hierarkinë e gradave diplomatike si më poshtë: a) përgjegjës sektori Me gradën jo më të ulët se “Sekretar i parë”. b) drejtor Me gradën jo më të ulët se “Këshilltar”...*”, sipas tabelës nr.1.

➤ **Misione diplomatike dhe poste konsullore**

-Të gjitha misionet diplomatike dhe postet konsullore funksionojnë pa një strukturë personeli të miratuar, si dhe nuk disponohet asnjë marrëveshje e lidhur me shtetet pritëse mbi përcaktimin e numrit të personelit në këto struktura, në kundërshtim me pika 2, neni 21, ligji Nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se “*Struktura e misionit diplomatik dhe postit konsullor miratohen me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme. Numri i personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor përcaktohet me marrëveshje me shtetin pritës.*”

-Plani një vjeçar i emërimeve/mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore

2020 U konstatua se për vitin 2020 nuk është hartuar plan lidhur me emërimet/mbarimet të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore.

2021 U konstatua se plani një vjecar i emërimit/mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore, për vitin 2021 është përgatitur nga DBNj më datë 11.01.2021. Nëpërmjet Memorandumit për informacion, sekretari i Përgjithshëm ka përcjellë më datë 16.06.2021 Ministres një përmbledhje për diplomatët, të cilët i kanë plotësuar afatet e qëndrimit 3 vjet në përfaqësi dhe nga ana e Ministres nuk ka patur asnjë vendimmarrje. Planin sipërcituar duhet të ishte paraqitur si fillim për vlerësim pranë sekretarit të përgjithshëm, jo më vonë se data 15 dhjetor e vitit 2021, si dhe ky i fundit duhet t'ia përcillte Ministres për vendimmarrje jo më vonë se data 10 janar 2021.

2022 U konstatua se plani një vjecar i emërimit/mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore, për vitin 2022 është përgatitur në mënyrë të plotë dhe të detajuar nga DBNj më datë 24.01.2022. Lidhur me këtë plan, nga ana e Ministres nuk ka patur asnjë vendimmarrje.

Përgjatë tre viteve, 2020, 2021, 2022 edhe pse nuk ka patur një plan të miratuar nga Ministria, në cilësinë e personit përgjegjës për këtë vendimmarrje, është vijuar me emërimin/mbarimin e detyrës së stafit në misione diplomatike dhe poste konsullore. Veprime këto në kundërshtim me parashikimet e Kreu VII, Seksioni 4, i VKM nr. 816/2015, e cila parashikon se “1. *Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si rregull, bën planin njëvjeçar të emërimeve /mbarimit të detyrës në misione Diplomatiqe dhe poste konsullore dhe ia paraqet për vlerësim sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se data 15 dhjetor e çdo viti.*

2. *Sekretari i Përgjithshëm i paraqet për miratim ministrit, jo më vonë se data 10 janar e çdo viti, planin e emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike/postet konsullore.*

3. *Ministri miraton, brenda muajit janar, planin e emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike/postet konsullore.*

4. *Pas miratimit të planit nga ministri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në konsultim me drejtorinë që mbulon misionin diplomatik/postin konsullor ku krijohet vendi i lirë, përgatit të dhënat dhe kushtet specifike për plotësimin e tij dhe, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, bën shpalljen për plotësimin e vendeve të lira.*

5. *Brenda 15 ditëve, nga shpallja e vendeve të lira, Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit listën e kandidaturave dhe ia paraqet, për vlerësim, sekretarit të Përgjithshëm.*

6. *Sekretari i Përgjithshëm bën përzgjedhjen e kandidaturave për vendet e lira dhe, brenda datës 15 mars të çdo viti, ia paraqet për miratim ministrit.*

7. *Urdhri i Ministrit për emërimet/mbarimin e detyrës së diplomatëve në misione diplomatike /poste konsullore del brenda muajit mars të çdo viti. Efektet e zbatimit të urdhrin të emërimit /mbarimit të detyrës fillojnë, të paktën, tre muaj, por jo më shumë se katër muaj, nga data e nxjerrjes së tij.”*

-Nga auditimi me zgjedhje, konstatohet se 11 (njëmbëdhjetë) prej anëtarëve të personelit të misioneve diplomatike vijojnë të kryejnë funksione diplomatike edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit, si dhe gjithashtu vijojnë të mbajnë statusin e diplomatit, i cili duhet t'iu humbiste me plotësimin e moshës së pensionit, si dhe gjithashtu edhe një punonjës i stafit të MEPJ, në kundërshtim me shkronjën e), pika 1, neni 42, dhe shkronjën c), neni 45, ligji Nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, e cila parashikon “*Ministri i Punëve të Jashtme urdhëron mbarimin e parakohshëm të funksionit, ose transferimin e kreut të misionit diplomatik dhe postit konsullor, si dhe të çdo anëtar të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor, për arsye të mëposhtme: e) kur mbush moshën për pension...*

Diplomati i karrierës, përveç rasteve të parashikuara në ligjin e nëpunësit civil, humbet statusin e diplomatit të karrierës kur: ... c) plotëson moshën për pensionin e plotë...”, sipas tabelës nr.2

-Referuar pikës 9, Seksioni 1, VKM 816/2015 numri i diplomatëve të karrierës që përfitojnë gradat diplomatike “Ambasador” dhe “Ministër Fuqplotë”, nuk duhet të jetë më i lartë se 80 dhe i ndarë si më poshtë vijon për Ambasadorë dhe Ministër Fuqplotë:

- Ambasadorë - 5
- Ministra Fuqplotë - 35

Në këto kushte, duke qenë se numri i diplomatëve që mund të përfitojnë grada si më sipër është i limituar, si dhe në mbështetje të faktit se një prej diplomatëve me gradë “Ambasador” dhe katër prej diplomatëve me gradë “Ministër Fuqplotë” kanë dal në pension, por vijojnë të ushtrorjnë funksionin dhe të mbajnë gradat diplomatike ndikojnë dhe çenojnë vazhdimësinë e karrierës për diplomatët të cilëve nuk ju jepet mundësia për marrjen e gradave edhe pse i plotësojnë kriteret ligjore, parimin e paanësisë si dhe korrektësisë së zbatimit të legjislacionit.

-Nga auditimi me zgjedhje, konstatohet se 64 (gjashtëdhjetë e katër) anëtarë të personelit të misioneve diplomatike kanë vijuar të mbajnë poste pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore edhe pse ka përfunduar afati 3 vjeçar, në kundërshtim me pikën 2, neni 41, ligji Nr. 23/2015, sipas së cilit “*Diplomatët e karrierës qëndrojnë me shërbim në të njëjtin mision diplomatik ose post konsullor, si rregull 3 vjet. Ministri i Punëve të Jashtme urdhëron fillimin e procedurave të mbarimit të detyrës së diplomatit të karrierës jo më pak se tre muaj nga data e emërimit tij në një pozicion në Shërbimin e Jashtëm.*” 25 (njëzetë e pesë) prej tyre janë në pozicionin e kreut të misionit diplomatik/poste konsullore, në kundërshtim me pikën 5, neni 26, Ligji 23/2015, sipas së cilit “*Funksioni i kreut diplomatik është, si rregull, 3 vjet*” dhe pikës 4, neni 30, Ligji 23/2015, sipas së cilit “*Funksioni i kreut të postit konsullor është, si rregull, jo më shumë se tre vjet*”, sipas tabelës nr. 3.

-Nga auditimi me zgjedhje, në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për rekrutimin dhe ushtrimin e detyrës së kreve të misioneve diplomatike, rezultoi se një punonjës me pozicion Ambasador, rezulton se ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. Gjithashtu vijon të ushtrorjë detyrën si Amasador edhe pse ka mbushur moshën e pensionit. Veprime në kundërshtim me shkronjën e), pika 1, neni 42, dhe shkronjën c), neni 45, ligji Nr. 23/2015, si dhe kreu IX, VKM nr. 816/2015, sipas së cilit “*1. Personeli diplomatik, teknik, administrativ dhe i shërbimit, në Shërbimin e Jashtëm, i nënshtrohet verifikimit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. 2. Në kuptimin e nenit 38, të ligjit nr. 23/2015, ... me verifikim të pastërtisë kuptohet lëshimi i vërtetimit nga institucionet përkatëse, se personi nuk ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. 3. Në rastin e mosmarrjes së certifikatës së sigurisë dhe vërtetimit të pastërtisë së figurës së personelit diplomatik, teknik, administrativ dhe të shërbimit, punonjësi përjashtohet nga Shërbimi i Jashtëm.*”, sipas tabelës nr.4.

-Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se një ambasadë drejtohej nga diplomat me gradë personale Sekretar i Tretë, i emëruar në pozicionin i ngarkuar me punë a.i, në cilësinë e kreut të misionit, meqënëse ky mision në atë kohë ndodhej në rastin e mungesës së përkohshme të kreut të misionit, e si rrjedhojë jo detyrimisht duhet që i ngarkuari me punë të ketë gradën jo më pak se Këshilltar. Këtë detyrë vijon ta ushtrorjë edhe aktualisht, pra afërsisht për një periudhë 2 vjet e tre muaj, sipas tabelës nr. 5.

Në kuptim të nenit 26, të ligjit nr. 23/2015, procedura e drejtimit të misionit diplomatik i kalojnë si rregull diplomatit me gradën më të lartë, me përjashtim të rasteve të vecanta ku lejohen edhe me gradë më të ulët se Këshilltar, përkatësisht në rastet e mungesës së përkohshme të kreut të misionit. Duke mbajtur në konsideratë këtë dispozitë dhe faktin se nuk është ndërmarrë asnjë procedurë për emërimin në këtë pozicion të diplomatëve me gradën përkatëse, rasti konkret në të cilin kanë kaluar afërsisht 2 vjet e tre muaj, nuk mund të konsiderohet dhe/apo të përbëjë shkak që kjo të konsiderohet si fazë e përkohshme, duke bërë që misioni diplomatik, të drejtohet në kundërshtim me pika 1, neni 27, ligji Nr. 23/2015, sipas së cilit “*Kreu i misionit diplomatik përzgjidhet ndërmjet diplomatëve të karrierës me gradë të lartë, jo më pak se këshilltar.*”

-Në zbatim të pikës 3 dhe 4, neni 31, Ligji Nr. 23/2015, Ministrin të Punëve të Jashtme i njihet e drejta të emërojë në misionet diplomatike dhe postet konsullore, në raste të vecanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Nga auditimi me zgjedhje, rezultoi se në përfaqësitë diplomatike janë emëruar 28 (njëzetë e tetë) punonjës, në cilësinë e ekspertëve, të cilët gëzojnë statusin e diplomatit në misionet diplomatike për aq kohë sa punojnë pranë këtyre misioneve. Për këta ekspertë, nuk rezultoi asnjë gjurmë dokumentare, se përse konsiderohen raste të vecanta, çfarë njohurish dhe ekspertize zotërojnë, cila është procedura e hapjes së thirrjes për nevoja të rekrutimit të këtyre llojve ekspertëve dhe të dhëna të ngjashme, duke mundur rekrutimin e tyre pa një procedurë transparente, në kundërshtim me parashikimet e nenit 4, neni 5, ligji Nr. 23/2015, sipas së cilit “*Shërbimi i Jashtëm është pjesë përbërëse e Shërbimit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe vepron në bazë të parimeve të profesionalizmit, integritetit, paanësisë politike, transparencës, shërbimit ndaj publikut, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë, si dhe korrektesisë në zbatimin e legjislacionit.*”, sipas tabelës nr. 6.

-Në strukturën e misioneve diplomatike ushtrojnë funksion:

- ✓ 65 (gjashtëdhjetë e pesë) diplomatë nuk ju përputhet grada emërore me gradën personale;
- ✓ 52 (pesëdhjetë e dy) punonjës janë emëruar nga jashtë sistemit;
- ✓ 18 (tetëmbëdhjetë) diplomatë të cilëve ju përputhet grada emërore me gradën personale;
- 4 (katër) punonjës janë të ngarkuar me punë.

Pra, pjesa më e madhe e diplomatëve ushtrojnë funksion diplomatik në misionet diplomatike dhe grada emërore e tyre nuk përputhet me gradën personale, në kundërshtim me shkronjën c), neni 50, Ligji nr. 23/2015, i cili parashikon se “*Të mbajë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në misionet diplomatike ose postet konsullore, në përputhje me gradën diplomatike, aftësitë dhe eksperiencën profesionale*”, sipas tabelës nr. 7.

Gjatë auditimit, konstatohet se 99 punonjës me grada Ministër Fuqplotë, Ministër Këshilltar, Këshilltar, Sekretar i Tretë, i Dytë, i Parë, ushtrojnë funksionet pranë MEPJ, të cilët sëbashku me punonjësit e tjerë në përfaqësi të pozicionuar me grada emërimi jo në përputhje me gradën personale, mund të përshtaten në pozicionet e duhura dhe në përputhje të plotë me gradën emërim/personale.

-Për të gjitha problematikat e konstatuara më sipër, në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas së cilit Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor që rregullon Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, konsiderohet e rëndësishme që Ministria e MEPJ në rastin konkret të nxirrte udhëzime të caktuara që do të vinin në ndihmë zbatimit me korrektësi të dispozitave të ligjit të posaçëm, duke mbajtur në fokus të në cdo rast parimet e profesionalizmit, integritetit, transparencës, vazhdimësisë së karrierës, si dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit. Nxjerrja e këtij akti nënligjor, në të cilin të përcaktohej qartë procedura e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm, afati maksimal i qëndrimit në pozicionin e kreut të misionit diplomatik në situata të përkohshme, rotacionet e emërimeve në përfaqësi do të sillte realizim të procedurave të sakta dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, Gjithashtu, do të vinte në ndihmë për të normuar cdo procedurë tjetër për të cilën kuadri ligjor aktual nuk është shprehur, apo lë vend për interpretim, duke shmangur në këtë mënyrë mungesën e theksuar të transparencës dhe vendimmarrjes subjektive.

Komisioni i Karrierës Diplomatike

-Nga grupi i auditimit është përzgjedhur për tu shqyrtuar dosja e Komisionit të Karrierës Diplomatike për vitin 2021, lidhur me vlerësimin etiko-profesional të punonjësve të rekrutuar në sistemin e karrierës diplomatike, si dhe mënyrën e organizimit dhe procedurat e ndjekura nga KKD. Nga shqyrtimi i dosjeve u konstatua se mbledhja e Komisionit të Karrierës Diplomatike (KKD) është realizuar në të gjitha rastet e punonjësve të rekrutuar me vonesë dhe në mospërputhje me parashikimet e shkronjës d, pika 2, Seksioni 2, VKM 816/2015, e cila parashikon se *“Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike, vlerësimi i eprorit direkt dhe vlerësimi i strukturës trajnuese në MPJ i përcillen, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ministrit, jo me vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës. Ministri shprehet me vendim për pranimin ose mospranimin e nëpunësit në sistemin e karrierës. Vendimi i ministrit u njoftohet, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nëpunësit dhe strukturave përkatëse në MPJ dhe DAP, brenda afateve të parashikuara në ligj.”*

-Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të KKD, rezulton se KKD shqyrton edhe vlerësimet e eprorëve direkt, strukturave trajnuese të MPJ, të cilat nuk i ka detyrë funksionale, po detyrë ka vetëm vlerësimin etiko-profesional, referuar parashikimeve të Seksionit 2, VKM 816/2015.

-Gjatë mbledhjes së datës 16.07.2021, KKD e mbledhur në zbatim të urdhërit nr. 300, datë 8.7.2021 të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ndër të tjera KKD pas shqyrtimit të plotësisimit të kritereve ligjore ka vendosur për ti propozar Ministrit dhënien e gradës “Ambasador” dhe propozimin nga kjo e fundit të Presidentit të Republikës me qëllim dhënien e gradës “Ambasador” për 4 (katër) diplomat karriere. Procesverbali i është përcjellë Ministres me anë të Memorandumit për vendimmarrje nr. 227 prot., datë 19.07.2021. Nga ana e Ministres nuk rezulton të jetë marrë asnjë vendimmarrje lidhur me propozimet e kryera brenda afatit ligjore tre ditor, veprim në kundërshtim me pikën 15, Seksioni 2, VKM 816/2015, e cila parashikon se *“Kryetari i Komisionit të Karrierës Diplomatike i dorëzon ministrit, brenda ditës, dokumentacionin e plotë të seancës së Komisionit. Ministri vendos për propozimet e Komisionit të Karrierës Diplomatike brenda tre ditëve, nga marrja e tyre”*, sipas tabelës nr.8.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53 prot., datë 10.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

*Lidhur me gjetjen: Gjate auditimit u konstatua se rezultojne 21 (njëzet e një) vende vakante ne strukturën e MEPJ, per te cilat nuk disponohet asnje dokument justifikues per te filluar procedurat e rekrutimit dhe plotësimit te vendeve. Nder keto, Sektori i Çeshtjeve Tematike i planifikuar me nje strukture 1+3, rezulton i plotësuar vetem me nje punonjes. **Nuk pranohet.***

Sqarim: Nisur nga specifikat e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, vendet vakante janë krijuar përkohësisht, për shkak të rotacionit të diplomatëve që levizin në mënyrë të vazhdueshme nga MEPJ në Përfaqësi dhe anasjelltas. Këto pozicione vakante, janë plotësuar në vijim me diplomatë karriere, të cilët janë kthyer nga përfaqësitë dhe janë emëruar në MEPJ.

Numri i vakancave të përmendura në këtë gjetje, është krijuar edhe për shkak të emërimit të diplomatëve, të cilët u emëruan në Misionin e Përherëshëm të RSh-së në Nju Jork, organika e të cilit u zgjerua në kuadër të anëtarësimit të RSh-së, si anëtare jo e përherëshme e Këshillit të Sigurimit. Në këtë kuadër, i është dhënë përparësi zgjerimit/plotësimit me staf të Misionit të Përherëshëm të RSh-së në OKB, në Nju Jork, i cili përballon një volum më të lartë punë, në raport me Drejtorinë e krijuar në MEPJ (Drejtoria e Këshillit të Sigurimit). Gjithashtu, shtojmë se struktura e Drejtorisë, më tej u ndryshua me Urdhrin e fundit për strukturën dhe aktualisht është drejtori 1+4 (1 drejtor dhe 4 specialistë). Theksojmë se MEPJ ka të dokumentuara të gjitha komunikimet drejtuar Departamentit të Administrës Publike (njësia përgjegjëse që kryen procedurat e rekrutimit), për shpalljen e vendeve vakante.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen: Gjate auditimit u konstatua se 4 prej punonjesve te rekrutuar pergjate periudhes Janar 2020-Shtator 2022 ne sistemin e karrieres diplomatike, figurojne te derguar ne misione diplomatike. Procedura per dergimin e tyre ne misione diplomatike eshte kryer me ane te njoftimit nepermjet postes elektronike nga DBNj drejtuar vetem stafit te MEPJ, duke perjashtuar ne kete menyre personelin e pozicionuar ne misione diplomatike apo poste konsullore, te cilet gjithashtu mund te shprehin interesin per pozicionet e krijuara. Nuk pranohet.

Sqarim: Njoftimi mbi shpalljen e vendeve vakante në përfaqësi i drejtohet vetëm stafit të MEPJ, në mënyrë që të mundësohet emërimi në përfaqësi i diplomatëve që ndodhen në Ministri, duke realizuar kështu një rotacion të tyre.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen: Konstatohet se per 12 (dymbëdhjete) punonjes te rekrutuar, procedura per perfitimin grades "Atashe", ka filluar per nje periudhe mbi nje muaj me vone se perfundimi i periudhes se proves, duke mos respektuar afatin jo me vone se nje muai perpara perfundimit te proves, ne kundërshtim me shkronjën d), pika 2, Seksioni 2, V.K.M 816/2015. Nuk pranohet.

Sqarim: Duke qenë se grupi i rekrutuar ka funksionuar si një gjeneratë edhe për trajnimin pranë strukturave të brendshme të MEPJ (Akademia Diplomatike), testimi për gradën Atashe, është organizuar në mënyrë të tillë që të gjithë kandidatët të plotësonin afatin 1-vjeçar të periudhës së provës. Pra, për 9 (nëntë) nga 11 (njëmbëdhjetë) nëpunës civil në periudhë prove, KKD ka qenë brenda afatit të përcaktuar në VKM 816/2015.

Gjithashtu, theksojmë se rekrutimi i Nëpunësve Civil nga DAP është realizuar në periudha të ndryshme dhe shpalljet nuk janë bërë njëherazi.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen:Nga auditimi me zgjedhje, rezultojnë se në strukturën e MEPJ, 3 (tre) pozicione janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën sipas hierarkisë së gradave, veprime në kundërshtim me pikën 3), neni 39), Ligji Nr. 23/2015. Nuk pranohet.

Sqarim:Procedura e ndjekur për emërimin e diplomatëve në pozicione të ndryshme në MEPJ dhe përfaqësi diplomatike është bazuar në ligjin për shërbimin e jashtëm, nr. 23/2015, neni 53, pika 1: Paga e diplomatit të karrierës, i cili punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që ai kryen; Paga e diplomatit të emëruar pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në bazë të: a) gradës diplomatike të emërimit. Sa i përket emërimit të diplomatëve në MEPJ, është marrë në konsideratë kontributi dhe përvoja e gjatë e punës në fushat përkatëse sipas drejtorive ku janë emëruar, që ka sjellë përmirësim në proceset e punës.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Edhe pse pagesa e personave të emëruar kryhet sipas gradës së tyre personale dhe jo sipas gradës së emërimit, emërimi i tyre në këto pozicione është në kundërshtim të plotë me pikën 3), neni 39, Ligji Nr. 23/2015, duke mosrespektuar edhe parimet bazë të shërbimit të jashtëm, përkatësisht atë të paanësisë dhe të korrektësisë në zbatimin e legjislacionit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen: Te gjitha misionet diplomatike dhe postet konsullore funksionojne pa nje strukture personeli te miratuar, si dhe nuk disponohet asnje marrëveshje e lidhur me shtet pritse mbi percaktimin e numrit te personelit ne keto struktura, ne kundërshtim me pika 2, neni 21, ligji Nr. 23/2015 "Per shërbimin e jashtem te Republikës se Shqiperise".

Pranohet pjesërisht.

Sqarim: Në varësi të prioriteteve dhe zhvillimit të politikës së jashtme, edhe struktura e përfaqësive mund të ndryshojë. Në këto raste, duhet një konsultim me shtetin pritës, ndërsa sa i takon numrit të punonjësve, ai është i përcaktuar në marrëveshje me shtetin pritës, sipas nevojave.Si rregull, çdo akreditim i një diplomati të emëruar në përfaqësi, lejohet nga shteti pritës vetëm si zëvendësim, brenda numrit të aprovuar të personelit. Në rast të kundërt, nëse ka shtesa në numrin e punonjësve, duhet miratim dhe regjistrim paraprak nga shteti pritës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen: Plani nje vjecar i emërimeve/mbarimit te detyres ne misione diplomatike dhe poste konsullore.

U konstatua se per vitin 2020 nuk eshte hartuar plan lidhur me emerimet/mbarimet te detyres ne misione diplomatike dhe poste konsullore. Nuk pranohet.

Sqarim: Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, çdo vit është përgatitur dhe përcjellë plani 1-vjeçar i emërimeve/mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen: Nga auditimi me zgjedhje, ne lidhje me plotesimin e kushteve ligjore per rekrutimin dhe ushrimin e detyres se kreve te misioneve diplomatike, rezultoi se nje punonjes me pozicion Ambasador, ka qene bashkepunetor i Sigurimit te Shtetit. Gjithashtu vijon te ushtroje detyren si Amasador edhe pse ka mbushur moshën e pensionit.

Pranohet pjesërisht.

Sqarim: Rasti ka qenë punonjës në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit dhe jo bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit i cili është paraqitur personalisht pranë Autoritetit të Dosjeve dhe ka dhënë sqarimet përkatëse. Për rastet e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, janë marrë masat për lirim/largimin e tyre nga Shërbimi i Jashtëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen: Nga shqyrtimi i procesverbaleve te mbledhjeve te KKD, rezulton se KKD shyrton edhe vleresimet e eproreve direkt, strukturave trajnuese te MPJ, te cilat nuk i ka detyre funksionale, po detyrë ka vetem vleresimin etiko-profesional, referuar parashikimeve te Seksionit 2, VKM 816/2015. Nga ana e Ministres nuk rezulton te jete marre asnje vendimmarrje lidhur me propozimet e kryera brenda afatit ligjore tre ditor, veprim ne kundërshtim me pikën 15, Seksioni 2, VKM 816/2015 (lidhur me propozimet e bera nga KKD per graden Ambasador). Pranohet pjesërisht.

Sqarim: KKD nuk hyn në detaje, apo merr vendim mbi vlerësimin e eprorit direkt apo strukturës trajnuese të MEPJ, por njihet me to në kuadër të realizimit të vlerësimit etiko-profesional.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin

e projekraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: Nga auditimi me zgjedhje, konstatohet se 65 anëtarë të personelit të misioneve diplomatike kanë vijuar të mbajnë poste pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore edhe pse ka përfunduar afati 3-vjecar, duke tejkaluar këtë afat qëndrimi në shumë raste deri në afërsisht 9 vjet, në kundërshtim me pikën 2, neni 41, ligji nr. 23/2015. Nuk pronohet **Sgarim:** Procedura e ndjekur për emërimin e diplomatëve në pozicione të ndryshme në MEPJ dhe përfaqësi diplomatike është bazuar në ligjin 23/2015, neni 53, pika 1: Paga e diplomatit të karrierës, i cili punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që ai kryen; Paga e diplomatit të emëruar pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në bazë të: a) gradës diplomatike të emërimit.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Edhe pse pagesa e 65 personave të emëruar kryhet sipas gradës së tyre personale dhe jo sipas gradës së emërimit, vijimi i ushtrimit të detyrës së tyre në këto pozicione është në kundërshtim të plotë me pikën 2, neni 41, Ligji Nr. 23/2015, duke mosrespektuar edhe parimet bazë të shërbimit të jashtëm, përkatësisht atë të paanësisë dhe të korrektësisë në zbatimin e legjislacionit, si dhe duke mos lejuar për një kohë shumë të gjatë rotacion.

Titulli i gjetjes 27	Parregullsi lidhur me stafin e strukturës së MEPJ
<p>Situata:</p>	<p>Nga auditimi është konstatuar se:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultojnë 21 (njëzetë e një) vende vakante në strukturën e MEPJ, për të cilat nuk disponohet asnjë dokument justifikues për të filluar procedurat e rekrutimit dhe plotësimit të vendeve. Ndër këto, Sektori i Çështjeve Tematik i planifikuar me një strukturë 1+3 (aktualisht kthyer në drejtori 1+4), rezulton i plotësuar vetëm me një punonjës; Katër prej punonjësve të rekrutuar përgjatë periudhës Janar 2020-Shtator 2022 në sistemin e karrierës diplomatike, figurojnë të dërguar në misione diplomatike. Procedura për dërgimin e tyre në misione diplomatike është kryer me anë të njoftimit nëpërmjet postës elektronike nga DBNj drejtuar vetëm stafit të MEPJ, duke përjashtuar në këtë mënyrë personelin e pozicionuar në misione diplomatike apo poste konsullore, të cilët gjithashtu mund të shprehin interesin për pozicionet e krijuara. Pas përcjelljes së kërkesave nga punonjësit e interesuar, DBNj përmbledh në formë tabelare të gjithë informacionin e detajuar mbi secilin prej tyre. Nuk administrohet asnjë gjurmë auditiv/dokumentar lidhur me vendimmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm, në cilësinë e strukturës vlerësuese dhe përzgjedhëse të kandidatave dhe paraqitjen pranë Ministres për miratim, në kundërshtim me pikën 5 dhe 6, Kreu VII, VKM nr. 816/2015; Për dymbëdhjetë punonjës të rekrutuar, procedura për përfitimin gradës “Atashe”, ka filluar për një periudhë mbi një muaj më vonë se përfundimi i periudhës së provës, duke mos respektuar afatin <u>jo më vonë se një muaj</u> përpara përfundimit të provës, në kundërshtim me shkronjën d), pika 2, Seksioni 2, VKM 816/2015;

	4.Nga auditimi me zgjedhje, rezultojnë se në strukturën e MEPJ, 3 (tre) pozicione janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave, veprime në kundërshtim me pikën 3), neni 39, Ligji Nr. 23/2015.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, neni 39, pika 3; - VKM nr. 816, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë”, pika 5 dhe 6, Kreu VII; shkronja d), pika 2, seksioni 2;
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mungesa e plotësimit të vakancave sjell rezultate jo të mira në ushtrimin e funksioneve të MEPJ;</p> <p>-Mos ndjekja e procedurës sipas kuadrit ligjor lidhur me emërimin e stafit në struktura të Misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, sjell mungesë transparence në kryerjen e këtij procesi;</p> <p>-Vonesa në fitimin e gradës “Atashe” për punonjësit që kanë kaluar periudhën e provës, sjell vonesë në fitimin e gradave të tjera më të larta të cilat varen ndër të tjera nga periudha që ka kaluar pas fitimit të gradës “Atashe”;</p> <p>-Mos përputhja e gradës së emërimit me gradën personale sjell mangësi në kryerjen e proceseve të punës.</p>
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat përkatëse
Rekomandim:	<p>-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e vakancave të krijuara.</p> <p>-Për të gjitha lëvizjet e reja nga pozicione në strukturën e MEPJ drejt misioneve diplomatike apo posteve konsullore të ndiqet procedura sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>-Strukturat përkatëse në MEPJtë organizohen dhe koordinohen në mënyrë që në vijim vendimet e KKD, të eprorit direkt dhe të strukturës trajnuese, për përfitimin e gradës “Atashe” të përcillen pranë Ministres jo më vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës.</p> <p>-Të merren masa për zëvendësimin e punonjësve në tre pozicionet në të cilat janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i gjetjes 28	Problematika lidhur me stafin e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore
Situata:	<p>Nga auditimi është konstatuar se:</p> <p>1. Të gjitha misionet diplomatike dhe postet konsullore funksionojnë pa një strukturë personeli të miratuar, si dhe nuk disponohet asnjë marrëveshje e lidhur me shtetet pritëse mbi përcaktimin e numrit të personelit në këto struktura, në kundërshtim me pika 2, neni 21, ligji Nr. 23/2015;</p>

2. Përgjatë tre viteve, 2020-2022 MEPJ nuk ka të miratuar plan një vjeçar të emërimeve/mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore nga Ministria, në cilësinë e personit përgjegjës për këtë vendimmarrje. Emërimet/mbarimet e detyrës së stafit në misione diplomatike dhe poste konsullore kryhen pa asnjë plan të miratuar, në kundërshtim me parashikimet e Kreu VII, Seksioni 4, i VKM nr. 816/2015;

3. Nga auditimi me zgjedhje, konstatohet se 11 (njëmbëdhjetë) prej anëtarëve të personelit të misioneve diplomatike vijojnë të kryejnë funksione diplomatike edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit, si dhe gjithashtu vijojnë të mbajnë statusin e diplomatit, i cili duhet t'iu humbiste me plotësimin e moshës së pensionit, si dhe gjithashtu edhe një punonjës i stafit të MEPJ, në kundërshtim me shkronjën e), pika 1, neni 42, dhe shkronjën c), neni 45, ligji Nr. 23/2015;

4. Nga auditimi me zgjedhje, konstatohet se 64 (gjashtëdhjetë e katër) anëtarë të personelit të misioneve diplomatike kanë vijuar të mbajnë poste pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore edhe pse ka përfunduar afati 3 vjeçar, në kundërshtim me pikën 2, neni 41, ligji Nr. 23/2015;

5. Nga auditimi me zgjedhje, në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për rekrutimin dhe ushtrimin e detyrës së kreve të misioneve diplomatike, rezultoi se një punonjës me pozicion Ambasador, rezultoi se ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. Gjithashtu vijon të ushtrojë detyrën si Amasador edhe pse ka mbushur moshën e pensionit. Veprime në kundërshtim me shkronjën e), pika 1, neni 42, dhe shkronjën c), neni 45, ligji Nr. 23/2015, si dhe kreu IX, VKM nr. 816/2015;

6. Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se një Ambasadë drejtohej nga diplomat me gradë personale Sekretar i Tretë, i emëruar në pozicionin i ngarkuar me punë a.i, në cilësinë e kreut të misionit, meqënëse ky mision në atë kohë ndodhej në rastin e mungesës së përkohshme të kreut të misionit, e si rrjedhojë jo detyrimisht duhet që i ngarkuari me punë të ketë gradën jo më pak se Këshilltar. Këtë detyrë vijon ta ushtroj edhe aktualisht, pra afërsisht për një periudhë 2 vjet e tre muaj. Në kuptim të nenit 26, të ligjit nr. 23/2015, procedura e drejtimit të misionit diplomatik i kalojnë si rregull diplomatit me gradën më të lartë, me përjashtim të rasteve të vecanta ku lejohen edhe me gradë më të ulët se Këshilltar, përkatësisht në rastet e mungesës së përkohshme të kreut të misionit. Duke mbajtur në konsideratë këtë dispozitë dhe faktin se nuk është ndërmarrë asnjë procedurë për emërimin në këtë pozicion të diplomatëve me gradën përkatëse, rasti konkret në të cilin kanë kaluar afërsisht 2 vjet e tre muaj, nuk mund të konsiderohet dhe/apo të përbëjë shkak që kjo të konsiderohet si fazë e përkohshme, duke bërë që misioni diplomatik, të drejtohet në kundërshtim me pika 1, neni 27, ligji Nr. 23/2015;

	<p>7. Në zbatim të pikës 3 dhe 4, neni 31, Ligji Nr. 23/2015, Ministrit të Punëve të Jashtme i njihet e drejta të emërojë në misionet diplomatike dhe postet konsullore, <u>në raste të vecanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit.</u> Nga auditimi me zgjedhje, rezultoi se në përfaqësitë diplomatike janë emëruar 28 (njëzetë e tetë) punonjës, në cilësinë e ekspertëve, të cilët gëzojnë statusin e diplomatit në misionet diplomatike për aq kohë sa punojnë pranë këtyre misioneve. Për këta ekspertë, nuk rezulton asnjë gjurmë dokumentare, se përse konsiderohen raste të vecanta, çfarë njohurish dhe ekspertize zotërojnë, cila është procedura e hapjes së thirrjes për nevoja të rekrutimit të këtyre lloj ekspertëve dhe të dhëna të ngjashme, duke mundësuar rekrutimin e tyre pa një procedurë transparente, në kundërshtim me parashikimet e nenit 4, neni 5, ligji Nr. 23/2015;</p> <p>8. Në strukturën e misioneve diplomatike ushtrojnë funksion:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ 65 (gjashtëdhjetë e pesë) diplomatë nuk ju përputhet grada emërore me gradën personale; ✓ 52 (pesëdhjetë e dy) punonjës janë emëruar nga jashtë sistemit; ✓ 18 (tetëmbëdhjetë) diplomatë të cilëve ju përputhet grada emërore me gradën personale; ✓ 4 (katër) punonjës janë të ngarkuar me punë. <p>Pra, pjesa më e madhe e diplomatëve ushtrojnë funksion diplomatik në misione diplomatike dhe grada emërore e tyre nuk përputhet me gradën personale, në kundërshtim me shkronjën c), neni 50, Ligji nr. 23/2015.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, neni 21, pika 2; shkronja e), pika 1, neni 42; shkronja c), neni 45; pika 2, neni 41; shkronja e), pika 1, neni 42; shkronja c), neni 45; pika 1, neni 27; neni 4, neni 5; shkronja c), neni 50. - VKM nr. 816, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë”, Kreu VII, Seksioni 4.
Ndikimi/Efekti:	<p>-Funksionimi pa asnjë strukturë emërore dhe pa asnjë plan vjetor mbi emërimet/mbarimet e detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore sjell mungesë transparence dhe abuzim në emërimet pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore;</p> <p>-Mbajtja e pozicioneve dhe statusit të diplomatit edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit, gjithashtu dhe në mbështetje të faktit se numri i diplomatëve që mund të përfitojnë grada si ambasadorë, ministër fuqiplotë, ministër këshilltarë është i limituar çënojnë vazhdimësinë e karrierës për diplomatët të cilëve nuk ju jepet mundësia për marrjen e gradave edhe pse i plotësojnë kriteret ligjore, parimin e paanësisë si dhe korrektësisë së zbatimit të legjislacionit;</p> <p>-Mbajtja e posteve pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore edhe pse ka përfunduar afati 3 vjecar, ndikon në mungesën e rotacionit dhe të drejtën e të gjithë punonjësve pjesë të shërbimit të</p>

	<p>jashtëm të Republikës së Shqipërisë për tu pozicionuar në këto pozicione, duke cënauar parimin e vazhdimësisë së karrierës;</p> <p>-Rekrutimi i punonjësve si raste të vecanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, pa një procedurë transparente sjell abuzime në emërimet;</p>
Shkak:	Neglizhencë nga strukturat përkatëse.
Rekomandim:	<p>-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për miratimin e strukturave të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, si dhe për cdo rast për përcaktimin e numrit të personelit në këto struktura të lidhi marrëveshje me shtetet pritëse.</p> <p>-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme, që për cdo vit të miratoj plane një vjecare të emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike dhe poste konsullore nga Ministria.</p> <p>-Të merren masa për largimin nga pozicionet e emërimit dhe heqjen e statusit të diplomatit të njëmbëdhjetë anëtarëve të personelit të misioneve diplomatike, të cilët vijojnë të kryejnë funksione diplomatike edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit. Të merren masa për largimin nga pozicioni i emërimit për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit në MEPJ.</p> <p>-Të merren masa për largimin nga postet pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, për gjashtëdhjetë e katër anëtarë të personelit të misioneve diplomatike apo poste konsullore të cilët vijojnë të mbajnë postet edhe pse ka përfunduar afati 3 vjeçar.</p> <p>-Të merren masa zëvendësimit nga detyra dhe heqje të statusit të diplomatit të punonjësit që rezulton se ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit.</p> <p>-Të merren masa për zëvendësimit nga detyra si kreu i misionit diplomatik, të diplomatit me gradë personale Sekretar i Tretë, i emëruar në pozicionin i ngarkuar me punë a.i, i cili vijon ta ushtroj këtë detyrë vijon për një periudhë mbi 2 vjet.</p> <p>-Të ngrihet grup pune me qëllim verifikimin nëse 28 (njëzetë e tetë) punonjësit e emëruar si raste të vecanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Në varësi të përfundimit të arritur prej grupit të merren masa për qëndrimin e mëtejshëm të tyre në atë pozicion apo largimin e tyre.</p> <p>-Të merren masa për largimin nga pozicionet e punës së 65 (gjashtëdhjetë e pesë) diplomatëve të cilët punojnë pranë misioneve diplomatike dhe nuk ju përputhet grada emërore me gradën personale dhe vendosjen në pozicione të tjera pune në të cilat ju përputhet grada emërore me gradën personale.</p> <p>-Të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e udhëzimeve që do të vijnë në ndihmë për zbatimin me korrektësi të dispozitave të ligjit të posaçëm, lidhur me procedurat e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm, afati maksimal i qëndrimit në pozicionin e kreut të misionit diplomatik në situata të përkohshme, rotacionet e emërimeve në përfaqësi, si dhe cdo problematikë tjetër e konstatuar për të cilën kuadri</p>

	ligjor aktual nuk është shprehur, apo lë vend për interpretim, duke shmangur në këtë mënyrë mungesën e theksuar të transparencës dhe vendimmarrjes subjektive.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i gjetjes 29	Parregullsi lidhur me Komisionin e Karrierës Diplomatike dhe vendimmarrjen e Ministres për dhënien e gradave diplomatike.
Situata:	<p>Nga auditimi është konstatuar se:</p> <p>1. Nga grupi i auditimit është përzgjedhur për tu shqyrtuar dosja e Komisionit të Karrierës Diplomatike për vitin 2021, lidhur me vlerësimin etiko-profesional të punonjësve të rekrutuar në sistemin e karrierës diplomatike, si dhe mënyrën e organizimit dhe procedurat e ndjekura nga KKD. Nga shqyrtimi i dosjeve u konstatua se mbledhja e Komisionit të Karrierës Diplomatike (KKD) është realizuar në të gjitha rastet e punonjësve të rekrutuar me vonesë dhe në mospërputhje me parashikimet e shkronjës d, pika 2, Seksioni 2, VKM 816/2015,</p> <p>2. Gjatë mbledhjes së datës 16.07.2021, KKD e mbledhur në zbatim të urdhërit nr. 300, datë 8.7.2021 të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ndër të tjera KKD pas shqyrtimit të plotësimit të kritereve ligjore ka vendosur për ti propozuar Ministrit dhënien e gradës “Ambasador” dhe propozimin nga kjo e fundit të Presidentit të Republikës me qëllim dhënien e gradës “Ambasador” për 4(katër) diplomat karriere. Procesverbali i është përcjellë Ministres me anë të Memorandumit për vendimmarrje nr. 227 prot., datë 19.07.2021. Nga ana e Ministres nuk rezulton të jetë marrë asnjë vendimmarrje lidhur me propozimet e kryera brenda afatit ligjore tre ditor, veprim në kundërshtim me pikën 15, Seksioni 2, VKM 816/2015.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - VKM nr. 816, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë”, shkronja d, pika 2, Seksioni 2; pika 15, Seksioni 2.
Ndikimi/Efekti:	<ul style="list-style-type: none"> -Vonesa në mbledhjen e KKD, sjell vonesa në fitimin e gradave diplomatik për personelin pjesë të Shërbimit të Jashtëm; -Mungesa e një vendimmarrje nga ana e Ministres, sjell vonesa në dhënien e gradave diplomatike të diplomatëve të cilët i kanë përmbushur të gjitha kriteret ligjore për ta përfutur.
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat përkatëse
Rekomandim:	<ul style="list-style-type: none"> -Komisionit të Karrierës Diplomatike, të marrë masa për të zhvilluar mbledhjet brenda afateve ligjore dhe pa vonesa. -Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për marrjen e një vendimmarrje dhe përcjelljen pranë Presidentit të Republikës me qëllim dhënien e gradës “Ambasador” për 4 (katër) diplomat karriere.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare:

3.1 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë

Nga auditimi i likuidimeve të kryera me bankë janë konstatuar disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, janë konstatuar mos përputhje me datave të lëvizjes dhe ceremonive sipas protokollit, janë konstatuar vizita studimore në ditë pushimi shtune e të djela, janë konstatuar pagesa në Euro (konvertuar jo sipas kursit të bankës së Shqipërisë). Janë konstatuar 3 blerje emergjente karburanti në datat 01.06.2022 me vlerë 119,974 lekë, më 08.06.2022 me vlerë 119,786 lekë dhe 14.06.2022 me vlerë 119,970 lekë.

Me urdhër shpenzimit datë 19.05.2022 tërheqje paradhënie dietash në vlerën 1,225,000 lekë e konvertuar në 10,000 euro nga Banka C. me kurs 122,5 lek = 1 euro datë 19.05.2022 ndërkohë që në këtë periudhë kursi i këmbimit në Bankën e Shqipërisë 1 euro = 120.21 lekë, pa kërkuar një kurs preferencial nga bankat e nivelit të dytë. Urdhër shpenzimi datë 13.06.2022 paradhënie dietash në vlerën 1,215,000 lekë e konvertuar në 10,000 euro nga Banka C. me kurs 121,5 lek = 1 euro datë 13.06.2022 ndërkohë që në këtë periudhë kursi i këmbimit në Bankën e Shqipërisë 1 euro = 119.93 lekë.

Janë paguar me urdhër shpenzimit nr. 367 datë 10.05.2022 shpenzimet përmbartimore dhe detyrimet gjyqësore ndaj ish punonjëses B.D, në vlerën 2,559,193 nga e cila shpenzime përmbartimore kapin shumën 585,534 lekë të cilat kanë një efekt financiar negative për buxhetin e MEPJ.

Me urdhër shpenzimit nr 607 datë 12.10.2021 MEPJ ka paguar një gjobë nga sigurimet shoqërore për deklaram të vonuar sipas urdher pagesës 1900 me vlerë 5000 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.

Me urdhër shpenzimit nr 608 datë 12.10.2021 MEPJ ka paguar një gjobë nga sigurimet shoqërore për deklaram të vonuar sipas urdhër pagesës 1900 me vlerë 5000 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.

Me urdhër shpenzimit nr 701 datë 18.11.2021 MEPJ ka paguar një gjobë nga sigurimet shoqërore për deklaram të vonuar sipas urdhër pagesës 1900 me vlerë 5000 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.

Me urdhër shpenzimit nr 670 datë 11.11.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 33 datë 26.10.2021 për pagesën e disa produkteve për pritje përcjellje për zyrën e Ministrisë me vlerë 117,500 lekë duke përdorur procedurën emergjente, e pa justifikuar për periudhën dhe natyrën e produkteve të likuiduara, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e Blerjeve me Vlerë të Vogël.

Me urdhër shpenzimit nr 671 datë 11.11.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes 210/2021 për pagesën e disa produkteve pastrimi me vlerë 116,700 lekë duke përdorur procedurën emergjente,

e pa justifikuar për periudhën dhe natyrën e produkteve të prokuruar, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e Blerjeve me Vlerë të Vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 687 datë 18.11.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 380 datë 17.08.2021 për pagesën e disa produkteve kancelarike për zv. Ministrin me vlerë 8,800 lekë duke përdorur procedurën emergjente. Kjo kërkesë është e pa justifikuar duke parë kërkesën nga ZV Ministri që mban datën 23.07.2021 dhe datën e procesverbalit të emergjencës 17.08.2021, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e Blerjeve me Vlerë të Vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 689 datë 18.11.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 388 datë 05.11.2021 për pagesën e disa produkteve kancelarike për zv. Ministrin me vlerë 3,200 lekë duke përdorur procedurën emergjente, e pa justifikuar duke parë kërkesën nga ZV Ministri që mban datën 23.07.2021 dhe datën e procesverbalit të emergjencës 05.11.2021, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e Blerjeve me Vlerë të Vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 660 datë 08.11.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 353/2021 për pagesës e biletave të avionit Tiranë-Romë-Tiranë duke përdorur procedurën emergjente, Procesverbali i rastit të emergjencës mban nr, 70 prot datë 05.10.2021 duke iu referuar komunikimeve me email për blerjen e biletave. Ndërkohë që urdhri për shërbim jashtë shteti mban nr. 14288 prot datë 13.10.2021, edhe pse në dijeni të plotë të situatës Sekretari i përgjithshëm nxjerr urdhërin për shërbim jashtë shtetit pas kryerjes së vizitës, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Sekretarin e Përgjithshëm për nxjerrjen e urdhërit me vonesë.

Me urdhër shpenzimin nr 718 datë 24.11.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 163 2021 datë 11.11.2021 për pagesës e 'gjelberim ambjenti te MEPJ' me vlerë 119,400 lekë duke përdorur procedurën emergjente, e pa justifikuar duke parë natyrën e shpenzimeve dhe kohën, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e Blerjeve me Vlerë të Vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 749 datë 10.12.2020 MEPJ ka paguar një gjobë nga tatimet për deklarim të vonuar sipas urdhër pagesës 1500 me vlerë 5000 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiar negative për MEPJ.

Me urdhër shpenzimin nr 750 datë 10.12.2020 MEPJ ka paguar një gjobë nga sigurimet shoqërore për deklarim të vonuar sipas urdhër pagesës 1900 me vlerë 5000 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.

Me urdhër shpenzimin nr 751 date 10.12.2020 MEPJ ka paguar një gjobë nga sigurimet shoqërore për deklarim të vonuar sipas urdhër pagesës 1900 me vlerë 5000 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.

Me urdhër shpenzimin nr 774 datë 11.12.2020 është paguar kamat vones për pagesën e energjisë elektrike në vlerën 25,986 lekë e cila konsiderohet efekt financiar negativ për MEPJ, kjo kamatë është akumuluar nga pagesat me vonesë të shërbimit të energjisë elektrike për muajt dhjetor 2018, Shkurt 2020 dhe shtator 2020. Gjithashtu pritet të aplikohet kamatë dhe për pagesën e muajit tetor 2020 pasi rezultoi si principal i pa shlyer edhe pse jemi në muajin dhjetor.

Me urdhër shpenzimin nr 806 datë 16.12.2020 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 2129 datë 07.12.2020 për likuidimin e procedurës së prokurimit Marrëveshje kuadër "Përkthim i legjislacionit evropian" me vlerë 6,913,922 lekë me TVSH. Nga auditimi i kontratës nr. 521 prot

datë 20.10.2020 u konstatua se ky shërbim duhet të kishte përfunduar më 03.12.2020 sipas nenit 3 pika 3.1 të kontratës. Nga dorëzimi me vonesë i materialeve OE ekonomik duhet të paguante një penalitet prej 6,913,922 lekë x 4/1000 x 4 ditë = 110,622 lekë që konsiderohet efekt financiarë negative dhe ngarkon me përgjegjësi E.H dhe B.Dh si monitorues të kontratës dhe hartues të memorandumit për vendimmarrje drejtuar z. A.S për pagesën e faturës.

Me urdhër shpenzimin nr 755 datë 09,12,2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 36 datë 11,11,2019 me vlerë 481,584 lek, fotokopjo e sigluar me vulë të Drejtorisë së Shërbimeve qeveritare sipas një kontrate qiraje nr. 4984/1 datë 08.11.2019, një likujdim me shumë vonesë dhe me dokumentacion jo original.

Me urdhër shpenzimin nr 761 datë 14.12.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 37/2021 datë 06.12.2021 me vlerë 338,670 lekë me objekt “Përkthim materialesh” sipas kontratës nr. 33 datë 06.12.2021 nënshkruar midis A.S si titular dhe R.Gj si përkthyes ofrimit të shërbimit.

Nga analizimi i kontratës vihet re se në nenin 7 pika 7.2 vlefshmëria e kontratës më saktë afati i kryerjes së shërbimit nga ana e MEPJ është lënë i hapur, pa një afat maksimal të ditëve që ky operator duhet të kryej këtë shërbim, madje nga analizimi i dokumentacionit bashkangjitur rezulton se kjo kontratë mban datën 06.12.2021, po në të njëjtën datë nga ana e MEPJ është mbajtur procesverbali nr. 33/1 datë 06.12.2021 për marrjen në dorëzim të materialeve të përkthyer. Në praktik nuk gjendet asnjë gjurmë e dokumentacionit të dorëzuar, afatin e dorzimit dhe të kryerjes e tij.

Me urdhër shpenzimin nr. 113 datë 16.02.2022 është likujduar fatura nr. 27/2020 datë 13.01.2022 me vlerë 260,000 lekë për shpenzime qira ambjenti muaji janar 2022” sipas kontratës nr 114 datë 04.01.2021 me shoqërinë “L. Shpk” dhe “Qendrës së studimeve dhe publikimeve për Arbëreshët” përfaqësuar nga D.K e cila sipas pikës 1,1 të kontratës vlefshmëria e kësaj kontrate është deri më 31.12.202. Pra, për muajin janar 2022 kjo kontratë nuk ka fuqi juridike, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi D.K si drejtuese e QSPA e cila pranon dhe sjellë për pagesë një faturë pa kontratë efektive sipas urdhrin nr. 4/1 datë 09.02.2022 për kryerje pagese.

-Me urdhër shpenzimin nr 94 datë 07.02.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 4/2022 datë 20.01.2022 me vlerë 564,200 lekë me objekt “Përkthim materialesh” sipas kontratës nr. 1 datë 19.01.2022 nënshkruar midis A.S si titular dhe R.Gj si përkthyes e ofrimit të shërbimit.

Nga analizimi i kontratës vihet re se në nenin 7 pika 7.2 vlefshmëria e kontratës më saktë afati i kryerjes së shërbimit nga ana e MEPJ është lënë i hapur, pa një afat maksimal të ditëve që ky operator duhet të kryej këtë shërbim, madje nga analizimi i dokumentacionit bashkangjitur rezulton se kjo kontratë mban datën 19.01.2022, po në të njëjtën datë nga ana e MEPJ është mbajtur procesverbali nr. 1/1 datë 19.01.2022 për marrjen në dorëzim të materialeve të përkthyer. Në praktik nuk gjendet asnjë gjurmë e dokumentacionit të dorëzuar, afatin e dorzimit dhe të kryerjes e tij.

-Me urdhër shpenzimin nr 95 datë 07,02,2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 3/2022 datë 20.01.2022 me vlerë 636,090 lekë me objekt “Përkthim materialesh” sipas kontratës nr. 2 datë 19.01.2022 nënshkruar midis A.S si titular dhe R.Gj si përkthyes ofrimit të shërbimit.

Nga analizimi i kontratës vihet re se në nenin 7 pika 7.2 vlefshmëria e kontratës më saktë afati i kryerjes së shërbimit nga ana e MEPJ është lënë e hapur, pa një afat maksimal të ditëve që ky operator duhet të kryej këtë shërbim, madje nga analizimi i dokumentacionit bashkangjitur rezulton se kjo kontratë mban datën 19.01.2022, po në të njëjtën datë nga ana e MEPJ është mbajtur procesverbali nr. 2/1 datë 19.01.2022 për marrjen në dorëzim të materialeve të përkthyer. Në praktik nuk gjendet asnjë gjurmë e dokumentacionit të dorëzuar, afatin e dorzimit dhe të kryerjes e tij.

Blerjet e vogla.

Nga auditimi në sistemin SPE të procedurave të prokurimit, janë marrë në analizë regjistrat e parashikimit dhe kryesisht të realizimi të procedurave ku në total sipas viteve janë realizuar:

-Për vitin 2022 nga 26 janë realizuar 14 procedura me fond 8,433 mijë lekë, këtu nuk përfshihen blerjet shkresore deri në 100,000 lekë të cilat të parashikuara janë 20 procedura.

Janë konstatuar 3 procedura prokurimi emergjente të njëpasnjëshme blerje karburanti për shkak të mos realizimit të procedurës nga ABP por që nuk e justifikon situatën me blerje emergjente.

-Për vitin 2021 nga 25 janë realizuar 17 procedura me fond 9,433 mijë lekë, këtu nuk përfshihen blerjet shkresore deri në 100,000 lekë të cilat të parashikuara janë 17 procedura.

Janë konstatuar dy procedura me fond 800,000 lek secili të së njëjtes natyrë që AK duhet të realizonte në procedurë prokurimi të madhe, kemi “Punime ndërtimi në funksion të ashensorit” me fond prej 800,000 lek dhe procedurën “Heqje ashensori dhe përgatitje e strukturës mbajtëse metalike” me fond 800,000 lek.

Nga auditimi i procedurave të së njëjtës natyrë të ndara nga AK kemi një rritje të kostove për këto procedura për zërin *‘Mbulimi i sheshpushimeve me karton firzamonike dhe panele druri, për mbrojtjen e mermerit’* me sipërfaqe 120 m2 e cila është dubluar për shkak të ndarjes së procedurës. Këtë zë e kemi dhe në procedurën e *‘Punime ndërtimi në funksion të ashensorit’* edhe në procedurën e *‘Heqje ashensori dhe përgatitje e strukturës mbajtëse metalike’*.

MEPJ ka kryer procedurën e prokurimit “Blerje dhe vendosje ashensori” me fond limit 2,480,000 lekë, copëzimi apo ndarja e procedurës në një procedurë të hapur të thjeshtuar dhe dy procedura blerje me vlerë të vogël është në kundërshtim me nenin 56 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 paragrafi i dytë, dhe ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK dhe Komisionin e blerjeve me vlerë të vogël.

-Me urdhër shpenzimin nr 814 datë 23.12.2021 është likujduar fatura me vlerë 864,000 lek me tvsh nga subjekti I. shpk për realizimin e punimeve në procedurën e prokurimit blerje e vogël “Punime ndërtimi në funksion të ashensorit”.

Me urdhër prokurimin nr 5 datë 08.07.2021 titullari I AK A.S ka nxjerrë urdhër prokurimin për kryerjen e procedurës “Punime ndërtimi në funksion të ashensorit”

Me shkresën nr. 5/1 datë 08.07.2021 titullari i AK ka miratuar ftesën për ofertë së bashku me kriteret përkatëse si dhe zërat e punimeve si më poshtë:

Nr.	Emërtimi punimve	Njësia	Sasia
1	Mbulim i shesh-shpushimit me karton fizarmonik dhe panele druri, për mbrojtje mermeri	m ²	120
2	Prishja e suvatimit të vjetër, pastrami I fugave. Larja e murit të tullës	m ²	400
3	Sprucim me granil të thyer dhe cemento	m ²	400
4	Suvatim rëre guri	m ²	400
5	Prishje mur tulle	m ³	5
6	Pastrim, transport mbeturina inerte	m ³	17
7	Arkitra betoni dhe strukturë hekuri	m ³	1.2
8	Granit star galaxy, trashësia 3 cm. Për shpatullat e hyrjes në ashensor	m ²	40

...Afati I lëvrimin të mallrave, punëve ose shërbimeve **do të jetë brenda 20 ditësh.**

Në realizimin e procedurës nga auditimi në sistem SPE dhe në dosje kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë:

I.shpk me ofertë 720,000 lekë

S.Rr me ofertë 755,000 lekë

M. B me ofertë 776,000 lekë

Pas realizimit të procedurës me shkresën nr. 5/5 datë 12.07.2021 AK ka nxjerrë njoftimin e fituesit me operator ekonomik "I. shpk"

Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua se realizimi i mallrave/punimeve është kryer me shumë vonesë nga data e shpalljes së fituesit sipas shkresës nr 5/5 datë 12.07.2021 situacioni i paraqitur nga OE mban datën 21.12.2021 pra rreth 3 muaj me vonesë ose 100 ditë me vonesë nga ftesa për ofertë që kjo procedurë duhet të realizohet brenda 20 ditësh.

Edhe pse me vonesë nga AK nuk është përlogaritur asnjë penaltet për OE "I shpk" 864,000 lek 4/1000 x 100 ditë = 345,600 lekë penaltet i pa mbajtur.

Gjithashtu në zërat e punimeve kemi shumë zëra të pa nevojshëm ose të dubluar pasi me urdhër shpenzimin n. 815 datë 23.12.2021 është kryer përsëri një likujdim për punime të ngjashme me operator të njëjtë si më poshtë.

-Me urdhër shpezimin nr 815 datë 23.12.2021 është likujduar fatura me vlerë 732,000 lekë me tvsh nga subjekti I. shpk për realizimin e punimeve në procedurën e prokurimit blerje e vogël "Heqja e ashensorit dhe pregatitja e strukturës mbajtëse".

Me urdhër prokurimin nr 6 datë 08.07.2021 titullari I AK A.S ka nxjerr urdhër prokurimin për kryerjn e procedurës "Heqja e ashensorit dhe pregatitja e strukturës mbajtëse"

Me shkresën nr. 6/1 datë 08.07.2021 titullari I AK ka miratuar ftesën për ofertë së bashku me kriteret përkatëse si dhe zërat e punimeve si më poshtë:

Nr.	Emertimi punimve	Njësia	Sasia
-----	------------------	--------	-------

1	Mbulim i sheshshpushimit me karton fizarmonik dhe panele druri, për mbrojtje mermeri	m ²	120
2	Cmontim I ashensorit, depozitimi i pjesëve në magazin	set	1
3	Profil perimetral U-10 10.2 kg/ml. Do të vendoset në cdo 1.1 m të lartësisë së kafazit të ashensorit në perimetrin e brendshëm të tij. Lidhja me saldime e këndeve në cdo plan. Furnizim vendosje	ml	140
4	Bullona Ekspansion M/6, 1160. Furnizim vendosje.	copë	160
5	Shina kundërpeshë, 50x50x5 mm. Furnizim vendosje	ml	40
6	Shina gabine, 70x65x9mm. Furnizim vendosje	ml	40
7	Skele metalike për kafazin e ashensorit	m ²	40

... Afati I lëvrimit të mallrave, punëve ose shërbimeve **do të jetë brenda 20 ditësh.**

Në realizimin e procedurës nga auditimi në sistem SPE dhe në dosje kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë:

I shpk me ofertë 610,000 lekë

Mbi fondin limit

S. Rr me ofertë 755,000 lekë

K-AAV me ofertë 988,000 lekë

Pas realizimit të procedurës sipas sitemit SPE datë 12.07.2021 AK ka nxjerrë njoftimin e fituesit me operator ekonomik "I. shpk"

Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua se realizimi i mallrave/punimeve është kryer me shumë vonesë nga data e shpalljes së fituesit sipas SPE datë 12.07.2021 situacioni i paraqitur nga OE mban datën 21.12.2021 pra rreth 3 muaj me vonesë ose 100 ditë me vonesë nga ftesa për ofertë që kjo procedurë duhet të realizohej brenda 20 ditësh.

Edhe pse me vonesë nga AK nuk është përlogaritur asnjë penalitet për OE "I. shpk" 732,000 lek 4/1000 x 100 ditë = 292,800 lekë penalitet i pa mbajtur.

Gjithashtu në zërat e punimeve kemi zërin "**Mbulim i sheshshpushimit me karton fizarmonik dhe panele druri, për mbrojtje mermeri**" me vlerë 27,600 lekë e cila konsiderohet **dëm ekonomik** është i pa nevojshëm ose i dubluar pasi me urdhër shpenzimin n. 815 datë 23.12.2021 është kryer përsëri një likujdim për punime të ngjashme me operator të njëjtë si më poshtë.

Gjithashtu vlen të theksohet se vonesa e realizimit të kësaj procedure lidhet ngushtë me furnizimin e ashensorit të ri duke bërë përsëri kryqëzim të zërave pasi ashensori i blerë me procedurë prokurimi të hapur të thjeshtuar është furnizuar më datë 24/12.2021 sipas faturës 142/2021. Angazhimi i stafit të subjekti "I shpk" ka qenë tejet i pakët pasi realizimi i punimeve është kryer në të njëjtën periudhë.

Për këtë vit kemi 17 procedura prokurimi shkresore (deri në 100,000 lekë) të cilat auditohen gjatë procesit të auditimit të bankës sipas rastit.

-Per vitin 2020 nga 21 janë realizuar 17 procedura me fond 9,033 mijë lekë, këtu nuk përfshihen blerjet shkresore deri në 100,000 lekë të cilat të parashikuara janë 20 procedura.

-Janë audituar 5 praktika të blerjeve të vogla për vitin 2020, `Blerje gomash makine`, `Blerje materiale pastrimi`, `Blerje letër adeziv`. `Blerje siguracion automjetesh TPL` dhe `Pastrim i

ambjenteve të brendshme dhe të jashtme`. Duke u audituar nga iniciimi i procedurës deri në marrjen e produkteve ose shërbimit dhe likuidimin e faturës, nga të cilat dy prej tyre kanë problematikat si vijojnë.

1-Me urdhër prokurimin nr. 15 datë 16.07.2020 është nisur procedura e prokurimit ‘Blerje goma për automjetet e MEPJ’ dhe ftesës për ofertë nr. 15/1 datë 16.06.2020 për blerje gomash me numrin e gomave dhe sasi të sipas rastit.

Në specifikimet teknike të vendosura nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël janë përcaktuar dizajni i gomës sipas modeleve të kërkuara duke i shoqëruar me foto për secilin rast. Nga verifikimi i modeleve të kërkuara në ëeb page u konstatua se këto modele të kërkuara orintojnë në përcaktimin e markës së gomave Goodyear indirekt duke orientuar dhe në fituesin e procedurës pasi nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël është kërkuar dhe autorizimi i prodhuesit për ofertuesin.

2-Me urdhër prokurimin nr. 8 datë 30.06.2020 është nisur procedura e prokurimit ‘Pastrim i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme’ (edhe pse në organik janë 3 punonjëse sanitare) dhe ftesës për ofertë nr. 8/1 datë 30.06.2020 me sipërfaqet për pastrim dhe llojin e tyre të përcaktuar me operator ekonomik fitues ‘P.S’.

Sipas ftesës për ofertë afati i kryerjes së shërbimit është 15 ditë nga shpallja e fituesit, njoftimi i fituesit është bërë më 7.07.2020 pas tërheqjes së dy operatorë të renditur në vendin e parë dhe të dytë.

Nga verifikimi i faturës së kryerjes së shërbimit ajo mban datë 12.10.2020 pra rreth 2,5 muaj përtej afatit 15 ditor të ftesës për ofertë, në praktik nuk u gjet procesverbali i kryerjes së shërbimit për të saktësuar nëse janë apo jo me vonesë në kryerjen e shërbimit.

Titulli i Gjetjes 1:	Penalitet i pa mbajtur ndaj operatorit ekonomik
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje e vogël ‘Punime ndërtimi në funksion të ashensorit’ sipas ftesës për ofertë Afati i lëvrimin të mallrave, punëve ose shërbimeve do të jetë brenda 20 ditësh. Nga verifikimi i realizimit të procedurës u konstatua se realizimi i saj është kryer rreth 3 muaj me vonesë ose 100 ditë me vonesë nga ftesa për ofertë që kjo procedurë duhet të realizohej brenda 20 ditësh. Edhe pse me vonesë nga AK nuk është përlogaritur asnjë penalitet për OE “I shpk” $864,000 \text{ lek} \times 4/1000 \times 100 \text{ ditë} = 345,600 \text{ lekë}$ penalitet i pa mbajtur.
Kriteri:	Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe VKM nr. 285 dat 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, si dhe ftesa për ofertë.
Ndikimi/Efekti:	Penalitet i pa mbajtur në vlerën 345,600 lekë
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të miratuara në ftesën për ofertë
Rekomandimi:	MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 345,600 lekë për penalitet të pa mbajtur kontraktorit “I” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Vazhdimisht

Titulli i Gjetjes 2:	Penalitet i pa mbajtur ndaj operatorit ekonomik
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje e vogël ‘Heqja e ashensorit dhe përgatitja e strukturës mbajtëse’ sipas ftesës për ofert Afati i lëvrimin të mallrave, punëve ose shërbimeve do të jetë brenda 20 ditësh. Nga verifikimi i realizimit të procedurës u konstatua se realizimi i saj është kryer rreth 3 muaj me vonesë ose 100 ditë me vonesë nga ftesa për ofert që kjo procedurë duhet të realizohet brenda 20 ditësh. Edhe pse me vonesë nga AK nuk është përlllogaritur asnjë penalitet për OE “I shpk” 732,000 lek 4/1000 x 100 ditë = 292,800 lekë penalitet i pa mbajtur.
Kriteri:	Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe VKM nr. 285 dat 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, si dhe ftesa për ofertë.
Ndikimi/Efekti:	Penalitet i pa mbajtur në vlerën 292,800 lekë
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të miratuara në ftesën për ofertë
Rekomandimi:	MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej 292,800 lekë për penalitet të pa mbajtur kontraktorit “I” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Vazhdimisht

-Vendimet gjyqësore.

Titulli i Gjetjes 3:	Ndërprerjen e paligjshme e marrëdhënieve të punës
Situata:	Nga auditimi i proceseve gjyqësore në të cilat MEPJ është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë dëmshpërblyer 8 ish punonjësit të larguar padrejtësisht nga puna të cilat kanë paditur MEPJ në Gjykatë dhe kanë marrë dëmshpërblimin në shumën prej 25,267,377 lekë , si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore.
Kriteri:	Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ në shumën prej 25,267,377 lekë
Shkaku:	Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit nga puna të punonjësve
Rekomandimi:	Nga drejtoria juridike dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të MEPJ të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit

	pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Vazhdimisht

Gjatë periudhës objekt auditimi MEPJ ka dëmshpërblyer 8 ish punonjësit të larguar padrejtësisht nga puna të cilat kanë paditur MEPJ në Gjykatë dhe kanë marrë dëmshpërblimin në shumën prej **25,267,377 lekë**, e ndarë sipas viteve ;

Për vitin 2020 janë paguar 1,630,507 lekë nga të cilat B D është dëmshpërblyer në vlerën 206,260 lekë, R Ll në vlerën 1,033,581 lekë dhe A B në vlerën 390,666 lekë.

Për vitin 2021 janë paguar 11,146,928 lekë nga të cilat A C është dëmshpërblyer për vlerën 372,185 lekë dhe E K për vlerën 10,774,743 lekë.

Për vitin 2022 janë paguar 12,489,942 lekë nga të cilat R.Ll për pjesën e mbetur në vlerën 470,316 lekë, Ll K në vlerën 684,787 lekë, B D në vlerën 9,021,167 lekë, R P në vlerën 420,199 lekë dhe E K për pjesën e mbetur në vlerë 1,893,473 lekë.

Vlera prej 25,267,377 lekë si dëmshpërblim për largime të pa drejta nga puna përbën efekt financiar negative për buxhetin e MEPJ.

-Problematik mbetet fakti i ish punonjësës E K e cila pas përfitimit të dëmshpërblimit prej 10,774,743 lekë është në pritje të rikthehet në vendin e punës, ish punonjësja E K përfiton pagën për çdo muaj duke dubluar kostot e MEPJ për të njëjtin vend pune paguhen 2 punonjës në vlerën 24 muaj x 126,000 = **3,024,000 lekë vlerë që konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.**

-Problematik mbetet dhe fakti i ekzekutimit të këtyre vendimeve me përbaruaes duke shtuar kostot për MEPJ në total në vlerën prej **1,590,026 lek vlerë që konsiderohet efekt financiarë negative për MEPJ.**

-Vonesa në likuidimin e faturave

Nga auditimi i urdhër shpezimeve janë konstatuar disa pagesa me mbi 30 ditë vonesë në shlyerjen e faturave, kryesisht të natyrës së operatorëve që ofrojnë shërbimet si energji elektrike dhe ujë gjithashtu dhe për operatorët ekonomik fitues të tenderave. Midis tyre evidentohen kamatvonesa për pagesën e energjisë elektrike në vlerën 25,986 lekë, duke shfaqur efektet e pagesave me vonesë të faturave. Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 52 përcaktohet se “Nëpunësit zbatues të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”. Mos pagesa në kohë e faturave, shkakton premisë që operatorët ekonomikë të kërkojnë kamatëvonesa në favor të tyre, sikurse përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, ku specifikohet se: “Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën”. Nga sa më sipër, në ato raste kur operatorët ekonomikë do të kërkojnë kamatëvonesa për moskryerjen e pagesës në afat, kjo vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik, duke dëmtuar përdorimin e fondeve publike.

Titulli i Gjetjes 4:	Vonesa në likuidimin e faturave
Situata:	Nga auditimi i urdhër shpezimeve janë konstatuar disa pagesa me mbi 30 ditë vonesë në shlyerjen e faturave të energjisë elektrike dhe ujë gjithashtu si dhe për operatorët ekonomik fitues të tenderave. Midis tyre evidentohen kamat vonesa për pagesën e energjisë elektrike në vlerën 25,986 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52.
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ në menaxhimin e buxhetit
Shkaku:	Mos respektimi i kushteve të pagesave
Rekomandimi:	MEPJ në të gjitha rastet të tregohet sa më korrekte në likuidimin e faturave të pranuar sipas kushteve të përcaktuara për pagesë me qëllim shmangien e kostove të tjera shtesë për buxhetin e saj.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Vazhdimisht

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023 dhe administruar nga grupi i auditimit më 21.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në faqen 16-22 të observacioneve paragrafi parë shprehet se: Në lidhje me projekt raportin faqe 226-290 për kapitujt e prokurimeve të realizuara dhe përdorimit të karburantit.

1. Në blerjen me rast emergjent, sipas faturës tatimore nr. 210/2021 janë blerë materiale pastrimit të cilat janë mëse të nevojshme për higjienën e godinës së MEPJ. Kërkesat janë paraqitur verbalisht nga punonjëset e pastrimit dhe magazinierja e MEPJ. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla kryen blerje përfshire edhe rast emergjent vetëm kur institucioni ka nevojë për blerje materiale.

2. Referuar blerjeve për materiale kancelari për zyrën e zv ministrit M.F, materialet janë blerë që me datë 23.07.2021, datë në të cilin është paraqitur nevoja por OE ka faturuar me vonese për rrjedhoje është dashur që procesverbalet të mbaheshin ditën e lëshimit të faturës. Zv ministri ka porositur dosje dhe materiale të tjera, një pjese e te cilave nevojiteshin për përfaqësimin e saj në një mbledhje jashtë vendit (dosjet).

3. Në lidhje me urdhër shpenzimin nr. 718, datë 24.11.2021 MEPJ ka kryer blerjen dhe shërbimin e mbjelljes së disa luleve dhe prerjes së disa ligustrave. Periudha në të cilën është kryer shërbimi dhe furnizimi është koha e përshtatshme për mbjellje lulesh etj. MEPJ ka një hapësirë të madhe oborri e cila kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme. Mirëmbajtja e Popullit.

pjesës se mbrapme te oborrit është kryer edhe pas ankesave te vazhdueshme të Avokatit te
4. Në blerjen me rast emergjent, sipas faturës tatimore nr. 671/2021 janë blerë materiale pastrimit të cilat janë mëse të nevojshme për higjienën e godinës së MEPJ. Fondi për vitin kalendarik 2021 është ezauruar për rrjedhojë janë blerë me rast emergjent materiale pastrimit për nevojat e MEPJ deri në organizmin e procedurës-bhu vitin e ardhshëm.



5. Sa i takon pagesës së faturës tatimore nr. 2129, datë 07.12.2020, ajo është bërë konform rregullave ligjor. Afati i realizimit të shërbimit është brenda datës 03.12.2020, kjo vërtetohet me materialet e nisura me email drejt Sektorit të Certifikimit dhe Përkthimit. Sa më sipër, sjellja e efekteve financiare negative në vlerën 110,622 lek nuk qëndron.

6. Me urdhër shpenzimin nr. 761 datë 14.12.2021 është paguar fatura tatimore e shitjes nr. 37/2021 datë 06.12.2021 me vlerë 338.670 lekë me objekt "Përkthim materialesh" sipas kontratës nr. 33 datë 06.12.2021 nënshkruar midis A.S si titullarë dhe R. Gj si përkthyes e ofrimit të shërbimit.

...

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj ju bëjmë me dije se: Në lidhje me praktikën e përkthimit që mban të njëjtën datë dorëzimi kontrate dhe produkti me jeni shprehur dhe me shumë JU bëjme me dije se: bashkangjitur në format JPG (foto) keni dy praktika përkthimi të kryer po nga JU, njëra kjo e shumë diskutuara dhe një tjetër që në këndvështrimin e audituesit të pavaruar konsiderohet e sakt, JU lutem shikojeni më kujdes dhe do shikoni dhe diferencen, për sa bashkangjitur observacioni nuk merret në konsiderat.*

Praktik e pa rregullt



Praktik e rregullt

KONTRATË
PËR PËRKTHIMIN E DOKUMENTEVE ZYRTARE

Nr. 1

E lidhur në Tiranë në datë 12/01/21, ndërmjet palëve:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me adresë Bulevardi "Gjergj Fishta", Nr. 6, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm, që më poshtë do të quhet **Porositësi**,

dhe

Znj. Elona Vrenezi, përkthyes zyrtar i Gjuhës Angleze, që më poshtë do quhet **I Porosituri**

Neni 7
Dispozita të fundit

7.1. Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen në këtë mënyrë, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

7.2. Vlefshmëria dhe zbatimi i kësaj kontrate fillon nga data 12/01/21 deri më 31/01/21.

7.3. Palët mund ta zgjidhin kontratën edhe para plotësisht të afatit, për shkak të një detyrimi ligjor, me mirëkuptim ose gjyqësish, duke çuar deri në fund detyrimet e marra reciprokisht përpara datës së zgjidhjes së kontratës.

Kjo kontratë përbëhet nga 4 (katër) faqe, përpilohet në tri kopje që mbahen, dy nga Porositësi dhe një nga I Porosituri, dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy palët.

PËR POROSITËSIN I POROSITURI

Armand SKAPI Elona VRENEZI

PROCES VERBAL

I mbajtur sot më datë 22/01/2021, për dorëzimin e materialit mbi "Vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian" të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

Materiali i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe pëmban 136,417 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) karaktere, që janë të barasvlershme me 50 faqe të pagueshme nga 50 faqe A4 të marra në dorëzim.

Ky procesverbal mbahet në 2 (dy) kopje origjinal.

DORËZUESI MARRËSINË DORËZIM

Përkthyesi Drejtoria e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve

Elona VRENEZI Inida Methoxha, drejtor i komanduar

Ju lutem shikojeni dhe beni krahasimin, per kete ndryshim dhe standard jo të njëjtë grupi auditimit është shprehur në material që Ju ju duket e sakt. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat, procedura e ndjekur sa i takon aspektit ligjore (afatet) nuk është respektuar, në asnjë rast grupi i auditimit nuk ka vënë në dyshim ekzistencën apo jo të materialit të përkthyer por mënyrën e realizimit të procedurës.

Pretendimi i subjektit: Në faqen 20 të observacioneve pika 7 shprehet se: Në lidhje me copëzimin e fondeve për punimet dhe vendosjen e ashensorit, sipas parashikimve të nenit 56, të vkm-së 285, datë 19.05.2021, për disa arsye si vijon.

-Fondi për vendosjen e ashensorit 2,500,000 lek pa tvsh ishte vendosur në PBA dhe regjistrin e prokurimeve. Kjo është një vlere minimale për furnizim vendosje ashensori me 5 ndalese dhe kapacitet 8 (tetë) persona.

-Njëra nga procedurat ka vetëm punime ndërtimit për forcim të strukturës të kafazit të ashensorit me suvatim, zgjerimi i të gjithë hapësirave hyrëse dhe vendosja e mermerit. Këto punime nuk realizohen me kompani qe furnizojnë dhe vendosin ashensor. Nqs këto punime duhet te ishin përfshire edhe furnizim vendosje ashensori vlere do te ishte me e lartë pasi OE fitues do te nënkontraktonte nje OE me veprimtari fushën e ndërtimit.

-Duke marrë në konsideratë specifikat e objektit të kontratës furnizimi vendosje ashensori dhe realizimin e këtij procesi pune, konstatojmë se në të gjitha rastet kompanitë instalojnë ashensorë në strukturën përkatëse prej betoni dhe çimento te armuar e cila përgatitet paraprakisht nga konstruktorët. Në rastin tone një strukture betoni nuk ekzistonte. Jemi detyruar për arsye te veçorive te strukturës ndërtimit të oxhakut te ashensorit i cili nuk ka qene me strukturë

betoni por me tulla të realizojmë dy procedurat e tjera të përforcimit të strukturës me strukture metalike dhe punime ndërtimi. Janë dy shërbime/ punime të cilat ofrojnë OE të ndryshëm në treg.

Lidhur me punimet e kryer nga OE I shpk për të dyja kontratat e lidhura, punimet janë kryer brenda afateve kohore pavarësisht se kryerja e punimeve është faturuar në një datë të mëvonshme dhe shoqëruar me relacionin në një datë të mëvonshme për këtë arsyeja Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nuk ka patur shkak ligjor për të mbajtur kamaton në realizim shërbimesh.

Oëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj ju bëjmë me dije se: mbase nga mungesa e informacionit apo njohjes së ligjit por në asnjë rast nuk konsiderohen punimet e kryera nëse nuk ka një situacion bashkëlidh dokument ky me 2 muaj vonese dhe ju e dini fare mire. Mbase fatura mund të lëshohet me vonesë për 1001 arsye por jo situacionit i punimeve për kujtesën tuaj po Ju a bashkëngjis në material.*

Date 21/12/2021

SITUACIONI PERFUNDIMTAR

Ortësi Kontraktor : Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
 Objekti : "Punime ndërtimi në funksion të ashensorit"
 Operatori Ekonomik : INA shpk

Nr	Emërtimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Mbulimi i sheshpushimeve me karton firzamonike dhe panele druri, për mbrojtjen e mermerit.	m ²	120	230	27600
2	Prishja e suvatimit të vjetër, pastrimi i fagave. Larja e murit të tullës.	m ²	400	221	88486
3	Sprucim me granit të thyer dhe cemento	m ²	400	290	116000
4	Suvatim me rere guri	m ²	400	720	288000
5	Prishje mur tulle	m ³	5	1200	6000
6	Pastrim, transport mbeturina, inerte.	m ³	17	650	11050
7	Arkitra betoni dhe strukture hekuri	m ³	1.2	1720	2064
8	Granit star galaxy, trashësia 3 cm. Per shpatullat e hyrjes në ashensor.	m ²	10	17200	172000
9	Skele e brendshme në oxhakun e ashensorit	m ²	40	220	8800
VLERA PA TVSH					720000
TVSH					144000
VLERA ME TVSH					864000

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat.

-Për sa i përket fondit në zërin e prokurimve i cili sipas jush është i vogël për të mbuluar dhe punimet e ndërtimit, kjo është përgjegjësi e Juaja në parashikimin jo të sakt të këtij zëri.

-Për sa i përket elementit... Njëra nga procedurat ka vetëm punime ndërtimit për forcim të strukturës të kafazit të ashensorit me suvatim, zgjerimi i të gjithë hapësirave hyrëse dhe vendosja e mermerit.

Këto punime nuk realizohen me kompani që furnizojnë dhe vendosin ashensor...më vjen keq që e citoni pasi ligjvënësi ka parashikuar në një nen të veçantë bashkimin e operatoreve dhe ky është një rast tipik.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat

Blerjet emergjente

Për periudhën objekt auditimi MEPJ ka realizuar këto procedura emergjente sipas viteve respektive:

Viti 2020

1. Blerje me rast emergjent në total 79 blerje në vlerën 5,198,258.58 lekë pa tvsh.

Viti 2021

1. Blerje me rast emergjent në total 82 blerje në vlerën 3,706,103.59 lekë pa tvsh.

Viti 2022

1. Blerje me rast emergjent në total 123 blerje në vlerën 9,498,681.47 lekë pa tvsh.

Blerjet emergjente mbeten problem duke e rritur numrin e procedurave emergjente nga vitit në vit në një total prej 284 procedura emergjente për 3 vite periudhë auditimit ose në një vlerë 18,403,042 lekë pa TVSH edhe pse në disa raste është e pashmangshme kjo procedurë nga ana e MEPJ duhet të bëhet një pasrashikim më i saktë i procedurave të prokurimit për shmangjen e këtyre procedurave.

-Në disa raste këto procedura nuk plotësojnë asnjë element të procedurës emergjente siç është 'Blerje siguracioni automjeteve TPL' duke qenë se AK është në dijeni të saktë të afatit të mbarimit të çdo siguracioni mjeti.

-Në disa raste memot e kërkesës për blerje malli apo shërbimi kanë mbi 20 ditë të hartuara nga sektorët përkatës për blerje mallrash apo shërbimesh por nga ana e AK nuk janë marrë në shqyrtim duke shmangur procedurat elektronike dhe zhvilluar atë në kushte emergjente.

-Në dy raste kemi kryerjen e procedurës 'Riparim Autoveture' brenda një periudhe 30 ditore të të njëjtit automjet me targa AA781IK dhe mbi të gjitha për të njëjtën arsye 'defekt në sistemin ftohës, prezenc vaji'.

-Në disa raste këto procedura nuk plotësojnë asnjë element të procedurës emergjente siç është 'Blerje kuti kartoni për dërgesa diplomatike' duke qenë se AK është në dijeni të plotë të programeve diplomatike duhet të jetë dhe në gadishmëri të sigurimit të bazës së nevojshme për transferim.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi në të gjitha rastet, autoriteti duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij, në rastet e mësipërme neglizhenca e AK ka rolin kryesor.

Nga auditimi i procedurave emergjente të cilat u morën në shqyrtim pasi u analizuan si procedura me më shumë risk nga grupi i auditimit u konstatua se:

-Procedura e prokurimit me nr. 36 prot datë 09.01.2020 "Blerje shërbim siguracioni automjeteve" me vlerë 37,164 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësisht e programuar dhe parashkuar kur ndodh, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H. anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

-Procedura e prokurimit me nr. 2 prot datë 23.01.2020 "Blerje kutish për nevoja të MEPJ" me vlerë 117,600 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësisht e programuar dhe parashkuar kur ndodh, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël. Kjo procedurë është realizuar edhe dy herë të tjera gjatë vitit 2020 me vlerë 105,600 lekë dhe 117,600 lekë veprime në kundërshtim me VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 40 pika 8; 8. Në asnjë rast, procedura e prokurimit me

vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.

-Procedura e prokurimit me nr. 3 prot datë 22.01.2020 “Blerje shërbim riparim telefonie” me vlerë **117,600 lekë me tvsh e cila konsiderohet dëm ekonomik** pasi është realizuar në shmangie të procedurës elektronike si dhe në dublim të kontratën së vitit 2019 datë 25.03.2019 “Shërbime në funksion të mirëmbajtjes së centralit telefonik, shtesa license, përshtatje sistemi” me të njëjtin operator fitues” Communication progress me vlerë 593,500 lekë pasi kjo procedurë është lehtësisht e programuar dhe parashikuar kur ndodh, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

-Procedura e prokurimit me nr. 6 prot datë 14.01.2020 “Blerje Letër adeziv me ndarje” me vlerë 118,575 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësisht e programuar dhe parashikuar kur ndodh, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël. Kjo procedurë është realizuar edhe dy herë të tjera gjatë vitit 2020 me vlerë 118,575 lek dhe 118, 575 lekë, gjithashtu për këtë procedurë është realizuar edhe procedura e prokurimit me vlerë të vogël me vlerë 800,000 lekë duke sjellë copëzim të fondit për efekt të shmangies nga procedurat elektronike të prokurimit, veprime në kundërshtim me *VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8; 8.Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.*

-Procedura e prokurimit me nr. 62 prot datë 09.09.2021 “Blerje aksesore për automjete” me vlerë 80,3989 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë nuk ka asnjë lement të emergjencës pasi materialet e blera janë aksesore pastrimi dhe disa llampa rezervë për makina etj, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetarë, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

-Procedura e prokurimit me nr. 68 prot datë 27.11.2020 “Blerje Web camera dhe speaker” me vlerë 63,500 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike gjithashtu në praktik nuk gjendet asnjë memo për nevojën e këtyre pajisjeve por duket sikur është kryer në dëshirë të komisionit të blerjeve me vlerë to vogël, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 782 datë 12.12.2020 është paguar procedura e prokurimit me nr. 69 prot datë 18.11.2020 “Kuti kartoni për dërgesa diplomatike” me vlerë 118,464 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është e përhershme në MEPJ dhe nga ana e institucionit duhet bëhet një programim më i mirë i nevojës, gjithashtu në praktik nuk gjendet asnjë memo për nevojën e këtyre pajisjeve por duket sikur është kryer në dëshirë të komisionit të blerjeve me vlerë to vogël veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 750 datë 09,12,2020 është paguar procedura e prokurimit me nr. 75 prot datë 11.11.2020 blerje shërbimi “Pastrim i ambjenteve të jashtme të MEPJ” me vlerë 119,640 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësisht e programueshme nga MEPJ, nuk paraqet asnjë rast emergjent dhe në praktik nuk gjendet asnjë

memo për nevojën e kryerjes së këtij shërbimi por duket sikur është kryer në dëshir të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 633 datë 20.10.2020 është paguar procedura e prokurimit me nr. 57 prot datë 18.09.2020 blerje shërbimi “Blerje karburant për nevojat e MEPJ” me vlerë 119,808 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësuar e programushme nga MEPJ, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetarë, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 138 datë 16.02.2022 është paguar procedura e prokurimit me nr. 83 prot datë 04.12.2021 blerje “Blerje tonera” me vlerë 117,600 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësuar e programushme nga MEPJ, madje fakt ky i konfirmuar dhe nga fatura e furnizimit dhe fletë hyrja që mbajnë datë 10.01.2022 pra me 1 muaj mbas procesverbalit të emergjencës duke konfirmuar dhe një herq që nuk përmbën rast emergjent, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

Me urdhër shpenzimin nr 671 datë 11.11.2021 është paguar procedura e prokurimit me nr. 69 prot datë 11.11.2021 blerje shërbimi “Materiale pastrimi” me vlerë 116,700 lekë është realizuar në shmangie të procedurës elektronike pasi kjo procedurë është lehtësuar e programushme nga MEPJ, nuk paraqet asnjë rast emergjent dhe në praktik nuk gjendet asnjë memo për nevojën e kryerjes së këtij shërbimi por duket sikur është kryer në dëshir të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël veprime që ngarkojnë me përgjegjësi z. A.S titullar i AK, S.G kryetar, E.H dhe G.H anëtarë të komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

Konkluzion: MEPJ drejtoria e shërbimeve si dhe drejtoria e prokurimit nuk ka funksionuar brenda kuadrit ligjor, kemi devijime në planifikimin e procedurave dhe mos rakordimit me sektorët apo drejtoritë përkatëse duke sjellë si pasojë një numër tejet të madhe të procedurave emergjente.

Titulli i Gjetjes 5:	Volum i lartë i procedurave emergjente
Situata:	Nga auditimit i procedurave të blerjeve me vlerë të vogël në MEPJ u konstatua se për periudhën objekt auditimit në këtë institucion janë realizuar 284 procedura emergjente për në një vlerë 18,403,042 leke pa TVSH. Këto procedura kryesisht janë blerje biletash apo pritje përcjellje të pashmangshme por ka dhe nga ato që nuk e justifikojnë llojin e procedurës së përzgjedhur.
Kriteri:	VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8; 8 dhe VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 pika 9;
Ndikimi/Efekt:	Keqmenaxhim i fondeve, shmangje e procedurave elektronike
Shkaku:	Parashikim i gabuar i regjistrat të parashikimit
Rekomandimi:	Drejtoria e shërbimeve dhe e prokurimeve pranë MEPJ të kryej një parashikim më të saktë në regjistrat e parashikimit sidomos për ato

	procedura të përsëritura që struktura disponon informacion tejet të plotë për një parashikim sa më korrekt me qëllim shmangien e procedurave emergjente.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Vazhdimisht

Titulli i Gjetjes 6:	Procedurë e pa argumentuar
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me nr. 3 prot datë 22.01.2020 “Blerje shërbim riparim telefonie” e realizuar me procedurë emergjente, u konstatua se kjo procedurë është realizuar 20 ditë pas likuidimit të kontratës së vitit 2019 datë 25.03.2019 “Shërbime në funksion të mirëmbajtjes së centralit telefonik, shtesa license, përshtatje sistemi” me të njëjtin operator fitues “C. p” gjithashtu për kryerjen e kësaj procedure emergjente nuk kemi asnjë kërkesë të tillë, veprime në kundërshtim me VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8; 8. Vlera prej 117,600 lekë e likuiduar për këtë procedurë konsiderohet dëm ekonomik dhe do të dëm shpërblehet nga përfituesi ‘C p’
Kriteri:	VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8; 8
Ndikimi/Efekti:	Keqmenaxhim i fondeve
Shkaku:	keqmenaxhim
Rekomandimi:	MEPJ të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit ‘C.p’, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 117,600 lekë, të cilën e ka përfituar me pa të drjetë.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Deri më 31.12.2023

Titulli i Gjetjes 7:	Procedura emergjente pa plotësuar kushtet
Situata:	Nga auditimi i procedura e prokurimit me natyrë emergjente nga ana e MEPJ janë realizuar procedura prokurimi të natyrave të ndryshme si: “Blerje Letër adeziv me ndarje”, “Blerje karburant për nevojat e MEPJ”, “Materiale pastrimi”, “Blerje tonera”, “Kuti kartoni për dërgesa diplomatike” ‘Siguracion mjetesesh’ etj, të cilat nuk plotësojnë kriteret e një procedure emergjente. Në disa raste nuk përkojnë datat e kërkesave me datën e realizimit të procedurës, në disa raste kemi përsëritje të procedurës së prokurimit (emergjencë pas emergjence)
Kriteri:	VKM 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8; 8 dhe VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 pika 9;
Ndikimi/Efekti:	Keqmenaxhim i fondeve, shmangje e procedurave elektronike

Shkaku:	Parashikim i gabuar i regjistrit të parashikimit
Rekomandimi:	Drejtoria e shërbimeve dhe e prokurimeve pranë MEPJ në asnjë rast mos të anashkalojë procedurat elektronike online duke përzgjedhur procedurën emergjente, së pari për të mos eliminuar konkurrencën dhe së dyti për të patur një qasje të njëjtë ndaj operatorëve.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Vazhdimisht

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023 dhe administruar nga grupi i auditimit më 21.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në faqen 21 të observacioneve pika 12 shprehet se: Të gjitha praktikat e realizuara me rast emergjent janë kryer në bazë të kërkesave nga personeli i MPEJ dhe drejtoritë përkatëse. Këto praktika nuk mund të parashikoheshin pasi në një vit kalendrik nuk mund të dimë:

Sa procedura legalizimi do të realizohen dhe sa leter adezive kërkojnë Sa kuti kartoni me logo nevojiten për dërgesat e sendeve personale të diplomateve, librave shkollore për diasporën, pasaportat biometrike për emigrantet, pasi në shume raste me këto dërgesa operojmë edhe për llogarit të inistucioneve të tjera. AK nuk parashikon se sa do jetë numri i diplomatëve në përfaqësi, dhe sa sende personale do të transportojë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj ju bëjmë me dije se: MEPJ për periudhën objekt auditimit ka realizuar në total 284 procedura emergjente sipas viteve 79 viti 2020, 82 viti 2021 dhe 123 viti 2022 pothuajse 1 në 2 ditë. Grupi i auditimit siç edhe Ju a bëri me dije në takimin përmbyllës ka përmendur në këtë raport ato procedura që janë tejet e tipike tëparashikueshme dhe të pa sinkronizuara nga ana juaj në aspekt të afateve, në ato raste kur diskohet kërkesa për blerje emergjente procedura realizohet mbas disa javësh në raste të tjera ska fare kërkes por thjesht realizohet procedurë duke mos respektuar kornizat e ligjit. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat.*

3.2 Verifikimi i veprimeve të kryera përmes magazinës

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

U audituan me zgjedhje dokumentacioni i magazinës për periudhën e auditimit.

Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu iii, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës

përpilohet nga nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

Nga auditimi u konstatua mungesë e kartelave personale, të cilat përmbanin informacion mbi aktivet në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e MEPJ.

Lidhur me inventarizimin e magazinës

Për vitin 2020

Me Urdhër nr. 241 datë 20.05.2020 është ngritur komisioni “Për vlerësimin e aktiveve gjendje në magazinën e MEPJ”, për të bërë inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të godinës së Ministrisë.

Komisioni, i përbërë nga 4 anëtar konkretisht, S.G kryetar; E.H anëtar; N.K anëtar, G.H anëtar.

Për vitin 2021

Me Urdhër nr. 7 datë 05.01.2022 është ngritur komisioni “Për vlerësimin e aktiveve gjendje në magazinën e MEPJ”, për të bërë inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të godinës së Ministrisë.

Komisioni, i përbërë nga 4 anëtar konkretisht, S.G kryetar; E.H anëtar; N.K anëtar, G.H., anëtar.

Gjetje nr. 19:

Nga auditimi u konstatua mungesë e kartelave personale, të cilat përmbanin informacion mbi aktivet në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e MEPJ.

Titulli i Gjetjes 8:	<i>Saktësia dhe rregullartiteti i veprimeve të kryera në magazinë</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua mungesë e kartelave personale, të cilat përmbanin informacion mbi aktivet në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e MEPJ.
Kriteri:	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk i keqpërdorimit të aktiveve të njësisë publike dhe për pasojë cënimit të vlerave materiale
Shkaku:	Mos kryerje e procedurave të inventarizimit të magazinës
Rekomandimi:	Të merren masa konkrete për të hartuar kartelat personale për të gjithë punonjësit e institucionit.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

3.3 Inventarizimi i pronës Shtetërore

Për vitin 2020

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2020, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm A.S në rolin e Nënpunësit Autorizues është nxjerr Urdhër nr.241 datë 20.05.2020 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të aktiveve” me objekt “Për të bërë inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të personelit dhe në ambientet e përbashkëta të MEPJ”, me përbërje të 4 anëtarëve S.G në rolin e kryetarit, E.H, N.K dhe G.H në rolin e anëtarëve. Është ngarkuar Drejtorja e Financës me zbatimin e këtij Urdhëri.

Nga auditimi u konstatua se, ngritja e këtyre komisioneve ka qenë vetëm formale, pasi nuk kanë operuar dhe nuk është kryer asnjë veprim në mbështetje të tyre.

Për vitin 2021,

Nga ana e titullarit të Institucionit është nxjerr Urdhër nr.253 datë 15.06.2021 “Për delegim kompetencash” tek Sekretari i Përgjithshëm për:

- Krijimin e komisionit për vlerësimin e aktiveve
- Krijimin e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit
- Miratimin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi

Me Urdhër nr.301 datë 13.07.2021 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm në rolin e nënpunësit autorizues, është ndryshuar komisioni i vlerësimit të aktiveve ku sërish në përbërje të tij vijonin 7 anëtar, S.G në rolin e kryetarit, G.H, E.H, B.Dh, E.Z në rolin e anëtarëve si dhe dy inxhinier (K.L dhe N.Xh) në rolin e inxhinierëve mekanik.

Në të dy vitet është ngarkuar Drejtorja e Shëbimeve Mbështetëse dhe Drejtorja e Financës për zbatimin e këtij Urdhëri.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e këtyre dy drejtorive nuk është kryer asnjë veprim për vijimin e mëtejshëm të procesit.

Nga ana e komisioneve të ngarkuara me inventarizimin e aktiveve për vitin 2020-2021 nuk është kryer procesi inventarizimit e për pasojë nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve të MEPJ-së, në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që sanksionon detyrimin e komisionit, “të përpilojë një raport lidhur me: inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nënpunësit Autorizues”; Komisioni Inventarizimit ka operuar në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, konkretisht nenin 85 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin” në të cilin citohet: “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :

a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me

gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues".

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, nuk arrijmë dot të sigurojmë informacion për të dhënat e aktiveve, duke operuar institucioni në moszbatim të plotë të UMFE nr.30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ” sipas të cilit parashikohet se : *“Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efciencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike”.*

Gjetje nr.20:

Nga auditimi u konstatua se, në MEPJ nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, konkretisht me pikat.

Pika 26 .. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

Pika 27 ... Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.

Pika 30 ... Format i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Titulli i Gjetjes 9:	<i>Inventarizimi i pronës shtetërore, vlerësimi, nxjerrjet jashtë përdorimit dhe asgjësimi i aktiveve / Regjistri Aktiveve</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, në MEPJ nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, konkretisht me pikat.</p> <p><i>Pika 26 .. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.</i></p> <p><i>Pika 27 ... Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.</i></p> <p><i>Pika 30 ... Format i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve</i></p>

	kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
Kriteri:	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në përputhje me UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nr.10:

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi (2020-09.2022) lidhur me inventarizimin e aktiveve (pavarësisht se ka dal Urdhër i SP të MEPJ për inicimin e inventarizimit për 2020 Urdhër nr.241 datë 20.05.2020 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve” dhe për 2021 nr.533 datë 27.10.2020 nga ana e S.P në rolin e nënpunësit autorizues, është ngritur komisioni për të bërë nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ku në përbërje të tij janë 5 anëtar, (S.G në rolin e kryetarit, L.B, K.D, B.Dh, M.L në rolin e anëtarëve të cilit nuk janë vendosur në zbatim) është operuar jo në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve”, Inventarizimi i aktiveve,

Pika 73 Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.

Pika 74 ... Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomatere, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Si rezultat, gjendja e të dhënave kontabël në pozicionin financiar të vitit 2020-2021, nuk është rakorduar me gjendjen fizike.

Titulli i Gjetjes 10:	<i>Inventarizimi i pronës shtetërore, vlerësimi, nxjerrjet jashtë përdorimit dhe asgjësimi i aktiveve</i>
------------------------------	---

Situata:	<p>Nga auditimi ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi (2020-09.2022) lidhur me inventarizimin e aktiveve (pavarësisht se nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ-së është miratuar urdhri për iniciimin e inventarizimit, për 2020 Urdhër nr.241 datë 20.05.2020 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve” dhe për 2021 me nr.533 datë 27.10.2020) është operuar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 dhe 74 e tij duke mos kryer procesin e inventarizimit.</p> <p><i>Pika 73</i> Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.</p> <p><i>Pika 74 ...</i> Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.</p> <p>Si rezultat, gjendja e të dhënave kontabël në pozicionin financiar të vitit 2020-2021, nuk është rakorduar me gjendjen fizike dhe nuk arrijmë të japim dot siguri të arsyeshme mbi pohimet e nevojshme që lidhen me saktësinë e vlerave të aktiveve.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekt:	Risk i lartë në keqmenaxhimin / keqpërdorimin e pasurisë / pronës publike.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e inventarizimit të aseteve të njësisë dhe çdo aktiv tjetër që ky Instituc disponon/zotëronsi. - Të kryhet rakordimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël në funksion ruajtjes edhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 11397 prot., datë 14.07.2023 me tonën nr.894/6 prot., datë 19.07.2023

Gjetje 13 faqe 346 Projekt Raport

Në vijim të gjetjes suaj lidhur me procedurat e inventarizimit ju informojmë se, periudha objekt auditimi përkon me periudhën e shpalljes së pandemisë botërore COVID 19. Në zbatim të Urdhërit

nr.38 datë 12.05.2020 “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të Administratës Shtetërore gjatë periudhës së pandemisë shkaktuar nga COVID 19” të Departamentit të Administratës Publike, MEPJ ka përpiluar urdhëresa për limitimin e prezencës së stafit në ambientet e MEPJ-së çka ka penguar procesin e inventarizimit.

Gjithashtu, MEPJ i është nënshtruar procesit të ristrukturimit disa herë gjatë periudhës objekt auditimi.

Konkretisht në strukturën e MEPJ-së u afruan 2 agjenci (Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët) që deri në vitin 2021 kanë qenë nën varësinë e ish Ministrisë së Diasporës dhe janë larguar stafi i ish Ministrisë së Integritetit për t'u bashkuar strukturave të SASPAC dhe asaj të Kryenegociatores.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar argumentimeve nga ana e subjektit (MEPJ) sjellim në vëmendjen Tuaj se, pavarësisht pandemisë botërore, e cila për hir të së vërtetës na preku të gjithëve por nuk na penalizoj në mosrealizim/funksionim të veprimtarive institucionale, po ashtu edhe pavarësisht ndryshimeve strukturore që institucioni Juaj ka pësuar, procesi inventarizimit është një proces i detyrueshëm për tu realizuar çdo vit (referuar UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar) me qëllim monitorimin e riskut të keqmenaxhimit / keqpërdorimit të pasurisë / pronës publike.

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

3.3.1 Regjistrimi i Pasurisë së Paluajtshme të MEPJ në ish - ZVRPP.

Nga ana e MEPJ, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, nuk ka gjurmë mbi kryerjen e inventarizimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, për pasojë informacioni mbi procedurat e ndjekura për inventarizimin e pasurive të paluajtshme mungon, në kundërshtim kjo me pikën 74, të kapitullit IV *Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve të UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i cili specifikon se... “*Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale... nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*”

Nga auditimi u konstatua se, nuk ka një urdhër titullari mbi inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore për periudhën objekt auditimi.

Nga ana e MEPJ nuk është zbatuar Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e Ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

- Nuk janë zbatuar pikat 2 dhe 9 të VKM nr.500 datë 14.08.2001 konkretisht:

Pika nr.2, ... Institucionet e administratës qendrore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë palë pjesëmarrëse aktive në këtë proces dhe janë të detyruara të përgatisin dhe të vënë në dispozicion të AITPP-së të gjithë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e këtij procesi, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Pika nr.9, Çdo institucion i pushtetit qendror dhe çdo njësi e qeverisjes vendore, në strukturën e administratës së vet, krijon, me miratimin e këshillit përkatës, një njësi të veçantë (zyrë ose sektor) me karakter të përkohshëm. Emërimi i personelit bëhet nga titullari i institucionit apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Seksioni apo zyra funksionon vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar në këtë vendim dhe përgjigjet përpara titullarit apo personit të autorizuar nga ai.

Gjetje nr.11:

Nga ana e MEPJ nuk është zbatuar plotësisht VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Konkretisht përsa i përket zbatimit të detyrimit të pikës nr.2, ...Institucionet e administratës qendrore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë palë pjesëmarrëse aktive në këtë proces dhe janë të detyruara të përgatisin dhe të vënë në dispozicion të AITPP-së të gjithë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e këtij procesi, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Pikës nr.9, Çdo institucion i pushtetit qendror dhe çdo njësi e qeverisjes vendore, në strukturën e administratës së vet, krijon, me miratimin e këshillit përkatës, një njësi të veçantë (zyrë ose sektor) me karakter të përkohshëm. Emërimi i personelit bëhet nga titullari i institucionit apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Seksioni apo zyra funksionon vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar në këtë vendim dhe përgjigjet përpara titullarit apo personit të autorizuar nga ai.

Gjatë periudhës së ushtrimit të misionit auditues, u konstatua përmbushje e *Pikës nr. 10*, të VKM sipërcituar. Sipas së cilës*Institucionet e pushtetit qendror dhe organet e qeverisjes vendore, brenda tre muajve pas marrjes së dokumentacionit nga AITPP-ja, përgatisin dhe dërgojnë në DPP inventarin e pronave shtetërore nën përgjegjësitë e tyre administrative, në përputhje me formularët dhe udhëzimet e dërguara nga AITPP-ja.*

Në kushtet e sipërcituara, nga ana e MEPJ nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.11397 prot., datë 14.07.2023 me tonën 894/6 prot., datë 19.07.2023

Në vijim të gjetjes suaj lidhur me moszbatimin e VKM nr.500, datë 14.08.2001, ju bëjmë me dije se nën mbikqyrjen e Këshillit të Ministrave, institucioni ka marr masa për përfundimin e procesit të inventarizimit dhe regjistrimit të pronave publike në administrim të MEPJ. Në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të regjistrimit të pronave dhe pajisjen me certifikatë pronësie, me Urdhërin nr.144, datë 11.04.2023 “Për ngritjen e strukturës së Posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin kadastral publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie për çdo pasuri.

Procedura që do ndiqet për këtë proces është e përcaktuar në VKM nr.28 datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunim ndërmjet institucioneve.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në mbështjet të argumentave të mësipërm nevojitet një dokumentacion justifikues i fakteve (prania e Urdhërit sipërcituar nr.144 datë 11.04.2023) e në mungesë të sa mësipër nuk mund të shprehim siguri të arsyeshme mbi statusin e objeksionit Tuaj .

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes 11:	REGJISTRIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME TË MEPJ NË ish - ZVRPP
Situata:	<p>Nga ana e MEPJ nuk është zbatuar Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e Ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.</p> <ul style="list-style-type: none">- Në kushtet e sipërcituara nga ana e MEPJ nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.- Nuk janë zbatuar pikat 2 dhe 9 të VKM nr.500 datë 14.08.2001 konkretisht: <i>Pika nr.2, ... Institucionet e administratës qendrore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë palë pjesëmarrëse aktive në këtë proces dhe janë të detyruara të përgatisin dhe të vënë në dispozicion të AITPP-së të gjithë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e këtij procesi, sipas përcaktimeve në këtë vendim.</i> <i>Pika nr.9, Çdo institucion i pushtetit qendror dhe çdo njësi e qeverisjes vendore, në strukturën e administratës së vet, krijon, me miratimin e këshillit përkatës, një njësi të veçantë (zyrë ose sektor) me karakter të përkohshëm. Emërimi i personelit bëhet nga titullari i institucionit apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Seksioni apo zyra funksionon vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar në këtë vendim dhe përgjigjet përpara titullarit apo personit të autorizuar nga ai.</i>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar- Ligji nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,- VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet,- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

	- UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk i lartë në keqmenaxhimin / keqpërdorimin e pasurisë / pronës publike.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e regjistrimit tëpronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast dhe kryerja e rivlerësimit të tyre në mënyrë që të pasqyrojnë drejt dhe saktë vlerat në pasqyrat financiare.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

3.3.2 Lidhur me karburantin dhe automjetet e MEPJ-së

Nisur nga niveli i lartëi shpenzimeve të karburantit u auditua zbatimi i normativave të harxhimit të karburanteve të mjetet motorike apo gjeneratorëve që disponon, marrja nga magazinë e MEPJ-së për secilin tip mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe siguracioneve vjetore;

Për vitin 2020

Nr.	Lloji i automjetit	Targa	Viti prodh.	karburanti	Norma harxhimit sipas modelit l/100 km	Norma harxhimit 2020	Norma harxhimit 2021	Norma harxhimit 2022
	Në funksion							
1.	Hyunday Tucson	TR 69 02 R	2008	naftë	8.4	11.7	12.7	-
2.	Toyota Rav 4	AA 096 PL	2016	naftë	7.6	7.3	7.2	-
3.	Toyota Prius	AA 097 PL	2016	benzinë	3.4 – 3.9	-	10	-
4.	Benz E320	TR 6828 K	2003	benzinë	8.8 -10	24.8	23.3	-
5.	Benz S 300	Tr 3019 I	1990	benzinë	13.8			-
6.	Audi A6	AA 280 MR	2011	naftë	7.4-8.2	32	32.2	-
7.	Jeep Grand Cherokee	AA 770 DI	2009	naftë	14.8	14.8	20.9	-
8.	Toyota Prius	AA 016 PL	2016	benzinë	3.4 - 3.9	8.6	9.6	-
9.	Volksëagen Touareg	AA 243 JB	2007	naftë	13.8 – 15.9	21	27	-
10.	Volksëagen Touareg	AA 781 IK	2007	naftë	13.8 – 15.9		23.3	-
11.	Volksëagen Passat	AA 845 YG	2008	naftë	6.6 – 8.6	-	16.5	-
12.	Mercedes Benz s350 Bluetec	AA 575 OS	2017	naftë	5.1 - 6.4			-

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Shënim: Për normën e harxhimit marr si bazë për referencën tonë (me qëllim shmangien e argumenteve mospërputhës mes modelit të përdorur nga ana e subjektit dhe atij të referuar nga ne) është marr intervali i plotë për të tre rastet: city, highway dhe combined.

Nga verifikimi që ju bë harxhimit të karburantit u konstatua se, nga ana e MEPJ për periudhën objekt auditimi nuk janë përcaktuar normat e harxhimit të karburantit për çdo mjet në përdorim.

Gjetje nr.12:

Nga auditimi sa i takon normativave të harxhimit u konstatua se,

- nga krahasimi mes normave të konsumit sipas secilit model referuar manualit të automjeteve dhe normave të specifikuara nga MEPJ rezultonin mospërputhje në të gjithë rastet;
- mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së;

- Nuk janë nxjerrë normativat e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së për vitin 2022 dhe për vitet 2020-2021 nuk janë të miratuara me Urdhër të Titullarit (ato që janë përcaktuar pjesërisht për vitin 2020 nuk janë të miratuara nga Titullari institucionit, (nga 12 automjete janë nxjerr vetëm për 7) dhe për vitin 2022 mungojnë plotësisht);
- Trendi rritës i harxhimit, referuar normativave jozyrtare (ato që janë të cituara në fletë udhëtimi) nga viti 2020 në vitin 2021 është i pa justifikuar nga ana e subjektit, p.sh automjeti Jeep Grand ka rritje me 6.1l/100 km dhe Volksaëen Touareg me 6 l/100 km.

Titulli i Gjetjes 12:	<i>Lidhur me karburantin dhe automjetet e MEPJ-së</i>
Situata:	<p>Nga auditimi sa i takon normativave të harxhimit u konstatua se,</p> <ul style="list-style-type: none"> - nga krahasimi mes normave të konsumit sipas secilit model referuar manualit të automjeteve dhe normave të specifikuara nga MEPJ rezultoi mospërputhje në të gjithë rastet; - mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së; - Nuk janë nxjerrë normativat e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së për vitin 2022 dhe për vitet 2020-2021 nuk janë të miratuara me Urdhër të Titullarit (ato që janë përcaktuar pjesërisht për vitin 2020 nuk janë të miratuara nga Titullari institucionit, (nga 12 automjete janë nxjerr vetëm për 7) dhe për vitin 2022 mungojnë plotësisht); - Trendi rritës i harxhimit, referuar normativave jozyrtare (ato që janë të cituara në fletë udhëtimi) nga viti 2020 në vitin 2021 është i pa justifikuar nga ana e subjektit, p.sh automjeti Jeep Grand ka rritje me 6.1l/100 km dhe Volksaëen Touareg me 6 l/100 km.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk i lartë në keqmenaxhimin / keqpërdorimin e pasurisë / pronës publike.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	<p>Të merren masa për :</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktimin e normave të harxhimit / konsumit për secilin automjet në përdorim në përputhje me bazën ligjore përkatëse. - hartohen në mënyrë periodike raporte dhe procesverbale për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e institucionit në kuadër të një sistemi kontrolli dhe monitorimi proaktiv; - plotësimin me dokumentacionin e domosdoshëm justifikues të praktikave.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nga ana e grupit të auditimit u konstatua se kishte mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ;

Pamundësi e kryerjes së kryqëzimit të të dhënave midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimeve të plotësuara për lëvizjet e brendshme për të cilat është bërë tërheqja e karburantit bazuar në kilometrat e përshkruar, për arsye sepse nuk disponoheshin të dhëna të lëvizjeve, në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, si dhe në kundërshtim të plotë me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Gjetje nr.13:

Nga auditimi rezultoj se, nga ana e MEPJ-së nuk është vendosur një plan mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së lëvizjeve të personave që i përdorin për nevoja të punës.

- Nga ana e MEPJ-së, nuk kryhet asnjë verifikim për kilometrat e kryera nga makinat e Ministrisë.

Titulli i Gjetjes 13:	<i>Lidhur me karburantin dhe automjetet e MEPJ-së</i>
Situata:	Nga auditimi rezultoj se, nga ana e MEPJ-së nuk është vendosur një plan mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së lëvizjeve të personave që i përdorin për nevoja të punës. - Nga ana e MEPJ-së, nuk kryhet asnjë verifikim për kilometrat e kryera nga makinat e Ministrisë.
Kriteri:	- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk i lartë në keqmenaxhimin / keqpërdorimin e pasurisë / pronës publike.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Të merren masa të hartohet dhe miratohet një plan mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së lëvizjeve të personave që i përdorin për nevoja të punës, si dhe në mënyrë të vazhdueshme të kryhen verifikime për kilometrat e kryera nga makinat e Ministrisë.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Administrimi i Karburantit

Për 13 automjetet në funksion të MEPJ-së është mbajtur dokumentacioni justifikues mbi kryerjen e shërbimit dhe është nënshkruar rregullisht nga zyrtarët apo punonjësit udhëtues. Nga auditimi u konstatua se, praktika e tërheqjes së karburantit bëhej pa autorizim apo urdhër tërheqje. Prej subjektit specifikohet se tërheqja kryhet duke mbajtur në konsideratë planifikimin për çdo makinë.

U vërejtën mangësi e parregullsi në plotësimin e fletëve të udhëtimit, konkretisht:

- u konstatuan raste që nuk dokumentonin kilometrazhin e lëvizjes. Nga auditimi me zgjedhje i 7 fletëve të udhëtimit, në 5 prej tyre konstatohet fenomeni i sipërcituar
- u konstatua se, plotësimi i fletëve udhëtimeve kryhej formalisht, pa pasqyruar volumin real të distancës kilometrike.
- u konstatua se, plotësimi i fletëve udhëtimeve kishte një normë të lartë të mos-rakordimit të distancave reale të destinacioneve dhe atyre të pasqyruara në regjistër.

Viti 2020

Konkretisht, u audituan fletëve udhëtimit për makinën Honday me targë AA 69 02 R,

Norma e harxhimit 11,7 l/100 km

Përshkruar 11,223 km

Harxhuar 1,320 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 1,313 litra, dif 7 litra

Makina Toyota me targë AA 096 PL,

Norma e harxhimit 7.3 l/100 km

Përshkruar 33,566 km

Harxhuar 2,480 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 2,450 litra, dif 30 litra

Makina me targë AA 845 YG nuk ka të përcaktuar Normën e harxhimit, kilometrat e përshkruar dhe sasinë e karburantit të harxhuar.

Makina me targë AA 770 DI

Norma e harxhimit 14.8 l/100 km

Përshkruar 12,980 km

Harxhuar 1,920 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 1,912 litra, dif 8 litra

Makina me targë AA 097 PL nuk ka të përcaktuar Normën e harxhimit, kilometrat e përshkruar dhe sasinë e karburantit të harxhuar

Makina me targë AA 280MR (Audi A6)

Norma e harxhimit 32 l/100 km

Përshkruar 10,480 km

Harxhuar 3,380 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 3,354 litra, dif 24 litra

Nga auditimi u konstatua normë shumë e lartë harxhimi e kësaj makine, e cila nuk përkon me të dhënat xhenerike të automjetit, po ashtu në auditimin e lëvizjeve të saj u konstatua mungesë informacioni për lëvizjet e kryera. Kudo shkruhej vetëm lëvizje për protokollin e shtetit.

Makina me targë AA 016 PL

Norma e harxhimit 8.6 l/100 km

Përshkruar 9,600 km

Harxhuar 828 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 826 litra.

Makina me targë AA 243 JB

Norma e harxhimit 21 l/100 km

Përshkruar 94,625 km

Harxhuar 970 litra

Makina me targë TR 6828 K

Norma e harxhimit 24.8 l/100 km

Përshkruar 8,745km

Harxhuar 2,170 litra

Me qëllim verifikimin e përdorimit të sasive të karburantit në përputhje me distancat kilometrike të kryera nga automjetet e MEPJ, nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën ato automjete që kishin krey më tepër kilometra, si dhe respektivisht muajt me më tepër lëvizje.

Për vitin 2020 u përzgjedhën automjetet:

1. AA 770 DI,

*Në muajin janar kryer 15 lëvizje të gjitha brenda Tiranës ku distanca më e largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Rinas, sipas distancës në kilometra në hartën e Republikës së Shqipërisë prej 20 km nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 223 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 100.4 km total pasi 2 raste janë ‘lëvizje brenda Tiranës’ pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 122.6 km shumë e lartë për të justifikuar 2 lëvizje brenda Tiranës.**

*Në muajin Shkurt kryer 54 lëvizje ku nga ku vetëm 1 jashtë Shqipërisë, me destinacion Selanik. Referuar fletëudhëtimet km e përshkruar rezultojnë në total 1,473 dhe sipas distancës në hartë identifikojmë vetëm 1,007.6 km pasi 7 raste janë ‘lëvizje brenda Tiranës’ pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 465.4 km shumë e lartë për të justifikuar 7 lëvizje brenda Tiranës.**

*Në muajin Mars janë kryer 9 lëvizje të gjitha brenda Tiranës, ku distanca më e largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Kontrolli Teknik i Automjeteve me 2.9 km referuar distancës kilometrike në hartë; nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 48 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 26.6 km total, për periudhën 01.03-06.03 pasi 1 rast është ‘lëvizje brenda Tiranës’ pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 21.4 për të justifikuar 1 lëvizje brenda Tiranës.**

Nga data 11.03.2020 deri në muajin qershor automjeti ka qenë në servis;

*Në muajin qershor janë kryer 30 lëvizje, ku distancat më të largëta referuar fletëudhëtimeve rezultojnë Savarjeva, Podgorica, Prishtina nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 1718 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 1,683.1 km total, pasi 10 raste janë ‘marrje dhe dërgim punëtorësh brenda Tiranës’ pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 34.9 km për të justifikuar 10 lëvizje brenda Tiranës.**

*Në muajin korrik janë kryer 40 lëvizje brenda Tiranës dhe jashtë Shqipërisë, me destinacion Prishtinë dhe Athinë, nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 2,722 km dhe nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 2,020.6 km për rrugë pasi 18 raste janë ‘lëvizje brenda Tiranës’ pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 701.4 km shumë e lartë për të justifikuar 18 lëvizje brenda Tiranës.**

*Në muajin Gusht janë kryer 24 lëvizje, ku brenda Tiranës 20 dhe jashtë Shqipërisë 2 lëvizje me destinacion Prishtinë(4 vajte ardhje), nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 1,229.9 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 1,150.3 km për rrugë pasi 7 raste janë ‘lëvizje brenda Tiranës’ pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 79.6 km për të justifikuar 7 lëvizje brenda Tiranës.**

Në muajin Shtator janë kryer 12 lëvizje brenda Tiranës, ku distanca më e largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Rinas me 20 km referuar distancës kilometrike në hartë; nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 171 km dhe nga distanca kilometrike të hartë

identifikojmë vetëm 90.6 km total (vajtje-ardhje) pasi 4 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 80.4 km për të justifikuar 4 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Tetor janë kryer 37 lëvizje brenda Tiranës, Tiranës dhe 2 jashtë(4 vajtje ardhje) me distancë më të largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Sarajeva dhe Prishtina; nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 1,707 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 1,147.2 km total (vajtje-ardhje) pasi 6 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 559.8 km shumë e lartë për të justifikuar 6 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Nëntor janë kryer 36 lëvizje, ku 34 brenda Tiranës dhe 2 jashtë dhe distanca më e largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Selaniku, nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 1,813 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 1,274.2km total (vajtje-ardhje) pasi 10 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 538.8 km shumë e lartë për të justifikuar 10 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Dhjetor janë kryer 34 lëvizje brenda Tiranës, ku distanca më e largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Rinas me 20 km referuar distancës kilometrike në hartë; nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 1,813 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 1,274.2 km total (vajtje-ardhje) pasi 10 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 538.8 km shumë e lartë për të justifikuar 10 lëvizje brenda Tiranës.*

Nga auditimi i destinacionit të lëvizjeve u konstatuan 14 raste të shkuarjes në servis, kur ky automjet ka qëndruar në servis për periudhën 11.03-01.06

2. AA 096 PL,

Në muajin janar kryer 22 lëvizje të gjitha brenda Tiranës ku distanca më e largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Rinas, sipas distancës në km në hartën e Republikës së Shqipërisë prej 20 km, nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 2,100 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 160 km total për 4 vajtje-ardhje nga MEPJ në Rinas, dhe 18 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' kunjë është në M.Mbrojtjes, një në Presidencë, dhe një me mbishkrimin Ambasadë po pa specifikuar se tek cila; pjesa tjetër 15 lëvizje brenda Tiranës pa përcaktuar destinacionin;total referuar distancave kilometrike në hartë rezulton në 170.4 km të kryera, *diferenca prej 1,929.6 km për të justifikuar 15 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Shkurt kryer 38 lëvizje nga ku një në Podgoricë dhe një në Shkup, 2 në Rinas dhe 34 brenda për brenda Tiranës,

Referuar fletëudhëtimet km e përshkruar rezultojnë në total 1,960 dhe sipas distancës në hartë identifikojmë vetëm 1,008 km pasi 32 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 952 km për të justifikuar 7 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Mars janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës, pa përcaktuar destinacionin vetëm me arsyetimin lëvizje personeli; *total 3,500 kmpër 38 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Prill kryer 23 lëvizje nga ku, dy në Durrës, një në Muriqan, një në Janinë 3 në Rinas dhe një në Korçë pjesa tjetër lëvizje brenda për brenda Tiranës, referuar fletëudhëtimet km e përshkruar rezultojnë në total 2,210 km dhe sipas distancës në hartë identifikojmë vetëm 1,462 km pasi 12 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 748 km për të justifikuar 12 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Maj kryer 38 lëvizje nga ku, një në Podgoricë, një në Rinas dhe një në Durrës pjesa tjetër lëvizje brenda për brenda Tiranës,

Referuar fletëudhëtimet km e përshkruar rezultojnë në total 2,800 km dhe sipas distancës në hartë identifikojmë vetëm 444 km pasi 26 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 2,356 km për të justifikuar 26 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Qershor janë kryer 38 lëvizje, ku të gjitha lëvizjet janë brenda Tiranës, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,240 km, të gjitha pa destinacion;

Në muajin Korrik janë kryer 29 lëvizje nga ku, shtatë në Rinas, një në Prishtinë, një në Kryeministri, 1 në Min.Financave, 1 në Presidencë, 1 në Thesar, 1 në Min.Drejtesisë dhe 12 lëvizje brenda për brenda Tiranës, referuar fletëudhëtimet km e përshkruar rezultojnë në total 2,380 km dhe sipas distancës në hartë identifikojmë vetëm 818.8 km pasi 12 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 1,531.2 km për të justifikuar 12 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Gusht janë kryer 38 lëvizje, ku një në Maqedoni, dy në Kosovë dhe tetë në Rinas, 27 lëvizjet e tjera janë brenda Tiranës, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë 2,660 km sipas distancës në hartë identifikojmë vetëm 2,034 km pasi 27 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 2,034 km për të justifikuar 27 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Shtator janë kryer 38 lëvizje, ku të gjitha lëvizjet janë brenda Tiranës, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,240 km, të gjitha pa destinacion;

Në muajin Tetor janë kryer 27 lëvizje brenda Tiranës, Tiranës dhe 2 jashtë (4 vajtje ardhje) me distancë më të largët referuar fletëudhëtimeve rezultonte Sarajeva dhe Prishtina; nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 1,707 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 1,147.2 km total (vajtje-ardhje) pasi 6 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 559.8 km shumë e lartë për të justifikuar 6 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Nëntor janë kryer 38 lëvizje, ku vetëm 1 në Sarajevë dhe 37 brenda Tiranës nga fletëudhëtimet rezultojnë të përshkruara 2,100 km dhe nga distanca kilometrike të hartë identifikojmë vetëm 786 km total (vajtje-ardhje) pasi 37 raste janë 'lëvizje brenda Tiranës' pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 1,314 km për të justifikuar 37 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Dhjetor janë kryer 38 lëvizje, ku të gjitha lëvizjet janë brenda Tiranës, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,160 km, të gjitha pa destinacion;

3. AA 280 MR (Audi A6)

Në muajin Janar janë kryer 775 km;

Në muajin Shkurt janë kryer 868 km;

Në muajin Mars janë kryer 775 km;

Në muajin Prill janë kryer 713 km;

Në muajin Maj janë kryer 713 km;

Në muajin Qershor janë kryer 930 km;

Në muajin Korrik janë kryer 868 km;

Në muajin Gusht janë kryer 341 km;

Në muajin Shtator janë kryer 1,209 km;

Në muajin Tetor janë kryer 1,364 km;

Në muajin Nëntor janë kryer 775 km;

Në muajin Dhjetor janë kryer 1,148 km.

Në auditimin e lëvizjeve të këtij automjeti u konstatua mungesë informacioni për lëvizjet e kryera. Kudo shkruhej vetëm lëvizje për protokollin e shtetit.

Viti 2021

Konkretisht, u audituan fletë udhëtimi për:

Makina Hondai me targë AA 69 02 R,

Norma e harxhimit 12.7 l/100 km

Përshkruar 14,072 km

Harxhuar 1,790 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 1,787 litra, dif 3 litra

Makina Toyota me targë AA 096 PL

Norma e harxhimit 7.2 l/100 km

Përshkruar 45,750 km

Harxhuar 3,300 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 3,294 litra, dif 6 litra

Makina me targë AA 845 YG

Norma e harxhimit 16.5 l/100 km

Përshkruar 14,900 km

Harxhuar 2470 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 2458 litra, diferenca 12 litra

Makina me targë AA 770 DI

Norma e harxhimit 20.9 l/100 km

Përshkruar 9,120 km

Harxhuar 1,910 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 1,906 litra, dif 4 litra

Makina me targë AA 097 PL

Norma e harxhimit 10 l/100 km

Përshkruar 26,112 km

Harxhuar 2,611 litra

Makina me targë AA 280MR (Audi A6)

Norma e harxhimit 32,2 l/100 km

Përshkruar 14,043 km

Harxhuar 4,530 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 4,522 litra, dif 8 litra

Më total 12 lëvizje, pa destinacion, me mbishkrimin “për protokollin e shtetit” kryer 14,010 km

Makina me targë AA 016 PL

Norma e harxhimit 9.6 l/100 km

Përshkruar 14,851 km

Harxhuar 1,420 litra

Makina me targë AA 243 JB

Norma e harxhimit 27 l/100 km

Përshkruar 2,760 km

Harxhuar 750 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 745 litra, dif 5 litra

Në total 36 lëvizje, nga të cilat 18 të tjera pa destinacion, por me mbishkrimin në funksion të titullarit dhe kryer 2,760 km dhe 18 “lëvizje në tiranë” kryer 175 km.

Makina me targë TR 6828 K

Norma e harxhimit 23.3 l/100 km

Përshkruar 14,680 km

Harxhuar 3,420 litra

Makina me targë AA 781 IK

Norma e harxhimit 23.3 l/100 km

Përshkruar 8,642 km

Harxhuar 2,020 litra

Referuar kësaj norme, rezulton se duhet të ishin harxhuar 2,013 litra, dif 7 litra.

Për vitin 2021 u përzgjedhën automjetet:

1. AA 096 PL,

Në muajin Janar janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,800 km;

Në muajin Shkurt janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,900 km;

Në muajin Mars janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,500 km;

Në muajin Prill janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,800 km;

Në muajin Maj janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,800 km;

Në muajin Qershor janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 5,520 km;

Në muajin Korrik janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,100 km;

Në muajin Gusht janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,800 km;

Në muajin Shtator janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,830 km;

Në muajin Tetor janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,900 km;

Në muajin Nëntor janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,900 km;

Në muajin Dhjetor janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,900 km;

2. AA 097 PL,

Në muajin janar janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,000 km;

Në muajin Shkurt janë kryer 38 lëvizje, ku 35 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, dhe 3 lëvizje drejt Rinasit, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,000 km; nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 120km total (vajtje-ardhje) pasi për 35 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 880 km për të justifikuar 35 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Mars janë kryer 38 lëvizje, ku 37 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, dhe 1 në Rinas, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,300 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 40km total (vajtje-ardhje) pasi për 37 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 1,260 km për të justifikuar 37 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Prill janë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Kosovë, 2 në Rinas dhe 35 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,500 km,

nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 624km total (vajtje-ardhje) pasi për 35 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 876 km për të justifikuar 35 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Maj janë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Athinë dhe 1 në Rinas, 36 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,500 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 1,502km total (vajtje-ardhje) pasi për 36 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 1,998 km për të justifikuar 36 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Qershor janë kryer 38 lëvizje, 1 në Prizren, 2 në Rinas dhe 36 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,500 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 450km total (vajtje-ardhje) pasi për 36 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 2,050 km për të justifikuar 36 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Korrik janë kryer 38 lëvizje, 1 në Shkup, 1 në Shkodër, 2 në Rinas, dhe 34 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,000 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 760km total (vajtje-ardhje) pasi për 35 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 2,240 km për të justifikuar 34 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Gusht janë kryer 38 lëvizje, 2 në Sarandë, 1 në Rinas dhe 35 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,000 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 572km total (vajtje-ardhje) pasi për 35 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 1,428 km për të justifikuar 35 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Shtator janë kryer 38 lëvizje, 1 në Prishtinë dhe 2 në Lezhë, pjesa tjetër 35 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,310 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 786km total (vajtje-ardhje) pasi për 35 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 1,524 km për të justifikuar 35 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Tetor janë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Podgoricë, 1 në Rinas, dhe 36 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,500 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 312km total (vajtje-ardhje) pasi për 35 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 2,188 km për të justifikuar 35 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Nëntor janë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Sarandë dhe 2 në Rinas, si dhe 36 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,002 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 878km total (vajtje-ardhje) pasi për 36 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 1,124 km për të justifikuar 36 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Dhjetor janë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Athinë, 1 në Podgoricë dhe 36 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,000 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 1,734km total (vajtje-ardhje) pasi për 36 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 1,266 km për të justifikuar 36 lëvizje brenda Tiranës.*

3. TR 6828 K

Në muajin janar janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,320 km;

Në muajin Marsjanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,160 km;

Në muajin Prilljanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,000 km;

Në muajin Maj janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,400 km;

Në muajin Korrik janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,320 km;

Në muajin Shtator janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,680 km;

Në muajin Nëntor janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,400 km;

Në muajin Dhjetor janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,400 km;

Për vitin 2022 u përzgjedhën automjetet:

Konkretisht, u audituan fletë udhëtimi për:

1. Makina Hondai me targë AA 69 02 R, për periudhën janar-qershor
Përshkruar 7,300 km

2. Makina Toyota me targë AA 096 PL për periudhën janar-qershor
Përshkruar 27,524 km

3. Makina me targë AA 845 YG për periudhën janar-gusht
Përshkruar 7,520 km

4. Makina me targë AA 770 DI për periudhën janar-shtator
Përshkruar 12,200 km

5. Makina me targë AA 097 PL për periudhën janar- gusht
Përshkruar 14,850 km

6. Makina me targë AA 280MR (Audi A6) për periudhën janar-gusht
Përshkruar 6,030 km

7. Makina me targë AA 016 PL për periudhën janar-14.08
Përshkruar 14,838 km

8. Makina me targë AA 243 JB periudha nga janar deri 30.05.2022
Përshkruar 3,550 km, lëvizje “brenda tiranës” pa destinacion

9. Makina me targë TR 6828 K për periudhën janar- gusht
Përshkruar 11,640 km

10. Makina me targë AA 781 IK për periudhën janar-gusht
Përshkruar 6,219 km

1.AA 096 PL

Në muajin Janar janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,200 km;

Në muajin Shkurt janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,200 km;

Në muajin Marsjanë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,900 km;

Në muajin Prilljanë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,900 km;

Në muajin Maj janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,060 km;

Në muajin Qershorjanë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 6,264 km;

Në total për 6 mujorin e parë janë përshkruar 27,524 km për 228 lëvizje brenda për brenda Tiranës.

2. AA 770 DI

*Në muajin Janar janë kryer 36 lëvizje, 1 në Shëngjin dhe 1 në Rinas, ndërkohë 34 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 500 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 182km total (vajtje-ardhje) pasi për 34 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 318 km për të justifikuar 34 lëvizje brenda Tiranës.**

Në muajin Shkurtjanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, 12 lëvizje me personelin dhe 14 lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 4,200 km;

Në muajin Marsjanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,400 km;

Në muajin Prilljanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,400 km;

Në muajin Maj janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,440 km;

Në muajin Qershorjanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 3,340 km;

Në muajin Korrikjanë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,220 km;

Në muajin Shtator janë kryer 36 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 300 km;

Në total për 8 mujorin e parë janë përshkruar 12,200 km për 287 lëvizje brenda për brenda Tiranës.

3. TR 6828 K

Në muajin Janar janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me personelin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,000 km;

Në muajin Shkurtjanë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me personelin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 900 km;

Në muajin Mars janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me personelin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,125 km;

Në muajin Prill janë kryer 38 lëvizje të gjitha brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me personelin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,265 km;

Në muajin Maj janë kryer 19 lëvizje ku 1 në Rinas dhe 18 brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, të gjitha lëvizje me kabinetin, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 50

km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 40km total (vajtje-ardhje) pasi për 18 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; *Diferenca prej 10 km për të justifikuar 18 lëvizje brenda Tiranës.*

Në muajin Qershorjanë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Rinas dhe 37 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,100 km; nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 40km total (vajtje-ardhje) pasi për 37 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 2,060 km për të justifikuar 37 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Korrikjanë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Shkup, 1 në Rinas dhe 36 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 1,220 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 512km total (vajtje-ardhje) pasi për 36 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 708 km për të justifikuar 36 lëvizje brenda Tiranës.

Në muajin Gushtjanë kryer 38 lëvizje, ku 1 në Rinash dhe 37 lëvizje brenda Tiranës pa destinacion specifik të përcaktuar, referuar fletëudhëtimeve rezultojnë të përshkruara 2,300 km, nga distanca kilometrike në hartë identifikojmë vetëm 40km total (vajtje-ardhje) pasi për 37 rastet e lëvizjeve brenda Tiranës kemi të pa përcaktuar destinacionin; Diferenca prej 2,260 km për të justifikuar 37 lëvizje brenda Tiranës.

Në total për 8 mujorin e parë janë përshkruar 11,640 km për 280 lëvizje brenda për brenda Tiranës.

Përmbledhtazi në tabelën e mëposhtme situata mbi automjetet e përzgjedhura për t'ju audituar fletëudhëtimet:

2020	AA 770 DI		AA 096 PL		AA 280 MR	
	Distanca në km	Nr. lëvizje	Distanca në km	Nr. lëvizje	Distanca në km	Nr. Lëvizje
Janar	122.6	2	1,929.6	15	775	protokoll i shtetit
Shkurt	465.4	7	952	7	868	protokoll i shtetit
Mars	21.4	1	3,500	38	775	protokoll i shtetit
Prill			748	12	713	protokoll i shtetit
Maj			2,356	26	713	protokoll i shtetit
Qershor	34.9	10	3,240	38	930	protokoll i shtetit
Korrik	701.4	18	1,531.2	12	868	protokoll i shtetit
Gusht	79.6	7	2,034	27	341	protokoll i shtetit
Shtator	80.4	4	3,240	38	1,209	protokoll i shtetit
Tetor	559.8	6	559.8	6	1,364	protokoll i shtetit
Nentor	538.8	10	1,314	37	775	protokoll i shtetit
Dhjetor	538.8	10	4,160	38	1,148	protokoll i shtetit
Total	1,976.3	75	25,564.6	294	10,479	
2021	AA 097 PL		AA 096 PL		TR 6828 K	
	Distanca në km	Nr. lëvizje	Distanca në km	Nr. lëvizje	Distanca në km	Nr. Lëvizje
Janar	1,000	38	2,800	36	1,320	36
Shkurt	880	35	3,900	36		
Mars	1,260	37	3,500	36	1,160	36
Prill	876	35	2,800	36	2,000	36
Maj	1,998	36	2,800	36	2,400	36
Qershor	2,050	36	5,520	36		
Korrik	2,240	34	2,100	36	2,320	36
Gusht	1,428	35	2,800	36		
Shtator	1,524	35	4,830	36	1,680	36

<i>Tetor</i>	2,188	36	4,900	36		
<i>Nentor</i>	1,124	36	4,900	36	1,400	36
<i>Dhjetor</i>	1,266	36	4,900	36	2,400	36
Total	17,834	429	45,750	432	14,680	288
2022	AA 770 DI		AA 096 PL		TR 6828 K	
	<i>Distanca në km</i>	<i>Nr. lëvizje</i>	<i>Distanca në km</i>	<i>Nr. lëvizje</i>	<i>Distanca në km</i>	<i>Nr. Lëvizje</i>
<i>Janar</i>	318	34	4,200	38	2,000	38
<i>Shkurt</i>	4,200	36	4,200	38	900	38
<i>Mars</i>	2,400	36	4,900	38	1,125	38
<i>Prill</i>	1,400	36	4,900	38	1,265	38
<i>Maj</i>	1,440	36	3,060	38	10	18
<i>Qershor</i>	3,340	36	6,264	38	2,060	37
<i>Korrik</i>	1,220	36			708	36
<i>Gusht</i>					2,260	37
<i>Shtator</i>	300	36				
Total	12,200	287	27,524	228	11,640	280

Burimi: MEPJ, përpunoi Grupi Auditimit

Nga auditimi i kryer mbi fletëudhëtimet dhe kryeqëzimi më distancat kilometrike të raportuara si të kryera nga automjetet e MEPJ, nga ana e grupit të auditimit u operua me përgjdhje ato automjete që kishin kryer më tepër kilometra, si dhe respektivisht muajt me më tepër lëvizje, sa më sipër rezultoj se,

- Për vitin 2020, nga 3 automjetet e përgjdhura për lëvizjet brenda për brenda Tiranës, pa destinacion specifik, totali i kilometrave të kryera ishte 27,834.8 km për 369 lëvizje;
- Për vitin 2021, nga 3 automjetet e përgjdhura për lëvizjet brenda për brenda Tiranës, pa destinacion specifik, totali i kilometrave të kryera ishte 78,264 km për 1,149 lëvizje;
- Për vitin 2022, nga 3 automjetet e përgjdhura për lëvizjet brenda për brenda Tiranës, pa destinacion specifik, totali i kilometrave të kryera ishte 51,364 km për 795 lëvizje.

Gjetje nr.14 :

Sa i takon lëvizjeve me automjete u konstatua se,

- Për vitin 2020
 - Nga auditimi u konstatua normë shumë e lartë harxhimi e automjetit AA280MR (Audi A6), e cila nuk përkon me të dhënat xhenerike të automjetit;
 - Nga krahasimi i distancave kilometrike të përshkruara nisje-mbërritje referuar fletëve të udhëtimit dhe distancës kilometrike në hartë u konstatuan diferenca të konsiderueshme;
 - Automjeti me targë AA 096 PL në total 294 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 25,564.6 km.
 - Automjeti me targë AA 280 MR në total nuk specifikohet numri i lëvizjeve, ka vetëm shënimin “lëvizje për protokollin e shtetit” kryer 10,479 km.
 - Automjeti me targë AA 770 DI në total 75 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 1,976.3 km.
- Për vitin 2021
 - Nga krahasimi i distancave të përshkruara nisje-mbërritje referuar fletëve të udhëtimit dhe distancës kilometrike në hartë u konstatuan diferenca të konsiderueshme;
 - Automjeti me targë AA 280 MR (Audi A6) në total 12 lëvizje, pa destinacion, me mbishkrimin “për protokollin e shtetit” kryer 14,010 km

- Automjeti me targë AA 243 JB në total 36 lëvizje, nga të cilat 18 të tjera pa destinacion, por me mbishkrimin në funksion të titullarit dhe kryer 2,760 km dhe 18 “lëvizje në tiranë” kryer 175 km.
 - Automjeti me targë AA 096 PL në total 432 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 45,750 km;
 - Automjeti me targë AA 097 PL në total 429 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 17,834 km;
 - Automjeti me targë TR 6828 K në total 288 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 14,680 km
 - *Për vitin 2022 (janar-gusht 2022) u konstatua se,*
 - Në asnjë rast nuk ishte detajuar destinacioni;
 - Në asnjë rast nuk ishte specifikuar arsyeja e lëvizjes.
 - Automjeti me targë AA 096 PL në total 228 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, për periudhë 6 mujore, kryer 27,524 km;
 - Automjeti me targë AA 770 DI në total 287 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, për periudhë 7 mujore, kryer 12,200 km;
 - Automjeti me targë TR 6828 K në total 280 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, për periudhë 8 mujore, kryer 11,640 km
- Në të gjithë rastet kilometrat e kryera janë shumë të larta referuar lëvizjeve nrenda për brenda qytetit.

Titulli i Gjetjes 14:	Lidhur me karburantin dhe automjetet e MEPJ-së
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, Sa i takon lëvizjeve me automjete u konstatua se,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2020 <ul style="list-style-type: none"> - Nga auditimi u konstatua normë shumë e lartë harxhimi e automjetit AA280MR (Audi A6), e cila nuk përkon me të dhënat xhenerike të automjetit; - Nga krahasimi i distancave kilometrike të përshkruara nisje-mbërritje referuar fletëve të udhëtimit dhe distancës kilometrike në hartë u konstatuan diferenca të konsiderueshme; - Automjeti me targë <u>AA 096 PL</u> në total 294 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 25,564.6 km - Automjeti me targë <u>AA 280 MR</u> në total nuk specifikohet numri i lëvizjeve, ka vetëm shënimin “lëvizje për protokollin e shtetit” kryer 10,479 km - Automjeti me targë <u>AA 770 DI</u> në total 75 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 1,976.3 km • Për vitin 2021 <ul style="list-style-type: none"> - Nga krahasimi i distancave të përshkruara nisje-mbërritje referuar fletëve të udhëtimit dhe distancës kilometrike në hartë u konstatuan diferenca të konsiderueshme; - Automjeti me targë <u>AA 280MR (Audi A6)</u> në total 12 lëvizje, pa destinacion, me mbishkrimin “për protokollin e shtetit” kryer 14,010 km

	<ul style="list-style-type: none"> - Automjeti me targë <u>AA 243 JB</u> në total 36 lëvizje, nga të cilat 18 të tjera pa destinacion, por me mbishkrimin në funksion të titullarit dhe kryer 2,760 km dhe 18 “lëvizje në tiranë” kryer 175 km. - Automjeti me targë <u>AA 096 PL</u> në total 432 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 45,750 km; - Automjeti me targë <u>AA 097 PL</u> në total 429 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 17,834 km; - Automjeti me targë <u>TR 6828 Kn</u> në total 288 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, kryer 14,680 km • <i>Për vitin 2022 (janar-gusht 2022) u konstatua se,</i> - Në asnjë rast nuk ishte detajuar destinacioni; - Në asnjë rast nuk ishte specifikuar arsyeja e lëvizjes. - Automjeti me targë <u>AA 096 PL</u> në total 228 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, për periudhë 6 mujore, kryer 27,524 km; - Automjeti me targë <u>AA 770 DI</u> në total 287 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, për periudhë 7 mujore, kryer 12,200 km; - Automjeti me targë <u>TR 6828 Kn</u> në total 280 lëvizje brenda për brenda Tiranës, pa destinacion, për periudhë 8 mujore, kryer 11,640 km <p>Në të gjithë rastet kilometrat e kryera janë shumë të larta referuar lëvizjeve nrenda për brenda qytetit.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me planin kontabël të miratuar për institucionet, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Risk i lartë në keqmenaxhimin / keqpërdorimin e pasurisë / pronës publike.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Të merren masa të dokumentohen lëvizjet e automjeteve në mënyrë korrekte duke shmangur plotësimet evazive dhe të paqarta.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë

Nga auditimi me zgjedhje, u vërejtën mangësi e parregullsi, mbi kilometrat e pasqyruara në fletë udhëtime. Sikundër pasqyrohet në tabelën sipërcituar, mes kilometrave të pasqyruara në fletë udhëtimi dhe atyre faktike ka diferencë në terma materiale; në asnjë rast nuk është specifikuar masa e konsumit të karburantit të automjeteve, në vetëm një pjesë të rasteve është shënuar destinacioni i nisjes ose kthimit dhe në pjesën tjetër operohet duke shënuar vetëm “lëvizje brenda tiranës”, etj, vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe paragrafin nr. 36, të Udhëzimit të Ministrit të Financave

nr. 30/2011, ku përcaktohet se: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”: si dhe pikën nr. 6, kreu II, të ligjit nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, që shpreh se: “Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes” dhe paragrafin nr. 36 kreu III, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30/2011: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve. “

Nuk është kryer për periudhën objekt auditimi inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit në çdo fund viti apo në çdo proces të inventarizimit të kryer, në shkelje të kërkesave të pikës 74, kreu IV, të UMF nr. 30/ 2011, sipas të cilit, “çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Lidhur me çështjen e mësipërme “ Mbi administrimin e pronës shtetërore” mbajtur Akt Konstatim nr.4 datë 16.05.2023, protokolluar në MEPJ nr. 8651 prot., datë 16.05.2023, personat përgjegjës mbi gjetjet nga MEPJ janë: P. K, S.G, G.H, E.H, N.K, E.H, E.Sh

4. Prokurimet e fondeve publike:

I.1 Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të VKM-së nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Udhëzim Nr.2 datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

I.2 Nga ana e Autoritetit Kontraktor Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (këtu e në vijim MEPJ), përgjatë viteve periudhë auditimi, janë kryer procedurat e prokurimit publik, si më poshtë:

➤ **Për vitin 2020** është realizuar 1 procedurë e hapur prokurimi / marrëveshje kuadër, me vlerë totale 16,952,877 lekë pa TVSH.

➤ **Për vitin 2021** janë realizuar 2 procedura të hapura prokurimi / marrëveshje kuadër, me vlerë totale 15,335,281 lekë pa TVSH.

➤ **Për vitin 2022** janë realizuar 2 procedura të hapura prokurimi / marrëveshje kuadër, me vlerë totale 115,044,000 lekë pa TVSH.

Vlera totale e procedurave të hapura dhe marrëveshjeve kuadër për vitet 2020-2022, objekt auditimi, është 147,332,158 lekë.

Nr.	Viti	Objekti	Fondi limit	Lloji i procedurës	Vlera e kontratës
1.	2020	Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian	17,000,000	Procedurë e hapur / Marrëveshje kuadër	16,952,877
2.	2021	Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian	13,128,666.7	Procedurë e hapur / Marrëveshje kuadër	12,936,281
3.	2021	Blerje dhe vendosje ashensor godine	2,480,000	Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)	2,399,000
4.	2022	Blerje dhe vendosje gjenerator godine	4,900,000	Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)	4,499,000
5.	2022	Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete	112,220,076	Procedurë e hapur mbi kufirin monetar (Shërbime)	110,545,000

I.2 Për auditimin e këtyre procedurave u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2020-30.09.2022;
2. Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
3. Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
4. Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së;
5. Përlllogaritja e fondit limit.

1. Procedura e prokurimit “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2020, me fond limit 17,000,000 lekë pa TVSH, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2020.

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian, 2020		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr. 390 datë 01.09.2020 Njësinë e prokurimit: A.Sh, G.H, E.H.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr. 328, datë 08.07.2020 është ngritur grupi komisioni për llogaritjen e fondit limit me përbërje : B.Dh, G.Z dhe E.H	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Urdhri nr 391 datë 01.09.2020 Komisioni i përbërë nga: E.Sh, N.H, S.G.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur / Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 17,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) A.G.G shpk me vlerë oferte 16,952,877.8 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 47,122.2 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 28.09.2020	9. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1 A.G.G shpk me vlerë oferte 16,952,877.8 lekë.

11. Ankimim Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur Marrëveshja kuadër nr. 519, datë 19.10.2020, me fond të përgjithshëm 17,000,000 lekë pa tvsh, me afat 12 muaj. Sipas MK janë lidhur kontratat e mëposhtme: 1-Kontrata nr. 521, datë 20.10.2020 me çmim kontrate 5,761,602 lekë pa tvsh, me afat deri 03.12.2020. 2-Kontrata nr. 95, datë 24.02.2021 me çmim kontrate 5,607,815.4 lekë pa tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. 3-Kontrata nr. 259, datë 18.06.2021 me çmim kontrate 5,566,512.1 lekë pa tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	15. Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: Marrëveshja kuadër me fond të përgjithshëm 20,400,000 lekë me tvsh.	16. Likuiduar Urdhër shpenzimi nr. 571, datë 24.09.2021 Vlera 5,691,333 Lekë me tvsh
17- Faturë 42/2021 Vlera pa tvsh 5,566,512.1 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë Zbatuar 45 ditë nga nënshkrimi i secilës minikontratë	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka

- Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.

Bazuar në memon nr. 62, datë 03.06.2020 drejtoria e BE-së, ka paraqitur kërkesën për përkthim 10,109.78 faqe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe 788.35 faqe nga gjuha shqipe në anglisht. Me miratimin e datës 16.06.2020, Titullari ka vendosur përkthimin e një totali prej 8,500 faqe. Me anë të urdhrin nr. 328, datë 08.07.2020 “Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi komisioni për llogaritjen e fondit limit me përbërje: B.Dh, G.Z dhe E.H. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1, “Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, më datë 24.07.2020, i cili për përllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave, si dhe në çmimet e kontratave të mëparshme.

Anëtarët e komisionit të përllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit vetëm për përkthim 17,980,805.4 lekë pa tvsh, dhe fondi për rishikim prej 2,833,390 lekë pa tvsh, kjo vlerë është nga kontratat e ngjashme të lidhura në vitet paraardhëse. Vlera tejkalohet me 3,814,195.4 lekë nga fondi i parashikuar në regjistrin e prokurimeve publike 2020, ”, fond limit i përcaktuar është vlera 17,000,000 lekë pa tvsh.

Urdhri i prokurimit nr. 390 datë 01.09.2020, urdhëron kryerjen e prokurimit, procedurë e hapur / marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, me fond limit 17,000,000 lekë pa tvsh, dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga A.Sh, G.H, E.H. Njësia e prokurimit më datë

01.09.2020, ka mbajtur procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit, ku jepen kriteret për kualifikim.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas Urdhrit nr 391 datë 01.09.2020 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” urdhërohet të ngrihet komisioni i përbërë nga: S.G, E.Sh, N.H (K).

Më datë 29.09.2020, komisioni ka mbajtur procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku është paraqitur 1 operator ekonomik:

1. Operatori ekonomik A.G.G” shpk me vlerë oferte 16,952,877.8 lekë pa tvsh, i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar OE “A.G.G” shpk me vlerë oferte **16,952,877.8 lekë pa tvsh**, si ofertën më ekonomike pasi ka plotësuar dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Më datë 01.09.2020, është mbajtur raporti përmbledhës i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, dorëzuar me nr. extra prot. datë 07.10.2020, ku jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar dhe shpallur fitues OE A.G.G” shpk me vlerë oferte 16,952,877.8 lekë pa tvsh.

Sipas Autorizimit nr. 520 datë 20.10.2020, është autorizuar E.H për nënshkrimin e kontratës dhe A.J për monitorimin dhe zbatimin e kushteve të kontratës.

-Lidhja e kontratës

Marrëveshja kuadër nr. 519, datë 19.10.2020 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a. me fond të përgjithshëm 17,000,000 lekë pa tvsh, me afat 12 muaj.

-Zbatimi i kontratës.

Sipas MK janë lidhur kontrata e mëposhtme:

1- Kontrata nr. 521, datë 20.10.2020 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësuar nga E.H, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a., me përfaqësues E.P, NIPT K.....S, me çmim kontrate 5,761,602 lekë pa tvsh / 6,913,922.4 lekë me tvsh, me afat deri 03.12.2020. (Përkthimi i 86 akteve evropiane, 2909.90 faqe).

2- Kontrata nr. 95, datë 24.02.2021 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësuar nga E.H, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a. me përfaqësues E.P, NIPT K.....1S, me çmim kontrate 5,607,815.4 lekë pa tvsh / 6,729,378.48 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. (Përkthimi i 64 akteve evropiane, 2832.23 faqe).

3- Kontrata nr. 259, datë 18.06.2021 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësuar nga E.H, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a. me përfaqësues E.P, NIPT K.....S, me çmim kontrate 5,566,512.1 lekë pa tvsh / 6,679,814.52 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. (Përkthimi nga gjuha anglezë në gjuhën shqipe 2582.15 faqe + nga gjuha shqipe në gjuhën anglezë 198.19 faqe).

Operatori ka sjellë faturat tatimore:

- Për kontratën nr. 521, fatura me nr. 2129, datë 07.12.2020, me vlerë 5,761,602 lekë pa tvsh / 6,913,922,4 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 806, datë 16.12.2020.

- Për kontratën nr. 95, fatura elektronike me nr 1/2021, datë 05.05.2021, me vlerë 5,607,815.40 lekë pa tvsh / 6,729,378.48 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 338, datë 10.06.2021.
- Për kontratën nr. 259, fatura elektronike me nr 42/2021, datë 25.08.2021, me vlerë 5,566,512.1 lekë pa tvsh/ 6,679,814.52 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimet me nr 519, datë 09.09.2021 vlera 453,855 dhe nr 571, datë 24.09.2021 vlera 5,681,333.

Gjetje: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurës së prokurimit rezultoi se dosjet e procedurës të prokurimeve nuk janë të numëruara dhe inventarizuara, veprime në kundërshtim Kreun V, ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka paraqitur observacionin nr. 11397 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH nr. 894/6 prot., datë 20.07.2023, ku pretendojnë si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje shërbim përkthimi të legjislacionit të BE”, viti 2020, me fond limit 17,000,000 lekë pa tvsh.

- Në lidhje me përllogaritjen e vlerës limit, subjekti sqaron se në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2020 është parashikuar fondi prej 17,000,000 lek pa tvsh. Komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka parashikuar vlerën prej 17,980,805.4 lek në pikën 6, të vendimmarrjes Komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka sqaruar se përfshire fondin e rishikimit vlera tejkalohe në total por jo për procedurën e prokurimit.
- Referuar konstatimit AK do numerizojë, inventarizojë dhe dorëzojë dosjet pranë Drejtorisë së Sekretarisë Qendrore të MEPJ.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Procedura e prokurimit “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”:

- Referuar DST dhe Urdhrit të Prokurimit nr. 390 datë 01.09.2020, grupi i auditimit shprehet se vlera e fondit limit i prokuruar është 17,000,000 lekë.
- Gjatë auditimit rezultoi se dosjet e prokurimit nuk ishin të numerizuara dhe të inventarizuara, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

2. Procedura e prokurimit “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2021, me fond limit 13,128,666.7 lekë pa TVSH, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2021.

B. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian, 2021		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr. 420 datë 15.09.2021 Njësinë e prokurimit: S.G, G.H, A.R.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr. 263, datë 25.06.2021, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje : B.Dh, N.H dhe G. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Urdhri nr 421 datë 15.09.2021 Komisioni i përbërë nga: E.H, E.Sh, E.H.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit		

Procedurë e hapur / Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 13,128,666.70 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) A.G.G shpk me vlerë oferte 12,936,281 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 192,385.7 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.10.2021	9. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1 A.G.G shpk me vlerë oferte 12,936,281 lekë 2.Ë.T.A” ka paraqitur vetëm ofertën ekonomike, me vlerë oferte 11,919,746 lekë. (i s’kualifikuar).
11. Ankimim Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur Marrëveshja kuadër nr. 18556, datë 29.12.2021 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.p.k., me afat 12 muaj. Sipas MK janë lidhur kontratat e mëposhtme: 1-Kontrata nr. 80, datë 01.04.2022 me çmim kontrate 5,148,175.5 lekë pa tvsh / 6,177,810.60 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. 2-Kontrata nr. 356, datë 25.07.2022, me çmim kontrate 2,524,561.5 lekë pa tvsh / 3,029,473.8 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. 3-Kontrata nr. 11597/2, datë 06.09.2022, me çmim kontrate 5,263,557 lekë pa tvsh / 6,316,268.4 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	15. Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: Marrëveshja kuadër me fond të përgjithshëm 15,523,537.2 lekë me tvsh.	16. Likuiduar Urdhër shpenzimi nr. 957 datë 06.12.2022. Vlera 6,316,268 Lekë me tvsh
17- Fatura nr. 327/2022 dt. 09.11.2022 Vlera me tvsh 6,136,268 lekë Vlera pa tvsh 5,263,557 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka

- Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.

Bazuar në memon datë 07.06.2021 drejtorja e BE-së, ka paraqitur kërkesën për përkthim 6412.87 faqe nga gjuha angleze në shqip dhe 188.29 faqe nga gjuha shqip në anglisht.

Me anë të urdhrit nr. 263, datë 25.06.2021 “Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi komisioni për llogaritjen e fondit limit me përbërje: B.Dh, G.Z dhe N.H. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 1, “Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian” në datën 23.07.2021, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave, si dhe në çmimet e kontratave të mëparshme. Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit vetëm për përkthim 13,128,666.7 lekë pa tvsh, dhe fondi për rishikim prej 2,200,430.6 lekë pa tvsh, kjo vlerë është nga kontratat e ngjashme të lidhura në vitet paraardhëse.

Urdhri i prokurimit nr. 420 datë 15.09.2021, urdhëron kryerjen e prokurimit, procedurë e hapur / marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian” me fond limit 13,128,666.7 lekë pa tvsh, dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga S.G, G.H, A.R. Njësia e prokurimit më datë 22.09.2021, ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim. Më datë 30.09.2021, njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin Për ndryshimin e dokumenteve të tenderit sipas rekomandimeve nga koordinatori APP, janë bërë ndryshimet në kriteret dhe ndryshuar data e hapjes së ofertave.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas Urdhrit nr. 421 datë 15.09.2021 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” komisioni i përbërë nga: E.H, E.Sh, E.H, më datë 29.10.2021 komisioni ka mbajtur procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku janë paraqitur 2 operatorë ekonomik:

1. Operatori ekonomik “A.G.G” shpk me vlerë oferte 12,936,281 lekë pa tvsh, është kualifikuar pasi plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.
2. Operatori ekonomik “Ë.T.A” shpk me vlerë oferte 11,919,746 lekë pa tvsh, është s’kualifikuar pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar OE “A.G.G” shpk me vlerë oferte 12,936,281 lekë pa tvsh, si oferta më ekonomike pasi ka plotësuar dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Më datë 24.11.2021 është mbajtur raporti përmbledhës, jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar dhe shpallur fitues OE “A.G.G” shpk.

Gjetje: Nga auditimi i procedurës së prokurimit në sistemin elektronik, rezultoi se KVO ka kualifikuar OE i cili nuk ka dorëzuar kopje të deklaratave të xhiros vjetore sipas kërkesave të DST. Ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit por referuar VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pika 2, nuk përmban deklarinimin mbi deklaratën e xhiros vjetore.

-Lidhja e kontratës

Marrëveshja kuadër nr.18556, datë 29.12.2021 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.p.k., me përfaqësues E.P, me afat një vit nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

-Zbatimi i kontratës.

Sipas MK janë lidhur kontrata e mëposhtme:

1- Kontrata nr. 80, datë 01.04.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, përfaqësuar nga E.H, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a., me përfaqësues E.P, NIPT K.....S, me çmim kontrate 5,148,175.5 lekë pa tvsh / 6,177,810.60 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. (Përkthimi i 35 akteve evropiane, 2640.09 faqe).

2- Kontrata nr. 356, datë 25.07.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, përfaqësuar nga G.T, Sekretar i Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a., me përfaqësues E.P, NIPT K.....S, me çmim kontrate 2,524,561.5 lekë pa tvsh / 3,029,473.8 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. (Përkthimi i 1073.52 faqe anglisht-shqip, 188.295 faqe shqip-anglisht).

3- Kontrata nr. 11597/2, datë 06.09.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, përfaqësuar nga G.T, Sekretar I Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik A.G.G sh.a., me përfaqësues E.P, NIPT K.....S, me çmim kontrate 5,263,557 lekë pa tvsh / 6,316,268.4 lekë me tvsh, me afat deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. (Përkthimi i 2,699.26 faqe anglisht-shqip).

Operatori ka sjellë faturat tatimore:

- Për kontratën nr. 80, fatura elektronike me nr 116/2022, datë 06.05.2022, me vlerë 5,148,175.50 lekë pa tvsh/ 6,177,810.60 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 433, datë 18.05.2022.
- Për kontratën nr. 356, fatura elektronike me nr 224/2022, datë 08.08.2022, me vlerë 2,524,561.50 lekë pa tvsh/ 3,029,473.80 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 865, datë 01.11.2022.
- Për kontratën nr. 11597/2, fatura elektronike me nr 327/2022, datë 09.11.2022, me vlerë 5,263,557.00 lekë pa tvsh/ 6,316,268.4 lekë me tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr. 957, datë 06.12.2022.

***Gjetje:** Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurës së prokurimit rezultoi se dosjet e procedurës të prokurimeve nuk janë të numëruara dhe inventarizuara, veprime në kundërshtim Kreun V, ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.*

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka paraqitur observacionin nr. 11397 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH nr. 894/6 prot., datë 20.07.2023, ku pretendojnë si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje shërbim përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”, viti 2021, me fond limit 13,128,666.7 lekë pa tvsh.

- Subjekti pretendon se nga verifikimi rezulton se OE e ka sjellë fizikisht dokumentin kopje të deklaratës së xhiros vjetore vërtetim nr. T04750807, datë 29.09.2021 (bashkëlidhur një kopje).
- Referuar konstatimit AK do numerizojë, inventarizojë dhe dorëzojë dosjet pranë Drejtorisë së Sekretarisë Qendrore të MEPJ.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

1. Procedura e prokurimit “Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian”:

- Nga auditimi i procedurës në SPE, në sistemin e prokurimit elektronik nuk ishte ngarkuar kopje të deklaratës së xhiros vjetore, dhe kjo nuk është evidentuar në procesverbalin e mbajtur nga KVO.

- Gjatë auditimit rezultoi se dosjet e prokurimit nuk ishin të numerizuara dhe të inventarizuara, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

3. Procedura e prokurimit “Blerje dhe vendosje ashensor godine”, viti 2021, me fond limit 2,480,000 lekë pa TVSH, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2021.

C. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Blerje dhe vendosje ashensor godine		
1. Urdhër Prokurimi nr. 467 datë 06.10.2021 Njësinë e prokurimit: E.Dh, G.H, S.G.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr. 278, datë 02.07.2021 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: E.Dh, L.B dhe E.H.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Urdhri nr 466 datë 06.10.2021 Komisioni i përbërë nga: B.Dh, E.I (K), A.H.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,480,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE G. K shpk dhe E. E. G sh.p.k. me vlerë oferte 2,399,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 81,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 25.10.2021	9. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike 1. BOE “M. F” & G K me vlerë ofertë 2,399,000 lekë pa tvsh. 2. S-K” nuk ka paraqitur ofertë. (i s’kualifikuar)
11. Ankimim Pranë AK- nuk ka; APP– nuk ka; KPP– nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata nr.17781, datë 10.12.2021 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe bashkimit të operatorëve ekonomik G.K shpk dhe E.E.G me afat brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.	15. Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 2,878,800 lekë me tvsh	16. Likuiduar Urdhër shpenzimi nr. 829 dt.29.12.2021 Vlera 2,878,800 Lekë me tvsh
17- Faturë Malli nr.142 dt.24.12.2021 Vlera me tvsh 2,878,800 lekë Vlera pa tvsh 2,399,000 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë Zbatuar 14 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Nuk ka

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.

Në procedurën e prokurimit “Blerje dhe vendosje ashensor godine”, me anë të procesverbalit nr. 1 datë 14.07.2021, janë përcaktuar karakteristikat dhe specifikimet për objektin e prokurimit pajisje ashensori ne MEPJ, procesverbal i hartuar nga ekspertja E.Dh.

Me anë të urdhrit nr. 278, datë 02.07.2021 “Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: E.Dh, L.B dhe E.H. Grupi i punës ka mbajtur procesverbali nr. 2 “Për llogaritjen e vlerës limit” në datë 02.09.2021, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre ofertave.

OE	Vlera e ofertës (lekë)	Oferta ardhur me shkresën
O.E	2,480,000	Oferta datë 28.07.2021
E.A	2,600,000	Oferta datë 30.07.2021
A.L	2,580,000	Oferta datë 20.07.2021

Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 2,480,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është oferta më e ulët nga tre ofertat, pasi mesatarja e tre ofertave është më e lartë se vlera e parashikuar.

Urdhri i prokurimit nr. 467 datë 06.10.2021 urdhëron kryerjen e prokurimit, procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra), me objekt “Blerje dhe vendosje ashensor godine” me fond limit 2,480,000 lekë pa tvsh dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbëhet nga S.G, E.Dh, G.H. Njësia e prokurimit më datë 06.10.2021, ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim.

Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi:

- Hartimi i DST ka disa parregullsi përkatësisht në DST për kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe kapacitetin teknik, është cituar...”Për plotësimin e kriterit të mësipërm është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Operatori ekonomik që do të shpallet fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin vërtetues.”. Në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin publik”, neni 77, 82 dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Miratimi i rregullave të prokurimit publik” neni 25,26, ku Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk ka asnjë të dhënë për kriteret e mësipërme, si rrjedhojë KVO ka kualifikuar një operator pa vërtetuar që disponon kapacitetet e nevojshme për kryerjen e kësaj shërbimi.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas Urdhrit nr. 466, datë 06.10.2021 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” urdhërohet të ngrihet komisioni i përbërë nga: B.Dh, E.I (K), A.H.

Më datë 03.11.2021, komisioni ka mbajtur procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku janë paraqitur 2 operatorë ekonomik:

1. Operatori ekonomik “S.K”, i cili nuk ka paraqitur ofertë.
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “M.F” & G.K, me vlerë oferte 2,399,000 lekë pa tvsh, i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar BOE “M.F” & G.K me vlerë oferte 2,399,000 lekë pa tvsh, si oferta më ekonomike pasi ka plotësuar dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Gjetje: Nga auditimi i procedurës së prokurimit në sistemin elektronik, rezultoi se:

- KVO ka kualifikuar BOE i cili sipas kontratës së bashkëpunimit jepet % e pjesëmarrësve dhe ndarja e fitimit në % por jo çfarë punimesh merr secili nga pjesëmarrësit, në kundërshtim me kriteret/kërkesat e përcaktuara në DST.

- KVO ka kualifikuar BOE, ku njëri nga OE pjesëmarrës në BOE, nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes për punën e ngjashme, e cila i përket sektorin privat, në kundërshtim me kriteret/kërkesat e përcaktuara në DST.

Më datë 18.11.2021, është mbajtur raporti përmbledhës i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues bashkimi operatorëve ekonomik G.K shpk dhe E.E.G sh.p.k. me vlerë oferte 2,399,000 lekë pa tvsh. (shkresa e raportit pa nr. Protokolli).

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 17781, datë 10.12.2021 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm A.S dhe bashkimit të operatorëve ekonomik G.K shpk me NIPT L.....O dhe E.E.G me NIPT L.....M, përfaqësuar nga M.F, me afat brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës (siç specifikohet në dokumentet e tenderit).

-Zbatimi i kontratës.

Me anë të Urdhrit nr. 641 datë 30.12.2021 "Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallit", komisioni në përbërje nga: S.G, G.H, A.B.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të përkohshëm i ashensorit me datë 30.12.2021.

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 142, datë 24.12.2021, me vlerë 2,878,800 lekë me tvsh / 2,399,000 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimit me nr 829, datë 29.12.2021.

Gjetje: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurës së prokurimit rezultoi se:

- Mungon njoftimi i dorëzimit të mallit dhe skeda teknike e ashensorit të vendosur, në kundërshtim me Nenin 4 të KVK të kontratës nr.17781 prot. datë 10.12.2021, përkatësisht pika 4.1 b,c ku citohet "...Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim, faks, postë elektronike etj Blerësin një ditë më para çdo dorëzimi të mallrave...".

- Ashensori i vendosur nuk është i certifikuar pavarësisht që është marrë në dorëzim, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10489, date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", Neni 3, pika 24 në të cilën theksohet "Personi përgjegjës i produktit/instalimit të vënë në shërbim për të tretë apo për publikun" është titullari i së drejtës së pronësisë mbi produktin/instalimin...". Sipas VKM-së Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për Miratimin e Rregullit teknik "Për Sigurinë e Ashensorëve në përdorim" pranë Strukturës Përgjegjëse, pika 4.1 "çdo ashensor i ri ose ekzistues regjistrohet pranë Strukturës Përgjegjëse, siç referohet në nenin 16 të ligjit nr. 10489, date 15.12.2011. Personi përgjegjës që bën regjistrimin e një ashensori të ri duhet gjithashtu të bashkëngjisë në formatin e regjistrimit dhe një kopje të deklaratës së konfirmimit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë", në cilësinë e përgjegjësit për Furnizim-Vendosjen e ashensorit, duhet të bëni certifikimin dhe regjistrimin e tij pranë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

- Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurës së prokurimit rezultoi se dosjet e procedurës të prokurimeve nuk janë të numëruara dhe inventarizuara, veprime në kundërshtim Kreun V, ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka paraqitur observacionin nr. 11397 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH nr. 894/6 prot., datë 20.07.2023, ku pretendojnë si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje dhe vendosje ashensor godine”, viti 2021, me fond limit 2,480,000 lekë pa tvsh.

- Në lidhje që KVO ka kualifikuar një operator pa vërtetuar që disponon kapacitetet e nevojshme për kryerjen e kësaj shërbimi, subjekti pretendon se ky devijim i vogël ka ndodhur pasi AK nuk ka mundur të zhvillojë trajnimet e nevojshme për tu njohur me ndryshimet e reja ligjore.

- Në lidhje me kriterin mbi disponimin e licencës kategoria 12/a zbatim subjekti pretendon se me emailin e datës 12.10.2021 APP ka kërkuar modifikimin e disa kriterëve të kualifikimit ndër të tjera edhe kërkesat e mësipërme, me procesverbalin e datës 15.10.2021 AK ka pezulluar procedurën e prokurimit dhe ka bere ndryshimet e nevojshme. Ndryshimet të cilat reflektojnë edhe konstatimet e juaja, bashkëlidhur kopje e procesverbalit, dhe emailit të APP.

- Në lidhje me punimet e secilit pjesëmarrës të BOE, subjekti pretendon në zbatim të nenit 423 dhe në vijim të Kodit Civil dhe referuar përmbajtjes së marrëveshjes së bashkëpunimit rezulton se dy OE pjese e BOE përgjigjen në mënyre solidare për realizimin e furnizim vendosjes.

- Në lidhje me KVO ka kualifikuar BOE ku njëri nga OE nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes për punë të ngjashme, subjekti pretendon se jemi para një kontrate furnizimi dhe nuk jemi në kushtet e zbatimit të paragrafit të dyte të pikës 3, të nenit 88 të VKM-së 285, datë 19.01.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i cili parashikon kontratat e llojit pune/punime.

- Sa i takon kërkesës për skedën teknike OE e ka paraqitur ndodhet ne dokumentet e OE e përkthyer dhe e noterizuar.

- Në lidhje me certifikimin e ashensorit, nevojitet që për realizmin e procedurës së certifikimit godina të jete e pajisur me certifikatë pronësie. Aktualisht jemi në fazën e aplikimit për pajisjen me certifikatë pronësie të MEPJ dhe regjistrimin e pronës në regjistrat hipotekor.

- BOE i shpallur fitues ka njoftuar AK verbalist një ditë para për dorëzimin e mallit.

- Dosjet do të numerizohen, inventarizohen dhe arkivohen.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Procedura e prokurimit “ Blerje dhe vendosje ashensor godine”:

- Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit, pra KVO ka kualifikuar një operator pa vërtetuar që disponon kapacitetet e nevojshme për kryerjen e kësaj shërbimi.

- Në lidhje me kriterin mbi disponimin e licencës kategoria 12/a zbatim, kjo pikë merret në konsideratë.

- Në lidhje me punimet e secilit pjesëmarrës të BOE, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST nga ana juaj.

-Në lidhje me se KVO ka kualifikuar BOE ku njëri nga OE i cili nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes për punë të ngjashme, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST nga ana juaj.

- Sa i takon kërkesës për skedën teknike pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

- Në lidhje me certifikimin e ashensorit, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

- Në lidhje me njoftimin verbalisht një ditë para për dorëzimin e mallit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kontratës.

- Gjatë auditimit rezultoi se dosjet e prokurimit nuk ishin të numerizuara dhe të inventarizuara, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

4. Procedura e prokurimit “Blerje dhe vendosje gjenerator godine”, viti 2022, me fond limit 4,900,000 lekë pa TVSH, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2022.

D. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Blerje dhe vendosje gjenerator godine		
1. Urdhër Prokurimi nr. 208 datë 10.06.2022 Njësinë e prokurimit: S.G, G.H, A.M	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr. 156, datë 10.05.2022, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje : S.G, G.H dhe A.M.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Urdhri nr 209 datë 10.06.2022 Komisioni i përbërë nga: E.Sh, N.H, E.Dh.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,900,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) A. shpk me vlerë oferte 4,499,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 401,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 27.06.2022	9. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1.“A.” shpk me vlerë ofertë 4,499,000 lekë pa tvsh 2.“P.P.A & T” nuk ka paraqitur ofertë. (i s’kualifikuar)
11. Ankimim Pranë AK- nuk ka; APP– nuk ka; KPP– nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata nr. 11975, datë 26.08.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe operatorit ekonomik A. shpk me afat brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës (siç specifikohet në dokumentet e tenderit).	15. Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 5,398,800 lekë me tvsh	16. Likuiduar Urdhër shpenzimi nr. 737 datë 14.09.2022 Vlera 5,398,800 Lekë me tvsh
17- Faturë Malli nr. 323 dt. 06.09.2022 Vlera me tvsh 5,398,800 lekë Vlera pa tvsh 4,499,000 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 15 ditë Zbatuar 11 ditë	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.

Në procedurën e prokurimit “Blerje dhe vendosje gjenerator godine”, me anë të raportit teknik datë 25.05.2022, mbi gjendjen e kabinës elektrike dhe veçoritë teknike të gjeneratorit, raport i hartuar nga eksperti inxh. A.M.

Me anë të urdhrit nr. 156, datë 10.05.2022 “Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës” është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje: S.G, G.H dhe A.M. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin “Për llogaritjen e vlerës limit” më datë 03.06.2022, i cili për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është bazuar në testimit të tregut, në bazë të tre ofertave.

OE	Vlera e ofertës (lekë)	Oferta ardhur me shkresën
I	4,200,000	Oferta datë 01.06.2022
A. A	4,900,000	Oferta datë 01.06.2022
I.A.S.	5,600,000	Oferta datë 01.06.2022

Anëtarët e komisionit të përlllogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit 4,900,000 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Urdhri i prokurimit nr. 208 datë 10.06.2022, urdhëron kryerjen e prokurimit, procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra), me objekt “Blerje dhe vendosje gjeneratori godine” me fond limit 4,900,000 lekë pa tvsh, dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbërë nga S.G, G.H, A.M. Njësia e prokurimit më datë 16.06.2022, ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim.

Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi:

- *Kriteri që “OE që do të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë: Licencë të vlefshme e OE ekonomik ofertues kategoria 4/c të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë”. Kriteri diskriminues, jo në përputhje me natyrën e punimeve, objekti i kontratës është blerje dhe vendosje, në kundërshtim me nenin 40, Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, pika 3, të VKM Nr. 285/2021, i ndryshuar, ku citohet: “...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.*

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas Urdhrit nr 209, datë 10.06.2022 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave” urdhërohet të ngrihet komisioni i përbërë nga: E.Sh, N.H (K), E.Dh.

Më datë 01.07.2022, komisioni ka mbajtur procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku janë paraqitur 2 operatorë ekonomik:

1. Operatori ekonomik “P.P.A & T” nuk ka paraqitur ofertë.
2. Operatori ekonomik “A.” shpk me vlerë oferte 4,499,000 lekë pa tvsh, i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

KVO ka klasifikuar OE “A.” sh.p.k. me vlerë oferte 4,499,000 lekë pa tvsh, si oferta më ekonomike pasi ka plotësuar dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Më datë 19.08.2022, është mbajtur raporti përmbledhës i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të

gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar dhe shpallur fitues OE A. shpk, me vlerë oferte 4,499,000 lekë pa tvsh. (shkresa e raportit pa nr. Protokolli).

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata e shërbimit me nr.11975, datë 26.08.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm G.T dhe operatorit ekonomik A. shpk, me NIPT L.....K, përfaqësuar nga F.H, me afat brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës (siç specifikohet në dokumentet e tenderit).

-Zbatimi i kontratës.

Dhe Urdhrit nr 433 datë 26.08.2022 “Për ngritjen e Strukturës për ndjekjen e Kontratës” ngrihet komisioni i përbërë nga: S.G, G.H, E.H.

Me anë të Urdhrit nr. 434 datë 26.08.2022 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim dhe të kolaudimin e mallit”, komisioni në përbërje nga: S.G, G.H, A.B.

Nga komisioni dhe Kontraktori A. sh.p.k. është mbajtur procesverbali blerje dhe vendosje gjenerator godine më datë 06.12.2022, ku u konkludua që gjeneratori plotëson kërkesat e kontratës. Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 323, datë 06.09.2022, me vlerë 4,499,000 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 737, datë 14.09.2022.

Gjetje: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurës së prokurimit rezultoi se:

- Mungon njoftimi i dorëzimit të mallit, në kundërshtim me Nenit 4 të KVK të kontratës, përkatësisht pika 4.1 c ku citohet “...Njoftimi i dorëzimit do të bëhet me shkrim, faks, postë elektronike etj tek Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme...”.

- Dosjet e procedurës të prokurimeve nuk janë të numëruara dhe inventarizuara, veprime në kundërshtim Kreun V, ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka paraqitur observacionin nr. 11397 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH nr. 894/6 prot., datë 20.07.2023, ku pretendojnë si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje dhe vendosje gjenerator godine”, viti 2022, me fond limit 4,900,000 lekë pa tvsh.

- AK ka kërkuar kategoria licence kategoria 4/c për të provuar se OE ofertues ka kapacitete nevojshme për montimin e gjeneratorit, shtrirjen e linjave dhe lidhjen e tij me kabinën qendrore. Ky kriter është në përpjesëtim të drejtë me objektin e kontratës.

- OE ka njoftuar verbalisht AK për dorëzimin e mallit një ditë përpara.

- Dosjet do të numerizohen, inventarizohen dhe dorëzohen në arkivë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje dhe vendosje gjenerator godine”:

- Në lidhje me kategorinë e licencës 4/c, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

- Në lidhje me njoftimin verbalisht një ditë para për dorëzimin e mallit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kontratës.

- Gjatë auditimit rezultoi se dosjet e prokurimit nuk ishin të numerizuara dhe të inventarizuara, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

5. Procedura e prokurimit “Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete”, viti 2022, me fond limit 112,220,076 lekë pa TVSH, i parashikuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2022.

E. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete		
1. Urdhër Prokurimi nr. 106 datë 08.04.2022 Njësinë e prokurimit: S.G, G.H, A.S.	3. Llogaritja e fondit limit Me anë të urdhrit nr. 65, datë 29.03.2022, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje : I.D, E.H dhe L.Gj.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Urdhri nr 105 datë 08.04.2022 Komisioni i përbërë nga: E.H, M.L, K.D.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur mbi kufirin monetar (Shërbime)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 112,220,076.00 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE “A.J” sh.a. & “I. J.” sh.a. & “S” sh.a., me vlerë ofertë 110,545,000 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,675,076 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 16.05.2022	9. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1. BOE “A.J” sh.a. & “I.J” sh.a. & “S” sh.a., me vlerë ofertë 110,545,000 lekë pa tvsh. 2. OE “S.U.G.A” sh.a., me vlerë ofertë 112,219,700 lekë pa tvsh;. (i s’kualifikuar).
11. Ankimim Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr. 272, datë 21.06.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe BOE A.J sha, S sha dhe I.J sha, me vlerë kontrate 110,545,000 lek pa tvsh, polica e sigurimit do të lëvrohet brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, kohëzgjatja e policës së sigurimit është 12 muaj.	15. Vlera e kontratës (me tvsh) lekë: 110,545,000 lekë me tvsh	16. Likuiduar Urdhër shpenzimi nr. 56 dt.15.09.2022 Vlera 110,545,800 Lekë pa tvsh
17- Faturë Malli nr. 12863/2022 dt. 29.07.2022 Vlera me tvsh 110,545,000 lekë Vlera pa tvsh 110,545,000 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë (deri 31.12.2022)	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe hartimi i kriterëve të DST.

Me anë të shkresës datë 25.03.2022, me lëndë Mbi fillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje sigurim shëndeti, shëndet në udhëtim dhe jete”, ku ndër të tjera përcaktohet realizimi i një tenderi ndërkombëtar, nëpunësit që do ngarkohen për kryerjen e këtij prokurimi si vijon. Komisioni për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe hartimit të termave të referencës me përbërje: I.D, E.H dhe një ekspert i jashtëm (ekspert i fushës). Njësia e prokurimit me përbërje: S.G, G.H dhe një ekspert i jashtëm (ekspert i fushës). Si dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje E.H, M.L dhe B.Dh.

Me anë të urdhrit nr. 65, datë 29.03.2022 “Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës”, urdhërohet hartimi i termave të referencës, vlerës limit të kontratës dhe ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit me përbërje: I.D, E.H dhe L.Gj. Me ekspertin e jashtëm L.Gj, person fizik me NIPT L.....O, me licencë nr. 180, datë 22.11.2019, për ushtrimin e veprimtarisë vlerësues dëmsh në sigurime, është lidhur kontrata nr. 4138 prot., datë 29.03.2022, me vlerë 100,000 lekë pa tvsh, me objekt kontrate asistencë teknike në cilësinë e anëtarit të komisionit në përlogaritjen e fondit limit. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin “Për llogaritjen e fondit limit të kontratës” më datë 07.04.2022, i cili për përlogaritjen e vlerës së kontratës dhe hartimit të termave të referencës është bazuar në testimin të tregut, në bazë të tre kërkesave ndaj 3 operatorëve ekonomik që operojnë në treg.

OE	Vlera e ofertës (lekë)	Oferta ardhur me shkresën
A.J	112,702,230	Shkresa nr.33/1, datë 06.04.2022
I.J	112,690,000	Shkresa nr.121, datë 06.04.2022
S.U.G.A	111,268,000	Shkresa nr.CB2205, datë 05.04.2022

Anëtarët e komisionit të përlogaritjes së vlerës limit, kanë llogaritur fondin limit me vlerë 112,220,076 lekë pa tvsh, kjo vlerë është mesatarja e tre ofertave.

Urdhri i prokurimit nr. 106 datë 08.04.2022 urdhëron kryerjen e prokurimit, procedurë e hapur mbi kufirin monetar, me objekt “Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete” me fond limit 112,220,076 lekë pa tvsh dhe ngritjen e njësisë së prokurimit të përbëhet nga S.G, G.H, A.S. Me ekspertin e jashtëm A.S, person fizik me NIPT K.....P, është lidhur kontrata nr. 4750 prot., datë 08.04.2022, me vlerë 100,000 lekë pa tvsh, me objekt kontrate asistencë teknike për procedurën e prokurimit. Njësia e prokurimit më datë 12.04.2022, ka mbajtur procesverbalin

Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve teknike rezulton se në procesverbalin e mbajtur nga grupi:

- Vendosja kriterit se OE, duhet të jenë në zotërim të licencës për veprimtarinë e sigurimit të jo jetës për Klasa A 1 “Sigurimi i aksidentëve” dhe Klasa A 2 “Sigurimi i sëmundjeve dhe/ose “Sigurimi i aksidentëve dhe shëndetit”, duhet të jenë në zotërim të licencës klasa B 19 “Për veprimtarinë e sigurimit të jetës”, duhet të jenë në zotërim të licencës klasa B 23 “Për veprimtarinë e sigurimit të jetës”. Bazuar në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” Aneksi I Pikat A1 dhe A2 plotësohen nga B23. Kriteri i vendosur në kundërshtim me nenin 41, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, pika 2, të VKM Nr. 285/2021, i ndryshuar, ku citohet: “...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Sipas Urdhrit nr. 105 datë 08.04.2022, “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave”, komisioni përbëhet nga: E.H, M.L, B.Dh. Me anë të Urdhrit nr. 173 datë 19.05.2022, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 105, datë 08.04.2022 për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave”, anëtari i Komisionit B.Dh zëvendësohet me K.D. Më datë 23.05.2022, komisioni ka mbajtur procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku janë paraqitur 2 operatorë ekonomik:

1. Operatori ekonomik “S.U.G.A” sh.a., me vlerë ofertë 112,219,700 lekë pa tvsh, nuk ka plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim.
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “A.J” sh.a. & “I.J” sh.a. & “S” sh.a., me vlerë ofertë 110,545,000 lekë pa tvsh, i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. KVO ka klasifikuar BOE “A.J” sh.a. & “I.J” sh.a. & “S” sh.a., si oferta më ekonomike pasi ka plotësuar dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Është mbajtur raporti përmbledhës datë 21.06.2022, jepet informacion mbi procedurën, vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, dhe klasifikimin nga KVO, në vendin e parë sipas kriterit çmimi më i ulët dhe i cili ka plotësuar të gjitha kriteret e caktuara në DST, KVO ka klasifikuar dhe shpallur fitues BOE “A.J” sh.a. & “I.J” sh.a. & “S” sh.a..

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata blerje shërbimit me nr.272, datë 21.06.2022 midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm A.Sdhe bashkimit të operatorëve ekonomik A.J sha me NIPT L.....V, S sha me NIPT K.....Q dhe I.J sha me NIPT L.....H, përfaqësuar nga E.M, me vlerë kontrate 110,545,000 lek pa tvsh, polica e sigurimit do të lëvrohet brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, kohëzgjatja e policës së sigurimit është 12 muaj.

(Formulari i sigurimit të kontratës datë 20.06.2022, në emër të BOE “I.J” sha, “A.J” sha dhe “S” sha për shumën 11,054,500 lekë i vlefshëm nga 21.06.2022 deri në zbatimin e plotë të kontratës.)

-Zbatimi i kontratës.

Me anë të shkresës nr. 9692 datë 15.07.2022 “Dërgohen udhëzime për zbatimin e kontratës me objekt “Sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete” Drejtuesve të misioneve diplomatike / posteve konsullore të RSH-së të akredituara jashtë vendit.

Me Urdhrin nr. 272 prot., datë 21.06.2022, “Për ngritjen e strukturës për ndjekjen e kontratës”, përcaktohet komisioni me përbërje E.H, S.G, G.Hdhe përfaqësues të misioneve diplomatike.

Me Urdhrin nr. 521 prot., datë 19.09.2022, “Për ngritjen e strukturës për ndjekjen e kontratës”, përcaktohet komisioni me përbërje S.G, A.M, G.H.

Plani i zbatimit të kontratës me nr.8440/prot., datë 21.06.2022, mbi ecurinë e zbatimit të kontratës e mbajtur midis Autoritetit Kontraktor dhe BOE A.J sha, S sha dhe I.J sha.

Operatori ka sjellë faturën tatimore, me nr 12863/2022, datë 29.07.2022, me vlerë 110,545,000 lekë pa tvsh, likuiduar me urdhër shpenzimin me nr 56, datë 15.09.2022.

Gjetje: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurës së prokurimit dhe pagesës së OE, rezultoi se:

- *Pagesa e OE është kryer me vonesë në kundërshtim të Nenit 14 të KPK të kontratës nr. 272, datë 21.06.2022, përkatësisht pika 14.3 ku citohet: “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga*

dita që janë kryer shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”.

- Dosjet e procedurës të prokurimeve nuk janë të numëruara dhe inventarizuara, veprime në kundërshtim Kreun V, ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka paraqitur observacionin nr. 11397 prot., datë 14.07.2023, protokolluar në KLSH nr. 894/6 prot., datë 20.07.2023, ku pretendojnë si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete”, viti 2022, me fond limit 112,220,076 lekë pa tvsh.

- AK ka kërkuar sigurimin e shëndetit dhe sigurimin e shëndetit në udhëtim i cili mbulohet nga subjektet e licencuara sipas klasës A1 dhe A2. Gjithashtu kemi kërkuar sigurimin e jetës, këtë shërbim e ofrojnë kompanitë e licencuara sipas aneksit B 19-23.

- Në lidhje me licencën e z. A.S, bashkëlidhur ju përcjellim një kopje se licencës se tij profesionale ku përfshihet dhe sigurimi në shëndet. Sa i takon të dhënave të personit tregtar në QKB, kontraktimi i z. S është bërë jashtë rregullave të prokurimit publik sipas pikës 3, të nenit 11 të VKM-së 285/2021.

- Asnjë OE pavarësisht vonesave në shlyerjen e detyrimeve nuk ka paraqitur kërkesa për likuidimin e kamat-vonesave në shlyerjen e faturave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Procedura e prokurimit “Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete”:

- Në lidhje me licencat e subjektit, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacion të ri, që nuk është administruar më parë nga grupi i auditimit.

- Në lidhje me kontraktimi i z. Sulce, observacioni është marrë në konsideratë dhe në projekt raport.

- Në lidhje me mungesën e ankimimit për vonesat në likuidimin e faturave ndaj OE, është detyrim kontraktual zbatimi i afateve të pagesave nga Autoriteti Kontraktor.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes 26:	<i>Parregullsi mbi procedurat e prokurimit publik</i>
Situata:	<p>- Parregullsi në përcaktimin e kriterëve kualifikuese në procedurat e prokurimit publik si: a. Në procedurën Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, DST ka parregullsi përkatësisht në kriteret mbi kapacitetin financiar dhe kapacitetin teknik, si rrjedhojë KVO ka kualifikuar një operator pa vërtetuar që disponon kapacitetet e nevojshme për kryerjen e kësaj shërbimi.</p> <p>b. Në procedurën Blerje dhe vendosje gjeneratori godine, viti 2022, kriterin mbi licencën kategoria 4/c jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e punimeve.</p> <p>c. Në procedurën Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022, kriterin mbi zotërimin të licencës për Klasa A1 “Sigurimi i aksidenteve” dhe Klasa A2 “Sigurimi i sëmundjeve dhe/ose “Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit”, dhe klasa B23 “Për veprimtarinë e sigurimit të jetës”, kriteret jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.</p>

	<p>- Parregullsi në vlerësimin e ofertave në procedurat e prokurimit publik si:a. Në procedurën Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian, viti 2021, KVO ka kualifikuar OE i cili nuk ka dorëzuar kopje të deklaratave të xhiros vjetore sipas kërkesave të DST.</p> <p>b. Në procedurën Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021, KVO ka kualifikuar OE i cili nuk ka përcaktuar çfarë punimesh merr secili nga pjesëmarrësit, dhe ku njëri nga OE pjesëmarrës në BOE, nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes për punën e ngjashme, e cila i përket sektorin privat, në kundërshtim me kriteret/kërkesat e përcaktuara në DST.</p> <p>- Nga auditimi rezultoi se në MEPJ të gjitha dosjet e procedurave të prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ligji Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” VKM nr. 914 datë 29.12.2014.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM nr. 285 datë 19.05.2021.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” kreu I, pika 1. VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” Nenin 10, pika 1a. VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar, lidhja 4.</p>
Ndikimi:	<p>- Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit. - Risku që cilësia e mallit/punimeve të prokuruar të mos jetë me cilësinë e duhur sipas specifikimeve teknike. - Evidentimin, sistemimi dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.</p>
Shkaku	<p>- Vlerësim i parregullt mbi llojin dhe sasinë e punës që kërkohet të prokurohet nga ana e njësisë së prokurimit. - Mosvlerësim i saktë i ofertave ekonomike. - Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike.</p>
Rëndësia:	E lartë
1. Rekomandimi:	Njësitë e Prokurimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.
2. Rekomandimi:	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në

	kushtet e mosplotësimit të kritereve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.
3. Rekomandimi:	Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Titulli i gjetjes 27:	Mungesa e certifikimit të ashensorit të ri
Situata:	Ashensori i vendosur nuk është i certifikuar pavarësisht që është marrë në dorëzim, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10489, date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", Neni 3. Çdo ashensor i ri ose ekzistues regjistrohet pranë Strukturës Përgjegjëse, MEPJ në cilësinë e përgjegjësit për Furnizim-Vendosjen e ashensorit, duhet bërë certifikimin dhe regjistrimin e tij pranë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.
Kriteri:	Ligjin Nr. 10489, date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", Neni 3, pika 24. VKM-së Nr.1056, datë 23.12.2015 "Për Miratimin e Rregullit teknik "Për Sigurinë e Ashensorëve në përdorim".
Ndikimi:	Moscertifikimi i ashensorëve nga entet përkatëse sjell rrezik për jetën e përdoruesve të ashensorit.
Shkaku	Mungesa e certifikimit nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të marrë masat e menjëhershme për pajisjen me certifikatë dhe regjistrimin e ashensorit pranë strukturave të posaçme si Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim sigurimin e jetës të përdoruesve të tij.

Lidhur me çështjen e mësipërme, personat përgjegjës mbi gjetjet nga MEPJ janë: *E.H, S.G, G.H, E.Sh, E.H, B.Dh, A.H, A.B, E.Dh, E.I, A.M, A.S.*

5. Vlerësimi aktivitetit të njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit:

5.1 Auditimi i Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB), është emëruar me Urdhrin nr. 02, datë 08.01.2019 "Për riemërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme" dhe ka vijuar të ushtroj funksionet e përcaktuara përgjatë vitit 2021 duke tejkaluar afatin 2-vjeçar, në kundërshtim me pikën 6, kreu II, të VKM 160, datë 2.3.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm", i cili parashikon

se “Mandati i Komitetit të Auditimit të Brendshëm është 2-vjeçar, me të drejtë riemërimi”. Në zbatim të urdhrin sipërcituar, mandat i anëtarëve të KAB duhet të kishte përfunduar më datë 07.01.2021.

Referuar raportit vjetor të vitit 2020 dhe 2021 rezulton se KAB për vitin 2020 është mbledhur gjithësej 2 (dy) herë, përkatësisht në datën 23.01.2020 dhe 18.09.2020, si dhe për vitin 2021 është mbledhur gjithësej 3 (tre) herë, përkatësisht në datën 28.01.2021, 29.09.2021 dhe 10.12.2021 dhe për vitin 2022, rezulton që KAB nuk është krijuar dhe rrjedhimisht nuk është mbledhur asnjëherë, në kundërshtim me pikën 9, kreu II, të VKM 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, i cili parashikon se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm e zhvillon veprimtarinë sipas një kalendari të miratuar prej tij dhe mbledhet jo më pak se katër herë në vit.”.

Auditi i Brendshëm

➤ Organizimi dhe Funksionimi

Për periudhën janar 2020-shtator 2022, NJAB në MEPJ ka funksionuar me një strukturë prej 5 (pesë) punonjësish, në zbatim të Urdhrit nr. 138, datë 21.10.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”.

➤ Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Për periudhën objekt auditimi, NJAB ka të miratuar Kartën e Auditimit të Brendshëm me urdhër nr.422, datë 23.7.2018 të titullarit të Institucionit, hartuar në përputhje me parashikimet e Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

➤ Planet Strategjike dhe Vjetore dhe realizimi i tyre

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2020 me shkresën nr.18783/1 prot., datë 30.12.2019 është miratuar plani strategjik për vitet 2020 – 2022 dhe plani vjetor për vitin 2020. Këto plane janë dërguar në formë shkresore me anë të shkresës nr.18783 prot., datë 30.12.2019 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

Për vitin 2021 me shkresën nr.3 prot., datë 12.01.2021 është miratuar plani strategjik për vitet 2021 – 2023 dhe plani vjetor për vitin 2021. Këto plane janë dërguar në formë shkresore me anë të shkresës nr.1141 prot., datë 27.01.2021 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

Për vitin 2022 me shkresën nr.14970/1 prot., dhe nr. 14970/2 prot., datë 20.10.2021 është miratuar plani strategjik për vitet 2022 – 2024 dhe plani vjetor për vitin 2022. Këto plane janë dërguar në formë shkresore me anë të shkresës nr.14970 prot., datë 20.10.2021 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga MEPJ, misionet diplomatike dhe postet konsullore. Republika e Shqipërisë përfaqësohet gjithësej nga 51 struktura të misioneve diplomatike dhe poste konsullore. Në mënyrë të përmbledhur, në formë tabelare përgjatë vitit 2020-2022 rezulton se janë planifikuar dhe realizuar misione të auditimit të brendshëm, si më poshtë vijon:

vitet	lloji i auditimit	planifikuar	ndryshim	realizuar	diferenca
2020	Përputhshmërie	16	13	12	1
2021	Përputhshmërie	15	11	10	1
2022	Përputhshmërie	15	16	16	0

Burimi: AB pranë MEPJ

Ndryshimet kanë ardhur si pasojë e pandemisë Covid-19.

Për veprimtarinë e NJAB për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbysës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr. 2349 prot, datë 22.02.2021, është dërguar raporti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në MEPJ për vitin 2020. Me shkresën nr. 2026 prot, datë 15.02.2022, është dërguar raporti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në MEPJ për vitin 2021.

Informacion më i detajuar lidhur me subjektet e audituara në misionet diplomatike dhe poste konsullore, riskun, buxhetin e planifikuar për 2021 dhe diferencën në vite nga auditimi i fundit pasqyrohet në tabelën nr.1, ANEKS.

Lidhur me llojin e auditimit të ushtruar: Konstatohet se të gjitha auditimet e planifikuara dhe realizuara kanë qenë të llojit “Auditim Përputhshmërie” dhe në asnjë rast nuk është konsideruar e nevojshme të kryhet Auditim Financiar i mirëfilltë, edhe pse afërsisht 80 (tetëdhjetë) % e buxhetit të miratuar për MEPJ shkon për misionet diplomatike dhe postet konsullore. Nga auditimi me zgjedhje i raporteve të auditit të brendshëm u konstatuan raste të trajtimit të aspekteve financiare, referuar peshës totale që shpenzimet kanë në buxhetin e përfaqësive. Si rrjedhojë, gjykojmë të nevojshme trajtim të posacëm në formë të një auditimi financiar, e cila ndër të tjera do të sjellë edhe unifikimin formatit të evidencave raportuese të shpenzimeve.

Lidhur me subjektet e përzgjedhura për auditim: Konstatohet se 48 struktura të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore rezultojnë të audituara mestarisht 1 (një) herë në 3.8 vite (maksimalisht për 10 vjet dhe minimalisht për 2 vjet). Përsa më sipër, NJAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar pjesërisht në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve, planifikime në kundërshtim me pikën 3.1.3, të “Manuali i auditimit të brendshëm”, i ndryshuar, i cili parashikon se “Për të përcaktuar kohën për kryerjen e auditimeve merret në konsideratë niveli i riskut për çdo sistem ... ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t'u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet”.

Lidhur me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe mangësitë/problematikat e konstatuara: NJAB pas çdo auditimi dhe lënies së rekomandimeve në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë, ndjek zbatimin e tyre në fund të çdo viti, në përputhje me shkronjën ç), neni 6, Ligji 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili parashikon se: “Roli i auditimit të brendshëm është ti japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë... duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna”, megjithatë referuar raporteve vjetore konstatohet se nuk janë evidentuar mangësitë dhe shkeljet ligjore evidente të konstatuara

gjatë punës së kryer nga grupi i KLSH-së, gjithashtu konstatohet se rekomandimet nuk zbatohen plotësisht nga Institucioni si dhe NJAB nuk merr masa të mëtijshme administrative-juridike për zbatimin e tyre me qëllim që ti shërbejnë arritjes së objektivave të Institucionit dhe misionit të NJAB.

Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Në 19 dosje auditimi të përzgjedhura për tu audituar konstatohet se përgjithësisht janë mbajtur në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm. Në disa raste fletët e inventarit të këtyre dosjeve nuk figurojnë të nënshkuara nga tre punonjësit: Audituesi, Drejtuesi AB dhe Marrësi në dorëzim, në mospërputhje me parashikimet e Manuali i auditimit të brendshëm, i ndryshuar. Dosjet fizikisht gjenden në zyrën e njësisë së auditimit të brendshëm. Në dosjet e përzgjedhura rezultojnë të arkivuara memorandumet drejtuar Ministres, Programet e Auditimit, Urdhër shërbimi, Autorizimi, deklaratat e pavarësisë së audituesve, njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit, pyetësi për vlerësimin paraprak të riskut, takimi prezantues, takimi përmbyllës, vlerësimi i riskut, buxheti dhe afati kohor i angazhimit, testet e detajuara të auditimit, aktet e verifikimit/konstatimit, projekt raporti, raporti përfundimtar, informacion përfundimtar për Ministren, Plan veprimi drejtuar subjektit, formularët e monitorimit dhe kontrollit të brendshëm dhe shkresat përcjellëse të ndryshme.

Konkluzion: KAB përgjatë periudhës Janar 2021 deri më Shtator 2022 ka ushtruar funksionet pa tagër ligjor. KAD rezulton se për periudhën 2020-2022 është mbledhur gjithësej 5 (pesë) herë dhe jo të paktën 12 (dymbëdhjetë) herë siç e parashikon VKM sipërcituar. Edhe pse mbledhjet e 28 Janar 2021 dhe në vijim janë zhvilluar nga ana e anëtarëve të KAD pa tagër ligjor, ato janë paguar nga ana e MEPJ. KAB nuk i jep titullarit të njësisë publike garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike.

NJAB pas lënies së rekomandimeve në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë nuk kërkon në mënyrë të vazhdueshme ndjekjen e zbatimit të tyre, si dhe NJAB nuk ka evidentuar mangësitë dhe shkeljet ligjore të konstatuara gjatë punës së kryer nga grupi i KLSH për periudhën objekt auditimi në veprimtarinë e shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë, trajtuar në këtë material.

➤ *Nga auditimi me zgjedhje i kryer mbi dosjet e auditit të brendshëm u konstatua problematika si më poshtë vijon:*

Nga ana e drejtorisë së Auditit të Brendshëm të MEPJ-së me programin nr.54 prot, datë 24.05.2022 mbi Urdhër nr.180 datë 27.05.2022 është audituar përputhshmëria dhe performanca ekonomiko-financiare e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, (pjesë e strukturës organizative të MEPJ-së). Ky mision auditimi ka përfshirë periudhën nga data 01.03.2017 - 31.05.2022.

Përmbledhja e gjetjeve kryesore është si më poshtë vijon:

1. Rezulton se me urdhër pagese nr.prot.23 datë 25.02.2019 në vlerën 3,826.80 euro dhe nr.prot.21 datë 22.02.2019 në vlerën 1,913.40 euro është autorizuar nga titullari përfaqësisë “Pagar ndihma për shkollimin e fëmijëve të Këshilltarit” (dy fëmijë) dhe “Pagar ndihma për shkollimin e vjetor së fëmijës të Ministrit Këshilltar” në kundërshtim me pikat 8, 9 të VKM-së nr.20, datë 18.01.2017 dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011.

2. Rezulton se mandat pagese nr.13, datë 13/9/2018 nga ana e Ministrit Këshilltar është tërhequr nga arka e përfaqësisë shuma në vlerën 1,500 euro paradhënie. Nga auditimi i dokumentacionit gjatë kohës që ky diplomat ka ushtruar detyrën në këtë përfaqësi nuk rezulton që kjo shumë të jetë rimbursuar. Bashkëlidhur praktikës nuk ka dokumenta justifikues për qëllimin e tërheqjes së kësaj shume paradhënie.
3. Rezulton se për periudhën nga viti 2017 deri në dhjetor 2019 nga buxheti i përfaqësisë janë kryer pagesa për telefonat fiks (pakete telefon/internet/tv) për apartamentet e Ministrit fuqiptotë dhe Ministrit Këshilltar në kundërshtim me pikën 10 shkronja c) e VKM-së nr.20, datë 18.01.2017 dhe pika 4 në qarkoret e MEPJ për zbatimin e buxhetit.
4. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me pagesat që raportohen si shpenzime për MEPJ rezulton se, për periudhën objekt auditimit janë realizuar dhe raportuar pagesa në vlerën prej 5,518.83 euro për të cilat nuk është kërkuar dhe nuk është marë miratimi nga nënpunësi i parë autorizues i MEPJ si kërkesë e Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandimet për gjetjet kryesore:

1. MEPJ duhet të kërkojë zhdëmtimin e buxhetit të Ambasadës të RSH-së në Mbretërinë e Spanjës nga Z.P.N në vlerën 1,913.40 euro, për pagesa të kryera në kundërshtim me pikat 8, 9 të VKM-së nr.20, datë 18.01.2017 dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011.
2. Nga MEPJ të kërkohej kthimi i shumës në vlerën e 1,500 euro të përfutur në formën e paradhënies nga ish Ministri Këshilltar pranë kësaj përfaqësie në kundërshtim me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pika 62 e në vazhdim e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011.
3. Nga MEPJ të kërkohej zhdëmtimi i buxhetit të Ambasadës të RSH-së në Mbretërinë e Spanjës në vlerën 935.64 Euro dhe në vlerën 1,435.38 Euro, si pagesa në kundërshtim me pikën c) të VKM-së nr.20, datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe i familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në Misionet Diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë Jashtë Shtetit”.
4. Në të ardhmen të mos bëhen dhe raportohen shpenzime për MEPJ pa miratimin paraprak të nënpunësit të parë autorizues në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër, me shkresën nr.87 prot, indeksi J datë 07.09.2022 është vendosur në dijeni titullari i Institucionit për gjetjet e auditimit. Kjo shkresë nuk përmban ekstremitetet e plota të një dokumenti zyrtar.

Gjetje: Aktualisht nga ana e titullarit të Institucionit nuk është nxjerr asnjë urdhër/ nuk është ndërmarr asnjë nisëm për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës. Ku impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën 5,784.42 Euro.

Titulli i Gjetjes 28:	Madrid AB
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i kryer mbi dokumentacionin e përfaqësisë Madrid u konstatua problematika si më poshtë vijon:

	<p>Nga ana e drejtorisë së Auditit të Brendshëm të MEPJ-së me programin nr.54 prot, datë 24.05.2022 është audituar përputhshmëria dhe performanca ekonomiko-financiare e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, (pjesë e strukturës organizative të MEPJ-së). Referuar materialit të grupit të audit të brendshëm konstatohet se:</p> <p><i>Gjetje nr.1</i></p> <p>Aktualisht nga ana e titullarit të Institucionit nuk është nxjerr asnjë urdhër/ nuk është ndërmarr asnjë nisëm për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës. Ku impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën 5,784.42 Euro.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; - VKM nr.20, datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe i familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në Misionet Diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë Jashtë Shtetit”. - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; - Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; - VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
Ndikimi/Efekti:	Keqpërdorim dhe keqmenaxhim i pararsë publike.
Shkaku:	Problematik në dokumentacion justifikues.
Rekomandimi:	Nga ana e DAB të MEPJ-së të merren masa për të risjell në vëmendje të titullarit të institucionit nevojën për të ndërmarr nismën për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës. Impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën 5,784.42 Euro.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53 prot., datë 10.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit :Lidhur me gjetjen nr.29

Në konstatimin Tuaj keni theksuar se Komiteti është ngritur me urdhërin nr. 2, datë 08.01.2019 dhe sipas akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e këtij organi, ai ka një mandat dy vjeçar më të drejtë riemërimi dhe se Komiteti për vitin 2021 ka vepruar pa tagër pasi i ka mbaruar mandati. Për vitin 2022 nuk është mbledhur asnjëherë dhe më pas tek Konkluzioni “KAB rezulton se për periudhën 2020-2022 është mbledhur 5 herë dhe jo të paktën 12 herë...”

Sqarim: DAB ka vënë në dijeni rregullisht titullarin nëpërmjet komunikimeve elektronike, pasi. Në kohën e mbarimit të mandatit ka qenë kulmi i pandemisë COVID 19 dhe është marrë e mirëqënë vijimi i funksionimit të këtij komiteti me të njëjtët anëtarë, duke e konsideruar në të mirë të punës dhe standarteve të auditimit vijimi i punës së tyre. Gjithashtu në të njëjtën logjikë është edhe numri më i vogël i mbledhjeve për të cilat këta anëtarë kanë përfituar pagesë, dy herë në vitin 2020 dhe tre herë në vitin 2021. Ndonëse komunikimi me anëtarët e Komitetit për shkak të pandemisë ka qenë i vazhdueshëm online, duke përmbushur detyrimin ligjor që parashikohet në pikën 9, kreu II, VKM 160/2016, ata kanë përmbushur detyrimet sipas kalendarit, por nuk kanë përfituar pagesë për takimet që nuk kanë qenë prezent fizikisht. Nga viti 2022 e në vijim nuk është ngritur si strukturë pra nuk ka dal akt administrativ për këtë qëllim. Ndaj mendojmë që për të paraqitur situatën e saktë në raport të cilësohet fakti që për vitin 2022 e në vijim nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, jo nuk është mbledhur. Pas rekomandimit tuaj, mendojmë se ky proces do të përshpejtohet nga ana e strukturave drejtuese në MEPJ.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj, sqarojmë se nga ana juaj nuk na janë paraqitur gjatë fazës së projektraportit dokumentacione justifikuese, përveç shpjegimit të mësipër. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit. Lidhur me zëvendësimin e termit “ngritur” me “mbledhur” e gjykojmë të arsyeshme për ta reflektuar ndryshimin e sugjeruar.*

Pretendimi i subjektit:Lidhur me llojin e auditimit

Sqarim: E gjejmë me vend të sqarojmë se ashtu siç e keni konstatuar edhe ju në auditimin me zgjedhje të kryer në disa dosje auditimi, auditimi i përputhshmërisë e ka të përfshirë edhe auditimin financiar. Për shkak të kostove të auditimit të përfaqësive është e pamundur që të auditohet vetëm një sistem por gjatë një angazhimi auditohen të gjitha sistemet përfaqësive edhe atë financiar. Në çdo program pune dhe raport të auditimit është bërë një analizë e hollësishme për mënyrën e mbajtjes së kontabilitet, si dhe ndjekja e buxhetit nëse është bërë në përputhje me ligjin Nr.9936/2008. Unifikimi i evidencave raportuese është kryer me udhëzim të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ndërsa misioni i auditimit është ndjekja e zbatimit dhe vlerësimi i tyre në rast se cmohet e arsyeshme. Në cdo angazhim auditimi, ai financiar kryhet i plotë, duke zënë një pjesë të rëndësishme të volumit total të punës që kryhet në terren. Për shkak të largësisë gjeografike që kanë subjektet e vartësisë dhe kostove që mbart pashmangshmërisht cdo auditim, grupet e punës përballojnë një volum të madh pune duke mos patur luksin të bëjnë auditim për një sistem, por të disa sistemeve, përfaqësive edhe atë financiar, pasi vetë objekti i punës së përfaqësive është kompleks dhe nuk mund të shmangen p.sh. auditim i aktivitetit konsullor dhe të bëhet vetëm auditim financiar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pretendimit tuaj sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim që në misionet e auditimit duhet të përfshihet edhe Auditim Financiar i mirëfilltë. Observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me subjektet e përzgjedhura për auditim

Sqarim: Në lidhje me këtë konstatimin tuaj për frekuencën e kryerjes së auditimeve ku cilësoni që është 3.8 vite, theksojmë faktin se periudha juaj e auditimit përkon me periudhën e pandemisë Covid-19, ku ka qenë e pamundur lëvizja, pasi në kohë normale dhe aktualisht frekuenca është në përputhje me afatet e parashikuara në MAB. Megjithatë nga DAB është bërë një punë e mirë për të vijuar me procesin e auditimit edhe në këto kushte të vështira duke realizuar 10-15 auditime në vit. Aktualisht subjekti me një periudhë të gjatë kohe i pa audituar është vetëm Ambasada Kanada, e planifikuar të kryhet këtë vit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pretendimit tuaj, si dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion gjatë fazës së observacioneve të akt konstatimeve, i cili fakton realizimin e auditimit në Ambasada e RSH Brazil (Memorandum nr. 106 prot., datë 08.11.2022), në Ambasada e RSH Rumani (Memorandum nr. 29 prot., datë 02.05.2023), si dhe Plani vjetor 2023, lidhur me planifikimin për tu audituar Ambasada e RSH në Kanada, observacioni merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin tuaj për ndjekjen e rekomandimeve, ku cilësoni se NJAB nuk merr masa të mëtejshme administrativo-juridike për zbatimin e tyre me qëllim që ti shërbejnë arritjes së objektivave të Institucionit dhe Misionit të NJAB sqarojmë se: Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është kryer me përpikmëri detyra e saj funksionale në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 114/2015, si dhe Udhëzimit nr. 42, datë 27.10.2020. Janë hartuar raportet periodike për zbatimin e rekomandimeve dhe është njoftuar titullari për këtë qëllim. Në zbatim të pikës 4 të kreut III të këtij akti nënligjor, është në tagrin e titullarit të njësisë publike pra Ministrisë të përcaktojë përgjegjësinë individuale të personave të ngarkuar drejtpërsëdrejti për zbatimin e rekomandimeve. Titullari ka tagrin dhe instrumentat e nevojshme të urdhërojë nxjerrjen e akteve administrative përkatëse për këtë qëllim në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe jo DAB sic keni cilësuar në projekt raport. Përsa i përket asaj që ju keni cilësuar se në raportet vjetore nuk janë evidentuar mangësitë dhe shkeljet e konstatuara gjatë punës së kryer nga Grupi i KLSH sqarojmë se në zbatim të Ligjit për auditimin e brendshëm, MAB, kapitulli 4, pika 4.3 NJAB komunikon rezultatet e punës së saj dhe jo ato të KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me pretendimin tuaj sqarojmë se pranohet arsytimi juaj dhe se është kompetencë e titullarit të Institucionit nxjerrja e akteve administrative përkatëse, por ajo që konstatohet nga ana e grupit të auditimit është këmbëngulja më e madhe që duhet të kryhet nga ana e NJAB me qëllim marrjen e masave nga ana e titullarit. Përsa i përket evidentimit të shkeljeve dhe mangësive të konstatuara nga ana e KLSH dhe jo nga NJAB, grupi i auditimit është plotësisht dakord me faktin se misioni i KLSH është i ndryshëm nga misioni i NJAB, por referuar gjetjeve dhe konstatimeve të kryera nga KLSH, NJAB gjatë ushtrimit të detyrave të saj funksionale duhet ti kishte vlerësuar me risk të lartë. Përsa më sipër, observacioni merret në konsideratë pjesërisht dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Titulli i gjetjes nr. 29	Ushtrimi i funksionit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm në mospërputhje me kuadrin kigjor në fuqi
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se:

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka ushtruar funksionet e përcaktuara përgjatë vitit 2021 pa urdhër emërimi, në kundërshtim me pikën 6, kreu II, të VKM 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm”; 2. KAB për vitin 2020 është mbledhur gjithësej <u>2 (dy)</u> herë, përkatësisht në datën 23.01.2020 dhe 18.09.2020, si dhe për vitin 2021 është mbledhur gjithësej <u>3 (tre)</u> herë, përkatësisht në datën 28.01.2021, 29.09.2021 dhe 10.12.2021 dhe për vitin 2022, rezulton që KAB nuk është krijuar dhe rrjedhimisht nuk është mbledhur asnjëherë, në kundërshtim me pikën 9, kreu II, të VKM 160/2016.
Kriteri:	- VKM 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, kreu II, pika 6, pika 9.
Ndikimi/Efekti:	KAB nuk i jep titullarit të njësisë publike garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike.
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat përkatëse
Rekomandim:	-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e Komitetit të Auditimit sipas formës së kërkuar nga ligji. -KAB të mblidhet jo më pak se 4 (katër) herë në vitit.
Afati:	Menjëherë dhe në vijimësi
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 30	Problematika në lidhje me Auditin e Brendshëm.
Situata:	<p>Nga auditimi është konstatuar se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të gjitha auditimet e planifikuara dhe realizuara kanë qenë të llojit “<i>Auditim Përputhshmërie</i>” dhe në asnjë rast nuk është konsideruar e nevojshme të kryhet Auditim Financiar i mirëfilltë, edhe pse afërsisht 80 (tetëdhjetë) % e buxhetit të miratuar për MEPJ shkon për misionet diplomatike dhe postet konsullore. Nga auditimi me zgjedhje i raporteve të auditit të brendshëm u konstatuan raste të trajtimit të aspekteve financiare, referuar peshës totale që shpenzimet kanë në buxhetin e përfaqësive. 2. Dyzetë e tetë struktura të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore rezultojnë të audituara mestarisht 1 (një) herë në 3.8 vite (maksimalisht për 10 vjet dhe minimalisht për 2 vjet), në kundërshtim me pikën 3.1.3 të “Manuali i auditimit të brendshëm”, i ndryshuar. 3. NJAB pas cdo auditimi dhe lënies së rekomandimeve në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë, ndjek zbatimin e tyre në fund të cdo viti, në përputhje me shkronjën ç), neni 6, Ligji 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili parashikon se: “<i>Roli i auditimit të brendshëm është ti japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë... duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna</i>”, megjithatë referuar raporteve vjetore konstatohet se nuk janë evidentuar mangësitë dhe shkeljet ligjore evidente të konstatuara gjatë punës së kryer nga grupi i KLSH-së,

	gjithashtu konstatohet se rekomandimet nuk zbatohen plotësisht nga Institucioni si dhe NJAB nuk merr masa të mëtijshme administrative-juridike për zbatimin e tyre me qëllim që ti shërbejnë arritjes së objektivave të Institucionit dhe misionit të NJAB.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, shkronja ç). - Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	<ul style="list-style-type: none"> - Mos trajtimi i posacëm në formën e një auditimi financiar, sjell ndër të tjera mos unifikim të formatit të evidencave raportuese. - Mos respektimi i frekuencës në zgjedhjen e subjekteve për auditim sjell mungesë në përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit. - Mos ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna ndikon në mosmbështetjen e titullarit në arritjen e objektivave të njësisë. - Mos evidentimi i të gjitha mangësive dhe shkeljeve ligjore të shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë, ndikon në efektivitetin e njësisë publike.
Shkaku:	Largësia dhe shpenzimet e larta në përfaqësi.
Rekomandim:	<p>-Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa të përfshijë edhe Auditim Financiar të mirëfilltë në auditimet e misioneve diplomatike dhe përfaqësive.</p> <p>-Njësia e Auditit të Brendshëm në hartimin e planeve të subjekteve për tu audituar të fokusohet edhe në frekuencën e kryerjes së auditimit, duke mos lënë asnjë subjekt pa u audituar për më shumë se 5 vjet, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.</p> <p>-NJAB të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të lëna, duke siguruar dhënien e mbështetjes së titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë.</p> <p>-NJAB të angazhohet për të evidentuar në çdo rast shkeljet e kryera në shërbimin e jashtëm të republikës së Shqipërisë, duke siguruar në këtë mënyrë përmirësimin e vazhdueshëm të punës në Institucion.</p>
Afati:	Menjëherë dhe në vijimësi
Rëndësia:	E lartë

5.2 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli Brendshëm

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit, lidhur me vlerësimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe Auditit të Brendshëm, bazuar në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; VKM 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm”; urdhri nr. 108, datë 17.11.2016 i Ministrit të Financave “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, urdhri nr. 100, datë 25.10.2016 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” si dhe aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tyre, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullore e brendshme dhe Kod Etike;
- Regjistri i riskut;
- Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe deklaratat e cilësisë dhe pyetësi i vetëvlerësimit;
- Planet strategjike për periudhën (2020 – 2022), Planet vjetore të auditimit (2020-2022);
- Raportet vjetore të veprimtarisë (2020, 2021);
- Karta e Auditimit;
- Praktika e mbledhjeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

a) Mbi vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

- **Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike**

Titullari i njësive publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” (këtu e në vijim **Manuali MFK**), në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se “*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësive publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se MEPJ nuk disponon Kod Etike, por në pikat III, VIII, IX dhe X të Rregullores së Brendshme në fuqi, janë përfshirë orari i punës, rregulla të veshjes, të takimeve dhe pritjeve zyrtare, prona shtetërore vetëm nga ana e punonjësve të MEPJ dhe jo të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore. Mungojnë parashikime të elementëve si: parimet e etikës që duhet të respektojnë punonjësit në punën e tyre, rastet e konfliktit të interesit dhe shmangia e tyre gjatë veprimtarisë në këtë institucion, lejimi apo ndalimi i veprimtarive të jashtme rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror apo të mirëbesimit kur është e nevojshme, sjellje të veçanta që duhet të manifestojnë punonjësit në misionet diplomatike dhe posteve konsullore etj.

- Politikat menaxheriale dhe stili i punës

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxiti kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*’. Për sa më sipër rezulton se MEPJ nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat, si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publik*”. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se “*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashitohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave*”. Për vitin 2020, 2021, 2022 konstatohet se titullari i MEPJ nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “*GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike*”. Për sa më sipër, për periudhën 2020, 2021, 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar*

dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës”. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk figuron që nëpunësi autorizues të ketë deleguar disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit

MEPJ funksionon në bazë të një rregulloreje të brendshme të vitit 2010, përkatësisht ”Rregullore për disiplinën e brendshme në MPJ”, nr. 478 prot., datë 08.06.2010, e cila ka për objekt rregullimin e etikës dhe disiplinës së punës vetëm të strukturës së MEPJ, duke përjashtuar misionet diplomatike dhe postet konsullore në kuptim të ligjit nr. 9095, datë 03.07.2003 “Për shërbimin e jashtëm”, i shfuqizuar (në fuqi në momentin e daljes së rregullores). Për misionet diplomatike dhe postet konsullore rregulloret e brendshme nuk janë të azhornuara me ndryshimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk i përgjigjet kërkesave që rrjedhin nga Manuali MFK. Rregullorja aktuale e MEPJ nuk është e azhornuar me kuadrin ligjor në fuqi dhe nuk është përshtatur me ndryshimet e strukturave që kanë ardhur pas vitit 2010. Kjo rregullore nuk i përgjigjet kërkesave që rrjedhin nga Manuali MFK, për sa i përket: listimit të prioritetëve kryesore të Institucionit, funksionet e larta të menaxhimit, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të Njesisë, mënyrën e kryerjes së përfaqësimit ligjor, rregullat e etikës së stafit në mënyrë të detajuar, lëvizjet e stafit brenda dhe jashtë vendit, rregullat për komunikimin me median, informimi i publikut, rregullat mbi administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, mënyra e mbajtjes së dosjes së personelit, përshkrimet e punës të secilit prej pozicioneve, procedura e sinjalizimit, procedura e nxjerrjes së akteve administrative të njesisë, mënyra e mbajtjes së korrespondencës me strukturat brenda njesisë dhe me njësitë tjera etj.

Me shkresën nr. 10406/1 prot., datë 24.07.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konfirmuar Nëpunësin Autorizues për MEPJ, Z. A.Snë cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe me shkresën nr. 20606/587 prot., datë 14.05.2012, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konfirmuar Nëpunës Zbatues, znj. I.D në cilësinë e drejtoreshës së përgjithshme të Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse. Në zbatim të nenit 12, të ligjit 10296/2010, NZ është niveli menaxherial në vartësi direkte të NA. Në funksionet e tij, NZ mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njesisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Aktualisht, drejtoresha e përgjithshme ekonomike dhe e shërbimeve mbështetëse kryen funksionet e përcaktuara më sipër dhe është në vartësi direkte të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ. Sa më sipër, janë përmbushur kërkesat e nenit 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit 10296/2010.

- politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale MEPJ disponon plane të trajnimeve, por jo në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e Manualit të MFK.

Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*’ Për sa më sipër, rezulton se MEPJ nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar’ ku përcaktohet se ‘*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*’.

MEPJ nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, MEPJ nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

Aktivitetet e Kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në MEPJ, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësieve.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*’. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i MEPJ për vitet 2020, 2021, 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

Nuk rezulton e miratuar një procedurë mbi ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit në MEPJ. Për menaxhimin e aktiveve nuk rezulton i hartuar regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

Informimi dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e MEPJ, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, MEPJ ka një faqe zyrtare Web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Punonjësit e MEPJ kanë mundësinë e përdorimit të e-mail zyrtar nëpërmjet kompjuterave të punës dhe faqes ëeb të ministrisë.

Monitorimi

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se *'Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë'*. Për sa më sipër, nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në MEPJ mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paqaritet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se MEPJ nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se *'Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual'*. Për sa më sipër, për vitin 2020, 2021, 2022 rezulton se nëpunësi autorizues i MEPJ nuk ka hartuar deklaratën dhe

raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen mbi rregulloren e brendshme të MEPJ, si dhe rregulloren e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore. Pranohet pjesërisht.

Sqarim: DBNJ ka iniciuar përgatitjen e rregullores së brendshme të MEPJ, e cila është drejt përfundimit. Lidhur me rregulloren e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, sqarojmë se të gjitha përfaqësitë kanë një rregullore të brendshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:*Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe në materialin e projektraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen mbi planet e trajnimeve në fushën e menaxhimit financiar.

Nuk pranohet.

Sqarim: DBNJ vendos në dispozicion të punonjësve vetëm trajnime të lidhura me karrierën diplomatike, pasi për këtë qëllim ekziston struktura e Akademisë Diplomatike. Sa i përket nëpunësve civil të institucionit, ku përfshihen edhe punonjësit e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, kurset e trajnimit ofrohen nga ASPA (Shkolla Kombëtare e Administratës Publike), në të cilat punonjësit marrin pjesë vazhdimisht.

Qëndrimi i grupit të auditimit:*Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe në materialin e projektraportit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

Konkluzion: Nga analizimi i komponentëve të MFK-së, rezulton se strukturat drejtuese të MEPJ nuk e zbatojnë kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhërat e udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Titulli i gjetjes nr. 31	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata:	Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se: <ol style="list-style-type: none"> 1. MEPJ nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. 2. MEPJ nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

	<ol style="list-style-type: none"> 3. Për vitin 2020, 2021, 2022 titullari i MEPJ nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK. 4. Për periudhën 2020, 2021, 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’. 5. MEPJ kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme të vitit 2010, përkatësisht ”Rregullore për disiplinën e brendshme në MPJ”, nr. 478 prot., datë 08.06.2010. Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë. Për misionet diplomatike dhe postet konsullore rregulloret e brendshme nuk janë të azhornuara me ndryshimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk i përgjigjen kërkesave që rrjedhin nga Manuali MFK. 6. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi MEPJ nuk disponon një program trajnimi për punonjësit në fushën e MFK. 7. MEPJ nuk ka hartuar një strategji rrisht, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK. 8. Ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër rrisht, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296 për MFK. MEPJ nuk disponon as procedurë të menaxhimit të rrishtit ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i rrishteve dhe as raporte monitorimi të fushave me rrisht. 9. Titullari i MEPJ për vitet 2020, 2021, 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK. 10. Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e MEPJ, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit. 11. Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. 12. MEPJ nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK.
--	--

	13. Për vitin 2020, 2021, 2022 rezulton se nëpunësi autorizues i MEPJ nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27. - Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. - Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’. - Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. - Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. - Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ‘Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura’, neni 24; neni 35.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve financiare publike. Gjithashtu ka ndikuar negativisht në performancën institucionale për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Shkaku:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor nga titullari i institucionit, nëpunësi autorizues dhe personat e tjerë përgjegjës për MFK.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	<ul style="list-style-type: none"> -Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre. -Titullari i institucionit të ngrëjë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre. -Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.5 dhe nr. 6, datë 16.05.2023 dhe ngarkohen me përgjegjësi:

-Anëtarët e KAB, ngritur me urdhrin nr. 02, datë 08.01.2019 “Për riemërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme”;

-z.A.S, me detyrë ish Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues;

-zj. I.D, me detyrë drejtoreshë e përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues;

-zj. E.H, me detyrë drejtoreshë e NJAB, në cilësinë e drejtuesit të NJAB.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: MEPJ me anë të urdhrit nr. 79, date 01.02.2023, ka ngritur grupin e punës i cili do të hartojë ndryshimet e ligjit nr. 23/2015 Për shërbimin e Jashtëm me RSh-se. Ne ketë kuadër, grupi i punës do të evidentojë dispozitat qe do te preken nga dyshimi i ligjit dhe do te përgatis një analize te detajuar mbi ato se çfarë synon ndryshim i dispozitave.

Referuar sa më sipër, në proces rishikimi janë edhe te gjithë dispozitat ligjore, urdhrat, udhëzimet dhe manualet qe referohen ne ligj. Nder dispozita ligjore qe janë pjese e listës për rishikim janë:

1. VKM nr.816, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullores të shërbimit të jashtëm”
2. Urdhri nr.507, datë 15.10.2012 i Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për përdorimin e automjeteve dhe të karburantit në Përfaqësitë Diplomatike e Konsullore të Republikës së Shqipërisë”.
3. Ligji nr.8372, datë 09.07.1998 «Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga Përfaqësitë Diplomatike ose Konsullore, Manuali Konsullor».
4. Udhëzim mbi bashkëpunimin e strukturave të MEP, MPB dhe Shërbimit Informativ shtetëror për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt.
5. VKM nr.20, datë 18.01.2017 «Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe i familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në Misionet Diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë Jashtë Shtetit».
6. VKM nr.870, datë 14.12.2011 e Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.
7. Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, dalë në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
8. Udhëzim nr. prot 6999, datë 21.06.2012, “Udhëzim për inventarët dhe nxjerrjet jashtë përdorimit.
9. Urdhër i MPJ 418, datë 19.07.2012, Për miratimin e rregullores specifike për MPJ, “Për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në njësinë publike.
10. Shkresë e MEPJ nr. 10003. datë 13.06.2014. përcillet “Manual i protokollit të përfaqësive diplomatike në përgatitjen dhe zbatimin e programit të vizitave zyrtare”
11. Urdhër nr.276, datë 05.08.2014 “Për miratimin e Rregullores për punën me dokumentet me dokumentet dhe arkivat në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH-së” Urdhër nr.86, datë 10.12.2015, Për miratimin e kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”.
12. Urdhër nr. 86, datë 10-12-2015 “Për miratimin e kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”
13. Urdhër nr.317, datë 22.09.2016, “Për miratimin e kartës së auditimit të brendshëm”
14. Urdhër nr.281, datë 15.05.2015 “Ngritjen e komisioneve të vlerësimit në përfaqësi dhe komisionit të nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve të MPJ-së dhe përfaqësive diplomatike dhe konsullore të RSH-së të akredituara jashtë vendit”
15. Urdhër nr.505, datë 16.10.2015 “Procedurat e pajisjes me targë diplomatike për automjetet në pronësi të diplomatëve gjatë periudhës të ushtrimit të detyrës në misionet diplomatike dhe konsullore të RSH-së”.
16. Urdhër nr.181, datë 18.04.2018 “Procedurat e pajisjes me targë diplomatike për automjetet në pronësi të diplomatëve gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës në misionet diplomatike dhe konsullore të RSH-së”.
17. Urdhër nr.3749 datë 13.03.2019 “Për emetimin dhe transportin e dokumenteve biometrike të shtetasve shqiptar që aplikojnë në misionet diplomatike /postet konsullore jashtë vendit”.
18. Rregullore për punën me dokumentet dhe arkivat në përfaqësitë diplomatike e konsullore të RSH-së.
19. Udhëzim nr.79, datë 14.06.2021 “Për parkimin e automjeteve në oborrin e MEPJ”
20. Vendim nr.1416, datë 01.02.2023 “Për miratimin e listës së informacioneve të klasifikuara sekret shtetëror në MEPJ dhe strukturat në varësi të saj”.
21. Urdhër nr.123, datë 17.03.2023 “Për kategoritë dhe llojet e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror të cilat u nënshtrohen procedurave të asgjësimit në MEPJ dhe strukturat në varësi”
22. Udhëzim nr.prot124, datë 17.03.2023 “Për zbatimin e VKM nr.81 datë 28.01.2008 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror në MEPJ dhe strukturave në varësi të saj”.
23. Urdhër nr.143, datë 18.04.2017 “Për disiplinimin dhe qarkullimin e brendshëm në godinën e MEPJ”.
24. Urdhër nr.80, datë 08.02.2018 “Për miratimin e skemës të indeksimit dhe ekspertizës së dokumenteve në MEPJ.
25. Udhëzim nr.591, datë 03.12.2020 “Për zbatimin e VKM nr.542, datë 25.07.2019 për miratimin e rregullores për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit SKI në MEPJ”.

MEPJ me anë të Urdhri nr. 150, datë 28.04.2022 ka hartuar Planin e Integritetit të Institucionit për periudhë 2022-2025 (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sqarojmë se grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim sic ju është përcjellë edhe ne materialin e projekraportit.*

Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

6. Zbatimi rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme:

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën 01.05.2017 deri 31.08.2019 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 1, datë 13.01.2020, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 675/29 prot., datë 06.10.2020 konstatohet se:

- Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **24** rekomandime gjithsej, nga këto, 2 propozime për përmirësime ligjore, 15 masa organizative, 1 masë shpërblim dëmi, 3 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, 2 masa disiplinore dhe 1 trajtim ankese.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Propozime për përmirësime ligjore janë lënë **2** rekomandime, nga të cilat janë pranuar dhe janë të pazbatuar **2**.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **15** masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht **8**, në proces zbatimi **1**, të pazbatuar **5** dhe i pa pranuar **1**.
- c) Rekomandime për Shpërblim Dëmi është lënë **1** rekomandim për shumën 8,780,443 lekë, i cili është pranuar dhe është i pazbatuar **1**.
- d) Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **3** rekomandime, të cilat janë pranuar të **3**, është zbatuar **1** dhe janë në proces zbatimi **2**.
- e) Rekomandime për masa disiplinore, administrative dhe të tjera janë lënë **2** rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë të pazbatuar.
- f) Rekomandim mbi ankesën nr. 887, date 04.11.2019, te ish-punonjësit të MEPJ është lënë **1** i cili është pranuar dhe zbatuar.
- g) Rekomandime të lëna nga auditimi i mëparshëm lënë **10** masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht **2**, të pazbatuar **5** dhe i pa pranuar **3**.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIMIN OSE PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë Nr. 23/2015, neni 47 “Dhënia e Gradave” parashikohen hapat që ndiqen

në mënyrë që një Diplomat karriere të përftojë gradat njëra pas tjetrës, ku ndër të tjera pika 5 parashikon se: “*për përfitimin e gradave, Ministër Këshilltar, dhe Ministër Fuqplotë, përveç kushteve të pikës 1, kandidati duhet të ketë të paktën dy vjet përvojë në poste drejtuese për secilën gradë, si edhe të ketë shërbyer në misionet diplomatike dhe konsullore*”. Në fakt, ky ligj, në nenin 58 parashikon nxjerrjen e akteve nën ligjore për nenin 47 pika 3, 4 e 8, dhe jo për pikën 5 sikundër edhe ka ndodhur. Konkretisht, në zbatim të ligjit Nr. 23/2015, ka dalë VKM Nr. 816, datë 07.10.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, ku rezultoi se është parashikuar me pa të drejtë, një interpretimi gabuar i pikës 5 të nenit 47 të ligjit 23/2015, në kushtet kur ligji **nuk** ngarkon me detyrimin për interpretim të kësaj pikë. Konkretisht pika 6 e VKM Nr. 816, datë 07.10.2015 (në interpretim të pikës 5 të ligjit), përkufizon se për qëllim interpretimi “post drejtues” quhet:

- a) Drejtor i Drejtorisë, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme, Sekretar i Përgjithshëm, dhe
- b) kreu i misionit diplomatik ose posti konsullor, i ngarkuar me punë”.

Sa më sipër përveç se në shkelje të nenit 58, pika 1 të ligjit 23/2015, gjithashtu bie ndesh me konceptin e “postit drejtues” i cili parashikohet qartë në nenin 39 pika 1, ku thuhet se:

“*Diplomati i karrierës emërohet me post drejtues (...):*

- a) *përgjegjës sektori me gradën jo më të ulët se Sekretar i Parë;*
- b) *drejtor me gradën jo më të ulët se Këshilltar, dhe c) drejtor i përgjithshëm me gradën jo më të ulët se Ministër këshilltar*”.

Pra, koncepti i postit drejtues është më i gjerë se interpretimi i kufizuar dhe në shkelje ligjore të pikës pika 6 të kreut V të VKM Nr. 816, datë 07.10.2015.

Gjithashtu ky interpretim bie në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”:

-pika 4 (Nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese ku përfshihen *Sekretar i Përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor drejtorie të përgjithshëm dhe pozicione të barazvlefshme me të*”

-pika 5 (Nëpunës civil të kategorisë së mesëm drejtuese ku përfshihen *drejtor drejtorie dhe pozicione të barazvlefshme me të*) dhe

-pika 6 (Nëpunës civil të kategorisë së ulët drejtuese ku përfshihen *shëf sektori dhe pozicione të barazvlefshme me të*) të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

Pika 6 e Kreut V të “Rregullores së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë” është në kundërshtim me të dy ligjet e sipërcituara.

Gjithashtu interpretimi i bërë në këtë pikë të Rregullores ka tejkalar detyrimet që burojnë nga ligji 23/2015, neni 58, pika 1, sipas të cilit aktet nënligjore për zbatimin e tij duhet të dilnin për nenin 47, pika 3, 4, 8 dhe jo për pikën 5, sikundër në fakt ka ndodhur.

1.1 Rekomandimi: Grupi i auditimit rekomandon se, MEPJ t’i drejtohet Këshillit të Ministrave për të kërkuar shfuqizimin e pikës 6 të kreut V të VKM Nr. 816, datë 7.10.2015, me qëllim mos kufizimin e të drejtës dhe ofrimin e mundësive të barabarta të gjithë diplomatëve të karrierës që të avancojnë në përfitimin e gradave diplomatike sipas detyrimeve të ligjit dhe jo ndryshe.

Brenda 31.01.2020

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është pranuar dhe konsiderohet i pazbatuar.

Në mbështetje të zbatimit të këtij rekomandimi, është ngritur urdhri nr. 206, datë 11.04.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë”, i cili ka parashikuar ngritjen e grupit të punës me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë për shërbimin e jashtëm të republikës së Shqipërisë. Ndodhur në kushtet ku nuk ka asnjë veprim konkret nga grupi i punës për hartimin e ndryshimeve përgjatë periudhës Maj 2019 – Shtator 2022, si dhe mjedisi veprues nuk ka ndryshuar në mënyrë të tillë që problemi mos të ekzistojë më ose rekomandimi nuk është më i përshtatshëm apo i realizueshëm, e konsiderojmë të pa zbatuar si rekomandim.

2.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në ligjin 23/2015 dhe në VKM 816, datë 07.10.2015: nuk parashikohet raporti i drejtë që duhet të këtë grada e emërimit me gradën personale të diplomatit; nuk parashikohet rotacion emërimesh në përfaqësitë diplomatike; si dhe nuk parashikohet se sa duhet të jetë në përqindje raporti i emërimeve mes diplomatëve të karrierës me emërimet nga jashtë sistemit.

Mungesa e këtyre kritereve të rëndësishme, nuk argumentohet, për më tepër që në ligjin e mëparshëm (të shfuqizuar nga ligji 23/2015), këto kritere ishin parashikuar në mënyrë të detajuar si:

- pas çdo emërimi në përfaqësi diplomatike me kohëzgjatjen 3 vjet, personi i emëruar të qëndrojë dy vite pune në MEPJ.

- raporti i emërimeve mes diplomatëve të karrierës me ata jashtë sistemit ka qenë 80% me 20%.

- grada e emërimit të jetë maksimumi një gradë më lartë se grada personale,

a. Paraqitur në këtë formë, ligji krijon hapësira për vendimmarrje subjektive. Gjithashtu rritja e gradës e cil shoqërohet me rritje të pagës, rrezikon të shkaktojë rritje të kostos financiare pa një kriter ligjor, por vetëm në gjykimin personal të titullarit.

b. Nga ana tjetër, ky fenomen:

- rrezikon të çënojë të drejtën që çdo diplomati t’i jepet mundësia të emërohet në misione diplomatike apo ambasada, si dhe

- jep mundësinë e tejzgjatjes në kohë të mandatit të një/ disa diplomatëve.

c. Mungesa e këtyre përcaktimeve ligjore çënon parimin e mundësive të barabarta përdiplomatët e karrierës, duke lejuar emërime subjektive nga jashtë sistemit.

2.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet epunës, rezultoi se sa i takon nëpunësve të MEPJ-së, të cilët prej disa vitesh kanë fituar statusin e nëpunësit civil, duke qenë të punësuar në MEPJ dhe që referuar ligjit nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, duhet të kenë gradën e diplomatit, përshkak se janë në poste drejtuese, edhe pse vërejmë nevojën për rishikimin e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nuk mund të shprehem për zgjidhjen e këtij “ngërçi ligjor”, pasi Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka konflikt interesi në kuptimin që parashikon ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

2.1 Rekomandimi: MEPJ të marr masa për ngritjen e grupeve të punës me qëllim hartimin e draft ndryshimeve në ligjin 23/2015 dhe në VKM 816, datë 07.10.2015, për vendosjen e kritereve të detajuara, në lidhje me:

- raportin e gradës personale dhe asaj të emërimit,
- kohëzgjatjen dhe rotacionin e diplomatëve,

- raportin e emërimeve mes diplomatëve të karrierës me ata jashtë sistemit, etj çështje që i shërbejnë parimeve të meritokracisë dhe shanseve të barabarta të punësimit në shërbimin e jashtëm. Sa më sipër t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

Brenda 31.03.2020

Oëndrimi i grupit të auditimit;

*Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.*

Në mbështetje të zbatimit të këtij rekomandimi, është ngritur urdhri nr. 206, datë 11.04.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e shërbimit të jashtëm të republikës së Shqipërisë”, i cili ka parashikuar ngritjen e grupit të punës me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë për shërbimin e jashtëm të republikës së Shqipërisë. Ndodhur në kushtet ku nuk ka asnjë veprim konkret nga grupi i punës për hartimin e ndryshimeve përgjatë periudhës Maj 2019 – Shtator 2022, si dhe mjedisi veprues nuk ka ndryshuar në mënyrë të tillë që problemi mos të ekzistojë më ose rekomandimi nuk është më i përshtatshëm apo i realizueshëm, e konsiderojmë të pa zbatuar si rekomandim.

C.1 MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për të gjithë periudhën objekt auditimi, raportet e monitorimit të Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ) janë paraqitur në kohë dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit, për njësitë e qeverisjes qendrore”. Përveç sa më sipër, nga verifikimet e raporteve të monitorimit rezultuan edhe disa mangësi si vijon:

-Për vitin 2019 rezultuan diferenca mes planit të buxhetit të raportuar nga MEPJ dhe realizimit faktik nga thesari, sipas SIFQ, në kundërshtim me paragrafin 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit”, që parashikon se të dhënat duhet të jenë të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin në fakt të thesarit sipas SIFQ.

Për sa më sipër, MEPJ nuk ka dijeni dhe si pasojë nuk ka paraqitur shpjegimet përkatëse në raportin e monitorimit. Konkretisht për shpenzimet korente, në programin “Mbështetje institucionale për procesin e integritetit” rezultoi një diferencë prej -105 mijë lekë. Ndërsa për shpenzimet kapitale ka mospërputhje për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” dhe “Mbështetje institucionale për procesin e integritetit”, përkatësisht 7,576 mijë lekë dhe 67,958 mijë lekë.

- Raporti i monitorimit, për vitin 2018 (8 mujori), dhe për 4 mujorin e parë të vitit 2019, nuk shoqërohet me Aneksin nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”, për të gjithë programet, sikundër dikton udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit, për njësitë e qeverisjes qendrore”.

-Në raportin e monitorimit, për vitin 2018, për programin 01120, nuk jepen shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, në kundërshtim me sa parashikohet në paragrafin 49, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit”.

1.1 Rekomandimi: MEPJ t’i drejtohet Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim verifikimin dhe saktësimin e vlerave të raportuara për llogari të MEPJ-së konkretisht në programin 01110 “Planifikimi, menaxhimin dhe administrimi” për vlerën 7,576

mijë lekë; në programin 01150 “Mbështetje institucionale në programin e integritetit” për vlerën 68,064 mijë lekë.

Menjëherë

Oëndrimi i grupit të auditimit;

*Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.*

1.2 Rekomandimi: Me qëllim ndjekjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara nëdeklaratën e politikës së programit, nëpërmjet krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktikë, nevojitet sa më poshtë vijon:

-Në të gjitha raportimet periodike mbi monitorimin e buxhetit, të plotësohet Aneksi nr.4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”, për të gjithë programet.

Në vazhdim

Komenti i grupit të Auditimit

*Rekomandimi **i pranuar** dhe konsiderohet **i zbatuar**.*

1.3 Rekomandimi:

Në çdo raportim periodik të realizimit të buxhetit, të jepen shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli.

Në vazhdim

Komenti i grupit të Auditimit

*Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.*

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, buxheti i planifikuar për programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, për vitin 2018 u parashikua në shumën totale prej 2,179,089 mijë lekë. Referuar raportit të monitorimit të buxhetit për vitin 2018, që MEPJ dërgon në Ministrinë e Financave, rezultoi se ky program është realizuar në shumën 2,177,131 mijë lekë ose rreth 99.9% ndaj planit. Nga kryqëzimi i të dhënave sipas këtij raporti, me transfertat bankare të buxheteve individuale për çdo ambasadë rezultoi se, vlera totale e transferuar nëpërmjet transfertave bankare për vitin 2018 ishte 1,642,344 mijë lekë, nga 2,177,131 mijë lekë që raportohet buxheti për po të njëjtin vit (pra me një diferencë prej -534,787 mijë lekë, ose 35% më pak). Diferenca vjen si pasojë e kryerjes së disa shpenzimeve direkt nga Aparati i MEPJ-së për llogari të ambasadave, si shpenzimet për sigurime shëndetësore e shoqërore, pagesë kuotash ndërkombëtare si dhe një kategori shpenzimesh “për llogari të MEPJ-së” që lidhen me udhëtimet jashtë shtetit të delegacioneve ministrore, si dhe transfertat të tjera si ato të miratuara me VKM.

Këto të fundit përgjithësisht janë kryer në bazë të shkresës nr. 3515, datë 02.03.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm, ku parashikohet se: “*Titullari i përfaqësive, në cilësinë e NA të Nivelit të Dytë, është urdhëruar vetëm për buxhetin e misionit diplomatik dhe postit konsullor dhe nuk mund të urdhërojë në asnjë rast shpenzime jashtë këtij buxheti, qofshin këto për llogari të MEPJ apo për llogari të institucioneve të tjera si Presidencë, Këshilli I Ministrave, Parlamenti, etj, pa u udhëzuar më parë nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MEPJ*”.

Si të tilla këto fonde duke u transferuar për llogari të përfaqësive diplomatike, prekin programin buxhetor të përfaqësive nr. 01120, kur në fakt i takojnë programit 01110 “Planifikim, menaxhim

dhe administrim” të Aparatit të MEPJ, duke rrezikuar kështu kalimin nga një program në një tjetër pa ndjekur procedurat standarde që parashikon udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

b. Në vijim rezultoi se, në bazë të VKM nr. 115, datë 23.02.2018 “Për autorizimin e MEPJ për lidhjen e kontratës ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe kompanisë “A.Ë” është korrigjuar struktura buxhetore e Ambasadës së Londrës, duke u shtuar fondi 602, i kësaj përfaqësie dhe pakësuar Fondi Rezerve (llog. 609) me shumën 80,400,000 lekë (600,000 Eur). Nga auditimi rezultoi se për këtë rishikim buxhetor, grupi i auditimit edhe pse kërkoi informacion, nuk ju vu në dispozicion asnjë evidencë që të tregojë se MEPJ si ministri e linjës të ketë përgatitur ndonjë projekt ku të argumentojë nevojën për shtesë fondesh, pamundësinë për tu përballuar nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit nisur nga analiza e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese, emergjencën e problemit dhe pamundësinë e parashikimit në procesin buxhetor, në kundërshtim me sa dikton paragrafi 88 i Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, I ndryshuar, ku parashikohet se: “Fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit”. Gjithashtu ndryshimet buxhetore sipas VKM-së sësipërpërmendur, nuk relatohen në raportet e monitorimit.

2.1 Rekomandimi: Me qëllim shmangien e risqeve për shkelje të disiplinës financiare dhe buxhetore, në raportet e monitorimit të buxhetit, të argumentohen në çdo rast, të gjitha shtesat dhe pakësimet e buxheteve. Të gjitha shumat e akorduara në përfaqësitë respektive, veçanërisht ato me VKM të veçanta, të reflektohen përkatësisht në buxhetin dhe realizmin e tij, për secilën përfaqësi dhe jo ndryshe.

Në raportet e monitorimit të ndiqet realizmi i buxhetit të programit 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit” edhe për secilën ambasadë, si njësi shpenzuese më vete, duke analizuar hap pas hapi shkaqet për realizim ose tejkalim të këtyre buxheteve, në respekt të rritjes së transparencës së përdorimit të fondeve publike.

NA dhe NZ të marrin masa të mos kryejnë më shpenzime për llogari të MEPJ, jashtë përfaqësive diplomatike, pa ndjekur procedurat standarde që dikton Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Në vazhdim

Përgjigja e institucionit.

Pranuar pjesërisht dhe konsiderohet në zbatim.

Nga ana e MEPJ ndiqet realizimi i buxhetit për përfaqësitë diplomatike, specifikisht edhe për pjesën e fondeve të programit 120 i cili u transferohet atyre, sa më sipër rekomandimi do të mbahet në konsideratë në çdo planifikim, zbatim dhe rialokim buxheti.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

Referuar projekt buxhetit të vitit pasardhës dhe realizimit të tij këto elementë konsiderohen të realizuara.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nuk është kryer inventarizimi fizik iaktiveve për vitin 2017 dhe 2018. Për vitin 2017 inventarizimi është kryer i pjesshëm vetëm për materialet gjendje në magazinë. Si rezultat, gjendja e të dhënave kontabël në pozicionin financiar të vitit 2017

dhe 2018, nuk është rakorduar me gjendjen fizike, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, neni 7 Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kapitulli V. Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve , Inventarizimi i Aktiveve pika 74.

3.1. Rekomandimi: MEPJ të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit, të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit.

Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe konsiderohet në zbatim.

Nga ana e MEPJ në zbatim të rekomandimit të mësipërm është ngritur me Urdhër nr.241 datë 20.05.2020 komisioni për inventarizimin e aktiveve.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi është i pranuar dhe konsiderohet në proces zbatimi.

Ky rekomandim është pranuar por nuk mund të gjykojmë saktësisht mbi zbatueshmërinë e tij, pasi kemi një variabël të pamatshëm dhe të pavlerësueshëm për shkak të intervalit kohor në vijimësi, por nisur nga ngritja e komisionit për inventarizimin e aktiveve gjykojmë ta konsiderojmë në proces zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se, Pasqyrat Financiare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2017 dhe 2018 **nuk pasqyrojnë me vërtetësigjendjen kontabël për periudhat respektive, pasi nuk është bërë reflektim i plotë i aktivitetit të ish Ministrisë së Integritimit Evropian, konkretisht:**

Në vijim të VKM nr. 500, datë 13.09.2017 Nëpunësi Autorizues i MEPJ ka nxjerrë urdhrin nr. 266, datë 10.10.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të dokumentacionit financiar dhe buxhetit të ish- MIE”. Grupi i punës përbëhej nga 10 punonjës, 6 prej të cilëve nga personeli i ish- MPJ (aktualisht MEPJ) me kryetar Drejtorin aktual të financës në MEPJ dhe 4 nga personeli i ish- MIE. Urdhri nuk ka të cilësuar datën e përfundimit të marrjes në dorëzim dhe detyrimin e relatimit tek NA nga grupi i punës, duke mos dokumentuar përgjegjësinë e NA në monitorimin e këtij procesi. Nga auditimi u konstatua se nuk ka një procesverbal dorëzimi apo relacion mbi marrjen në dorëzim të dokumentacionit nga ish- MIE, megjithëse sipas sektorit të financës së MEPJ është marrë në arkivën e MEPJ gjithë aktiviteti financiar dhe dokumentar i saj. Në kundërshtim me plotësinë e dokumentacionit të marrë nga ish- MIE, sipas sektorit të financës dhe grupit të marrjes në dorëzim, nuk janë marrë në dorëzim pasqyra financiare të vitit 2016 të ish- MIE. Gjithashtu nuk janë marrë pasqyra paraprake për vitin 2017, megjithëse përgjegjësi i sektorit dhe specialisti financës janë larguar nga detyra në mes të muajit janar 2017.

4.2 Ish-Nëpunësi Autorizues i ish MIE-së Znj. D.Ç dhe ish-Nëpunësi Zbatues i ish MIE-së, Znj. B.P , në rolin e nëpunësve të lartë të menaxhimit të njësisë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, kontabilitetin dhe raportimin financiar, **nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës**, në kundërshtim me VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, kreu III, neni 27, 28, 29 dhe 30 i tij si dhe udhëzimit

nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke ndikuar në cilësinë e procesit të konsolidimit. Ky fakt ka sjellë mungesën e plotësisë së dokumentacionit kontabël dhe pamundësi në administrimin e kujdesshëm të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrat respektive të ministrisë që përthithi programet të këtij institucioni.

4.3 Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të MEPJ dhe gjendjes kontabël më datë 31.12.2017 dhe 31.12.2018 konstatohet se janë përfshirë në pasqyrat financiare të MEPJ, pas ndryshimit të fushës së përgjegjësisë, vetëm mjete transporti në vlerën 30,448,197 lekë dhe pajisje në vlerën 8,724,773 lekë, të vlerës së mbartur nga viti 2016. Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të ish-MIE për vitin 2016, rezulton se gjendja e Aktivit më 31.12.2016 është në vlerën 79,875,251 lekë dhe se ka një *diferencë midis zërave të përfshirë në pasqyrat e MEPJ në vlerën totale 51,361,321 lekë*, si dhe mungesë pasqyrimi të amortizimit të akumuluar të aktivit përkatës. Konkludojmë se, vetëm nga aktiviteti financiar i vitit 2016 i ish- MIE është përfshirë në MEPJ 43% i aktiveve joqarkullues, sipas gjendjes fillestare dhe pa përfshirë amortizimin e akumuluar, si dhe nuk janë përfshirë aktivet e tjerë joqarkullues, apo aktivet qarkullues në vlerën fillestare 76,888,257 lekë. (Në 31.12.2016 llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” rezulton me gjendje 712,606 lekë dhe llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” rezulton në vlerën 120,135 lekë), si dhe aktiviteti operativ dhe investues i vitit 2017, ku sipas aktit normativ nr. 2/2017, “Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2017” konstatohet se fondet e akorduara për ish- MIE kapin vlerën 695,020 mijë lekë. Nga raportet e monitorimit për vitin 2017 dhe komentet e MFE në lidhje me to, sipas të dhënave të publikuara nga MFE në faqen zyrtare konstatohen vetëm komentet për raportimin e 4 mujorit të parë të vitit 2017, nga ish-MIE janë kryer 44,107 mijë lekë shpenzime korrente dhe 38,393 mijë lekë shpenzime kapitale. Këto shpenzime, së bashku me shpenzimet e veprimtarisë së ish- MIE deri në fund të ekzistencës së saj, nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare të MEPJ.

4.4 Nga ana e Nëpunësit Autorizues të MEPJ-së për periudhën objekt auditimi, si përgjegjës për planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së institucionit, **nuk janë marrë masat e nevojshme** për marrjen në ngarkim të të gjithë elementëve pasurorë dhe jo pasurorë të aparatit të ish MIE-së. Gjatë auditimit nuk na u vu në dispozicion asnjë urdhër i NA-së së MEPJ, për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2017 të ish- Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE).

4.5 Pasqyrat financiare janë firmosur nga Shefi Financës në cilësinë e Hartuesit dhe Nëpunësi Zbatues në cilësinë e Drejtuesit të Aparatit të MEPJ dhe në relacionin shpjegues nuk ka asnjë shpjegim që në këto pasqyra, nuk është përfshirë aktiviteti i ish Aparatit të MIE-së. Nga auditimi u konstatua se MEPJ për vitin 2017 dhe 2018 nuk ka cilësuar në pasqyrën e shënimeve shpjeguese ndryshimin e fushës së përgjegjësisë dhe arsytet e reflektimit të disa aktiveve dhe mosreflektimit të zërave të tjerë. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14 date 28/12/2006 “ Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave Financiare të vitit 2006 për Institucionet Qëndrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, të ndryshuar, Kreu III, Pika 12, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.7 Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale. Pika 85.

4.1 Rekomandimi:

-Nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik, të merren masa për përfundimin e procesit të konsolidimit të të gjithë

elementëve të pozicionit financiar që i takojnë pas përthithjes së programeve të ish- Ministrisë së Integritimit Evropian.

-Strukturat Drejtuese të MEPJ/Nëpunësi Autorizues i MEPJ-së, të marrë masat e nevojshme për të përfunduar procesin e dorëzimit të detyrës nga ish drejtuesit e MIE-së, brenda një afati të caktuar prej tij. Për çdo mungesë apo dëmtim të aktiveve në ngarkim të personave përgjegjës, të merren masat e nevojshme kundrejt legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi **i pranuar** dhe konsiderohet **i pazbatuar**.

5.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të MEPJ konstatohet se hartimidhe raportimi financiar i përfaqësive diplomatike nuk është i plotë, pasi:

- Përfaqësitë diplomatike nuk hartojnë pasqyra financiare të veçanta. Në strukturat e tyre nuk ka domosdoshmërisht punonjës me formim financiar. Përzgjedhja e nëpunësit të ngarkuar me financën bëhet nga titullari i përfaqësisë diplomatike dhe në përshkrimin e punës nuk ka specifikime në lidhje me detyrimin për pozicionin e punës dhe mbajtjes së llogarive financiare, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Neni 12, Pika 3/1.

-Për hartimin e pasqyrave të konsoliduara të përfaqësive, sektori i financës në MEPJ merr evidenca mujore, progresive nga secila përfaqësi. Si rezultat, MEPJ harton pasqyra financiare të konsoliduara për gjithë përfaqësitë diplomatike për të cilat bën raportim në Degën e Thesarit Tiranë. Monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë nuk kryhet nga sektori i financës, megjithëse minimalisht ndërtimi i pasqyrave financiare që ajo realizon kërkon mbështetjen dhe verifikimin e evidencave mbështetëse për të ruajtur dhe pasqyruar vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre. Gjatë auditimit u konstatua se në përfaqësitë diplomatike nuk mbahet libër magazine dhe nuk kryhet inventarizim përpara mbylljes së pasqyrave financiare. Libri i magazinës apo inventarizimi nuk kryhen as nga MEPJ, për llogari të përfaqësive. Hartimi i këtyre pasqyrave nuk mbështetet mbi bazën e evidencave mbështetëse, në kundërshtim me Neni 6 “Evidenca mbështetëse”, Pika 1, ... “Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencambështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjate gjithë periudhës kohore. Sa më sipër në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë Pika 34, si dhe Udhëzim e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të PasqyraveFinanciare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kreu 2.2.

-Nga evidencat e vëna në dispozicion nga përfaqësitë e përzgjedhura për tu audituar, konstatohet se evidencat janë të plotësuara sipas një varianti elektronik të dërguar nga sektori i financës së MEPJ. Megjithatë në përfaqësitë e përzgjedhura konstatohet se nuk ruhet i njëjti format raportimi, nuk përcillet tërësia e këtyre evidencave, si dhe bashkëlidhur evidencave mujore dhe progresive nuk ka dokumente justifikuese si fatura, bileta udhëtimi, mandat pagese etj, duke konstatuar një mungesë standardizimi në procedurën e ndjekur nga MEPJ.

-Nga përfaqësitë nuk plotësohen urdhër shpenzime, për ekzekutimin e të cilave të merret miratim nga MEPJ, duke cënuar kontrollin e veprimtarisë financiare nga MEPJ. Shpenzimet raportohen vetëm pasi kryhen, në zërin që i korrespondon në evidencën mujore.

Për veprimtarinë e mësipërme të përfaqësive diplomatike konkludojmë se, përfaqësitë diplomatike e kryejnë aktivitetin e tyre financiar jashtë rregullave të përgjithshme kontabël të hartimit dhe raportimit financiar dhe mbulimi i këtyre rregullave nga vetë MEPJ, nuk paraqitet i plotë për faktin e mungesës së justifikimit të vërtetësisë me dokumente të miratuara kontabël dhe monitorimit të pamjaftueshëm të shpenzimeve në përfaqësi.

5.2 Pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe vitit 2018 depozituar në Degën e Thesarit Tiranëpërkatesisht me shkresat nr. 1, datë 30.03.2018, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2017” dhe nr. 100, datë 29.03.2019, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018” nuk janë miratuar nga Nëpunësi autorizues i MEPJ, në kundërshtim me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 9, Pika 4 dhe Neni 12, Pika 2.

5.3 Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 u konstatua se, formatet që shoqërojnë këtë raportim, si dhe normat e amortizimit të aplikuar në aktivet afatgjata materiale dhe pajisjet kompjuterike, nuk janë të përditësuara, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Pikat 25, 26, 27 dhe Pika 36.

5.1 Rekomandimi:

Nga MEPJ të merret në shqyrtim, nëpërmjet një analize kosto-përfitim, përfshirja në strukturën e përfaqësive diplomatike të një punonjësi me formim në shkencat ekonomike minimalisht të studimeve të nivelit të parë.

Deri në arritje e një konkluzioni në lidhje me të, në MEPJ të monitorohen shpenzimet e përfaqësive që në fazën e miratimit dhe deri në zbatimin e tyre, si dhe të punohet në drejtim të justifikimit të regjistrimeve kontabël me dokumentet bazë të kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi i sipërcituar **nuk është pranuar.**

5.2 Rekomandimi: MEPJ gjatë raportimit financiar duhet të reflektojë përgjegjësinë e nëpunësit të saj autorizues mbi kontabilitetin, nëpërmjet miratimit të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi është **pranuar** dhe konsiderohet **i zbatuar**

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese të viteve 2020, 2021 rezultojnë të jenë të nënshkruara nga ana e Nëpunësit zbatues dhe Nëpunësit autorizues.

5.3 Rekomandimi: MEPJ të marrë masat e nevojshme në reflektimin e ndryshimeve të formateve shoqëruese të pasqyrave financiare dhe normave të amortizimit, në funksion të ruajtjes së procedurave të unifikuar të hartimit dhe raportimit financiar.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi është **pranuar** dhe konsiderohet **i pazbatuar.**

Pasqyrat financiare hartohen sipas formatit të vjetër dhe nuk janë përshtatur me ndryshimet e reja.

6.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, për periudhën objekt auditimipërfaqësitë diplomatike kanë funksionuar pa struktura të miratuara, pasi nga strukturat përgjegjëse të MEPJ këto të fundit nuk janë hartuar dhe miratuar asnjëherë. Për pasojë, kanë munguar edhe përshkrime për pozicionet e punës, duke mbartur risqe që vendimmarrja në lidhje me emërimet të jetë subjektive, vecanërisht në kushtet kur nuk parashikohet strukturë fikse (me numër të caktuar punonjësish) referuar edhe natyrës specifike që çdo përfaqësi diplomatike ka.

Mungesa e akteve rregullative që rregullojnë sa më sipër, mbart risqe të krijimit të vakancave/mbingarkesës në numrin e stafit tek përfaqësitë diplomatike, e cila mund të krijojë efekte financiare dhe/ose mosrealizim të detyrave funksionale (psh mungesa e financierit në strukturat e përfaqësive diplomatike). Në të tilla kushte, emërimet për këto struktura rrezikojnë të ngelen në iniciativën subjektive të titullari të MEPJ dhe jo të kryhen sipas kriterëve që duhet të plotësojë punonjësit për secilin pozicion.

6.1 Rekomandimi: Titullari të marrë masa për miratimin e strukturave organike pas hartimit të tyre nga njësitë përgjegjëse, në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të marrëdhënieve diplomatike që secila përfaqësi ka, si dhe në përputhje me misionin e tyre. Njëkohësisht, në përputhje me strukturat, nevojitet të hartohen dhe miratohen përshkrimet e punës, të cilat duhet të përfshihen edhe në kontratat respektive të punës.

Brenda datës 30.04.2020

Përgjigja e institucionit.

*Ky rekomandim **është pranuar** nga subjekti.*

Neni 21/2. Struktura e misionit diplomatik dhe postit konsullor, miratohen me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme. Numri i personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor përcaktohet me marrëveshje me shtetin pritës. Strukturat e misioneve dhe posteve konsullore janë dinamike. Këto ndryshojnë në varësi të prioritetëve të politikës së jashtëm.

Jemi në komunikim me shtete pritëse për t'u akordësuar për ato vende ku ka patur ndryshim të numrit të personelit. Sapo kjo të ketë përfunduar, do miratohet nga titullari për t'u zbatuar. Sa i takon rekomandimit për kontratat e punës, sqarojmë se në misione Diplommatike dhe poste konsullore, me kontratë punojnë vetëm punonjësit e stafit tekniko-administrativ, mbështetës.

Koment i grupit të auditimit;

*Rekomandimi është **pranuar**dhe konsiderohet **i pazbatuar**.*

MEPJ nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për zbatueshmërinë e tij, e për rrjedhojë konsiderohet i pazbatuar si rekomandim.

7.Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se përgjatë periudhës objekt auditimi, nëMEPJ janë bërë 24 emërimet në përfaqësitë diplomatike sipas nenit 31/3 të ligjit nr.23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” ku parashikohet se: “*Ministri i Pjmund të emërojë në misione diplomatike dhe postet konsullore, në raste të veçanta ekspertë jashtë shërbimit të jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Këta punonjës gëzojnë statusin e diplomatit për aq kohë sa punojnë pranë misioneve diplomatike*”.

Nga auditimi rezultoi se, në 22 nga 24 raste emërimesh, nuk arsyetohet përse këto kanë qenë “rast i veçantë” dhe/ose llojin e njohurive dhe ekspertizës që zotërojnë personat e emëruar, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Për më tepër që në kushtet kur mungojnë përshkrimet e

punës, vendosja e kriterëve bëhet thuajse e pamundur. Nën të njëjtin arsyetim është bërë edhe emërimi i studentëve të ekselencës për pozicione në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit. Për sa kohë që vetëm në 2 nga 24 raste rezultoi se, emërimet janë bërë në përputhje me kriteret kumulative që parashikon ligji, do të thotë se neni 31/3 është kuptuar por nuk është zbatuar për të gjitha emërimet njëloj. Një tjetër aspekt i këtyre emërimeve është fakti se përcaktimi i gradës së emërimit bëhet nga Ministri pa asnjë kriter.

7.1 Rekomandimi: Titullari i MEPJ të marri masa që emërimet në shkelje të nenit 31/3 tërësisht, me qëllim vlerësimin dhe plotësimin e pozicioneve të kërkuara në përputhje me misionin dhe objektivat e përfaqësive respektive, si dhe sipas ekspertizës së nevojshme që kërkon pozicionin. Gjithashtu në kushtet kur “rastet e veçanta” janë kthyer në fenomen (22/24 raste) nevojitet që në çdo rast të konsideruar të tillë, të argumentohen elementët specifike që e bëjnë rastin “të veçantë”. Në përfundim të rivlerësimit, ato urdhra të emërimit që do të rezultojnë të paargumentuar sipas kriterëve ligjore, të shpallen si akte absolutisht të pavlefshëm.

Brenda 31.01.2020

Koment i grupit të auditimit:

*Rekomandimi është **pranuar** dhe konsiderohet **i pazbatuar**.*

MEPJ nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret dhe nuk ka vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion justifikues në lidhje me zbatimin e rekomandimit të sipërcituar si dhe në thyerje të afatit kohor të vendosur për zbatueshmërinë e tij, e gënjohet të pazbatuar si rekomandim.

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për 30 ambasadorë, edhe pse kapërfunduar afati 3 vjeçar i qëndrimit në detyrë, ata vazhdojnë të kryejnë funksionin e kreut të misionit diplomatik. Evidentohen raste të kapërcimit të këtij afati deri 9 vite, çka e bën shkeljen ligjore abuzive dhe për më tepër kur këta persona vijnë nga jashtë shërbimit pra nuk janë diplomat karriere, por persona të cilët janë emëruar në kuadër të nenit 31/3 të ligjit, i cili gjithashtu është shkelur pasi specifikisht parashikon se : “...3. Ministri i Punëve të Jashtme mund të emërojë në misionet diplomatike dhe postet konsullore, në raste të veçanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Këta punonjës gëzojnë statusin e diplomatit në misionet diplomatike për aq kohë sa punojnë pranë këtyre misionëve. ...”. Pra, edhe në këtë aspekt emërimi në bazë të këtij neni ka shkelur përcaktimet specifike si është “në raste të veçanta”, “ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit”. Pra, në kushtet kur 42% e totalit të ambasadorëve është emëruar në këtë mënyrë, rastet nuk mund të quhen “të veçanta”. Gjithashtu, ushtrimi i funksionit të ambasadorit nuk parashikon ligjërisht specifika që nuk i kanë diplomatët e karrierës pjesë e MEPJ, prandaj edhe lind nevoja të plotësohet nga personat e përzgjedhur si “ekspertë të jashtëm”, për të cilët në rastet e verifikuara nga grupi i auditimit kanë munguar evidenca që të pohojnë plotësimin e këtij kriteri.

8.1 Rekomandimi: Nga sa më sipër rekomandohet se, për të gjithë ambasadorët që u ka mbaruar afati i qëndrimit në detyrë, të merren masa që të kthehen në mënyrë që përzgjedhja e tyre të bëhet në përputhje me kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit:

*Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe është **i pazbatuar**.*

MEPJ nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret dhe nuk ka vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion justifikues në lidhje me zbatimin e rekomandimit të sipërcituar si dhe në thyerje të afatit kohor të vendosur për zbatueshmërinë e tij, e gjejkojmë të pazbatuar si rekomandim.

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave tenderuese të zhvilluara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e autoritetit kontraktor, për vitet buxhetore 2017, 2018 dhe 2019 u konstatua se:

- Në dosjet e prokurimit në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit citohet se fondi limit përlllogaritjet nga mesatarja e tre ofertave por në dosje nuk ka asnjë ofertë ekonomike e cila të përmbajë çmimet përkatëse sipas specifikimeve të përcaktuara dhe periudhës që kryhet prokurimi në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 59 “Përlllogaritja e Vlerës Limit të Kontratës”.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se mungon urdhri për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave dhe relacioni për te verifikuar nëse specifikat e mallit/shërbimit të marrë në dorëzim janë apo janë përputhje me kriteret e parashikuara, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin eAktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50. Pra në përfundim konkludojmë se, plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, dhe se dosjet nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

9.1 Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të marrë masa:

-Të kryhet inventarizimi, arkivimi dhe të plotësohen dosjet e prokurimeve nga Njësia e Prokurimit për çdo procedurë prokurimi.

Menjëherë dhe në vazhdim

Koment i grupit të auditimit;

Rekomandimi **është pranuar** dhe konsiderohet **i zbatuar**.

9.2 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, në çdo rast duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e fondit limit.

Menjëherë dhe në vazhdim

Përgjigja e institucionit.

Ky rekomandim **është pranuar** nga subjekti.

Koment i grupit të auditimit;

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

9.3 Rekomandimi:Të merren masa, që për çdo marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim, i cili duhet të përpilojë procesverbalin nëse mallrat/shërbimet janë në përputhje me të dhënat e verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës, pastaj të bëhet fletë-hyrja në magazinë dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vazhdim

Përgjigja e institucionit.

Ky rekomandim **është pranuar** nga subjekti.

Koment i grupit të auditimit;

Rekomandimi konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**.

C.2 MASA TË PAZBATUARA, NGA AUDITIMI I MËPARSHËM I KLSH-së DËRGUAR ME SHKRESËN NR. 509/13, DATË 06.10.2017

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 27 masa organizative, të cilat: 18 janë zbatuar plotësisht 8 masa nuk janë pranuar dhe zbatuar, dhe është në process zbatimi 1 masë.

b. Masa zhvendim të demit janë lënë 5, ndër të cilat 3 nuk janë pranuar dhe 1 është zbatuar dhe 1 është në proces zbatimi.

c. Mbështetur në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë rekomanduar: 1 masë disiplinore nga “Vërejtje” deri “largim nga shërbimi civil” për tre punonjës e cila nuk është pranuar nga subjekti .

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme **të marrë masa të menjëhershme** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën e KLSH-së nr. 509/13, datë 06.10.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, në proces zbatimi ose të papranuara, *veçanërisht për më poshtë vijon:*

1. Gjetje nga auditimi: Detyrimi i (llog. 468) “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2016 rezulton në vlerën 489,528 lekë i cili paraqet detyrimet e subjekteve private dhe punonjësve ndaj institucionit. Pra i zbrërthyer në mënyrë analitike përbëhet nga detyrimet e 10 subjekteve të cilat nuk kanë derdhur asnjë vlerë nga detyrimi për një periudhë 5 vjeçare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/4, faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017).*

Rikërkojmë

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i debitorëve, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative, deri në arkëtimin e vlerës.

Koment i grupit të auditimit;

Rekomandimi konsiderohet i **pranuar** por i **pazbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin i zbatimit të procedurave të blerjes së automjeteve për Përfaqësitë Shqiptare jashtë shtetit u konstatua se:

- Me Urdhër shpenzimin nr. 139, dt. 21.10.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 21,158,635 lekë. Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 150,000 EURO. Procedura e blerjes së këtyre automjeteve nuk është kryer e përqendruar nga Ministria e Punëve Brendshme në kundërshtim me VKM nr. 53, dt.21.01.2009 “Për ngarkimin e ministrisë së brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë për disa mallra e shërbime” i ndryshuar (shfuqizuar me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015) pika 1.

- Me Urdhër shpenzimin nr. 180, dt. 31.12.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 30,000,000 lekë. Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 211,348 EURO, nga ku rezultoi se: likuidimi i vlerës së blerjes së automjeteve është kryer nga përfaqësitë nga llogaria e tyre e çelur sipas transfertave nga llog. 600, 601, 602, 605 dhe jo nga llog 231 për të cilën gjatë vitit 2015 nuk ka çelje përkatësish për përfaqësitë që kanë kryer likuidimin e vlerave për automjetet e blera si: Stokholm, Varshavë, Bari, Pragë, Misioni i BE, Bukuresht; Nga verifikimi i inventarëve dhe kontratave të dërguara nga përfaqësitë rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të tjera rezultojnë automjete e blera për vitin 2015. *(Mëhollësisht trajtuar në pikën III/5, faqe 4753 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017).*

Rikërkojmë:

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ambasada Paris të merren masat për arkëtimin e vlerës prej 781,64 Euro si diferencë midis fondit limit të miratuar, Oferta fituese 31,548 Euro dhe vlerës së blerjes sipas inventarit prej 32,329.64 Euro.

Të merren masat për plotësimin e dosjeve pranë Ministrisë me dokumentacionin përkatës për blerjet e automjeteve nga përfaqësitë jashtë shtetit për vlerat sipas Urdhër Shpenzimin nr. 139, dt. 21.10.2014.

Nga Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financë të merren masat që likuidimet nga Përfaqësitë jashtë shtetit për shpenzimet e tyre të kryhen nga llogaritë përkatëse të çelura sipas transfertave dhe natyrës së shpenzimet buxhetore.

Me miratimin e memorandumit për kryerjen nga MEPJ e procedurave të blerjes së automjeteve janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve sipas VKM nr. 28, dt. 14.01.2015.

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Përfaqësitë Diplommatike të merren masat për të përcaktuar rregullat që do të ndiqen nga përfaqësitë për procedurat e blerjes së automjeteve. Sipas përcaktimit të VKM nr. 28, dt. 14.01.2015, i ndryshuar, nën pika 1.3

“Përfundimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjetesh ti realizojë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme”.

Përgjigja e institucionit.

Ky rekomandim është pranuar nga subjekti.

Lidhur me konstatimin e sipërcituar, ju informojmë se vlera e blerjes së makinës (shpenzimi kapital) është 31,548 euro. Në kushtet kur makina do të përdorej si makinë e parë protokollare ishte e domosdoshme që të bëhej një ndërhyrje në pjesën ballore të saj për të vendosur pajisjen për mbajtjen e shtizës së flamurit. Shërbimi i montimit të kësaj pajisje kushtoi 781.64 euro. Në momentin e raportimit të blerjes këtë shpenzim, financierja e ambasadës e raportoi si shpenzim kapital (automjete). Në zbatim të rekomandimit të lënë kemi marr masa duke kryer veprimet rregulluese në fund të periudhës, konkretisht : Kredituam për shumën 781.64 euro llogarinë shpenzime Kapitale (Automjete) dhe debituam për të njëjtën vlerë llogarinë “Shpenzime transporti”.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm, madje duke aktivizuar me pagesë edhe persona të tretë nga jashtë AK. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme, duke përfshirë edhe tenderat e zhvilluar për blerje e shërbime të vogla si dhe ato të karakterit sekret. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/6, faqe 58-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017*).

Rikërkojmë:

Ministri, në varësi të burimeve njerëzore, që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “Njësia e Prokurimit” të VKM nr. 914, datë 29/12/2014, me qëllim edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **pazbatuar**.

MEPJ nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret dhe nuk ka vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion justifikues në lidhje me zbatimin e rekomandimit të sipërcituar si dhe në thyerje të afatit kohor të vendosur për zbatueshmërinë e tij, e gjetjeve të pazbatuar si rekomandim.

4. Gjetje nga auditimi: Grupet e auditimit të brendshëm për rastet, kur kanë konstatuar mbi shpenzime të pa argumentuara dhe kanë fiksuar vlerat përkatëse si dëme ekonomike për buxhetin e shtetit, për punonjësit që nuk janë më në marrëdhënie pune me subjektin e audituar (punonjësit e ambasadave dhe konsullatave kanë lëvizje të shpeshta nga një shtet në shtetin tjetër) nuk njoftojnë më për arkëtimin e dëmit ekonomik të konstatuar, por e kanë bërë praktikë pune, që ia dërgojnë Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë Ekonomike pranë MPJ. Për të tilla detyrime nuk janë bërë programe verifikimi siç programohen zbatimet e rekomandimeve të tjera.

Rikërkojmë:

Drejtoria e Auditit të Brendshëm të bëjë verifikimet e nevojshme herë pas here duke i programuar edhe në planet vjetore të auditimit dhe të nxjerrë përgjegjësinë për personat përkatës të dy drejtorive në rast se nuk është bërë ndonjë përpjekje për arkëtimin e dëmeve ekonomike.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm, të veprimtarisë financiare së përhershme të RSH-së në NATO, është konstatuar marrja me qira e tre apartamenteve, të cilat nuk janë më në përdorim nga përfaqësia, por ka mbetur e bllokuar shuma e vlerës së ngurtësuar prej 5,640 euro. Nga Përfaqësia e RSH në NATO dhe Misioni i RSH pranë BE nuk u janë vënë në

dispozicion dokumentacioni i plotë për mënyrën e zgjidhjes së këtyre kontratave dhe detyrimet, që kanë mbetur pa shlyer apo arsyeën e bllokimit të shumave të ngurtësuar. Nuk ka rezultuar që të ketë një korrespondencë zyrtare midis përfaqësuesit të RSH-së në NATO dhe MPJ për këtë çështje. Për këtë nga grupit të auditimit të brendshëm është lënë Rekomandoj: “*që përfaqësia e përhershme e RSH në NATO në bashkëpunim me ambasadën e RSH në Mbretërinë e Belgjikës dhe misioni i përhershëm i RSH pranë Bashkimit Evropian të ngrenë një grup pune për sqarimin e problematikave të kësaj çështje duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm. Ky grup duhet të përgatisë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Programimit Buxhetor dhe Financës dhe Drejtorisë së Auditimit në MPJ informacion të hollësishëm dhe masat e nevojshme që do të merren për zgjidhjen e kësaj çështje*”. Në fakt audituesit duhej ta kishin audituar në vend këtë çështje duke i propozuar titullarit të ministrisë për një shtyrje afati verifikimi dhe kjo çështje duhej të ishte mbyllur përfundimisht rezultatit konkretë.

Rikërkojmë:

Drejtorja e Auditimit të iniciojë pranë ministrit një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve deri në saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së ngurtësuar, duke vënien para përgjegjësisë punonjësit përkatës

Përgjigja e institucionit.

*Ky rekomandim **është pranuar** nga subjekti.*

Rekomandimi është marrë në konsideratë gjatë auditimit të Misionit NATO dhe Misionit tonë në Bruksel në vitin 2019. Për shkak se Grupi i auditimit e ka fushën e veprimit ligjor vetëm brenda përfaqësisë tonë në NATO duke e bërë të pamundur përfaqësimin me persona të tretë për marrjen dhe dhënien e informacionit mbi këtë çështje është lënë detyrë për përfaqësitë tona në Bruksel për ndjekjen e saj në Raportin Përfundimtar të Auditimit nr.3251, datë 4.03.2019. Në zbatim të rekomandimit të lënë nga auditimi, Misioni i RSH në Bruksel dhe Misioni i RSH në NATO kanë ngritur një grup të përbashkët pune të cilët kanë shqyrtuar dokumentacionin që ndodhej në përfaqësi nga ku ka rezultuar se nuk kanë gjetur asnjë të dhënë. Po kështu, është marrë takim edhe me BNP Paris Bank, me qëllim marrjen e ndonjë të dhëne në lidhje me adresat ose pronarët e apartamenteve, por rezultoi që banka nuk kishte të dhëna. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit si dhe të faktit që shtetasit që kanë banuar në këto apartamente nuk kanë qenë punonjës të MEPJ, por të MM dhe apartamentet janë lënë rreth viteve 2000, gjykojmë që **ky rekomandim është i pazbatueshëm**. Mungesa e dokumentacionit dhe gjurmës së auditimit për këtë problematikë e bën të pamundur adresimin e përgjegjësive për persona konkretë, ashtu sic rekomandohet nga KLSH.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi *konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.*

6.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm të MPJ, të veprimtarisë financiare së Misionit të RSH pranë OKB-së dhe aktivitetit të Konsullatës së RSH në Nju-Jork (N.Y-e mbyllur), ka konstatuar si gjetje pagim penaliteti për objekt qiraje, të vlerës prej 12,000

USD, të një godine, që kishte administruar konsullata. Kontrata e lidhur që në fillim vitit 2006 nga nëpunës, i cili është në marrëdhënie pune me MPJ, është lidhur me gabime e risk të lartë, si pa shënuar afatin përkatës, dhe më vonë me një kontratë e rilidhur në Mars 2013, nuk është bërë rishikimi apo ndryshimi përkatës i kushteve të kontratës. Pra vlera e ngurtësuar është dëm ekonomik për shtetin pasi apartamenti nuk përdoret më dhe misioni është mbyllur.

Audituesit e brendshëm, këtë vlerë duhej ta kishte konsideruar dëm ekonomik, duke ja ngarkuar përgjegjësinë lidhësit të parë të kontratës si dhe nëpunësit që ka rilidhur kontratën pa asnjë lloj ndryshimi.

Rekomandoj i lënë nga DAB, që kontratat për të ardhmen duhet të lidhen pasi të jetë marrë miratimi juridik më parë nga MPJ, nuk i shërben efektivitetit ekonomik të vlerave të përdorura. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/7, faqe 85-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017).

Rikërkojmë:

Drejtoria e Auditimit të iniciojë ministrin për të kryer një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve, vënien para përgjegjësisë të personave përgjegjës, deri në arkëtimin e vlerës si pagim penaliteti, nqse nuk ka argumentim dokumentar.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi **nuk është pranuar** prej institucionit.

7.Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm, për veprimtarisëfinanciare të Ambasadës së RSH-së, në Ankara-Turqi, janë konstatuar mjaft mangësi e shkelje në kuadrin e zbatimit të projektit të Qendrës Kulturore Shqiptare (QKSH) në Ankara, në zbatimin e ligjin nr. 7982, datë 21/12/1994 “Për sponsorizimet”. MPJ për këtë auditim ka bashkëpunuar me APP-në si dhe Inspektimin Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, ku kjo e fundit i ka kthyer përgjigje që kemi të bëjmë me dëme ekonomik në vlerën prej 4,210.34 EURO dhe 3,018.6 lira turke, nga financimi i bërë nga QKSHja në vlerën prej 20,125 EURO për 3 vite, sipas nenit 5 të memorandumit. Në materialet e auditimit cilësohen edhe shpenzime të tjera të kryer nga ky projekt për shpërblime punonjësish të ambasadës pa marrë më parë miratimin e MPJ. (Më hollësishttrajtuar në pikën III/7, faqe 85-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017).

Rikërkojmë:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, materialin e audituar për veprimtarinë financiare të Ambasadës së RSH-së, në Ankara-Turqi, në kuadrin e zbatimit të projektit të Qendrës Kulturore Shqiptare në Ankara, ta dërgojë pranë organeve të prokurorisë për vlerësim të elementeve penale.

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi **konsideroheti pranuar** dhe **i zbatuar**.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH meshkresën nr. 985/7, dt. 04.01.2013 rezultoi se në zbatim të Rekomandojt nr. 9 “Të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm por që nga verifikimi i tyre rezultuan të pa zbatuara, apo në proces zbatimi, si dhe për të gjitha rekomandimet, për të cilat janë nxjerrë

urdhurat e zhdëmtimit në datë 24.12.2012, të kryhet kontabilizimi dhe të fillojë arkëtimi i detyrimeve, deri në ndjekjen, në rrugë ligjore të arkëtimit të dëmeve ekonomike, sipas trajtimit të bërë në faqet 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit” MPJ për punonjësit të cilat duhet të arkëtojnë shumat e lëna në ngarkim është dërguar shkresa pranë përfaqësive përkatëse.

Vlera e mësipërme nuk është kontabilizuar dhe nga 200 punonjës në vlerën 40,400 EURO është arkëtuar vlera 27,143 EURO për 107 punonjës. Mbetet pa u arkëtuar vlera 13,257 EURO. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/1, faqe 9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017).

Rikërkojmë:

Nga MEPJ, Përfaqësitë Jashtë Shtetit dhe Sektori i Financës të merren masa të menjëhershme që vlera e mbetura pa arkëtuar prej 13,257 EURO të kontabilizohet dhe të fillojë procedura e arkëtimit të detyrimit.

Përgjigja e institucionit.

Ky rekomandim **është pranuar** por Sekretari i Përgjithshëm nuk ka nxjerr urdhra ekzekutimi për arkëtimin e shumës 13,257 euro.

Koment i grupit të auditimit

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

9.Gjetje nga auditimi: Me anë të Memorandumit Nr. 454, datë 30.01.2014 të cilit i janë bashkëlidhur vendimet e ish Sekretarit të Përgjithshëm, Q.Q, janë kaluar në listë pritje punonjësit të cilëve u është prekur vendi i punës si pasojë e ristrukturimit të institucionit në zbatim të urdhrat të Kryeministrit nr. 227, datë 02.12.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MPJ”.

Nga auditimi i listë pagesave dhe nëpunësve të cilët trajtohen me statusin e nëpunësit civil u konstatua se për periudhën 01.01.2014 deri në 24.02.2015 kanë përfituar nga lista e pritjes 44 punonjës dhe ish punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas listë pagesave të deklaruara në shumën 22,419,502 lekë bruto, dhe neto në vlerën 17,851,033 lekë.

Në nenin 50 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 për sistemimin e punonjësve në vende vakante është përcaktuar se ... Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje: a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkruar apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar; ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil..” VKM nr. 171, datë 26.3.2014, Kreu III.

Në Ligjin 152/2013, datë 30.5.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, konstatohet se termi “Listë pritje”, nuk ekziston. Nën këtë arsyetim pagesat e kryera nga MPJ për punonjësit në “Listë pritje” është në kundërshtim me ligjin e mësipërm dhe vlera prej 15,833,657 lekë (Mars 2014 deri mars 2015) përbën dëm ekonomik për Institucionin dhe duhet të arkëtohet. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/3, faqe 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017)

Rikërkojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 15,833,657 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, të përfituar padrejtësisht për shkak të trajtimit të tyre si punonjës në “*listëpritje*” nga 44 punonjës dhe ish punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas listëpagesave të deklaruara (*bashkëlidhur*) për vitin 2014 dhe 2015 në kundërshtim me Ligjin 152/2013, datë 30.5.2013 “*Për statusin e nëpunësit civil*”.

Koment i grupit të auditimit;

*Rekomandimi **nuk është pranuar.***

10.Gjetje nga auditimi: Sipas Urdhrit të Ministrit të punëve të Jashtme nr. 22, dt.25.01.2016, anëtarët e Komisionit të posaçëm të shpronësimit të një pjese të pasurisë “*Oficina e Automjeteve Tiranë*” kanë përfituar në mënyrë të pa drejtë vlerën prej 800,000 lekë, vlerë e destinuar për shpenzimet procedurale të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë shpenzimet e procedurës së shpronësimit në kundërshtim me VKM nr. 1044, dt. 16.12.2015 “*Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme*” pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës “*Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodohen përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës Tiranë*” nënshkruar më 10.04.1960”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/3, faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017)

Rikërkojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 800,000 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, të përfituar padrejtësisht si shpërblim në kundërshtim me VKM nr. 1044, dt.16.12.2015 nga anëtarët e komisionit.

Koment i grupit të auditimit;

*Rekomandimi **nuk është pranuar.***

D. MASA PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: *Nga fondet e programit 01120*, nëpërmjet bankës C. janë kryer transfertat për llogari të përfaqësive diplomatike, në valutën EUR dhe USD, respektivisht:

- **për vitin 2018**, në shumën totale 11,353,290 EUR dhe 3,133,543 USD, ku nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, me kursin e referencës së BSH rezultoi se, nëse MEPJ do të kishte kërkuar kurs preferencial, do të kishte kursyer mesatarisht 69,528 USD dhe 153,374 EUR, ndërsa **për vitin 2019** (vetëm për periudhën objekt auditimi), janë transferuar 1,917,039 USD⁴, dhe rreth 7,707,567 EURO⁵, ku nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, me kursin e referencës së BSH rezultoi se nëse MEPJ do të kishte kërkuar kurs preferencial, do të kishte kursyer mesatarisht 26,690 USD dhe 79,228 EUR.

Me qëllim vlerësimin e menaxhimit të fondeve buxhetore, veçanërisht ato që i takojnë programit 01120, të cilat transferohen në valuta të huaja (respektivisht EUR dhe USD) grupi I auditimit ka përdorur kursin zyrtar të publikuar nga Banka e Shqipërisë⁶, i cili është një nivel referencë (i vetëm), dhe mund të përdoret nga të interesuarit, ndër të tjera për qëllime vlerësuese dhe krahasuese.

1.1 Rekomandimi:

Për përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, në asnjë rast në vazhdim, transfertat bankare për llogari të buxheteve të përfaqësive diplomatike të RSH, nuk duhet të ekzekutohen pa marrjen dhe dokumentimin e një kursi preferencial, nga banka ku aktualisht depozitohen dhe transferohen fondet. Nëse ky rekomandim nuk do të zbatohet nga MEPJ, në rast së konsatohet i njëjti fenomen në të ardhmen, vlerat e gjeneruara nga ky fenomen do të konsiderohen dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër, “Nëpunësi Autorizues”, si përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset, të marr masa për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit sa i takon procesit të konvertimit të monedhës për llogari të buxheteve të përfaqësive diplomatike, duke parashikuar rrjedhën e dokumentuar të kësaj kategorie të transaksioneve financiare, nga fillimi deri në përfundim të tyre, me synimin që të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet **pranuar** dhe **i zbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Si pasojë e bashkimit të dy ish-ministrive dhe krijimit të MEPJ, 17 punonjës kanë ngelur jashtë strukturës së re, dhe si pasojë e kësaj është kryer edhe shpërblimi i tyre, referuar detyrimit ligjor që institucioni ka karshi këtyre punonjësve në bazë të nenit 50, pika 7 e ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” se “...nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë”. Nga buxheti i MEPJjanë shpenzuar **9,979,629 lekë**, në një kohë që institucioni ka mbartur vazhdimisht pozicione vakante, duke cënuar parimet e përdorimit të fondeve publike me ***ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet***.

2.1 Rekomandimi: MEPJ, të marrë masat e nevojshme administrative në mënyrë që në të ardhmen të mos kryhen largime të padrejta nga puna, të cilat shkaktojnë kosto shtesë të panevojshme në buxhetin e shtetit, rrjedhojë e keqmenaxhimit.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Ky rekomandim është pranuar por nuk mund të gjykojmë mbi zbatueshmërinë e tij, pasi kemi një variabël të pamatshëm dhe të pavlerësueshëm për shkak të intervalit kohor në vijimësi dhe subjektivitetit të argumentimit nga ana e subjektit.

3.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019, janë liruar nga detyra 15 punonjës, të cilët me Vendim Gjykatë të formës së prerë kanë fituar të drejtën për kthim në punë dhe/ose dëmshpërblim në lekë. Nga këta, MEPJ ka zgjedhur që vetëm 7 prej tyre t'i kthejë në punë, gjithashtu duke i dëmshpërblyer. Në këto kushte shuma e likuiduar prej 8,089,920 lekë, në bazë të vendimeve të gjykatës, deri më 31.08.019, përbën menaxhim joefektiv të fondeve buxhetore, pasi janë shkelur parimet e eficiencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit.

3.2 Rekomandimi: MEPJ, të marrë masat e nevojshme që në asnjë rast, të mos kryej lirimetë padrejta nga detyra, në mënyrë që të mos shkaktohen efekte financiare për buxhetin e shtetit. Gjithashtu të merren masa të menjëhershme për kthimin në detyrë, për ata punonjës që kanë fituar këtë të drejtë në bazë të një vendimi gjykate të formës së prerë, në të kundërt çdo pagesë dëmshpërblimi rrjedhë e zbatimit të vendimit të Gjykatës do të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Ky rekomandim është pranuar por nuk mund të gjykojmë mbi zbatueshmërinë e tij, pasi kemi një variabël të pamatshëm dhe të pavlerësueshëm për shkak të intervalit kohor në vijimësi dhe subjektivitetit të argumentimit nga ana e subjektit.

E. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019, janë liruar nga detyra 15 punonjës, të cilët me Vendim Gjykate, të formës së prerë kanë fituar të drejtën për kthim në punë dhe/ose dëmshpërblim në lekë. Nga këta, MEPJ ka zgjedhur që 8 prej tyre të mos i kthejë në punë, duke i dëmshpërblyer në shumën 8,780,443 lekë, deri më 31.08.019, edhe pse në mënyrë të vazhdueshme ka mbartur vende vakante në strukturë.

1.1 Rekomandim: NJAB të auditojë dhe verifikojë 8 rastet e konstatuara të punonjësve, të cilët nuk janë kthyer në punë me qëllim vlerësimin e shumave të likuiduara nga MEPJ për secilin prej tyre, pas datës së Vendimit të formës së prerë të Gjykatës. Në përfundim, çdo vlerë e konstatuar pas kësaj date, do të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit ku përgjegjësi për sa më sipër mbajnë Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues. Në varësi të rezultave, për vlerat e konstatuara të merren masa për kontabilizimin dhe kërkimin në rrugë ligjore të arkëtimit të tyre, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit:

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

F. MBI ANKESËN NR. 887, DATE 04.11.2019, TË ISH-PUNONJËSIT TË MEPJ

Sa i takon ankesës së z.M.M, e protokolluar me tonën, me nr. 887, datë 04.11.2019, i cili pretendon mungesën e transparencës përgjatë procesit të largimit nga puna, si pasojë e mosrinovimit të certifikatës së sigurisë, rezultoi se:

Rezultoi se, në 4 Tetor 2019, ish-punonjësit të MEPJ-së, i është komunikuar urdhri i përjashtimit nga shërbimi i jashtëm, me referencë ligjore “mospajisjen me certifikatë sigurie”, ndërkohë që për këtë certifikatë MEPJ ka aplikuar pranë DSIK në shkurt të vitit 2018, ndërsa certifikata e tij e fundit ka pasur vlefshmëri deri në datën 23.09.2017. Nga verifikimi, grupi i auditimit konstaton se, ende ngelet e paqartë:

- nëse ky punonjës, nga data 23.09.2017 deri në shkurt të vitit 2018 ka qenë apo nuk ka qenë i pajisur me çertifikatë sigurie gjatë ushtrimit të veprimtarisë diplomatike; si dhe
- nëse strukturat përgjegjëse në MEPJ kanë ushtruar të drejtën që i njeh neni 27, paragrafi i II, i VKM Nr. 188, datë 04.03.2015 “*Refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP-së*” duke (mos)kërkuar me shkrim rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK-ja.

Për sa më sipër, grupi i auditimit edhe pse kërkoi në mënyrë zyrtare, nuk mori asnjë informacion në lidhje me paqartësitë e mësipërme, me arsyetimin se: “*kërkesa për informacion bie ndesh me nenin Nr. 162 të Kushtetutës, ku është përcaktuar kompetenca e KLSH-së, e cila kjo e fundit ka si objekt kontrollin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare*”.

KLSH konstaton se, mos dhënia e informacionit nga ana e MEPJ-së është bërë në kundërshtim me kërkesat që burojnë nga Ligji Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit”, kreu IV, Nenin 26, “Aksesi në dokumentet zyrtare”, ku parashikohet se: “*Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore*”.

Për sa më sipër rekomandojmë që MEPJ të marr masa të menjëhershme të analizojë, dhe shqyrtojë me kujdes rastin me qëllim informimin e ish punonjësit mbi arsyet ligjore të largimit të tij nga puna. Gjithashtu inkurajojmë z. M.M që, në rast të vijimësisë së mungesës së transparencës nga MEPJ, sa i takon procedurave të ndjekura për largimin e tij nga puna, t’i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e kësaj situate.

Koment i grupit të auditimit:

*Rekomandimi konsiderohet **pranuar** dhe **i zbatuar**.*

G. MASA DISIPLINORE E ADMINSTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, nenin 59 “*Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Sekretarin të Përgjithshëm të MEPJ-së që:

Në varësi të analizës së përgjegjëse, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “*Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*” deri në “*Largim nga puna*”, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, veçanërisht për drejtuesit që nuk kanë rakorduar dhe treguar vëmendjen e duhur, sa i takon:

-Përgatitjes së Pasqyrave Financiare të MEPJ-së për vitin 2017, pasi rezultoi se nuk është bërë reflektimi i plotë i aktivitetit të ish Ministrisë së Integritimit Evropian, në mënyrë që pas bashkimit/konsolidimit këto pasqyra të mbulojnë të gjithë aspektet e funksionimit të të dy ministrive, në respekt të VKM nr. 500, datë 13.09.2017 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së MEPJ*”;

-Mos marrjes së masave të nevojshme për marrjen në ngarkim të të gjithë elementëve pasurorë dhe jo pasurorë të aparatit të ish MIE-së si dhe mungesën e miratimit të urdhërit për mbylljen e

pasqyrave financiare të vitit 2017 të ish MIE-s, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së MEPJ”;

-Hartimit dhe raportimit financiar të përfaqësive diplomatike, pasi rezultoi se përfaqësitë diplomatike nuk hartojnë pasqyra financiare të veçanta; Largimeve të padrejta të punonjësve nga puna veçanërisht në kushtet e mungesës së transparencës së procedurave të ndjekura;

-Mos ekzekutimit të Vendimeve të formës së prerë të Gjykatës, për kthimin në detyrë të punonjësve të larguar;

-Mungesës së strukturave të miratuara për përfaqësitë diplomatike dhe si pasojë mungesës së përshkrimeve për pozicionet e punës, duke mbartur risqe që vendimmarrja në lidhje me emërimet të jetë subjektive, veçanërisht në kushtet kur nuk parashikohen struktura fikse (pra me numër të caktuar punonjësish), kjo referuar edhe natyrës specifike që çdo përfaqësi diplomatike ka.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, fillimin e procedurave për për dhënien e masës disiplinore “Largim nga puna”, për nëpunësit:

-Znj. D.Ç, me detyrë ish Sekretare e Përgjithshme në ish Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE) dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si person përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe kontabilitetin dhe raportimin financiar, pasi nuk ka bërë dorëzimin e detyrës, në kundërshtim me VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, kreu III, neni 27, 28, 29 dhe 30 i tij si dhe udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke ndikuar në cilësinë e procesit të konsolidimit të pasqyrave financiare të të dy ministrive. Në këto kushte, pasqyrat financiare të ish MIE-s nuk janë dorëzuar dhe si pasojë nuk është bërë reflektimi i plotë i aktivitetit të ish Ministrisë së Integritimit Evropian, në mënyrë që pas bashkimit/konsolidimit këto pasqyra të mbulojnë të gjithë aspektet e funksionimit të të dy ministrive.

-Z. G.B me detyrë ish Sekretar i Përgjithshëm i MEPJ-së dhe në cilësinë e ish Nëpunësit Autorizues të MEPJ-së (nga data 02.08.2016 deri më 15.07.2019), pasi si përgjegjës për planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së institucionit, nuk ka marrë masat e nevojshme për marrjen në ngarkim të të gjithë elementëve pasurorë dhe jo pasurorë të aparatit të ish MIE-së, si dhe nuk ka nxjerrë asnjë urdhër për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2017 të ish MIE-s.

Si pasojë Pasqyrat Financiare të MEPJ-së për vitin 2017 nuk paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen kontabël të MEPJ-së, pasi nuk është bërë reflektimi i plotë i aktivitetit të ish Ministrisë së Integritimit Evropian, në mënyrë që pas bashkimit/konsolidimit këto pasqyra të mbulojnë të gjithë aspektet e funksionimit të të dy ministrive, sa më sipër në kundërshtim VKM nr. 500, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së MEPJ”, i cili ka shfuqizuar VKM nr. 941, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Jashtme", dhe nr. 946, datë 9.10.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Integritimit Evropian".

Koment i grupit të auditimit;

Rekomandim konsiderohet i pazbatuar

G.1 MASA DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish nëpunësin e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore pasi shkeljet e konstatuara, pavarësisht se konstatimet ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen, në kushtet kur personi i poshtëpërmendur nuk është më në marrëdhënie pune me MEPJ-në.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara, masa disiplinore për këtë punonjës do të ishte “Largim ngapuna”, konkretisht për:

-Znj. B.P, me detyrë dhe në cilësinë e ish Nëpunësit Zbatues të ish MIE-se, si person përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe kontabilitetin dhe raportimin financiar, pasi nuk ka bërë dorëzimin e detyrës, në kundërshtim me VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, kreu III, neni 27, 28, 29 dhe 30 i tij si dhe udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke ndikuar në cilësinë e procesit të konsolidimit të pasqyrave financiare të të dy ministrive. Znj.P. në bazë të Vendimit të Komisionit të Ristrukturimit nr. 503, më datë 04.12.2017, rezultoi e dëmshpërblyer për largimin nga shërbimi civil.

Koment i grupit të auditimit:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 1, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni datë 14.04.2023, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit 1:

*Lidhur me gjetjen mbi auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm, të veprimtarisë financiare së përhershme të RSH-së në NATO, është konstatuar marrja me qira e tre apartamenteve, të cilat nuk janë më në përdorim nga përfaqësia, por ka mbetur e bllokuar shuma e vlerës së ngurtësuar prej 5,640 euro. Nga Përfaqësia e RSH-së në NATO dhe Misioni i RSH-së pranë BE nuk u janë vënë në dispozicion dokumentacioni i plotë për mënyrën e zgjidhjes së këtyre kontratave dhe detyrimet, që kanë mbetur pa shlyer apo arsyen e bllokimit të shumave të ngurtësuar. Nuk ka rezultuar që të ketë një korrespondencë zyrtare midis përfaqësisë së RSH-së në NATO dhe MPJ për këtë çështje. Për këtë nga grupit të auditimit të brendshëm është lënë Rekomandoj: "që përfaqësia e përhershme e RSH në NATO në bashkëpunim me ambasadën e RSH në Mbretërinë e Belgjikës dhe misioni i përhershëm i RSH pranë Bashkimit Evropian të ngrenë një grup pune për sqarimin e problematikave të kësaj çështje duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm. Ky grup duhet të përgatisë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Programimit Buxhetor dhe Financës dhe Drejtorisë së Auditimit në MPJ informacion të hollësishëm dhe masat e nevojshme që do të merren për zgjidhjen e kësaj çështje". Në fakt audituesit duhej ta kishin audituar në vend këtë çështje duke i propozuar titullarit të ministrisë për një shtyrje afati verifikimi dhe kjo çështje duhej të ishte mbyllur përfundimisht rezultatit konkret. **Rikërkojmë:** Drejtoria e Auditimit të iniciojë pranë ministrit një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve deri në saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së ngurtësuar, duke vënë para përgjegjësisë punonjësit përkatës.*

Rekomandimi është marrë në konsideratë gjatë auditimit të Misionit NATO dhe Misionit tonë në Bruksel në vitin 2019.

Si dhe kemi sqaruar në auditimin e mëparshëm të KLSH, për shkak se Grupi i auditimit e ka fushën e veprimit ligjor vetëm brenda përfaqësisë tonë në NATO dhe Misionit tonë pranë BE, duke e bërë të pamundur përfaqësimin me persona të tretë në Belgjikë për marrjen dhe dhënien e informacionit mbi këtë çështje është lënë detyrë për përfaqësitë tona në Bruksel për ndjekjen e saj në Raportin Përfundimtar të Auditimit nr.3251, datë 4.03.2019. Në zbatim të rekomandimit

të lënë nga auditi, Misioni i RSH në Bruksel dhe Misioni i RSH në NATO kanë ngritur një grup të përbashkët pune të cilët kanë shqyrtuar dokumentacionin që ndodhej në përfaqësi nga ku ka rezultuar se, nuk është gjetur asnjë e dhënë. Po kështu nga ky grup, është marrë takim edhe me BNP Paris Bank, me qëllim marrjen e ndonjë të dhëne në lidhje me adresat ose pronarët e apartamenteve, por rezultoi që banka nuk kishte të dhëna. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit si dhe të faktit që shtetasit që kanë banuar në këto apartamente nuk kanë qenë punonjës të MEPJ, por të MM dhe apartamentet janë lënë rreth viteve 2000 pra 23 vjet më parë, **rikonfirmojmë dhe dalim në konkluzion që ky rekomandim është i pazbatueshëm.** Mungesa e dokumentacionit dhe gjurmës së auditimit e cila është konfirmuar me akte administrative dhe nga dy Misionet e RSH-së në Bruksel për këtë problematikë, e bën të pamundur adresimin e përgjegjësive për persona konkretë, ashtu siç rekomandohet nga KLSH. Bashkëlidhur :

-Postë zyrtare e datës 24 gusht 2018 me kërkesën ndaj përfaqësive tona në Bruksel për dhënien e informacionit mbi çështjen e ngurtësimeve të pakthyera.

-Urdhër i përbashkët i Misionit të RSH-së pranë bashkimit europian dhe Misionit të RSH-së pranë NATO nr.03, nr.01 datë 07.02.2019 për ngritjen e komisionit për verifikimin e vlerave të ngurtësuar.

-Proces-verbal i mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhërat e mësipërm.

-3 dokumenta në gjuhën angleze dhe franceze drejtuar nga Misionet tona në Bruksel në bankën BNP Paribas me kërkesë për dhënie informacioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pretendimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk justifikon zbatimin e rekomandimit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

6. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit:

Në praktikën e ndjekur për inicimin e zhvillimit të pronës së republikës së Shqipërisë në Neë york, Manhattan ndërtesa e misionit të përhershëm të RSH në New york, godinë bashkë me truall prone e shtetit Shqiptar u konstatua se:

Në praktikën për inicimin e këtij investimi shkresa e pare zyrtare e ndodhur nëdosje daton me nr. 1417 prot. Datë 19,08,2013 me lëndë “Informacion për ndërtesën e Ambasadës së misionit të përhershëm të RSH pranë OKB-së në Neë york”. Drejtuar këshillit drejtues të DSHTD-së, Nga 04,08,2013 deri më 15,08,2013 grupi I punës I përbërë nga Murat Mehmeti drejtor i DSHTD-së, S.N shef sektori, R.Ç dhe Y.S kanë kryer një vizitë në këto ambiente për të parë gjendjen e ndërtesës, shkak I kësaj vizite ishte shkresa e ambasadorit F.H nr. 187 datë 08,04,2013 dhe nr. 508 datë 04,08,2013 të cilat nuk administrohen në dosjen e investimit.

Pas kryerjes së vizitës verifikues të gjendjes së godinës grupi I punë hartoi shkresën nr. 1417 prot datë 19,08,2013 për gjendjen e godinës ku problematikat kryesore po I paraqesim më poshtë:

Fasada e godinës, në anën veriore të godinës, që sheh mbi rrugën 79 str. Është në gjendje degraduar nga njeri vit në tjetrin dhe në pjesën e sipërme të saj ka rënë edhe suvaja . Në pjesët e poshtme ka njolla lagështire të cilat kanë ardhur nga depërtuar në muret e ndërtesës. Kjo ka ardhur për shkak të lagështirës së ardhur nga tarraca duke krijuar problem nga brenda dhe nga jashtë godinës.

...Fasada në tërësinë e saj vlerësohet shumë e dëmtuar, e rrezikshme për jetën e banoreve të Misionit dhe kalimtarëve dhe ka nevojë urgjente për tu rikonstruktuar.

Bodrumi është ne një gjendje te papërdorshme dhe me gropën septike jashtë përdorimit për shkak të djegies se dy pompave që nxjerrin shkarkimet e godinës në rrjetin e qytetit. Puseta është e mbushur me shkarkime te ujerave të zeza, me kapak te kalbur e totalisht e dëmtuar dhe ne kontakt te plote me ambientin e brendshëm te godinës. Gjithashtu, u konstatua prezence lagështirës së madhe, veçanërisht ne katin përdhe e nëntokësor, për shkak të së çiles suvaja ka rene, është varur e deformuar e tere boja e mureve anore, muret janë te mykura, e po kështu edhe sistemi elektrik, ai i ndriçimit, e orenditë e pranishme në këto ambiente janë te dëmtuara. Tavanet janë te rena dhe sistemi i ajrimit nuk funksionon. Lagështira mendohet se është krijuar për shkak te kullimit te ujerave nga tarraca, një pjesë e të cilës është e hapur krejtësisht dhe lejon hyrjen e lire te reshjeve e lagështirës, e cila depozitohetne katet e poshtme.

Kjo gjendje vlerësohet tepër emergjente ndaj është i nevojshëm si fillim zëvendësimi I menjëhershëm i pompave, pesetës dhe i kanalizimit përkatëse.

Kati përdhe, është totalisht i dëmtuar si ne mure anësore edhe ne tavane, salla e madhe dhe çdo ambient është totalisht i papërdorshëm dhe jashtë funksionit, dysHEMEJA është e kalbur e po kështu moketi qe e mbulon; tavanet janë te kalbura e te rena. ... Zyrat e Misionit janë ne katin e dyte ne te cilat nuk është bere asnjë ndryshim të gjendjes fillestare, duke specifikuar dyer te vjetra, dritare me defekt dhe qe nuk funksionojnë. sistem ajrimi pjesërisht funksional. Banjoja nuk ka uje te ngrohte, e po kështu, kuzhina nuk ka as sistem shkarkimi funksional ... etj

Gjithashtu në këtë shkresë përmendet dhe një aktrakordimi datë 21,08,2009 ku janë konstatuar problematikat.

Gjatë qëndrimit të grupit të punës në New York kontaktuan me kompani Amerikane për një preventiv punimesh për pjesët e vlerësuar si më të dëmtuara; tarraca e godinës; fasada e godinës dhe rikonstruksion I katit përdhe.

Kompania Giovani Martini Contractor, INC paraqiti këto preventive

Riparim tarrace me vlerë 24,000 USD

Riparim fasade varianti A me vlerë 62,000 USD

Riparim fasade varianti B me vlerë 97,000 USD

Rikonstruksion total kati përdhe me vlerë 165,000 USD

Trotal oferta e ketij operatori për këto punime shkon në 251,000 USD variant A dhe 286,000 USD variant B.

Kompania Concerte Solutions Contracting LLC, paraqiti preventivin e saj

Riparim terrace me vlerë 63,750 USD

Riparim fasade varianti me vlerë 34,750 USD

Bazuar në sa më sipër grupi I punës I kërkon këshillit drejtues të DSHTD-së miratimin e fondit

1. Miratimin e fondit prej 17900 usd per punime te kryera nga 04.08.2013 deri 14.08.2013 ne godinën e Misionit te RSH pranë OKB-s ne New York.

2. Miratimin e fondit prej 16000 usd per zëvendësimin e tubacionit ne bodrumin e godines seMisionit te RSH prane OKB-s ne New York, dhe rikonstruksionin e rrjetit telefonik.

3. Te miratoje fondin per rikonstruksionin e Tarracës ne shumen 35000 usd

4. Te miratoje fondin per rikonstruksionin e Fasadës ne shumen 64000 usd

Ne planin e investimeve te vitit 2013 nga ana e Ministrisë Punëve te Jashtme është miratuar fondi I investimeve për këtë godine ne shumen 100 mije usd prej te cilave janë përdorur 34000 usd.

E gjithë kjo situatë mbeti vetëm në letër dhe në të gjithë periudhë në këtë godinë nga blerja e saj nga Shteti Shqiptarë deri më sot nuk është bërë asnjë investim serioz por duke e len të degradohet përditë, element ky I vërtetuar dhe nga web page zyrtare e godinave ne New jork <https://WWW.nyc.gov/site/buildings/index.page>, ku ne godinën e misionit tone janë konstatuar vazhdimisht shkelje ne punime pa leje apo dhe ne kushtet jo te mira të objektit me paralajmërimë nga autoritetet për sigurinë e objektit.

-Investimi ne Ndërtesë e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së në Nju Jork.

Godina e Ambasadës tone pranë OKB në Nju Jork është një prone e shtetit Shqiptarë e blerë nga shteti Shqiptar rreth vitetve 1960 , kjo godinë sipas të dhënave në dosjen e konsulentit ligjorë është e ndërtuar në vitin 1910 dhe ka një sipërfaqe prej 650 m2 me 5 kate me rreth 111 m2 kati.

Problematikat me këtë objekte datojnë me shkresa nga vitin 2009 e në vazhdim për gjendjen e saj të keqe lagështirën sistemin tejet të vjetër hidraulik dhe elektrik etj, kjo duket qart dhe në fotot e dërguara nga përfaqësuesit e misionit.

Me urdhrin nr. 208 datë 17,04,2020 sekretari i përgjithshëm A.S `Ngritjen e komision të vlerësimit për kryerjen e procedurave për Zhvillimin e pronës shtetërore të Shtetit Shqiptar tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në ...`

Ky urdher është mbështetur në VKM nr. 203 datë 26,02,2020 `Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit.

Nga ana e komisionit të krijuar prej 9 personash në përbërje të të cilës janë dhe 3 ekspertë jashtëm u vendos prokurimi i një studio ligjore (konsulencë) për orientimin e MEPJ në kryerjen e procedurës së kontraktimit të një subjekti privat për lidhjen e një kontrate zhvillimi prone ku shteti Shqiptarë kërkonte një sipërfaqe rreth 25% më të madhe se ekzistuesja dhe pjesën tjetër ta përfitoj subjekti ndërtues.

Pas kryerjes së procedurës së kontraktimit të konsulencës me procedure të hapur duke njoftuar disa kompani që ofrojnë këtë shërbim u përzgjedh kompania fituese.

Kompania fituese hartoi dokumentacionin e kryerjes së procedurës së përzgjedhjes së një kompanie ndërtimi procedure e cila u krye me shpallje online , shprehen interes 3 kompani dhe pas fazës së përzgjedhjes te terja kompanitë u tërhoqën për pa mundësi realizimi, së pari sipërfaqja që pretendonte MEPJ sipas tyre ishte e madhe, se dyti realizimi I objektit në atë zone vetëm për objektin tone ishte tejet e vështir pas objekti është me dimensione 6,1 ml x 31 ml sheshi i ndërtimit dhe ndodhet ne mes te dy objekteve te tjera e ngjitur.

Pas dështimit te procedurës së prokurimit të një kompanie ndërtimi MEPJ ka kontraktuar nje konsulent ligjor i cili end nuk ka dhëne një zgjidhje definitive. Situata vijon te jete e njëjte.

Gjetje nga auditimi.:

Nga auditimi në MEPJ u konstatua agravim i kushteve të aseteve shtetërore në New york konkretisht të godinës së përfaqësis tonë diplomatike prone e Shtetit Shqiptarë. Edhe pas shumë kërkesash nga përfaqësia diplomatike dhe inicimit të një procedure zhvillimi prone ky objekt mbetet ne kushte te këqia duke rrezikuar jetën e përfaqësuesve dhe një përfaqësim jo dinjitoz për shtetin Shqiptarë .

Rekomandim:

MEPJ së bashku me DSHTD-në të gjejnë mënyrën dhe mundësinë për zgjidhjen e situatës së krijuar, gjetjen e një zgjidhje të përshtatshme për rikonstruksionin e objektit apo rihvillimin e

pronës së shtetit Shqiptar në New York duke plotësua kushtet dhe standardet normale të ndërtimit në vendin ku ndodhet.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën protokolluar me tonën nr. 894/6 prot., datë 19.07.2023 dhe administruar nga grupi i auditimit më 21.07.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në faqen 4 të observacioneve paragrafi fundit shprehet se: në bazë të VKM nr. 840 datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e drejtorisë së shërbimit të trupit diplomatik” i ndryshuar, DSHTD ka si përgjegjësi administrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, prone e shtetit shqiptarë në shtetet e tjera, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja dhe në asnjë rast nuk e ka përjashtuar përgjegjësin e DSHTD në këtë proces por ka rekomanduar gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejt dh të mirë për këtë problematikë.*

IV. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua një mungesë përcaktimesh dhe harmonizimi e plotësimesh në bazën ligjore e rregullatorë, për sa i takon shpenzimeve për sigurimin e jetës së përfaqësuesve të shërbimit të jashtëm dhe shoqëruesve të tyre. Kështu, konstatohet se në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, nuk është sanksionuar qartë “Pagesa për sigurim e jetës së familjarëve/shoqëruesve të këtyre diplomatëve”, specifikuar në VKM nr.20 datë 18.01.2017. Nga auditimi i kontratave të lidhura rezultoi se, referuar Ligjit nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, MEPJ mbulon masën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për diplomatit e emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor dhe në raste të veçanta, kur është emëruar në zona me rrezikshmëri të lartë i mbulon diplomatit dhe familjarëve të tij sigurimin e jetës, për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

E njëjta gjë specifikohet edhe në VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, MEPJ paguan shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit të shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë. Nga auditimi u konstatua se, në 100% të rasteve të audituara siguracioni i jetës ka përfshirë edhe shoqëruesit e përfaqësuesve, por asnjë nga përfaqësitë nuk kishte të shpallur situatë me rrezikshmëri të lartë për periudhën objekt auditimi.

Pra mungon një përcaktim mbi autoritetin, rastet dhe procedurat e kryerjes së sigurimit të jetës për personelin e shërbimit të jashtëm dhe të familjarëve të tyre në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ të merren masat për harmonizimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi shërbimin e jashtëm, duke marrë masat për një zbatimin të plotë dhe efektiv të parimit të ekskluzivitetit, dhe të ndërmerren masat e nevojshme për të iniciuar amendime në Ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e dala në zbatim të tij, me synim qartësimin dhe sanksionimin e "pagesës së sigurimit të shëndetit", në funksion të përdorimit me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mungon një rregullim nënligjor mbi përcaktimin e:

- limiteve të qirapagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim;
- përcaktimin periodik të kushteve kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit.
- gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve, apo mënyrën se si do të kryhet kjo praktikë (nëpërmjet kontraktimit të një kompanie apo një personi fizik), referuar nevojave dhe specifikave të punëve brenda misioneve respektive, në përputhje me zbatimin e parimit të 3E-ve, (eficencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit) ,etj (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e institucionit, për hartimin dhe miratimin nga ana e Ministrisë të urdhëresave dhe metodologjive të brendshme që përcaktojnë rregullat dhe normojnë kriteret e limitet, gjurmët e auditimit, aprovimet dhe procedurën që duhet zbatuar në lidhje me marrjen me qira të godinave të ambasadave dhe selive diplomatike apo apartamenteve në përdorim të diplomatëve gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar prej tyre si dhe mënyrës së zbatimit të gjurmës dhe procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të pikave 3 dhe 4, neni 31, të ligjit Nr. 23/2015, Ministrisë të Punëve të Jashtme i njihet e drejta të emërojë në misionet diplomatike dhe postet konsullore, në raste të veçanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët duhet të zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit.

Nga auditimi me zgjedhje, rezultoi se në përfaqësitë diplomatike janë emëruar 28 (*njzetë e tetë*) punonjës, në cilësinë e ekspertëve, të cilët gëzojnë statusin e diplomatit në misionet diplomatike për aq kohë sa punojnë pranë këtyre misioneve. Për këta ekspertë, nuk rezultoi asnjë gjurmë dokumentare, ku të shpjegohet se përse konsiderohen raste të veçanta, çfarë njohurish dhe ekspertize zotërojnë, cila është procedura e hapjes së thirrjes për nevoja të rekrutimit të këtyre ekspertëve dhe të dhëna të ngjashme, duke mundësuar rekrutimin e tyre pa një procedurë transparente, në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 dhe nenit 5, të ligjit Nr. 23/2015.

-Në strukturën e misioneve diplomatike ushtrojnë funksionet:

- 65 (*gjashtëdhjetë e pesë*) diplomatë, që nuk u përputhet grada emërore me gradën personale;
- 52 (*pesëdhjetë e dy*) punonjës janë emëruar nga jashtë sistemit;
- 18 (*tetëmbëdhjetë*) diplomatë të cilëve ju përputhet grada emërore me gradën personale;
- 4 (katër) punonjës janë të ngarkuar me punë.

Pra, pjesa më e madhe e diplomatëve ushtrojnë funksion diplomatik në misione diplomatike dhe grada emërore e tyre nuk përputhet me gradën personale, në kundërshtim me shkronjën c), neni 50, Ligji nr. 23/2015. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi:

Të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e udhëzimeve, që do të vijnë në ndihmë për zbatimin me korrektësi të dispozitave të ligjit të posaçëm, lidhur me procedurat e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm, përcaktimin e afatit maksimal të qëndrimit në pozicionin e kreut të misionit diplomatik në situata të përkohshme, rotacionet e emërimeve në përfaqësi, si dhe çdo aspekt tjetër të konstatuar në veprimtarinë praktike, për të cilën kuadri ligjor aktual nuk është shprehur, apo lë vend për interpretim, duke shmangur në këtë mënyrë mungesën e theksuar të transparencës dhe vendimmarrjen subjektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, MEPJ kryen aktivitetin e saj në bazë të dokumentit të rregullores së brendshme të vitit 2010, përkatësisht "*Rregullore për disiplinën e brendshme në MPJ*", nr. 478 prot., datë 08.06.2010. Kjo rregullore nuk është përditësuar me ndryshimet ligjore (të vitit 2015), si dhe përmirësimet e strukturës organizative. Këto veprime e mosveprime pengojnë kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit, pasi kjo rregullore nuk përcakton detyrat konkrete që ata duhet të kryejnë, si dhe çështje të lidhura me vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës, etj. Për misionet diplomatike dhe postet konsullore, rregulloret e brendshme nuk janë të azhornuara me ndryshimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk i përgjigjen kërkesave që rrjedhin nga Manuali i MFK. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 303-322 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi:

Titullari i institucionit të marrë masat dhe të ngrejë një grup pune për hartimin e rregulloreve në harmoni me legjislacionin e azhornuar, me qëllim saktësimin e detyrave dhe përgjegjësisive të çdo punonjësi, referuar pozicioneve të strukturës së miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve dhe praktikave zyrtare të vlerësuara nga grupi i auditimit, lidhur me autorizimin dhe regjistrimin e lëvizjes dhe hartimit të fletë udhëtimeve së automjeteve, rezultoi mungesë e dokumentacionit justifikues, duke vepruar në kundërshtim me Urdhrin e nr.507, datë 15.10.2012, të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, pasi mungojnë:

- Gjurmët e urdhrave të titullarëve të përfaqësive diplomatike, për autorizimin e lëvizjes së automjeteve, me përshkrimin e arsyes dhe itinerarit të lëvizjes së automjeteve.
- Gjurma e kërkesës për përdorimin e automjetit nga ana e punonjësve të përfaqësive, ku të jetë specifikuar qartë arsyeja si dhe pamundësia e përdorimit të transportit publik për në destinacion.
- Gjurma e miratimit apo dakordësisë nga ana e titullarit të misionit (konsull/ ambasador, etj) *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi:

Të merren masat për plotësimin e zbatimit të gjurmës së auditimit dhe zbatimin me korrektesë të procedurave të detyrueshme për kryerjen e shërbimeve dhe disiplinimin e lëvizjes së automjeteve, referuar përcaktimeve të Urdhrit nr.507, datë 15.10.2012 të Ministrit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, nga ana e MEPJ për hartimin e pasqyrave financiare mungon përditësimi me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018, i ndryshuar, për “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pasi është operuar bazuar në dispozita ligjore të shfuqizuara. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimet dhe formatet zyrtare aktuale të miratuara nga MEF.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe analiza e të dhënave dhe informacioneve të trajtuara në relacionin shoqëruar të pasqyrave financiare, evidentohet se, nga ana e MEPJ-së në përbërje të llogarisë 212 “Ndërtime dhe konstruksione” përfshihet vlera prej 52,601,250 lekë për rikonstrukcionin e godinës, të kryer në vitin 2020 dhe në vlerën prej 1,543,680 lekë, shuma e shpenzuar për mbikëqyrje punimesh, në kuadër të këtij rikonstrukcioni.

Nga auditimi rezultojnë problematikat si më poshtë vijon:

- MEPJ ka llogaritur për vitin 2020 shpenzime amortizimi mbi vlerën e ndërtesës, ndërkohë që këtë aset institucioni nuk e disponon as në pronësi dhe as në librat e kontabilitetit.

Për sa më sipër, nga MEPJ nuk janë zbatuar procedurat për marrjen e dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek MEPJ dhe regjistrimit të tyre në kontabilitet, si pjesë e aktiveve afatgjata në përdorim të institucioneve të varësisë dhe të tjera, në kundërshtim me pikën nr.10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

- Nga auditimi evidentohen parregullsi e dobësi, përsa i takon kontabilizimit të vlerës së garancisë së ndërtimit, (në shumën 5% të garancisë), ku u konstatua mungesë e evidentimit të kësaj llogarie në pasqyrat financiare, as për garancinë e punimeve. Nga ana e MEPJ-së kjo vlerë është kontabilizuar në llogarinë 212 të zërit “ndërtesa e rikonstrukcione”. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi:

- Nga ana e MEPJ-së, të merren masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm nga NJQQ mbi kalimin e përgjegjesisë së operimit/menaxhimit të këtyre aktiveve tek kjo Ministri.
- Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të hartuar dhe paraqitur në mënyrë të drejtë, zërat e bilancit (në pasqyrat financiare), në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu t'i kushtohet rëndësi e veçantë klasifikimit në mënyrë të drejtë të posteve të bilancit. Aktivët afatgjata në përdorim të njësisë të kontabilizohen në përputhje me procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, lidhur me rimbursimin e TVSH-së, në aktrakordimin me thesarin pasqyrohet një llogari me përshkrim "rimbursim TVSH" e cila përfaqëson vlerën e TVSH të rimbursueshme për trupin diplomatik të akredituar në vendin tonë, e cila është keq klasifikuar si pjesë e këtij aktrakordimi. Nisur nga fakti që MEPJ përmes Drejtorisë së Protokollit, përgatit urdhër shpenzimet me shumat përkatëse të TVSH-së që do ti rimburohet çdo misioni diplomatik dhe diplomati të akredituar në RSH, të mbahet parasysh pasqyrimi i tyre i saktë në kontabilitetin e njësisë shpenzuese, në kuadër të klasifikimit dhe rakordimit me Thesarin, pasi nuk mund të trajtohet si e ardhur një shumë shpenzimi. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi:

Të merren masat nga MEPJ të rishikohet formati i akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin, me qëllimin e shmangies së keq-klasifikimit të të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimeve të prapambetura llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" përbëhet nga detyrimet që stafi dhe të tretët kanë ndaj MEPJ-së, që në mënyrë më të detajuar përfshijnë:

- ✓ Shumën prej 489,528 lekë, detyrime nga të tretët që i përkasin një periudhe kohore mbi 10 vjeçare,
- ✓ Shumën prej 16,786,553 lekë, detyrime të mbartura nga stafi dhe nga kompani apo persona të tretë, (*më konkretisht, në 10,448,110 lekë detyrime që stafi ka ndaj MEPJ-së dhe 6,338,443 lekë detyrime që kompanitë/të tretët kanë ndaj MEPJ-së*);

Nga vlerësimet e audituesve të pavarur, gjykohen si më problematike vlerat që të tretët kanë ndaj institucionit ku peshën më të lartë e ka kompania "D. sh.p.k" me vlerën 6,025,225 lekë, që në terma relative përfaqëson 95% të totalit të detyrimeve të të tretëve. Nga ana e MEPJ-së janë ndërmarr veprime e procedura për arkëtimin e shumave, por përpjekjet kanë qenë të pamjaftueshme dhe jo rezultative. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi:

- Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në vijimësi arkëtimi i të drejtave të arkëtueshme (debitorët), duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme në rrugë administrative e ligjore, deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezulton se, nuk janë kryer procedurat e inventarizimit të aktiveve të institucionit buxhetor, e për pasojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen me siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe transparencën e të dhënave që përbëjnë llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, që gjykuar nga vlera e lartë e tyre (127,143,416 lekë) përbën risk të moderuar deri në të lartë për mundësinë e keqadministrimit të tyre. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi:

- Të hartohen analizat e llogarisë inventariale 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” duke identifikuar dhe peshën specifike të çdo artikulli në bilancin kontabël (në shënime shpjeguese), si dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme të verifikimit të ekzistencës së tyre nëpërmjet kryerjes së inventarizimit periodik fizik të kësaj pasurie.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur, për të dy vitet objekt auditimi, sa i takon llogarisë 215 “mjete transporti”. Në inventarin e automjeteve të MEPJ, rezultojnë 29 mjete, (27 automjete dhe 2 motoçikleta), nga të cilët aktualisht funksionale janë vetëm 13 prej tyre (12 automjete dhe 1 motoçikletë) dhe vlerë kontabël të mbetur kanë vetëm 6 (1 motoçikletë dhe 5 automjete) prej 15,059,069 lekë.

Sa më sipër, konstatohen këto parregullsi:

- **Së pari, problemi i vlerës së mbetur:** U konstatuan automjete që janë jashtë përdorimit aktualisht, por që kanë vlerë kontabël të mbetur (me vit prodhimi të afërt p.sh 2008, 2015). Konkretisht, automjeti “*Mercedes Benz C Class*”, viti i prodhimit 2015, me vlerë të mbetur 2,683,994 lekë dhe ndërkohë që për automjetet që janë në përdorim vetëm 3 prej tyre kanë vlerë kontabël (“*Toyota Rav 4*”, me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 3,019,061 lekë, “*Toyota Prius*” me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë si dhe “*Toyota Prius*” me vit prodhimi 2016 dhe vlerë të mbetur 2,962,345 lekë).

Në këtë rast kemi të bëjmë me një parregullsi financiare, pasi janë funksionale automjete pa vlerë kontabël dhe nga ana tjetër vlera mbi të cilën llogaritet amortizimi përfshin automjete të cilat nuk janë në funksion, në kundërshtim me SKK5, “*Aktivët afatgjatë materiale dhe aktivët afatgjatë jomateriale*” pika 43, ku parashikohet se, amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je përgjatë jetës së tij të dobishme, ku me jetë të dobishme kuptohet: (a) periudha gjatë të cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësia ekonomike.

- **Së dyti, mbajtja në inventar e automjeteve që janë efektivisht jashtë përdorimit.** Konkretisht, janë 17 aktive referuar sa më lartë, jashtë funksionit dhe që vazhdojnë të mbahen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, duke dhënë një pamje jo reale të gjendjes së tyre, si dhe okupuar hapësirën fizike të parkimit të MEPJ-së.

- Përsa i përket numrit të lartë të automjeteve jashtë funksionit, KLSH ka konstatuar se në vitin 2021 është iniciuar procesi i nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit, por konstatohet se kjo procedurë nuk është vijuar më tej prej këtij institucioni. Nga ana e MEPJ-së janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për secilin prej automjeteve, por mungon një relacion final për titullarin e institucionit dhe nga ana e grupit të ngritur të jetë nxjerrë një përfundim lidhur me këto aktive afatgjatë materiale. Nga ana tjetër, procesverbalet e vlerësimit janë me parregullsi e mangësi; mungon një analizë kosto/ përfitim për çdo mjet si dhe një relacion argumentues për destinacionin e tyre nga

ana e inxhinierëve vlerësues. (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e MEPJ, me qëllim finalizimin e procedurës për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve, pas kryerjes së një analize të plotë kosto përfitim mbi këto automjete si dhe mbështetur në vlerësimet dhe relacionet argumentues për çdo automjet nga ana e inxhinierit vlerësues dhe nga të gjithë anëtarët e komisionit., për nxjerrjen nga përdorimi, ku të përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të këtyre aktiveve, dhe nënshkruhet

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Përsa i takon përlllogaritjeve të amortizimit vjetor për aktivet, nga auditimi u konstatua fenomeni i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi, si më poshtë vijon,

- llogaritja e amortizimit vjetor është kryer në bazë të normave të amortizimit të VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Mbi normat e amortizimit të mjeteve kryesore”, sipas së cilës ndërtesa amortizohet me normë amortizimi 1.3%, dhe vlerë 5,857,164 lekë, pajisje zyrash me normë amortizimi 5.8% dhe vlerë 7,828,363 lekë, mjete transporti me normë amortizimi 13.8% dhe vlerë 2,078,152 lekë dhe inventari ekonomik me normë amortizimi 3% dhe vlerë 541,686 lekë.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, kreu 3.1, paragrafi 36, sipas të cilit ...“Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi;
- Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15% (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi:

- Të merren masat nga ana e Nëpunësit Zbatues dhe Sektorit Financiar të këtij institucioni, për aplikimin me korrektesë të normave të amortizimit vjetor të aktiveve afatgjata materiale e jo materiale dhe llogaritjen e drejtë të amortizimit të aktiveve, sipas përcaktimeve në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin public.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të shërbimit konsullor dhe reflektimit të tyre në kontabilitet rezulton se, për të dy vitet objekt auditimit, në detyrimin total nga veprimtaria e shërbimit konsullor për tu arkëtuar vijon të mbetet e paarkëtuar vlera e detyrimit të subjektit “D.” prej 22,950 lekë, mbartuar qysh nga viti 2019.

Nga auditimi u konstatua se, arkëtimet e munguara i përkasin muajit dhjetor plus mbartjen e detyrimit të D.-së, por në dokumentacionin e vendosur në dispozicion këto vlera nuk rakordojnë.

Konstatohet diferencë në arkëtimin e munguar prej 408,380 lekë në të dy vitet. Diferencë e cila ka ardhur si rrjedhojë e llogaritjes jo të sakta nga ana e MEPJ-së.

Referuar të dhënavë vendosur në dispozicion vlera e detyrimit të mbartur për tu arkëtuar, i cili përfshin edhe muajin dhjetor 2022 dhe detyrimin e D. duhet të ishte 12,580,919 lekë ndërkohë kjo vlerë e llogaritur prej institucionit rezultonte 12,110,539 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa konkrete për të arkëtuar vlerat e munguara dhe sistemuar diferencat reale të të ardhurave të munguara.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk kryej rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve, në përputhje dhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme me nr.37, datë 31/12/2014 “*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit*”, pika 5 e tij.

Konkretisht,

a. rakordimi kryhej mes Inspektorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Zyrës së Veprimeve Konsullore për MEPJ dhe ky rakordim nuk kryhej rregullisht:

- Kështu, për vitin 2020 akt rakordimi mban datën 22.02.2021 dhe është kryer vetëm 1 (një) herë.
- Për vitin 2021 akt rakordimi për muajt janar-qershor dhe mban datën 09.08.2021 dhe për muajt korrik-dhjetor është kryer pas përfundimit të vitit kalendarik dhe mban datë 17.02.2022.

b. Nga auditimi u konstatua se, për të ardhurat e mbledhura nga agjentët e mbledhjes së tarifave (P.Sh, TNT, A.C dhe A.D.E) nga ana e MEPJ-së nuk mbahej asnjë aktrakordimi me degën e thesarit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.37, datë 31.12.2014 me pretendimin e institucionit, se operonin në zbatim të VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “*Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore*” dhe kontratës për sipërmarrje shërbimi mes P.Sh sh.a dhe MEPJ-së.

Nga auditimi nënvizohet se, VKM nr. 241, datë 31.03.2011 “*Për kryerjen nga “P.Sh sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe veprimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore*” pika 1, shkronja b, u drejtohet të gjithë shërbimeve financiare, ndërkohë që Udhëzimi nr.37, datë 31/12/2014 “*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit*” nxjerr me vonë se VKM ka fushëveprimi specifike dhe i drejtohet pikërisht shërbimit konsullor (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 Rekomandimi:

Të merren masa konkrete për kryerjen e veprimtarisë operative në përputhje dhe në zbatim me bazën ligjore rregullatore si dhe të zbatohen detyrimet e kontratës mes palëve “P.Sh” sh.a dhe MEPJ-së, sikundër edhe parashikohet në nenin 2 “*Të drejtat dhe detyrimet e palëve*”, pika 2.3 dhe 2.4 e saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me rakordimin e vlerave të pasqyruara në situacionin e shpenzimeve, (të paraqitura në akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit Tiranë), për zërin “Shpenzimet korrente” dhe atyre të evidentuara në pasqyrat financiare vjetore të MEPJ, për llogaritë e shpenzimeve për vitin 2021, u konstatua një diferencë ose mungesë rakordimi, në shumën prej **2,701,850 lekë**, pasi sipas pasqyrave të llogaridhënies vjetore ato paraqiten në vlerën 408,393,801 lekë, kurse sipas akt rakordimit të nënshkruar me Degën e Thesarit, vlera e tyre është 411,641,651 lekë.

Në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore mungon shpjegimi i diferencave dhe i mungesës së rakordimeve, për shpjegimin e arsyeve ngase rezultojnë këto diferenca. Sa më lartë, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 37 – 39. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masat për të kryer rakordimin dhe unifikim të vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare, me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit të kundërfirmuara me degën e thesarit, si dhe për rastet e mospërputhjeve të bëhen shpjegimet e nevojshme në relacionet që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore.

- Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e MEPJ dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

Periodikisht dhe çdo muaj

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi ka rezultuar se, në MEPJ nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, vepruar në kundërshtim me përcaktimet e:

Paragrafit nr. 26, Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

Paragrafit nr. 27, Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.

*Paragrafit nr. 30, Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

12.1 Rekomandimi:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në përputhje me detyrimet e normuara në Udhëzimin e MFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi lidhur me inventarizimin e aktiveve konstatohet se, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ-së janë miratuar urdhrat për kryerjen e inventarizimit të pasurisë për vitin 2020 dhe 2021, përkatësisht:

- për vitin 2020, *Urdhri nr.241 datë 20.05.2020 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve”*
- dhe për 2021, *Urdhri nr.533 datë 27.10.2020,*

të cilët nuk kanë gjetur zbatuar dhe për rrjedhojë nuk është kryer procesi i inventarizimit periodik të pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë dhe gjendjen fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, (Kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve”, paragrafi nr.73 dhe 74 i tij) dhe urdhrat e mësipërm.

Si rezultat, të dhënat e vlerave kontabël në pasqyrën e pozicionit financiar për vitet 2020-2021, nuk janë verifikuar e rakorduar me gjendjen fizike të tyre, ndaj audituesit e KLSH nuk arrijnë të japin një siguri të arsyeshme mbi pohimet e nevojshme që lidhen me saktësinë dhe vërtetësinë e vlerave të pasqyruara në kontabilitet mbi aktivet e këtij institucioni.

(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi:

- Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e inventarizimit të aseteve të njësisë dhe çdo aktiv tjetër që ky Institucion disponon për të verifikuar e rakorduar gjendjen fizike të tyre me të dhënat e librave të llogarisë.

- Të kryhet rakordimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga ana e MEPJ nuk është zbatuar plotësisht VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Kështu, nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr.2 të këtij vendimi, që përcakton se, Institucionet e administratës qendrore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, janë palë pjesëmarrëse aktive në këtë proces dhe janë të detyruara të përgatisin dhe të vënë në dispozicion të AITPP-së të gjithë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e këtij procesi, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Më konkretisht rezulton se,

Nga ana e MEPJ nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e

qeverisjes vendore”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi:

- Të merren masa të menjëhershme për të iniciuar procedurat e regjistrimit të pronësisë dhe përcaktuar kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit për çdo rast dhe kryerja e rivlerësimit të tyre në mënyrë që të pasqyrojnë drejt dhe saktë vlerat në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të karburanteve rezultoi se,

- Rezultojnë mospërputhje në të gjithë rastet për të dhënat, nga krahasimi mes normave të konsumit për çdo mjet referuar manualit të automjeteve dhe normave të specifikuara nga MEPJ;
- Mungesë e raporteve dhe procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së;
- Nuk janë nxjerrë normativat e harxhimit të karburantit për automjetet e MEPJ-së për vitin 2022, si dhe për periudhën 2020-2021 nuk janë të miratuara me Urdhër të Titullarit, etj.
- Nga ana e MEPJ-së, nuk kryhet asnjë verifikim për kilometrat e regjistruara nga makinat e Ministrisë që të shërbejnë për efekt llogaritjesh të karburantit të shpenzuar;
- (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi:

Të merren masa nga ana e zyrtarëve përgjegjës për :

- përcaktimin e normave të harxhimit / konsumit për secilin automjet në përdorim në përputhje me bazën ligjore përkatëse.
- hartimin në mënyrë periodike procesverbaleve për matjen e harxhimit të karburantit për automjetet e institucionit, si dhe të raporteve mbi monitorimin dhe informimin e rezultateve, në kuadër të një sistemi kontrolli dhe monitorimi proaktiv;
- hartimin dhe miratimin e një plani mujor sipas tipit të makinave dhe ngarkesës së punëve, për lëvizjeve të personave që i përdorin automjetet për nevoja të punës, si dhe në mënyrë të vazhdueshme të kryhen verifikime për kilometrat e përshkruara nga makinat e Ministrisë.
- plotësimin me dokumentacionin e domosdoshëm justifikues të këtyre praktikave administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me përzgjedhje përsa i takon dokumentimit të lëvizjes së automjeteve rezultuan parregullsi e mangësi si vijon,

- Për vitin 2020 për 3 automjete të përzgjedhura për testim, në vetëm për 2 prej tyre mund të përcaktohej numri i lëvizjeve dhe rezultoi të jenë kryer 369 lëvizje, për të cilat janë përshkruar 38,019.9 km dhe të gjitha pa një destinacion të specifikuar;
- Për vitin 2021 për 5 automjete të përzgjedhura për testim rezultojnë të jenë kryer 1179 lëvizje gjithsej, për të cilat janë përshkruar 95,209 km, të gjitha pa destinacion të specifikuar;
- Për vitin 2022 (për periudhën janar-gusht 2022), për 3 automjete të përzgjedhura për testim rezultojnë të jenë kryer 795 lëvizje, për të cilat janë përshkruar 51,364 km pa destinacion të specifikuar

- Për të tre vitet e audituara, në asnjë rast nuk ishte shënuar në dokumentin e fletudhëtimit, arsyeja e udhëtimit dhe itinerari, në kundërshtim me kuadrin nënligjor në fuqi. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim:

- Të merren masa të dokumentohen dhe monitorohen me korrektesë lëvizjet e automjeteve me qëllim që të shmangur veprimet që sjellin keqadministrim financiar të fondeve publike.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve me fondet publike janë konstatuar mangësi, parregullsi e shkelje:

• **Parregullsi në përcaktimin e kriterëve kualifikuese në procedurat e prokurimit publik si:**

a. Në procedurën *Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021*, DST kanë parregullsi përkatësisht në kriteret mbi kapacitetin financiar dhe kapacitetin teknik, si rrjedhojë KVO ka kualifikuar një operator pa vërtetuar që disponon kapacitetet e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi.

b. Në procedurën *Blerje dhe vendosje gjeneratori godine, viti 2022*, kriterin mbi licencën kategoria 4/c, jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e punimeve.

c. Në procedurën *Blerje sigurim shëndeti, shëndeti në udhëtim dhe jete, viti 2022*, kriterin mbi zotërimin të licencës për Klasën A1 “Sigurimi i aksidentëve” dhe Klasën A2 “Sigurimi i sëmundjeve dhe/ose “Sigurimi i aksidentëve dhe shëndetit”, dhe Klasën B23 “Për veprimtarinë e sigurimit të jetës”, kriteret jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.

• **Parregullsi në vlerësimin e ofertave në procedurat e prokurimit publik si:**

a. Në procedurën *Përkthim i legjislacionit të Bashkimit Evropian, viti 2021*, KVO ka kualifikuar OE, i cili nuk ka dorëzuar kopje të deklaratave të xhiros vjetore, sipas kërkesave të DST.

b. Në procedurën *Blerje dhe vendosje ashensor godine, viti 2021*, KVO ka kualifikuar OE, i cili nuk ka përcaktuar çfarë punimesh merr secili nga pjesëmarrësit, dhe njëri nga OE pjesëmarrës në BOE, nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes për punën e ngjashme, e cila i përket sektorin privat, në kundërshtim me kriteret/kërkesat e përcaktuara në DST.

Protokollit.

• **Parregullsi në inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit në arkivë:**

Nga auditimi rezultoi se në MEPJ të gjitha dosjet e procedurave të prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit.

(Trajtuar më hollësisht në faqe 283-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në vijimësi

17.2. Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra,

shërbime me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim garantimin e përdorimit me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në vijimësi

17.3. Rekomandimi: Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumenteve zyrtare të procedurave të prokurimit, nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Ng auditimi evidentohet se ashensori i vendosur në ndërtesën e MEPJ, nuk është i certifikuar pavarësisht faktit që është marrë në dorëzim, në kundërshtim me Ligjin Nr.10489, datë 15.12.2011 "*Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore*", Neni 3, që parashikon se çdo ashensor i ri ose ekzistues regjistrohet pranë Strukturës Përgjegjëse, dhe MEPJ në cilësinë e përgjegjësit për furnizim-vendosjen e kësaj pajisjeje, duhet të kërkojë certifikimin dhe regjistrimin e tij pranë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. *(Më hollësisht trajtuar në faqet faqe 283-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të marrë masat e menjëhershme për pajisjen me certifikatë dhe regjistrimin e ashensorit pranë strukturave të posaçme si Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në funksion të sigurimit të jetës të përdoruesve të tij.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MEPJ, për financimin e *task-forcës* së ngritur me VKM nr. 116, dt. 13.03.2019, "Për ngritjen e *task-forcës* pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të njësisë pranë misionit të Republikës së Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare në Vjenë, përgjegjëse për kryesimin e "G.K.M, O.S.B.E dhe G.K.A" është kërkuar një rritje e fondeve të buxhetit prej 125,000 mijë lekë, e cila nuk është pranuar nga MFE, por është miratuar vetëm në vlerën prej 19,000 mijë lekë, duke mos e justifikuar fondin e kërkuar nga MEPJ, në kundërshtim me VKM nr. 897/2020, "Për miratimin e dokumentit për programin buxhetor afatmesëm 2021-2023", të rishikuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 27-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së në çdo rast të analizohen me saktësi elementet e buxhetit për çdo zë të tij duke argumentuar shtesat dhe pakësimet, me qëllim rritjen e efektshmërisë së planifikimit dhe realizimit, dhe miradministrimin e buxhetit të akorduar.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se:

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB) të MEPJ është emëruar sipas Urdhrit nr. 02, datë 08.01.2019 "Për riemërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë për

Evropën dhe Punët e Jashtme” dhe kjo strukturë ka vijuar të ushtrojë funksionet e përcaktuara përgjatë vitit 2021, në tejkalim të mandatit/ afatit 2-vjeçar, në kundërshtim me pikën 6, Kreu II, të VKM 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm”;

- KAB për vitin 2020 është mbledhur gjithsej 2 (dy) herë, për vitin 2021 është mbledhur gjithsej 3 (tre) herë, dhe për vitin 2022, rezulton që KAB nuk është mbledhur asnjëherë, në kundërshtim me parashikimet e pikës 9, Kreu II, të VKM 160/2016. (Trajtuar më hollësisht në faqe 303-322, të Projekt Raportit të Auditimit).

20.1. Rekomandimi:

-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm për MEPJ sipas formës së kërkuar nga ligji, pasi ai ka rolin e një autoriteti që monitoron sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik për institucionin dhe që ofron këshilla për Ministrin brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie.

-KAB të zhvillojë veprimtarinë e tij sipas një kalendarit të miratuar, të zhvillojë takimet/mbledhjet jo më pak se 4 (katër) herë në vit bazuar në kompetencat e raportimit, si dhe të zbatojë parashikimet e legjislacionit për organizimin dhe funksionim e organeve kolegjiale.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se:

- Të gjitha auditimet e planifikuara dhe realizuara nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të MEPJ i përkasin tipologjisë së “Auditimeve të Përputhshmërisë”, por nuk janë planifikuar e realizuar për periudhën objekt auditimi nga KLSH, të angazhimeve audituese të Auditimit Financiar, të Performances, IT-së apo të kombinuara, edhe pse afërsisht 80 (tetëdhjetë) % e buxhetit të miratuar për MEPJ shkon për misionet diplomatike dhe postet konsullore. Nga auditimi me zgjedhje i raporteve të auditit të brendshëm u konstatuan raste të trajtimit të aspekteve financiare, referuar peshës totale që shpenzimet kanë në buxhetin e përfaqësive.

- 48 (Dyzetë e tetë) struktura të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore rezultojnë të audituara mesatarisht 1 (një) herë në 3.8 vite (maksimalisht për 10 vjet dhe minimalisht për 2 vjet), në kundërshtim me pikën 3.1.3 të “Manuali i auditimit të brendshëm”, i ndryshuar.

- NJAB pas çdo auditimi dhe lënies së rekomandimeve në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, ndjek zbatimin e tyre në fund të çdo viti, në përputhje me shkronjën “ç”, neni 6, i Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili parashikon se: “Roli i auditimit të brendshëm është ti japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë... duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna”, megjithatë referuar raporteve vjetore konstatohet se nuk janë evidentuar mangësitë dhe shkeljet ligjore të konstatuara gjatë punës së kryer nga grupi i KLSH-së, gjithashtu konstatohet se rekomandimet nuk zbatohen plotësisht nga Institucioni si dhe NJAB nuk merr masa të mëtejshme administrative-juridike për zbatimin e tyre me qëllim që ti shërbejnë arritjes së objektivave të Institucionit dhe fuqizimit të rolit e misionit të NJAB brenda kësaj ministrie.

(Trajtuar më hollësisht në faqe 303-322, të Projekt Raportit të Auditimit).

21.1. Rekomandimi:

-Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për përfshirjen në planet vjetore dhe strategjike të auditimit, të angazhimeve të auditimeve financiare dhe atyre të kombinuara, në auditimet e misioneve diplomatike dhe përfaqësive jashtë vendit.

-Njësia e Auditimit të Brendshëm në hartimin e planeve të subjekteve për tu audituar të mbajë parasysh frekuencën e kryerjes së këtyre angazhimeve audituese, duke mos lënë asnjë subjekt pa u audituar për më shumë se 5 vjet, me qëllim kryerjen në kohë të misionit të auditimit, duke i shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit dhe parandalimit të parregullsive dhe shkeljeve të ligjshmërisë.

- NJAB të angazhohet për të evidentuar në çdo rast parregullsitë dhe shkeljet e disiplinës financiare në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë, duke siguruar në këtë mënyrë një mekanizëm efikas për përmirësimin e vazhdueshëm të punës në Institucion.

-NJAB të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të lëna, duke siguruar dhënien e mbështetjes së titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Nga ana e strukturave përgjegjëse të MEPJ nuk është hartuar e miratuar kodi i etikës, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranura të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit, ndonëse është hartuar një plan integriteti, miratuar me Urdhrin nr. 150/2022, mirëpor ky dokument nuk ka të parashikuara të gjithë elementet e Kodit të Etikës.

- MEPJ nuk ka hartuar një strategji institucionale ku të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe të detajohen mbi këtë bazë planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me parashikimet e pikës 8, të nenit 8, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

- Për vitet 2020, 2021 e 2022 titullari i MEPJ nuk ka marrë masat për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për Ministrinë, në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.

- MEPJ nuk ka hartuar dokumentin e Strategjisë së Riskut, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296, i ndryshuar. Evidentohet se institucioni për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistrin e riskut, në kundërshtim me parashikimet e nenit 12, pika 3, të Ligjit nr. 10296 për MFK.MEPJ nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

- Titullari i MEPJ për vitet 2020 - 2022 nuk janë hartuar e miratuar gjurmët e auditimit për proceset kryesore, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK si dhe mungojnë programet e trajnimit të stafit për çështjet e Menaxhimit të Financave Publike dhe Kontrollit të Brendshëm.

- Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e MEPJ, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse ky informacion sigurohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme.

- Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

- MEPJ nuk ka plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit dhe raportet, në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III, të Manualit të MFK. Gjithashtu, për vitin 2020, 2021, 2022 rezulton se nëpunësi autorizues i MEPJ nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit të referuar më lartë. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 303-322 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi:

- Titullari i institucionit të ngrejë një grup pune, i cili të analizojë në mënyrë të plotë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për dobësitë dhe moszbatimin e harmonizuar të komponentëve të Menaxhimit të Financave Publike dhe Kontrollit të Brendshëm dhe mbi këtë bazë të hartojë një plan pune të detajuar për përmirësimin e gjendjes dhe për zbatimin e menjëhershëm të këtyre detyrimeve. Njësia e Auditimit të Brendshëm e MEPJ të monitorojë në vijimësi zbatimin e këtij plani dhe të cilësisë së MFK për institucionin..

- Titullari i institucionit të ndjekë zbatimin dhe monitorimin e të gjithë komponentëve dhe çështjeve të Menaxhimit të Financave Publike dhe Kontrollit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të *blerjeve me vlerë të vogël në MEPJ* u konstatua se për periudhën objekt auditimit në këtë institucion janë realizuar 284 procedura emergjente në vlerën 18,403,042 lekë pa TVSH. Këto procedura kryesisht janë blerje biletash apo pritje përcjelle të pashmangshme, por në disa raste shpenzimet e kësaj natyre nuk e justifikojnë llojin e procedurës së përzgjedhur. (Trajtuar më hollësisht në faqe 179-282 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Shërbimeve dhe e Prokurimeve pranë MEPJ të kryej një parashikim më të saktë në regjistrat e parashikimit, sidomos për procedura të përsëritura, për të cilat strukturat e MEPJ kanë informacionin e plotë, me qëllim parashikimin sa më korrekt të këtyre procedurave dhe eventeve, me qëllim shmangien e procedurave emergjente kur kjo është e pajustificuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me *natyrë emergjente për periudhën objekt auditimi 1.1.2021-30.09.2023* nga ana e MEPJ evidentohet se, ato janë kryer për blerje e shërbime të tilla si: “Blerje letër adeziv me ndarje”, “Blerje karburant për nevojat e MEPJ”, “Materiale pastrimi”, “Blerje tonera”, “Kuti kartoni për dërgesa diplomatike”, ‘Siguracion mjetesh’ etj, të cilat nuk plotësojnë kriteret e një procedure emergjente. Parregullsitë e tjera janë të këtyre llojeve: Në disa raste nuk përkojnë datat e kërkesave me datën e realizimit të procedurës; përsëritje të procedurës së prokurimit (*emergjencë pas emergjence*), veprime në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8, që thekson se “Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit”/. (Trajtuar më hollësisht në faqe 179-282 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve pranë MEPJ në asnjë rast mos të anashkaloje procedurat elektronike online duke përzgjedhur procedurën emergjente, me qëllim nxitjen e konkurrencës midis operatoreve ekonomikë dhe garantimin e përdorimit me kursim, dobi dhe frytshmëri të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për periudhën objekt auditimi, janë *konstatuar disa pagesa me mbi 30 ditë vonesë në shlyerjen e faturave*, (si faturat e energjisë elektrike dhe të ujit, po ashtu dhe likuidimi i detyrimeve për operatorët ekonomik fitues të tenderave). Si pasojë, evidentohet të jenë aplikuar kamat vonesa për pagesën e energjisë elektrike jashtë afatit ligjor, në vlerën 25,986 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52 . (*Trajtuar më hollësisht në faqe 179-282 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1 Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse të MEPJ-së, në të gjitha rastet të tregohen sa më korrekte në likuidimin e faturave të pranuar sipas kushteve të përcaktuara për pagesë, me qëllim shmangien e kostove të tjera shtesë për buxhetin e saj si dhe të nxirren përgjegjësitë për çdo rast penaliteti të ardhur si pasojë e neglizhencës së zyrtarëve të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi:

- Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se për periudhën objekt auditimi, nuk janë hartuar pasqyrat financiare individuale sipas përcaktimeve të kuadrit nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik. Informacioni i përgatitur mbi veprimtarinë e tyre financiare është në trajtën e evidencave mujore dhe përmbledhëse vjetore, të cilat dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropën, dhe shërbejnë si bazë për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara. *Sa më sipër*, hartimi i këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara nuk ndjek parashikimet e akteve nënligjore dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.

- Monitorimi i shpenzimeve që kryejnë përfaqësitë për të garantuar vërtetësinë dhe besueshmërinë e këtyre të dhënave dhe transaksioneve kryhet vetëm nga shërbimi i auditimit të brendshëm të kësaj Ministrie. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 , të Projekt Raportit të Auditimit*).

26.1. Rekomandimi:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të hartuar dhe paraqitur pasqyrat financiare individuale nga këto njësi shpenzuese në përputhje me Udhëzimet dhe formatatet zyrtare të miratuara nga Ministria përgjegjëse për financat.

- Nga ana e MEPJ-së të përditësohet, standardizohet dhe zyrtarizohet evidenca, e cila do të përdoret për raportimin e shpenzimeve nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore në MEPJ.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi fenomeni i përsëritur i mos kryerjes së procesit të inventarizimit të plotë të aktiveve të MEPJ si dhe inventarizimi i përgjithshëm i aseteve të përfaqësive diplomatike e konsullore të Shqipërisë jashtë vendit, e për pasojë Audituesit shtetërorë të autorizuar të KLSH nuk mund të shprehen mbi nivelin e saktësisë dhe rregullshmërisë së regjistrimit dhe pasqyrimit në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë. Në vlerësimin e audituesve të pavarur të KLSH, inventarizimi i aktiveve është një element shumë i domosdoshëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të Ministrisë, përmes të cilit vërtetohet saktësia, cilësia dhe ekzistenca fizike e aktiveve në një kohë të caktuar si dhe një mekanizëm i përdorimit në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre, për të evituar riskun e dëmtimit, humbjes dhe keq administrimit të tyre. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.1 Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ të merren masat për evidentimin, regjistrimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të elementeve analitike inventarialë që bëjnë pjesë në llogaritë e aktiveve afatgjata dhe aktiveve qarkulluese duke garantuar elementet e kontrollit të përvitshëm të ekzistencës së aktiveve nëpërmjet inventarizimit vjetor e periodik, për të evituar riskun e humbjes dhe keqadministrimit të aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi kontratat e qirave, për **18 përfaqësitë diplomatike të përzgjedhura për t'u audituar** nga ana e grupit të auditimit, u konstatua se,

- Nga ana e përfaqësive nuk disponohet dokumentacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së ofertës më të mirë për godinat e ambasadave dhe konsullatave si dhe apartamenteve të banimit për përfaqësuesit e shërbimit të jashtëm, apo një analizë e vlerës së tregut që është përdorur për përzgjedhjen e tyre bazuar në koston më të mirë, referuar zonës ku ndodhen ndërtesat dhe sipërfaqeve në dispozicion.

- Nuk ka gjurmë të urdhrimit të brendshëm për ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të përzgjedhjes së ambienteve për zyrat qendrore apo apartamentet e banimit, e për pasojë nuk disponohet informacion për mënyrën e testimit, marrjes dhe vlerësimit të disa ofertave dhe më tej përzgjedhjes së ofertës më të përshtatshme dhe më të arsyeshme.

- Sa i takon kontratave të nënshkruara të qirave (megjithëse një pjesë e tyre janë lidhur në periudha të hershme, përtej periudhës së auditimit), rezultoi se, këto akte zyrtare nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, ato janë hartuar dhe nënshkruar në gjuhët respektive të vendit pritës (Izrael, Greqi, Gjermani, etj), duke vepruar në këto kushte në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kontabilitetin e sektorit publik si dhe përcaktimet e pikës nr. 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, e cila ka parashikuar se ...*Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.*”

- Nga auditimi i kontratave të pronësisë për selitë e përfaqësive të Republikës së Shqipërisë në Athinë dhe Stokholm, të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit për shqyrtim e vlerësim rezultoi se, këto kontrata janë të mbajtura në gjuhën angleze ose gjermane, mungon një kopje dublikatë në shqip, në mospërputhje me pikën nr. 9, neni 4, të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”;

- MEPJ për marrjen me qira të ambienteve të banimit dhe të selisë së përfaqësive nuk ka përcaktuar e miratuar rregulla apo manuale të shkruara si do të procedohet për këtë veprimtari të një natyre të veçantë që rregullojnë fushën e përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH jashtë vendit, të merren masa të:

- Kryhen përmirësimet ligjore e nënligjore të nevojshme, duke plotësuar bazën rregullatore me të gjithë elementët që parashikon kuadri ligjor për fushën e përgjegjësisë së MEPJ;
- Studiohet tregu i pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe operohet sipas formave që parashikon ligji për vijueshmërinë;
- Përcaktohen periodikisht kushtet kryesore të qiramarrjes, listës së orendive të nevojshme për ambientet e banimit;
- Nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip (si varianti origjinal), për rastet e hartimit të këtyre dokumenteve në gjuhë të huaj fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i *kontratave të qirave dhe limiteve të qirapagesave*, dokumente të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit për shqyrtim e vlerësim, rezultoi se, praktikat e nënshkruara ishin me mangësi e parregullsi, për argumentimin e fondeve dhe masës së mbulimit të këtyre shpenzimeve nga e MEPJ, sipas parashikimeve të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, i ndryshuar, ku sipas përfaqësive të analizuar ka rezultuar si më poshtë:

- Përfaqësia Izrael:

Për vitin 2021, zëri i qirave ka ndikim nga ndryshimi i rritjes së qirasë nga 3% mbi qiranë e vitit pararendës sipas kontratës, në 1.5% për arsye të pandemisë dhe totali i shpenzimeve është 100,895.4 \$ dhe jo 100,909.06 \$ sikundër është paraqitur në evidenca, duke marrë parasysh se norma e rritjes së rentës është 3% dhe jo 1.5%, e përbërë nga 44,015.4 \$ për seli dhe 56,880 \$ për banim.

- Përfaqësia Madrid:

Për vitin 2021, totali i shpenzimeve të qirasë për selinë është 28,237.92 Euro. Nga mosvënia në dispozicion të audituesve shtetëror të autorizuar, të informacioneve specifike mbi përcaktimin e vlerës konkrete të ndryshimit (rritjes së vlerës së qirasë dhe indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), ku specifikohet vetëm se, duke nisur nga viti i katërt (nga v.2021), qiraja të rritet 10% përveç rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit; në kushtet që nuk është përcaktuar sa është indeksi i çmimeve të konsumit dhe sa është impakti i rritjes 10% mbi të, kjo ka bërë të pamundur vlerësimin mbi rregullshmërinë dhe saktësinë e pagesave të qirasë për godinën/at e përfaqësisë së shërbimit të jashtëm të vendit tonë në Madrid.

U konstatua mungesë e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme dhe mos argumentim i faktit, se përse është pranuar të rinovohet kontrata me një nivel rritje të përgjithshëm prej 10% përveç rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit.

- Përfaqësia Paris:

Referuar evidencave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se, në shpenzimet për qiranë vjetore janë përfshirë rritjet për qiratë e diplomatëve me 3% por në kontratat e qirave mungonte një klauzolë specifikuuese e tillë. Në kontratat e banimit nuk specifikohet klauzola e rilidhjes së kontratës pas përfundimit të afatit.

- Përfaqësia New York:

Nga auditimi rezultoi se 7 nga 8 kontratat e vendosura në dispozicion janë nënshkruar në vitin 2022 dhe mungon gjurma justifikuese e dokumentacionit të ri, ku të jetë i përafuar me vlerat e

tregut, për rrjedhojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen mbi rregullaritetin e shpenzimeve të kryera për zërin e qirave për periudhën 2020-2021.

Në total shpenzimet e qiramarrjes së përfaqësisë në New York për vitin 2021 ishin 309,300.72 USD, ku shpenzimet e qirasë për apartamente ishin 110,450.70 USD, shpenzimet e qirasë së zyrave ishin 84,828.15 USD dhe shpenzime të tjera qiraje ishin 84,980.52 USD. Grupi auditimit nuk arrin të shprehet mbi saktësinë dhe rregullshmërinë e shpenzimeve të qiramarrjes së kësaj përfaqësie, duke qenë se dokumentacioni i vendosur në dispozicion është i pjesshëm dhe i paplotë.

Nga auditimi u konstatua pagesa e kryer në shumën prej 29,041.35 USD për *broker fees*, por mungonte gjurma justifikuese e këtij shpenzimi. Kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme, (pika 10, germa ç, e VKM nr.20, datë 18.01.2017, që përcakton se, “*Ministria e Punëve të Jashtme përcakton, periodikisht, kushtet kryesore të qiramarrjes, listën e orendive të nevojshme për ambientin e banimit dhe limitet e qirapagesave për banesat e punonjësve të përfaqësive, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim. Rregullat e përcaktuara në këtë paragraf do të zbatohen vetëm për kontratat e qiramarrjes, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi*”.

- *Përfaqësia Moskë:*

Nga auditimi i kontratave të qirasë, u evidentua se shpenzimet e qiramarrjes për vitet 2020 dhe 2021 përfaqësia vijonte ti kishte në vlerën 78.536.41 Euro, nga ku shpenzimet për 1 apartament ishin 44,951.15 Euro dhe për zyra 33,585.26 Euro, si numër ambientesh me qira janë 4 (katër) zyra dhe 1 (një) apartament. Struktura e Ambasadës është 1 (Ambasadori) + 2 (Diplomatë). Në prill të vitit 2018 janë larguar dy diplomat dhe ambasada ka funksionuar me strukturë 1+1 deri në shkurt 2021, kur ka vijuar funksionimin vetëm me pozicionin e Ambasadorit.

Nga auditimi rezultoi se, vijojnë të paguhen shpenzimet e qirasë për 4 (katër) zyra, ku në 2 prej tyre janë depozituar mobiljet dhe orenditë e apartamenteve të diplomatëve të larguar e të cilat nuk kryejnë funksionin si zyra, por përdoren në trajtën e magazinave, megjithëse të 4 zyrat ndodhen në një godinë gjë që kërkon një proces të rivlerësimit të vlerës së rentës totale.

- *Përfaqësia Podgoricë:*

Nga auditimi i kontratave të qirasë, për përfaqësinë Podgoricë rezultoi se, për vitin 2021 totali shpenzimeve të qirasë për ambiente banimi ishte 46,800 Euro dhe shpenzimet e qiramarrjes së selisë ishin 25,800 Euro. Në total 72,600 Euro, nga 72,900 Euro të raportuara në evidencat periodike të MEPJ-së, *me një diferencë prej 300 Euro sa raportuar më tepër.*

- *Përfaqësia Londër:*

Audituesit e autorizuar të KLSH nuk arrijnë të verifikojnë vlerën e plotë të shpenzimeve të qirasë dhe qirapagesat për ambiente banimi, për shkak se dokumentacioni i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit është i mangët. Një pjesë e kontratave i përkasin periudhës nga gusht 2021 e në vijim dhe një pjesë i përkasin vitit 2022, për rrjedhojë audituesit shtetëror të autorizuar nuk mund të shprehen me saktësi mbi rregullaritetin e shpenzimeve të kryera.

Referuar evidencave të dërguara në MEPJ, shpenzimet e qiramarrjes së selisë, për vitin 2021 ishin 102,504 £ konvertuar në Euro referuar kursit të cituar në evidenca të konvertimit të 1£ në 1.15 € rezulton shuma 117,879.60 Euro, nga 127,327.70 Euro të raportuara në evidencat dërguar në MEPJ. *Në total një diferencë prej 9,448.1 Euro është e pa mbuluar me dokumentacion*

- *Përfaqësia Vjenë:*

Nga auditimi i kontratave të qirasë, janë vënë në dispozicion 4 nga 5 kontratat e nënshkruara për ambiente banimi, që përfaqësia disponon;

Kontratë është nënshkruar më 30.11.2016 me afat të papërcaktuar; dy pa emra nominal përfituesi kanë nënshkruar në kontratën e lidhur në emër të ambasadorit, me vlerë rente 824 € në muaj.

Kontrata e nënshkruar më 01.03.2017 është me afat të papërcaktuar, me vlerë rente prej 1,297.06 € në muaj;

Nisur nga fakti i mos vënies në dispozicion të audituesve shtetëror të autorizuar, të dokumentacionit të plotë justifikues mbi kontratat e qirasë, kjo ka bërë të pamundur auditimin e vlerës së plotë dhe të saktësisë së zërit të shpenzimeve;

Evidentohet mungesë e gjurmës së auditimit mbi kontratat e lidhura dhe shkallën e përditësimit të informacionit të tyre, në lidhje me kushtet e vijueshmërisë së tyre.

Totali shpenzimeve të qirasë për selinë diplomatike rezultonte në 29,268 Euro nga 28,921.56 Euro të raportuara, me një diferencë prej 346.44 Euro.

- *Përfaqësia Berlin:*

Nga auditimi i kontratave të qirasë dhe qirapagesat për këtë përfaqësi, u konstatua, ekzistenca e një kontrate që i përket një periudhe të mëparshme të nënshkrimit, konkretisht në vitet 2000, kur monedha e përdorur nuk ka qenë Euro, por është nënshkruar për 1,800.04 DM/Marka Gjermane dhe mungesa e informacioneve të përditësuara e bën të pamundur për audituesit shtetëror të autorizuar të arrijnë një konkluzione të bazuar në lidhje me shumat e paguara dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare.

Mosvënia në dispozicion e kontratave të tjera të qirasë, që duhet të ishin pjesë e kësaj dosjeje për auditim), bën të pamundur verifikimin e saktësisë së informacionit zyrtar mbi shpenzimet e qiramarrjes të paguara për selinë diplomatike si dhe llogaritjen e totalit të shpenzimeve. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH jashtë vendit, të merren masa:

- Për të plotësuar praktikat dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm;

- Të kryhet analiza e tregut në vazhdimësi, nëse ka ndryshim në termat e kontratave apo do të lidhen kontrata të reja, shoqëruar me argumentimin shterues për rastet kur pranohet rinovim me rritje rente/norme qiraje mujore/vjetore.

- Në të gjitha rastet të hartohet kopje e dokumentacionit /dublikatë në gjuhën amtare për kontratat e lidhura.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua, *mangësi në procedurat dhe hartimin e gjurmës së auditimit lidhur me lëvizjet e automjeteve.*

Mungesa e një regjistri për dokumentimin e lëvizjeve të automjeteve, bën të vështirë dhe pengon vijimin e verifikimit të lëvizjeve të automjeteve të përfaqësisë, brenda orarit zyrtar (pika 3 e urdhrin nr.507 dt.15.10.2012) si dhe verifikimin e destinacionit të lëvizjeve, sasisë së karburantit të harxhuar, qëllimit të lëvizjes (pika 14 e urdhrin nr. 507 dt.15.10.2012)

- Nga auditimi sa i takon çështjeve të lëvizjes së automjeteve dhe shpenzimeve të transportit, rezultoi mungesa e plotë e gjurmës së komunikimit me Drejtorinë Juridike dhe të Shërbimeve në

MEPJ, veprime jo në përputhje me pikat nr.4 dhe 5, të Urdhrit të Ministrit të Punëve të Jashtme nr.507 datë 15.10.2012. Konkretisht, nga ana e përfaqësive për rastet e pritjeve apo përcjelljeve në aeroporte, porte apo pika të kalimit kufitar, mungon plotësisht kjo gjurmë dokumentare, e tilla si kërkesë dhe procedurë e miratimit të lëvizjes së automjetit, etj.

Mungesë e gjurmës të realizimit të praktikës së furnizimit të automjeteve me karburant, në moszbatim të plotë të pikës nr.11 të Urdhrit nr.507 dt.15.10.2012, konkretisht:

- ✓ mungesë e gjurmës së dokumentimit të bërjes hyrje (në kontabilitet/ në magazinë) të sasisë së karburantit;
- ✓ mungesë e gjurmës së dokumentimit të bërjes dalje shoferëve sipas destinacionit të çdo lëvizje, të shoqëruar me masën e harxhimit të karburantit.

Mungesë e plotë e formularëve bashkangjitur shpenzimeve të transportit. MEPJ mbulon pagesën e karburantit të automjeteve zyrtare për përdorim zyrtar në Mision. Veprime e mosveprime në kundërshtim me aktin përkatës nënligjor të MEPJ, Urdhrit nr.507, datë 15.10.2012, pika 12 e tij, e cila thekson se “shoferët janë të detyruar të plotësojnë formatet shoqëruese nr.1-nr.6 për çdo automjet. Misionet diplomatike duhet të dorëzojnë këto formular me qëllim dokumentimin dhe justifikimin e veprimtarisë së automjeteve nëpër përfaqësi”.

Mungesë e plotë e gjurmës së krijimit nga ana e titullarit të misioneve, të Komisionit që përcakton sasinë efektive të harxhimit të karburantit për 100 km, (brenda dhe jashtë qytetit) për çdo automjet në dispozicion, veprime në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.10 të Urdhrit nr.507, dt.15.10.2012, ku për vitin 2021 nga 22 përfaqësi të përzgjedhura për auditim ka plotësuar këtë dokumentacion të nevojshëm në përputhje me përcaktimet e këtij urdhri vetëm 1 (një) përfaqësi diplomatike, (ajo në Athinë).

Nga auditimi i dokumentacionit të përfaqësive u konstatua në shumicën e rasteve mungesa e dokumentimit dhe e gjurmës së marrjes së automjeteve në dorëzim nga drejtuesit e ngarkuar të mjeteve/ shoferi i përfaqësisë diplomatike.

Për vitin 2021 nga 22 përfaqësi të përzgjedhura për tu audituar dokumentacionin, vetëm 2 prej tyre e kanë plotësuar kriterin e dokumentimit të marrjes së automjetit në ngarkim nga ana e drejtuesve të mjeteve, (përfaqësia në Athinë dhe përfaqësia në Milano). (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30. Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësive të merren masa për të punuar, zbatuar dhe mbikëqyrur me korrektesë Urdhrit nr.507, datë 15.10.2012 të Ministrit të Punëve të Jashtme, duke mbajtur në konsideratë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm autorizues dhe justifikues sipas parashikimeve në bazën ligjore dhe aktet e tjera rregulluese.

- Nga ana e përfaqësive të merren masa që i gjithë dokumentacioni të mbahet në mënyrë kronologjike dhe të plotë me qëllim kjo, verifikimin e përdorimit të sasisë së karburantit të furnizuar në përputhje me kriteret e miradministrimit material, si dhe kryqëzimin e të dhënave midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimeve të plotësuar për lëvizjet e brendshme/ jashtme, duke rakorduar me kilometrat e përshkuara.

- Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merren masa për të kryer procesin e inventarizimit të aseteve që administrohen, me qëllim që në përfundim të procesit, të ngarkohen me procesverbal të rregullt tek personat përgjegjës që i kanë në ngarkim.

31. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit të përfaqësive rezultoi *mungesë e dokumentacionit justifikues lidhur me praktikën e bartjes së sendeve personale të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre ("cargo")*.

Përfaqësuesit dhe personeli diplomatik/ konsullor në nisje/ përfundim të mandatit të tyre në vendin pranues mund të sjellin në vendin pritës/e origjinës sendet personale të tyre. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit diplomatik/konsullor rregullohet nga VKM nr.20, datë 18.01.2017, germa b, e pikës 10, që shpreh se, *"MEPJ mbulon shpenzimet e transportit të sendeve personale të personelit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në momentin e emërimit dhe kthimit në atdhe. Transporti i sendeve dhe orendive personale të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor bëhet me miratimin e MPJ-së, deri në masën 7,5 m³ për anëtar familjeje, pa kaluar limitin e 30 m³ për çdo familje. Prokurimi i fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi"*; (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1. Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të merren masa për të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm justifikues praktikën e bartjes së sendeve personale të përfaqësuesve dhe familjarëve të tyre (*"cargo"*).

- Të vlerësohet rast pas rasti praktika e *cargo-ve* nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes përfaqësisë dhe Drejtorisë së Financës së MEPJ-së,

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, sa i takon zërit *"shpenzime transporti"* . sipas përfaqësive diplomatike të analizuar rezultoi se,

për përfaqësinë Mynih,

- rezultoi se furnizoheshin 3 automjete me karburant ndërkohë që Konsullata në pronësi të saj ka të deklaruar vetëm 1 automjet. (kartat me nr: 700669, 748947, 000031).

- Mosrakovim i vlerave në fatura/dokumentacion justifikues dhe evidencën e dërguar pranë MEPJ.

- Për vitin 2020 nga ana e përfaqësisë është kryer shërbimi i riparimit të automjetit 5 (pesë) herë me një vlerë totale prej 4,285.25 Euro, ku vetëm për një interval një mujor frekuenca e riparimit është në 3 (tre) raste; në asnjë rast nuk u konstatua prania e gjurmës së argumentimit të domosdoshmërisë për kryerjen e shërbimit të riparimit, pra mungon një memo argumentuese e situatës;

për përfaqësinë Pragë:

- disponon 3 automjete në inventar, por nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion evidentohet se shpenzimet e transportit ngarkohen në vetëm 2 prej tyre.

- Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues për shpenzimet e siguracionit të automjeteve, për vitin 2021, praktika për automjetit "Mercedes Benz" përmbante mungesa si më poshtë vijojnë: kartela e siguracionit mungonte; dokumentacioni i vendosur në dispozicion ishte

vetëm një informacion i përgjithshëm për të kryer pagesën; vlera e pa specifikuar po ashtu edhe afati (shkruar me shkrim dore në fletë);

- rezultojnë tre fatura të lëshuara nga Servis Mercedes Benz me vlerë totale 1,497.14 Euro, për të cilat ka mungesë të dokumentacionit justifikues ndaj audituesit shtetërorë nuk arrijnë të vërtetojmë se për cilin automjet janë kryer shërbimet dhe cila është pronësia e tij; si dhe fatura me vlerë 245.8 Euro për të cilën mungon informacioni mbi objektin e pagesës së kryer.

Totali shpenzimeve të mbështetura me dokumentacion justifikues rezultojnë të jetë në vlerën 2,460.23 Euro, nga ku shpenzimet për karburant janë 2,204.32 Euro dhe siguracioni për automjetin BMW është 255.91 Euro. Diferenca prej 3,215.95 Euro përfaqëson shpenzime të kryera pa dokumentacion justifikues mbështetës për të cilat duhet të kryhen analizat përkatëse.

për përfaqësinë Romë:

- Për vitin 2020 në të gjitha rastet nuk janë hartuar e nënshkruari mandatat pagesat,
- Për shpenzimin me vlerë 2,380 Euro, praktikës dokumentare i mungonte shkresa e marrjes së miratimit nga MEPJ, shkresa që përfaqëson ka njoftuar MEPJ-në; si dhe specifikimet teknike të automjetit apo kontratë e blerjes së tij;
- Për shpenzimin me vlerë 1,640 Euro, riparim automjeti Benz me targë CD 081 AA pas aksidentit, praktikës dokumentare i mungonte memo/shkresa njoftuese e titullarit të përfaqësisë po ashtu dhe dokumentacion justifikues i vërtetimit të ngjarjes;
- Për shpenzimin me vlerë 1,327 Euro, riparim i automjetit Audi A6 me targë CD 0141 AA, praktikës dokumentare i mungonte shkresa e marrjes së miratimit nga MEPJ, si dhe memo/shkresa njoftuese e titullarit të përfaqësisë ku detajohet problematika.

për përfaqësinë Madrid:

- nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për vitin 2020 rezultojnë se, për 3 makinat që përfaqëson disponon janë paguar siguracionet vjetore respektive me vlerë totale prej 2,238.2 Euro, por praktikat dokumentare përmbajnë vetëm ekstraktin e llogarisë dhe urdhër pagesën e nxjerrë nga përfaqësia.
- Për automjetin Citroen C1 është kryer shpenzimi me vlerë 50.19 Euro, por praktikës dokumentare i mungon relacioni identifikues i situatës, urdhër i titullarit për blerjen e artikullit, kryerja e testimit të tregut;
- Sa i takon pagesave për karburant, për muajit shkurt dhe tetor, mungonin faturat justifikuese me vlerë 193.47 Euro;
- Në total shpenzimet e transportit referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion shkojnë 3,460.83 Euro nga 3,601 të raportuara, pra një diferencë e pambuluar me dokumentacion prej 140.17 Euro.

për përfaqësinë Uashington:

- për vitin 2020, rezultoi se në asnjë rast pagesat nuk janë shoqëruar me mandate pagesë por vetëm nga fatura;
- Referuar të dhënave vendosur në dispozicion të misionit të auditimit, kjo përfaqësi disponon 2 automjete ndërkohë nga auditimi i dokumentacionit justifikues rezultojnë prania e 4 automjeteve (referuar pagesave kryer në *Sahouri Insurance*: Chevrolet Captiva; Dodge dart; Cadillac XTS, Mitsubishi Outlander);

për përfaqësinë Tel Aviv:

- Nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 rezultoi se, referuar kursit mesatar të këmbimit (Shekel/Dollar), 1 Shekel konvertohej mesatarisht në 0.2909 Dollar, dhe totali rezultonte në 3,735.16 Dollar nga 3,866 Dollar raportuar, me një diferencë prej 130.84 Dollar më tepër nga sa rezulton nga dokumentacioni justifikues.

për përfaqësinë Moskë:

- nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 rezultoi se, në të gjitha rastet mungonte hartimi i mandat pagesës,

- Të gjitha dokumentacionet janë në gjuhën Ruse pa patur dublikatë në gjuhën Shqipe çka cenon kuptueshmërinë dhe transparencën e tyre; *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave. Ky dokumentacion duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Per MFK”, i ndryshuar i cili specifikon se ... *“Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. ...”,* si dhe kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2

- MEPJ të marrë masa për të kryer analizimin e faturave dhe pagesave të kryera në vlerën prej 4,285.25 Euro, argumentimin e nevojave dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.

32.2. Rekomandimi:

- Nga ana e MEPJ-së në bashkëpunim me përfaqësinë Pragë të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës totale prej 4,958.89 Euro (detajuar si në gjetje);

32.3. Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë Romë të merren masa për të kryer verifikimin e vlerës prej 2,380 Euro;

32.4. Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë Madrid të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej 2,481.86 Euro;

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi është konstatuar se, përfaqësia diplomatike në Londër operon me 4 llogari bankare të hapura tek “M. B.”, ku prej përfaqësisë është dhënë informacion si më poshtë vijon:

- Llogaria 976 në Euro përfaqëson llogarinë për MEPJ, kjo llogari pret të gjitha furnizimet nga MEPJ.

- Llogaria 641 në GBP përfaqëson llogarinë e ambasadës, kjo llogari kryen të gjitha shpenzimet operative të Ambasadës.

- Llogaria 749 në GBP përfaqëson llogarinë e konsullatës ku hyrjet janë arkëtimet e të ardhurave të krijuara nga shtetasit Shqiptarë për të gjitha produktet së bashku, shitja e ID, pasaportave, pullave, prokurave, përkthimeve. Daljet e kësaj llogarie janë ajo pjesë e të ardhurave të krijuara vetëm nga ID dhe Pasaportat, dhe këto likuiditete hyjnë tek llogaria 684 e "A"- it.

- Llogaria 684 në GBP përfaqëson llogarinë e "A", e cila pret hyrjet e të ardhurave nga Llogaria 749 e Konsullatës vetëm për ID dhe pasaporta dhe daljet e kësaj llogarie janë detyrimet ndaj këtij subjekti. Nga kjo llogari bëhen edhe shpenzime të tjera si pagat e operatoreve dhe shpenzime kancelarie.

Grupi auditimit gjykon si me risk të lart mbajtjen e 4 llogarive të ndryshme bankare, ku veç të tjerash duhet theksuar se janë në 2 monedha të ndryshme e kjo sjell impakt të konsiderueshëm nga kursi këmbimit në konvertim.

- Nga auditimi u konstatua problematika e konvertimit të monedhës.

✓ Për periudhën objekt auditimi mungon hartimi i gjurmës sa i takon procesit të konvertimit të monedhës për llogari të buxheteve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për të parashikuar rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, nga fillimi deri në përfundim të tyre, me synimin që ajo të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

✓ Aktualisht, nga ana e përfaqësive operohet në disa lloj monedhash, në varësi kjo të vendndodhjes ku është e dislokuar përfaqësia.

✓ Impakti më i madh krijohet nga përfaqësia Londër, kjo për shkak edhe të faktit të mbajtjes së 4 llogarive si më lartë cituar.

✓ Humbja e krijuar nga kursi këmbimit është në vlera relativisht të konsiderueshme konkretisht për vitin 2020 është 4,540.55 Euro dhe 342.95 Dollar, dhe për vitin 2021 është 5,294.43 Euro dhe 1,731.35 Dollar. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1 Rekomandimi:

- Nisur nga risku i lartë që mbart mbajtja e 4 llogarive të ndryshme bankare, (në 2 monedha të ndryshme), e kjo sjell impakt të konsiderueshëm nga kursi i këmbimit në konvertim, mundësi të larta për humbje nga kursi këmbimit, të merren masat për të rishikuar mbajtjen e vetëm 2 llogarive bankare sipas monedhave respektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi dokumentacioni i magazinës nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore nuk mbahej i plotë.

- Mungon gjurma e ngarkimit të detyrës së magazinës me një akt administrativ (urdhër titullari).

- Regjistrimi dhe lëvizja e aktiveve që qarkullojnë nuk kryhet në libër magazine. Plotësohen në mënyrë rastësore dokumente të tilla si fletë hyrje dhe fletë dalje, etj.

- Për dokumentimin e aktiveve të blera, vetëm në disa raste është operuar duke prerë fletë hyrje të magazinës, etj. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1 Rekomandimi:

- Nga ana e secilës përfaqësi të merren masa për zbatimin e kuadrit të normave mbi mirëmenaxhimin material të magazinës, kryerjes së inventarizimit të saj periodik si dhe hartimin e kartelave personale të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion (*kartela inventar, fletë inventari, regjistra*) rezultoi se është operuar në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi inventarët u konstatua se,

- Në të gjitha rastet, vlera ekonomike e aktiveve përfaqëson çmimin e blerjes, për të cilat nuk është llogaritur amortizim dhe vlera e mbetur aseteve të përfaqësisë;

- Në të gjitha rastet: mungonte gjurma e pasqyrimit të inventarëve në evidencat përmbledhëse të përfaqësisë; investimet e kryera nuk janë pasqyruar si pjesë e inventarit të vitit në të cilin kryhen; mungon një informacion përmbledhës apo një relacion në fund të përfundimit të procedurave të inventarizimit të pasurisë;

- Për vitin 2021, në 6 raste kishte mungesë të plotë inventari për apartamentet e banimit (*Madrid, Mynih, Berlin, Londër, Vjenë dhe Podgoricë*);

- Për vitin 2021, në 6 raste kishte pasqyrim pjesor të inventarëve për ambientet e banimit (*Milano, Athinë, Selanik, Pekin, Neë york, Romë*), ku për përfaqësinë Berlin dhe Londër ishte fenomen ky i mbartur nga 2020;

- Për vitin 2021, në 5 raste mungonte totalisht gjurma për inventarë zyre apo banimi (*Paris, Izrael*) ndërkohë që mungonte edhe për vitin 2020 në përfaqësitë Bruksel, Moskë dhe Pragë);

- Për vitin 2021, në 2 raste kishte pasqyrim pjesor të inventarëve për zyra (*Berlin, Londër*) fenomen i mbartur nga 2020;

- Në rastin e përfaqësisë Podgoricë të gjithë artikujt pjesë e inventarit janë të pasqyruar pa vlerë ekonomike të përcaktuar;

- Në 2 raste inventari është pasqyruar si kartelë pa ekstremitete, nënshkrim të personave dhe datë, (*Madrid dhe New York*);

- Në 4 raste nuk ka gjurmë të ngritjes së komisionit të inventarizimit nga ana e Titullarit (*Milano, Romë, Londër dhe Uashington*);

- Në 6 raste mungon gjurma e inventarit të zyrave A (*Mynih 1 zyrë, Athinë 16 zyra, Selanik 4 zyra, Neë York 1 zyrë, Romë 3 zyra dhe Londër 2 zyra*) fenomen i mbartur nga 2020;

- Në rastin e përfaqësisë Izrael, u konstatua se, nëse krahasojmë vlerat e totalit të fletëve të inventarit dhe vlerat e totalit të bllokut të inventarit të përfaqësisë rezultonte diferencë në artikuj dhe vlerë prej 35 artikuj më tepër në bllokun e inventarit të përfaqësisë dhe 45,018.84 Dollar në vlerë mungesë e inventarit të ambienteve të banimit për përfaqësuesit;

- Aktivitet e blera nuk janë shtuar në asnjë rast në inventar,

- Sa i takon nxjerrjeve jashtë përdorimit nuk ka gjurmë të dokumentimit të procesit në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2012 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar pikat 5, 35 të tij.

- Në rastin e *përfaqësisë Athinë*, u konstatua rasti i përcaktimit të 5 artikujve për nxjerrje jashtë përdorimit me vlerë 19,034.29 Euro, por pa evidence justifikuese.

- Referuar inventarizimit të fundit (viti 2021) të kryer nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se,

Në përfaqësinë tonë në New York,

- Kartela e aktiveve të Zyrës (në formë regjistri) përmbante 70 artikuj, me vlerë 7,794.47 USD. U konstatuan pjesë të inventarit edhe produkte personale me vlerë 298.86 USD. Në të specifikohet se 26 artikuj ishin vlerësuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit, por mungonte gjurma e relacionit dhe vlerësimit të komisionit. Gjithashtu kartela e inventarëve ishte pa ekstremitete

- Kartela e aktiveve të banesës (në formë regjistri) përmbante 51 artikuj, me vlerë 7,756.38 USD. U konstatuan pjesë të inventarit edhe produkte personale me vlerë 135.57 USD. Në të specifikohet se 11 artikuj ishin vlerësuar nga komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit, por mungonte gjurma e relacionit dhe e vlerësimit të komisionit. Gjithashtu kartela e inventarëve ishte pa ekstremitete (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

35.1. Rekomandimi:

Për shkak të ndjeshmërisë së lartë të vlerave të aktiveve qarkulluese, nga ana e secilës përfaqësie diplomatike dhe konsullore të merren masa për mirë menaxhimin e këtyre zërave të pronës shtetërore dhe kryerjen e procesit të rregullt të inventarizimit të tyre.

- Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i MEPJ-së në bashkëpunim me titullarët e përfaqësive të marrin masa të kryejnë procesin e inventarizimit të aktiveve dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

- Të merren masa për të kryer evidentim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.

- Të merren masa për aktivet që janë për dalje jashtë përdorimit të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar *procesin e vlerësimit të aktiveve* të propozuara për dalje nga përdorimi; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

- Të merren masa për të shmangur kryerjen e shpenzimeve personale me paratë publike dhe përfshirjen e tyre në inventarët e njësisë;

- Në rastin e përfaqësisë Izrael, të merren masa për sistemim të diferencave dhe nxirret përgjegjësia për to sikundër trajtuar në material.

Menjëherë

36. Gjetje nga auditimi:

- Rezultojnë 21 (*njëzetë e një*) vende/*pozicione vakante* në strukturën e MEPJ, për të cilat nuk disponohet asnjë dokument justifikues për të filluar procedurat e rekrutimit dhe plotësimit të vendeve. Ndër këto, Sektori i Çështjeve Tematik i planifikuar me një strukturë 1+3 (aktualisht kthyer në drejtori 1+4), rezulton i plotësuar vetëm me një punonjës;

- 4 (katër) prej punonjësve të rekrutuar përgjatë periudhës Janar 2020-Shtator 2022 në sistemin e karrierës diplomatike, rezultojnë të dërguar në misione diplomatike. Procedura për dërgimin e tyre në misione diplomatike është kryer me anë të njoftimit nëpërmjet postës elektronike nga DBNj drejtuar vetëm stafit të MEPJ, duke përjashtuar në këtë mënyrë personelin e pozicionuar në misione diplomatike apo poste konsullore, të cilët gjithashtu mund të shprehin interesin për pozicionet e krijuara. Pas përcjelljes së kërkesave nga punonjësit e interesuar, DBNj përmbledh në formë tabelare të gjithë informacionin e detajuar mbi secilin prej tyre. Nuk administrohet asnjë gjurmë auditi/dokumentare lidhur me vendimmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm, në cilësinë e strukturës vlerësuese dhe përzgjedhëse të kandidaturave dhe paraqitjen pranë Ministrisë për miratim, në kundërshtim me pikën 5 dhe 6, Kreu VII, VKM nr. 816/2015;

-Për 12 (dymbëdhjetë) punonjës të rekrutuar, procedura për përfitimin gradës “Atashe”, ka filluar për një periudhë mbi një muaj më vonë se përfundimi i periudhës së provës, duke mos respektuar afatin jo më vonë se një muaj përpara përfundimit të provës, në kundërshtim me shkronjën d), pika 2, Seksioni 2, VKM 816\2015;

-Nga auditimi me zgjedhje, rezultojnë se në strukturën e MEPJ, 3 (tre) pozicione janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave, veprime në kundërshtim me pikën 3), neni 39, Ligji Nr. 23/2015. (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1. Rekomandimi:

- Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e vakancave të krijuara në stafin e institucionit dhe shërbimin e jashtëm.

- Për të gjitha lëvizjet e reja nga pozicione në strukturën e MEPJ drejt misioneve diplomatike apo posteve konsullore të ndiqet me korrektesë procedura e parashikuar sipas kuadrit ligjor në fuqi.

- Strukturat përkatëse në MEPJ të organizohen dhe koordinohen në mënyrë që në vijim vendimet e KKD, të eprorit direkt dhe të strukturës trajnuese, për përfitimin e gradës “Atashe” të përcillen pranë Ministrisë jo më vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës.

- Të merren masa për zëvendësimin e punonjësve në tre pozicionet në të cilat janë emëruar punonjës ku grada diplomatike personale nuk ju përputhet me gradën diplomatike sipas hierarkisë së gradave.

Menjëherë dhe vijimësi

37. Gjetje nga auditimi:

- Përgjatë periudhës tre vjeçare 2020-2022, MEPJ nuk ka të miratuar planin vjetor të emërimeve/mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore nga Ministria, në cilësinë e personit përgjegjës për këtë vendimmarrje, në kundërshtim me parashikimet e Kreu VII, të VKM nr. 816/2015 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të RSH”;

-Nga auditimi me zgjedhje, konstatohet se 64 (gjashtëdhjetë e katër) anëtarë të personelit të misioneve diplomatike kanë vijuar të mbajnë poste pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore edhe pse ka përfunduar afati 3 vjeçar, në kundërshtim me pikën 2, neni 41, ligji Nr. 23/2015.

25 (njëzetë e pesë) prej tyre janë në pozicionin e Kreut të Misionit Diplomatik/poste Konsullore, në kundërshtim me pikën 5, neni 26, Ligji 23/2015, që shpreh se “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

-Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se 1 (një) ambasadë drejtohej nga diplomat me gradë personale “Sekretar i Tretë”, i emëruar në pozicionin “I ngarkuar me punë”, në cilësinë e Kreut të Misionit, duke qenë se ky mision në atë kohë ndodhej në kushtet e mungesës së përkohshme të kreut të misionit, e si rrjedhojë jo detyrimisht duhet që i ngarkuari me punë të ketë *gradën jo më pak se “Këshilltar”*. Këtë detyrë vijon ta ushtroj edhe aktualisht, pra afërsisht për një periudhë 2 vjet e tre muaj. Në kuptim të nenit 26, të ligjit nr. 23/2015, procedura e drejtimit të misionit diplomatik i kalojnë si rregull diplomatit me gradën më të lartë, me përjashtim të rasteve të veçanta ku lejohen edhe me gradë më të ulët se “Këshilltar”, përkatësisht në rastet e mungesës së përkohshme të kreut të misionit. Duke mbajtur në konsideratë këtë dispozitë dhe faktin se nuk është ndërmarrë asnjë procedurë për emërimin në këtë pozicion të diplomatëve me gradën përkatëse, (në rastin konkret, për këtë pozicion kanë kaluar afërsisht 2 vjet e tre muaj, kjo nuk mund të konsiderohet dhe/apo të përbëjë shkak që kjo të konsiderohet si fazë e përkohshme), duke bërë që misioni diplomatik, të drejtohet në kundërshtim me pikën 1, neni 27, ligji Nr. 23/2015; (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

37.1. Rekomandimi:

- Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për miratimin e strukturave të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, si dhe për çdo rast për përcaktimin e numrit të personelit në këto struktura të lidhë marrëveshjet me shtetet pritëse.
- Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme, që për çdo vit të miratojë plane vjetore të emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore.

37.2. Rekomandimi:

- Të merren masa për largimin nga pozicionet e emërimit dhe heqjen e statusit të diplomatit të personelit të misioneve diplomatike, të cilët vijnë të kryejnë funksione diplomatike edhe pse kanë mbushur moshën e pensionit. Të merren masa për largimin nga pozicioni i emërimit për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit në MEPJ.
- Të merren masa për zëvendësimin nga postet pranë misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, për 64 (gjashtëdhjetë e katër) anëtarët e personelit të misioneve diplomatike apo poste konsullore të cilët vijnë të mbajnë këto poste edhe pasi ka përfunduar afati 3 vjeçar.
- Të merren masa për zëvendësimin nga detyra si Kreu i Misionit Diplomatik, të diplomatit me gradë personale “Sekretar i Tretë”, i emëruar në pozicionin i ngarkuar me punë a.i, i cili vijon ta ushtroj këtë detyrë vijon për një periudhë mbi 2 vjet.

37.3. Rekomandimi:

- Të ngrihet grup pune me qëllim verifikimin nëse 28 (njëzetë e tetë) punonjësit e emëruar si raste të veçanta, ekspertë jashtë Shërbimit të Jashtëm, zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit. Në varësi të përfundimit të arritur prej grupit të merren masa për qëndrimin e mëtejshëm të tyre në atë pozicion apo largimin e tyre.
- Të merren masa për largimin nga pozicionet e punës së 64 (gjashtëdhjetë e katër) diplomatëve të cilët punojnë pranë misioneve diplomatike dhe nuk ju përputhet grada emërore me gradën personale dhe vendosjen në pozicione të tjera pune në të cilat ju përputhet grada emërore me gradën personale.

Menjëherë dhe vijimësi

38. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i praktikës së ndjekur nga Komisioni i Karrierës Diplomatike për vitin 2021, lidhur me vlerësimin etiko-profesional të punonjësve të rekrutuar në sistemin e karrierës diplomatike, si dhe mënyrën e organizimit dhe procedurat e ndjekura nga KKD, nga shqyrtimi i dosjeve të vëna në dispozicion të auditimit u konstatua se: mbledhja e Komisionit të Karrierës Diplomatike (KKD) është realizuar në të gjitha rastet e punonjësve të rekrutuar me vonesë dhe në mospërputhje me parashikimet e shkronjës d, pika 2, Seksioni 2, VKM 816/2015.

- Gjatë mbledhjes së datës 16.07.2021, KKD e mbledhur në zbatim të urdhrin nr. 300, datë 8.7.2021 të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, pas shqyrtimit të plotësimit të kriterëve ligjore, ndër të tjera ka vendosur për ti propozuar Ministrit dhënien e gradës “Ambasador” dhe propozimin nga kjo e fundit të Presidentit të Republikës me qëllim dhënien e gradës “Ambasador” për 4 (katër) diplomatë karriere. Procesverbali i është përcjellë Ministres me anë të Memorandumit për vendimmarrje nr. 227 prot., datë 19.07.2021.

Nga ana e Ministrit nuk rezulton të jetë marrë asnjë vendimmarrje lidhur me propozimet e kryera brenda afatit ligjore tre ditor. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

38.1 Rekomandimi:

- Komisionit të Karrierës Diplomatike, të marrë masa për të zhvilluar mbledhjet brenda afateve ligjore dhe pa vonesa, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për shërbimin e jashtëm.

- Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për vendimmarrje dhe përcjelljen pranë Presidentit të Republikës, me qëllim dhënien e gradës “Ambasador” për 4 (katër) diplomatët e karrierës për të cilët është shprehur Komisioni i Karrierës Diplomatike (KKD).

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se ka një tejkalim të tavanit buxhetor në lidhje me financimin e huaj. Kjo ka ardhur për shkak se kërkesa shtesë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për një korigjim të tavanit buxhetor nuk është miratuar gjatë fazës së hartimit të buxhetit për vitin 2021 dhe realizimit të projekteve me asistencë të huaj gjatë të gjithë vitit 2021, veprime jo në përputhje me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, VKM nr. 440, datë 09.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”.

- Nga auditimi u konstatua se kërkesat për fonde shtesë për të siguruar vijueshmërinë normale të aktivitetit të programit 01150 “Mbështetja institucionale në procesin e integritit” në vitin 2021 nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, si rezultat i mos argumentimit/ justifikimit siç duhet i tyre nga ana e MEPJ, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, VKM nr. 440, datë 09.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”, Udhëzimin nr. 19, dt. 09.07.2021, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” *(Trajtuar më hollësisht në faqe 27-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

39.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa për planifikim dhe shpërndarjen e fondeve buxhetor në kohën e duhur dhe sipas prioriteteve të projekteve në kuadër të mbështetjes për Shqipërinë dhe forcimin e rolit të saj në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian si dhe shmangien e vonesave në implementimin e projekteve.

Në vijimësi

40. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MEPJ, për përmirësimin e strukturës dhe të metodave të punës të përfaqësive diplomatike dhe konsullore në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj të gjithë personave të interesuar, ka hapur 4 qendra konsullore në Ulqin, Strugë, Guanzhou dhe në Liban, por që nuk janë bërë efektive për mungesë të fondeve financiare. Mos bërja efektive e katër posteve konsullore të mësipërme tregon mos koordinim të politikës së jashtme të MEPJ me Qeverinë Shqiptare, veprime jo në përputhje me VKM nr. 735, date 03.12.2021 “Për miratimin e Projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesmes 2022-2024” dhe Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 09.07.2021 “Për Përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 27-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

40.1. Rekomandimi:

Nga ana e MEPJ-së të merren masa që në çdo rast, përpara inicimit të një procesi zgjerimi apo shtimi në poste konsullore apo të stafit në postet ekzistuese duke miratuar dhe fondet përkatëse, të merren masat për koordinimin e politikës së jashtme të ndërmarr nga MEPJ dhe Qeveria Shqiptare me qëllim mbarëvajtjen e saj.

Në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje e vogël “*Punime ndërtimi në funksion të ashensorit*” , sipas ftesës për ofertë afati i lëvrimit të mallrave, punëve ose shërbimeve do të jetë brenda 20 ditësh. Nga verifikimi i realizimit të procedurës u konstatua se realizimi i saj është kryer rreth 3 muaj me vonesë ose 100 ditë me vonesë nga ftesa për ofertë që kjo procedurë duhet të realizohej (brenda 20 ditësh). Edhe pse me vonesa nga AK nuk është përlllogaritur penaliteti për OE “I shpk”. Sipas përlllogaritjeve të bëra nga audituesit e autorizuar të KLSH rezultojnë se vlera e penaltetit arrin në 864,000 lek x 4/1000 x 100 ditë = **345,600 lekë penaltitet i pa mbajtur**. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 179-282 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi:

MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej **345,600 lekë** si penaltitet i pa mbajtur ndaj kontraktorit “T” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë, në kundërshtim me parashikimet e dokumenteve të tenderit.

Deri më 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje e vogël “*Heqja e ashensorit dhe përgatitja e strukturës mbajtëse*” sipas ftesës për ofertë afati i livrimit të mallrave, punëve ose shërbimeve do të jetë brenda 20 ditësh. Nga verifikimi i realizimit të procedurës u konstatua se realizimi i saj është kryer rreth 3 muaj me vonesë (ose 100 ditë me vonesë nga ftesa për ofertë që kjo procedurë

duhet të realizohet). Nga ana e AK nuk është përlogaritur vlera e penalitetit për OE “I shpk”, që referuar përlogaritjeve të bëra nga audituesit e autorizuar të KLSH rezultojnë: 732,000 lek x 4/1000 x 100 ditë = **292,800 lekë penalitet** i pa mbajtur. (Trajtuar më hollësisht në faqe 179-282 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi:

MEPJ të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej **292,800 lekë** për penalitet të pa mbajtur kontraktorit “I” SHPK për kryerje punimesh me 100 ditë vonesë.

Deri më 31.12.2023

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedura e prokurimit me nr. 3 prot datë 22.01.2020 “Blerje shërbim riparim telefonie”, realizuar me procedurë emergjente, u konstatua se kjo procedurë është realizuar 20 ditë pas likuidimit të kontratës të kontratës së vitit 2019 datë 25.03.2019 “Shërbime në funksion të mirëmbajtjes së centralit telefonik, shtesa license, përshtatje sistemi” me të njëjtin operator fitues “C.P”, gjithashtu për kryerjen e kësaj procedure emergjente nuk kemi asnjë kërkesë të tillë, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 8; 8. Vlera prej **117,600 lekë** e likuiduar për këtë procedurë konsiderohet dëm ekonomik dhe do të dëm shpërblehet nga përfituesi ‘C.P’. (Trajtuar më hollësisht në faqe 179-282 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi:

MEPJ të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “C.P”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **117,600 lekë**.

Deri më 31.12.2023

D. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje i kryer mbi dokumentacionin e përfaqësisë Madrid u konstatua problematika si më poshtë vijon:

Nga ana e drejtorisë së Auditit të Brendshëm të MEPJ-së me programin nr.54 prot, datë 24.05.2022 është audituar përputhshmëria dhe performanca ekonomiko-financiare e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, (pjesë e strukturës organizative të MEPJ-së). Referuar materialit të grupit të audit të brendshëm konstatohet se: “...Aktualisht nga ana e titullarit të Institucionit nuk është nxjerr asnjë urdhër/ nuk është ndërmarr asnjë nisëm për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës. Ku impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën 5,784.42 Euro”.

(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim:

Nga ana e DAB të MEPJ-së të merren masa për të risjellë në vëmendje të titullarit të institucionit, nevojën për të ndërmarrë nismën për ekzekutimin e masave të lëna nga ana e grupit të auditit të

brendshëm lidhur me raportin e lënë në përfaqësinë Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, ku impakti financiar në dëm të buxhetit të përfaqësisë Madrid është në vlerën **5,784.42 Euro**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat MEPJ është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të KLSH konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë dëmshpërblyer 8 ish punonjësit të larguar padrejtësisht nga puna, të cilat kanë paditur MEPJ në Gjykatë dhe kanë marrë dëmshpërblimin në shumën prej **25,267,377 lekë**, si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore (*Trajtuar më hollësisht në faqe 27-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi:

Nga Drejtoria Juridike dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të MEPJ të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shpërblyes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zërit “*shpenzime transporti*” për përfaqësinë tonë diplomatike në Paris, e cila posedonte vetëm 1 automjet, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se, Për të dy vitet 2020-2021 nga analiza e të dhënave, në varësi të llojit të karburantit të blerë, rezultojnë të jenë furnizuar me karburant më tepër se 1 makinë, (të paktën 2 apo më tepër).

- Për vitin 2020 përfaqësia diplomatike totalin e shpenzimeve për karburant dhe vaj për autovetura e kishte 4,827.07 Euro, por në këtë shpenzim total, u konstatua se nuk është blerë vetëm “Naftë” për makinën zyrtare, por edhe benzinë.

- Për vitin 2021 totali shpenzimeve për karburant dhe vaj rezultojnë të jetë 5,320.13 Euro, por në këtë total u konstatua se nuk është blerë vetëm “Naftë” për makinën zyrtare por edhe benzinë.

- Fatura prej 457.84 Euro, për kryerjen e shërbimit të automjetit (*ferrota, disk, paketa etj*) nuk rezultojnë të jetë shpenzuar për makinën zyrtare të përfaqësisë.

(*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën prej **10,147.2 Euro** dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2.

- Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon zëri 'shpenzime transporti' për përfaqësinë BE-Bruksel, e cila posedonte 3 automjete funksionale, nga auditimi dokumentacionit (faturat e karburantit), të vendosura në dispozicion të KLSH u konstatua se,

- Praktika dokumentare ishte me mangësi, në dosje rezultonin të dhëna vetëm për 2 nga automjetet e përfaqësisë dhe fletë udhëtimet vetëm për disa muaj;
- Në të gjitha rastet mungonte praktika e plotë me specifikim të destinacionit/ itinerarit, arsyes së lëvizjes dhe personit udhëtues;

- Në të gjitha rastet mungonin urdhër pagesat dhe faturat e karburantit;

Nga auditimi praktikës mbi karburantin e vendosur në dispozicion u konstatua se,

- Rezulton një diferencë prej 619.91 Euro e raportuar më tepër dhe pa dokumentacion justifikues;

- Nga faturat bashkangjitur rezultonte furnizim për vetëm 2 automjete dhe vetëm për disa muaj,

Faturat ishin jo të plota si më poshtë vijon:

- Për pagesën 60.45 Euro karburant për automjetin CD AL 088 në praktikën dokumentare rezultonte bashkangjitur fatura për automjetin me targë CD AC 145

- Për pagesën 66.66 Euro karburant për automjetin CD AL 088 në praktikën dokumentare rezultonte bashkangjitur fatura për automjetin me targë CD AC 145 me vlerë 83.28.

Për vitin 2020

- Në të gjithë rastet urdhër pagesat janë pa vlerë ekonomike të specifikuar;

- Sa i takon furnizimit me karburant për 5 raste me vlerë totale prej 394.48 Euro rezulton se nëpërmjet dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk arrijmë të sigurojmë informacion se për cilat automjete është marr ky karburant.

Për shpenzime transporti për vitin 2021 me vlerë totale 6,762.23 Euro rezultuan mos rakordime në dokumentacionin e administruar.

- shpenzime për karburant dhe vaj, totali i raportuar është 1,323.33 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 703.42 Euro

- shpenzime për pjesë këmbimi, goma, bateri totali i raportuar është 2,482.80 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 0 Euro

- shpenzime për sigurim të mjeteve të transportit totali i raportuar është 2,956.10 Euro dhe sipas dokumentacionit justifikues rezulton 4,613.15 Euro

Në total shpenzime transporti sipas dokumentacionit justifikues rezultojnë të jenë 5,316.57 Euro, pra 1,445.66 Euro më pak nga sa janë raportuar;

- Për vitin 2020, në të gjithë rastet urdhër pagesat janë pa vlerë ekonomike të specifikuar; Sa i takon furnizimit me karburant për 5 raste me vlerë totale prej 394.48 Euro rezulton se nëpërmjet dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk arrijmë të sigurojmë informacion se për cilat automjete është marr ky karburant (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej **2,065.57 Euro** dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2.

- Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi “shpenzimet e transportit” për përfaqësinë diplomatike në Athinë, u konstatua se:

- Referuar të dhënave vendosur në dispozicion kjo përfaqësi disponon 2 automjete, ndërkohë nga auditimi i dokumentacionit rezultojnë prania e 4 automjeteve (CD 54, CD 54-1, CD 54-2, CD 54-27) dhe ku automjeti me targë 54 27 është automjet personal i ambasadores;
- Për 18 ngjarje me vlerë ekonomike 651.72 Euro që përfaqësojnë larje automjete dhe taksa rruge, mungon dokumentacioni justifikues i përdorur për të dokumentuar veprimtaritë/ ngjarjet, por rezultonte vetëm urdhër pagesa e nënshkruar
- Sa i takon pagesës së vlerës 280 Euro që përfaqëson *servis automjeti* për automjetin me targë CD 54-27 që është automjeti personal i titullarit të përfaqësisë dhe pagesa e tij është kryer nga buxheti i përfaqësisë gjykojmë nevojën e verifikimit të vlerës, pasi vetë përfaqësia ka 2 automjete në pronësi të cilat mund të përdoren për përmbushje të nevojave të përfaqësuesve referuar edhe VKM nr.20 datë 18.01.2017 “Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej **931.72 Euro** si dhe të operohet duke mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, si dhe të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2.
- Nga ana e MEPJ të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës për të saktësuar vlerën e mësipërme si dhe për të identifikuar destinacionin e shpenzimeve të kryera nga kjo përfaqësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua mungesë e:

- Gjurmës rregullatore lidhur me shpenzimet e transportit publik të stafit të Misionit Diplomantik dhe Konsullor për vajtje – ardhjet në punë (New York) si dhe përdorimit të taksive.
- Gjurmës së argumentimit të nevojës për kryerje të udhëtimit, si dhe më tej mungesë e gjurmës së kërkimit/miratimit të kryerjes së udhëtimit (përgjashtimisht përfaqësia Podgoricë)

v.2021

-Sa i takon zërit “shpenzime udhëtimi” për përfaqësinë diplomatike në Mynih, nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se, në të gjitha rastet lëvizjet janë pa destinacion të përcaktuar, pa arsye të lëvizjes (ato që janë jashtë qytetit pa një agjendë /protokoll apo dokument tjetër justifikues), pa përcaktuar personin udhëtues, etj.

- Sa i takon zërit “shpenzime udhëtimi” për përfaqësinë Athinë, nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se, për shpenzime udhëtimi

Tunizi/kredencialet me vlerë totale 2,509.08/1,263.91 Euro rezulton mbuluar me dokumentacion justifikues vetëm vlera prej 978.09 Euro për Tunizi, diferenca prej 2,509.08 Euro për shpenzime udhëtimi dhe 285.82 Euro rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues.

-Sa i takon zërit “shpenzime udhëtimi” për përfaqësinë BE - Bruksel, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2021 u konstatua se, nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se në 18 Urdhër Pagesa, vetëm 3 ishin të nënshkruara nga personi i ngarkuar me financën dhe vetëm në 2 raste ishte përcaktuar vlera për pagesë.

- Sa i takon faturës me vlerë 607.31 Euro, rezulton prania e dokumentacionit justifikues vetëm për pagesën e parkimit prej 6.40 Euro dhe diferenca prej 600.91 Euro rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues;

- Sa i takon pagesës prej 395.48 Euro mungon fatura, nga auditimi nuk konstatohet gjurmë e agjendës së veprimtarisë apo argumentim i vizitës;

- Sa i takon pagesës prej 81.88 Euro mungon fatura, ka gjurmë rezervimi në booking i cili është fotokopje e pjeshme;

v.2020

Sa i takon zërit “shpenzime udhëtimi” për përfaqësinë Berlin, nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, në të gjitha rastet praktikat dokumentare të shpenzimeve të udhëtimit me vlerë totale prej 3,895.02 Euro, ishin pjesore, pa agjenda apo memo shoqëruese/argumentuese të veprimtarisë dhe qëllimin e lëvizjes.

Sa i takon zërit “shpenzime udhëtimi” për përfaqësinë Londër, nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se, shpenzimet e udhëtimit janë kryer për 4 procedura ku:

- 3 nga të cilat rezultojnë të paplota, udhëtimi i Ambasadorit për në Shqipëri nuk ka dokumentacion justifikues mbështetës për transaksionet financiare, mungon gjurma justifikuese e ngjarjes për vlerën e paguar prej 343.66 Paund Britanik (bileta);

- Vlera për ri prerje të biletës për shkak të anulimit të fluturimeve për arsye Covid 19 prej 501.66 Paund Britanik nuk ka dokumentacion justifikues mbështetës për transaksionet financiare, mungon gjurma justifikuese e ngjarjes për vlerën e paguar (bileta);

- Pagesa prej 227.16 Paund Britanik për shpenzime diete në Irlandë nuk ka gjurmë dokumentare, praktika justifikuese mban informacion vetëm për dy fatura për taxi me vlerë 124.95 Euro;

- Vlera totale rezulton 1,331.25 Paund Britanik e pambështetur në dokumentacion justifikues.

Sa i takon zërit “shpenzime udhëtimi” për përfaqësinë Madrid, nga auditimi dokumentacionit vendosur në dispozicion, për vitin 2020 u konstatua se,

Me Mandat Pagesë nr.16 datë 05.11.2020 janë paguar shpenzime udhëtimi dhe diete për Ambasadorin me vlerë 80.15 Euro, (aktivitet në Galicia). Për dy pagesa të tjera me vlerë totale 225.01 Euro praktika dokumentare e mangët si më poshtë vijon:

- Fletë shërbimi-udhëtimi për titullarin e përfaqësisë shërbim në Barcelonë, vlera totale e dietës 50 Euro dhe fatura e hotelit 125.01 Euro.

- Praktika dokumentare është pjesore, mungon agjenda apo memoja shoqëruese argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë me qëllim verifikimin e lëvizjes;

- Pa nxjerrje të urdhër pagesës për procedim të mëtejshëm të transaksioneve financiare

- Fletë shërbimi – udhëtimi për titullarin e përfaqësisë shërbim në Santiago de Compostela, vlera totale e dietës 50.

- Praktika dokumentare pjesore, pa agjenda apo memo shoqëruese argumentuese të veprimtarisë ku po merr pjesë me qëllim verifikimin e lëvizjes;

- Pa nxjerrje të urdhër pagesës për procedim të mëtejshëm të transaksioneve financiare.

Për pagesën e udhëtimit Madrid Tiranë me vlerë 80 Euro dhe fjetjen në .H H me vlerë 325.34 Euro mungon gjurma e argumentimit të nevojës së lëvizjes (*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar Auditimit*).

6.1 Rekomandimi:

Të merren masa për hartimin e gjurmës rregullatore lidhur me shpenzimet e transportit publik si dhe përdorimit të taksive, nga ana e stafit të misionëve diplomatik dhe konsullorë;

Të merren masa për hartimin e gjurmës së plotë të argumentimit dhe miratimit lidhur me nevojën për kryerje të udhëtimeve;

- Përfaqësia Mynih, të marr masa për plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve;

- Përfaqësinë Athinë, të marr masa për verifikim të vlerës prej **2,509.08 Euro dhe 285.82 Euro** për shpenzime udhëtimi e cila rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.

- Përfaqësia BE - Bruksel, të marr masa për plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve si dhe verifikim të vlerës prej **600.91 Euro**, e cila rezulton e pambuluar me dokumentacion justifikues;

- Përfaqësia Berlin, të marr masa për plotësim të praktikave dokumentare;

- Përfaqësia Londër, të marr masa për verifikim të vlerës totale prej **1,331.25 Paund** Britanik e pambështetur në dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.

- Përfaqësia Madrid, të marr masa për verifikim të vlerës prej **710.5 Euro** si dhe plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve plotësim të praktikës dokumentare për të gjitha rastet e lëvizjeve

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dokumentacionit justifikues mbi mirëmbajtjen e zakonshme rezulton se:

Përfaqësia Paris

- Diferenca prej 45.84 Euro e pajustificuar, analizuar kundrejt dokumentacionit justifikues/mbështetës.

- PAGESA për mirëmbajtje softëare prej 99 Euro, është kryer pa faturë tatimore bashkangjitur, por është faturë e nxjerr nga Microsoft Account/Older History. Ku me shkrim dore “pagesë për mirëmbajtje soft kompjuterik i rrjetit të PC të Ambasadës”.

Përfaqësia Berlin:

Nga auditimi u konstatua se,

- Me Vërtetim shpenzimi nr.20 datë 18.02.2021 është paguar diferenca për rritje qiraje garazhi me vlerë 257.46 Euro; (dokumentacioni mbështetës vetëm në gjermanisht);

- Me Vërtetim shpenzimi nr.10 datë 05.03.2021 është paguar shpenzim për evadim mbeturinash me vlerë 2,900 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);

- Me Vërtetim shpenzimi datë 08.04.2021 është paguar shpenzim për riparim aparati printer HP, me vlerë 127.99 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);

- Me Vërtetim shpenzimi nr.20 datë 19.04.2021 është paguar shpenzim komunale viti 2020, *banesa am Zirkus 5, 10117 Berlin* me vlerë 323.77 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi nr.21 datë 19.04.2021 është paguar riparim i lavamanit të kuzhinës në katin e 5 të përfaqësisë me vlerë 437.18 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 30.04.2021 është paguar shpenzim për riparim të ekranit të tabletit në përdorim të titullarit, me vlerë 584.80 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 05.07.2021 është paguar shpenzim për riparim të sistemit të ujit të ngrohtë në kuzhinën e katit të pestë të përfaqësisë, me vlerë 488.27 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Me Vërtetim shpenzimi datë 26.07.2021 është paguar shpenzim për riparim të lavatrices Tip Bosch, me vlerë 286 Euro; (dokumentacioni mbështetës në gjermanisht);
- Totali i shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme, referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton të jetë 5,405.47 Euro. Sa më sipër, grupi auditimit i është referuar vetëm vlerave dhe urdhër pagesave të cilat janë të hartuara në shqip, dokumentacioni justifikues nuk është audituar për shkak të mungesës së dokumentacionit të përkthyer

Përfaqësia Romë:

- Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion të audituesve të KLSH u konstatua se, totali shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme është në shumën prej 5,202.96 Euro, mirëpo mungonte gjurma e dokumentacionit justifikues për shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme për pajisje zyrash prej 461.32 Euro.

Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi për vitin 2020

Përfaqësia Londër:

Nga auditimi mbi shpenzimet e mirëmbajtjes u konstatua se,

- Nga ana e përfaqësisë janë kryer 3 blerje për qëllime mirëmbajtje të përfaqësisë me vlerë totale 626.26 Paund Britanik;
- Në 2 nga 3 rastet mungonte gjurma e fletë hyrjes në magazinë;
- Mungonte urdhër i titullarit për kryerjen e shërbimit

Përfaqësia Vjenë

- Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi shpenzimet e mirëmbajtjes u konstatua se, për 5 raste pagesash lidhur me këtë zë, në të gjithë rastet mungojnë urdhër pagesat; në 3 raste si pjesë e sistemit të dokumentacionit janë vetëm faturat, me vlerë totale prej 218.57 Euro, si dhe ka mungesë të procesverbaleve të blerjes/shërbimeve dhe mungojnë urdhër pagesat;
- Në total rezultoi një diferencë 50 Euro raportuar më tepër nga ana e përfaqësisë.
(*Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar Auditimit*).

7.1. Rekomandimi:

- *Përfaqësia Paris* të marrë masa për verifikim të vlerës prej **144.84 Euro**, e pa mbështetur në dokumentacionin mbështetës, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues.
- *Përfaqësia Berlin* të marrë masa për mbajtje të dokumentacionit në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për MFK”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-

36 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2

- *Përfaqësia Romë* të marrë masa për verifikim të vlerës prej **461.32 Euro**, e pa mbështetur në dokumentacionin mbështetës, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

- *Përfaqësia Londër* të marrë masa për plotësim të praktikave dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm;

- *Përfaqësia Vjenë* të marrë masa për plotësim të praktikave dokumentare me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje i kryer mbi përfaqësitë diplomatike dhe konsullore rezultuan problematika kryesisht në dokumentacionin justifikues *për procedurat e blerjeve, ku në të gjitha rastet e testuara nuk është ndjekur një procedurë standarde*. Në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Përfaqësia Milano:

Nga auditimi mbi procedurat e blerjeve rezultuan mangësi në dokumentacionin e procedurës së prokurimit.

Përfaqësia Madrid:

Në 2 nga 3 praktikat e shqyrtuara, mungonin faturat e artikujve të blerë apo shërbimeve të marra, me vlerë totale prej 903.34 Euro;

Përfaqësia Paris:

Në 7 nga 8 rastet e analizuara, komisioni që ka nënshkruar procesverbalin e blerjes dhe komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla nuk kanë plotësuar kuorumin me 3 anëtar.

Përfaqësia Mynih:

Për vitin 2021, lidhur me blerjen e artikujve për apartamente banimi në vlerën totale prej 415.80 Euro, mungonin gjurmët dokumentare si të fletë hyrjeve të mallrave në magazinë, ashtu dhe aktet e marrjes së këtyre artikujve në dorëzim.

Përfaqësia Berlin:

Përgjatë vitit 2020, në të gjithë rastet e shqyrtuara nga KLSH, anëtarët e komisionit që kanë nënshkruar procesverbalin e blerjeve janë të njëjtë me ato të përcaktuar në Urdhrin e Brendshëm për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionin e Prokurimit të në vlera të vogla, si dhe nuk është plotësuar kuorumi me 3 anëtar.

Përfaqësia BE Bruksel:

Nga auditimi mbi procedurat e blerjeve rezultuan mangësi në dokumentacionin e procedurës së prokurimit.

Përfaqësia Uashington:

Për vitin 2021 rezultoi se, totali i vlerës së investimeve është në shumën prej 1,596.57 USD, nga 1,969 USD të raportuara në evidencë, me një diferencë prej 372.43 USD me mosrakordim, si dhe komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla nuk ka plotësuar kuorumin me 3 anëtar. Nga auditimi u konstatua se, për vlerën totale prej 415.80 USD që përfaqëson blerje artikujsh për apartamente banimi, mungonin fletë hyrjet e magazinës dhe aktet e marrjes së artikujve në dorëzim. Nga auditimi u konstatua se, referuar kartelës shoqëruese të inventarëve, sipas blerjeve të kryera me Urdhër Prokurimit nr.21/11 datë 05.11.2021, rezulton një diferencë prej 248.71 USD.

Përfaqësia Romë:

Për vitin 2021 nga auditimi u konstatua se:

- Blerja e pajisjeve të akomodimit të apartamentit të banimit për diplomatët, me vlerë 2,320 Euro rezultonte me mangësi në dokumentacionin e procedurës së prokurimit.
- Blerja e pajisjeve të akomodimit të apartamentit 22, referuar Urdhër Pagesës nr.240, datë 28.12.2021 ishte me vlerë 2,080 Euro, kurse referuar faturave shoqëruese të veprimeve rezulton totali prej 1,785.36 Euro, diferencë e pajustificuar me dokumentacion mbështetës prej 294.65 Euro.

Përfaqësia Londër:

Për vitin 2020 nga auditimi praktikës së blerjes, referuar urdhër pagesës nr.20/6, datë 16.12.2020 me vlerë totale 269.99 Euro, konstatohet se, e gjithë praktika e audituar lidhur me periudhën 2020 – 2021 ishte me mangësi në dokumentacion.

Sa i takon fondeve të investimeve, referuar evidencave të vendosura në dispozicion rezultoi se, *së pari* në mbështetje të faturave të disponuara totali i shpenzimeve për investim është 12,455 £ për pajisje zyre, nga 13,825 £ të pasqyruara në tabelat e dërguara në MEPJ; *së dyti*, nga ana e përfaqësisë u konstatua se në pasqyrën e shpenzimeve të Ambasadës Londër, nuk pevidentoheshin shpenzimet për investime të kryera nga zyra konsullore, ndërkohë që kjo zyrë është pjesë integrale e Ambasadës sonë në Londër.

Përfaqësia Neë York:

Nga auditimi dokumentacionit justifikues lidhur me investimet e përfaqësisë rezultoi se,

- Në 6 nga 7 praktika dokumentare të testuara nga audituesit shtetëror të autorizuar, mungonte gjurma e urdhrit të titullarit për ngritjen e komisionit të prokurimit;
- Mungon gjurma e dërgimit të kërkesës dhe marrja e miratimit nga MEPJ;
- Komisioni që ka firmos në procesverbalin e blerjes është i njëjti me komisionin e prokurimit;
- Në 2 raste procedura e testimi të tregut është me parregullsi e shkelje, pasi data e kryerjes së testimi është pas datës së hartimit të procesverbalit të blerjes.

(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: *Nga ana e përfaqësive tona në Milano, në Paris, në Mynih, në Berlin; si dhe nga përfaqësia BE në Bruksel:*

të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2, i ndryshuar si dhe akteve udhëzuese të nxjerra nga ana e MEPJ.

8.2. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësive tona në Madrid, Uashington, Romë:

- Nga ana e përfaqësive respektive, të merren masa për të mbajtur në mënyrë të rregullt dokumentacionet justifikues të pagesave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin nr.26, neni 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë, 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi 34-36, përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, kreu II, paragrafi 2.2, i

ndryshuar si dhe akteve udhëzuese të nxjerra nga ana e MEPJ, si dhe të plotësojnë praktikën dokumentare me të gjithë elementët përkatës, në përputhje me kërkesat e miradministrimit financiar.

- MEPJ në bashkëpunim me përfaqësinë Madrid, të marrë masa për verifikim të vlerës prej **903.34 Euro dhe 36.03 Euro** mbartur prej 2020 pa dokumentacion justifikues, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

- MEPJ në bashkëpunim me përfaqësinë Uashington, të marrë masa për të verifikuar vlerën totale prej **1,565.67 Dollar**;

- MEPJ në bashkëpunim me përfaqësinë Romë, të marrë masa për verifikimin e vlerës prej **2,614.65 Euro**.

8.3. Rekomandimi:

Nga ana e përfaqësisë sonë në Londër:

- Të merren masa që në të gjitha rastet e trajtimit të një blerje si emergjente, autoriteti të vërtetojë, argumentojë dhe dokumentojë se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij;

- Të merren masa për të verifikuar vlerën prej **1,370 £**, e rezultuar si diferencë mes vlerës së faturave të dhe evidencës përmbledhëse, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues në përputhje me kërkesat e miradministrimit financiar.

- Të merren masa për të unifikuar formatet dhe konsoliduar veprimtarinë e përfaqësisë në të njëjtën evidencë përmbledhëse dhe në kuadër të sistemit të raportimit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi:

Referuar evidencave vjetore të fundit (viti 2021) të kryer nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, rezulton se,

Në përfaqësinë në New York:

- Në evidencat e vitit 2021 u konstatua pagesa e shumës prej 29,041.35 Dollar *për broker fees*, por mungonte gjurma justifikuese e saj. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10, germa ç, e VKM nr.20, datë 18.01.2017);

- Vlera prej 2,952 Dollar, paguar për qëndrimin në Hotel K. të grupit të auditit të MEPJ nuk ka faturë bashkangjitur (prania vetëm e Urdhër Pagesës);

- Pagesa prej 2,104.55 Dollar pasqyron biletën e avionit dhe shtesë në të, për udhëtim në Nice (Francë), ku mungojnë bashkëlidhur agjenda dhe programi i veprimtarisë. Nga auditimi dokumentacionit të lëvizjes rezulton të jetë udhëtim personal.

Në përfaqësinë BE-Bruksel,

- Pagesa për hotel me vlerë 395.48 Euro, nuk ka gjurmë të pranisë së dokumentit justifikues (*faturë hoteli*), si dhe nga auditimi nuk konstatohet prania e gjurmës së agjendës së veprimtarisë apo argumentim i vizitës;

- Pagesa për hotel me vlerë 81.88 Euro, nuk ka gjurmë të pranisë së dokumentit justifikues (*faturë hoteli*), bashkangjitur është rezervimi në *booking* i cili është fotokopje e pjesshme;

- Nga 51 urdhër pagesa të audituara, 35 ishin pa vlerë të specifikuar për pagesë dhe vetëm 16 me vlerë ekonomike të specifikuar për tu paguar;

- Në pagesën me vlerë 310.96 Euro, për blerje produkte ushqimore për pritje të doktorëve në Mision, fatura bashkangjitur lëshuar nga “D.” është e pjesshme, nuk ka datë, përmban vetëm vlerën totale prej 310.96 Euro dhe artikujt e pjesës së faturës fotokopjuar bashkangjitur janë vetëm 11 copë me vlerë 39 Euro.

Në përfaqësinë Milano,

- Për biletën me vlerë 99.98 Euro prerë për itinerarin Budapest – Milano nuk ka informacion se për cilin person është prerë kjo biletë; Pagesa 134 Euro nuk arrin të identifikohet produkti apo shërbimi i marrë; Pagesa prej 947.63 Euro nuk identifikohet se për cilin person është kryer pagesa pasi ka mungesë dokumentacioni;

- Për biletat e avionit, fatura me vlerë 28.846 all për itinerarin Tiranë - Bergamo, nuk është e shoqëruar me një argumentim të personave që po udhëtojnë dhe arsyet e udhëtimit.

- Për biletat e avionit, fatura me vlerë 79 Euro për itinerarin Milano - Tiranë, nuk është e shoqëruar me një argumentim të personave që po udhëtojnë dhe arsyet e udhëtimit;

- Pagesa e faturës prej 192.8 Euro total, për itinerarin Milano-Santiago-Milano nuk ka një argumentim të arsyes së lëvizjes si dhe të pozicionit/statusit të personit që kryen këtë udhëtim.

Në përfaqësinë Athinë,

- Nga auditimi rezultoj se, *shpenzimet imobiliare* janë kryer për apartamentin e përfaqësuesit diplomatik në vlerën 1,488 Euro. Fatura dhe dokumentacioni mbështetës ishin në greqisht duke mos patur dublikatë në gjuhën shqipe.

- Kryerja e procedurave për sigurimin e ambientit të banimit nëpërmjet një zyre imobiliare është në kundërshtim me bazën ligjore e rregullative në fuqi, e cila ngarkon me përgjegjësi MEPJ për kryerjen e analizës së tregut dhe gjetjen e ambienteve të përshtatshme për përfaqësuesit. Nga ana tjetër kjo pagesë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore, e cila ngarkon MEPJ me kryerjen e analizës së tregut të pasurive të paluajtshme (pika 10, gërma ç, e VKM nr.20 datë 18.01.2017).

Në përfaqësinë Romë,

- Lidhur me pagesën 435 Euro hotel nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, mungon fatura e hotelit;

- Lidhur me pagesën 386.60 Euro transferim për znj.Sh.Sh u konstatuan mungesë e dokumentacionit justifikues të nevojës së kryerjes së këtij udhëtimi. Referuar listës së përbërjes së përfaqësive vendosur në dispozicion nga DBNj e MEPJ, rezulton se personi në fjalë gjatë kësaj periudhe ka qenë emëruar në Romë dhe fatura e hotelit është po në këtë qytet.

- Lidhur me pagesën 2,648.50 Euro mungon argumentimi arsyes së udhëtimit; Referuar VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 9, germa c, dhe lidhja 1 “masa e dietës në valutë të huaj sipas kategorive” rezulton se, i përket kategorisë 7 ku hoteli është deri me 3 yje dhe jo 4 sikundër është paguar. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 84-88, të Projekt Raportit të Auditimit*).

Në përfaqësinë Londër

- Lidhur me pagesën 910 GBP mungon gjurma e faturave elektronike (pa statement të pagesës), vetëm me praninë e një emaili për vlerën e pagueshme;

Në përfaqësinë Washington

- Lidhur me pagesën 669.13 USD për të njëjtin shërbim janë mbajtur dy urdhër shërbime të plotësuara ndryshe, me datat dhe hotelin njësoj, përkatësisht 18.11-20.11.2021;

Në përfaqësinë Podgoricë

- Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk është i identifikueshëm dhe i kuptueshëm. Nga ana e përfaqësisë është operuar duke vendosur faturat (të cilat janë për total shpenzimi dhe jo detajuar zërat) mbi procesverbale dhe fotokopjuar mbi njëra tjetrën duke e bërë të pamundur kuptueshmërinë e informacionit që përmban.
(Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi:

Në lidhje me Përfaqësinë Neë york, të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **29,041.35 USD** për *broker fees*, paguar në kundërshtim me VKM nr.20, datë 18.01.2017, pika 10, germa ç, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar dhe konfirmuar vlerën prej **2,952 USD**, paguar për qëndrimin në Hotel K. të grupit të auditit të MEPJ-së, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **2,104.55 Dollar**, biletë avioni dhe shtesë në të, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Përfaqësia BE-Bruksel, të marr masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **395.48 Euro** pagesa për hotel, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej 81.88 Euro pagesa për hotel kryer, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **271.96 Euro**, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Milano, të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **99.98 Euro** prerë për itinerarin “Budapest – Milano”, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **134 Euro** për të cilën nuk arrin të identifikohet produkti apo shërbimi i marr, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **947.63 Euro** nuk arrin të identifikohet se për cilin është paguar, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **28.846 all** për itinerarin Tiranë Bergamo, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **192.8 Euro** total, për itinerarin Milano-Santiago-Milano, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Athinë, të marr këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën prej **1,488 Euro** pagesë e kryer për agjenci imobiliare, si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Lartë të Arkivave, nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e

“Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, pika 9, neni 4.

Në lidhje me Përfaqësinë Romë, të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej **3,470.1 Euro** si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Londër të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej **910 GBP** si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Përfaqësia Uashington të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar vlerën totale prej **669.13 USD** si dhe plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës justifikues;

Në lidhje me Përfaqësinë Podgoricë të marrë këto masa:

- Nga ana e MEPJ-së të merren masa për të verifikuar dokumentacionin justifikues për ra trajtohet në raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi përfaqësinë diplomatike Vjenë u konstatua se, 2 automjetet e përfaqësisë të cilat janë në inventar të ambasadës, janë çregjistruar dhe mbahen në parkim, (respektivisht automjeti *Mercedes Benz dhe Citroen*), ku pagesa mujore e parkimit të secilës është 58 Euro për makinë, për vit shkon në **1,392 Euro**.

Nga auditimi u konstatua se, 2 automjetet të cilat aktualisht nuk përdoren, kanë kosto të larta mbajtje të tyre, konkretisht referuar të dhënave të vendosura në dispozicion, (komunikimi shkresor me MEPJ) prej **4,385.87 Euro në vit**. (Trajtuar më hollësisht në faqe 82-178, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi:

- Nga ana e përfaqësisë të kryhet analiza kosto përfitim dhe të gjykohet për vijueshmërinë duke patur në konsideratë menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

- Të kryhet analizimi i këtyre situacioneve/ faturave dhe pagesave të bëra në vlerën prej **4,385.87 Euro**, duke kërkuar argumentimin e nevojave dhe nxjerrjen e përgjegjësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

KONTROLLI LARTE I SHTETIT